

RREGULLA RRETH TEKFIRIT



THIRRJAISLAME 

Autor:

AbdulMunim Mustafa Halime
(Ebu Basir Tartusi)

Rregulla rreth tekfirit

Autor

Abdulmunim Mustafa Halime

(Ebu Basir Tartusi)

Përktheu:

Florian Leli

Botimi elektronik i parë 2014

© Të gjitha të drejtat e librit janë të rezervuara për përkthyesin. Nuk lejohet shumëfishimi apo botimi i librit për qëllime përfitimi me çdo mjet apo formë pa leje me shkrim të përkthyesit.

Me të gjitha shprehjet në këtë libër ku thuhet: fjala e Allahut apo Allahu ka thënë, kihen për qëllim ajetet në gjuhën arabe ashtu siç janë në Kuranin e ndritur. Ndërsa përkthimi i ajeteve në gjuhën shqipe është një mund njerëzor i mangët dhe i papërkryer sepse përsosmëria i takon vetëm Allahut.

Ajetet e përkthyer në gjuhën shqipe, nuk janë fjale të Allahut në realitet, por një përcjellje e kuptimeve të fjalës së Allahut me përafërsi, sepse ajetet kuranore Allahu i ka folur vetëm në arabisht.

Shënim

Duhet ditur se gjyqimi me iman dhe kufër për diçka ose për dikë është një çështje fetare e rëndësishme dhe të folurit pa dije dhe pa siguri shkakton pasoja të padëshiruara dhe të rrezikshme në dynja dhe ahiret.

Atë që gjykon me kufër ose me iman për diçka ose për dikë, e këshilloj që përpara se të gjykojë ose të mbajë qëndrim, të mbledhë të gjitha rregullat që lidhen me kufirin dhe imanin. Ai duhet të ketë dije të mjaftueshme rreth këtyre rregullave dhe të mos nënvlerësojë asnjërin prej tyre, sepse ajo që është e pakufizuar në një rregull mund të jetë kufizuar në një rregull tjetër dhe ajo që është kufizuar në një rregull mund të jetë përgjithësuar në një tjetër. Ose një rregull mund të pengojë zbatimin e një rregulli tjetër në varësi të çështjes rreth së cilës duam të gjykojmë. Gjithashtu ajo që mund të jetë e paqartë ose e përshtatshme shkurtimisht në një rregull sqarohet hollësisht nëpërmjet një rregulli tjetër.

Shumica e atyre që gabojnë në çështjet e kufirit dhe imanit gabojnë për shkak se përqëndrohen në 2-3 rregulla të tekfirit duke anashkaluar rregulla të tjerë të cilat mund t'i japin një prizëm tjetër çështjes. Kjo metodë i çon këta njerëz ose në ekstremitet dhe shtrëngim ose në irxha dhe nënvlersim.

Ë theksojmë edhe njëherë se për evitimin e këtyre devijimeve duhet punuar me të gjitha rregullat e tekfirit të përmendura në këtë libër duke i bashkuar me njëra-tjetrën dhe pa refuzuar apo anashkaluar asnjërin prej tyre dhe e lus Allahun të na ndihmojë.

Shejh Ebu Basir Tartusi

**Drejtuar vëllezërve të mi musliman
në trevat shqipëtare ... Allahu i ruajt.**

Es selamu alejkum ue rrahmetullahi ue berekatuhu!

Dijeni _Allahu ju ruajt_ se e vërteta qëndron në mes të egzagjerimit dhe të neglizhimit, në mes të ekstremizmit dhe anashkalimit dhe irxhasë. Shejtani përpiket gjithmonë të depërtojë te njeriu nëpërmjet dy shtegjeve. Ose ndjek shtegun e teprimit dhe të ekstremit dhe të shtrëngimit, e nëse nuk ia del mbanë atëhere mundohet ti orvatet atij nga shtegu i tolerimit dhe irxhasë; me cilindo që ti ecë puna ai gëzohet, sepse në të dyja këto metoda humben shumë të drejta në aspektin fetar, në dallim nga pasuesit të së vërtetës dhe të së mesmes, të cilët ecin në rrugën e sunetit dhe në të mesmen të cilën Allahu e ka zgjedhur dhe e ka pëlqyer për robtë e tij.

Allahu ﷻ thotë: **﴿Kështu ju bëme juve një umet të mesëm﴾** pra të mirë dhe të drejtë. U përshkruan me këto virtyte sepse ata nuk anuan as nga ekstremizmi i tepruar dhe as nga anashkalimi dorëlëshues, por ishin të mesëm në çdo çështje të fesë së tyre, **﴿që të jeni dëshmitarë për njerëzit﴾** sepse kush anon nga dy skajet e teprimit dhe të dorëlëshimit, ai e ka humbur veçorinë e drejtësisë dhe të paanshmërisë, prandaj dhe nuk mund të shërbejë si dëshmitar dhe gjykues për njerëzit e tjerë.

Allahu ﷻ thotë: **﴿Kjo është rruga ima e drejtë, prandaj ndiqeni atë dhe mos i ndiqni rrugët e tjera e të ndaheni prej rrugës së tij. Me këtë ju ka porositur që të ruheni﴾** El enam 153. Rruga e drejtë, të cilën u urdhëruam ta pasojmë është e vërteta e mesme, ndërsa rrugët e tjera të cilat degëzohen nga rruga e drejtë sa majtas djathtas, të cilat jemi urdhëruar t'i shmangemi, ato janë degëzimet e teprimit dhe të anashkalimit, rrugët e tekjkalimit ekstrem dhe irxhasë neglizhuese. Të gjitha këto rrugë janë prej rrugëve të shejtanit. Allahu na ruajt prej tyre dhe na udhëzofte në rrugën e drejtë, **﴿Na udhëzo në rrugën e drejtë﴾** El fatiha 6. Amin.

Libri që keni në dorë “Rregulla rreth tekfirit” është një përpjekje për vendosur rregullat dhe bazat e një menhexhi të mesëm në çështjet e dispozitave, të kufrit dhe të imanit. Ju këshillojmë ta lexoni të gjithë atë, sepse ky libër është prej atyre lloj librash që nuk pranojnë përpjestim apo copëtim. Nuk duhet që të lexohet një pjesë dhe të lihet një pjesë tjetër, sepse edhe rregulli i parë prej këtyre rregullave ka lidhje me rregullin e fundit dhe në mënyrë që lexuesi të kuptojë rregullin e fundit, duhet të ketë lexuar rregullin e parë, dhe e anasjellta është e vërtetë. Pra këto rregulla shpjegojnë dhe sqarojnë njëra-tjetrën.

Pregulla rreth tekfrit

Në mbyllje falenderojmë vëllezërit e nderuar që përgatitën këtë libër të rëndësishëm në gjuhën shqipe, sepse udhëzuesi të një e mirë është njësoj si vepruesi i saj dhe në shpërblim ata janë njësoj. Allahu i shpërbleftë me gjithë të mirat.

Ue selamu alejkum ue rrahmetullahi ue berekatuhu.

Vëllai juaj

Abdulmunim Mustafà Halime

Ebu Basir Tartusi

24.4.1435 h - 24.2.2014

www.abubaseer.bizland.com

www.altartosi.net

PARATHËNIE

Falenderimi i takon Allahut. Atë e falenderojmë dhe vetëm prej tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje prej Allahut prej të keqes së veteve dhe punëve tona. Atë që e udhëzon Allahu nuk ka kush e humbet dhe atë që e humbet nuk ka kush e udhëzon.

Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut një dhe të vetëm dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguari i tij.

﴿O ju që keni besuar ruajuni Allahut me të vërtetë dhe vdisni vetëm si musliman﴾ Ali Imran 102.

﴿O njerëz! Ruajuni prej zotit tuaj i cili ju ka krijuar ju prej një vete të vetme dhe krijoi prej tij gruan e tij dhe nxorri prej tyre shumë burra dhe gra. Ruajuni prej Allahut me emrin e të cilit po kërkonit dhe tregohuni të kujdesshëm për farefisnisë sepse Allahu ju vështron ju﴾ En nisa 1.

﴿O ju që keni besuar! Ruajuni Allahut dhe thoni fjalë të goditur që t'ua drejtojnë punët tuaja dhe t'ua falë gjynahet. Ai që i bindet Allahut ka fituar me një fitore të madhe﴾ El Ahzab 70-71.

Në vijim themi:

Fjala më e vërtetë është libri i Allahut ﷻ. Udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit ﷺ. Gjërat më të këqija janë shpikjet dhe çdo shpikje është bidat dhe çdo bidat është humbje dhe çdo humbje është në zjarr.

O Allah! O Zot i Xhibrilit, Mikailit dhe Israfil! O Krijues i qiejve dhe i tokës! O Dijës i të fshehtës dhe të shfaqurës. Ti gjykon mes robërve të tu për kundërshtimet ku ata kanë rënë. Na udhëzo për të vërtetën ku janë kundërshtuar me lejen tënde sepse ti e udhëzon kë dëshiron në rrugën e drejtë.

Nëse vështrojmë realitetin e shumë njerëve kemi për të gjetur se ata në jetën e tyre fetare dhe në jetën e dynjasë anojnë ose për në ekstremizëm dhe shtrëngim ose në neglizhim dhe anashkalim dhe rrallëherë e gjen të mesmen mes tyre. Mirëpo kjo e mesme në umetin islam nuk mund të zhduket sepse ajo do vazhdojë _me lejen e Allahut_ derisa e vërteta të ekzistojnë në mesin e njerëzve deri në ditën e gjykimit.

Dukuria e ekstremizmit në tekfir është rishfaqur në kohën tonë gjerësisht. Kjo dukuri i shpall njerëzit qafirë dhe cënon të drejtat e tyre padrejtësisht dhe pa u bazuar në rregullat dhe bazat e tekfirit.

Kjo i shtyu këta njerëz, me dashje apo padashje, të qëndrojnë nën tendën dhe flamurin e havarixhëve të parë dhe të antarësohen në grupin dhe varganin e tyre të zi. Havarixhët u bazuan në dyshime dhe e lanë atë që ishte e sigurtë, u bazuan në injorancë dhe i shpallën njerëzit qafirë për shkak të gjynaheve të cilat nuk e arrijnë gradën e kufrit të madh. Pastaj nxorrën rregulla rreth miqësisë dhe armiqësisë duke cënuar të drejtat e muslimanëve pa asnjë argument prej Allahut.

Këtyre njerëzve u shkon për shtat fjala e profetit ﷺ: **“I vrasin pasuesit e islamit dhe i lënë idhujtarët. Nëse do t’i arrij kam për t’i vrarë ashtu siç u vra Adi”**,¹ dhe fjala e profetit ﷺ: **“Në fundin e kohës do të shfaqet një grup njerëzish dhëmbënjomë², budallenj që ëndërrojnë. Flasin me fjalët më të mira të krijesave. Imani i tyre nuk i kalon fytyrës së tyre. Dalin prej fesë ashtu siç del shigjeta prej harkut. Kudo që t’i gjeni vritini sepse në vrasjen e tyre ka shpërblim në ditën e gjykimit për atë që i vret”**. E transmeton Buhariu.

Ibn Umeri thoshte për ta: **“I morrën disa ajete që kanë zbritur për qafirët dhe i zbatuan te muslimanët”**. E transmeton Buhariu.

Në anën tjetër gjejmë hizbin e xhehmive dhe murxhive; hizbin e nënvlersimit dhe neglizhimit, ata që hiqen si të mbështetur dhe thonë: gjynahet nuk ndikojnë pas besimit aspak dhe ai që thotë “La ilahe il-lallah” do të hyjnë në xhenet sido që të jenë veprat e tij.

Ata i gjykuan njerëzit sipas emrave dhe prejardhjes muslimane, pa i kushtuar rëndësi akides dhe veprave të tyre. Sipas tyre nëse njeriu emrin e ka Ahmed apo Halid, apo posedon një certifikatë ku dëshmohet se është musliman, atëhere konsiderohet musliman në dunja dhe ahiret, martohet me muslimane dhe i jepen të drejtat dhe përgjegjësitë e muslimanëve dhe nuk ndikon pastaj nëse është komunist apo laik që e urren islamin dhe muslimanët, e shan Allahun dhe fenë për gjërat më të vogla, apo prej atyre që e luftojnë Allahun dhe të dërguarin e tij dhe nuk i frikësohen Allahut për të drejtat e besimtarëve. Sipas tyre gjynahet dhe kufri nuk ndikojnë nëse ai ka emër dhe certifikatë muslimane.³

¹ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

² “Dhëmbënjomë” ka për qëllim të rinj që nuk janë pjekur akoma.

³ Ndalë pak dhe vështro! Vallë a ke dëgjuar që të jetë ndarë burri nga gruaja për shkak të riddes të njërit prej tyre kur dihet që shoqëria jonë është e mbushur plot me murtedë, zindikë dhe laik?! Në shoqërinë tonë ajo grua që kërkon ndarje për shkak se burri është bërë murted, akuzohet si e çmëndur dhe mbase mund të dënohet edhe me burg. E gjitha kjo ndodh për shkak të xhehmive dhe murxhive të cilët kanë gjetur përkrahje të madhe prej tagutëve të gjykimit.

Rreziku i murxhiave, sidomos në këtë kohë, nuk konstiston në disa çështje teorike ku kanë kundërshuar ehlisunetin dhe xhematin. Sikur çështja të ishte vetëm teorike nuk do të e merrnim mundimin të replikonim me ta. Por këto çështje kanë ndikim në jetën dhe aktualitetin e njerëzve, në mënyrën e adhurimit të zotit, në mënyrën si sillen me vetet dhe në mesin shoqësisë së tyre.

Për shkak të medhhebit të xhehmive dhe murxhive, ke për të gjetur shumë të rinjë prej këtij umeti që e konsiderojnë të mirë punën si ushtarë dhe spiunë të tagutëve zullumqarë të gjykimit. Nuk tuten as prej spiunimit të besimtarëve dhe njësuesve për hesap të tagutëve mizorë, duke u justifikuar me faktin se ata janë

Ajetet e zbritura për besimtarët njësuës dhe argumentat e thëna për njësuësit gjynahqar, ata i zbatuan për qafirët e dalë nga feja, për zindikët laikë dhe tagutët mizorë, duke i konsideruar ata si besimtarë gjynahqarë.

Ata e vranë umetin, Allahu i vraftë! E dobësuan atë duke i ushqyer dashurinë e dunjasë dhe urrejten e vdekjes. Pasardhësve të umetit u lanë për trashëgimi shpirtin e nënvleftësimit dhe të braktisjes së punës, derisa kur u krijuan kushtet për braktisjen e ligjeve të Allahut dhe zëvendësimin me ligjet e tagutit, u frynë në vesh se: “Kjo çështje nuk është më shumë se një gjynah ose kufër i vogël dhe nuk është si ai kufri që ju po kujtoni”. Kështu i inkurajuan për kufirin e qartë, me dije apo padije.

Namazin, shtyllën e islamit, gjënë e fundit që humbet prej fesë, me humbjen e tij humbet edhe feja, për të cilin i dërguari ka gjykuar se është kufër dhe shirk dhe dalje prej milletit islam, ata e morrën për diçka të lehtë, sepse namazi është punë dhe debatuar aq ashpër saqë njerëzit e morrën për të lehtë braktisjen e tij, derisa braktisja e tij u bë veti e shumë njerëzve.

Ata u thanë njerëzve: Mos u shqetësoni! Ky lloj kufri është në vepra dhe kufri në vepra nuk arrin në gradën e kufrit që ju kujtoni, sepse është vetëm kufër i vogël. Kështu e zgjeruan, pa dije dhe pa argument, diapazonin e kufrit të vogël në vepra duke futur në një thes me të edhe kufirin e madh bashkë me kokat e kufrit të qartë.

Ata devijuan kur i pakësuan gjërat që e prishin teuhidin dhe i shpjeguan ato me një gjë të vetme: Konsiderimin hallall ose mohimin me zemër. Konsiderimi hallall që të çon në kufër sipas tyre është konsiderimi hallall me zemër, ndërsa çdo dëshmi tjetër në vepra të qarta që dëshmojnë për kënaqësinë dhe konsiderimin hallall, mohimin apo atë që fshihen në brendësinë e tyre nuk e marrin parasysh. Këtu dera e keqinterpretimeve është hapur me të dy kanatat dhe fusha e justifikimeve të kota mund të përfshijë edhe tagutët më të mëdhenj të tokës.

Kështu i shtynë njerëzit për lënien e veprave të mira dhe të bëjnë një jetë vetëm me iluzione, plot me siguri se në fund të fundit e kanë një thërmijë iman **﴿A mos vallë u siguruan prej kurdisjes së Allahut! E kush tjetër përveç popullit të humbur sigurohet prej kurdisjes së Allahut﴾** El araf 99.

Padyshim se të dy këto grupe; egzagjeruesit dhe grupi i irxhasë, janë në humbje dhe në rrezik të madh për fenë e tyre. Ashtu si tekfiri i muslimanëve me supozime, padije dhe pa argumente, i kthehet mbrapsht pretenduesit, ashtu edhe moskonsiderimi qafir i qafirët ose dyshimi në kufirin e tij, e çon këtë person në kufër dhe dalje prej islamit.¹

sundimtarë të ligjshëm prandaj dhe bindja e dashuria e tyre kundër atyre që i kundërshtojnë është detyrë, ashtu siç i kanë mësuar shujuhat e murxhive; Allahu i gjykoftë ashtu siç e meritojnë.

¹ Kjo çështje ka rregullat e veta siç do shpjegohet në vijim.

Parandalimi prej shkarjes në këto grupe bidati është vetëm dija e dobishme. Padyshim se teuhidi, i cili i mëson robit rreth krijuesit dhe rreth emrave dhe cilësive të tij, është dija më e rëndësishme, më e obligueshmja dhe më e larta. Teuhidi i mëson robit të drejtën e Allahut ﷻ ndaj tij, i mëson imanin, kushtet e tij, nevojat e tij, shkaqet që e shtojnë, të cilat përpiqet t'i kryej, i sqaron shirkun dhe atë që të çon në shirk për t'u distancuar prej tij dhe pasuesve të tij.

Ai që nuk e njeh teuhidin, mund të sulmohet dhe të mashtrohet lehtësisht, sepse nuk është i mbrojtur prej rënies në kurthet e shirkut dhe kufrit, ose prej ndihmimit të zullumqarëve. Sepse ai që e nuk e njeh diçka është njësoj si ai që nuk e posedon atë dhe ai që nuk e posedon diçka nuk mund ta japë atë.

Ai që nuk e zotëron teuhidin nuk ka qëndrueshmëri dhe as nuk i pranohen adhurimet dhe veprat e tij sado që të përkushtohet në kryerjen e tyre. Prandaj i duhet kushtuar shumë rëndësi teuhidit dhe gjëja e parë që duhet të kryej një musliman është përvetësimi i tij dhe nxitimi për plotësimin e tij tërësisht, duke e studiuar atë me argumente prej Kuranit dhe sunetit, ashtu siç e kanë kuptuar të parët e këtij umeti. Kërkuesi i teuhidit duhet të largohet prej metodës së kelamistëve dhe bidatçive të cilët kanë humbur rrugën, megjithëse kujtojnë se po veprojnë mirë.

Allahu i lartësuar thotë: **﴿Dije se nuk ka asnjë ilah përveç Allahut﴾** Muhamed 19.

Prej Xhundub ibn Abdullahit ؒ thotë: **“Kur ishim me profetin djelmosha e mësuam imanin _dmth teuhidin_ përpara se të mësonim Kuranin dhe kur e mësuam Kuranin na e shtoi imanin”**.¹

Ky kërkim të cilin e kam titulluar **“Rregulla rreth tekfirit”**, është një kërkim serioz për udhëzimin në rrugën e mesme dhe të vërtetë islame, të dy kaheve të tejkalimit dhe neglizhimit. Ai është ndihmues për këdo që synon të vërtetën në çështjet e teuhidit, kufrit dhe imanit.

Në këtë kërkim kam përmendur katërmbëdhjetë rregulla rreth tekfirit dhe në fund të disa rregullave kam vendosur një shtojcë ku u jam përgjigjur disa pyetjeve të rëndësishme që lidhen me këtë temë dhe me këtë libër, pyetje të cilat janë të paqarta për shumë njerëz.

E pranoj që është udhë e vështirë dhe e gjatë, plot me rreziqe vrasëse dhe torba e udhëtimit është e pakët. Sikur të mos ndieja që kërkimi në këtë temë të rëndësishme është i domosdoshëm dhe njerëzit kanë nevojë për të, nuk do ta merrja guximin për të shkruar. Shpresoj prej Allahut të lartë të më ndihmojë dhe udhëzojë. Nëse gaboj, gaboj prej vetes dhe për shkak të shejtanit dhe i kërkoj falje Allahut ﷻ dhe pendohem te ai, e nëse ja qëlloj ajo është vetëm prej Allahut ﷻ dhe e gjithë mirësia i takon vetëm atij, **﴿Udhëzimi im është vetëm prej Allahut. Atij i mbështetem dhe te ai pendohem﴾** Hud, 88.

¹ Sahihu i sunen Ebi Maxheh, 170.

Salati dhe selami qofshin mbi profetin Muhamed dhe mbi familjen dhe shokët e tij.

E shkroi:

Abdul Munim Mustafà Halime

4. Sefer. 1415 h.

Ebu Basir Tartusi

13. 6. 1994 h.



HYRJE

Terma dhe kuptime që lidhen me kërkimin.

Për kuptimin e rregullave të tekfirit duhet patjetër të shpjegojmë disa kuptime dhe terma shariatike që lidhen me këtë temë:-

Kufri.

Së pari: Kuptimi gjuhësor.

Kufri _në gjuhën arabe_ është mbulimi i diçkaje. Për çdo gjë që mbulon diçka tjetër përdoret folja “*Kefere*”. Kështu për bujkun përdoret fjala “*Kafir*” sepse ai e mbulon farën me dhë.

Allahu ﷻ thotë: **«Si shembulli i shiut që buiqëve u pëlqejnë bimët që mbijnë prej tij»** El hadid 20. Fjala “*kuf-far*” e përdorur në këtë ajet nënkupton bujqit.

Edhe qafiri quhet kështu sepse ai mbulon dhe mohon mirësitë e Allahut ﷻ.

Zuhriu thotë: “*Mirësitë e Allahut ﷻ janë ajetet (dëshmitë, argumentet) që dëshmojnë për teuhidin e tij. Mirësitë të cilat qafiri i ka mohuar janë ajetet që dëshmojnë për të logjikshmin _se krijuesi i tij është një i vetëm dhe i pa shok. Prej këtyre mirësive është edhe dërgimi i profetëve me ajete të pakontestueshme, me librat e shpallur dhe argumente të qartë. Kushdo që nuk i beson këto mirësi dhe i mohon ato, ai u ka bërë **kufër** mirësive të Allahut, dmth i ka fshehur dhe mbuluar këto mirësi prej vetes së tij*”.¹

Së dyti: Kuptimi terminologjik.

Në kuptimin terminologjik, kufri është e kundërta e imanit, pra kufri me Allahun ﷻ dhe mirësitë e tij. Kufri në shariat klasifikohet në dy lloje: Kufër i madh dhe kufër i vogël.

1- Kufri i madh është kufri i cili e privon vepruesin e tij prej cilësimit si musliman dhe pasues të islamit. Me fjalë të tjera ai është kufri i cili e nxjerr vepruesin e tij prej islamit dhe largon prej tij mbrojtjen dhe të drejtat e islamit. Në dynja gjykohet me dispozitat e kufrit nëse në origjinë ka qënë qafir, ose me dispozitat e riddes nëse kufirin e ka vepruar pas islamit.

Ndërsa në ahiret përfundimi i tij është i keq, dënimi i tij do të jetë zjarri i xhehenemit

¹ Lisanul arab.

dhe nuk i bën dobi ndërmjetësimi i askujt.

Kufri i madh ka të njëjtin kuptim si kufri i besimit (kufrul itikad) dhe si kufri i qartë (kufrul beuah). Me këto dy fjalë, kudo që të përdoren nënkuptohet kufri i madh dhe domethënia e tij ose anasjelltas.

Shëmbuj për këtë lloj kufri nga Kurani:-

Ajetet që dëshmojnë për këtë lloj kufri janë të shumta, prej tyre:-

﴿E atë që bën kufër e lë që të dëfrehet pak dhe pastaj e hedh në dënimin e zjarrit dhe ai është përfundim i keq﴾ El bekare, 126.

﴿Kanë bërë kufër ata që thanë: Allahu është mesihu i biri i Merjemes﴾ El maide, 17.

﴿Kanë bërë kufër ata që thanë: Allahu është i treti prej të treve﴾ El maide, 73.

﴿Ata që bënë kufër dhe i përgënjeshtroan ajetet tona ata janë banorët e zjarrit e në të do të jenë përgjithmonë﴾ El bekare, 39.

Allahu ﷻ thotë: ﴿Ata që bënë kufër dhe vdiqën qafirë mbi ta qoftë mallkimi i Allahut, i melekëve dhe i të gjithë njerëzve. Në të do të jenë të përhershëm. As nuk u lehtësohet dënimi dhe as nuk u jepet afat﴾ El bekare, 161-162.

E shumë ajete të tjera që dëshmojnë për këtë lloj kufri i cili të nxjerr prej islamit.

Shëmbuj prej haditheve:-

Prej Ubade ibn Samit ؓ thotë: *“Na thirri profeti ﷺ dhe ia dhamë besën. Prej asaj që i dhamë besën ishte: Dëgjimi dhe bindja për atë që na pëlqen dhe atë që nuk na pëlqen, në vështirësi dhe lehtësi dhe në varfëri, dhe të mos ua rrëmbejmë sundimin atyre që sundojnë përveçse nëse shohim kufër të qartë, për të cilin kemi argument prej Allahut”.*¹

Kufri i qartë (el kufrul beuah) nënkupton kurfin e madh që të nxjerr prej milletit islam, dhe ky lloj kufri ndahet në disa degë:

- Kufër kryeneçësie.²
- Kufër përgënjeshtrimi.³

¹ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

² Zakonisht një person i tillë e di të vërtetën dhe e pohon me gjuhë, mirëpo nuk e pranon prej kryeneçësisë dhe as nuk i dëshmon dy dëshmitë e islamit, si kufri i Ebu Talibit dhe atyre që i përngjasojnë atij, siç thotë Allahu: ﴿Hidheni në xhehenem çdo qafir kryeneç﴾ Kaf, 24 dhe thotë: ﴿Jo! Ai ishte kryeneç ndaj ajeteve tona﴾ El mudethir, 16.

³ Ai i cili e mohon me zemër dhe me gjuhë krijuesin, ditën e gjykimit, profetët dhe gjëra të tjera. Të tillë janë ateistët, komunistët, dhe sorollapi i tyre. Për këtë lloj kufri Allahu ﷻ thotë: ﴿E dinë mirësinë e Allahut dhe pastaj e mohojnë atë dhe shumica e tyre janë qafirë﴾. En nahl, 83.

- Kufër mëndjemadhësie.¹
- Kufër mohimi.
- Kufër nifaku (dyfytysie).²
- Kufër përgënjeshtimi dhe lejimi.³
- Kufri i urrejtjes.⁴
- Kufri i fyerjes dhe talljes.⁵
- Kufri i refuzimit dhe kthimit të shpinës.⁶

Kush konsumon ndonjë lloj nga këto lloje të kufrit, ose një vepër nga këto vepra, atëhere ai është qafir me kufër të qartë që të nxjerr prej islamit. E nëse vepron disa lloje ose disa prej këtyre veprave, atëhere ai është kufër më i madh dhe më i ndërlikuar, sepse kufri

¹ Mëndjemadhësia përngjason me kryeneçësinë, sepse shkak i kufrit në këtë rast është inati dhe mëndjemadhësia. Këtë lloj kufri e ka vepruar Iblisi i mallkuar dhe pasuesit e tij prej tagutëve të cilët pasi e panë se islami barazonte mes tyre dhe mes muslimanëve të dobët dhe të varfër, e konsideruan këtë si cënim të nderit të tyre dhe i shpallën islamit armiqësi. Këta njerëz kërkonin prej të dërguarve t'i dëbonin muslimanët e varfër si kusht për të pasuar islamin, siç thotë Allahu ﷻ për ta: **«Thanë: A të besojmë ty kur të kanë pasuar vetëm të ultët. U tha: E si ta di unë për atë që kanë punuar. Llogaria e tyre i takon vetëm zotit tim sikur ta dini dhe unë nuk kam për t'i dëbuar besimtarët»** Esh shuara, 114.

² Ky lloj kufri ndodh kur e fshih kufirin në zemër dhe e shfaq islamin në vepra. Për këtë Allahu ﷻ thotë: **«Munafikët janë në thellësitë më të ulta të zjarrit»** En nisa, 145 dhe thotë: **«Allahu u ka premtuar munafikëve dhe munafikeve dhe qafirëve zjarrin e xhehenemit, të përhershëm janë në të, ai u takon atyre dhe Allahu i ka mallkuar dhe ata kanë dënim të përhershëm»** Et teube 68.

³ Këtë lloj kufri e bën ai i cili i merr për të lejuara ato gjëra që Allahu ﷻ i ka bërë haram. Për këtë lloj kufri nuk ka kundërshtim sepse ai e ka bërë veten e tij rival me Allahun ﷻ dhe ka vendosur dispozita duke rivalizuar sheriatin e Allahut ﷻ dhe gjithashtu ka përgënjeshtuar atë që e ka ligjësuar Allahu. Allahu thotë: **«Por ata që kanë bërë kufër përgënjeshtrojnë»** El inshikak, 22, dhe thotë: **«Por ata që kanë bërë kufër janë në përgënjeshttrim»** El buruxh, 19.

⁴ Argument për këtë është fjala e Allahut ﷻ: **«ata që kanë bërë kufër sa ters është për ta dhe ua humbi mundin e tyre sepse ata e urren atë që e zbriti Allahu prandaj ua rrëzoi punët e tyre»** Muhamed, 9. Dhe thotë: **«Ata që u kthyen mbrapsht pasi u sqarua e vërteta në fakt shejtani i mashtroi dhe i inspiroi ata sepse ata u thanë atyre që urren atë që e zbriti Allahu: Do ju bindemi juve në disa gjëra»** Muhamed 25-26. Nëse ata që u thonë atyre që e urrejnë atë që e ka zbritur Allahu: Do ju bindemi në disa gjëra, ata janë qafirë dhe murtedë që ja kthyen shpinën islamit; çfarë të themi atëhere për atë që e urren atë që e ka zbritur Allahu?! Padyshim se kufri i tij është më i madh.

⁵ Argument për këtë është fjala e Allahut ﷻ: **«E nëse i pyet ata kanë për të thënë: Vetëm ishim duke luajtur dhe biseduar. Thuaju: A me Allahun, me ajetet e tij dhe me të dërguarin e tij ishit duke u tallur?! Mos u justifikoni! Ju keni bërë kufër pas imanit tuaj»** Et teube 65-66. Dhe fjala e Allahut: **«Ju ka shpallur juve në libër që: Nëse dëgjoni të bëhet kufër dhe të tallen me ajetet e Allahut atëhere mos u ulni me ta derisa të bisedojnë për diçka tjetër sepse ju pastaj do të jeni si ata dhe Allahu ka për t'i mbledhur në xhehenem të gjithë munafikët dhe qafirët sëbashku»** En nisa, 140. Dhe fjala e Allahut ﷻ: **«E nëse i thejnë betimet e tyre pas besës që dhanë dhe cënojnë fenë tuaj atëhere luftojeni parinë e kufrit sepse ata nuk kanë betime se mbase heqin dorë»** Et teube, 12.

⁶ Argument për këtë është fjala e Allahut ﷻ: **«E kush është më i padrejtë se ai që përkujtohet me argumentet e Allahut e pastaj ua kthen shpinën atyre dhe harron atë që ka punuar me duart e tij»** dhe fjala e Allahut: **«Të kemi dhënë ty prej nesh një përkujtues (Kuranin). Kush ia kthen shpinën ka për të mbartur në ditën e ringjalljes gjynahun. Të përhershëm janë në të (në zjarr) e sa barrë e keqe është ajo që mbartin»** Taha 99-101, dhe thotë: **«E kush i kthen shpinën përkujtimit tim ai ka për të jetuar një jetë të rëndë dhe do ta sjellim ditën e ringjalljes të verbër»** Taha, 124.

mund të jetë i thjeshtë dhe mund të jetë i rëndë dhe i mbledhur së bashku dhe disa grada të tija janë më të rënda se disa të tjera.

2- Kufri i vogël.

Kufri i vogël është kufër nën kufirin e madh. Ai e nxjerr vepruesin e tij prej islamit, nuk e mohon cilësimin e tij si musliman dhe nuk i mohon të drejtat që i garanton islami si musliman. Ndërsa në ditën e gjykimit ai është në dorë të Allahut; nëse dëshiron e fal dhe nëse dëshiron e dënon. Edhe nëse dënohet ai nuk do të jetë i përhershëm në zjarr të xhehenemit, në dallim nga vepruesi i kufrit të madh i cili ka vdekur në kufër dhe shirk.

Atij i bën dobi ndërmjetësimi i ndërmjetësuesve, të cilët Allahu ﷻ u jep leje të ndërmjetësojnë.

Ky lloj kufri quhet edhe kufër pune i vogël, kufër mirësie, kufër nën kufër. Me këto emërtime sa herë që përmenden, kihet për qëllim kufri i vogël i cili nuk e nxjerr njeriun prej islamit.

Shëmbuj prej kufrit të vogël:-

Allahu ﷻ thotë: **«Ai që kishte dije prej librit i tha: Unë ta sjell atë para se të hapësh e mbyllësh sytë. E kur e pa përpara tij tha: Kjo është prej mirësisë së zotit tim që të më sprovtojë a do falenderoj apo do mohoj (bëj kufër)»** En neml, 40. Pra a do falenderoj për mirësinë e Allahut ﷻ apo do bëj kufër dhe do e mohoj atë e nuk do e falenderoj? Kufri i përmendur në këtë ajet nënkupton kufirin e mirësisë dhe jo kufirin ndaj Allahut ﷻ.

Në këtë përdorim hyn edhe fjala e faraonit drejtuar Musait ﷺ: **«I tha: A nuk të kemi rritur në mesin tonë kur ishe foshnje dhe qëndrove mes nesh shumë vite të jetës tënde, pastaj bëre atë që bëre dhe ishe prej mosfalenderuesve (qafirëve)»** Esh shuara, 18-19. Dmth. ishe prej mohuesve të mirësive tona, siç e përmend Ibn Abasi ﷺ dhe të tjerë. Ky është mendimi që Ibn Xherir Taberiu e ka përzgjedhur në tefsirin e tij.¹ Ky lloj kufri (kufri i mosfalenderimit) nëse bëhet kundër tagutit është i pëlqyeshëm. Kufri i përmendur në këtë ajet ka kuptim gjuhësor dhe jo terminologjik dhe nuk është prej kufrit që vepruesi i tij bën gjynah.

Shëmbuj prej haditheve:-

Prej Ibn Abasit ﷺ thotë: I dërguari i Allahut ﷻ ka thënë: **“Mu shfaq zjarri dhe shumica e banorëve të tij ishin gra për shkak të mohimit (kufrit) të tyre. I thanë: “O i**

¹ Shiko tefsirin e Ibn Kethirit.

dërguar i Allahut a i bëjnë kufër Allahut? Tha: “Mohojnë jetesën bashkëshortore dhe mohojnë mirësinë. Sikur të tregohesh bamirës ndaj saj për gjithë jetën, pastaj shikon prej teje diçka të vogël, do të të thotë: Kurrë s’kam parë hair prej teje”.¹

Fjala “kufër” e përmendur në hadith nënkupton kufrin i cili është nën kufrin e madh dhe nuk të nxjerr prej islamit. Këtë hadith Buhariu e ka vendosur në kapitullin me titull: “Kufri (mohimi) i jetës bashkëshortore dhe kufri nën kufër”.

Kadiu Ebu Bekr Ibn Arabiu në komentimin e këtij hadithi thotë: “Autori (Buhariu) dëshiron të shpjegojë se ashtu siç quhet bindja iman po ashtu edhe gjynahet quhen kufër, mirëpo kur ato cilësohen si kufër nuk janë si kufri që të nxjerr prej islamit”.²

Këtu hyn edhe fjala e profetit ﷺ: “**Sharja e muslimanit është fisk dhe vrasja e tij është kufër**”.³

Dhe hadithi: “**Dy lloj njerëzish bien në kufër; mohimi i prejardhjes dhe vajtimi i të vdekurit**”.⁴

Dhe hadithi: “**Kush bën marrëdhënie me gruan në kohën e hajzit ose në anusin e saj, ose shkon te ndonjë falltor dhe e beson për atë që thotë, ai ka bërë kufër me atë që i është zbritur Muhamedit**”.⁵

Prej Tausit thotë: Ibn Abasi ؓ, u pyet për atë që kryen marrëdhënie me gruan e tij në anus? Tha: Ky po më pyet për kufrin.⁶

Kufri i përmendur në këto hadithe nënkupton kufrin nën kufër, kufrin e vogël në vepra, i cili nuk e nxjerr vepruesin e tij prej islamit dhe Allahu është më i ditur.

Vërejtje:-

Kufri i mirësisë disa herë mund të jetë kufër i vogël i cili nuk e nxjerr vepruesin e tij prej islamit. Kjo ndodh atëhere kur i kushton rëndësi mirësisë dhe harron dhuruesin e kësaj mirësie, ose nuk ja jep hakun e duhur atij ashtu siç e meriton sipas sheriatit.

Por nganjëherë mund të jetë kufër që të nxjerr prej islamit atëhere kur e mohon dhuruesin e mirësisë, e mohon bujarinë e tij dhe ia vesh këtë mirësi vetes dhe mundit të tij dhe jo Allahut ﷻ, siç thotë Allahu ﷻ për Karunin ﴿**Tha: Unë e kam fituar atë me dijen time. A nuk e di ai se Allahu i ka shkatërruar brezat që kanë qënë përpara tij e shumë**

¹ E transmeton Buhariu.

² Fethul Bari, 3/344.

³ E transmeton Muslimi.

⁴ E transmeton Muslimi.

⁵ E transmeton Tirmidhiu, Ebu Daudi dhe Ibn Maxheh. Shejh Albani e ka konsideruar sahih në librin e tij “Adabul zefaf”.

⁶ E transmeton Nesaiu dhe shejh Albani e ka konsideruar sahih në librin e tij “Adabuz zefaf”.

prej tyre kanë pasur më shumë fuqi se ai dhe më shumë pasuri mirëpo kriminelët nuk do pyeten për gjynahet e tyre) e deri te fjala e Allahut (sa çudi me qafirët të cilët nuk shpëtojnë) El Kasas 78-82.



Shirku

Shirku është bërja shok Allahut në uluhijen dhe rububijen e tij ose në cilësitë dhe veprat e tij. Shirku në shariat klasifikohet në shirk të madh dhe shirk të vogël.

1- Shirku i madh.

Shirku i madh është i ngjashëm me kufirin e madh dhe përfundimi i tij është njësoj si kufri i madh. Ai i rrëzon të gjitha veprat dhe e nxjerr vepruesin e tij prej islamit. Vepruesi i tij do të jetë i përhershëm në zjarrin e xhehenemit dhe nuk i bën dobi shefati i askujt.

Argumente për këtë lloj shirku prej Kuranit:-

Argument për këtë lloj shirku është fjala e Allahut ﷻ: **«Allahu nuk e fal t'i bëhet shirk dhe atij që dëshiron ia fal atë që është më e vogël se ai»** En Nisa: 48.

Allahu thotë: **«Atij që i bën shirk Allahut, Allahu ia ka privuar xhenetin»** El maide, 72.

Dhe thotë: **«E nëse bën shirk ka për të rënë poshtë e gjithë vepra jote dhe ke për të qënë prej të humburve»** Ez zumer, 65.

Dhe thotë: **«E nëse do të bënin shirk kishin për t'u rënë poshtë të gjitha ato që kishin punuar»** El enam, 88.

Shirku në këto ajete ka të njëjtin kuptim dhe dispozitë si kufri i madh. Prej kësaj kuptojmë që çdo kufër është shirk dhe çdo shirk është kufër dhe çdo mushrik është qafir dhe çdo qafir është mushrik, siç thuhet në fjalën e Allahut ﷻ: **«Kemi për t'i mbushur me frikë zemrat e qafirëve përshkak se ata bënë shirk me Allahun»** Ali Imran, 151. Pra ata bënë kufër dhe në të njëjtën kohë u cilësuan me shirk.

Dhe thotë: **«Nuk i takon mushrikëve të luten në xhamitë e Allahut ndërkohë që ata dëshmojnë me kufër kundër veteve të tyre»** Et teube, 17.

Dhe thotë: **«Ata që bënë kufër prej ehilil kitabit dhe mushrikëve janë të përhershëm në zjarrin e xhehenemit dhe ata janë krijesat më të këqija»** El Bejineh, 6. Pra ata që kanë bërë shirk janë qafirë.

Në suren *“El kehf”* përmendet historia e personit të cilit Allahu ﷻ, prej bujarisë së tij i dhuroi dy kopshte me rrush dhe me hurma, por ai e mohoi mirësinë e Allahut ﷻ dhe e

mohoi ringjalljen. Ky person njëherë cilësohet me kufër dhe njëherë me shirk. Kjo dëshmon se secila prej tyre nënkupton edhe tjetrën domosdoshmërisht. Allahu ﷻ thotë: **«Shoku i tij në dialog me të i tha: A po bën kufër me atë që të ka krijuar prej dheut pastaj prej një pike uji pastaj të formoi si njeri»** e deri te fjala e Allahut ﷻ **«U shkatërruan të gjitha frytet e tij dhe zuri të përplaste duart për shpenzimet e bëra dhe ai (kopshti) ishte shkatërruar plotësisht dhe thoshte: A sikur të mos i kisha bërë shok (shirk) zotit tim askënd»** El kehf, 42. Pra vepra e tij njëherë u cilësua si kufër dhe njëherë si shirk.

Po kështu fjala e Allahut ﷻ: **«Kanë bërë kufër ata që thanë: Allahu është i treti prej të treve»** El maide, 73. Fjala e tyre “i treti prej të treve” është shirk i pastër dhe ata u cilësuan në ajet me kufër. Kjo dëshmon që shirku është kufër dhe se çdo qafir është mushrik dhe çdo mushrik është qafir.

Argumente prej hadithit:-

Prej Burejdas ؓ thotë: E kam dëgjuar të dërguarin e Allahut ﷺ të thotë: **“Besa që është mes nesh dhe mes tyre është namazi e kush e lë atë ai ka bërë kufër”**.¹

Prej Theubanit ؓ thotë: E kam dëgjuar të dërguarin e Allahut ﷺ të thotë: **“Mes robit dhe kufrit dhe imanit është namazi e kush e lë atë ka bërë shirk”**.²

Vëre me kujdes se si hadithi i parë e cilësoi lënësin e namazit me kufër ndërsa i dyti e cilësoi me shirk ndërkohë që i cilësuarit është i njëjtë në të dy hadithet. Kjo dëshmon se kur përmendet njëra nga këto dy fjalë, secila prej tyre nënkupton edhe tjetrën dhe Allahu është më i ditur.

Nëse thuhet: A ka dallim mes kufrit dhe shirkut?

Them: Nëse kufri dhe shirku përmenden veças atëhere secili prej tyre nënkupton edhe tjetrin bazuar në argumentet e përmendura më sipër. Por nëse përmenden në një kontekst sëbashku kur thuhet: Kufër dhe shirk, qafir dhe mushrik, në këtë rast ata janë të njëjta në aspektin e kuptimit sheriatik dhe dispozitave të tij por janë të ndryshëm në kuptimin gjuhësor, sepse me kufirin nënkuptohet mohimi, përgënjeshtrimi dhe mbulimi i asaj që duhet shfaqur ndërsa me shirkun nënkuptohet pohimi i ortakut me Allahun ﷻ dhe adhurimi i dikujt tjetër me Allahun.

Shirku i vogël:-

Ai është shirku i fshehtë i cili është nën shirkun e madh. Ai i përngjan kufrit të vogël

¹ E transmeton Ahmedi; Ebu Daudi, Nesaiu dhe Tirmidhiu i cili thotë: Hadith hasen sahih. Sahihul Tergib, 564.

² E transmeton Taberiu me sened sahih. (Sahihul tergeb; 565). Në këtë hadith përmendet se lënësi i namzit është mushrik dhe fjala e Allahut **«la fal atë që është më i vogël se ai atij që dëshiron»** nuk e përfshin lënësin e namazit sepse lënësi i namazit me teks të qartë është mushrik dhe qafir.

sepse nuk e nxjerr vepruesin e tij prej islamit dhe nuk e mohon cilësimin e tij me iman tërësisht. Në ahiret ai do të jetë në mëshirë të Allahut; nëse dëshiron e dënon e nëse dëshiron e fal, mirëpo edhe nëse dënohet, prapëseprapë atë do e kapë ndërmjetësimi i ndërmjetësuesve.

Prej Mahmud ibn Lebidit se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Ajo prej të cilës friksohem më shumë për ju është shirku i vogël” I thanë: Çfarë është shirk i vogël o i dërguar i Allahut? U tha: Dyfaqësia. Allahu kur t’i gjykojë njerëzit për punët e tyre thotë: Shkoni te ata për të cilët hiqeshit me dyfytyra në dynja dhe shikoni se mos gjeni te ata ndonjë shpërblim”.**¹

Po prej tij thotë: I dërguari i Allahut ﷺ doli dhe tha: **“O njerëz! Ruajuni prej shirkut të fshehtë!” I thanë: “O i dërguar i Allahu! Çfarë është shirk i fshehtë? Tha: “Njeriu ngrihet për t’u falur dhe e zbukuron namazin qëllimisht për shkak të vështrimeve të njerëzve. Ky është shirku i fshehtë”.**²

Bejhakiu transmeton prej Jala ibn Shedadit prej babait të tij thotë: **“Në kohën e të dërguarit të Allahut, rijanë (syfaqësinë) e konsideronim shirk të vogël”.**³

Këtu hyn edhe fjala e profetit ﷺ: **“Çdo betim që bëhet për diçka tjetër përveç Allahut është shirk”**⁴ dhe fjala e profetit ﷺ: **“Kush betohet me diçka tjetër përveç Allahut ai ka bërë kufër ose shirk”.**⁵



¹ E transmeton Ahmedi dhe Bejhakiu. Sahihut tergib, 29.

² E transmeton Ibn Huzejme në sahihun e tij. Sahihut tergib 28.

³ tergib 32.

⁴ Es silsiletus sahiha 2042.

⁵ E transmeton Tirmidhiu dhe thotë: Hadith hasen. Shejh Albani thotë: Madje ai është sahih. Es silsiletus sahihah, 2042.

Fisku

Fisku, në gjuhen arabe, nënkupton daljen e diçkaje prej lëvores së saj. Kjo fjalë përdoret psh kur hurma arabe e njomë del prej lëvores së saj ose kur miu del prej folesë. Thuhet: Filani bëri fisk atëhere kur nuk bindet dhe u del kundër ligjeve dhe kufijve të sheriatit. Thuhet: Bëri fisk ndaj urdhrin të zotit dmth nuk iu bind atij.¹

Fisku në aspektin e sheriatit ndahet gjithashtu në dy lloje:-

1- Fisku i madh:-

Ai është i përngjashëm me kufrin dhe shirkun e madh, sepse e nxjerr vepruesin e tij prej islamit dhe e rrëzon të gjithë imanin ashtu si kufri dhe shirku. Ai ka dispozita të njëjta si kufri dhe shirku. Allahu thotë: **«Të kemi zbritur ty ajete (argumente) të qarta dhe askush nuk i mohon ato përveç fasikave (të pabindurve)»** El bekareh, 99.

Dhe thotë: **«E kush ia kthen shpinën atij pas kësaj mu ata janë fasikat (të pabindurit)»** Ali Imran, 82.

Dhe thotë: **«E kush nuk gjykon me atë që ka zbritur Allahu mu ata janë fasikat (të pabindurit)»** El Maideh, 47.

Dhe thotë: **«Munafikët dhe munafiket shkojnë me njëri-tjetrin urdhërojnë për keq, ndalojnë nga e mira dhe i zbrapsin duart (nuk veprojnë punë të mira). E harruan Allahun dhe Allahu i harroi ata. Munafikët mu ata janë fasikët (të pabindurit)»**. Et teube. 67.

Dhe thotë: **«E kush bën kufër pas kësaj mu ata janë fasikët (të pabindurit)»** En nur, 55.

Dhe thotë: **«Mos jini si ata që e harruan Allahun dhe Allahu i bëri që të harrojnë vetet e tyre dhe mu ata janë fasikët (të pabindurit)»** El hashr, 19.

Me fiskun në këto ajete kihet për qëllim fisku i madh që të nxjerr prej islamit.

2- Fisku i vogël:-

Fisku që është nën fiskun e madh dhe përdoret për vepruesit e gjynaheve që nuk të nxjerrin prej islamit. Ai nuk e rrëzon të gjithë imanin dhe nuk e rrëzon cilësimin me islam, si

¹ Shiko: El muxhem el uestit, fjalor arabisht-arabisht i akademisë së gjuhës arabe në Kajro.

në fjalën e Allahut: ﴿O ju që keni besuar! Nëse ju vjen ndonjë fasik me ndonjë lajm atëhere sigurohuni﴾ El huxhurat, 6.

Dhe fjala e Allahut ﷻ : ﴿Nuk ka rafth dhe as fusuk (mosbindje) dhe as debate në haxh﴾ El bekare, 197.

Me fiskun e përmendur në këto ajete kihet për qëllim fisku i vogël.

Është saktësuar në hadith se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: *“Sharja e muslimanit është fusuk (prishje, pabindje)”*.

Dhe ka thënë: *“Nëse dikush prej jush agjëron atëhere të mos flasë keq e të mos bëj fisk”*.

Dhe thotë: *“Sa herë që dikush e akuzon tjetrin për fisk ose për kufër ai i kthehet atij nëse shoku i tij nuk është ashtu siç ka pretenduar”*. E transmeton Buhariu.

Me fiskun e përmendur në këto hadithe kihet për qëllim gjynahet, të cilat nuk e nxjerrin vepruesin e tyre prej islamit dhe nuk ja rrëzojnë të gjithë imanin.

Prej kësaj del qartë se fjala “fisk” nganjëherë përdoret me kuptimin e kufrit të madh dhe nganjëherë përdoret me kuptimin e gjynahut që është poshtë kufrit, në varësi të gradës së gjynahut, llojit të tij dhe realitetit të vetë gjynahqarit.

Këtu lind një pyetje: Si të bëjmë dallim mes tyre në argumentet e Kuranit dhe të sunetit?

Themi: Nga rrethanat e argumentit kuptohet edhe qëllimi me fiskun, a është fisk i madh apo i vogël? Konteksi i ardhur në vetë argumentin ose në argumente prej ajeteve dhe haditheve të tjera të ndihmon për të kuptuar llojin e fiskut.

Dhulmi

Dhulmi (padrejtësia-zullumi) në gjuhën arabe nënkupton tejkalimin e caktuar dhe mosvendosjen e diçkaje në vendin e vet. Ai gjithashtu ndahet në dy lloje: dhulm i madh dhe dhulm i vogël.

1- Dhulmi i madh.

Dhulmi i madh është njësoj si kufri dhe shirku i madh dhe nënkupton rrëzimin e të gjithë imanit prej vepruesit të tij, sepse dhulmi më i madh është shirku dhe t'i mveshësh krijuesit tënd, ortak në çfarëdo cilësi prej cilësive të tij dhe drejtësia më e madhe është njësimi dhe veçimi i Allahut ﷻ me adhurim.

Argumentet për këtë lloj dhulmi janë të shumta. Prej tyre fjala e Allahut: **«Shirku është padrejtësi (dhulm) e madhe»** Lukman, 13.

Kur Allahu zbriti këtë ajet: **«Ata të cilët besuan dhe nuk e përzierin imanin e tyre me padrejtësi»**, sahabët thanë: Cili prej nesh nuk ka bërë padrejtësi? Atëherë Allahu ﷻ zbriti: **«Shirku është padrejtësi (dhulm) e madhe»**.

Ibn Haxheri, në *“El fet’h”* (1/87) thotë: *“Argumenti në këtë hadith, është se sahabët kuptuan prej fjalës “padrejtësi” të gjitha llojet e gjynaheve dhe i dërguari i Allahut ﷻ nuk e mohoi këtë, por u shpjegoi se qëllimi në këtë ajet është lloji më i madh i dhulmit (padrejtësisë) i cili është shirku. Kjo dëshmon që dhulmi është me grada të ndryshme”*.

Për dhulmin që është i njëjte me kufrin dhe shirkun dëshmojnë këto ajete:

«Nuk do t’ju bëjë dobi sot pasi ju bëtë padrejtësi (dhulm) prandaj do merrni pjesë në dënim» Ez zuhruf, 39.

«Ata i humbën vetet e tyre për shkak se bënë padrejtësi (dhulm) ndaj ajeteve tona» El araf, 9.

«Allahu nuk u bëri padrejtësi atyre por ata i bënë padrejtësi (dhulm) vetëve të tyre dhe i zuri e keqja prej gabimeve të tyre dhe i goditi ajo me të cilën talleshin» En nahl, 34.

«Përveç atyre që kanë bërë padrejtësi prej tyre, prandaj mos iu frikësoni atyre por m’u frikësoni mua» El bekare, 150.

E shumë ajete të tjera që flasin për këtë lloj padrejtësie me të cilën nënkuptohet kufri i madh.

2- Dhulmi i vogël.

Ai është dhulm nën dhulmin e madh, i cili nuk e rrëzon të gjithë imanin prej vepruesit të tij dhe nuk ja heq atij emërtimin si musliman.

Argument për këtë lloj padrejtësie është fjala e Allahut ﷻ: **«e nëse i ndani gratë dhe arrijnë fundin e periudhës së pritjes atëhere ose kthejini ato me mirësi ose lëshojini me mirësi, por mos i mbani për t'i dëmtuar dhe t'i kaloni caqet sepse kush vepron kështu i ka bërë vetes së tij padrejtësi»** El bekare, 231.

Dhe fjala e Allahut ﷻ: **«Tha: Të ka bërë padrejtësi kur të kërkoi që ta merrte dhinë tënde me dhitë e tija»** Sad, 24.

Dhe fjala e tij: **«Ata të cilët nëse bëjnë diçka të turpshme ose u bëjnë padrejtësi veteve të tyre ata përkujtojnë Allahun»** Ali Imran, 135.

Dhe fjala e tij: **«Thanë: O Zoti ynë! Ne i bëmë padrejtësi veteve tona. Nëse nuk na fal dhe nuk na mëshiron kemi për të qënë prej të humburve»** El araf, 23.

Me dhulmin e përmendur në këto ajete kihet për qëllim dhulmi i vogël i cili nuk ka të njëjtin gjykim si dhulmi i madh që është si kufri dhe shirku.

Është saktësuar prej hadithi të profetit ﷺ se ai ka thënë: **“Padrejtësia (dhulmi) të cilën Allahu nuk e fal është shirku. Allahu thotë: (Shirku është padrejtësi e madhe). Ndërsa padrejtësia (dhulmi) të cilën Allahu e fal është padrejtësia mes robërve dhe zotit të tyre. Ndërsa padrejtësia të cilin Allahu nuk e lë pa ndëshkuar është padrejtësia mes robërve derisa të gjykohet mes tyre”.¹**

Prej këtij hadithi kuptohet se dhulmi ndonjëherë nënkupton kufirin dhe shirkun dhe ndonjëherë nënkupton gjynahun i cili është më i vogël se kufri dhe shirku. Dallimi mes tyre bëhet në bazë të kontekstit të teksit ose me argumente të tjerë që lidhen me temën.

Prej kësaj nxjerrim si përfundim rregullin e mëposhtëm: **“Çdo kufër është shirk dhe çdo shirk është kufër dhe çdo shirk është dhulm (padrejtësi) dhe fisk (pabindje), por jo çdo dhulm dhe fisk janë kufër dhe shirk”.**

Fjalë të dijetarëve për kufirin, fiskun dhe dhulmin e vogël.

Ibën Tejmija në Fetvatë e tij (7/67) rreth fjalës së profetit: **“Shirku në umetin tim është më i fshehtë se ecja e milingonës”** thotë:

¹ E transmeton Tajalisiu dhe Bezari. Sahihul xhami', 3961.

“Ibn Abasi dhe nxënësit e tij thonë: Ai është kufër nën kufër, dhulm (padrejtësi) nën dhulm dhe fisk nën fisk. Edhe pasuesit e sunetit si Ahmedi e të tjerë thonë të njëjtën gjë”.

Prej Tausit thotë: “I thashë Ibn Abasit ﷺ (E kush nuk gjykon me atë që ka zbritur Allahu) a është qafir? Tha: Ai është kufër por jo si kufri i atij që bën kufër në Allahun, botën tjetër, melekët, librat dhe të dërguarit e tij. Pastaj tha: Ai është kufër që nuk të nxjerr prej islamit”¹

¹ Fjala e Allahut ﷻ: **(E kush nuk gjykon me atë që ka zbritur Allahu mu ata janë qafirët), (E kush nuk gjykon me atë që ka zbritur Allahu mu ata janë të zullumqarët), (E kush nuk gjykon me atë që ka zbritur Allahu mu ata janë të pabindurit (fasikat))**. Ibn Abasi ﷺ thotë: Allahu ﷻ i ka zbritur këto ajete për dy grupe çifutësh. Për ta kanë zbritur dhe ata ka pasur për qëllim Allahu. Dhe thotë: Kush mohon atë që ka zbritur Allahu ai ka bërë kufër.

Transmetohet se Bera ibn Azib, Hudhejfe ibn Jemani, Ibn Abasi, Ibn Mixhlizi, Ebu Rexha Atari, Ikrimaja, Ubejdullah ibn Abdullahi, Hasen Basriu dhe shumë të tjerë kanë thënë: “Kanë zbritur për ehlikitabin (çifutët dhe të krishterët) dhe Hasen Basriu shton: “Ky ajet është detyrimisht edhe kundër nesh”.

Sufjan Theuriu, Mensuri, Ibrahim (Nehaiu) thonë: “Kanë zbritur për izraelitët dhe Allahu është kënaqur prej këtij umeti (muslimanët)”.

Ibn Xherir Taberiu ka zgjedhur në tefsirin e tij se në këtë ajet flitet për çifutët dhe të krishterët dhe për ata që mohojnë ligjin e Allahut ﷻ të zbritur në librin e tij. (Shiko Tefsirin e Ibn Kethirit).

Nga kjo që përmendëm na sqarohen disa çështje:-

1- Këto ajete kanë zbritur për qafirët e ehlikitabit dhe përfshijnë çdokënd që vepron të njëjtin veprim dhe ndërrim të ligjit të Allahut ﷻ.

2- Këto ajete në origjinë nënkuptojnë kufrin, fiskun dhe dhulmin (padrejtësinë) e madh sepse ato kanë zbritur për ehlikitabin të cilën ndërruan dhe mohuan ligjin e Allahut ﷻ, në dallim me murxhitë të cilët i interpretojnë ajetet vetëm me kufrin, dhulmin dhe fiskun e vogël, a thua se kanë zbritur vetëm për këtë lloj kufri.

3- Kur ta zbatojmë këtë ajet për muslimanët duhet parë vepra e tyre. Nëse i kthejnë shpinën, e ndërrojnë ose e mohojnë ligjin e Allahut njësoj siç kanë vepruar ehlikitabi atëhere ata kanë vepruar kufër të madh, fisk të madh dhe dhulm të madh edhe nëse nuk e deklarojnë me gojë e tyre se ata e mohojnë ligjin e Allahut sepse gjendja dhe veprat e tyre në shumicën e rasteve janë më të domethënëse për mohimin dhe kthimin e shpinës ndaj ligjit të Allahut sesa deklaratimet me gojë.

Mirëpo nëse gjykojnë me atë që ka zbritur Allahu dhe gjejmë fjalë dhe vepra që dëshmojnë se ata i duan ligjet që i ka zbritur Allahu ﷻ dhe tregohen të kujdesshëm që t’i zbatojnë dhe t’i praktikojnë dhe përpiqen me sa kanë mundësi, por në një çështje ose në disa çështje nuk gjykojnë me atë që ka zbritur Allahu ﷻ për shkak të epshit ose dobësisë ose si një keqinterpretim atëhere ata hyjnë te fjala e Ibn Abasit dhe dijetarëve të tjerë se ky është kufër i vogël, fisk i vogël, dhulm i vogël dhe Allahu është më i ditur.

4- Nëse Ibn Abasi ﷺ thotë: **“Këto ajete kanë zbritur për qafirët e ehlikitabit”** dmth. kanë zbritur për kufrin e madh, atëhere kë ka për qëllim me fjalën e tij: **“Kufër nën kufër. Ai nuk është kufri që ata kujtojnë”?** Padyshim ka pasur për qëllim të sundimtarët musliman në kohën e tij prej emevitëve dhe ka pasur për qëllim t’u kundërpërgjigjet havarixhëve të kohës së tij, të cilët i zbatuan këto ajete mbi emevitët, pa argumentet bindës. Edhe pse emevitët kishin disa gjëra që binin në kundërshtim me sheriatin, por Ibn Abasi ﷺ iu kundërpërgjigj atyre me këtë fjalë të njohur të tij.

I dërguari i Allahut ﷻ e pati paralajmëruar umetin e tij për këto kundërshtime të sheriatit që ndodhën në kohën e emevitëve, kur tha: **“Gjëja e parë që do të humbasë prej islamit është pushteti (ndërrimi i sitetemit te shuras në sistem monarkie të trashëguar)”**. Dhe thotë: **“I pari që do e ndërrojnë sunetin tim është një burrë prej emevitëve”** pra ndryshimin e sunetit të tij nga sistemi i shuras për zgjedhjen e halifes në një sistem të trashëgueshëm. E megjithatë askush prej dijetarëve nuk u ngrit të thoshte që Muavija dhe pasardhësit e tij kanë bërë kufër për shkak se trashëguan sundimin.

5- Nëse kjo sqarohet, kemi për ta kuptuar se në çfarë rrethanash e tha Ibn Abasi ﷺ fjalën e tij: **“Kufër nën kufër”** dhe kë pati për qëllim. Do e kuptojmë se nuk lejohet të zbatohet kjo fjalë për taguat e gjykimit në kohën

Prej Ibn Xhurejhut prej Ibn Atasë thotë: “Kufër nën kufër, fisk nën fisk, dhulm nën dhulm”.

Muhamed ibn Nasri ka thënë: “Ataja ka thënë diçka të vërtetë sepse qafiri mund të quhet zullumqar (dhalim) ashtu si gjynahqari prej muslimanëve mund të quhet zullumqar (dhalim) sepse njëri dhulm të nxjerr nga islami ndërsa tjetri jo”.

Thotë: Gjithashtu edhe fisku është dy llojesh, një fisk i cili të nxjerr prej islamit dhe një fisk që nuk të nxjerr. Qafiri quhet fasik ashtu siç mund të quhet i pabinduri prej muslimanëve fasik. Allahu i lartë kur thotë: **﴿Ata që nuk u bindën (bënë fisk) strehimi i tyre do të jetë zjarri﴾** ka për qëllim qafirët sepse për këtë dëshmon vazhdimi i ajetit **﴿sa herë që duan të dalin prej tij kthehen prapë në të﴾**.

Gjithashtu edhe i pabinduri prej muslimanëve quhet fasik edhe pse nuk ka dalë prej islamit. Allahu ﷻ thotë: **﴿Ata të cilët i akuzojnë gratë e ruajtura e pastaj nuk sjellin katër dëshmitarë, goditini me tetëdhjetë kamzhikë dhe kurrë mos e pranoni dëshminë e tyre dhe ata janë fasikët (të pabindurit)﴾**. Dijetarët kanë thënë për shpjegimin e fiskut në këtë ajet: Kihen për qëllim gjynahet.

Thanë: E meqë dhulmi dhe fisku janë dy llojesh po kështu edhe kufri është dy llojesh. Njëri lloj të nxjerr prej islamit, ndërsa lloji tjetër nuk të nxjerr. Po kështu edhe shirku është dy llojesh; shirk në teuhid i cili të nxjerr prej islamit dhe shirk në vepra i cili nuk të nxjerr prej islamit dhe ai është syfaqësia”.¹



e sotme, të cilët i kanë mbledhur sëbashku të gjitha llojet e daljes nga feja, duke ua kaluar edhe vetë sundimtarëve të *ehli-kitabit*. Nuk lejohet të bëhet analogji dhe krahasim mes tagutëve bashkohorë dhe mes emevitëve dhe abasitëve ashtu siç veprojnë dijetarët e murxhive.

¹ Cituar prej fetvave të Ibn Tejmijes, 7/227-239.

Nifaku

Nifaku është fshehja e kufrit dhe shfaqja e islamit. Në sheriat ai ndahet në dy lloje: Nifak në besim dhe nifak në vepra.

Nifaku në besim:

Ndodh atëhere kur fshihet kufri dhe shfaqet islami prej frikës nga dënimi. Ai ka dispozita të njëjta si kufri i madh. Ai e rrëzon të gjithë imanin dhe vepruesi i tij në ditën e gjykimit do të jetë përjetë në gradën më të ulët të zjarrit. Në dynja konsiderohet si musliman dhe sillemi me të si musliman përderisa nuk e shfaq nifakun dhe kufrin e tij haptas, sepse dispozitat në dynja bazohen në pamjen e jashtme dhe në kufrin ose islamit që personi shfaq.

Prej argumenteve për këtë lloj nifaku është fjala e Allahut ﷻ: **«Munafikët janë në thellësitë më të ulta të zjarrit dhe nuk ke për të gjetur për ta ndihmues»** En nisa, 145.

Dhe ajeti: **«Allahu u ka premtuar munafikëve dhe munafikeve dhe pabesimtarëve zjarrin e xhehenemit, të përjetshëm janë në të. Atë meritojnë dhe Allahu i ka mallkuar dhe ata do të kenë dënim të përhershëm»** Et teube 68.

Dhe ajeti: **«Allahu ka për t'i mbledhur të gjithë munafikët dhe qafirët në xhehenem»** En nisa 140.

Nifaku i përmendur në këto ajete është nifaku në besim, i cili e rrëzon të gjithë imanin, e nxjerr njeriun prej islamit dhe meriton dënim të përhershëm në zjarr.

Vërejtje:-

Nifaku i përmendur në Kuran nënkupton vetëm nifakun në besim, i cili e rrëzon të gjithë imanin, në dallim nga kufri, dhulmi dhe fisku të cilat nganjëherë përmenden me kuptimin e kufrit, fiskut dhe dhulmit të madh dhe nganjëherë me kuptimin e kufrit, fiskut, dhe dhulmit të vogël.

Nifaku në vepra:-

Ai është më i vogël se nifaku në besim, sepse nuk ia rrëzon njeriut të gjithë imanin. Në botën tjetër është në mëshirën e Allahut ﷻ; nëse dëshiron e dënon e nëse dëshiron e fal, por edhe nëse dënohet nuk do qëndrojë përjetë në zjarr si qafirët sepse e përfshin ndërmjetësimi me lejen e Allahut të lartë.

Argument për këtë lloj nifaku është fjala e profetit ﷺ: **“Kush vdes dhe nuk ka luftuar ose nuk ka menduar për të luftuar ai ka vdekur në një degë të nifakut”**.¹

Dhe thotë: **“Kush i ka katër gjëra ai është munafik i pastër dhe kush ka njëren prej tyre ai ka një degë prej nifakut derisa ta lerë atë; kur flet gënjen, kur jep besën tradhton, kur premtun nuk e përmbush dhe kur zihet ofendon”** e transmeton Muslimi. Me nifakun këtu nënkuptohet nifaku në vepra i cili nuk e rrëzon të gjithë imanin.

Neveviu në shpjegimin e sahihut të Muslimit (2/46-47) thotë: *“Të gjithë dijetarët kanë rënë dakort se ai që beson me zemër dhe me gjuhë por vepron këto vepra (të përmendura në hadith) nuk gjykohet me kufër dhe as nuk është munafik i përhershëm në zjarrin e xhehenemit. Ndërsa kuptimi i fjalës së profetit **“munafik i pastër”** është se ai u ngjason shumë munafikëve për shkak të këtyre veprave.*

Imami Ebu Isa Tirmidhiu e përmend këtë kuptim prej të gjithë dijetarëve dhe thotë: Kuptimi i saj te dijetarët është nifaku në vepra.

Mirëpo Hatabi, Allahu e mëshiroftë, ka përmendur një mendim tjetër se ai është tërheqje vërejtje ndaj muslimanit, që këto vepra të mos i bëhen shprehi, prej frikës se mos e shtyjnë në nifakun e vërtetë”.

Ibn Tejmije në Mexhmuul Fetaua (11/140-143) thotë: *“Nifaku përdoret me kuptimin e nifakut të madh i cili është fshehja e kufrit dhe me kuptimin e nifakut të vogël, i cili është mospërputhja e brendësisë së njeriut me atë që e shfaq në kryerjen e detyrave fetare.*

Prej kësaj kuptojmë që nifaku është emër i përgjithshëm, i cili përfshin dy lloje:

*Nifaku në bazën e fesë (akides dhe besimit) si në fjalën e Allahut ﷻ: **﴿Munafikët janë në gradën më të ulët të zjarrit﴾** dhe **﴿Nëse të vinë ty munafikët dhe të thonë: Dëshmojmë se ti je i dërguari i Allahut dhe Allahu e di se ti je i dërguari i tij por Allahu dëshmon se munafikët janë gënjeshtarë﴾** El munafikun, 1. Me munafikun këtu nënkuptohet qafiri.*

*Ose mund të kihet për qëllim me të nifaku në veprat fetare si në fjalën e profetit ﷺ: **“Shenjat e munafikut janë tre gjëra”** dhe në fjalën e tij: **“Kush i ka katër gjëra ai është munafik i pastër”**.*

Çështje: Cili është dallimi mes takijes (shtirjes) dhe nifakut, duke qenë se të dyja janë shfaqje të asaj që nuk është në zemër?

Dallimi mes tyre është i madh. Shtirja (takija) nënkupton fshehjen e imanit dhe islamit dhe dashurinë për Allahun ﷻ, për profetin ﷺ dhe për besimtarët dhe shfaqjen e të kundërtës në rast imponimi ose domosdoshmërie në një masë të caktuar, aq sa të largojë dëmin dhe vështirësinë dhe jo ta teprojë pa masë, me kusht që imponimi dhe cënimi të mos kenë rrugë

¹ E transmeton Muslimi.

tjetër largimi përveç kësaj mënyre.

Nëse nuk ka imponim atëhere shtirja (takija) nuk lejohet. Gjithashtu shtirja është vetëm me fjalë dhe jo me vepra sepse muslimanët janë të barabartë në të drejtat e tyre dhe askujt nuk i lejohet ta largojë dëmin prej vetes duke dëmtuar vëllezërit e tij, ose të shpëtojë veten në shpagim të dënimit dhe frikësimit të vëllezërve të tij, si psh. kur i thuhet: Ose të vrasësh vëllain tënd ose kemi për të të vrarë, apo: Na ndihmo që të vrasim ose të luftojmë vëllezërit e tu. Në këtë rast nuk i lejohet t'u bindet atyre edhe nëse kjo çon në vrasjen e tij.

Prej argumenteve për lejimin e takijes (shtirjes) me kushtet e përmendura është fjala e Allahut ﷻ: **«Kush bën kufër me Allahun pas imanit të tij përveç atij që imponohet dhe zemra e tij është e qetësuar me iman»** En nahl 106.

Dhe ajeti: **«Besimtarët të mos i marrin qafirët për miq përveç besimtarëve! E kush vepron kështu ai nuk është te Allahu asgjë, vetëm nëse shtireni ndaj tyre për t'u ruajtur»** Ali Imran, 28. Kjo është takija.

Ndërsa nifaku është fshehja e kufrit dhe shfaqja e islamit për t'u ruajtur kundër muslimanëve dhe shpatës së të vërtetës.

Nifaku është cilësi e vazhdueshme për munafikun që në fillimet e heqjes si musliman. Por ndonjëherë mund të jetë nifak i ri për shkak të ndonjë fjale apo vepre që kryhet vetëm prej munafikëve dhe përfiton cilësitë e munafikëve pas islamit. Si rasti i atyre që ishin nisur në betejën e Tebukut dhe në bisedë e sipër u shprehën për profetin ﷺ dhe sahabët ﷺ me shaka dhe tallje: *“Nuk kemi parë më barkmëdhenj se lexuesit tanë dhe as gënjeshtarë më të mëdhenj dhe as më frikacakë se ata”*. Atëhere Allahu ﷻ zbriti: **«E nëse i pyet ata do të thonë: Ne po bisedonim dhe po bënim shaka. Thuaju: A me Allahun, me ajetet e tij dhe me të dërguarin e tij po talleshit?! Mos u justifikoni! Ju keni bërë kufër pas imanit tuaj. Nëse e falim një grup prej jush e dënojmë një grup tjetër sepse ata ishin kriminelë»** Et teube 65-66.

Ata bënë kufër dhe nifak pas imanit për shkak të kësaj fjale siç thotë Ibn Tejmije në Mexhmuul Fetaua (7/272):

“Allahu e njoftoi (të dërguarin) se ata bënë kufër pas imanit të tyre. Mendimi se ata bënë kufër me gojë pas imanit, por kjo ndodhi pasi kishin bërë kufër me zemrat e tyre, është mendim i pasaktë, sepse shfaqja e imanit me gjuhë kur në zemër fshihet kufri, realisht është kufër dhe nuk ka kuptim të thuhet: Ju keni bërë kufër pas imanit tuaj, sepse në realitet ata ishin qafirë përpara kësaj fjale dhe pas saj.

Nëse thuhet: Ata e shfaqën kufrin pas shfaqes së imanit¹, atëhere u thuhet: Ata nuk e

¹ Dmth. ata ishin munafikë, e shfaqnin imanin por e fshihnin kufrin. Kuptimi i ajetit sipas këtij pretendimi është se ata munafikë kanë bërë kufër duke e shfaqur kufrin haptas ndërkohë që më përpara hiqeshin si muslimanë.

shfaqën këtë fjalë përpara njerëzve, por vetëm në rrethin e tyre dhe në rrethin e tyre ata kanë qënë munafikë edhe më përpara.

E vërteta është se ata u bënë qafirë pas imanit, me talljen dhe nifakun e tyre dhe u frikësuan se mos zbriste ndonjë sure që do të demaskonte nifakun e zemrave të tyre. Konteksi i ajetit nuk dëshmon se ata ishin munafikë më përpara (se të thoshin këto fjalë)”.

Dijetarët e tefsirit në fjalën e Allahut ﷻ **﴿Nëse e falim një grup prej jush﴾** përmendin se ata ishin një grup dhe se ai i cili u pendua prej tyre ishte një person që quhej Muhashen ibn Humejr. Disa dijetarë të tjerë thonë: Ai i qortoi ata për disa fjalë të tyre dhe nuk bashkëpunoi me ta, por zuri të ecte anash tyre. Kur zbriti ky ajet u distancua prej nifakut të tij dhe tha: O Allah! Unë akoma kënaqem me dëgjimin e ajeteve të tua, akoma më rrëngqethet mishi prej tyre dhe të më tronditet zemra. O Allah! Ma merr shpirtin duke u vrarë në rrugën tënde.

Po kështu ai që u del përkrah dhe i ndihmon munafikët dhe tagutët, ai bie në nifak edhe nëse më përpara ka qënë musliman. Grada e nifakut të tij bazohet në gradën e ndihmës dhe përkrahjes që u ofron tagutëve dhe munafikëve, siç ndodhi me Sad ibn Ubaden ﷻ atëhere kur i doli përkrah kokës së nifakut, Ibn Ubejit në çështjen e akuzimit të Aishes dhe i tha Sad ibn Muadhrit ﷻ: **“Gënjen pasha Allahun. Nuk ke për ta vrarë dhe as që ke mundësi që ta vrasësh”. Atëhere Usejd ibn Hudejri ju drejtua Sad ibn Ubades me fjalët: “Gënjeshtar! Pasha Allahun kemi për ta vrarë. Ti je munafik dhe debaton për munafikët”. Aisha thotë për Sad ibn Ubaden: “Ai përpara kësaj ngjarje ka qënë njeri i detvotshëm por e zuri euforia (për fisin e tij)”.** E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

Gjithashtu historia e Ebu Lubabes ﷻ kur ua bëri me shenjë çifutëve nga fisi Kurejdha se nëse do pajtoheshin me gjykimin e Muhamedit ﷺ ai ka për të gjykuar me vrasje, prandaj ua bëri me shenjë duke vendosur dorën në fyt. Thotë Ebu Lubabe ﷻ: Vallahi nuk lëviza prej vendit derisa e kuptova se e tradhtova Allahun dhe të dërguarin e tij.

Shiko se si zemra dhe imani i tij ndryshoi dhe u bind se ai kishte tradhtuar Allahun ﷻ dhe të dërguarin ﷺ, vetëm për shkak se ua bëri çifutëve me shenjë se profeti ﷺ kishte për t'i vrarë. Për këtë histori ka zbritur ajeti: **﴿O besimtarë! Mos e tradhtoni Allahun dhe të dërguarin e tij dhe kështu të tradhtoni amanetet tuaja pa e kuptuar﴾** El enfal, 27.

Nëse ky ajet bën fjalë për atë që ua bëri me shenjë vetëm një herë të vetme si qëndron puna me atë që gjithë jetën punon si spiun dhe agjent i tyre kundër muslimanëve. Padyshim ai më shumë e meriton të jetë munafik dhe tradhtar ndaj Allahut ﷻ, të dërguarit ﷺ dhe besimtarëve.

Po ashtu ata që e ndalojnë umetin prej xhihadit dhe i pengojnë muslimanët prej luftës në rrugë të Allahut ﷻ, duke u tallur me muxhahidat dhe duke i etiketuar ata me fjalë përçmuese dhe i trembin njerëzit prej tyre dhe i pengojnë prej ndihmës së tyre dhe i akuzojnë

për injorancë e çmenduri dhe se ata janë fitneshin për shkak të xhihadit të tyre e shumë e shumë fjalë të tjera. Këto fjalë dhe vepra janë dëshmi për nifak, të çojnë në nifak dhe kryhen vetëm prej munafikëve, Allahu na ruajt prej tyre.

Allahu ﷻ, thotë për ta: **«Allahu i njeh mirë ata që pengojnë (prej xhihadit) dhe ata që u thonë vëllezërve të tyre: Ejani me ne (dhe mos shkoni në xhihad) dhe aspak nuk shkojnë në vështirësi (në luftë)»** El ahzab, 18.

Dhe thotë: **«Ata që u thanë vëllezërve të tyre dhe nuk dolën (për xhihad): Nëse do na bindeshin ne nuk kishin për t'u vrrarë. Thuaj: Shmangeni atëhere vdekjen prej veteve tuaja nëse po thoni të vërtetën»** Ali Imran, 168.

Dhe thotë: **«Nuk të kërkojnë leje ata që besojnë Allahun dhe botën tjetër për të mos luftuar me pasuritë dhe vetet e tyre dhe Allahu i njeh mirë të ruajturit. Leje kërkojnë vetëm ata që nuk besojnë Allahun dhe botën tjetër dhe zemrat i kanë plot dyshim dhe ata në dyshimin e tyre vërtiten»** Et teube, 44-45.

Ibn Tejmije në Mexhmuul Fetaua (28/438) thotë: *“Në këtë ajet Allahu ﷻ na tregon se besimtari nuk i kërkon profetit ﷺ leje për lënien e xhihadit, por ata që kërkojnë leje janë ata që nuk besojnë. Ç'mund të themi atëhere për ata që e lenë xhihadin pa kërkuar leje fare?!”*.

Them: Si është puna e atyre që e pengojnë umetin prej xhihadit dhe i konsiderojnë muxhahidat gjynahqarë dhe kriminelë për shkak të xhihadit?!

Si është puna e atij që e hedh poshtë të gjithë xhihadin dhe e pengon umetin prej tij bazuar në keqinterpretime të pavlera të cilat origjinën e kanë te frika dhe tutja?!

Si është puna e atij që e urren xhihadin dhe më të mirët e këtij umeti, duke i armiqësuar ata dhe duke i nxitur njerëzit kundër tyre dhe kundër xhihadit të tyre?!

Si është puna e atij që në vend të xhihadit thërret në rrugën e kotë të shirkut, në rrugën e demokracisë, në zgjedhjet parlamentare etj?! Pa dyshim ai është më afër nifakut dhe rrëzimit të imanit.

Çdo njeri le të tregohet i kujdesshëm e të mos i ndihmojë armiqtë e Allahut qoftë edhe në një fjalë apo situatë! Të mos i frenojë njerëzit prej xhihadit! Të mos e bëjë veten armik të xhihadit dhe muxhahidave! Të mos i përkrah zullumqarët kundër tyre, që të mos bjerë në nifak pa e ndier dhe pa e kuptuar edhe nëse më përpara ka qënë musliman besimtar, sepse parasysh merret vetëm përfundimi i njeriut. I kërkojmë Allahut ﷻ të na ruaj dhe të na dhurojë përfundim të mirë.



Zendeka dhe zindiku

Zindiku është munafiku, sepse ai në brendësi ka akide kufri dhe në të njëjtën kohë e shfaq islamin. Dallimi mes tyre është se zindiku shfrytëzon rastin për përhapjen e kufrit të tij aq sa kur njerëzit e njohin dhe sillet për gjykim dhe i kërkohet pendim ai e mohon të ketë thirrur për kufër.

Mendimi më i saktë prej mendimeve të dijetarëve është se zindiku vritet dhe nuk i kërkohet teube nëse e shfaq kufirin dhe bëhet i njohur me të, sepse kërkimi i teubes bëhet për diçka të ditur, ndërsa zindiku e mohon kufirin dhe riddën e tij, megjithë provat e qarta që i paraqiten.

Ebu Idrisi thotë: *“I sollën Aliut ﷺ disa zindikë që kishin bërë ridde prej islamit dhe i pyeti mirëpo ata e mohuan. Më pas u sollën prova të qarta prej dëshmitarëve.*

Thotë: I vrau dhe nuk u kërkoi teube. Pastaj i sollën një të krishter që kishte pranuar islamin dhe pastaj dezertoj prej islamit. Thotë: E pyeti dhe e pranoi, pastaj i kërkoi që të pendohej dhe më pas e la të lirë.

I thanë: Pse i kërkove këtij të pendohej dhe nuk i kërkove të tjerëve. Tha: Ky e pohoi atë që kishte vepruar ndërsa ata e mohuan derisa u provua me prova prandaj nuk u kërkova të pendoheshin.

*Ndërsa në një transmetim tjetër thuhet: A e dini pse kërkova prej këtij të krishteri të pendohej? I kërkova të pendohej, sepse ai e shfaqti fenë e tij, ndërsa zindikët që u dënuan me prova e mohuan dhe i vrava sepse mohuan përballë provave të qarta”.*¹

Ibn Tejmije në “Sarimul meslul” fq. 350 shprehet: *“Për lejimin e vrasjes së zindikut munafik pa i kërkuar teube dëshmon edhe hadithi i transmetuar në dy sahihet prej Aliut rreth historisë së Hatib ibn Beltas ﷺ, kur Umeri ﷺ tha: Më jep leje o i dërguar i Allahut ‘tia heq qafën këtij munafiku. Por i dërguari i Allahut ﷺ i tha: “Ai ka marrë pjesë në Bedër. Ku e di ti se Allahu nuk i ka vështruar pjesmarrësit e Bedrit dhe ka thënë: Veproni çfarë të doni sepse ua kam falur”.*

Ky hadith dëshmon se vrasja e munfikut pa i kërkuar teube është e lejuar sepse profeti ﷺ nuk e qortoi Umerin ﷺ për lejimin e vrasjes së munfikut, por ju përgjigj se ai nuk është munafik, sepse është pjesëmarrës në Bedër të cilët janë të falur. Por nëse e shfaq nifakun, i cili është nifak i pastër atëhere gjaku i tij është i lejuar”.

¹ E përmend Ibn Tejmije në librin e tij “Sarimul meslul”, fq. 360.

Ibn Kajimi në “I’lam el-muuaki’in” (2/144) thotë: “Prej argumenteve se pendimi i zindikut pas kapjes, nuk e mbron prej dënimit është edhe fjala e Allahut: **﴿Thuaj a prisni për ne përveç njëres prej dy të mirave ndërsa ne presim që t’ju godasë Allahu me dënimin e tij ose me duart tona﴾** Et teube, 52. Selefi thonë për këtë ajet **﴿ose me duart tona﴾**: ose me vrasje nëse e shfaqni atë që keni në zemra.

Ky mendim është i drejtë sepse dënimi me duart e besimtarëve për kufirin që e fshehin kryhet vetëm me vrasje. Nëse do të lejohej pranimi i pendimit të tyre pas zendekas muslimanët nuk do të kishin mundësi që të presin t’i dënojnë zindikët me duart e tyre, sepse sa herë që të duan t’i dënojnë zindikët, ata do të hiqen me islam dhe do të shpëtojnë prej dënimit”.

Mirëpo nëse zindiku pendohet sinqerisht para se të kapet dhe distancohet prej kufirit dhe zendekasë së mëparshme dhe e pranon gabimin për atë që besonte dhe vepronte, në këtë rast mendimi më i saktë është se i pranohet pendimi dhe nuk vritet bazuar në fjalën e Allahut: **﴿përveç atyre që pendohen para se t’i kapni﴾** El maide, 34. Pra ka dallim mes pendimit para se të kapet dhe pas kapjes.

Ibn Kajimi në “I’lamul muuaki’in” thotë: “Këtë mendim¹ e ka dhënë Ebu Jusufi, Ahmedi në një nga dy rivajetet e tij. Ky dallim është nga mendimet më mira në këtë çështje”.

Dispozita për zindikët vlen edhe për grupet batini ekstreme, për sekularisët dhe për këdo që u përngjan atyre.

Këtu tërheqim vërejtjen se në këtë kohë, për shkak të mospasjes shtet islam dhe as ligje të shariatit, nuk gjen nifak dhe munafikë, por vetëm zendeka dhe zindikë. Këta njerëz e shfaqin islamin në disa gjëra dhe e shfaqin kufirin dhe cënimin e fesë në gjëra të tjera, sepse ata janë të sigurtë se askush nuk do t’i marrë në llogari.

Lind pyetja: Përse atëhere e shfaqin islamin?

Themi: E shfaqin islamin që njerëzit të mos i braktisin dhe të mos i akuzojnë me kufër se pastaj pësojnë humbje të madhe morale dhe shoqërore, e cila është në disfavor të tyre. Prandaj mund të gjesh shumë njerëz që e veprojnë kufirin gjatë e gjërë, mirëpo kurrsesi nuk pranohet që të akuzohet me kufër dhe zendeka.



¹ Mendimin e pranimit të teubes së zindikut nëse pendohet para se të kapet.

Ridja

Ridja është kalimi prej fesë islame në një fe tjetër. Murted është ai person që bën kufër pas islamit. Sa herë që në shariat përmendet ridja me të kihet për qëllim kufri i madh sepse nuk ka në shariat ridde të vogël si kufri, fisku dhe dhulmi i vogël.

Ridja në shariat klasifikohet në dy lloje: Ridde e thjeshtë dhe ridde e rëndë.

Të dyja këto lloj riddesh e nxjerrin personin prej islamit dhe dallimi mes tyre është vetëm në pranimin e pendimit siç do të sqarohet.

1- Ridja e thjeshtë:-

Kjo ridde nuk pasohet me prishje, cënim apo luftim të islamit dhe muslimanëve. Sipas sunetit, konsumuesit të një ridje të tillë duhet t'i kërkohet pendimi, e nëse pendohet prej kufrit pranohet, dhe kjo është më e mirë për të, e në të kundërt vritet.

Transmeton imam Ahmedi me sened të tij prej Ibn Abasit ؓ se një person prej ensarëve bëri ridde prej islamit dhe shkoi me mushrikët dhe Allahu ﷻ zbriti: **﴿Si ta udhëzoj Allahu atë popull që bënë kufër pas imanit të tyre dhe dëshmuan që i dërguari është i vërtetë dhe u erdhën argumentet e qarta. Allahu nuk e udhëzon popullin zullumqar﴾** deri në fjalën e tij **﴿përveç atyre që pendohen dhe veprojnë mirë sepse Allahu është falës dhe mëshirues﴾** Ali Imran 86-89. Të afërmit e tij ia dërguan këto ajete dhe pastaj u kthye i penduar. Atëhere profeti ﷺ e pranoi dhe e la të lirë.¹

Prej Muhamed ibn Abdullah ibn Abdulkariut thotë: Një burrë erdhi te Umer ibn Hatabi ؓ prej Ebu Musa Eshariut ؓ dhe e pyeti për njerëzit dhe ai u përgjigj. Pastaj i tha: A ke ndonjë lajm të rëndësishëm? I tha: Po! Një burrë bëri kufër pas islamit. I tha: Si vepruat me të? I tha: E kapëm dhe e vramë. Atëhere Umeri ؓ i tha: ***Sikur ta kishit burgosur tre ditë do ishte më mirë! Çdo ditë t'i jepnit bukë dhe t'i kërkonit pendim se mbase pendohej dhe kthehej në fenë e Allahut ﷻ. O Allah! Unë nuk isha prezent dhe as nuk i urdhërova dhe as nuk më pëlqeu ky veprim kur më erdhën lajmet.***²

Prej Abdullah ibn Utbes thotë: ***“Ibn Mesudi ؓ kapi disa njerëz prej Irakut që kishin dezertuar prej islamit dhe i shkroi Uthman ibn Afanit ؓ dhe Uthmani ؓ iu përgjigj: Paraqitua atyre fenë e vërtetë dhe dëshminë se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahu. Nëse e pranojnë lëri të lirë, e nëse nuk e pranojnë vriti. Disa prej tyre e pranuan***

¹ E përmend Ibn Tejmije në “Es-sarim el-meslul” të cituar prej imam Ahmedit.

² E përmend Ibn Tejmije në “Es-sarim el-meslul” dhe thotë: E transmeton Maliku, Shafiiu dhe Ahmedi

*dhe i liroi, e disa të tjerë nuk e pranuan dhe i vrau”.*¹

Ibn Tejmije rreth fjalës së Allahut ﷻ: **«E kur të mbarojnë muajt e shenjtë vritini mushrikët»** e deri te fjala e tij **«E nëse pendohen dhe e falin namazin dhe e japin zekatin atëhere lërimi të lirë»** thotë: *“Kjo fjalë përfshin luftimin e çdo mushriku dhe lëshimin e tij nëse pendohet prej shirkut, e fal namazin dhe e jep zekatin, qoftë ai mushrik në origjinë apo mushrik murted”.*²

Nga kjo që përmendëm sqarohet se syneti për murtedin që bën ridde të thjeshtë është kërkimi i teubes dhe pranimi i saj nëse heq dorë prej kufrit, e në të kundërt vritet, bazuar në fjalën e profetit ﷺ: **“Vriteni atë që e ndërron fenë e tij”.**³

2- Riddja e rëndë.

Është ajo ridde e cila pasohet me shkatërrim, cënim, keqbërje, vrasje, sharje të profetit ﷺ etj. Një murtedi të tillë nuk i pranohet teubeja⁴ nëse kapet dhe nuk konsiderohet si ai që bën ridde të thjeshtë. Kështu është syneti dhe kështu kanë vepruar edhe selefi.

Transmetohet se Enesi ؓ ka thënë: **“Një grup prej fisit Akel erdhën te i dërguari i Allahut ﷻ, mirëpo u ndikuan nga moti i Medines. Ai i urdhëroi të shkonin dhe të pinin prej qumëshit dhe urinës së deveve të sadakave. Ata vepruan kështu derisa u shëruan. Pastaj dezertuan (bën ridde), vranë barinjte dhe rrëmbyen devetë. Profeti ﷻ urdhëroi të viheshin në ndjekje të tyre derisa i kapën, pastaj ua preu duart dhe këmbët dhe ua nxorri sytë dhe i braktisi derisa vdiqën”.** Në një transmetim tjetër thuhet: **“I hodhën në shkretëtirë dhe luteshin prej etjes, por askush nuk u dha të pinin derisa vdiqën”.**

Në transmetimin e Muslimit thuhet: **“Pastaj udhëroi që t’u pritëshin duart dhe këmbët dhe iu nxorren sytë, pastaj u flakën nën përvëlimin e diellit derisa vdiqën”.**⁵

I gjithë ky dënim ishte për shkak se ridja e tyre u pasua me vjedhje të pasurisë, vrasje padrejtësisht dhe shpërfillje dhe nënvlersim të shtetit islam që udhëhiqej prej profetit ﷺ.

Në sahihun e Buhariut transmetohet prej Enes ibn Malikut ؓ se i dërguari i Allahut ﷻ hyri në vitin e Çlirimit të Mekës dhe në kokë kishte veshur një helmetë. Kur e hoqi atë i erdhi një person dhe i tha: **“Ibn Hatali është kapur pas pëlhurës së Qabes i penduar dhe kërkon mëshirë. Tha: Vriteni!”.**

¹ E përmend Ibn Tejmije në “Es-sarim el-meslul” dhe thotë: E transmeton Ahmedi me sened sahih.

² Es sarimul meslul, fq 318.

³ E transmeton Buhariu.

⁴ Me pranimin dhe refuzimin e teubes këtu kihet për qëllim pranimi i saj prej kadiut ose sundimtarit musliman në dunja dhe jo pranimi i teubes prej Allahut ﷻ sepse nëse teubja e tij është e sinqertë Allahu ﷻ e pranon atë dhe e fal. Shën. i përkthyesit.

⁵ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

Kjo përshkak se ai nuk u mjaftua me ridde por filloi të shante profetin ﷺ, të përdhoste fenë dhe të luftonte islamin dhe muslimanët.

Gjithashtu rasti i gruas që tallte profetin ﷺ me shpoti, rreth të cilës Ebu Bekri ؓ i shkroi Muhaxhir ibn Ebi Rabias ؓ: **“Sikur të mos më paraprije në vendimin tënd kisha për të të urdhëruar që ta vrisje, sepse dënimi për cënimin e profetëve nuk është njësoj si dënimet e tjera. Çdo musliman që vepron kështu është murted dhe çdo muahed është muhareb tradhtar”**.¹

Ibn Tejmija në *“Mexhmu’ul fetaua”* (20/103) thotë: *“Bëhet dallim mes murtedit që bën thjesht ridde i cili nuk vritet nëse pendohet dhe mes murtedit që bën ridde të rëndë i cili vritet pa ju kërkuar pendim”*.

Në librin e tij *“Es sarim el meslul”* shton: *“Në sunetin e profetit ﷺ do të gjejmë se bëhet dallim mes dy llojeve. Ai e pranoi teuben e disa murtedëve, mirëpo urdhëroi që Mekis ibn Hibaba të vritej në ditën e Çlirimit të Mekës pa ju kërkuar pendim, sepse ai rriden e pasoi me vrasjen e muslimanëve, rrëmbimin e pasurive dhe nuk u pendua para se të kapej. Ai urdhëroi edhe për vrasjen e urenijinëve të cilët e pasuan rriden e tyre me të njëjtën gjë. Gjithashtu urdhëroi për vrasjen e Ibn Hatelit i cili e pasoi rriden me sharje dhe vrasje të muslimanëve”*.

Mirëpo nëse pendohet para se të kapet dhe vetëdorëzohet i penduar dhe i kthyer te e vërteta a pranohet pendimi i tij apo jo?

Mendimi më i saktë është se pranohet, bazuar në fjalën e Allahut ﷻ: **﴿Dënimi i atyre që luftojnë Allahun dhe të dërguarin e tij dhe përhapin në tokë shkatërrim është vrasja ose kryqëzimi ose t’u priten duart dhe këmbët e tyre kundërzi ose të dëbohen prej vendit. Ky është poshtërim për ta në dynja. Ndërsa në ahiret do të meritojnë dënim të madh. Përveç atyre që pendohen para se t’i kapni dhe dijeni se Allahu është falës dhe mëshirues﴾** El maide, 34.

Allahu ﷻ ka bërë dallim mes teubes para dhe pas kapjes. Pendimi para kapjes i pranohet dhe rikthehet në islam edhe nëse luftimi i tij ka arritur gradën e riddes. Dënimet që lidhen me të drejtën e Allahut ﷻ bien, ndërsa dënimet që lidhen me të drejtat e njerëzve duhet të zbatohen dhe nuk tolerohen.

Gjithashtu nëse ka sharë ose cënuar profetin ﷺ ose tjetërkënd prej profetëve, ai vritet edhe nëse pendohet. Ky dënim nuk rrëzohet me teube edhe nëse teubeja e fshin gjynahun e kufrit dhe daljen prej islamit. Ai është njësoj si vrasësi pendimi i të cilit nuk e rrëzon dënimin e vrasjes, nëse të afërmit e viktimës nuk e falin. Profeti ﷺ gjatë jetës së tij i ka falur disa që e kanë tallur, mirëpo disa të tjerë i ka vrarë. Kjo është e një e drejtë personale e profetit ﷺ dhe

¹ Es sarim el meslul.

falja është vetëm në dorën e tij. Ndërsa pas vdekjes së tij askush prej umetit nuk është i autorizuar që të falë për një të drejtë që i takon vetëm profetit ﷺ. Askush nuk e merr guximin të pretendojë këtë të drejtë pa argumente dhe fakte. Prandaj, patjetër duhet të zbatohet dënimi me vdekje për tallësin e profetit ﷺ, kushdo qoftë ai, i penduar apo jo, qoftë pendimi i tij para se të kapet apo pasi të kapet.

Këtu duhet të pohojmë se pendimi i bën dobi në ditën e gjykimit, sepse pendimi i fshin gjynahet e mërparshme. Këtë çështje e kam filluar në librin tim “*Vërejtje ndaj të shkujdesurve për dispozitën e talljes me Allahun dhe fenë*”.

Vërejtje:-

Kohët e fundit disa publicistë dhe organizata fetare, për interesa vetjake, kanë filluar të mohojnë dispozitat e riddes dhe të murtedit dhe dënimin e tij me vrasje. Ata kanë përhapur shumë mjegull rreth kësaj çështje, për hatër të organizatave dhe institucioneve amerikane dhe perendimore dhe si përkrahje të demokracisë, që po mbizotëron si rend botëror dhe thërret për lirinë e mendimit, të shprehjes dhe besimit pa kushte dhe kufizime edhe nëse shpejta e mendimit dhe e besimit është kufër i qartë, apo tallje e qartë me Allahun ﷻ dhe të dërguarin e tij ﷺ.

Përveç kundërshtimit të tekseve të qarta të shariatit për vrasjen e murtedit, ata po i nxisin njerëzit për ridde duke shfaqur haptas idetë e kufrit dhe të zindikëve, sepse kjo është thjesht shprehje e lirisë të cilën e gëzojnë dhe e respektojnë të gjithë.

Ata nuk bënë dallim mes lirisë së mirë dhe rregullimit, lirisë së shpalosjes së të vërtetës përpara të padrejtëve, këtë liri me të cilën islami ka ardhur dhe e kanë pranuar njerëzit e asryeshëm, dhe mes lirisë së të keqes dhe shkatërrimit, të cilën islami dhe njerëzit me natyrë të pastër e luftojnë.

I pyesim: Në kohën tonë asnjë dispozitë islame nuk zbatohet. Përse atëhere gjithë kjo zhurmë për dispozitën e riddes? Çfarë qëllimi keni me këto thirrje?

Përgjigja duket qartë. Ata duan t’u japin zindikëve të kësaj kohe më shumë liri për përhapjen e të keqes. Duan t’u thonë atyre: Nuk keni pse të friksoheni. Frika prej dënimin të riddes që ju ka ndjekur si hije për shekuj të tërë, që ju pengonte ta hapnit trastën e helmit, që ua prente hovin e kufrit dhe mohimit, tashmë nuk ekziston më, prandaj mos u friksoni sado sherr dhe shkatërrim të shfaqni dhe të zhyteni në llumin e kufrit.

Çthurini njerëzit dhe vendet! Shkatërrojini shoqërinë! Shajeni Allahun ﷻ dhe profetin ﷺ e tij! Talluni me fenë e Allahut ﷻ si dhe kur të doni, pa u friksuar sepse askush nuk do t’ju marrë në përgjegjësi. Kjo është e drejta juaj të cilën vetë islami ua ka dhuruar dhe të gjithë duhet ta respektojnë.

Këta të vetëquajtur publicistë islamë dhe me famë, në realitet janë sëmundje që ka pllakosur umetin prej mëse një shekulli. Ata përfaqësojnë demoralizimin shpirtëror dhe dobësinë e shtresave të mëdha prej pasuesve të këtij umeti përballë sfidave të jashtme dhe kulturave të huaja dhe të prishura.

Këta publicistë të demoralizuar janë hajdutë të vërtetë që nuk u zihet besë as në fe dhe as në dynja. Ata profeti ﷺ i ka cilësuar shumë bukur me fjalët: **“Çdo munafik orator”**, prandaj kini kujdes prej tyre!



Epshi

Fjala arabe “*El haua*” nënkupton: devijim, anim, dashuri, pasion dhe epsh, teke dhe kapriço dhe përdoret për mirë ose për keq. Ajo vjen me kuptimin e dëshirës së diçkaje dhe “hauaja e vetes”, është dëshira e saj, Allahu thotë ﷻ: **«dhe e ndalon veten e tij prej epshit (hauasë)»** e ndalon veten prej epshit që të çon në gjynahe.

Fjala “*El haua*” kur përmendet e papërcaktuar me një fjalë tjetër përdoret vetëm me kuptim të keq, derisa të përshkruhet me një fjalë që i jep një kuptim tjetër si: haua (dëshirë) e mirë, ose haua (dëshirë) e drejtë.¹

Në shariat, përdoret me kuptimin e kufrit të madh dhe ndonjëherë përmendet me kuptimin e fiskut i cili është më i vogël se kufri, në varësi të gjësë që pason për shkak të epshit. Nëse epshi e shtyn që të pasojë kufirin, të rrëzojë islamin, të adhurojë tjetërkënd përveç Allahut ﷻ, të bëjë hallall dhe haram atë që i thotë epshi, të gjykojë gjërat për mirë dhe keq në varësi të epshit, atëhere në këtë rast epshi i tij është i adhuruari i tij përveç Allahut ﷻ dhe nënkupton kufirin e madh që të nxjerr prej islamit.

Ndërsa pasimi i epshit në gjynahe që janë më të vogla se kufri, si pirja e verës, zinaja, por pa i konsideruar si të mira dhe hallall, nënkupton fisk dhe gjynah që është nën kufirin e madh. Në vijim po paraqesim argumentet për të dy kuptimet e kësaj fjale.

Epshi me kuptimin e kufrit të madh që të nxjerr prej islamit.

Allahu ﷻ thotë: **«Mos iu bind atij që ja kemi shkujdesur zemrën për përkujtimin tonë dhe e ka pasuar epshin e tij dhe çështja e tij është e kotë»** El kehf, 28.

Dhe thotë: **«Mos i paso epshet e atyre që i kanë përgënjeshtuar ajetet tona»** El Enam, 150.

Dhe thotë: **«E nëse do i pasosh epshet e tyre pas dijes që të ka ardhur atëhere nuk ke për të gjetur ndaj Allahut asnjë mbrojtës dhe asnjë ndihmues»** El bekare, 120.

Dhe thotë **«Sikur e vërteta të ndiqte epshet e tyre kishte për t’u shkatërruar qielli dhe toka dhe çdo gjë që është në to»** El muminune, 71.

Dhe thotë: **«A e shikon atë që e ka marrë epshin e tij për zot (të adhuruar)? A mos vallë dëshiron të jesh mbikëqyrës i tij?!»** El furkan, 43.

¹ Shiko fjalorin “Lisanul arab”. Them: Pas hulumtimit të ajeteve të Kuranit do të gjejmë se kjo fjalë në Kuran përmendet vetëm me kuptimin e keq.

Dhe thotë: **﴿A e shikon atë që e ka marrë epshin e tij për zot (të adhuruar) dhe Allahu e ka humbur me dije﴾** El xathijeh, 23.

Epshi i përmendur në këto ajete nënkupton kufirin e madh që të nxjerr prej islamit.

Ibn Tejmije në “*Mexhmu’ul fetaua*” thotë: “*Kush e adhuron atë që e admiron me epsh ai e ka marrë epshin e tij për zot (të adhuruar) dhe atë që e ka admiruar me epsh, ai është i adhuruar i tij, sepse ai nuk po adhuron atë që e meriton adhurimin (Allahun) por po adhuron epshin e tij. Ky që epshin e tij e merr për zot, ka dashuri si dashuria e mushrikëve për zotët e tyre dhe si dashuria e adhuruesve të viçit për viçin e tyre.*”

Kjo është dashuri me Allahun dhe jo për Allahun. Kjo është dashuria e mushrikëve. Njerëzit pretendojnë nganjëherë se e duan Allahun, por në realitet dashuria e tyre është dashuri shirku sepse ata duan atë që e admirojnë me epsh, të cilin e kanë bërë ortak me Allahun (në dashurinë e tyre)”.

Në këtë nocion hyn edhe bërja e epshit burim prej burimeve të legjislacionit, të vlerësimit të gjërave si të mira apo të këqija, si realiteti i shumicës së rendeve bashkohore. Hallall është ajo që epshi i tij e shikon për hallall. E mirë është ajo që epshi i tij e shikon për të mirë. E keqe është ajo që epshi i tij e shikon për të keqe edhe nëse në shariat vlerësohet ndryshe. Ky është shirk i madh, sepse e ka bërë epshin e tij ortak me Allahun në një nga cilësitë më specifike të uluhijes, sepse Allahu ﷻ thotë: **﴿Nuk e bën askënd ortak në gjykimin e tij﴾** El kehf; 26, ndërsa këta e bëjnë epshin e tyre ortak me Allahun ﷻ në gjykimin e tij madje e bëjnë epshin burim primar të legjislacionit, mos të themi që ai është burimi i parë dhe i fundit.

Kur një person prej fisit Temim i tha profetit ﷺ: Lavdërimi im është i bukur dhe nënçmimi im është i keq, profeti ﷺ ia ktheu: **“Kjo i takon Allahut”**. Pra ai që cilësohet kështu është Allahu ﷻ, krijuesi i çdo gjëje dhe jo robi i krijuar. Kush i lakomon këto cilësi ka lakmuar cilësitë më specifike të uluhijes së Allahut ﷻ. Ai i ka tejkaluar caqet në cilësitë më të veçanta të Allahut ﷻ, me të cilat përshkruhet vetëm ai dhe askush tjetër prej krijesave të tij.

Epshi me kuptimin e pabindjes dhe gjynahut i cili është më i vogël se kufri i madh.

Si në fjalën e Allahut ﷻ: **﴿Mos e ndiqni epshin që të mos devijoni e të favorizoni (njërën palë) dhe të fshihni dëshminë (ndaj palës tjetër), sepse Allahu e di atë që veproni﴾** En nisa, 135.

Dhe fjala e Allahut ﷻ: **﴿Ndërsa ai që friksohet prej qëndrimit para Zotit të tij dhe e pengon veten e tij prej epshit atëhere përfundimi i tij do të jetë xheneti﴾** En naziat, 41, pra nëse e ndalon veten prej gjynaheve që e joshin.

Begeviu thotë në tefsirin e tij: “*Mukatili thotë: Bëhet fjalë për personin që joshet prej gjynahut, por përkujton qëndrimin për llogari përpara Allahut ﷻ dhe e braktis atë*”.

Gjynahet, sado të të shumta të jenë, me kusht që të mos arrijnë gradën e shirkut dhe konsiderimin hallall, nuk konsiderohen kufër i madh dhe nuk e nxjerrin njeriun prej islamit.

Pra u qartësua se me fjalën epsh nganjëherë nënkuptohet kufri dhe nganjëherë nënkuptohet ajo që është më e vogël se kufri. Pasuesi i epshit nganjëherë mund të jetë qafir dhe nga njëherë mund të jetë fasik, në varësi të epshit që e pason dhe mënyrës se si e pason, sepse ka dallim mes pasimit që vjen si rezultat i dobësisë dhe joshjes që shoqërohet me ndjenjë fajësie dhe pendim dhe mes pasimit përshkak se e shikon atë gjë të bukur dhe të lejuar. I pari nuk është kufër ndërsa i dyti po. Allahu është më i ditur.



Miqësimi

Fjala arabe “*el muvalah*” është antonim i armiqësimit dhe nënkupton dashuri, përkrahje dhe aleancë. Prej nënkuptime derivate të kësaj fjale janë: nënshtrimi, afrimi, lajkat, shoqërimi i ngushtë. Për të gjitha këto kuptime kanë ardhur argumente prej Kuranit dhe sunetit.

Miqësimi ndërmjet besimtarëve është vaxhip ndërsa miqësimi i qafirëve është haram.

Miqësimi në shariat është dy llojesh; miqësim i madh dhe miqësim i vogël.

Miqësimi i madh:-

E shtin vepruesin e tij në kufër të madh dhe e nxjerr prej islamit. Ky lloj miqësimi ndodh atëhere kur ndihmon qafirët, lidh aleancë me ta kundër muslimanëve, ose i ndihmon ata për torturimin e muslimanëve dhe përhapjen e fitnes në mesin e tyre. Gjithashtu realizohet me dashurinë e qafirëve dhe dashurinë e atyre që i duan ata, ose me urrejtien e atyre që i urrejnë qafirët; pra kur e bazon urrejtjen dhe dashurinë në miqësimin dhe urrejtjen e qafirëve. Atë që i miqëson qafirët e miqësojnë, e duan dhe e afrojnë, ndërsa atë që i armiqëson ata, armiqëohen me të, e urrejnë dhe e largojnë. Ky lloj miqësimi është kufër i madh dhe është nga prishëset më të rënda të islamit. Argumentet rreth kësaj janë të shumtë, prej tyre:

Fjala e Allahut ﷻ: **﴿O besimtarë! Mos i merrni çifutët dhe të krishterët për miq, sepse ata janë miq të njëri-tjetrit. Kushdo prej jush që i merr ata për miq ai është prej tyre﴾** El Maide, 51.

Ibn Sirini thotë: Abdullah ibn Utbe ka thënë: Çdokush prej jush të ruhet se mos është çifut apo i krishterë. E kuptuam se ai kishte për qëllim këtë ajet: **﴿O besimtarë! Mos i merrni çifutët dhe të krishterët për miq﴾** El maide, 51.¹

Miqësimi i përmendur në ajet nënkupton miqësimin e ndihmës dhe aleancës dhe jo miqësimin në fe dhe akide siç vërtetohet prej shkakut të zbritjes së këtij ajeti.²

Ibn Kethiri në komentimin e këtij ajeti thotë: “*Kur fisi Kurejdha luftuan profetin ﷺ*

¹ E përmend Ibn Kethiri në tefsirin e tij.

² Dijetarët e murxhive pretendojnë se miqësimi që e nxjerr njeriun prej islami është miqësimi në fe dhe akide, ndërsa llojet e tjera të miqësimeve hyjnë te miqësimi me vepra që nuk e nxjerr njeriun prej islamit.

Kjo bie ndesh me argumentet e Kuranit dhe të sunetit, sepse pëlqimi i fesë dhe akides së qafirëve është kufër më vete me apo pa miqësim. Pëlqimi dhe kënaqja me kufirin është diçka ndërsa miqësimi është diçka tjetër, edhe nëse të dyja ato janë kufër që të nxjerrin prej islamit.

Abdullah ibn Ubeji i përkrahu. Ndërkohë Ubade ibn Samit ؓ prej familjes Auf nga Hazrethët që kishte aleancë me ta njësoj si Abdullah ibn Ubeji vajti te profeti ﷺ dhe e prishi aleancën mes tyre përpara profetit ﷺ dhe u distancua prej tyre për hir të Allahut dhe të dërguarit, dhe i tha: O i dërguar i Allahut! Distancohem për hir të Allahut dhe të dërguarit të tij prej aleancës së tyre. Aleatët e mi janë vetëm Allahu, i dërguari i tij dhe besimtarët dhe distancohem prej aleancës së qafirëve dhe miqësimit të tyre. Për Ubade ibn Samit ؓ dhe Abdullah ibn Ubejin kanë zbritur këto ajete në suren El Maide”.

Sejid Kutbi në tefsirin e tij “Nën hijen e Kuranit” thotë: “Kuptimi i miqësimit prej të cilit Allahu ﷻ i ka ndaluar besimtarët është përkrahja dhe aleanca me çifutët dhe të krishterët, jo në kuptimin e përqafimit të fesë së tyre, sepse është pothuajse e pamundur që një musliman t’i pasojë ata në fenë e tyre. Prandaj këtu nënkuptohet aleanca dhe përkrahja”.

Sheukani në komentimin e fjalës së Allahut **﴿Kushdo prej jush që i miqëson ata ai është prej tyre﴾** thotë: “Ai është prej grupit të tyre dhe llogaritet prej tyre. Ky është një kërcënim i madh, sepse ky gjynah, që ka arritur gradën e kufrit, i ka tejkaluar të gjitha kufinjët. Ndërsa fjala **﴿Allahu nuk e udhëzon popullin zullumqar﴾** tregon shkakun e ajetit të mëparshëm, pra rënia e tyre në kufër është për shkak të mosudhëzimit prej Allahut ﷻ për ata që bëjnë padrejtësi veteve të tyre me kufër, si puna e atij që miqëson qafirët”.

Allahu thotë: **﴿E nëse do besonin në Allahun dhe profetin dhe në atë që ju zbrit atij, nuk kishin për t’i zënë ata për miq, por të gjithë ata janë fasikë (të pabindur)﴾** El maide, 81.

Ibn Tejmije në “Mexhu’ul fetava” 17/7 thotë: “Kjo dëshmon se imani në aspektin e sheriatit bie në kundërshtim me zënieën miq të qafirëve. Nuk mund të bashkohen në zemër imani dhe miqësimi i tyre. Njësoj si ky ajet është edhe fjala e Allahut: **(Mos i merrni çifutët dhe të krishterët për miq, sepse ata janë miq të njëri-tjetrit. Kushdo prej jush që i merr ata për miq ai është prej tyre)** El maide, 51. Allahu na tregon në ajetin e mëparshëm se miqësuesi i tyre nuk është besimtar. Ndërsa në këtë ajet na tregon se ai është prej tyre, sepse Kurani vërteton njëri-tjetrin”.

Allahu thotë: **﴿Besimtarët të mos i marrin qafirët për miq përveç besimtarëve! E kush vepron kështu ai nuk është te Allahu asgjë, vetëm nëse shtireni ndaj tyre për t’u ruajtur﴾** Ali Imran, 28.

Sheukani në tefsirin e tij thotë: “Fjala **﴿nuk është te Allahu asgjë﴾** pra i distancuar prej dashurisë dhe miqësisë së Allahut, madje i distancuar prej Allahut në çdo gjë”.

Miqësia dhe dashuria e Allahut ﷻ mohohen totalisht vetëm për qafirët mizorë. Allahu thotë: **﴿E përse të mos i dënojë Allahu kur ata pengojnë prej mesxhidul-haram (qabes) dhe ata nuk janë miqtë e tij sepse miqtë e tij janë vetëm të devotëshmit﴾** El enfal, 34.

Dhe thotë: **﴿Ata që kanë bërë kufër janë miq të njëri-tjetrit. Nëse nuk veproni**

kështu ka për të ndodhur fitne (sprovë) dhe çrregullim i madh në tokë﴾ El enfal, 73.

Begeviu në tefsirin e këtij ajeti thotë: “Fitna është fuqizimi i kufrit dhe çrregullimi i madh është dobësimi i islamit”.

Kurtubiu thotë në tefsirin e tij: “Çrregullimi i madh është dominimi i kufrit”.

Dhe thotë: **﴿Ata që melekët ua kanë marrë shpirtrat si zullumqarë dhe u thonë: Ku ishit? Thanë: Ishim të shtypur në tokë. U thanë: A nuk ishte toka e Allahut e gjerë që të bënit hixhret? Strehimi i tyre do të jetë xhehenemi dhe ai është përfundimi më i keq﴾** En nisa, 97.

Dhe thotë: **﴿Ata që melekët ua kanë marrë shpirtrat zullumqarë dorëzohen dhe thonë: Nuk kemi vepruar ndonjë gjë të keqe. Përkundrazi Allahu e di mirë çfarë keni punuar prandaj hyni nga dyert e xhehenemit, të përjetshëm jeni në të dhe ajo është streha më e keqe për mëndjemëdhenjtë﴾** En nahl, 29.

Ikreme thotë: “Ky ajet ka zbritur në Medine për një grup njerëzish që u bënë musliman në Mekë, dhe nuk bënë hixhret dhe kurejshët i morrën me zorr në Bedër dhe u vranë në të”.

Në sahihun e Buhariut transmetohet prej Ibn Abasit ؓ se disa muslimanë u rreshtuan në rradhët e mushrikëve kundër të dërguarit të Allahut ﷺ sa për numër. Disa prej tyre u goditën me shigjeta dhe vdiqën. Atëhere Allahu ﷻ zbriti: **﴿Ata që melekët ua morrën shpirtrat si zullumqarë﴾**.

Këto ajete, siç i kanë komentuar dijetarët e tefsirit, dëshmojnë se ata që melekët ua kanë marrë shpirtrat si zullumqarë, ata kanë vdekur në kufër dhe në shirk për shkak të ndihmës së mushrikëve kundër muslimanëve. Një tjetër argument që e fuqizon këtë mendim është se xhaxhai i profetit, Abasi, u kap rob në betejnë e Bedrit me disa mushrikë të tjerë. Me të u veprua njësoj si me mushrikët e tjerë, për shkak të ndihmimit të mushrikëve kundër profetit ﷺ. Megjithëse ai dëshmonte që ishte musliman, mirëpo prej tij u kërkua që të shpagonte për të liruar veten, njësoj si të gjithë robërit e tjerë.

Justifikimi se ai kishte dalë në luftë kundër muslimanëve i imponuar nuk ju pranua, sepse ai kishte mundësi dhe fuqi të bënte hixhret dhe të largohej prej sundimit të qafirëve përpara se të imponohej.

Gjithashtu Halid ibn Velidi ؓ kur arriti në krye të 200 kalorësve në El Ard në krahinën e Jemames kur ata bënë ridde, u tha: “Këdo që të kapni prej njerëzve merreni! Ata arritën të kapnin Mexha’an sëbashku me 23 veta prej fisit të tij. Kur arriti te Halidi ؓ i tha: O Halid! Ti e di shumë mirë që unë kur kam vajtur te profeti ﷺ, atëhere kur ishte gjallë, i kam dhënë besën për islam. Unë sot e kësaj dite e ruaj besën e dikurshme. Nëse një gënjeshtar (Musejleme) ka dalur prej nesh atëhere Allahu ﷻ thotë: **﴿Asnjë gjynah nuk rëndon mbi**

tjetrin).

I tha: O Mexha'ah! E braktise sot atë që e përkrahe mot. Pëlqimi dhe heshtja jote përpara këtij gënjeshtari, ndërkohë që ti je prijësi i Jemames, aq më shumë që u informove për marshimin e ushtrisë sime, ishte pohim dhe pëlqim për atë që pretendonte?! Ah sikur të gjeje justifikim dhe ta kundërshtoje ashtu siç e kundërshtuan të tjerët. Ashtu siç foli dhe kundërshtoi Thumame dhe Elishkiri. E nëse thua: Pata frikë për fisin, atëhere përse nuk erdhe te unë ose të më dërgoje një të dërguar?!

I tha: O bir i Mugiras! Ma bëj hallall të gjithë këtë. I tha: Ta kam falur gjakun por në zemër akoma kam dyshim për moskundërshtimin tënd”.¹

Shejh Muhamed ibn Abdul Vehabi ka përmendur në shumë libra të tij se përkrahja e qafirëve kundër muslimanëve konsiderohet prej prishësve të islamit.²

Nipi i tij shejh Sulejman ibn Abdullahi shkon deri aty sa thotë: “Kush i mbron qafirët për patriotizëm dhe u kërkon muslimanëve që t'i lënë rehat ata, ai është prej miqve më të mëdhenj të qafirëve dhe prej murtedëve munafikë.

Mjafton për këtë ajo që transmeton Ahmedi, Tirmidhiu _e ka konsideruar hasen_ Ibn Ebi Hatim, Taberani dhe Hakimi _e ka saktësuar_ prej Ibn Mesudit ؑ thotë: Në betejën e Bedrit sollën robërit e luftës dhe në mesin e tyre ishte Abasi. I dërguari i Allahut tha: Çfarë mendoni për ta? Ebu Bekri ؑ tha: Ata janë fisi yt dhe të afërmit e tu. Ndërsa në hadithin e Enesit ؑ _transmetimi i Ahmedit_ tha: Mendojmë që duhet t'i falësh dhe të mjaftohesh me shpagim.

Ndërsa Umeri ؑ tha: O i dërguar i Allahut! Ata të përgënjeshtroan, të dëbuan dhe të luftuan, prandaj pritua kokat.

Pastaj profeti ﷺ hyri brenda (në tendë) pa folur, pastaj doli dhe tha: **“Ju jeni robër. Askush të mos lëviz përveçse me shpagim ose t'i pritët koka”**. Më pas Allahu ﷻ zbriti: **﴿Nuk i takon profetit të mbajë robër derisa të fuqizohet në tokë﴾** El enfal 67.

Nëse u kërkon muslimanëve të mos i luftojnë qafirët, me qëllim afrimin e tyre që të pranojnë islamin, ose kanë hyrë në të ose i kanë premtuar që do ta pranojnë atë edhe nëse interesi është i pakët në mosluftimin e tyre atëhere kjo lejohet.

Mirëpo nëse ka për qëllim që muslimanët të mos u qasen atyre as me luftë, as me hakmarrje, as me ashpërsi, atëhere ai është prej përkrahësve të tyre më të mëdhenj dhe ai është mik i tyre edhe nëse është larg prej tyre.

¹ Mexhmuatul teuhid, 299. Shiko se si Halid ibn velidi e konsideroi Mexha'an se ishte kënaqur dhe kishte pranuar thirrjen e Musejleme gënjeshtarit vetëm për shkak të qëndrimit të Mexha'as nën sundimin e Musejlemes pa asnjë justifikim dhe asnjë lajmërim, duke ditur që Mexha'ah nuk pati thënë asnjë fjalë që dëshmonte se ai e përkrahte dhe e pranonte thirrjen e Musejleme gënjeshtarit.

² Er resail esh-shehsije, 213.

Këtu lind një pyetje: Ky miqësim, a konsiderohet nifak apo kufër? Nëse miqësimin e shoqëron bashkjetesa me ta, në shtetin e tyre dhe dalja në luftë bashkë me ta atëhere gjykohet për këtë person me kufër¹ siç thotë Allahu ﷻ: **«Kushdo që i miqëson ata prej jush ai është prej tyre»**.²

Shejh Abdulatif ibn Abdurrahman Ali Shejh në “*Er risaletul mufidah*” fq: 64, thotë:

“Gjynahu më i madh, më i humbur dhe që e kundërshton më shumë islamin është ndihmimi dhe përkrahja e armiqve të Allahut dhe përpjekja për ta përhapur fenë, shirkun, mohimin dhe gjynahet e tyre të mëdhaja. Gjithashtu edhe hapja e zemrës ndaj tyre, bindja e tyre, lavdërimi i tyre dhe lavdërimi i atyre që i nënshtrohen dhe ingranohen me ta. Po kështu edhe lënia e xhihadit kundër tyre, paqësimi me ta dhe vllazërimi dhe bindja ndaj tyre”.

Miqësimi i vogël:-

Ky lloj miqësimi nuk e nxjerr njeriun prej islamit. Ai nuk arrin në gradën e ndihmës si miqësimi i madh dhe ndodh atëhere kur njeriu anon me një lloj dashurie dhe ndikimi nga qafirët dhe munafikët, për ndonjë interes material, ose për shkak të lidhjes farefisnore, ose për shkaqe të tjera si këto.

Transmetohet në dy sahihet, në historinë e shpifjes ndaj Aishes, se i dërguari i Allahut ﷻ tha: **“Kush më del për krah kundër një njeriu që më ka cënuar gruan _ka për qëllim Abdullah ibn Ubejin kokën e munafikëve_ . Pasha Allahun nuk di për gruan time asgjë të keqe. Ata marrin nëpër gojë një burrë për të cilin kam dëgjuar vetëm mirë. Atëhere Sad ibn Muadhi ﷺ u ngrit dhe tha: Unë të dal për krah. Nëse është prej vëllezërve tanë nga Eusi kam për t’ia prerë kokën. E nëse është prej vëllezërve tanë prej Hazrexit atëhere na jep urdhër dhe kemi për ta zbatuar urdhrin tënd.**

Në këtë çast fanatizmi e mbërtheu Sad ibn Ubaden ﷺ. Aishja thotë: Ka qënë njeri i devotshëm por e mbërtheu fanatizmi sepse Ibn Ubeji ishte i pari i fisit të tij.

Atëhere Sadi ﷺ tha: Pasha Allahun gënjen. As ke për ta vlarë dhe as që e vret dot.

Usejd ibn Hudejri ﷺ u ngrit dhe ju drejtua: Pasha Allahun gënjen! Ti je munafik dhe debaton për të përkrahur munafikët.

Gjakrat e të dy fiseve u nxehën derisa i dërguari i Allahut i qetësoi.

Megjithëse Sad ibn Ubaden ﷺ e kapi fantizmi dhe u përzie në debat pro munafikëve, mirëpo ai as nuk bëri kufër dhe as nuk ishte i miqësuar me ta me miqësi të madhe që të nxjerr

¹ Sepse miqësimi bëhet haptas, ndërsa miqësimi prej nifakut ndodh atëhere kur njeriu është nën sundimin islam e megjithatë ai i miqëson dhe i ndihmon ata fshehtas, që të mos diktohet dhe mos t’i zbulohet nifaku i tij. Kjo te Allahu konsiderohet kufër dhe gjykohet me kufër edhe prej muslimanëve nëse ai zbulohet.

² Mexhmuatul tehuhid, risaletu “Euthak ural islam”.

prej islamit.

Ibn Tejmije në “*Mexhmu’ul fetaua*” thotë: “Mund të ndodhë që dikush t’i dojë ata për shkak të lidhjes së gjakut. Kjo është gjynah që e pakëson imanin, mirëpo nuk arrin gradën e kufrit. P.sh siç ndodhi me Hatib ibn Ebi Beltean¹ ﷺ kur u dërgoi mushrikëve disa lajme rreth profetit dhe Allahu ﷻ zbriti: **﴿O besimtarë! Mos e zini armikun tim dhe armikun tuaj për mik dhe t’u shprehni atyre dashuri﴾** El mumtahineh, 1.

¹ Veprimi i Hatib ibn Ebi Beltas ﷺ konsiderohet miqësim i madh që të nxjerr prej islamit, sepse ai i ndihmoi armiqtë e islamit kundra profetit dhe muslimanëve siç përmendet në rivajetin e Taberit prej transmetimit të Harith Ibn Aliut për këtë histori se profeti tha: **“A nuk ka marrë pjesë në Bedër?!”** Umeri i tha: Po! Porse ai të ka prerë në besë dhe i ka ndihmuar armiqtë e tu kundra teje. Profeti ﷺ nuk e kundërshtoi Umerin ﷺ për fjalën se Hatibi ﷺ i ka ndihmuar mushrikët por në të njëjtën kohë nuk e aprovoi Umerin se ai ka bërë kufër dhe nifak (të madh) sepse megjithëse Hatibi veproi veprën e kufrit mirëpo nuk u bë qafir për shkaqet e mëposhtme:

Së pari: Hatib ibn Ebi Belta ﷺ veproi kështu për shkak të keqinterpretimit, duke kujtuar se kjo nuk i dëmton muslimanët, siç duket qartë prej fjalës së tij drejtuar profetit ﷺ: **“Nuk veprova kufër dhe as bëra ridde dhe as u kënaqa me kufirin pas islamit”**. Atëhere i dërguari i Allahut ﷻ tha: **“Të vërtetën ju ka thënë”**. Keqinterpretimi është pengesë për shpalljen qafir të një personi konkret.

Së dyti: Hatibi ﷺ u tregua i sinqertë me profetin ﷺ dhe nuk e mohoi veprimin e tij. Ky është argument se kishte nijet të mirë dhe ishte i pastër prej nifakut, sepse prej shenjave të munafikut është se kur flet gënjen. Kjo ishte prej shkaqeve që profeti ia fali këtë shkarje. Ndërkohë për gruan që përcillte letrën e cila e mohoi të fshinte ndonjë letër për mushrikët, profeti urdhëroi që të vritej ditën e Çlirimit të Mekës, pa ju kërkuar pendim sepse i drejti i sinqertë nuk është njësoj si mohuesi përgënjeshtues.

Së treti: Hatibi ﷺ kishte të mira të mëdha. Më e madhe prej tyre ishte pjesëmarrja në Bedër dhe dalja në luftë me profetin ﷺ, siç thuhet në hadith: **“Ai ka marrë pjesë në Bedër dhe ku e di ti se Allahu i ka vështruar pjesëmarrësit e Bedrit dhe u ka thënë: Veproni çfarë të doni sepse ua kam falur”** dhe thotë: **“Askush prej atyre që kanë prezantuar në Bedër dhe Hudejbije nuk do të futen në zjarr”**. Hatibi ﷺ ka marrë pjesë në Bedër siç transmetohet në hadithin që e transmeton imam Muslimi se një skllav i Hatibit vajti te i dërguari i Allahut ﷻ për t’u ankuar për Hatibin ﷺ dhe i tha: O i dërguar i Allahut! Hatibi vërtetë ka për të hyrë në zjarr! I dërguari i Allahut ﷻ i tha: **“Gënjen! Ai nuk ka për të hyrë në zjarr sepse ka prezantuar në Bedr dhe Hudejbije”**.

Kjo vepër kaq e mirë nuk mund të arrihet prej askujt sepse askush nuk mund të prezantojë në një betejë si Bedri. Fjalët që profeti ﷺ i tha për Hatibin ﷺ nuk mund të thuhet për atë që vepron si Hatibi ﷺ, përshkak se ai nuk i ka mirësitë e Hatibit dhe as nuk jeton në rrethanat dhe kushtet që ka jetuar Hatibi ﷺ.

Së katërti: Fjala e profetit ﷺ për Hatibin: **“Ai ju ka thënë të vërtetën”**, është prej profecisë së tij, sepse ai flet me shpallje. Askush tjetër nuk mund gjykojë për zemrat dhe sinqeritetin e njerëzve, sidomos nëse pamja e jashtme bie në kundërshtim me brendësinë. Prandaj Umeri ﷺ gjykoi mbi Hatibin ﷺ në pamje të jashtme, sepse atij nuk i lejohet të gjykojë me diç tjetër dhe tha: **“Lejomë t’ia pres qafën këtij munafiku”** ndërsa në rivajetin e Taberit thuhet: **“Mirëpo ai të preu në besë dhe ndihmoi armiqtë e tu kundër teje”**, Kjo është pamja e jashtme me të cilën gjykoi Umeri ﷺ, ndërsa ajo që është në zemra _të cilën e di vetëm Allahu dhe ai të cilit Allahu ﷻ ia tregon nëpërmjet shpalljes_ dëshmon për të kundërtën.

Së pesti: Nuk pati ndodhur më parë ndonjë histori spiunazhi prej Hatibit, në dallim me spiunët profesionista dhe të punësuar. Ky fakt ndikon në dhënien e gjykimit për persona dhe raste të veçanta.

Të gjitha këto shkaqe pengojnë për shpalljen e Hatibit si qafir, megjithëse ai pati vepruar një vepër kufri. Këtu e kuptojmë gabimin e atij që e krahason spiunin me rastin e Hatibit dhe se vepra e Hatibit (spiunimi) është kufër i vogël dhe miqësim i vogël.

Muhamed ibn Abdulvehabi thotë: **“Aprovimi i mushrikëve ndahet në tre lloje. Rasti i parë është kur i aprovon në pamje të jashtme, por jo me zemër dhe pa hyrë nën pushtetin e tyre, por për shkak të ndonjë pozite, ose ndonjë interesi material, ose për shkak të frikës për fëmijët apo për humbjen e pasurisë. Në këtë rast ai konsiderohet murted dhe nuk i bën dobi urrejtja që ka për ta në zemër dhe ky person hyn te fjala e Allahut: **﴿sepse ata preferuan jetën e kësaj bote më shumë se ahireti dhe Allahu nuk e udhëzon popullin qafir﴾**”**. (Mexhmuatul teuhid, 296).

Siç ndodhi edhe me Sad ibn Ubadën ؓ kur mbrojti Ibn Ubejin në ngjarjen e shpifjes ndaj Aishes kur i tha Sad ibn Muadhrit: “Pasha Allahun gënjen! As ke për ta vrarë dhe as që e vret dot”. Aishja thotë: “Ka qënë njeri i devotshëm por e mbërtheu fanatizmi”.

Edhe fjala e Usejd ibn Hudejrit ؓ drejtuar Sad ibn Ubades ؓ:” Gënjeshtar! Pasha Allahun kemi për ta vrarë! Ti je munafik dhe debatton për munafikët”, hyn në këtë çështje.

Edhe akuzimi i disa sahabëve për Malik ibn Dahshemin se është munafik, megjithëse ata e thanë këtë përshkak se e panë të shoqërohej me disa munafikë”.

Ky lloj miqësimi nuk është kufër, mirëpo nëse zgjerohet dhe kalon në ndihmim, përkrahje dhe aleancë me qafirët dhe munafikët duke vënë në rrezik muslimanët dhe sigurinë e tyre, ai shndërrohet në miqësi të madhe e cila e nxjerr njeriun prej islamit. Prandaj duhet bërë kujdes sepse gjynahet e vogla të çojnë te të mëdhajat dhe miqësimi i vogël për shkak të shkujdesjes të shtyn te i madhi.



Imani

Në aspektin gjuhësor nënkupton vërtetim. Ndërsa në shariat ai është: Besim, fjalë dhe veprë, shtohet me bindje dhe vepra të mira dhe paksohet me gjynahe dhe vepra të këqija.

Disa vepra konsiderohen kusht për saktësimin e imanit. Ndërsa disa të tjera konsiderohen plotësuese të imanit. Shtimi dhe pakësimi i tij lidhet pikërisht me këtë lloj të dytë të veprave.

Për këtë dëshmon Kurani, suneti dhe fjalët e selefit dhe dijetarëve të devotshëm. Më poshtë po paraqesim argumentet përkatëse:-

1- Besimi me zemër është pjesë prej imanit.

Të gjithë dijetarët janë pajtuar unanimisht se kush nuk e beson imanin me zemër ai është qafir dhe jashtë miletit islam edhe nëse në pamje të jashtme vepron dhe flet si musliman.

Allahu ﷻ thotë: **«Nëse të vinë munafikët dhe të thonë: Dëshmojmë se ti je i dërguar i Allahut! Por Allahu dëshmon se munafikët janë gënjeshtarë. I bënë betimet e tyre sa për t'u mbrojtur dhe penguan prej rrugës së Allahut. Vërtet ata vepronin shumë keq. Kjo sepse ata besuan dhe pastaj bënë kufër dhe zemrat e tyre u vulosën prandaj ata nuk kuptojnë»**. El munafikun, 1-3. Ata ishin qafirë përshkak se u shtirën me fjalë imani për diçka që nuk e besonin me zemra. Nuk i thanë ato fjalë imani se i besonin, por me nifak dhe për t'u mbrojtur prej dënimit të riddes dhe kufrit.

Allahu ﷻ thotë: **«Munafikët janë në thellësitë më të ulta të zjarrit dhe nuk ka për ata asnjë mbrojtës»** En nisa, 145.

Dhe thotë: **«Allahu u ka premtuar munafikëve dhe munafikeve dhe pabesimtarëve zjarrin e xhehenemit, të përjetshëm janë në të. Atë meritojnë dhe Allahu i ka mallkuar dhe ata do të kenë dënim të përhershëm»** Et teube, 68.

Nifaku është fshehja në zemër e kufrit dhe mohimit dhe shfaqja e islamit në vepra, prej frikës së dënimit dhe paragjykitimit të njerëzve ndaj tij.

Me këtë mashtrim, ata mashtrojnë vetëm vetet e tyre, siç thotë Allahu ﷻ: **«Përpiqen t'i mashtrojnë Allahun dhe besimtarët por ata mashtrojnë vetëm vetet e tyre»** El bekare, 9.

Kurtubiu në tefsirin e tij thotë: *“Mashtrimi i tyre është shfaqja e veprave të imanit dhe fshehja e kufrit sa për të siguruar vetet dhe pasuritë e tyre duke kujtuar se me këtë kanë*

shpëtuar dhe u ka ecur mashtrimi”.

Imam Muslimi transmeton në sahihun e tij se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Veprat janë vetëm sipas nijeteve dhe çdokujt i takon ajo që ka bërë nijet”**. Ky hadith dëshmon se pranimit i veprave, përfshi edhe imanin, varet nga nijeti në zemër, i cili nxit për kryerjen e veprave.

I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Kushdo që dëshmon se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Allahut, me vërtetim prej zemrës së tij, Allahu ka për t’ia bërë harram zjarrin”** E transmeton Buhariu.

Në një transmetim tjetër të Buhariu thuhet: **“Përgëzojuni dhe përgëzoni njerëzit pas jush se kushdo që dëshmon se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut me vërtetim ai ka për të hyrë në xhenet”**.

Këto hadithe dëshmojnë se kush dëshmon se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut ﷻ, por nuk e thotë me besim, vërtetim dhe sinqeritet prej zemrës, ai nuk ka për të hyrë në xhenet dhe as nuk do të jetë prej banorëve të tij, por do të jetë prej banorëve të zjarrit.

Argumentet për konsiderimin e besimit me zemër pjesë të imanit dhe se imani nuk është i saktë pa besim në zemër, janë të shumtë dhe nuk mund të përmenden të gjitha këtu.

Këto argumente dëshmojnë kundër medhhebit të murxhive kerami, të cilët mendojnë se imani është vetëm me fjalë. Rrjedhojë e kësaj fjale është se munfikët janë besimtarë dhe do të hyjnë në xhenet në ditën e gjykimit.

Këtë medhheb të humbur edhe nëse në kohën tonë askush nuk e përkrah, mirëpo bazat e tij po i zbatojnë shumë njerëz pa e kuptuar. Argument për këtë është se kur flet para tyre për kufirin e komunistave dhe laikëve, të cilët besojnë në kufër dhe në të kotë, menjëherë të thonë: Ku e di ti që janë qafirë, sepse ata thonë: La ilahe il-lallah.

2- Fjalët janë pjesë e imanit.

Me konceptin *"fjalë"* kemi për qëllim vërtetimin me gjuhë të dy dëshmive të teuhidit: Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Allahut.

Prej argumenteve se shprehja e dëshmive është kusht prej kushteve të imanit është fjala e profetit ﷺ drejtuar Ebu Talibit¹: **“O xhaxhai im! Thuaj: Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut që të dëshmoj pro teje në ditën e gjykimit”**. Tha: **“Sikur të mos më paragjykonin kurejshët dhe të thoshin se më ka shtyrë frika kisha për të të gëzuar me këtë fjalë”**. Ai refuzoi të thoshte **“La ilahe il-lallah”** dhe Allahu zbriti për të: **﴿Ti nuk udhëzon atë**

¹ E transmetojnë Muslimi dhe të tjerë.

që dëshiron por Allahu udhëzon atë që dëshiron dhe fjalën e tij: **«Nuk i takon profetit dhe besimtarëve të kërkojnë falje për mushrikët edhe nëse janë të afërm të tyre pasi u është sqaruar se ata janë prej banorëve të zjarrit»**.

Ebu Talibi refuzoi të shqiptonte dëshminë e teuhidit, jo sepse e përgënjeshtroi profetin ﷺ dhe besonte se thirrja e tij ishte e kotë, përkundrazi ai u druajt prej paragjyqimeve të kurejshve se e pranoi shehadetin prej frikës së vdekjes, prandaj refuzoi ta shprehte dhe vdiq si qafir.

I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Jam urdhëruar t’i luftoj njerëzit derisa të dëshmojnë se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Allahut dhe derisa ta falin namazin e ta japin zekatin. Nëse e veprojnë këtë kanë siguruar prej meje gjakun dhe pasuritë e tyre, përveç me të drejtën e islamit dhe llogaria e tyre i takon Allahut”**.¹

Neveviu në shpjegimin e sahihut të Muslimit (1/212) thotë: *“Ky hadith është argument se pohimi i dy dëshmime me besim në to dhe besim në të gjithë atë me të cilën është dërguar profeti është kusht i imanit”*.

Ibn Tejmije në *“Mexhmu’ul fetaua”* (7/609) thotë: *“Nëse nuk i shqipton dy dëshmitë kur ka mundësi t’i shqiptojë, ai konsiderohet qafir me pajtimin e të gjithë muslimanëve. Ai është qafir në pamje të jashtme dhe të brendshme, me pajtimin e selefët, imamëve dhe të gjithë dijetarëve të umetit”*

3- Veprat janë pjesë e imanit.

Argumente të shumtë dëshmojnë se puna është pjesë e imanit, Allahu ﷻ thotë: **«Nuk i takon Allahut që t’ua humbasë imanin tuaj»** El bekare, 143. Këtu me fjalën "iman" nënkuptohet namazi.

Kurtubiu thotë: **«Nuk i takon Allahut që t’ua humbasë imanin tuaj»** namazin tuaj. Allahu e quajti namazin iman përshkak se ai përbëhet prej njetit, fjalëve dhe veprave. Imam Maliku thotë: *Sa herë e dëgjoj këtë ajet më kujtohet fjala e murxhive se namazi nuk është prej imanit*.²

Në hadithin e Ebu Hurejrës ؓ se i dërguari i Allahut ﷺ është pyetur: Cila vepër është më e mirë? Tha: **“Imani në Allahun dhe të dërguarin e tij”**. E transmeton Buhariu. Pra i dërguari i Allahut ﷺ e quajti imanin vepër madje e konsideroi prej veprave më të mira.

Dhe thotë: **“Imani është shtatëdhjetë e ca degë. Më e mira prej tyre është fjala “La ilahe il-lallah” dhe më e ulta e tyre është largimi i pengesës prej rrugës. Edhe turpi është**

¹ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

² Tefsiri i Kurtubiut, 2/157.

degë prej imanit". E transmeton Muslimi. I dërguari i Allahut e konsideroi largimin e pengesës dhe turpin prej imanit.

I dërguari i Allahut ﷺ i tha delegacionit të fisit Abdukajs: **"Ju urdhëroj për iman në Allah. A e dini se çfarë është imani në Allah një të vetëm? I thanë: Allahu dhe i dërguari i tij janë më të ditur. Tha: "Dëshmia se nuk ka të adhuroar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i ramazanit dhe të paguani një të pestën prej plaçkës së luftës".¹** I dërguari i Allahut ﷺ e shpjegoi imanin me veprat e gjymtyrëve.

Dhe thotë: **"Nuk është besimtar (mumin) ai që komshiu i tij nuk është sigurtë prej sherrit të tij".²**

Dhe thotë: **"Vallahi nuk beson, vallahi nuk beson, vallahi nuk beson ai prej sherrit të të cilit nuk është i sigurtë as komshiu i tij".³**

Dhe thotë: **"Kur zinaqari bën zina nuk është besimtar (mumin) dhe atëhere kur vjedh nuk është besimtar dhe atëhere kur pi verë nuk është besimtar".⁴**

Ibn Rexhepi thotë: **"Sikur të mos konsiderohej braktisja e këtyre gjynaheve të mëdha prej botëkuptimit të imanit, nuk kishte për t'u mohuar emërtimi me iman i vepruesit të këtyre veprave, sepse emërtimi i diçkaje mohohet vetëm atëhere kur bie diçka prej esencës dhe kushteve të tij".⁵**

Bazuar në këto argumente, dijetarët dhe selefi i këtij umetit kanë thënë se: Imani është besim me zemër, fjalë dhe vepër. Në vijim po paraqesim disa fjalë të tyre.

Imam Buhariu thotë në sahihun e tij: **"Imani është fjalë dhe vepër, shtohet dhe pakësohet".**

Umer ibn Abdulazizi u shkroi muslimanëve në vise të ndryshme: **"Imani ka farze, dispozita, kufinj dhe sunete. Kush i plotëson ato e ka plotësuar imanin dhe kush nuk i plotëson ato nuk e ka plotësuar imanin. Nëse jetoj gjatë kam për t'ua sqaruar ato që t'i veproni, e nëse vdes atëhere kurrë nuk i jam përkushtuar jetës me ju".**

Ibn Rexhepi thotë: **"Selefët e kanë kundërshtuar ashpër mendimin e atij që nuk i konsideron veprat prej imanit. Prej atyre që e kanë kundërshtuar këtë mendim janë: Said ibn Xhubejri, Mejmun ibn Mehrani, Katade, Ejub Sihtijani, Ibrahim Nehaiu, Zuhriu, Jahja ibn Kethiri e shumë të tjerë.**

¹ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

² E transmeton Muslimi.

³ E transmeton Buhariu.

⁴ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

⁵ Xhamiul ulum uel hikem, 1/105.

Suffjan Theuriu ka thënë: Ky është një mendim i shpikur. Njerëzit i kemi arritur në një mendim tjetër. Euzaiu ka thënë: Selefët që kanë qënë para nesh nuk bënin dallim mes imanit dhe punës”.¹

Imam Shafiu në librin e tij “*El umm*” thotë: “Ka pasur ixhma të sahabëve dhe tabinëve dhe prej dijetarëve që i kemi arritur se ata thonë: Imani është fjalë, vepër dhe nijet. Asnjëra prej tyre nuk vlen nëse bien të tjerat”.

Ibn Tejmije në Mexhmu’ul Fetaua, (7/144) thotë: “Ebu Kasim Ensariu shejhu i Shehrestanit në “*Sherhul irshad*” të Ebu Mealit, pasi përmend mendimin e medhhebit të tyre thotë: Pasuesit e hadithi mendojnë se imani i përfshin të gjitha veprat e mira farze apo sunete qofshin. Ata e përkufizuan imanin si veprim i asaj që Allahu e ka urdhëruar, qoftë ajo farz apo sunet dhe braktisje e asaj që Allahu e ka ndaluar, haram qoftë apo e papëlqyeshme.

Thotë: Ky është mendimi i Malik ibn Enesit imamit të “*darul hixhra*” dhe mendimi i shumicës së imamëve të selefit, Allahu qoftë i kënaqur prej tyre”.

Ibn Rexhepi thotë: “Shumica e dijetarëve thonë: Imani është fjalë dhe vepër. Kjo është ixhmaja e selefit dhe dijetarëve të hadithit. Imam Shafi’iu e ka përmendur ixhmanë e sahabëve dhe tabi’inëve rreth kësaj. Ixhmanë e ka përmendur edhe Ebu Theuri. Euzaiu ka thënë: Selefët që kanë qënë para nesh nuk bënin dallim mes imanit dhe punës.

Këtë mendim e kanë transmetur shumë dijetarë të hershëm prej ehli suneh uel xhema’ah. Prej dijetarëve të ehli sunetit që e kanë përmendur këtë është edhe Fudejl ibn Ijadi dhe Ueki’ ibn Xherahu.

Prej atyre që transmetohet se imani është fjalë dhe vepër janë edhe: Haseni, Said ibn Xhubejri, Umer ibn Abdulazizi, Ataja, Tausi, Muxhahidi, Shabiu, Nehaiu, Zuhriu. Ky është mendimi i Theuriut, Euzaiut, Ibn Mubarekut, Malikut, Shafi’iut, Ahmedit, Ishakut, Ebu Ubejdit, Ebu Theurit etj”.²

A janë veprat kusht për saktësimin e imanit apo plotësuese të tij?

Dikush mund të pyesë: Meqë veprat qëkan iman ose prej imanit, atëhere nëse ato bien, bie edhe imani.

Themi: Argumentet prej Kuranit dhe sunetit dhe fjalët e dijetarëve të hershëm dëshmojnë se disa vepra janë kusht për saktësimin e imanit, kështuqë imani bie tërësisht me rënien e tyre. Ndërsa disa vepra të tjera janë plotësuese të imanit dhe imani nuk bie tërësisht me moskryerjen e tyre, por pakësohet dhe nuk është i plotë.

Veprat që janë kusht për teuhidin dhe veprat që duhet të braktisen që të saktësohet

¹ Xhamiul ulum uel hikem, 1/144

² Fethul Bari sherh sahihul Buhari, 1/5.

teuhidi, këto lloj veprash janë kusht për saktësimin e imanit; sepse njeriu konsiderohet musliman vetëm nëse i vepron këto vepra me të cilat është urdhëruar dhe u shmanget atyre veprave prej të cilave është ndaluar.

Prej veprave që e prishin teuhidin dhe e rrëzojnë tërësisht imanin janë adhurimi i dikujt tjetër përveç Allahut, rënia në sexhde për ndonjë idhull apo varr, shqiptimi i kufrit pa imponim ose justifikim, tallja me fenë dhe emrat e Allahut, ulja me ata që tallen me fenë e Allahut, pjesëmarrja bisedën e tyre pa imponim dhe pa kundërshtim, sharja e Allahut dhe e të dërguarit, kthimi për gjykim te taguti, gjykimi me ligjet të tjera përveç ligjeve të Allahut, hartimi i ligjeve dhe legjislacioneve që u përngjajnë ligjeve të Allahut, mbrojtja dhe imponimi i ligjeve të kufrit dhe shirkut mbi njerëzit, miqësimi dhe ndihmimi i qafirëve kundër muslimanëve, ai që nuk ka vepruar asnjë vepër si bindje ndaj Allahut, magjia, lënia e namazit. Të gjitha këto vepra e rrëzojnë imanin tërësisht edhe nëse me gojë pretendon se ai nuk i konsideron hallall këto vepra. Në anën tjetër braktisja e këtyre veprave konsiderohet kusht prej kushteve të saktësimin të imanit.

Allahu ﷻ thotë: **«Kush bën kufër me Allahun pas imanit të tij përveç atij që imponohet dhe zemra e tij është qetësuar me iman, por ai që ja hap gjoksin kufrit. Mbi ta ka rënë zemërimi i Allahut dhe ata kanë dënim të madh»** En nahl 106.

Dhe thotë: **«E nëse i pyet ata do të thonë: Ne po bisedonim dhe po bënim shaka. Thuaju: A me Allahun, me ajetet dhe të dërguarin e tij po tallehit?! Mos u justifikoni! Ju keni bërë kufër pas imanit tuaj»** Et teube, 66.

Dhe thotë: **«Betohen në Allah se nuk thanë asgjë, por ata thanë fjalën e kufrit dhe bënë kufër pas imanit të tyre»** Et teube, 74.

Ibn Tejmije thotë: *“Kush e shan Allahun ﷻ dhe të dërguarin ﷺ pa imponim, madje kush e flet kufrin pa imponim dhe tallet me Allahun ﷻ, me ajetet e tij dhe me të dërguarin e tij ﷺ, ai është qafir në pamje të jashtme dhe në brendësi. Kush thotë që ai është qafir në pamje të jashtme por në brendësinë e tij mund të jetë besimtar, ai ka thënë një fjalë që nuk diskutohet se është e gabuar fetarisht”*.¹

Dhe thotë: *“Abdullahi thotë: Babai im (Ahmed ibn Hanbeli) është pyetur për atë që thotë: O bir i kësaj dhe asaj, ti dhe kush të ka krijuar ty. Babai më tha: Ai është murted i dalur prej islamit. I thashë: A i pritet koka? Tha: Po! I pritet koka”*.²

Prej argumenteve se dikush mund të shpallet qafir për shkak të veprave është edhe fjala e Allahut ﷻ: **«Ju ka shpallur në libër që nëse dëgjoni të bëhet kufër dhe të tallen me ajetet e Allahut atëhere mos u ulni me ta derisa të ndryshojnë bisedë sepse atëhere jeni njësoj si ata»** En nisa, 140.

¹ Mexhmu’ul fetaua, 7/557.

² Mexhmu’ul fetaua, 7/209.

Dhe fjala e tij: **«O besimtarë! Mos i merrni çifutët dhe të krishterët për miq sepse ata janë miq të njëri-tjetrit dhe kushdo prej jush që i miqëson ata ai është prej tyre»** El maide, 51.

Dhe thotë: **«A nuk i shikon ata që pretendojnë se kanë besuar atë që të është zbritur ty dhe atë që është zbritur para teje, dëshirojnë të gjykohen te taguti ndërkohë që janë urdhëruar të bëjnë kufër me të, mirëpo shejtani dëshiron t'i humbasë me humbje të largët»** En nisa, 60.

Dhe thotë: **«e kush nuk gjykon me atë që ka zbritur Allahu mu ata janë qafirët»** El maide, 44.

Dhe thotë: **«Jo pasha zotin tënd ata nuk besojnë derisa të të bëjnë ty gjykatës për atë që ka ndodhur mes tyre dhe pastaj të mos gjejnë në vetet e tyre asnjë siklet prej gjykimit tënd dhe ta pranojnë me nënshtrim»** En nisa 65.

Ibn Kajimi thotë: *“Allahu ﷻ u betua me veten e tij duke e përforcuar betimin me pjesëzën mohore “jo”, se ata njerëz nuk besojnë derisa ta bëjnë profetin ﷺ gjykues në çdo kundërshtim mes tyre, në bazat dhe degët e fesë, në dispozitat fetare, në dispozitat e ringjalljes, në cilësitë e Allahut ﷻ dhe në çdo gjë tjetër. Madje nuk mjafton vetëm kthimi për gjykim te profeti ﷺ për vërtetimin e imanit, por duhet të mos ndiejnë asnjë siklet dhe dyshim, por ta hapin gjoksin për gjykimin e tij dhe ta pranojnë menjëherë. E pas gjithë kësaj nuk cilësohen me iman, derisa të kënaqen, të dorëzohen dhe të mos kundërshtojnë gjykimin e tij”*.¹

Edhe lënësi i namazit konsiderohet qafir dhe mushrik. Transmetohet prej profetit ﷺ se gjëja e fundit që bie prej fesë është namazi, prandaj imani konsiderohet i saktë vetëm me faljen e namazit.²

Abdullah ibn Shakiku ka thënë: **“Sahabët e profetit nuk e shikonin lënien e ndonjë vepre kufër përveç namazit”**.³

Nuk mund të pretendohet se këtu kihet për qëllim kufri i vogël ose kufri në vepra dhe jo kufri i madh sepse kjo është larg kuptimit të kësaj fjale. Nëse do të ishte kështu, atëhere lënia e namazit do të ishte e barabartë me lënien e shumë veprave të mira të cilat konsiderohen kufër i vogël dhe nuk do kishte dallim mes tyre dhe namazit, duke ditur që namazi, me argumente të qarta prej Kuranit dhe sunetit, konsiderohet shtylla më e madhe e islamit pas shehadetit.

Fjala e Abdullah ibn Shakikut dëshmon qartë se sahabët kanë pasur për qëllim kufrin e madh dhe jo të voglin, me argument se sahabët kanë pas konsideruar për kufër të vogël

¹ Et tibjan li hameletil kuran, fq: 270.

² Shiko argumentet rreth kësaj në librin tonë “Gjykimi për lënësin e namazit”.

³ Sahihut tergib uet terhib, 564.

lënien e shumë veprave. Prej kësaj kuptojmë se ata nuk kanë pasë ixhma se lënia e diçkaje është kufër përveç namazit dhe se me kufër këtu kanë pasur për qëllim kufirin e madh dhe të qartë.

Hambeli thotë: Na ka treguar Humejdi thotë: Më është përcjellur se disa njerëz thonë: Kush e pohon namazin, zekatin, agjërimin dhe haxhin, porse nuk vepron asgjë prej tyre derisa të vdesë dhe falet me kurriz nga kibla derisa të vdesë, ai është besimtar përveçese nëse i mohon (këto adhurime), pasi ta dijë që mohimi i tyre ia rrëzon imanin, sepse ai i pohon këto farze dhe e pohon që duhet drejtuar nga kibla.¹

I thashë: Ky është kufër i pastër dhe në kundërshtim me librin e Allahut, me sunetin e profetit dhe me fjalët e dijetarëve të muslimanëve. Allahu ﷻ thotë: **«Ata u urdhëruan vetëm me adhurimin e Allahut me sinqeritet dhe nënshtrim»**. Hambeli thotë: E kam dëgjuar Ebu Abdullah ibn Habelin të thotë: Kush thotë kështu ai ka bërë kufër me Allahun dhe ka refuzuar fjalën e Allahut dhe atë me të cilën profeti është dërguar prej Allahut”.²

Ibn Tejmije thotë: “Nëse supozojmë se disa persona i thonë profetit ﷺ: Ne e besojmë me zemra atë që të është shpallur pa pikë dyshimi dhe i pohojmë me gojë të dy dëshmitë, mirëpo nuk të bindemi ty në asnjë urdhër dhe ndalesë. As nuk falemi, as nuk agjërojmë, as nuk bëjmë haxh, as nuk themi të vërtetën, as nuk e çojmë në vend amanetin, as nuk e përmbushim premtimin, as nuk i ruajmë lidhjet farefisnore dhe nuk veprojmë asnjë prej veprave të mirë me të cilën ke urdhëruar. E pijmë verën, martohemi me mehremet me zina, vrasim sa të kemi mundësi prej sahabëve dhe prej umetit tënd, ua grabisim pasuritë, madje edhe ty të vrasim dhe luftojmë kundër teje në rradhët e armiqve të tu. A mos vallë njeriu i logjikshëm mund të përfytyrojë se profeti do u thoshte: Ju jeni besimtarë me iman të plotë. Ju ka për t’ju përfshirë shefati (ndërmjetësimi) në ditën e ringjalljes dhe shpresoj të mos hyni në zjarr. Përkundrazi çdo musliman pa pikë dyshimi e di se ai do u thoshte: Ju jeni njerëzit më qafirë me atë që jam dërguar, dhe kishte për t’i vrarë nëse nuk pendoheshin prej kësaj”.³

Muhamed ibn Abdulvehabi thotë: “Nuk ka kundërshtim se teuhidi patjetër duhet të jetë me zemër, fjalë dhe vepra. Nëse teuhidi priset në ndonjërin prej tyre ai nuk konsiderohet musliman. Ai që e njeh teuhidin por nuk vepron sipas tij, ai është qafir mëndjemadh, njësoj si faraoni, Iblisi dhe sorollapi i tyre. E nëse vepron me teuhid në pamje të jashtme, por nuk e kupton dhe nuk e beson atë me zemër, ai është munafik më i keq se qafiri i pastër sepse Allahu thotë: **«Munafikët janë në gradën më të ulët të zjarrit»**.⁴

Prej kësaj kuptojmë se vënia në praktikë e teuhidit dhe e çdo gjëje që është kusht për të (si namazi), konsiderohet kusht për saktësimin e imanit. Ndërsa çdo punë tjetër përveç tyre

¹ Siç e thonë këtë dijetarët e irxhasë në kohën e sotme duke e pretenduar se ky është mendimi i ehli sunetit.

² Marrë prej “Mexhmu’ul fetava” të ibn Tejmijes, 7/209.

³ Mexhmu’ul fetava, 7/287.

⁴ Mexhmuatl teuhid, fq. 82.

konsiderohet plotësuese e imanit. Imani shtohet me veprimin e tyre dhe pakësohet me lënien e tyre.

Argument se imani shtohet me veprimin e veprave të mira dhe pakësohet me veprimin e gjynaheve është edhe fjala e Allahut ﷻ: **﴿E kur u lexohen ajetet e Allahut ato ua shtojnë imanin﴾** El enfal, 2.

Dhe fjala e tij: **﴿E kur zbritet ndonjë sure disa prej tyre thonë: Kujt ia shtoi imanin kjo sure? Atyre që besuan ua shton imanin dhe ata përgëzohen﴾** Et teube, 124.

Dhe fjala e tij: **﴿Allahu u shton atyre që u udhëzuan udhëzimin﴾** Merjem, 76.

Dhe fjala e tij: **﴿Që t'u shtohet imani bashkë me imanin e tyre﴾** El feth, 4.

Dhe fjala e tij: **﴿dhe ua shtoi atyre imanin dhe nënshtrimin﴾** El ah'zab, 22. Dhe shumë ajete të tjera.

Prej Xhundub ibn Abdullahit ؓ thotë: *“Kur ishim me profetin ﷺ djelmosha e mësuam imanin përpara se të mësonim Kuranin, pastaj e mësuam Kuranin dhe e shtuam imanin me të”*.¹

Prej Enes ibn Malikut ؓ thotë: *Një mëngjes sahabët vajtën te profeti ﷺ dhe i thanë: O i dërguar i Allahut! Për zotin e Kabes u shkatërruam! U tha: Pse? I thanë: Nifaku! Nifaku!*

U tha: A nuk dëshmoni se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se unë jam i dërguar i Allahut? I thanë: Po. U tha: Kjo nuk është nifak.

Pastaj e pyetën përsëri dhe i thanë: O i dërguar i Allahut! Për zotin e Kabes u shkatërruam. U tha: Pse? I thanë: Nifaku! Nifaku!

U tha: A nuk dëshmoni se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se unë jam i dërguar i Allahut? I thanë: Po. U tha: Kjo nuk është nifak.

Pastaj e pyetën për herë të tretë dhe thanë të njëjtën gjë. U tha: Kjo nuk është nifak. I thanë: O i dërguar i Allahut! Kur jemi me ty jemi në një gjendje (të lartë imani) e kur largohemi prej teje joshemi pas dynjasë dhe familjes. I dërguari i Allahut ﷺ u tha: “Sikur të ishit në të njëjtën gjendje kur jeni me mua pasi të largoheshit, kishin për t’ju përshëndetur melekët në rrugët e Medines”.²

¹ Sahih sunen Ibn Maxheh, 52.

² Kjo ndjenjë prej sahabëve ishte për shkak të imanit të tyre të plotë dhe pastërtisë së zemrave dhe përshakak se ndjenin çdo gjë që ndikonte në imanin e tyre negativisht. I dërguari i Allahut ﷺ në hadithin e saktë ka thënë: **“Atë që e mira e tij e gëzon dhe e keqja e tij e dëshpëron ai është besimtar”**. Ndjenja për sëmundjen e zemrës sado e vogël të jetë, ajo realisht buron nga pastërtia e zemrës dhe e veprave. Kjo në dallim me ata që zemrat i kanë të sëmura, të cilët nuk dëshpërohen për të këqijat e tyra, sepse nuk i ndjejnë ato, aq sa gjen dikë që vepron gjynahe të mëdha shkatërruese dhe kujton se imanin e ka si Ebu Bekri ؓ dhe Umeri ؓ!!

Shiko se si imani i tyre ndikohej kur ziheshin me punët dhe bukuritë e dynjasë, në dallim me imanin e fortë kur ishin me profetin ﷺ, aq sa u vunë në siklet nga frika e nifakut. Kjo dëshmon se imani shtohet dhe pakësohet në varësi të gjendjes, veprave dhe ambjentit që e rrethon personin.

Në hadithin sahih rreth shefatit, që e transmeton Ebu Said Hudariu ؓ prej profetit ﷺ, thuhet se besimtarët pasi të nxjerrin prej zjarrit çdokënd që njohin, prej atyre që kanë iman, zoti u drejtohet atyre dhe u thotë: Nxirreni çdokënd që në zemër ka iman sa një dinar, pastaj atë që ka iman sa një gjysëm dinar, e derisa thotë: Nxirreni atë që ka një thërrmijë iman. Ebu Saidi ؓ thotë: Kush nuk e beson këtë le të lexojë këtë ajet: **﴿Allahu nuk bën padrejtësi as sa një thërrmijë e nëse është vepër e mirë e shton atë dhe jep shpërblim të madh﴾** En nisa, 40.

Kjo dëshmon se imani ka grada të ndryshme në varësi të veprave të njerëzve. Ai që imanin e ka sa një mal, nuk mund të jenë njësoj me atë që imanin e ka sa pesha e një dinari. Ai që ka iman sa pesha e një dinari nuk është i barabartë me atë që ka një thërrmijë iman.

Ibn Umeri ؓ është pyetur: A qeshnin sahabët? Tha: Po, por imanin në zemra e kishin sa malet. Allahu qoftë i kënaqur prej të gjithë atyre.

Çështje: Kudërshtimi mes dijetarëve nëse imani e përfshin islamin apo secili prej tyre ka kuptim të ndryshëm.

Mendimi më i saktë në këtë çështje _bazuar në argumentet e kuranit dhe të sunetit_ është se imani nganjëherë përdoret me kuptim të veçantë dhe të ndryshëm nga islami, ashtu si edhe islami përdoret me kuptim të ndryshëm nga imani. Por nganjëherë imani përdoret me kuptim që e përfshin islamin dhe po kështu islami përdoret me kuptim që e përfshin imanin.

1- Kur imani merr kuptim të ndryshëm nga islami dhe islami kuptim të ndryshëm nga imani?

Në këtë rast imani nënkupton imanin në zemër dhe veprat e zemrës. Si psh. imani në Allahun, melaiket, librat, të dërguarit, botën tjetër, caktimin e Allahut, të mirën e tij dhe të keqen, dashurinë për Allahun dhe urrejtjen për hir të Allahut dhe vepra të tjera të zemrës.

Ndërsa islami nënkupton veprat e dukshme të gjymtyrëve si namazi, agjërimi, haxhi, zekati, xhahadi dhe të tjera vepra të dukshme.

Argument rreth kësaj është pyetja që Xhibrili i drejtoi profetit ﷺ për islamin dhe imanin, i tha: O Muhamed! Më trego për islamin. I dërguari i Allahut ﷺ i tha: **“Islami është të dëshmosh se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Allahut, të falësh namazin, të japësh zekatin, të agjërosh ramazanin, të bësh haxh në Qabe nëse të jepet mundësia”.** I tha: **Të vërtetën ke thënë.**

I tha: Më trego për imanin: I tha: Të besosh në Allahun, melekët e tij, librat e tij, të dërguarit e tij, ditën tjetër dhe të besosh në caktimin e Allahut të mirën dhe të keqen prej tij. I tha: Të vërtetën ke thënë.¹

Vështro se si profeti ﷺ e shpjegoi islamin me vepra të dukshme, që veprohen me gjymtyrë. Ndërsa imanin e shpjegoi me besim të brendshëm dhe vepra të zemrës.

Profeti lutej: ***“O Allah! Këdo që i jep jetë prej nesh jepi jetë në islam dhe kujdo që ja merr shpirtin merrja shpirtin me iman***”.² Pra profeti bëri dallim mes islamit dhe imanit.

Ibn Rexhepi thotë: ***“Sepse punët e gjymtyrëve i vepron gjatë jetës, ndërsa në çastin e vdekjes i mbetet vetëm vërtetimi me zemër***”.³

Dhe thotë: ***“Kush fal namazin tonë, drejtohet nga kibra jonë dhe ha prej kurbanit tonë, ai është musliman***”.⁴ Këto janë punë gjymtyrësh dhe të dukshme.

Transmetohet në sahihun e Muslimit se një person e pyeti të dërguarin e Allahut: Cili është muslimani më i mirë? Tha: ***“Ai që prej gjuhës dhe dorës së tij muslimanët nuk cënohen***”. Ndërsa kur u pyet për besimtarin (muminin) tha: ***“Ai prej të cilit kihet siguri për pasurinë dhe vetet e muslimanëve***”. Muslimanin e përshkroi me vepra të dukshme, si siguria prej gjuhës dhe dorës së tij dhe të dyja këto janë prej veprave të dukshme. Ndërsa besimtarin e përshkroi me gjëra të brendshme, si siguria e njerëzve prej tij, ndërkohë që dihet se siguria buron prej zemrës.

Në hadithin e Amr ibn Abeses thuhet se një person e pyeti profetin: ***Çfarë është islami? I tha: “Shpërndarja e ushqimit dhe fjala e butë” I tha: Çfarë është imani? I tha: “Falja dhe sabri***”. Profeti ﷺ e shpjegoi islamin me vepra të dukshme, si shpërndarja e ushqimit dhe fjala e butë. Ndërsa imanin e shpjegoi me vepra të brendshme sepse falja dhe durimi janë prej punëve të zemrës.

Gjithashtu fjala e profetit ﷺ në dy sahihet: ***“Askush prej jush nuk beson derisa të dojë për vëllain e tij atë që e do për veten e tij”*** dhe fjala e profetit ﷺ: ***“Askush prej jush nuk beson derisa unë të jem më i dashur për të sesa babai i tij, fëmija i tij dhe e gjithë njerëzia***”.

Dhe fjala e tij: ***“Tre gjëra kush i posedon, e ka arritur ëmbëlsinë e imanit: Të jenë Allahu dhe i dërguari i tij më të dashur për të se çdokush tjetër, ta dojë njeriun vetëm për hir të Allahut dhe të urrejë të kthehet në kufër ashtu siç urren të hidhet në zjarr***”. Profeti ﷺ e lidhi imanin dhe ëmbëlsinë e imanit me dashurinë për Allahun ﷻ dhe të dërguarin e tij ﷺ, ndërkohë që dashuria është prej veprave të zemrës.

¹ E transmeton Muslimi.

² E transmeton Tirmidhiu dhe thotë: Hasen sahih, dhe hakimi i cili e ka konsideruar të sahih dhe këtë e ka aprovuar edhe Dhehebiu.

³ Xhamiul ulum uel hikem, 1/108.

⁴ E transmeton Buhariu.

Këtu hyn edhe fjala e profetit ﷺ për ensarët: **“Ata i do vetëm besimtari dhe i urren vetëm munafiku”**.¹

Hadithet që dëshmojnë për këtë kuptim janë të shumta.

2- Kur imani e përfshin islamin dhe islami e përfshin imanin?

Në këtë rast imani përdoret me një kuptim që e përfshin islamin, ndërsa islami me një kuptim që përfshin imanin. Në këtë rast imani i përfshin të gjitha punët, të dukshmet dhe të padukshmet (punët e zemrës). Po kështu edhe islami i përfshin të gjitha punët e dukshme dhe të brendshme, si në fjalën e Allahut: **«Feja te Allahu është islami»** Ali Imran, 19, dhe në fjalën e tij: **«E kush synon fe tjetër përveç islamit nuk ka për t’u pranuar prej tij»** Ali Imran, 85. Islami i cili është feja e vetme të cilën Allahu ﷻ e pranon përfshin imanin dhe islamin dhe të gjitha veprat e dukshme dhe të brendshme të cilat Allahu ﷻ i pëlqen, sepse ky ajet nuk mund të komentohet në tjetër mënyrë.

Po kështu fjala e Allahut ﷻ: **«I nxorrëm prej saj ata që ishin besimtarë dhe gjetëm vetëm një familje prej muslimanëve»** Edh dharijat, 36. Besimtari (mumini) dhe muslimani këtu kanë kuptim të njëjtë dhe secila fjalë nënkupton edhe tjetrin. Këtë kuptim ka edhe fjala e profetit ﷺ në dhënien e selamit kur kalohet nga varrezat e muslimanëve: **“Selami (pagja) qoftë mbi ju o banorë të këtij vëndi prej besimtarëve dhe muslimanëve. Allahu i mëshiroftë të parët dhe të mëvonëshmit dhe ne në dashtë Allahu do vimë pas jush”**. E transmeton Muslimi.

Imam Neveviu thotë: **“Është e pamundur që në këtë hadith të nënkuptohet me fjalën “musliman” diçka tjetër përveç besimtarit (muminit) sepse nëse me besimtarin² nënkuptohet munafiku, atëherë munafikut nuk lejohet t’i jepet selam dhe të kërkohet mëshirë për të”**.³

I dërguari i Allahut ﷺ iu drejtua delegacionit të fisit Abdukajs me fjalët: **“Ju urdhëroj për iman në Allah. A e dini se çfarë është imani në Allah një të vetëm? I thanë: Allahu dhe i dërguari i tij janë më të ditur. Tha: “Dëshmia se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i ramazanit dhe të paguani një të pestën prej plaçkës së luftës”**. E shpjegoi imanin me islamin dhe veprat e dukshme. Kjo dëshmon se ndonjëherë imani përdoret me një kuptim që e përfshin edhe islamin.

Në musnedin e imam Ahmedit prej Amr ibn Abeses thotë: **“Një person erdhi te**

¹ E transmeton Muslimi.

² Mbase më e saktë është të themi “musliman” në vend të fjalës “besimtar”, sepse besimtari nuk mund të përfytyrohet me nifak, sepse nuk mund të bashkohen në një zemër të vetme imani me nifakun që të nxjerr prej islamit. Ndërsa për muslimanin mund të përfytyrohet nifaku, sepse ai mund të jetë i nënshtuar ndaj shariatit në pamje të jashtme, por e fsheh kufrin dhe nifakun në zemër dhe Allahu është më i ditur.

³ Sherh sahihul muslim, 7/44.

profeti ﷺ dhe e pyeti: O i dërguar i Allahut! Çfarë është islami? I tha: T'ia dorëzosh zemrën Allahut¹ dhe muslimanët të mos cënohen prej gjuhës dhe dorës tënde” I tha: Cili është islami më i mirë? I tha: Imani. I tha: Çfarë është imani? I tha: Të besosh në Allahun, melaiket e tij, librat e tij, të dërguarit e tij, dhe ringjalljen pas vdekjes. I tha: Cili është imani më i mirë. I tha: Hixhreti (braktisja). I tha: Çfarë është hixhreti? I tha: Braktisja e punëve të këqija. I tha: Cili është hixhreti më i mirë: I tha: Xhahadi”²

Profeti ﷺ këtu e konsideroi imanin pjesë të islamit, madje si islamin më të mirë. Ndërsa veprat e dukshme si hixhreti dhe xhahadi i konsideroi brenda imanit.

Gjithashtu fjala e profetit ﷺ: *“Në xhenet do të hyjë vetëm muslimani”*³. Me muslimanin kihet për qëllim besimtari. Islami këtu e përfshin edhe imanin, sepse imani është prej kushteve të hyrjes në xhenet, siç i tha profeti ﷺ Umerit ؓ: *“O bir i Hatabit! Shko e thirrri njerëzit e thuaju se në xhenet do të hyjnë vetëm besimtarët”*⁴.

Në një hadith tjetër thuhet: *“O bir i Aufit! Hyp mbi kalë dhe pastaj thirr: Xheneti është hallall vetëm për besimtarin”*⁵.

Vërejtje:-

Si përfundim mund të përmendim se çdo besimtar (mumin) është musliman, sepse imani patjetër ka për ta shtyrë besimtarin e sinqertë që të veprojë veprat e dukshme prej farzeve dhe të largohet prej veprave të ndaluara.

Në hadithin sahih thuhet: *“Në trup gjendet një copë mishi, e cila nëse rregullohet atëhere drejtohet i gjithë trupi, e nëse prishet atëhere shkatërrohet i gjithë trupi. Ajo është zemra”*.

Ibn Haxheri thotë: *“E veçoi zemrën me këtë cilësi, sepse ajo është komanduesja e trupit dhe kur komanduesi është i drejtë, atëhere drejtohen edhe të komanduarit. Ndërsa kur është i prishur atëhere prishen edhe të komanduarit”*.

Kushdo që pretendon iman në zemër dhe besimin në islam, por në të njëjtën kohë nuk i vepron shtyllat e islamit dhe obligimet e imanit, ai është qafir dhe gënjeshtar, sepse pamja e jashtme është argument për brendësinë. Prishja e anës së dukshme dëshmon për prishjen e brendësisë, ashtu si rregullimi i brendësisë të çon detyrimisht në rregullimin e punëve të dukshme, sepse ato kushtëzojnë njëra-tjetrën.

¹ Vështro se si e shpjegoi islamin me punë të brendshme, me dorëzimin e zemrës ndaj Allahut.

² Hajthemi në *“Mexhmaul zeuid”* 1/59 thotë: E transmeton Ahmed, Taberani në *“El kebir”* afërsisht dhe transmetuesit e tij janë të besueshëm.

³ E transmeton Buhari.

⁴ E transmeton Muslimi.

⁵ E transmeton Ebu Daudi, Sahihul xhami, 7837.

Mirëpo jo çdo musliman është besimtar (mumin) sepse ai mund të jetë musliman munafik. Mund t'i veprojë shtyllat e islamit në pamje të jashtme me nifak ndërsa në brendësinë të tij është qafir, i mbushur me smirë dhe mohues që nuk i beson mësimet e islamit.

Edhe pse një person i tillë në botën tjetër konsiderohet qafir dhe do të jetë në gradat më të ulta të xhehenimit, mirëpo në dynja ai konsiderohet musliman bazuar në pamjen e tij të jashtme, përderisa nuk e shfaq nifakun e tij haptas.

Bazuar në këtë që u përmend mund të themi se çdo besimtar (mumin) do të hyjë në xhenet, sepse ai që në zemër ka iman të sinqertë patjetër do punojë me këtë iman. Mirëpo jo çdo musliman _kur thuhet me kuptimin që nuk e përfshin imanin¹_ do të hyjë në xhenet sepse nuk është kusht që puna në pamje të jashtme të burojë nga zemra.

A lejohet që të dëshmojmë për një person të caktuar se ai është besimtar (mumin)?

Nuk lejohet të dëshmojmë për një person të caktuar se ai është besimtar (mumin) me bindje të plotë _nëse nuk transmetohen ajete ose hadithe_ sepse vendi i imanit është zemra dhe atë që fshihet në zemra e di vetëm i dijëshmi i së fshehtës. Gjithashtu nuk na lejohet të dëshmojmë për një person të caktuar se ai është prej banorëve të xhenetit _nëse nuk transmetohen ajete ose hadithe_ sepse besimtari padyshim është prej banorëve të xhenetit.

Mirëpo na lejohet të dëshmojmë se është musliman bazuar në pamjen e jashtme, e cila dëshmon për islamin e tij, siç thuhet në hadithin sahih: ***“Kush e fal namazin tonë, drejtohet nga kibra jonë dhe ha prej kurbanit tonë ai është musliman”***. Pra ai është musliman për islamin e të cilit mund të dëshmojmë dhe Allahu është më i ditur.



¹ Sepse nëse fjala musliman përdoret me kuptimin që i përfshin edhe imanin edhe islamin atëhere çdo musliman do të hyjë në xhenet dhe do të jetë prej banorëve të tij.

Rregulla rreth tekfirit

Pas kësaj parathënie të rëndësishme për sqarimin e disa termave fetare po nisim _me lejen e Allahut_ sqarimin e rregullave të tekfirit dhe shpjegimin e argumenteve të tyre. E lusim Allahun të na ndihmojë, të na udhëzojë dhe të na drejtojë.

Rregulli i parë: Kufri i përgjithshëm nuk nënkupton domosdoshmërisht shpalljen qafir të një personi të caktuar.

Tekfiri i përgjithshëm i përmendur në Kuran dhe në sunet nuk mund të zbatohet përherë mbi persona konkretë të cilët kanë rënë në këtë kufër. Kjo përshkak se mund të ekzistojnë pengesa që pengojnë prej shpalljes qafir, ose mund të mungojnë kushte të caktuara për shpalljen e tyre si qafirë.

Shprehjet: Kjo fjalë dhe kjo vepër janë kufër, ose kush vepron kështu ai është qafir; janë shprehje me tekfir të përgjithshëm, i cili nuk nënkupton domosdoshmërisht se kushdo që e ka thënë këtë fjalë ose e ka vepruar këtë vepër është bërë qafir. Kjo përshkak se mund të ekzistojnë shkaqe që nuk lejojnë bërjen e tij qafir, si mospërmbushja e disa kushteve për tekfir dhe ekzistimi i pengesave që lidhen me këtë person.

I dërguari i Allahut ﷺ në hadithin sahih ka thënë: **“Më erdhi Xhibrili dhe më tha: O Muhamed! Allahu e ka mallkuar verën, atë që e shtryll, atë që porosit prodhimin e saj, atë që e pi, atë që e mbart, atë për të cilin mbartet, shitësin e saj, blerësin e saj, atë që e servir dhe atë që kërkon t'i serviret”**.¹ Ky mallkim është i përgjithshëm.

Ndërkohë që në sahihun e Buharit transmetohet prej Umer ibn Hatabit ؓ, se një person në kohën e profetit me emrin Abdullah dhe nofkën “himar” që e gajaste profetin, ishte kamzhikuar për shkak se pinte. Një ditë e sollën dhe e kamzhikuan. Një person prej turmës tha: Mallkoje o Allah! Sa shumë herë që është ndëshkuar! Atëhere i dërguari i Allahut tha: **“Mos e mallkoni, se pasha Allahun unë e di që ai e do Allahun dhe të dërguarin e tij”**.

Megjithëse pijaneci është mallkuar në mënyrë të përgjithshme mirëpo profeti i ndaloi prej mallkimit të këtij sahabiu, për shkaqe që ndalojnë prej mallkimit të tij, sepse ai e donte Allahun ﷻ dhe të dërguarin ﷺ, duke e ditur që ai pinte shpesh, bazuar në deklarin e këtij

¹ E transmeton Taberani dhe Hakimi. Sahih El xhami'il sagir, fq. 72.

personit se ai ishte dënuar shpeshherë.

Profeti ﷺ ka thënë: **“Pirësi i verës vazhdimisht është si adhuruesi i idhullit”**¹ Por ky gjykim i përgjithshëm nuk mund të zbatohet mbi këtë sahabi, për shkak të një të mire që peshon më shumë se kjo e keqe dhe e pengon përfshirjen e tij në këtë kërcënim. Kjo e mirë penguese është dashuria për Allahun ﷻ dhe të dërguarin e tij ﷺ, sepse të mirat i fshijnë të këqijat.

Prej Ebu Hurejrës ؓ thotë se sollën një person që kishte pirë te profeti ﷺ dhe tha: **“Goditeni!** Ebu Hurejra ؓ thotë: Dikush e goditi me dorë, dikush me këpucë e dikush me rrobë. Kur u largua një person i tha: Allahu të poshtëroftë! Atëhere i dërguari i Allahut ﷺ tha: **“Mos thoni kështu! Mos e ndihmoni shejtanin kundër tij!”**. Në një transmetim tjetër thuhet: **“Por thoni: O Allah fale! O Allah mëshiroje!”**.²

Shiko se si profeti ﷺ i ndaloi të luten kundër tij, madje i urdhëroi që të luteshin për të, duke ditur që gjykimin e përgjithshëm për atë që pi është mallkimi dhe largimi prej mëshirës së Allahut.

Hatib ibn Belta ؓ i ndihmoi kurejshët kundër profetit ﷺ me një vepër kufri _siç u sqarua më parë_ mirëpo për të ndërmjetësoi vlera e Bedrit **“Mbase Allahu i ka vështruar pjesmarrësit e Bedrit dhe u tha: Veproni çfarë të doni sepse ua kam falur”**. Realisht ai keqinterpretoi dhe gaboi në veprimin e tij, mirëpo në brendësi ishte i sinqertë dhe nuk ishte i njohur për tradhti, prandaj kjo e pengoi gjykimin me kufër dhe nifak ndaj tij.

Gjithashtu grupi i muslimanëve _me në krye Kudame ibn Medhunin_ e keqinterpretuan fjalën e Allahut ﷻ: **﴿Ata që kanë besur dhe kanë vepruar vepra të mira, nuk kanë asnjë gjynah për atë që hanë nëse i ruhen (Allahut) dhe besojnë dhe veprojnë vepra të mira﴾** El maide, 93, dhe kur ishin në Sham pinë verë duke thanë: Na lejohet ta pimë. Atëhere Umeri ؓ urdhëroi të silleshin para tij dhe kërkoi mendimin e njerëzve dhe i thanë: O prijës i besimtarëve! Mendojmë se ata kanë përgënjeshtuar Allahun ﷻ dhe kanë ligjëruar në fe atë që Allahu ﷻ nuk e ka lejuar, prandaj prijua kokat.

Ndërkohë që Aliu ؓ po dëgjonte në heshtje iu drejtua dhe i tha: Po ti o Ebu Hasen çfarë mendon? I tha: Mendoj se duhet t’u paraqesësh teuben. Nëse pendohen duhet t’i dënosh me 80 kamzhikë për shkak të pirjes së verës. E nëse nuk pendohen hiqta qafat sepse kanë përgënjeshtuar Allahun ﷻ dhe kanë ligjëruar në fe atë që Allahu ﷻ nuk e ka lejuar.

Pastaj u kërkoi të pendohen dhe u penduan. Pastaj i fishkëlloi me 80 kamzhikë dhe Umeri ؓ i tha Kudames: Ja hodhe paq! Sikur të ruheshe prej Allahut dhe të veproje vepra të

¹ Sahih sunen ibn Maxheh, 2720.

² Sahih sunen Ebi Daud, 3758.

mira nuk kishe për të pirë verë”.¹

Ndalimi i verës ka ndodhur pas betejës së Uhudit dhe disa prej sahabëve pyetën: Si është puna e shokëve tanë të cilët kanë vdekur dhe kanë pas pirë verë? Atëhere Allahu ﷻ zbriti këtë ajet, për të sqaruar se ai që ka ngrënë diçka para se të bëhej haram, nuk merr gjynah nëse ka qënë i ruajtur prej harameve dhe ka punuar punë të mira. Mirëpo Kudame ﷺ dhe shokët e tij e keqinterpretuan ajetin dhe kujtuan se ka zbritur pas shpalljes haram të verës. Ata kujtuan se ky ajet i përfshin edhe ata, prandaj ia lejuan veteve të tyre verën.

Ajo që na intereson këtu është se megjithëse e konsideruan të lejuar verën _dhe kjo është kufër_, ata nuk u bënë qafirë përpara se t’u ngrihej argumenti, përshkak se e keqinterpretuan argumentin dhe dispozitën e sheriatit gabimisht.

Transmeton Ibn Abasi ﷺ se një burrë i dhuroi profetit ﷺ një enë me verë dhe profeti ﷺ i tha: A nuk e di se Allahu e ka ndaluar atë? Pastaj pëshpëriti por nuk e kuptova mirë çfarë tha dhe pyeta ata që ishin më pranë tij, ndërkohë profeti ﷺ i tha: Me çfarë pëshpërite? I tha: E urdhërova që ta shesë atë. Atëhere i dërguari i Allahut ﷺ i tha: ***Ai i cili e ka ndaluar pirjen e saj e ka ndaluar edhe shitjen e saj*** pastaj e hapi tapën dhe e derdhi.²

Padyshim që ky person e konsideronte verën hallall edhe pas zbritjes së dispozitës së ndalimit. Ky është kufër, mirëpo profeti e justifikoi dhe nuk e shpalli qafir sepse atij nuk i kishte arritur dispozita e sheriatit për ndalimin dhe shitjen e verës.

Po kështu ai personi i cili e kaloi gjithë jetën e tij i zhytur në gjynahe, siç përmendet në hadithin sahih të Muslimi prej Ebu Hurejres ﷺ, se profeti ﷺ ka thënë: ***“Një njeri, i cili kurrë nuk kishte vepruar mirë i tha familjarëve të tij: Nëse vdes më digjni! Pastaj shpërndajeni gjysmën e hirit në tokë dhe gjysmën në det. Pasha Allahun! Nëse Allahut ka caktuar për të më dënuar, ka për të më dënuar me një dënim që nuk e ka dënuar askënd prej njerëzve. Kur ky person vdiq e përmbushën porosinë e tij. Pastaj Allahu e urdhëroi tokën të mblidhte hirin e tij dhe e udhërdhëroi detin të mblidhte hirin e tij, pastaj i tha: Pse e bërë këtë? I tha: Prej frikës tënde o Zot dhe ti je më i ditur. Atëhere Allahu e fali”***.

Megjithëse ky person shqiptoi fjalë kufri dhe i porositi bijtë e tij me të, mirëpo ai nuk u bë qafir dhe nuk u dënua si qafirët, përshkak se ai ishte i paditur për disa cilësi të Allahut dhe përshkak se ai u nis në veprimin e tij prej frikës së Allahut, prandaj Allahu ia fali këtë shkarje.

Ibn Tejmije thotë: ***“Ky person dyshoi në fuqinë e Allahut dhe në ringjalljen e tij pasi të jetë bërë hi. Madje kujtoi se nuk do të ringjallet. Kjo është kufër me pajtimin e të gjithë muslimanëve. Mirëpo ai ishte i paditur dhe ishte besimtar që frikësohej se mos Allahu e***

¹ E transmeton Tahaviu në “Meanil athar”. Ibn Haxheri përmend disa transmetime të tjera në “Fethul bari”. Marrë prej librit “Ikfarul mulhidin”, fq. 95.

² Sahih sunen Ibn Maxheh, 4349.

dënonte, prandaj edhe Allahu e fali”.¹

Ibn Hazmi thotë: “Ky njeri deri në pragun e vdekjes nuk e diti se Allahu ﷻ ka fuqi ta mbledhë të gjithë hirin e tij dhe ta ringjallë, mirëpo Allahu ﷻ e fali për shkak të pranimit të fajit, prej frikës dhe paditurisë së tij”.²

Prej Uakid Lejthiut thotë: *Dolëm me profetin ﷺ për në Hunejn, kur ishim akoma të sapokthyer prej kufrit _ishin bërë musliman në ditën e Çlirimit të Mekës_ thotë: Kaluam pranë një peme dhe i thamë: O i dërguar i Allahut! Na cakto një “dhatu enuat” njësoj siç kanë ata “dhatu enuat”, sepse mushrikët kishin një pemë para së cilës qëndronin (për ibadet) dhe i varnin armët e tyre dhe e quanin “dhatu enuat”. Kur i thamë profetit kështu na tha: “Allahu ekber! Pasha atë në dorën e të cilit është shpirti im, keni thënë njësoj siç i thanë izraelitët Musait: Na cakto një ilah (të adhuruar) ashtu siç kanë ata të adhuruar. Tha: Ju jeni popull i paditur. Keni për t’i ndjekur rrugët e atyre që kanë qënë para jush”.³*

Megjithëse ata shqiptuan fjalë kufri njësoj si fjala e izraelitëve drejtuar Musait ﷺ: Na cakto një idhull ashtu siç kanë ata idhuj, mirëpo ata nuk u bënë qafirë sepse u justifikuan me periudhën kohore të shkurtër që kishin në islam, prandaj profeti u njaftua me mësimin dhe ndalimin e tyre prej kësaj fjale.

Shejh Muhamed ibn Abdulvehabi thotë: “ “...ishim akoma të sapokthyer prej kufrit ...” kjo është argument se tjetërkush nuk mund të mos e dijë diçka të tillë dhe se ai që kthehet nga e kota që i ishte rrënjësuar në zemër, akoma mund t’i mbeten në zemër disa gjëra të kota”.

Shejh Muhamed Hamid Fakiu thotë: “Kërkesa e tyre nuk ishte kufër i vogël. Nëse do të ishte e tillë profeti ﷺ nuk do e përngjasonte me fjalën e izraelitëve (Na cakto një idhull) dhe nuk kishte për t’u betuar. Ajo ishte kufër i madh, ashtu siç ishte kërkesa e izraelitëve kufër i madh. Mirëpo ata nuk u bënë qafirë sepse ishin akoma të rinj në islam dhe në fund të fundit ata nuk e vepruan atë që kërkuan dhe u tërhoqën (nga kërkesa e tyre) ...”.⁴

Këtu hyn edhe hadithi i Adij ibn Hatimit ؓ ku thotë: **Shkova te profeti ﷺ dhe në qafë kisha një kryq ari dhe më tha: “O Adij! Flake këtë put prej qafës sënde”. E flaka dhe kur u afrova më afër ai lexoi ﴿I morrën priftërinjtë dhe murgjit e tyre për zotër përveç Allahut﴾. Kur e mbaroi i thashë: Ne nuk i adhuronim ata. I tha: A nuk jua ndalonin atë që Allahu jua ka lejuar dhe e konsideronit haram dhe jua lejonin atë që Allahu ua ka ndaluar dhe e konsideronit hallall? I thashë: Po. Tha: Ky është adhurimi i tyre”.⁵**

¹ Mexhmu’ul fetaua, 3/331.

² El fisal fil milel ue nihel, 3/252.

³ E transmeton Tirmidhiu dhe ibn Ebi Asim në librin “Es sunneh” dhe shejh Albani e ka konsideruar sahih.

⁴ Marrë nga fusnotat e librit “Fethul mexhid”, botim i shtëpisë botuese “El kutubul ilmije”, fq. 141.

⁵ Tefsiri i Begeviut, 3/285.

Prej hadithit përfitojmë se:

1- Adij ibn Hatimi ؓ erdhi te profeti ﷺ si musliman dhe dëshmonte dy dëshmitë e islamit, megjithëse më përpara e ka pasur gjakun të lejuar mirëpo islami e ka mbrojtur.

2- Adij ibn Hatimi ؓ më parë ka qënë i krishterë dhe ishte akoma i ri në islam, pra nuk mund të dinte që në fillim çdo gjë që ka lidhje me teuhidin.

3- Prej kësaj që përmendëm do shohim se Adiu ؓ ra në dy lloje të shirkut dhe kufrit të madh, secili prej tyre e nxjerr vepruesin e tij prej islamit, nëse veprohet pas njohjes së argumentit shariatik rreth ndalimit të këtyre veprimeve.

Lloji i parë: Veshja e kryqit. Ky është shirk i madh, prandaj profeti ﷺ e quajti “put” i cili adhurohet përveç Allahut ﷻ. E megjithatë profeti ﷺ u mjaftua duke i thënë: *“flake këtë put prej qafës tënde”*, pa e shpallur atë qafir apo murted dhe se duhet të hyjë rishtazi në islam dhe të shqiptojë dy shehadetet edhe njëherë.

Lloji i dytë: Adiu ؓ nuk e dinte se bindja ndaj priftërinjve dhe murgjërve për ato gjëra që i bënin hallall dhe haram pa asnjë argument prej Allahut ﷻ është një lloj adhurimi i cili nuk i takon askujt tjetër përveç Allahut ﷻ, sepse ajo është shirk i madh. Ai nuk e diti këtë, derisa profeti ia shpjegoi dhe e njoftoi se bindja ndaj murgjërve dhe priftërinjve dhe gjykimi me fjalët e tyre për hallallin dhe haramin dhe jo me ligjet e Allahut ﷻ, konsiderohet adhurim i tyre dhe shirk me Allahun ﷻ. Por profeti ﷺ nuk gjykoi për Adion ؓ se është qafir dhe murted dhe se duhet të hyjë në islam rishtazi, sepse ai ishte akoma i ri në islam.

Gjithashtu ai që e shqipton kufirin me lapsus, pa qëllim dhe pa dashur ta shqiptojë atë¹. Edhe pse ajo është fjalë kufri, mirëpo ai është i justifikuar, sepse Allahu ﷻ e ka falur gabimin e paqëllimtë. Transmeton imam Muslimi se profeti ﷺ ka thënë: *“Gëzimi i Allahut për pendimin e robit të tij kur kthehet te ai është më i madh sesa gëzimi i një personi që kalon shkretëtirën me deve, por ajo i humbet me gjithë ushqimin dhe ujin e tij dhe i humb shpresat për ta gjetur. Pastaj shkon e shtrihet në hijen e një peme i pashpresë. Kur papritmas ajo i shfaqet para syve. E kap prej kapistre dhe nga gëzimi i madh thotë: O Allah i je rob i im dhe unë jam zoti yt; gaboi prej gëzimit të madh”*.

Profeti ﷺ ka thënë: *“Allahu ja ka falur umetit tim gabimin (e paqëllimtë), harresën dhe atë për të cilën imponohen”*.²

Dhe ka thënë: *“Ai që shkon te falltari apo orakulli dhe e beson për atë që thotë ai ka*

¹ Pa pasur qëllim lapsusin dhe jo pa pasur qëllim kufirin sepse ai që e thotë fjalën e kufirit me qëllim (jo si lapsus) ai bën kufër dhe të bëhet qafir, edhe nëse nuk dëshiron me këtë fjalë daljen prej islamit. Ki kujdes rreth kësaj, sepse shumë murxhi e ngatërrojnë çështjen e qëllimit të shqiptimit me qëllimin e daljes prej islamit. Ata e mohojnë bërjen qafir të atij që i shqipton fjalët e kufirit duke u argumentuar me të njëjtin hadith të përmendur më sipër.

² E transmeton imam Ahmedi dhe të tjerë. Sahihul xhami’is sagir, 1731.

bërë kufër me atë që i është zbritur Muhamedit”!

Në anën tjetër është saktësuar se Muavije ibn Hakem Silmiu ka thënë: I thashë: O i dërguar i Allahut! Ne jemi një popull që sapo kemi dalur prej xhahilijetit. Allahu ﷻ na ka dhuruar islamin, mirëpo disa njerëz prej nesh shkojnë te fallxhorët. Më tha: Ti mos shko.² Profeti ﷺ nuk gjykoj me gjykimin e përgjithshëm se kush shkon te fallxhori dhe i zë besë ai ka bërë kufër, por u mjaftua me mësimin e tij dhe e justifikoi atë për shkak se ishte akoma i ri në islam.

Këtu hyn edhe sexhdja që sahabiu i bëri profetit, duke kujtuar se ajo lejohet të bëhet për profetin. Profeti ﷺ e ndaloj dhe u mjaftua me mësimin e tij se sexhdja është ibadet, prandaj nuk lejohet të kryet për askënd tjetër përveç Allahut ﷻ, por nuk gjykoj mbi të se është bërë qafir dhe ka dalur prej fesë.

Gjithashtu fjala e një sahabiu drejtuar profetit ﷺ: ***“Ajo që ka dëshiruar Allahu dhe ke dëshiruar ti”. I dërguari i Allahut i tha: “A më bëre rival me Allahun?! Kurrsesi, por vetëm çfarë ka dëshiruar Allahu i vetëm”***. Megjithëse kjo fjalë është kufër dhe shirk mirëpo ky sahabi nuk e dinte se kjo fjalë nënkupton kufër prandaj u justifikua dhe nuk u bë qafir dhe as nuk u gjykua mbi të si qafir dhe mushrik.

E shumë e shumë argumente të tjerë që dëshmojnë për saktësinë e këtij rregulli që thotë: ***Kufri dhe tekfiri i përgjithshëm nuk nënkupton domosdoshmërisht bërjen qafir të një personi konkret, për shkak se mund të ketë ndonjë pengesë që pengon prej shpalljes së tij si qafir dhe dënimit të tij në zjarr.***

Allahut i takon falenderimi prej të cilit plotësohet çdo mirësi dhe devotshmëri.

Thëniet dhe konsensusi i dijetarëve rreth këtij rregulli.

Ibn Tejmije thotë: *“Një fjalë mund të jetë kufër dhe për thënësin e saj thuhet se është qafir papërcaktim, ose thuhet se kush thotë kështu ai është qafir. Mirëpo mbi personin konkret që e thotë këtë fjalë nuk gjykohet me kufër, derisa t’i paraqiten faktet, refuzuesi i të cilave bëhet qafir*

Mund të ndodhë që personit i cili shqipton fjalë kufri, të mos i kenë arritur argumentet që sqarojnë të vërtetën. Ose mund t’i ketë dëgjuar, por nuk i konsideron të sakta³, ose nuk i kupton ashtu siç duhet, ose mund të bjerë në paqartësi të justifikueshme. Çdo besimtar që përpiqet për gjetjen e të vërtetës, por gabon, Allahu ﷻ ia fal gabimin kushdo qoftë ai, qoftë kjo në çështje akideje apo në vepra. Kjo është rruga e sahabëve dhe e të gjithë dijetarëve islam. Ata nuk i kanë ndarë çështjet në baza të cilat po t’i mohojë bën kufër dhe degë të cilat

¹ E transmeton Ahmed dhe është hadith sahih.

² Sahih sunen Ebi Daud, 823.

³ Kjo ndodh në rastin e ixhtihadit rreth haditheve të ndryshme nëse janë sahihe apo daife.

po t'i mohojë nuk bën kufër ...

Ashtu siç nuk kuptohet prej mallkimit të përgjithshëm se lejohet mallkimi i një person konkret, për shkak të pengesave që e pengojnë prej meritimit të mallkimit, po ashtu është edhe tekfiri dhe kërcënimi i përgjithshëm. Prandaj kërcënimi i papërcaktuar në Kuran dhe në sunet është i varur nga disa kushte dhe mosekzistimin e pengesave ...

Ua pata shpjeguar atyre se transmetimet prej selefit dhe imamëve rreth tekfirit të atij që thotë kështu dhe ashtu ato janë të vërteta, mirëpo duhet bërë dallim mes thënies papërcaktim dhe caktimit për një person konkret i cili vepron kështu apo ashtu. Kjo është njësoj si fjala e disa prej selefit: Kush thotë kështu ai është kështu, mirëpo një person i caktuar mund të mos përfshihet në këtë gjykim, për shkak të teubes, veprave të shumta të mira që ja fshijnë të këqijat, musibetet e ndryshme që i bien ose me ndërmjetësimin e pranuar”.¹

Vërejtje:-

Fjala jone: "tekfiri i përgjithshëm nuk nënkupton domosdoshmërisht shpalljen qafir të një personi të caktuar", nënkupton që disa herë tekfiri i përgjithshëm zbatohet mbi një person të caktuar dhe shpallet qafir. Kjo ndodh atëhere kur nuk gjenden pengesa për shpalljen e tij si qafir dhe përmbushen kushtet e tekfirit. Prandaj kur nuk gjenden pengesa dhe plotësohen kushtet ai person shpallet qafir, sepse dispozitat e sheriatit, Allahu i ka zbritur për t'u zbatuar mbi ata që i meritojnë ato.

Pengesat dhe kushtet e tekfirit kërkojnë një shtjellim më të zgjeruar të cilin po e paraqesim në vijim:

Pengesat e shpalljes qafir të një personi të caktuar.

Duhet ditur se pamundësia e pashmangëshme, të cilën njeriu mundohet ta shmangë, e rrëzon çdo lloj angazhimi fetar që lidhet me këtë pamundësi, derisa t'i mundësohet shmangia e kësaj pamundësie.

Çdo shkak që të shtyn në pamundësinë e mësipërme, konsiderohet në sheriat si pengesë për zbatimin e dënimit për një person të caktuar, derisa të largohet kjo pengesë me paraqitjen e fakteve, qoftë ky shkak i lidhur me vetë personin _psh kur është shurdh dhe nuk ka mundësi t'i dëgjojë argumentet_, ose ka lidhje me ambientin rrethues ose me kohën në të cilën jeton.

Mirëpo nëse vërtetohet që ky person ka mundësi ta shmangë këtë pengesë që e ka shtyrë në haram, por për shkak të hutimit pas dunjasë nuk e shmang atë dhe nuk përpiqet që t'i jap fund asaj, atëhere ajo nuk konsiderohet pengesë për dënimin dhe ai person nuk

¹ Mexhmu'ul fetaua, 3/230, 10/329, 23/41.

justifikohet për gabimet e tij dhe shpallet qafir nëse harami në të cilin ka rënë është prej kufrit të madh.

Argument për këtë është fjala e Allahut ﷻ: **﴿Ruajuni Allahut aq sa keni mundësi﴾** Et tegabun, 16 dhe fjala e Allahut ﷻ: **﴿Allahu nuk e ngarkon askënd me atë që nuk ka mundësi﴾** El Bekare, 286.

Ibn Kethiri në tefsirin e tij thotë: *“Nuk e ngarkon askënd me diçka që nuk ka mundësi dhe fuqi. Kjo është prej butësisë dhe mirësisë së Allahut ﷻ me krijesat e tij”*.

Është saktësuar në hadithin sahih se i dërguari i Allahut ﷻ ka thënë: **“Prej asaj që ju kam urdhëruar veproni aq sa keni mundësi”**. Mutefek alejhi.

Prej Abdullah ibn Ebi Eufa thotë: *Një person erdhi te i dërguari i Allahut ﷻ dhe tha: Nuk kam mundësi të mësoj prej Kuranit asgjë, prandaj më mëso diçka që e zëvendëson atë. I tha: Thuaj: Subhanallah, uel hamdulillah, ue la ilahe il-lallah, la haule ue la kuuete il-la bil-lah” I tha: O i dërguar i Allahut! Kjo i takon Allahut, mirëpo dua një lutje për vete. I tha: Thuaj: O Allah! Më mëshiro! Më furnizo! Më jep shëndet dhe më udhëzo! Kur u ngrit bëri shenjë me dorë dhe i dërguari i Allahut tha: Ky e ka mbushur dorën e tij me mirësi”*.¹

Megjithëse leximi i Fatihasë është prej shtyllave të namazit, pa të cilën nuk konsiderohet i saktë, mirëpo ky person u justifikua, sepse nuk kishte mundësi të mësonte prej Kuranit asgjë.

Gjithashtu ai personi të cilin profeti ﷺ e pyeti: **“Çfarë thua në namaz? I tha: Shehadetin dhe pastaj them: O Allah të lutem ty për xhenetin dhe kërkoj mbrojtjen tënde prej zjarrit, sepse unë nuk di të them ashtu siç pëshpërisni ti dhe Muadhi. Atëhere i dërguari i Allahut i tha: Edhe ne rreth kësaj pëshpërisim”**.²

Bazuar në këto argumente dhe në argumente të tjerë, dijetarët kanë nxjerrë këtë rregull të fikhut: **“Ajo që është e mundur nuk bie poshtë përshkak të asaj që është e pamundur”**.

Imam Shafiu thotë: *“Allahu ﷻ e di se ky person vepron aq sa ka mundësi, prandaj e shpërblen atë. Ndërsa dikush tjetër nuk e vepron atë që ka mundësi ta veprojë, prandaj dhe e dënon atë, përshkak se ai nuk e ka vepruar diçka që ka mundësi dhe Allahu e njeh gjendjen e tij. Allahu nuk e urdhëron atë që nuk ka mundësi dhe nuk e dënon për atë që nuk ka mundësi”*.³

El-iz ibn Abduselami thotë: *“Kush ngarkohet me ndonjë urdhër, mirëpo ka mundësi*

¹ Sahih sunen Ebi Daud, 742.

² Sahih sunen Ebi Daud, 710.

³ Shpjegimi i akides së tahaviut, botim i “El mekteb el islami”, fq. 271.

*të zbatojë vetëm një pjesë të tij pa pasur mundësi për pjesën tjetër, atëhere e vepron atë që ka mundësi dhe i bie obligimi prej asaj që nuk ka mundësi”.*¹

Ibn Tejmije në librin e tij të vyer “Largimi i qortimit” thotë: “Justifikimi pranohet vetëm atëhere kur ndodh për shkak të pamundësisë, e në të kundërt nuk justifikohet nëse ka mundësi ta njohë të vërtetën por neglizhon”.²

Prej pengesave të tekfirit që shkaktojnë pamundësi për të njohur dispozitën e shariatit në një çështje ku e ka kundërshtuar shariatit janë:

1- Mosarritja e tekseve të shariatit.

Kush e kundërshton shariatit ose bie në kufër për shkak se nuk i kanë ardhur tekset e shariatit, atë nuk e përfshin kërcënimi dhe nuk bëhet qafir derisa t’i paraqiten argumentet e shariatit prej fjalës së Allahut ﷻ dhe fjalës së profetit ﷺ rreth asaj që ka kundërshtur. E nëse i mohon, i përgënjeshtron, tallet me to ose ua kthen shpinën atëhere ai bëhet qafir.

Si ai që i dhuroi profetit ﷺ verë pas zbritjes së ndalimit të saj. Ai kujtonte se ishte hallall, por profeti e justifikoi sepse nuk i kishte arritur argumenti i shariatit rreth ndalimit të verës.

Po kështu ata që faleshin akoma në drejtim të Kudsit, megjithëse kibla ishte ndryshuar drejt Kabes dhe kujtonin se namazi duhet falur në drejtim të Kudsit. Ata ishin të justifikuar, për shkak se nuk u kishin arritur argumentet për drejtimin e kibles nga Qabja e nderuar.

Transmetohet në hadith se ajeti: **«Ktheje fytyrën tënde drejt mesxhil haramit dhe kudo që të jeni kthejini fytyrat tuaja drejt saj»** El bekare, 144, zbriti kur muslimanët ishin duke falur sabahun në Kuba në drejtim të Bejtul Makdesit. Një burrë prej fisit Sulejma kaloi dhe u foli kur ishin në ruku dy herë, se kibla qe kthyer nga Qabja dhe u kthyen nga Qabja kur ishin akoma në ruku”.³

Po kështu edhe historia e atij personit i cili pati bërë shumë gjynahe dhe i urdhëroi fëmijët që ta digjinin dhe gjysmën e hirit ta shpërndanin në tokë ndërsa gjysmën tjetër në det. Ai dyshoi në fuqinë e Allahut ﷻ për ringjalljen e tij dhe ky është kufër i pastër, mirëpo Allahu ﷻ e justifikoi dhe e fali, për shkak të padijes dhe se nuk i kishte arritur dija e shariatit, e cila i dëshmon se Allahu ﷻ është i fuqishëm për çdo gjë dhe i tregon për emrat dhe cilësitë e përkryera të Allahut ﷻ.

Allahu ﷻ thotë: **«të dërguar përgëzues dhe qortues që njerëzit që mos të kenë**

¹ Kauaidul Ahkam, 2/5.

² “Raful melam an eimetil islam, fq. 114.

³ E transmeton Muslimi dhe të tjerë. Ky hadith është argument kundër atyre që nuk e pranojnë hadithin ehad në akide, sepse këtij personi të vetëm iu pranua fjala në përcjelljen e një urdhri që ishte zbritur prej qiellit pa më të voglin hezitim, madje në shtyllën më rëndësishme të islamit pas shehadetit. Kjo dëshmon se bërja dallim mes hadithit ehad dhe haditheve të tjera është bidat i shpikur dhe këtë ndarje selefët nuk e kanë ditur.

argument kundër Allahut pas dërgimit të profetëve) En nisa, 165 dhe Allahu ﷻ thotë: **«Nuk do të dënojmë derisa të dërgojmë të dërguar»** El isra, 15.

Shenkiti në tefsirin e tij thotë: *“Në aparence ky ajet dëshmon se Allahu ﷻ nuk dënon askënd prej krijesave të tij, as në dunja dhe as në ahiret, derisa t’u dërgojë të dërguar paralajmërues dhe qortues, e ata ta kundërshtojnë profetin e tyre dhe të vazhdojnë në kufër dhe gjynah edhe pas paralajmërimit”*.¹

Ibn Hazmi thotë: *“Allahu ﷻ e tregon qartë se paralajmërimi përfshin vetëm atë të cilit i ka arritur ky paralajmërim dhe se Allahu nuk dënon askënd para se të dërgojë të dërguar. Kjo dëshmon se atij që nuk i ka arritur thirrja për shkak të largësisë së vendit, ose për shkak se e ka arritur profetin në kohë shumë të shkurtër, ai nuk dënohet dhe nuk ka përgjegjësi asgjë dhe ky është mendimi i shumicës së dijetarëve tanë”*.²

Këtu hyjnë edhe katër personat e justifikuar për mosarritjen e thirrjes së profetëve, për shkak të sëmundjeve të ndryshme, siç transmetohet në hadith: **“Katër persona justifikohen në ditën e ringjalljes; shurdhi i cili nuk dëgjon asgjë, i çmenduri, plaku i shkuar në moshë dhe ai që vdes në fetra. Shurdhi thotë: O Zot! Islami erdhi por unë nuk dëgjoja asgjë. I çmenduri thotë: O Zot! Islami erdhi por unë nuk logjikoja asgjë. Ndërsa ai që ka vdekur në fetra thotë: O Zot! Nuk më ka ardhur asnjë i dërguar prej teje. Pastaj Allahu merr besën e tyre se do t’i binden atij, pastaj i urdhëron që të hyjnë në zjarr. Kush hyn do ta gjejë atë të ftohtë dhe paqe, e kush nuk hyn hidhet në të”**.³

Për shkaqe të ndryshme këta persona nuk janë të informuar për thirrjen islame, mirëpo ata pajtohen në pamundësinë e njohjes dhe kuptimit të thirrjes islame.

Është saktësuar se i dërguari i Allahut ﷻ ka thënë: **“Kush betohet me dikë tjetër përveç Allahut ka bërë kufër ose shirk”**. Ndërkohë që Ibn Umeri ؓ transmeton se profeti ﷺ e dëgjoi njëherë Umerin ؓ të thoshte: Pasha babën! Pasha babën! I tha: **“Allahu ju ndalon të betoheni me baballarët tuaj”**.⁴

Ky hadith dëshmon se shqiptimi i kufrit nuk nënkupton gjithmonë se ai person bëhet qafir ose mushrik. Ai dëshmon gjithashtu se Umeri ؓ ishte i justifikuar sepse ai nuk e kishte dëgjuar të dërguarin e Allahut ﷻ të ndalonte prej betimit me dikë tjetër përveç Allahut ﷻ, prandaj i dërguari i Allahut ﷻ justifikoi dhe u mjaftua me mësimin dhe ndalimin e tij.

Po kështu personi që i tha profetit ﷺ: **“Çfarë ka dashur Allahu dhe ke dashur ti. I tha: A më bërë rival me Allahun?! Por thuaj vetëm çfarë ka dashur Allahu”**.

Këtu hyn edhe ai që i bëri sexhde profetit ﷺ. Ai e ndaloi dhe i tha: **“Nuk i lejohet**

¹ Eduaul bejan, 3/471.

² El usul uel furu, fq. 131.

³ E transmeton Ahmedu dhe të tjerë, Sahih el xhami es sagir, 881.

⁴ E transmeton Buhariu dhe Muslimi, Sahih sunen et tirmidhi, 3526.

njeriut t'i bëjë sexhde njeriut. Sikur të lejohej t'i bëhej sexhde ndokujt kisha për ta urdhëruar gruan t'i bënte sexhde burrit të saj, për shkak të të drejtave që ai ka ndaj saj".¹
Dhe u mjaftua me mësimin e tij, pa gjykuar mbi të me kufër për shkak të sexhdes.

Kjo mënyrë e të folurit përdoret për atë që nuk e di dispozitën e sheriatit dhe nuk kundërshton qëllimisht, sidomos në çështje kufri, siç transmetohet në hadithin e Abdullah ibn Amrit ؓ thotë: I dërguari i Allahut ﷺ kur kapte ndonjë plaçkë luftime urdhëronte Bilalin ؓ të thërriste njerëzit dhe ata e sillnin plaçkën e luftës pastaj merrte një të pestën dhe pjesën tjetër e ndante. Njëherë pasi e ndau plaçkën i erdhi një person me një kapistër leshi dhe i tha: O i dërguar i Allahut! Kjo është prej plaçkës së luftës. I tha: A e dëgjove Bilalin të thërriste tre herë? I tha: Po. I tha: Çfarë të pengoi ta sillje më parë? Atëhere u justifikua, por profeti ﷺ i tha: **Ma sill në ditën e gjykimit se nuk do e pranoj prej teje**".²

Profeti ﷺ nuk ia pranoi justifikimin për shkak se ai kundërshtoi urdhrat e tij pasi i kishte dëgjuar, duke ditur që ky gjynah është më i vogël se kufri. Çfarë mund të themi nëse arrin gradën e kufrit. Padyshim se nuk justifikohet.

Po kështu edhe fjala e profetit ﷺ: **"Pasha atë në dorën e të cilit është shpirti i Muhamedit! Kushdo prej këtij umeti prej çifutëve dhe të krishterëve, i cili dëgjon për mua dhe pastaj vdes pa besuar në thirrjen time, ai ka për të qënë prej banorëve të zjarrit**".³
Profeti ﷺ e lidhi dënimin me zjarr me dëgjimin rreth tij dhe rreth thirrjes së tij dhe me mosbesimin.

Vërejtje:-

Kush është i paditur për dispozitat e sheriatit, për shkak të neglizhencës dhe lënies pas dore, apo për shkak të dunjasë dhe bukurive të saj dhe nuk përpiqet aspak të mësojë atë që e ka detyrë, ai nuk justifikohet për injorancën e tij nëse bie në kufër, bazuar në fjalën e Allahut: **﴿Ata që cilët preferojnë jetën e dunjasë më shumë se ahireti dhe pengojnë prej rrugës së Allahut dhe pasojnë rrugën e shtrëmbër ata janë në humbje të largët﴾** Ibrahim, 3, dhe thotë: **﴿Kjo sepse ata preferuan jetën e dunjasë më shumë se ahireti dhe Allahu nuk e udhëzon popullin qafir﴾** En nahl, 107.

Justifikimi merret në konsideratë atëhere kur e ka të pamundur për të mësuar dhe jo kur ka fuqi dhe mundësi.

2- Keqinterpretimi i tekseve të sheriatit:-

Ai që bie në gabim ose në kufër për shkak të keqinterpretimit dhe kuptimit të gabuar

¹ E transmeton Ahmedi dhe Nesaiu, Sahih el xhami es sagir, 7725.

² Sahih sunen Ebi Daud, 2359.

³ E transmeton Muslimi.

të tekseve të shariatit, të cilat mund të kuqkuptohen në aspektin gjuhësor, nuk bëhet qafir, derisa t'i qartësohet argumenti i shariatit dhe t'i largohen dyshimet dhe keqkuptimet rreth tekseve të tij.

Siç ndodhi me Kudame ibn Medhunin dhe shokët e tij, të cilët e konsideruan verën të lejuar _dhe kjo është kufër_ bazuar në kuptimin e gabuar të ajetit, mirëpo ata nuk u bënë qafirë për shkak të keqinterpretimit, siç përmendet në historinë e tyre.

Prej Adij ibn Hatimit ؓ thotë: Kur zbriti ky ajet **﴿derisa të dallohet fija e bardhë nga fija e zezë﴾** morra disa litarë të bardhë dhe të zinj dhe i vendosa nën jastëk. I vështrova gjatë mirëpo nuk i dallova dhe i tregova profetit ﷺ i cili qeshi dhe më tha: **“E paske jastëkun gjatë e gjerë. Allahu ka për qëllim ditën dhe natën”**.¹

Ky sahabi hante dhe pinte edhe pas shfaqes së agimit të vërtetë për shkak të keqinterpretimit të ajetit. Kur profeti ﷺ i sqaroi kuptimin e ajetit nuk e urdhëroi ta përsëriste agjërimin dhe e justifikoi për shkak të interpretimit të gabuar.

Prej Esmā bin Umejsit thotë: Thashë: O i dërguar i Allahut! Fatimes bijës së Ebu Hubejshit i ka ardhur hajzi prej kaq e kaq ditësh dhe nuk është falur. I dërguari i Allahut ﷺ i tha: **“Subhanallah! Kjo është prej shejtanit. Le të ulet në një govatë e nëse shikon një lëng të zverdhur le të marrë një gusl të vetëm për ylenë dhe ikindinë, pastaj le të marrë një gusl të vetëm për akshamin dhe jacinë, dhe të marrë gusl për sabahun dhe të marrë abdes mes tyre (mes dy namazve me një gusl)”**.²

Mosfalja e namzit është prej gjynaheve më të mëdha dhe argumentet dëshmojnë për kufrin e lënësit të namazit, mirëpo ato nuk e përfshijnë këtë grua, madje as nuk u urdhërua të bënte kaza namazet që i kishin kaluar, sepse ajo besonte se nuk e kishte vaxhib namazin në këtë gjendje dhe keqinterpretoi argumentet fetare, të cilat ndalojnë prej faljes së namazit gjatë hajzit, derisa i erdhi argumenti fetar që i sqaroi se rasti i saj nuk hyn te hajzi që e pengon namazin.

Eslem ibn Umrani thotë: Dolëm për luftë prej Medines në drejtim të Kostandionopojës dhe udhëheqësi i grupit ishte Abdurrahman ibn Halid ibn Velidi. Romakët ishin rreshtuar përpara bedenave të qytetit. Papritmas një burrë u vërsul në drejtim të tyre dhe njerëzit i thanë: Ndalo! Ndalo! La ilahe il-lallah! Po e hedh veten e tij në shkatërrim.

Atëhere Ebu Ejubi ؓ tha: Ky ajet ka zbritur për ne ensarët kur Allahu e bëri profetin triumfues dhe islamin sundues dhe thamë: Hajde të kujdesemi për pasuritë tona dhe t'i shtojmë ato! Atëhere Allahu ﷻ zbriti: **﴿Shpenzoni në rrugë të Allahut dhe mos i hidhni vetet tuaja në shkatërrim﴾**. Rënia në shkatërrim ishte lakmia e pasurisë dhe lënia e

¹ E transmeton Buhariu dhe Muslimi, Sahih sunen Ebi Daud, 2059.

² Sahih sunen Ebi Daud, 283.

xihadit.¹

Njerëzit e keqkuptuan këtë ajet dhe e zbatuan mbi atë që vërsulet në rreshtat e armikut i vetëm. Kështu ata e konsideruan haram një diçka të ligjshme për shkak të keqkuptimit të ajetit. Ndërsa Ebu Ejubi ؓ u sqaroi gabimin, se ajeti nuk ka atë kuptim, sepse ai ka zbritur për ata që lakmojnë pasurinë dhe lënë pas dore xihadin në rrugë të Allahut ﷻ. Mirëpo ai nuk i konsideroi ata prej atyre që e bëjnë haram hallallin dhe gjërat e lejuara.

Gjithashtu disa njerëz e keqkuptuan fjalën e Allahut ﷻ: **﴿Kujdesuni për vetet tuaja! Nuk ju dëmtojnë juve ata që kanë humbur nëse ju jeni udhëzuar﴾** El maide, 105, dhe kujtuan se lejohet braktisja e njerëzve dhe lënia e urdhërimit për të mirë (davetit) dhe ndalimit prej të keqes. Kur Ebu Bekri ؓ e morri vesh këtë, doli para njerëzve dhe pasi falenderoi Allahun ﷻ tha: O njerëz! Ju e lexoni këtë ajet por nuk e vini në vendin e duhur **﴿O Besimtarë! Kujdesuni për vetet tuaja! Nuk ju dëmtojnë juve ata që kanë humbur nëse ju jeni udhëzuar﴾**. Kam dëgjuar të dërguarin e Allahut ﷻ të thotë: *“Nëse njerëzit e shohin të padrejtin dhe pastaj nuk e udhëzojnë, shumë shpejt ka për t’i përfshirë Allahu me dënim”*. Dhe e kam dëgjuar të dërguarin e Allahut ﷻ të thotë: *“Çdo popull në mesin e të cilëve bëhen gjynahe dhe ata kanë mundësi t’i ndryshojnë, por nuk i ndryshojnë, shumë shpejt Allahu do t’i përfshijë me dënim”*.²

Përafërsisht si kjo është edhe hadithi që e transmeton Buhariu në “El edeb el mufred” prej Talk ibn Hubejbit thotë: Isha prej mohuesve më të betuar të shefatit (ndërmjetësimit në ditën e gjykimit), derisa pyeta Xhabirin ؓ dhe më tha: O Tulejk! E kam dëgjuar të dërguarin e Allahut ﷻ të thotë: *“Kanë për të dalur prej zjarrit pasi të hyjnë në të”*. Pastaj edhe ne i lexojmë ato që ti i lexon.³

Në një transmetim të Ahmedi thuhet: Çdo ajet që thotë “banorët e zjarrit” është për mushrikët, ndërsa këta janë njerëz që kanë vepruar gjynahe dhe dënohen e pastaj dalin.

Talku është prej brezave të hershëm të tabinëve, e megjithatë e mohonte shefatin, megjithëse ai është vërtetuar me Kuran dhe me sunet, duke i interpretuar për gjynahqarët ajetet e zbrituara për mushrikët, derisa Xhabir ibn Abdullahu ؓ ja korrigjoi këtë mendim të gabuar.

Vërejtje:-

Jo çdo keqinterpretim konsiderohet justifikim dhe pengesë për shpalljen qafir. Kushdo që bën kufër me interpretime që janë jashtë botëkuptimit gjuhësor të argumenteve, si ato të batinive ekstremë për shtyllat e fesë, të cilat realisht janë deformime dhe përgënjeshtime,

¹ Sahih sunen Ebi Daud, 2193.

² Sahih sunen Ebi Daud, 3644.

³ Sahih el edeb el mufred, 629.

nuk justifikohet por konsiderohet zindik dhe qafir edhe nëse ata i quajnë këto deformime, interpretime.

Nëse thuhet: A ka për keqinterpretimin ndonjë përkufizim të njohur me të cilin mund të dallojmë keqinterpretimin që justifikohet prej atij që nuk justifikohet.

Them: Nuk ka ndonjë përkufizim të njohur për keqinterpretimin e justifikueshëm, të cilin kush e tejkalon bie në gjynah dhe ndëshkohet. Ai që mund të konsiderohet keqinterpretim i justifikueshëm për një person, mund të mos pranohet për një person tjetër. Kjo është në varësi të dijes që ata kanë, dyshimeve që i rrethojnë, çështjes ku kanë gabuar dhe qartësisë së saj, e cila mund të jetë e njohur për një person dhe nuk justifikohet, por mund të jetë e vështirë dhe e panjohur për një tjetër dhe justifikohet me interpretimin e gabuar.

Zakonisht, keqinterpretimi i justifikuar shoqërohet me shenja dalluese, kur deri diku është i pranueshëm në aspektin gjuhësor dhe përputhet me bazat e përgjithshme të shariatit, ose kur bazohet në interpretimin e tij në argumente jo të forta apo të abroguara dhe nuk i njeh argumentet e forta dhe abroguese, ose kur argumentohet me argumente të përgjithshme dhe nuk i di argumentet përjashtuese, ose argumente të pakufizuara dhe nuk i di argumentet kufizuese.

Keqinterpretimi, kur shoqërohet me këto shenja, zakonisht është i pranueshëm dhe pengon prej bërjes qafir të atij që bie në kufër. Këto shenja forcohen dhe dobësohen në varësi të rrethanave që e rrethojnë personin. A e ka zakon pasimin e dyshimeve dhe devijimin prej argumenteve të qartë? A është i njohur më parë me interpretimet e zindikëve? A njihet prej tij dhënia përparësi logjikës ndaj argumenteve të shariatit? A është i njohur si pasues i bidateve dhe epsheve, apo në origjinë është pasues i sunetit dhe selefite? A ka rrëshkitur në një apo në shumë çështje? A ka më shumë mendime të drejta apo devijime? Gabimi a është i qëllimtë apo si pasojë e hulumtimit për të vërtetën? Të gjitha këto ndikojnë në përcaktimin se kush justifikohet me keqinterpretim dhe kush jo, dhe Allahu është më i ditur.

3- Kur është akoma i ri në islam:-

Kush bie në kundërshtime ose kufër për shkak se është akoma i ri në islam dhe sapo e ka braktisur kufrin justifikohet derisa t'i shpjegohen argumentet e shariatit dhe t'i vijë thirrja profetike për ato që ka gabuar. Një i ri në islam e ka të pamundur të mësojë menjëherë të gjitha obligimet në akide dhe dispozitat e islamit. U përmend se pamundësia e anulon ngarkimin fetar. Prej muslimanit të ri mund të priten shumë mendime që mund të jenë kufër ndërkohë që ai kujton se ato nuk bien ndesh me islam.

Ata që i thanë profetit ﷺ në ditën e Hunejnit: “Na cakto një *dhatu enuat* ashtu siç kanë ata *dhatu enuat*” ishin bërë musliman në ditën e Çlirimit të Mekës. Kur i thanë këto fjalë, nuk kishin kaluar prej islamit të tyre më shumë se 15 ditë, sipas mendimit më të saktë të

historianëve.

Këtu hyn edhe hadithi i Muavije ibn Hakem Silmiut ؓ kur i tha profetit ﷺ: **“Ne jemi një popull që sapo jemi shkëputur prej xhahilijetit dhe Allahu ﷻ na udhëzoi në islam por disa prej nesh shkojnë te fallxhorët. I tha: Mos shko te ata”**.

Po prej tij thotë: **“Po falesha pas të dërguarit të Allahut dhe dikush tështiu. I thashë: Allahu të mëshiroftë (jerhamukallah)! Njerëzit më mbërthyen me shikimet e tyre dhe thashë: Ju humbte nëna! Ç’hall keni që shikoni? Pastaj zunë të përplasim duart në kofshë dhe e kuptova që po ma bënin me shenjë që të hesht. Kur profeti e mbaroi namazin nënë e babë i qofshin falë as më goditi, as më bërtiti dhe as nuk më shau por më tha: “Nuk lejohet të flasësh në namaz me njerëzit, por vetëm të lartësosh dhe madhërosh Allahun dhe të lexosh Kuran”**.¹

Vëre se si profeti ﷺ e justifikoi dhe nuk e urdhroi ta përsëriste namazin, sepse ishte i paditur dhe akoma i ri në islam, siç u përmend në fjalën e tij se populli i tij akoma shkojnë te fallxhorët.

Po kështu historia e Adij ibn Hatimit ؓ, kur erdhi te profeti ﷺ me kryq në qafë, pasi ishte bërë musliman, mirëpo ishte akoma i ri në islam, siç u përmend më parë në historinë e tij.

Ibn Tejmije thotë: **“I sapohyri në islam nuk mund t’i mësojë të gjitha dispozitat dhe urdhëresat e fesë. Edhe i penduari prej gjynaheve edhe ai që përpiqet të mësojë nuk mund të ngarkohen me çdo urdhër dhe të mësojnë të gjithë dijen që në fillim, sepse është e pamundur dhe pamundësia e rrëzon obligimin në këtë rast. E nëse (mësimi i çdo gjëje) nuk është obligim atëhere nuk i takon pushtetarit dhe dijetarit që ta ngarkojnë atë, por e falin për ato urdhra dhe ndalesa që i ka të pamundura t’i mësojë dhe punojë, derisa t’i jepet mundësia; sepse profeti i falte këto lloj personash derisa t’ua sqaronte këto çështje. Veprimi i profetit në këtë rast nuk konsiderohet si pohim i haramit dhe lënje e vaxhibit, sepse obligimi dhe ndalimi janë të kushtëzuara me mundësinë e mësimit dhe veprimit, e nëse ky kusht nuk plotësohet atëhere bie obligimi dhe ndalimi**.

Prej kësaj na sqarohet se shumë gjëra që në origjinë janë vaxhip ose haram bien nga përgjegjësia, për shkak të mos arritjes së argumentit të sheriatit, i cili sqaron obligimet dhe ndalesat, sepse pamundësia e shfuqizon urdhrin dhe ndalimin edhe nëse ai është vaxhip (ose haram) në origjinë”.²

4- Nëse jeton në krahina të largëta ku është e pamundur arritja e dijes.

Kush bie në gjynah dhe kufër përshkak se jeton në krahina të largëta si në malësi, në

¹ Sahih sunen Ebi Daud, 823.

² Mexhmu’ul fetaua, 20/60-61.

xhungël dhe në zona ku nuk dinë asgjë për thirrjen e profetëve dhe dija është e pamundur t'i arrijë dhe as ai nuk ka mundësi ta gjejë dijen, atëherë ai justifikohet me paditurinë e tij, derisa t'i vijë argumenti i qartë prej shariatit për atë që ka kundërshtuar dhe t'i jepet mundësia e kërkimit të dijes fetare prej atyre që e posedojnë atë.

Prej argumenteve ku mund të mbështetemi për marrjen në konsideratë të kësaj pengese¹ është fjala e profetit ﷺ: ***“Sot jeni në një kohë të mbushur me dijetarë dhe me pak oratorë. Kush e lë një të dhjetën prej asaj që di, ai ka rrëshkitur. Më vonë do të vijë një kohë e mbushur me oratorë por me pak dijetarë. Kush kapet fort me një të dhjetën e asaj që di ka shpëtuar”***.²

Profeti ﷺ bëri dallim mes kohës së mbushur me dijetarë dhe gjykoi me rrëshkitje për atë që lë qoftë edhe një të dhjetën e asaj që di dhe mes kohës ku dijetarët janë të paktë dhe se ai që kapet fort pas një të dhjetës së asaj që njihet në mesin e tyre _për shkak të mungesës së dijetarëve_ ai ka shpëtuar.

Gjithashtu fjala e profetit ﷺ: ***“Islami do të vjetërohet ashtu siç vjetërohet rroba aq sa të mos njihen as agjërimi, as namazi, as haxhi, as sadakaja (zekati). Libri i Allahut do të ngrihet brenda një nate dhe nuk do mbetet prej tij në tokë asnjë ajet. Derisa të mbeten grupe njerëzish me pleqë e plaka që thonë: Baballarët thonin: La ilahe il-lallah dhe ne e themi atë”***.

Sileh ibn Zuferi e pyeti transmetuesin e hadithit, Hudhejfen ؓ: ***“E çfarë dobie u bën atyre fjala “La ilahe il-lallah” kur ata nuk njohin as namazin, as haxhin dhe as zekatin? Hudheifa nuk ju përgjigj. E pyeti tre herë mirëpo Hudheifa nuk i përgjigjej, e kur e pyeti për herë të tretë i tha tre herë: O Sileh! Ajo i shpëton prej zjarrit”***.³

Ky hadith është argument për justifikimin me padije dhe argument për justifikimin e personit që jeton në një kohë dhe vend ku islami pothuaj është zhdukur dhe as nuk i vjen dija dhe as nuk e gjen dot, prandaj nuk e njeh as namazin dhe as agjërimit. Në këtë rast dëshmia e teuhidit i bën dobi këtij personi.

Por nuk përfitohet prej hadithit, siç pretendojnë murxhitë dhe xhehmitë, se lënësi i të gjitha veprave përfshirë edhe shtyllat e islamit është musliman dhe prej banorëve të xhenetit, pa marrë parasysh ambjentin ku jeton edhe nëse jeton në një vend ku dija është e shumtë dhe e lehtë për atë që e kërkon.⁴

Prandaj themi: Nëse njeriu që jeton larg dijes, ka mundësi të udhëtojë në vendet e

¹ Pengesa e kohës dhe vendit ku mbizotëron injoranca e madhe dhe mosnjohja e shariatit dhe ndikimi i tyre në ndëshkimin e njeriut.

² Es silsiletus sahihah, 2510.

³ Sahih sunen Ibn Maxheh, 3273.

⁴ Shiko fjalën e shejh Nasirit në *“Es silsiletu es sahiha” 1/130*. Unë e kam kritikuar këtë fjalë të tij në shumë libra si: Triumfi, Justifikimi me padituri, gjykimi i lënësit të namazit dhe mund t'u kthehesh atyre nëse dëshiron.

dijes pa asnjë pengesë, por preferon rehatinë, pasurinë dhe qëndrimin në vendin e tij dhe nuk e merr mundin ta largojë paditurinë; një person i tillë nuk justifikohet nëse bie në kufër për shkak të neglizhencës, se ai ka mundësi ta largojë injorancën por nuk e bën.

Muslimani është krijuar për një qëllim që është më i rëndësishëm se çdo qëllim tjetër dhe nuk i lejohet ta neglizhojë dhe të vonohet në realizimin e këtij qëllimi, ashtu siç e kënaq Allahun. Ky qëllim është njësimi i Allahut me adhurim, siç thotë Allahu: **﴿I kam krijuar xhinët dhe njerëzit vetëm që të më adhurojnë﴾** Edh dharijat, 56. Dhe thotë: **﴿Ata u urdhëruan që të adhuronin vetëm një ilah, nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç atij. I pastër është ai prej shirkut që bëjnë﴾** Et teube, 31. Dhe thotë: **﴿Ata u urdhëruan të adhurojnë vetëm Allahun me sinqeritet, nënshtrim dhe pastërti dhe ta falin namazin e ta japin zekatin dhe kjo është feja e vyer﴾** El bejneh, 5.

Allahu ﷻ na ka krijuar për një gjë të vetme dhe na ka urdhëruar me një urdhër të vetëm, që është adhurimi i Allahut një dhe të vetëm. Kuptimi i përgjithshëm i adhurimit përfshin çdo vend dhe çdo kohë që lidhet me njeriun dhe përfshin çdo vepër dhe fjalë të dukshme apo të fshehtë që Allahu i lartë e pëlqen.

Njeriut nuk i lejohet të neglizhojë një qëllim kaq të madh dhe të justifikohet me justifikime që ka mundësi t'i largojë. Allahu thotë: **﴿O robërit e mi që keni besuar! Toka ime është e gjerë prandaj vetëm mua më adhuroni﴾** El ankebut, 56. Allahu e ka bërë tokën e gjerë, që robërit e tij ta adhurojnë dhe të mos i bëjnë atij shok. Nëse bien në vështirësi në një zonë, atëhere emigrojnë në një zonë tjetër, për të ruajtur fenë. Kudo që u jepet mundësia për kryerjen e ibadeteve fetare lirisht dhe në mënyrën që e kënaq Allahun më shumë, atëhere e ka detyrë të shkojë në atë vend, sepse hixhreti nga vendi i kufrit, i fiskut dhe padrejtësisë, është ligjëruar pikërisht për këtë qëllim.

Ibn Hazmi *_Allahu e mëshiroftë_* thotë: *“Kujt i arrin përmendja dhe thirrja profetike, por nuk gjen në vendin e tij askënd që ta informojë rreth profetit, ai e ka farz udhëtimin në një vend tjetër ku arrin dijen e të vërtetës. Kushdo që jeton në malësi të largëta dhe nuk gjen askënd që ia mëson dispozitat e fesë, të gjithë ata e kanë farz, burra e gra, që të shkojnë në një vend ku e gjejnë një njeri të ditur që u mëson fenë, ose të sjellin në zonën e tyre një fakih (njeri të ditur) që t'u mësojë çështjet e fesë. Nëse pushtetari islam informohet (se në këtë vend të largët nuk kanë hoxhë) atëhere e ka detyrë që t'ua dërgojë një njeri të ditur për t'i mësuar”*.¹

5- Gabimi i paqëllimtë.

Prej pengesave të shpalljes së një personi qafir është edhe gabimi i paqëllimtë, atëhere kur gabon nga harresa ose bën lapsus të paqëllimtë. Një person i tillë justifikohet sepse

¹ Ihkamul ahkam, 5/112.

Allahu thotë: **«Nuk merrni gjynahe për atë që gaboni (paqëllim) por për atë që zemra juaj e vepron qëllimisht dhe Allahu është falës dhe mëshirues»** El ahzab, 5.

I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“I është falur umetit tim gabimi dhe harresa”**.

Prej argumenteve se gabimi i paqëllimtë nuk ndëshkohet është edhe hadithi personit i cili i kishte humbur shpresat për devenë e humbur, në të cilën kishte ushqim dhe ujë, e kur e gjeti tha: **“O Allah! Ti je rob i im e unë jam zoti yt. Gaboi prej gëzimit të madh”**.

Lexuesi i Kuranit me vështirësi që shpeshherë shton dhe pakëson në të është i justifikuar për gabimet në lexim. Nëse do shtonte dhe pakësonte prej Kuranit me vetëdije dhe qëllim, atëhere do të shpallej qafir me përcaktim.

Ai që shkel diçka duke kujtuar se është prej sendeve të shtëpisë, por pastaj e kupton se ka shkelur Kuranin. Për këtë gabim të paqëllimtë nuk merr gjynahe, por nëse e shkel me qëllim duke e ditur që ai është libri i Allahut bëhet qafir.

Gabimi i paqëllimtë nënkupton mosdashjen e rënies në këtë gabim dhe nuk nënkupton mosdashjen e kufrit me këtë gabim, sepse ai që e thotë ose e vepron gabimin që është kufër me dëshirë, atëhere ai bëhet qafir, pati apo nuk pati për qëllim daljen prej islamit. Ka dallim mes atij që e vepron gabimin me dëshirë dhe qëllim _ky është kusht i drejtpërdrejtë për ndëshkimin_ dhe mes atij që e vepron gabimin për të bërë kufër me qëllim dhe kjo nuk është kusht për ndëshkim dhe rënien në kufër. Kushtëzimi i qëllimit të kufrit në bërjen qafir për shkak të gabimit është mendimi i xhehmive dhe murxhive, siç u përmend edhe më parë.

6- Ixhtihadi.

Gabimi për shkak të ixhtihadit është pengesë për tekfirin. Kur një dijetar gabon për një arsye të pranueshme¹ dhe e konsideron të lejuar një haram ose të ndaluar një hallall, ose gjykon me një dispozitë që nuk e ka zbritur Allahu, duke kujtuar se kjo është e vërteta që e kënaq Allahun, atëhere ai justifikohet për ixhtihadin e tij. Madje ai shpërblehet një herë nëse gabon dhe dy herë nëse ia qëllon, siç transmetohet në hadithin sahih se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Nëse gjykatësi bën ixhtihat dhe ja qëllon ai ka dy shpërblime, e nëse bën ixhtihad por gabon ai ka një shpërblim”**.²

Në dy sahihet prej hadithit të Said Hudariut ؓ thotë: Bilali ؓ i solli profetit ﷺ disa hurma të mira dhe profeti i tha: **“Ku i gjete? I tha: Kisha ca hurma të vjetra dhe i shkëmbeva dy sa’e me një të vetëm. I tha: Mos! Kjo është ribaja. Mos vepro kështu! Nëse**

¹ Kur nuk i ka arritur argumenti, ose i arrin por e harron, ose e konsideron senedin dhe teksin e tij të dobët, ose e konsideron të saktë por mendon se në të nuk ka argument për çështjen ku ka gabuar, ose e kujton për të abroguar ose të kufizuar, e shumë arsye të tjera që i justifikojnë dijetarët aty ku e kanë gabim. Shejhul islam Ibn Tejmije ka shkruar një libër për këtë temë të quajtur *“Mosqortimi i dijetarëve islamë”*.

² E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

dëshiron të blesh, shiti hurmat me diçka tjetër dhe pastaj ble”.¹

Ndërkohë në sahihun e Muslimit, transmetohet se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“E mallkoftë Allahu ngrënësin e ribasë, dhënësin e saj, dy dëshmitarët dhe shkruajtësin. Dhe tha: Ata janë njësoj”.**²

Dhe thotë: **“Dirhemi që hahet me riba është më i rëndë te Allahu se 36 herë zina”.**³ Por kjo dispozitë nuk e përfshin këtë sahabi sepse ai kujtoi, bazuar në ixhtihad, se kjo nuk konsiderohet riba, prandaj profeti e justifikoi dhe e fali dhe u mjaftua me mësimin dhe sqarimin e tij.

Gjithashtu atyre që u arriti fjala e profetit: **“Ribaja është vetëm në kredi”**⁴ dhe e lejuan, në kuptimin e këtij hadithi, shitjen e dy saeve me një të vetëm dorë më dorë, prej tyre ishin Ibn Abasi dhe nxënësit e tij; Ebu Shathai, Atau, Tausi, Said ibn Xhubejri, Ikreme dhe të tjerë prej dijetarëve të Mekës, të cilët janë ajka e dijetarëve të umetit në dije dhe pasim.⁵

Ibn Tejmije thotë: **“Nuk i lejohet muslimanit të besojë se dikë prej sahabëve ose ata që i pasojnë ata, aty ku lejohet pasimi, i kap mallkimi i ngrënësit të ribasë, sepse ata e vepruan këtë për shkak të interpretimit që në parim është i pranuar.**

Transmetohet se disa medinas i lejonin marrëdhëniet me gratë në anus, ndërkohë që Ebu Daudi transmeton se i dërguari i Allahut ka thënë: **“Kush kryen marrëdhënie me gruan në anus ai ka bërë kufër me atë që i është zbritur Muhamedit”.**⁶

Gjithashtu Usama ؓ vrau një person që tha: “La ilahe il-lallah”, duke kujtuar se ai e shqiptoi shehadetin për t’i shpëtuar shpatës. Profeti ﷺ e kritikoi ashpër, por nuk e dënoi as me kisas dhe as me shpagimin e “dijes”,⁷ por e justifikoi për shkak të ixhtihadit dhe për shkak se ai nuk i kishte dëgjuar argumentet që ndalonin bazimin në dyshime në të tilla çështje.

Ndërsa kur Mikdad ibn Esuedi ؓ e pyeti profetin ﷺ: O i dërguar i Allahut! Nëse përballem me një person qafir dhe ai më lufton dhe më pret njërën dorë me shpatë, pastaj fshihet pas një peme dhe thotë: I jam dorëzuar Allahut, a ta vras o i dërguar i Allahut pas kësaj fjale? I tha: Mos e vrit. I thashë: O i dërguar i Allahut! Po ai më ka prerë njërën dorë dhe këtë fjalë e thotë pasi të ma presë dorën, prandaj pse mos ta vras? I tha: **“Mos e vrit sepse po ta vrasësh ai do të jetë në pozitën tënde para se ta vrisje dhe ti do të jesh në pozitën e tij para se ta thoshte këtë fjalë”.**⁸ Pra ai do të jetë në pozitën tënde para se ta vrisje si musliman

¹ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

² E transmeton Muslimi:

³ Es silsiletu es sahiha, 1033.

⁴ E transmeton Muslimi.

⁵ Shiko: “Mosqortimi i dijetarëve islamë” i shejhul islamit, fq. 82.

⁶ “Mosqortimi i dijetarëve islamë” i shejhul islamit, fq. 82

⁷ Shpagimi që i paguhet të afërmeve të viktimës, atëhere kur nuk zbatohet kisasi. (Shën. i përkthyesit)

⁸ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

musliman dhe i siguruar me sigurinë e islamit, ndërsa gjaku yt do të lejohej ashtu si gjaku i tij ishte i lejuar para se të thoshte fjalën që e futi në islam dhe do zbatohet mbi ty dënimi i kisasit për vrasjen e muslimanit. Profeti ﷺ nuk e justifikoi atë për shkak se atij ju sqarua argumenti i ndalimit pas të cilit nuk bën dobi as ixhtihadi dhe as interpretimi.

Ibn Umeri ua priste grave këpucët që i vishnin në haxh, mirëpo Safije bint Ebi Ubejd i tregoi se Aishja i kishte treguar se i dërguari i Allahut ﷺ ua kishte lejuar grave mbathjen e këpucëve. Pas kësaj hoqi dorë prej grisjes së tyre.¹

Profeti ﷺ e këshillonte emirin e ushtrisë me këto fjalë: **“Nëse rrethon ndonjë kështjellë dhe kërkojnë prej teje që të zbresin në gjykimin e Allahut, atëhere mos prano të zbresësh në gjykimin e Allahut, por negocio me ta sipas gjykimit tënd, sepse ti nuk e di a ja qëllon gjykimin të Allahut apo jo”.**²

Profeti ﷺ shprehet qartë se gjykimi i emirit mund të mos përkojë me gjykimin e Allahut ﷻ. Në këtë aspekt ai mund të gjykojë me atë që Allahu nuk e ka ligjëruar, mirëpo ai është i justifikuar për ixhtihadin e tij.

Këtu hyn edhe ixhtihadi dhe kundërshtimi i sahabëve rreth urdhrit të profetit ﷺ: **“Askush të mos e falë ikindinë veçse te fisi Kurejdha”.** Disa prej tyre i kapi ikindia në rrugë dhe disa thanë: Falemi vetëm te fisi Kurjdha. Ndërsa të tjerët thanë: Ne do falemi, sepse profeti ﷺ nuk ka pasur për qëllim që të mos falemi. Kur e pyetën profetin ﷺ, ai nuk qortoi asnjërin prej tyre.³ Profeti ﷺ nuk qortoi asnjë sepse argumentet e tjera rreth namazit e lejojnë këtë lloj ixhtihadi dhe kundërshtimi.

Ebu Said Hudariu ؓ thotë: Dy veta u nisën për udhëtim dhe i zuri namazi, por nuk gjetën ujë dhe morrën tejemum. Pastaj gjetën ujë përpara se të dilte koha. Njëri e përsëriti abdesin dhe namazin, ndërsa tjetri jo. Kur vajtën te profeti ﷺ dhe e pyetën, i tha atij që nuk e përsëriti: **“E ke qëlluar synetin dhe namazin e ke të vlefshëm”** ndërsa atij që morri abdes dhe e përsëriti i tha: **“E ke shpërblimin dy herë”.**⁴

Ibn Tejmije thotë: **“Nëse është rritur në malësi të largët ose është akoma i ri në islam dhe vepron ndonjë haram pa e ditur se është haram, ai nuk ka gjynah dhe nuk dënohet edhe nëse nuk argumentohet për veprimin e tij me ndonjë argument prej sheriatit.**

Ndërsa atij që nuk i ka ardhur argumenti për ndalimin e diçkaje dhe bazohet në lejimin e saj në argumente po prej sheriatit, ai e meriton më shumë të justifikohet. Madje ai shpërblehet dhe lavdërohet për ixhtihadin e tij”.⁵

¹ Sahih sunen Ebi Daud, 1616.

² E transmeton Muslimi.

³ E transmeton Buhariu.

⁴ Sahih sunen Ebi Daud, 327.

⁵ Mosqortimi i dijetarëve islam; fq. 56.

Vërejtje: -

Kjo që u përmënd më sipër nuk përfshin injorantin i cili nuk është i aftë për ixhtihad dhe as bidatçiuin i cili e di të vërtetën me argumeta të prera, por devijon prej saj dhe jep fetva në kundërshtim me të vërtetën, për t'u bërë qejfin pushtetarëve të prishur dhe pabesimtarë, ose për shkak të interesit material. Një person i tillë nuk justifikohet me ixhtihad, sepse persona të tillë profeti ﷺ i ka përgëzuar me zjarr, kur thotë: **“Tre janë kaditë. Njëri është në xhenet dhe dy të tjerët në zjarr. Në xhenet është ai që e njeh të vërtetën dhe gjykon me të, ndërsa ai që e njeh të vërtetën dhe devijon në gjykim ai është në zjarr dhe kush gjykon mes njerëzve me injorancë ai është në zjarr”.**¹

Justifikimi i muxhtehidit në gabimin e tij nuk nënkupton që lejohet imitimi (taklidi) i tij në këtë gabim, nëse imituesi e di që ai është gabim. Imitimi i dijetarëve në të drejtë dhe në të kotë, në të saktë dhe në gabime, është prej rrugës së çifutëve dhe të krishterëve, të cilët i morrën priftërinjtë dhe murgjit e tyre zotër përveç Allahut, siç thotë Allahu: **﴿I morrën priftërinjtë dhe murgjit e tyre për zotër përveç Allahut﴾** Et teube, 31, sepse ju bindën atyre në lejimin e haramit dhe ndalimin e hallallit.

7- Imponimi:-

Shfaqja e kufrit për shkak të imponimit, kur zemra është plot me iman, nuk merret në përgjegjësi por justifikohet, sepse Allahu thotë: **﴿Kush bën kufër me Allahun pas imanit të tij përveç atij që imponohet dhe zemra e tij është e qetësuar me iman, por ai që ja hap gjoksin kufrit, mbi ta ka rënë zemërimi i Allahut dhe ata kanë dënim të madh﴾** En nahl 106.

Dhe thotë: **﴿Të mos i marrin besimtarët qafirët për miq përveç besimatarëve. E kush vepron kështu ai nuk është te Allahu asgjë, vetëm nëse shtireni ndaj tyre për t'u ruajtur. Allahu ju tërheq vërejtje që të frikësoheni prej tij﴾** Ali Imran, 28.²

¹ Sahih sunen Ebi Daud, 3051.

² Shfaqja e kufrit për shkak të imponimit është lehtësim dhe mëshirë prej Allahut. Kush dëshiron e marr këtë lehtësim dhe kush dëshiron e lë. Nëse imponohet për kufër më e mira është të rezistojë, bazuar në fjalën e Ebu Dardasë ؓ: **“Miku im më ka porsitur të mos i bëj shok Allahut edhe nëse pritem ose digjem ...”**. E transmeton Ibn Maxheh dhe Bejhakui. Sahihu et tergib, 566.

Dhe fjala e profetit ﷺ: **“Tre gjëra nëse njeriu i posedon ka gjetur ëmbëlsinë e imanit . . . të urrejë të kthehet në kufër ashtu siç urren të hidhet në zjarr”**. Mutefek alejhi.

Dhe fjala e tij: **“Dikur përpara jush e merrnin njeriun dhe e groposnin në tokë pastaj i vinin sharrën në kokë dhe e prisnin në mes ose e krihnin me krehër hekuri në mish dhe në kockë por asgjë nuk e kthente prej fesë së tij”**. Mutefek alejhi.

Argument është edhe historia e sahabiut Abdullah ibn Hudhafe Sehmiut ؓ me mbretin tiran të romakëve, kur u kap rob dhe tirani romak i tha: Nëse bëhesh i krishter të jap prej sundimit tim. Abdullahi ؓ i tha: Nëse ma jep të gjithë sundimin dhe sundimin e arabëve me kusht që të kthehem nga feja e Muhamedit ﷺ qoftë edhe një çast të vetëm nuk kisha për ta bërë. I tha: Do të vras. I tha: Si të duash. Pastaj urdhëroi që të kryqëzohej dhe u tha shigjetarëve: Qëlloni pranë duarve dhe këmbëve. Pastaj e joshte (për kufër) por refuzonte. Më pas i

Ibn Xheriri thotë në tefsirin e tij: “**(Vetëm nëse shtireni prej tyre për t’u ruajtur) vetëm nëse jeni nën sundimin e tyre dhe keni frikë për vetet tuaja dhe shtireni me fjalë se ju e pranoni sundimin e tyre, ndërsa në zemra fshihni armiqtësinë, por mos i përkrahni në kufrin e tyre dhe mos i ndihmoni kundër muslimanit me vepra.**¹

Ibn Abasi ؓ thotë: *Shtirja është fjalë me gojë, kur zemrën e ka të mbushur me iman*”.²

Transmetohet në hadithin sahih se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “**Allahu ja ka falur umetit tim gabimin, harresën dhe atë për të cilën janë imponuar**”.³

Gjithashtu kur mushrikët e kapën Amarin dhe nuk e lanë rehat derisa të fliste keq për profetin ﷺ dhe të lavdëronte idhujt e tyre, e kur vajti te profeti ﷺ i tha: **Si është puna? I tha: Shumë keq o i dërguar i Allahut. Nuk më lanë rehat derisa fola keq për ty dhe lavdërova idhujt e tyre. Profeti i tha: Si e ke zemrën? I tha: Zemrën e kam plot me iman. I tha: Nëse kthehen prapë, vepra njësor**”.⁴

urdhëroi ta zbrisnin dhe kërkoi një kusi. E mbushi me ujë derisa valoi dhe kërkoi dy robër musliman dhe urdhëroi që njëri prej tyre të hidhej në kusi pasi e ftoi në krishtërizëm por ai refuzoi. Pastaj i urdhëroi ta hidhnin (Abdullahin) në kusi. Kur e morrën sytë ju mbushën me lot. Atëhere i thanë mbretit: Sytë ju mbushën me lot. Ai kujtoi se u frikësua dhe u tha: Kthejeni! Pastaj e ftoi në krishtërizëm por refuzoi. I tha: Pse qajte atëhere? I tha: Qava sepse thashë me vetë: Tani do të hidhesh në këtë kusi dhe do të vdesësh dhe ëndërroja sikur çdo qime në trupin tim të kishte shpirt që merrej për hir të Allahut.

Atëhere tirani i tha: A e puth kokën time dhe unë të të liroj? Abdullahi ؓ i tha: T’i lirosh edhe robërit e tjerë musliman. I tha: Kam për t’i liruar të gjithë robërit musliman.

Abdullahi thotë: Thashë me vetë: Një armik prej armikëve të Allahut nëse ja puth kokën i liron të gjithë robërit musliman. Punë e madhe. Pastaj u afrua dhe ja puthi kokën dhe i liroi robërit.

Pastaj shkoi me të gjithë robërit te Umeri dhe ia tregoi të gjithë historinë dhe Umeri tha: Çdo musliman e ka hak t’ia puthë kokën Abdullah ibn Hudhafes. Unë jam i pari që po e puth. Ky është një aprovim me konsensus prej sahabëve për veprimin e Umerit dhe se rezistimi është më i mirë.

¹ Këtu duhet shtuar kushti i mospasjes forcë dhe mundësi për të dalur prej sundimit të tyre; sepse nëse kanë mundësi të largohen prej sundimit të tyre ose të bëjnë hixhret por nuk bëjnë hixhret, nuk justifikohen me shtirje dhe imponim, me argument historinë për të cilën ka zbritur fjala e Allahut ﷻ: **(Ata që melekët ua kanë marrë shpirtat zullumqar dhe u thotë: Ku ishit? Thanë: Ishim të dobët në tokë. U thanë: A nuk ishte toka e Allahut e gjerë e të bënit hixhret. Strehimi i tyre do të jetë xhehenemi dhe ai është përfundimi më i keq)** En nisa, 97.

² Xhamiul bejan, 3/228.

³ E transmeton Ahmedi dhe të tjerë. Sahihu el xhami’, 1731.

⁴ Këtu tërheqim vërtje, se kufri lejohet të veprohet vetëm nëse kërcënim i imponuesit është real dhe ka mundësi ta zbatojë atë, nëse nuk i përgjegjet kërkesave të tija. Gjithashtu është kusht që torturimi të jetë i padurueshëm. Nuk veprohet kufri thjesht për një kërcënim ose për një cënim që mund të durohet.

Ata që e praktikojnë kufrin bazuar në iluzione se janë të imponuar, ose për cënime që shumë thjesht mund të përballohen dhe argumentohen me historinë e Amarit ؓ, ata janë në iluzione të gabuara. Amari ؓ kur shkoi te mushrikët i urdhëroi për mirë dhe i ndaloi nga e keqja, derisa ia vranë prindërit përpara syve, pastaj e dogjën me zjarr, pastaj e zhytën në ujë, e vetëm më pas ua plotësoi kërkesat, siç transmetohet se kur profeti e takoi Amarin duke qarë, zuri t’i fshinte lotët dhe i thoshte: **“Qafirët të rrëmbyen dhe të zhytën në ujë derisa thekështu e ashtu. Nëse e përsërisin prapë, atëhere thuaj prapë”**. Amr ibën Mejmoni thotë: Mushrikët e dogjën Amar ibn Jasirin ؓ me zjarr.

Ndërsa atij që i flen zemra në kufër pas imponimit, ai nuk justifikohet, sepse Allahu thotë: **﴿por ai që ja hap gjoksin kufrit, mbi ta ka rënë zemërimi i Allahut dhe ata kanë dënim të madh﴾**. Askush prej krijesave nuk ka ndikim në zemra, sepse imponimi ndikon te gjymtyrët e jashtme por jo në zemër.

8- Shaqja e kufrit për të larguar një kufër më të madh dhe më të rëndë.

Kjo ndodh kur vihet para zgjedhjes mes dy gjërave që janë kufër dhe duhet patjetër ta veprojë njërën prej tyre. Në këtë rast e vepron atë që kufrin dhe dëmin e ka më të vogël, për të evituar një kufër dhe dëm më të madh.¹

Kjo ndodh atëhere kur umeti sprovohet me një tagut, kufri i të cilit është i rëndë, sprova dhe belaja e tij janë shumë të rënda për vendin dhe popullin dhe nuk ka asnjë mundësi të hiqet qafe dhe të biem rehat prej tij, veçse nëse depërtojmë në mesin dhe në ushtrinë e tyre duke u hequr se jemi prej ushtarëve dhe pasuesve të tij, derisa të na krijohet mundësia për ta hequr qafe.

Kjo çështje është aq e qartë sa nuk ka nevojë për shumë debate dhe kërkime, sidomos për xhematet e xhihadit, të cilat kanë nevojë për dispozita të hollësishme në fikhn islam, që t'i praktikojë në rezistencën kundër tagutëve që përhapin kufrin dhe laicizmin në tokë, të cilët i

Jahja ibn Maini, kur u përhap fitnia e krijimit të Kuranit, ishte në rradhën e atyre që zgjodhën lehtësimin dhe u shtirën dhe thanë: Kurani është i krijuar. Kur hyri te imam Ahmedi *Allahu e mëshiroftë* kur ishte i sëmurë i dha selam, por nuk ia ktheu. Jahja u justifikua me hadithin e Amarit ؓ dhe fjalën e Allahut: **﴿përveç atij që është imponuar dhe zemra e tij është e qetësuar me iman﴾**. Atëhere Ahmedi e ktheu kokën nga ana tjetër. Jahja i tha: Nuk pranon asnjë justifikim? Kur Jahja doli, Ahmedi u tha: Argumentohet me hadithin e Amarit! Në hadithin e Amarit ؓ thuhet: Kalova pranë tyre dhe ata po të shanin dhe unë i ndalova por më rrahën, ndërsa juve po ju thonë: Do t'u rrahim. Atëhere Jahja i tha: Pasha Allahun nuk kam parë nën shtresën e qiellit asnjë njeri që e kupton fenë e Allahut më mirë se ti.

¹ Kufri ndahet në dy lloje, i vogël që nuk të nxjerr prej islamit dhe i madh që të nxjerr prej islamit. Kufri i madh gjithashtu ndahet në dy lloje: kufër i thjeshtë, i cili nuk shoqërohet me armiqësi, luftim, sharje, cënim etj, pra thjesht kufër që nuk e kalon kufrin e kufrit të tij, dhe kufër i rëndë i cili shoqërohet me cënim atëhere kur i shton kufrin të thejstë kufër tjetër dhe e rëndon atë, si luftimi i Allahut, të dërguarit të tij dhe besimtarëve, sharja, cënimi, ironizimi me fenë, vrasja ose intrigat, të cilat ia shtojnë kufrin dhe gjynahun. Ashtu siç shtohet imani me vepra të mira, po kështu edhe kufri shtohet me tejkalimin e caqeve, me padrejtësi dhe kufër. Edhe ridja ndahet në ridde të thjeshtë ose të rëndë. Secila prej tyre ka dispozita të veçanta në dunja dhe ahiret edhe nëse të dy kanë dalë prej islamit dhe ditën e gjykimit do të jenë të përhershëm në zjarrin e xhehenemit. Kjo është ndarja e saktë. Ndërsa ndarja e riddes në ridde të vogël dhe ridde të madhe, duke supozuar se ridja e vogël ashtu si kufri i vogël nuk të nxjerr prej islamit, kjo ndarje është e kotë dhe e pasaktë të cilën nuk e ka bërë askush prej selefit.

Ibn Tejmije *_Allahu e mëshiroftë_* thotë: *“Bëhet dallim mes murtedit që bën ridde të thjeshtë, i cili vritet përveç nëse pendohet, dhe mes riddes së rëndë i cili vritet pa ju kërkuar pendim. Në sunetin e profetit do të gjejmë se bëhet dallim mes dy llojeve. Profeti ua pranoi teuben disa murtedëve, por urdhëroi për vrasjen e Mekis ibn Hababes ditën e Çlirimit të Mekës, pa i kërkuar teube, përshkak se ai i shtoi riddes së tij vrasjen e muslimanëve dhe rrëmbimin e pasurive dhe nuk u pendua para se ta kapnin muslimanët. Gjithashtu urdhëroi të vriten aranijinët, të cilët riddes së tyre i shtuan të njëjtat vepra. Po ashtu urdhëroi vrasjen e Ibn Hatelit sepse ai riddes së tij i shtoi edhe sharjen dhe vrasjen e muslimanëve. Dhe urdhëroi për vrasjen e Ibn Sershit atëhere kur ai i shtoi riddes së tij shpifjet dhe talljen me profetin”*.

dalin në krah xhahilijetit bashkohor me çdo mundësi dhe mjet që posedojnë.

Mirëpo pas një hulumtimi të gjatë, vura re se kjo çështje është shumë e debatuar në mesin e vëllezërve. Disa prej tyre nuk e pranojnë dhe pretendojnë se shfaqja e kufrit është e lejuar vetëm në rastin e imponimit direkt, i cili u shpjegua më parë. Prandaj u detyrova ta sqaroj këtë çështje më hollësisht dhe vetëm prej Allahut e kërkoj udhëzimin.

Muslimani nëse dëshiron të rehatohet prej një taguti ose prijësi të madh në kufër dhe padrejtësi, i lejohej që të depërtojë në rradhët e ushtrisë së tij dhe të shtiret si një prej tyre, me nijet që të heqë qafe këtë tagut dhe ta rehatoj umetin prej sherrit dhe kufrit të tij. Këtë fjalë e bazojmë në pikat e mëposhtme:-

Së pari: Argumentet e sheritatit që dëshmojnë për lejimin.

Imam Buhariu transmeton në sahihun e tij prej hadithit të Xhabir ibn Abdullahit thotë: I dërguari i Allahut tha: *“Kush i del ballë Kab ibn Eshrefit sepse ka fyer Allahun dhe të dërguarin e tij? Muhamed ibn Meslemeja i tha: O i dërguar i Allahut! A dëshiron që ta vras? I tha: Po! I tha: Atëhere më lejo që të shtirem në fjalë. I tha: Fol (atë që dëshiron).*

Pastaj Muhamed ibn Mesleme vajti dhe i tha (Kab ibn Eshrefit): Ky robi na ka kërkuar sadaka dhe na ka futur në hall, prandaj kam ardhur të kërkoj borxh. I tha: Pasha Allahun keni për t’u mërçitur prej tij. I tha: Ne e kemi pasuar dhe nuk na pëlqen ta braktisim, derisa të shohim se si do të përfundojnë gjërat. Borxh na duhen një ose dy uasak ...” e deri në fund të hadithit ku thuhet: *“Pasi i ra në dorë tha: Afrohuni! Dhe pasi e vranë vajtën te profeti dhe e njoftuan”.*

Ibn Haxheri thotë: *“Në transmetimin e Vakidiut thuhet: “Na kërkoi sadaka edhe pse nuk kemi për të ngrënë ... Kab ibn Eshrefi i tha Ebu Nailes: Ma thuaj troç atë që blun në kokë. Çfarë mendon të veprosh? I tha: Duam ta braktisim dhe të largohemi prej tij. I tha: Më gëzove”.¹*

Padyshim se debati i zhvilluar mes sahabiut dhe armikut të Allahut Kab ibn Eshrefit përmban kufër të qartë, i cili nuk lejohej të shfaqet në raste të zakonshme. Mirëpo këtu u lejua sepse qëllimi ishte heqja qafe e tagutit që kishte fyer Allahun dhe të dërguarin e tij.

Shenjat e kufrit duken qartë në këtë hadith në shumë aspekte:-

- Fjala e Muhamedit *“Na kërkoi sadaka edhe pse nuk kemi për të ngrënë”*, është akuzim i profetit me padrejtësi, sepse u kërkon njerëzve të paguajnë kur ata nuk kanë çfarë të hanë dhe kjo padyshim është kufër.
- Fjala *“na ka futur në hall”*, pra na ka munduar me këto kërkesa ndërkohë që ne nuk kemi mundësi, siç kuptohet prej kontekstit të fjalës. Kjo është kufër sepse

¹ El feth, 7/392.

përmban ankesa dhe pakënaqësi ndaj profetit dhe dispozitave që Allahu i ka zbritur.

- Nënkuptimi i fjalës “**na ka futur në hall**” e shtyu Kab ibn Eshrefin të thoshte: **Pasha Allahun keni për t’u mërziur prej tij**”. Pra do vijë dita kur do të mërziuni dhe do të lodheni prej profetit dhe thirrjes së tij, për shkak të padrejtësive dhe kërkesave të shumta në sadaka, megjithëse ju nuk keni asgjë.
- Fjala “**Ne e kemi pasuar dhe nuk na pëlqen ta braktisim derisa të shohim se si do të përfundojnë gjërat.**” Pra e pasojmë në varësi se si shkojnë gjërat; nëse triumfon e pasojmë për interes, e nëse triumfon tjetërkush kemi për ta braktisur dhe thjesht po presim se si do përfundojë puna e tij dhe padysim që kjo është kufër.
- Fjala e Ebu Nailes ؓ që ishte në të njëjtin mision me Muhamed ibn Meslemen ؓ “**Duam ta braktisim dhe të largohemi prej tij**”, është kufër i pastër pa pasur nevojë për interpretime dhe nëse dikush i thotë këto fjalë në raste të zakonshme shpallet qafir.
- Fjalët e armikut të Allahut, Kab ibn Eshrefit “**keni për t’u mërziur prej tij**” dhe “**më gëzove**” përmbajë cënim dhe fyerje ndaj profetit. E megjithatë sahabët nuk u kundërpërgjigjën dhe qëndruan me të derisa e përmbushën misionin. Ulja në kuvendet ku kuvendohet me kufër dhe tallje të fesë pa kundërshtuar dhe pa u imponuar dhe pa u ngritur nga kuvendi është kufër i madh, e megjithatë sahabët e vepruan atë që t’u jepej mundësia të hiqnin qafe një kufër më të madh të cilin e udhëhiqte taguti Kab ibn Eshrefi, Allahu e mallkoftë.
- Me kërkimin e lejes prej profetit për të folur rreth tij kishin për qëllim fjalën lënduese dhe nënçmuese të cilat në origjinë nuk lejohen të thuheshin vetëm nëse personi i thotë ato prej kufirit, sepse fjala e lejuar nuk ka nevojë për leje.

Ibn Haxheri e sqaron këtë në “*Fethul bari*” kur thotë: “**Fjala e tij “Atëhere më lejo që të shtirem në fjalë. I tha: Fol” i kërkoi leje për ta mashtruar, prandaj edhe autori (imam Buhariu) e ka vendosur këtë hadith në kapitullin “Gënjeshtra në luftë”.** Në transmetimin e Ibn Sadit të kësaj historie sqarohet se ata kërkuan leje që të ankoheshin prej tij dhe ta injoronin”

Në hadithi mursel prej Ikremes thuhet: “**Na lejo të flasim kundër teje që të sigurohet. U tha: Thoni çfarë të doni**”.

Në rivajetin e Musës dhe Ibn Is’hakut, të cilin Ibn Kethiri në “*El bidaje uen nihaje*”¹ e përmënd të plotë, thuhet: “**Muhamed ibn Mesleme u kthye dhe tre ditë hante e pinte aq sa**

¹ El bidajetu uen nihaje, 4/8.

të mbante shpirtin gjallë. Kur e njoftuan profetin e thirri dhe i tha: Pse nuk ha dhe pi? I tha: O i dërguar i Allahut! Ta dhashë fjalën për diçka por nuk e di a do ta përmbush dot apo jo. I tha: Përpigu. I tha: O i dërguar i Allahut! Patjetër duhet të flasim (keq). I tha: Thoni çfarë të doni se jua kam bërë hallall”.

Shejbani në “*Es sijer*” thotë: “*Na lejo të flasim se nuk ka rrugë tjetër*” pra na lejo ta mashtrojmë me ankesa dhe duke shfaqur ofendimin tënd”.¹

Ky hadith, me të gjitha transmetimet e tij dhe ashtu siç e kanë kuptuar dijetarët, është argument shumë i fortë në këtë çështje. Edhe nëse ndonjë fjalë në ndonjë transmetim mund të interpretohet, mirëpo nuk mund të refuzohen me interpretime të gjitha fjalët dhe transmetimet e përmendura mësipërm dhe Allahu është më i ditur.

Argument është edhe historia e vrasjes së tagutit Halid ibn Sufjan ibn Nebih Hudheliut, i cili mblodhi njerëz për të luftuar profetin në Medine. Ahmedit dhe të tjerë e transmetojnë këtë hadith të plotë. Prej Abdullah ibn Unejsit thotë: ***Më thirri profeti dhe më tha: Më njoftuan se Halid ibn Sufjani po mbledh njerëz për të më luftuar prandaj shko dhe vrite.*** Në një rivajet tjetër thuhet: ***“I dërguari i Allahut tha: Kush del për Halid ibn Sufjan Hudheliun sepse po më ironizon, po më shan dhe po më mundon? Thotë: I thashë: O i dërguar i Allahut! Ma përshkruaj atë që ta njoh. I tha: Kur ta shohësh ke për të ndjerë një rrëngethje. Thotë: Pastaj dola me shpatë në brez derisa e gjeta në Arane me një grup grash në shtëpinë e tyre. Kur hyri koha e ikindisë e pashë dhe e gjeta njësoj siç ma përshkroi profeti për rrëngethjen. U drejtova drejt tij dhe kisha frikë se mos më zbulon prandaj edhe namazin e fala duke bërë shenjë me kokë për rukunë dhe sexhden. Kur u afrova te ai më tha: Kush je ti? I thashë: Dikush që ka dëgjuar për ty dhe për njerëzit që ke mbledhur kundër këtij personi (profetit) dhe erdhi për të njëjtin qëllim. I tha: Po! Unë kam dalë për këtë qëllim. Thotë: Pastaj ecëm pak sëbashku derisa gjeta rastin dhe e godita me shpatë derisa e vrara pastaj dola dhe i lashë gratë e tij rreth tij. Kur arrita te profeti më pa dhe më tha: Fytyra flet për sukses. I thashë: E vrava o dërguar i Allahut. Më tha: Të vërtetën po thua. Pastaj u nisëm sëbashku dhe shkuam në shtëpinë e tij dhe më dha një shkop e më tha: Mbaje në shtëpinë tënde o Abdullah ibn Unejs si argument mes nesh në ditën e gjykimit. Njerëzit më të paktë atë ditë do të jenë mutehasirunët. Thotë: Abdullahi e lidhi në shpatë dhe e mbajti me vete deri kur i erdhi vdekja i urdhëroi që ta vendosnin në qefin dhe pataj i varrosën sëbashku”.***²

Vështroje shprehjen ***“Dikush që ka dëgjuar për ty dhe për njerëzit që ke mbledhur kundër këtij personi (profetit) dhe erdhi për të njëjtin qëllim”*** pra erdha për të të ndihmuar

¹ Es sijer, 1/189.

² E përmend ibn Hajthemiu në “*Mexhmaul zeuid*” 6/203, thotë: E transmeton Ahmedit dhe Ebu Jala afërsisht por në të ka një transmetues që nuk përmendet i cili është i biri i Abdullah ibn Unejsit, ndërsa transmetuesit e tjerë janë të besueshëm. Shiko “*Es silsiletus sahiha*”, 2981.

dhe t'i bashkohem ushtrisë sënde në luftën kundër profetit. Padyshim se këto fjalë kufri nëse thuhet në situata të zakonshme konsiderohen kufër i madh.

Imagjino nëse ky tagut do të lihej të realizonte qëllimin e tij, sa do t'i kushtonte kjo luftë thirrjes islame, e cila ishte akoma e brishtë.

Argument tjetër është edhe urdhri që profeti i dha Naim ibn Mesudit për përçarjen e armikut në favor të muslimanëve në luftën e Ahzabit. Prej fjalëve që Naim ibn Mesudi i tha Ebu Sufjan ibn Harbit në mesin e Kurejshve: Ju e dini dashurinë që kam për ju dhe urrejtjen që kam për Muhamedin. Jam njoftuar për diçka dhe mendoj se e kam detyrë t'ju njoftoj si këshillë, por mbajeni sekret ...”¹

Nëse thuhet që kjo fjalë: **“Ju e dini dashurinë që kam për ju dhe urrejtjen që kam për Muhamedin”** nuk nënkupton kufër u themi: Thjesht ulja dhe qëndrimi në kuvendet e kufrit, talljes dhe cënimit të fesë ku diskutohet për luftimin e Allahut dhe të dërguarit, pa kundërshtuar dhe pa u larguar, është kufër sepse Allahu thotë: **«Ju ka shpallur në libër që nëse dëgjoni të bëhet kufër dhe të tallen me ajetet e Allahut atëhere mos u ulni me ta derisa të ndryshojnë bisedë, sepse ju atëhere jeni njësoj si ata»** En nisa, 140. Pra nëse uleni me ta pa i kundërshtuar, atëhere jeni njësoj si ata në kufër. E si atëhere kur ky sahabi uljes në kuvendet e kufrit ku diskutohet për luftën kundër Allahut dhe të dërguarit i ka shtuar edhe fjalën e mësipërme e cila është kufër i qartë.

Kjo u lejua për shkak të qëllimit që Naim ibn Mesudi kishte për përçarjen e aleancës, që luftonte të dërguarin dhe thirrjen islame, në favor të muslimanëve. Ky mision kaq i rëndësishëm dhe me vlerë i justifikoi fjalët e thëna mësipërm.

Shejbani thotë: *“Nëse muslimani hyn në vendin e armikut pa marrë siguri dhe e kapin mushrikët dhe u thotë: Unë jam prej jush, ose kam ardhur të luftoj muslimanët, atëhere i lejohet të vrasë prej tyre këdo që dëshiron dhe t'i marrë pasuritë e tyre”*.² Pastaj u argumentua me dy historitë e mësipërme për vrasjen e tagutëve; Halid ibn Sufjanit dhe Kab ibn Eshrefit.

Fjala **“Unë jam prej jush ose kam ardhur që të luftoj muslimanët”** është kufër por lejohet, sipas Shejbanit, me qëllim vrasjen e atij që dëshiron. Nëse kjo është e lejuar atëhere lejimi për vrasjen e një taguti me kufër dhe tirani më të madhe i cili persekuton muslimanët është më parësor.

Së dyti: Rregullat e shariatit dëshmojnë për rregull bazë: “Dëmi më i rëndë lejohet të evitohet duke vepruar dëmin më të lehtë”. Kjo bazë i përfshin të gjitha çështjet dhe dispozitat fetare, duke përfshirë edhe çështjen për të cilën po flasim.

¹ Shiko “El bidaje uen nihaje”, 4/113.

² Es sijer, 1/185.

Kur njeriu vihet përballë dy kufrave dhe patjetër duhet të zgjedhë njërin prej tyre, atëhere mund ta largojë njërin kufër me tjetrin. Argumentet fetare dhe logjike, të shtyjnë të shikosh se cili është kufër më i rëndë dhe ta evitosh atë me atë që është kufër më i vogël, njësoj si në çështjen tonë. Taguti është një bela e madhe për umetin. Ai vepron lloj-lloj kufri, krime, vrasje dhe padyshim ai përfaqson një kufër më të rëndë dhe më të ndërlikuar. Nëse nuk gjehet rrugë tjetër për ta hequr qafe, përveçse me atentat duke u shtirur me disa fjalë të kufrit të thjeshtë, siç transmetohet në historinë e vrasjes së tagutëve; Kab ibn Eshrefit dhe Halid ibn Sufjanit, atëhere të lejohet inshallah dhe nuk ke gjynah nëse nuk themi se ajo mund të bëhet edhe obligim.

Por nëse dikush acarohet dhe thotë: Kjo nënkupton që ti po lejon disa lloje kufri.

I them: Mosveprimi i tij nënkupton heshtjen dhe mbrojtjen e një kufri dhe rreziku më të madh për njerëzit dhe vendin. Prandaj zgjidh atë që është më e mirë për fenë dhe botën tjetër.

Disa prej tyre thonë: Kufri lejohet vetëm në raste të domosdoshme që nuk kanë rrugdalje tjetër, sepse haramet lejohen vetëm në raste të domosdoshme, ndërsa largimi i tagutit është nevojë por jo domosdoshmëri.

U themi: Si mund të konsiderohet thjeshtë nevojë largimi i tagutit i cili shfuqizon sheriatin e Allahut, lufton teuhidin dhe muslimanët, i cili nuk ka lënë lloj kufri, tallje dhe shturje pa e vepruar?! Ai i cili e ka hedhur vendin dhe robërit në shkatërrim duke i persekutuar me tortura dhe varfëri. A mos vallë kjo është nevojë njësoj si nevoja e njeriut për lavatriçe dhe frigorifer?! Nëse largimi i tagutit është vetëm nevojë dhe jo domosdoshmëri atëhere çfarë konsiderohet domosdoshmëri sipas fukahave?!

Nëse largimi i tagutit i cili adhurohen përveç Allahut dhe pretendon cilësi të tij, nuk arrin gradën e domosdoshmërisë, atëhere asgjë nuk konsiderohet domosdoshmëri sipas jush.

Feja që në kohën e Nuhut e deri te profeti ynë ﷺ bazohet në dy baza të mëdha. E para është mohimi dhe luftimi i tagutit. Ndërsa baza e dytë është nënshtimi i plotë ndaj Allahut. Këto dy baza janë kuptimi i fjalës “*La ilahe il-lallah*” për të cilën Allahu i ka krijuar krijesat. Kjo fjalë është qëllim më i madh se çdo qëllim tjetër. Nëse çdo qëllim ose synim tjetër s'është asgjë para këtij qëllimi, çfarë mund të themi atëhere për mjetet dhe metodat?! A mos vallë e konsideroni gjysmën e teuhidit, o dijetarë të dyshimeve, nevojë dhe jo domosdoshmëri?!

Së treti: Ibn Mesudi e lejon që personi të flasë (fjalë kufri) për të evituar një ose dy gadije kamzhiku. Si atëhere nuk lejohet të folurit me kufër për të parandaluar masakrat, vrasjet, tiraninë dhe kufrin e rëndë me të gjitha format e tij?!

Nëse evitimi i dy kamzhikëve konsiderohet domosdoshmëri që e lejon ndalesën, atëhere mënjanimi i vrasjeve dhe masakrave që taguti i kryen ndaj fëmijëve dhe grave muslimane është domosdoshmëri që e lejon ndalesën.

Së katërti: Këtë metodë e kanë zbatuar muxhahidat e mëdhenj, duke filluar nga sahabët: Muhamed ibn Mesleme, Naim ibn Mesudi, Ebu Naile, Abdullah ibn Unejsi e deri te Salahudin Ejubi i cili ishte vezir i shtetit qafir fatimi (ubejdi), derisa iu dha mundësia për të shkukur nga rrënja kufirin e ubejdijinëve dhe rikthimin e Egjiptit në një shtet islam sunit muxhahid, e deri te heroi Halid Islamboli me shokë të cilët e rehatuan umetin prej tradhtarit Sadat.

Mendimi tjetër të çon në akuzimin e këtyre heronjve me kufër dhe asnjë njeri i logjikshëm dhe fetar nuk guxon t'i akuzojë ata.

Vërejtje për rregullat që lidhen me këtë pengesë:-

Prej kësaj që u përmend më sipër dalim në përfundim me pikat e mëposhtëme:-

1. Shfaqja e kufirit lejohet vetëm për çrrënjosjen e një kufri më të madh dhe më të rëndë si në rastin e tagutëve kriminelë, por nuk lejohet shfaqja e kufirit me fjalë dhe vepra për largimin e një kufri të njëjtë ose më të vogël.
2. Kjo metodë përdoret atëhere kur nuk kemi asnjë mjet ose mundësi tjetër për largimin e këtij taguti me kufër të rëndë por nëse kemi në dorë mjete dhe mënyra të tjera për ta larguar nuk lejohet që të përdorim këtë metodë.
3. Në rast praktikimi të këtij lehtësimi duhet pasur kujdes dhe nuk duhet folur dhe vepruar me kufër vetëm në rast nevojë pa tejkalluar dhe ekzagjeruar.
4. Nëse i jepet mundësia për të përdorur mjete dhe metoda të tjera në përmbushjen e misionit, atëhere nuk ka nevojë që të shtiret me kufër sepse Allahu thotë: **﴿Ruajuni Allahut aq sa keni mundësi﴾** Et tegabun, 16.
5. Ajo që lejohet gjatë xhihadit nuk lejohet në çdo rrethanë tjetër dhe ajo që i lejohet muxhahidit nuk i lejohet civilit. Kjo çështje është shumë e qartë dhe argumentet prej Kuranit dhe sunetit janë të shumta dhe zgjerimi për shpjegimin e kësaj çështje kërkon një libër të tërë.

9- Veprat e mira.

Veprat e mira, sprovat dhe kontributet e mëdha që personi ka dhënë për islamin edhe pse nuk pengojnë prej shpalljes së një personi qafir, mirëpo ato ndikojnë në gjykim atëhere kur ka dyshime dhe vepra është e komentueshme (mund të komentohet si kufër ose jo).

Veprat e mira e zgjerojnë diapazonin e pranimi të keqinterpretimit dhe tolerimin e gabimeve ashtu siç ndodhi me Hatib ibn Beltan. Pjesmarrja në Bedër dhe të tjera vepra të mira, e favorizuan dhe i dolën në krah, atëhere kur Umeri tha: Më jep leje o i dërguar i Allahut t'ia pres kokën këtij munafiku, sepse ai ka bërë nifak. Megjithëse ai i informoi

mushrikët dhe zbuloi sekretin e të dërguarit për marshimin drejt Mekës, mirëpo ai e veproi këtë me interpretim tjetër siç u sqarua më parë.

Edhe havarixhi i cili i tha profetit: *Friksoju Allahut dhe mbaj drejtësi! I dërguari i Allahut i tha: Mjerë për ty! A nuk meritoj t'i frikësohem Allahut më shumë se kushdo në tokë? Nëse nuk mbaj drejtësi unë atëhere kush do të mbajë drejtësi?! Halid ibn Velidi i tha: O i dërguar i Allahut! A t'ia pres kokën? I tha: Jo! Mbase është prej atyre që falen ...*¹ Namazi i doli në krah këtij personi dhe e ruajti prej vrasjes megjithëse fjala që ai tha e shtyu Halidin të kërkonte leje prej profetit që ta vriste.

Allahu thotë për namazin: **﴿Fale namazin në dy skajet e ditës dhe gjatë natës. Veprat e mira i fshijnë të këqijat. Ky është përkujtim për ata që përkujtojnë﴾** Hud 114.

Mirëpo nëse kufri është i qartë, i cili nuk pranon justifikim dhe interpretim, veprat e mira sado të mëdha dhe të shumta të jenë, ato nuk e ndihmojnë personin dhe nuk pegojnë prej shpalles qafir siç ndodhi me Kudame ibn Medhunin dhe shokët e tij, të cilët e lejuan verën dhe e pinë bazuar në interpretime të gabuara. Sahabët u pajtuan unanimisht, se nëse nuk pendohen prej lejimit të verës dhe keqinterpretimit të tyre të gabuar ata do të konsideroheshin qafirë që kishin ndërruar fenë dhe do të vriteshin për shkak të kufrit dhe riddes, duke ditur që Kudame ka qënë prej pjesmarrësve të betejës së Bedrit dhe Uhudit dhe e ka shoqëruar profetin në luftë disa herë. Shiko se si pjesmarrja në betejën e Bedrit i doli në ndihmë Hatibit mirëpo nuk do e ndihmonte Kudamen nëse do të këmbngulte për lejimin e verës. Kjo çështje do të saqarohet më shumë në vijim, me lejen e Allahut.

Kushtet për shpalljen qafir të një personi konkret.

Pasi sqaruar pengesat e tekfirit të një personi konkret, do sqarojmë, kushtet që duhen përmbushur për shpalljen qafir të një personi konkret.

1- Mosekzistimi asnjë pengesë prej pengesave të tekfirit të përmendura më sipër.

Kufri ose ajo që e shfaq prej veprave të kufrit duhet të jetë i pajustificueshëm, pra të mos jetë i paditur, i ri në islam, keqinterpretues, i imponuar etj.

2- Sigurimi dhe vërtetimi.

Prej kushteve të shpalljes qafir të një personi të caktuar është sigurimi për realitetin e kufrit të atij personi. Nuk lejohet shpallja qafir me hamëndje, supozime, dyshime dhe pa u vërtetuar me prova të qarta. Allahu i Lartë thotë: **﴿O besimtarë! Nëse ndonjë njeri i prishur ju sjell ndonjë lajm atëhere sigurohuni që të mos akuzoni askënd padije dhe pastaj të pendoheni për atë që vepruat﴾** El huxhurat, 6. Dhe thotë: **﴿Hamëndja nuk vlen asgjë**

¹ E transmeton Muslimi dhe të tjerë.

përpara të vërtetës» En nexhm, 28.

Nëse dëgjojmë se një person që nuk e njohim mirë, flet dhe vepron gjëra kufri ose beson në gjëra që janë kufër, nuk na lejohet ta konsiderojmë menjëherë qafir duke u bazuar në këto fjalë të përhapura, sepse ai që i përhap këto lajme mund të jetë gënjeshtar, ose e ka inat ose mund ta ketë kuptuar gabim atë që ka dashur të thotë, apo ka vepruar ai person. Fillimisht duhet të sigurohemi dhe pastaj të mos e shpallim qafir, derisa të posedojmë argument të mjaftueshëm për kufirin e tij, i cili na lejon që ta shpallim qafir.

Allahu thotë: **«O besimtarë! Nëse dilni në rrugë të Allahut sigurohuni dhe mos i thoni atij që ju jep salam: Ti nuk je besimtar, për të lakmuar të mirat e dynjasë sepse te Allahu ka më shumë shpërblime. Kushtu keni qënë edhe ju më parë por Allahu ju udhëzoi prandaj sigurohuni sepse Allahu e di çdo gjë që veproni»** En nisa, 94.

Prej Ibn Abasit thotë: Një person prej Beni Sulejmit kaloi pranë disa sahabëve me gjithë tufën e deleve që e kulloste dhe u dha salam. Ata thanë: Ky po na jep salam për të ruajtur veten. Pastaj iu vërsulën dhe e vranë dhe ia sollën delet profetit. Atëhere Allahu zbriti këtë ajet: **«O besimtarë! Nëse dini në rrugë të Allahut sigurohuni ...»**.¹

Ibn Abasi thotë: I dërguari i Allahut i tha Mikdadit pasi vrau një person që dëshmoi shehadetin “La ilahe il-lallah”: **“Ai ishte besimtar që e fshihte imanin para qafirëve dhe kur e shfaqti imanin ti e vrave. Edhe ti njësoj si ai e ke pas fshehur imanin tënd në Mekë”**²

Pra ti duhej ta pranoje imanin e shfaqur dhe të mos e vrisje, sepse dyshimin me të cilin e vrave, ti vetë e ke përjetuar më parë. A të pëlqen të vritesh për shkak të saj, ashtu siç u solle më këtë person dhe e vrave bazuar në hamëndje?

3- Sqarimi i argumentit.

Për shpalljen e dikujt qafir duhet patjetër, pas sigurimit, t’i ngrihet huxhja e shariatit (ti sillen faktet e pakontestueshme) për atë që ka kundërshtur nëse është prej atyre që justifikohen me padije ose ajo që ka shfaqur prej kufirit ka qënë pasojë e mosarritjes së argumentit të shariatit. Nëse e mohon dhe i kthen shpinën argumentit të qartë ai shpallet qafir sepse Allahu ﷻ thotë: **«Nuk kemi për të dënuar derisa të dërgojmë të dërguar»** El isra, 15. Dhe thotë: **«Të dërguar përgëzues dhe qortues, që njerëzit të mos kenë asnjë argument kundër Allahut pas dërgimit të profetëve dhe Allahu është i fuqishëm dhe i urtë»**. En nisa, 165.

Ngritja e huxhes bëhet me çdo mënyrë që sqaron faktet e pakontestueshme të shariatit: ka thënë Allahu, ka thënë i dërguari, dhe ja largon padijen dhe ja bën të pamundur justifikimin për atë që ka kundërshtur.

¹ E transmeton Buhariui dhe të tjerë, shiko tefsirin e Ibn Kethirit.

² E transmeton Buhariu.

Këto janë kushtet e shpalljes së një personi qafir dhe nëse plotësohen për një person të caktuar dhe nuk ka asnjë pengesë prej pengesave të përmendura më sipër, atëhere ai shpallet qafir detyrimisht.

Një kusht i pavlerë:-

Disa njerëz shtojnë në kushtet e tekfirit të një personi të caktuar edhe kushtin e kërkimit të pendimit prej kufirit që e ka shfaqur përpara se të shpallet qafir. Ky kusht është i kotë. Asnjë dijetar i njohur nuk e ka kushtëzuar atë. Ai është në kundërshtim edhe me argumentet e shariatit.

Allahu ﷻ thotë: **﴿Kur të mbarojnë muajt e shenjtë vritini mushrikët kudo që t'i gjeni dhe kapini, rrethojini dhe zijuni pritë në çdo shteg. E nëse pendohen dhe e falin namazin dhe e japin zekatin atëhere lejini të lirë sepse Allahu është falës dhe mëshirues﴾** Et teube, 5. Allahu ﷻ gjykoi mbi ta me shirk dhe i quajti mushrikë para se të pendoheshin ose t'u kërkohet pendimi.

Kërkimi i teubes duhet të ketë një arsye. Nëse nuk gjykohet mbi një person të caktuar me kufër, ridde apo fisk atëhere për çfarë po i kërkohet teube?!

Kërkimi i teubes konsiderohet mundësia e fundit që i jepet kundërshtuesit, përpara se të zbatohet mbi të dënimi, me qëllim që të kthehet te e vërteta dhe logjika. Disa dijetarë e kanë kufizuar kërkimin e teubes së murtedit me tre ditë.

Nuk duhet të ngatërrojmë ngritjen e huxhes me kërkimin e teubes sepse ngritja e huxhes, nënkupton sqarimin e argumentit të shariatit i cili e largon justifikimin ose pamundësinë për atë çështje ku ka kundërshtur. Ndërsa kërkimi i teubes nënkupton dhënien e mundësisë për herë të fundit që të kthehet dhe të pendohet pasi i është ngritur huxhja dhe para se të zbatohet mbi të dënimi i shariatit dhe jo para se të gjykohet me kufër dhe ridde.



Rregulli i dytë: Përmbushja e premtimit dhe vonimi i kërcënimit.¹

Mëshira dhe urtësia e Allahut ﷻ kërkojnë përmbushjen e premtimit dhe shpërblimin e veprave të mira. Ndërsa veprat e këqija, megjithëse meritojnë denim, ato janë në mëshirë të Allahut, nëse dëshiron dënon, e nëse dëshiron fal.² Allahu thotë: **﴿Allahu nuk e fal t'i bëhet shirk dhe ia fal atë që është më e vogël se ai, atij që dëshiron﴾** En Nisa: 48.

Dhe thotë: **﴿Allahu i ka blerë shpirtërat dhe pasuritë e besimatarëve sepse ata meritojnë xhenetin. Ata luftojnë në rrugën e Allahut duke vrrarë dhe duke u vrrarë. Ky është premtim prej Allahut, i vërtetë në Teurat, Inxhil dhe Kuran. E kush më shumë se Allahu e përmbush premtimin. Prandaj përgëzohuni për tregëtinë që keni bërë dhe kjo është fitorja e madhe﴾** Et teube, 111.

Dhe thotë: **﴿Prej atyre i pranojmë veprat më të mira që i punonin dhe ua falim banorëve të xhenetit të këqijat e tyre, ky është premtimi i vërtetë me të cilin premtoheshin﴾** El ahkaf, 16.

Dhe thotë: **﴿Falenderimi i takon Allahut i cili e përmbushi premtimin e tij dhe na trashëgoi tokën dhe lëvizim në xhenet ku të dëshirojmë. Ky është shpërblimi më i mirë për punëmirët﴾** Ez zumer, 74.

Dhe thotë: **﴿Thuaj: A kjo është më e mirë apo xheneti i përhershëm me të cilin janë premtuar të devotëshmit? Ai është për ta shpërblim dhe përfundim﴾** El furkan, 15. E shumë e shumë ajete që dëshmojnë për këtë kuptim.

Prej Ubade ibn Samit ؓ, se i dërguari i Allahut ﷻ kur rreth tij ishin një grup sahabesh, tha: *“Ma jepni besën se nuk do t'i bëni shirk Allahut asgjë. Nuk do të vidhni. Nuk do të bëni zina. Nuk do t'i vrisni fëmijët tuaj. Nuk do të sillni ndonjë trillim mes këmbëve dhe duarve tuaja. Nuk do të kundërshtoni në vepra të mira. Kush e përmbush këtë, shpërblimin e ka te Allahu. Kush vepron ndonjë prej këtyre gjynaheve dhe ndëshkohet në dynja, ajo është kefare (shlyerje) për të. Kush kryen diçka prej tyre dhe Allahu e mbulon, atëherë çështja e tij është te Allahu, nëse dëshiron e fal e nëse dëshiron e ndëshkon”.*³ I dërguari i Allahut ﷻ e tha prerazi se Allahu e përmbush premtimin ndaj robërve në varësi të punëve të

¹ Ky rregull lidhet me gjyqet që janë më të vogla se kufri dhe shirku, sepse dënimi për atë që vdes në shirk është i pashmangshëm ashtu siç thotë Allahu: **﴿Allahu nuk e fal t'i bëhet atij shok﴾** En nisa, 48.

² Për pranimin e veprave të mira duhet të plotësohen dy kushte:

1- Vetë puna duhet të jetë në përputhje me rrugën profetike.

2- Ajo duhet të kryehet vetëm për Allahun ﷻ. Allahu thotë: **﴿Ai që e synon takimin me zotin e tij le të veprojë vepra të mira dhe të mos i bëj Allahut shok në adhurim asgjë﴾** El kehf 110 dhe thotë: **﴿që t'ju sprovtojë se kush është më punëmirë﴾** El mulk, 2. Selefii kanë thënë: Ajo është puna më saktë dhe më e sinqetë.

³ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

mira. Ndërsa dënimin e lidhi me dëshirën e Allahut ﷻ, nëse dëshiron i dënon e nëse dëshiron i fal.

Prej Enesit ؓ thotë: I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Allahu nuk i bën padrejtësi besimtarit në asnjë punë të mirë. Me të furnizohet në dunja dhe me të shpërblehet në ahiret. Ndërsa qafiri ha me të mirat që i ka vepruar për Allahun në dunja¹ derisa kur të shkojë në ahiret nuk ka asnjë të mirë me të cilën shpërblehet”**.²

Dhe thotë: **“Kujt i premtan Allahu shpërblim për ndonjë vepër, ka për t’ia përmbushur dhe kujt i premtan se do e ndëshkojë për ndonjë punë, ai është në dëshirë të Allahut”**³ Kjo është një dëshmi shumë e qartë për saktësinë e këtij rregulli.

Gjithashtu fjala e profetit ﷺ: **“Nëse dikush prej jush vepron gjynah që meriton të dënohet (në dynja) dhe ndëshkohet ai është kefaret (shlyerje), e nëse nuk ndëshkohet çështja e tij është në dorë të Allahut, nëse dëshiron e dënon e nëse dëshiron e mëshiron”**.⁴

Ibn Umeri ؓ thotë: **“Kujtonim se ata që veprojnë gjynahe patjetër do të dënohen, derisa i zbriti profetit ky ajet: ﴿Allahu nuk e fal t’i bëhet shirk dhe ia fal atë që është më e vogël se ai atij që dëshiron﴾ dhe profeti na ndaloi që të dëshmojmë me zjarr për pasuesit e fesë”**.⁵ Fjala “për pasuesit e fesë”, pra për pasuesit e islamit dhe kjo nënkupton që ne dëshmojmë me zjarr për jo muslimanët.

Këtu bën përjashtim dënimin që lidhet me të drejtat e robërve dhe padrejtësitë mes tyre. I padrejti patjetër duhet të marrë dënimin e merituar dhe patjetër duhet t’i kthehet e drejta atij që i është bërë padrejtësi, atë ditë kur nuk bën dobi as fëmija dhe as pasuria. Kjo i shkon për shtat drejtësisë së Allahut dhe për këtë dëshmojnë argumentet e sheriatit.

I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Padrejtësia është tre lloje; padrejtësi të cilën Allahu nuk e fal, padrejtësi që e fal dhe padrejtësi të cilën nuk e lë pa e ndëshkuar. Padrejtësia të cilën Allahu nuk e fal është shirku. Allahu thotë: ﴿Shirku është padrejtësi e madhe﴾. Ndërsa padrejtësinë të cilën Allahu e fal është padrejtësia mes robërve dhe zotit të tyre. Ndërsa padrejtësinë të cilin Allahu nuk e lë pa ndëshkuar është padrejtësia mes robërve derisa të gjykohet mes tyre”**.⁶

¹ Ky hadith është argument se qafiri mund të veprojë vepër të ligjëruar në sheriat dhe të jetë i sinqertë në të, ndërsa kufri i tij mund të jetë në gjëra të tjera. Por ky kufër e pengon atë që të ketë dobi prej çdo pune të mirë që e ka vepruar në dynja, sepse Allahu thotë: **(Iu afruam asaj që kishin punuar dhe e bëmë pluhur e hi)** El furkan, 23, sepse ata kanë vdekur në shirk, i cili i rrëzon të gjitha punët.

² E transmeton Muslimi.

³ E transmeton Ebu Jala dhe Ibn Ebi Asim në librin “Es sunneh”. Es silsiletus sahiha, 2463.

⁴ E transmeton Ibn Ebi Asim në “Es sunneh” 961. Shejh Albani e ka konsideruar sahih në shqyrtimin që i ka bërë këtij libri.

⁵ E transmeton Ibn Ebi Asim në “Es sunneh” 973. Shejh Albani e ka konsideruar sahih në shqyrtimin që i ka bërë këtij libri.

⁶ Sahihul xhami’, 3961.

Prej Ebu Hurejres ؓ se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Kanë për t’u kthyer të drejtat te poseduesit e tyre në ditën e gjykimit, aq sa edhe delja brikëputur do ta marrë të drejtën e saj prej deles me bri”**¹

Po prej Ebu Hurejres ؓ se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Kush i ka bërë vëllait të tij ndonjë padrejtësi në nderin e tij ose në diçka tjetër, le t’i kërkojë hallall sot, para se të vijë një ditë ku nuk ka dinarë dhe as dirhem. Nëse ka vepruar vepra të mira merret prej tyre aq sa e shlyen padrejtësinë. E nëse nuk ka vepra të mira, merren të këqijat e vëllait të tij dhe i hidhen atij”**.²

Dhe thotë: **“A e dini se kush është i falimentuari? I thanë: I falimentuari është ai që nuk ka as dirhem dhe as pasuri. U tha: I falimentuari në umetin tim është ai që në ditën e gjykimit vjen me namaz, agjërim dhe zekat, mirëpo ka sharë këtë, ka shpifur ndaj një tjetri, ka ngrënë pasurinë e dikujt, ka derdhur gjakun e dikujt tjetër ose ka goditur dikë. Atyre u jepet prej të mirave të tij, e nëse mbarojnë para se të shlyen padrejtësitë, atëhere merren prej gjynaheve të tyre dhe i hidhen atij, pastaj flaket në zjarr”**.

Vërjetje:-

Argumentet e Kuranit dhe të sunetit që dëshmojnë për dënimin e dikujt duhet të kuptohen në mënyrë të përgjithshme dhe të papërcaktuara për një person konkret. Themi se një gjynah meriton këtë dënim, por nuk themi që filan person dënohet me këtë dënim, sepse mund të ketë pengesa që pengojnë prej dënimit. Këto pengesa³ janë të shumta, prej tyre:

1) Veprat e mira.

Veprat e mira i fshijnë të këqijat dhe e zhvlerësojnë dënimin, siç thotë Allahu: **﴿Fale namazin në dy skajet e ditës dhe gjatë natës. Veprat e mira i fshijnë të këqijat. Ky është përkujtim për ata që përkujtojnë﴾** Hud 114.

Prej Abdullah ibn Mesudit ؓ, thotë: **Një burrë erdhi te i dërguari i Allahut dhe i tha: Unë putha dhe përkëdhela një grua në periferi të Medines. Veprova me të çdo gjë, por pa kryer marrëdhënie. Ja ku jam para teje prandaj gjyko për mua çfarë të dëshirosh. Umeri i tha: Allahu të mbuloi dhe më mirë do ishte ta mbuloje veten.**

Thotë: I dërguari i Allahu nuk iu përgjigj. Pastaj ky personi u ngrit dhe iku dhe i dërguari i Allahut dërgoi dikë që ta thërriste dhe pastaj i lexoi këtë ajet: ﴿Fale namazin në

¹ E transmeton Muslimi.

² E transmeton Buhariu.

³ Ka dallim mes pengesave të tekfirit dhe pengesave të dënimit për gjynahe, për një person të caktuar. E para ka lidhje me kufirin dhe atë që bie në kufër, ndërsa e dyta ka lidhje me ata që bien në gjynahe që janë më të vogla se kufiri, prandaj thuhet: Çdo pengesë e tekfirit konsiderohet pengesë për dënimin e një personi të caktuar për ndonjë gjynah, por jo çdo pengesë prej pengesave të dënimit për gjynahe konsiderohet pengesë prej tekfirit. Ky rregull, me lejen e Allahut, do të shpjegohet në mënyrë të veçantë në vijim.

dy skajet e ditës dhe gjatë natës. Veprat e mira i fshijnë të këqijat. Ky është përkujtim për ata që përkujtojnë). Një person prej të pranishmëve e pyeti: O profet i Allahut! Kjo është e veçantë për këtë person? I tha: Jo! Ajo është për të gjithë njerëzit”.¹

Prej Enesit thotë: “Një person erdhi te i dërguari i Allahut dhe i tha: O i dërguar i Allahut! Kam bërë një gjynah që meriton ndëshkim prandaj më ndëshko. Pastaj hyri namazi dhe i dërguari i Allahut u fal. Pasi e kreu namazin i tha: O i dërguar i Allahut! Kam bërë një gjynah që meriton ndëshkim prandaj më ndëshko sipas librit të Allahut. I tha: A e fale namazin me ne? I tha: Po. I tha: Allahu ta ka falë”.

Në një transmetim tjetër thuhet: “Kur dole prej shtëpisë, a morre abdes në mënyrë të përkryer? I tha: Po, o i dërguar i Allahut! I tha: Pastaj e fale namazin me ne? I tha: Po, o i dërguar i Allahut! Atëhere i dërguari i Allahut i tha: Allahu ta ka falur ndëshkimin ose tha: Dënimin”.²

Dhe hadithi: “Pesë namazet i fshijnë gjynahet ashtu siç e pastron uji pisllekun”.³

Dhe thotë: “Kur njeriu falet gjynahet i vendosen mbi shpinë dhe mbi kokë. Sa herë që bie në ruku ose sexhde, gjynahet i rrëzohen”.⁴

Prej Abdullah ibn Mesudit ؓ thotë: I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Digjeni e digjeni⁵ e kur ta falni sabahun ai i fshin ato. Pastaj digjeni e digjeni e kur ta falni ylenë ajo i fshin ato. Pastaj digjeni e digjeni kur ta falni ikindinë ajo i fshin ato. Pastaj digjeni e digjeni kur ta falni akshamin ai i fshin ato. Pastaj digjeni e digjeni e kur ta falni jacinë ajo i fshin ato. Pastaj flini dhe veprat nuk ju shkruhen derisa të zgjoheni”.⁶

Dhe thotë: “Allahu ka caktuar një melek i cili thërret për çdo namaz: O bijë të Ademit! Çohuni dhe shuajini zjarret që i keni ndezur”.⁷

Dhe thotë: “A është i pafuqishëm ndonjëri prej jush të fitojë një mijë të mira? Ta madhërojë Allahun me njëqind tesbihe dhe Allahu ja shkruan një mijë të mira dhe ja fshin një mijë të këqija”.⁸

Agjërimi i fshin të këqijat, siç thuhet në hadith: “Kush e agjëron ramazanin me iman dhe shpresë (për shpërblim) atij do i falen gjynahet që i kanë kaluar”.

Haxhi i fshin gjynahet e kaluara, siç thuhet në hadith: “Kush e kryen haxhin pa

¹ E transmeton Muslimi.

² E transemeton Muslimi.

³ E transmeton Ahmed. Sahih el xhami es sagir, 1668.

⁴ E transmeton Taberani dhe të tjerë, Sahih el xhami, 1671.

⁵ Për shkak të gjynaheve.

⁶ Sahihu et tergib uet terhib, 354.

⁷ Sahihu et tergib uet terhib, 355.

⁸ E transmeton Ahmed, Muslimi dhe Nesaiu. Sahihul xhami, 2665.

gabime dhe gjynahe, ai kthehet me gjynahe si ditën kur e ka lindur nëna.¹

Dhe thotë: ***“Umra deri në umre është kefaret për gjynahet në mes tyre dhe shpërblimi i haxhit të pranuar është vetëm xheneti”***.²

Xhiahadi në rrugë të Allahut ﷻ i fshin gjynahet si asgjë tjetër. I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: ***“Kapuni pas xhihadit në rrugë të Allahut tebarek ue teala, se ai është portë prej portave të xhenetit. Allahu e largon me të ankthin dhe shqetësimin”***.³ Padyshim se gjynahet gjynahet janë shkaku kryesor i ankthit dhe shqetësimit.

Dhe thotë: ***“Ai që i ka plurosur këmbët në rrugë të Allahut, ai i është bërë zjarrit haram”***.⁴ Çfarë mund të themi atëhere për atë që pluroset i tëri në rrugë të Allahut!?

Dhe thotë: ***“Shembulli i muxhahidit në rrugë të Allahut, dhe Allahu i njeh më mirë ata që luftojnë në rrugën e tij, është njësoj si agjëruesi që falet me përkushtim dhe i shton rukutë dhe sexhdet”***.⁵

Dhe thotë: ***“Një vajtje dhe kthim në rrugë të Allahut është më e mirë se dynjaja dhe çfarë ka në të”***.⁶

Dhe thotë: ***“A nuk dëshironi t’ju falë Allahu dhe t’ju fusë në xhenet? Luftoni në rrugë të Allahut”***.⁷

Prej Ebu Hurejres ؓ thotë: Një person erdhi te i dërguari i Allahut ﷺ dhe i tha: Më trego një punë që është e barabartë me xhihadin! I tha: ***“Nuk di asnjë punë. Nëse muxhahidi nisat (për xhihad) a ke mundësi të hysh në xhami dhe të falesh pandërprerë dhe të agjërosh pa e prishur? I tha: E kush ka mundësi ta bëjë këtë!?”***.⁸

Në sahihun e Muslimit transmetohet se një rob i Hatibit vajti te profeti për t’u ankuar për Hatibin dhe i tha: O i dërguar i Allahut! Hatibi do të hyjë në zjarr. I dërguari i Allahut i tha: ***“Gënjen! Nuk do të hyjë, sepse ai ka marrë pjesë në Bedër dhe Hudejbije”***.⁹

E shumë hadithe të tjera që dëshmojnë për vlerën e xhihadit në rrugë të Allahut. Ai i fshin gjynahet dhe gabimet sado të mëdha të jenë, përveç shirkut, sepse atë nuk e fshin asgjë tjetër përveç pendimit të sinqertë.

Ibn Tejmije: ***“Ilaçi më i mirë për atë që ka bërë gjynahe të shumta është xhiahadi sepse***

¹ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

² E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

³ E transmeton Hakimi dhe të tjerë. Es silsiletus sahiha, 1941.

⁴ Sahih sunen En nesai, 2919.

⁵ Sahih sunen En nesai, 2930.

⁶ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

⁷ E transmeton Tirmidhiu, Es silsiletus sahiha, 902.

⁸ E transmeton Buhariu.

⁹ E transmeton Muslimi.

Allahu ia fal gjynahet, siç na ka treguar Allahu në librin e tij: «ua fal juve gjynahet tuaja». Edhe ai që dëshiron t'ia falë Allahu gabimet e tij në thirrjen dhe fanatizmin për xhahilijet, atëhere le të shkojë në xhihad».¹

Të gjitha këto argumente dëshmojnë se veprat e mira i fshijnë gabimet dhe janë pengesë për dënimin e një personi të caktuar.

Dijetarët kanë rënë në kundërshtim për gjynahet që fshihen me punë të mira. Disa thonë se fshihen vetëm gjynahet e vogla ndërsa gjynahet e mëdha fshihen vetëm me pendim të sinqertë.

Mendimi më i saktë, për të cilin dëshmojnë edhe argumentet nga suneti, është se kjo gjë varet nga lloji dhe vlera e veprave të mira dhe grada e sinqeritetit dhe njësimin të Allahut, sepse një dirhem i vetëm mund të jetë më i vlefshëm se mijra dirhemë.

Prandaj themi: Kush i ka punët e mira sa malet, Allahu ua fal gjynahet edhe nëse janë të mëdha. Kush i ka veprat e pakta ato fshijnë prej gjynaheve aq sa pesha e tyre. Ai që lufton në rrugë të Allahut me vete dhe pasuri nuk është si ai që bën xhihad vetëm me pasuri. Ai që fal pesë namaze në xhami nuk është si ai që falet në shtëpi. Ai që përqëndrohet në të gjithë namazin nuk është i barabartë me atë që përqëndrohet në çerekun apo në 10% të tij. Pra grada e veprave të mira është e ndryshme dhe shtohet e pakësohet ashtu si gjynahet. Prandaj nuk mund të barazojmë vepra të mira të mëdha me disa vepra të mira të vogla në fshirjen dhe faljen e gjynaheve.

Në hadith përmendet se një sahabi pinte verë vazhdimisht, e cila është koka e pislliqeve, dhe dënohej shpesh. Një ditë e sollën dhe u kamzhikua. Një prej të pranishëmve tha: Allahu e mallkoftë! Sa shumë herë që është ndëshkuar! Atëhere i dërguari i Allahut i tha: **“Mos e mallko! Unë e di se ai e do Allahun dhe të dërguarin e tij”**. Shiko se si mirësia e dashurisë për Allahun dhe të dërguarin, pengoi prej meritimit të mallkimit të pirësit të verës duke ditur që pirja e verës është gjynah i madh.

Po kështu ndodhi me Hatib ibn Beltan kur mirësia e betejës së Bedrit ndërmjetësoi për të: **“Mbase Allahu i vështroi pjesmarrësit e Bedrit dhe u tha: Veproni çfarë të doni sepse ua kam falur”**.

Lavirja izraelite e cila i dha ujë një qeni, siç transmetohet në hadith: **“Një qen po vërtitej rreth një pusi dhe etja gati po e vriste, kur një lavire prej lavireve izraelite e vërejti dhe zbathi këpucën dhe i dha të pijë dhe Allahu e fali”**.²

Vështro se si dhënia ujë një qeni që po e mbyste etja, i fshiu gjynahet e kurvërisë duke ditur që kurvëria konsiderohet gjynah i madh dhe Allahu është më i ditur.

¹ Mexhmu'ul fetaua, 28/421-422.

² E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

2- Sprovat dhe musibetet.

Allahu i fal mëkatet dhe gjynahet për shkak të musibeteve, sprovave, belave dhe sëmundjeve që e godasin njeriun, nëse bën durim dhe shpreson shpërblimin e Allahut. Allahu i lartë thotë: **﴿Do t’ju sprovovmë me frikë dhe uri dhe pakësim të pasurive dhe humbje të njerëzve dhe pakësim të fryteve. Por përgëzoi durimtarët, të cilët kur i godet ndonjë musibet (fatkeqësi) thonë: Të Allahut jemi dhe te ai do të kthehem. Ata kanë bekime prej zotit të tyre dhe mëshirë dhe mu ata janë të udhëzuarit﴾** El bekare 155-157.

Dhe thotë: **﴿Kemi për t’ju sprovuar derisa t’i njohim muxhahidat dhe durimtarët prej jush dhe t’i provovmë veprat tuaja﴾** Muhamed 31.

Transmetohet në hadithin e sahih se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: *“Nëse rob i arrin te Allahu një gradë që nuk e ka arritur më parë, Allahu e sprovon në trupin e tij, ose në pasurinë e tij, ose në fëmijën e tij, e pastaj i jep durim derisa ta arrijë atë gradë”*.¹

Prej Xhabir ibn Abdullahit ؓ se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: *“Ata që kanë qënë të shëndoshë, në ditën e gjykimit do të dëshirojnë sikur lëkurat e tyre të priteshin me gërshëra, për shkak të shpërblimit që shohin t’u jepet të sprovuarve”*.²

Dhe thotë: *“Për çdo gjë që e godet dhe e mundon besimtarin në trupin e tij, Allahu i shlyen atij gjynahe”*.³

Dhe thotë: *“Allahu thotë: Nëse e sprovov një rob besimtar prej robërve të mi dhe më falenderon dhe duron në sprovën me të cilën e kam sprovuar ai ngrihet prej shtratit të tij me gjynahe si ditën kur e ka lindur nëna. Zoti u thotë melekëve që e ruajnë: Unë e pengova dhe e sprovova robin tim prandaj shkruajani shpërblimin që e shkruanit më përpara kur ishte i shëndoshë”*.⁴

Dhe thotë: *“Belaja (sprova) qëndron në veten, fëmijën ose pasurinë e besimtarit, derisa ta takojë Allahun pa asnjë gjynah”*.⁵

Dhe thotë: *“Shpërblimi i madh vjen prej sprovës së madhe. Allahu nëse e do një popull e sprovon atë. Kush kënaqet le të kënaqet e kush hidhërohet le të hidhërohet”*.⁶

Dhe thotë: *“Njerëzit e devotshëm sprovohen. Besimtarin nëse e ther qoftë edhe një gjëmb ose më shumë se kaq, atij i fshihet një gjynah dhe i ngrihet një gradë”*.⁷

¹ Sahih sunen Ebi Daud, 2649.

² Es silsiletus sahiha, 2206.

³ Es silsiletus sahiha, 2274.

⁴ Es silsiletus sahiha, 2009. Veprat e mira dhe sprovat sado të mëdha që të jenë nuk e fshin gjynahun e shirkut sepse atë e fshin vetëm pendimi dhe kërkimi i faljes dhe plotësimi i teuhidit.

⁵ Es silsiletus sahiha, 2280.

⁶ E transmeton Tirmidhiu dhe Ibn Maxheh, Es silsiletus sahiha, 146.

⁷ E transmeton Ahmed i dhe të tjerë. Es silsiletus sahiha, 1610.

Dhe thotë: **“Belatë (sprovat) janë më afër prej të dashurit tim se rrëkeja e ujit në grykderdhjen e saj”.**¹

Dhe thotë: **“Sëmundja e muslimanit është kefaret (shlyerje) për gjynahet e tij”.**²

Dhe thotë: **“Sa herë që Allahu e sprovon një rob me ndonjë sprovë që nuk i pëlqen, Allahu e bën këtë sprovë shlyerje dhe pastrim, vetëm nëse pretendon se kjo sprovë është prej tjetërkujt përveç Allahut, ose lut dikë tjetër përveç Allahut, për t’ia larguar këtë sprovë”.**³

Dhe thotë: **“Njerëzit me sprova më të mëdha janë pejgamberët, pastaj ata që janë më afër tyre. Njeriu sprovohet sipas fesë së tij. Nëse është i fortë në fe i shtohet sprova, e nëse është i dobët në fe sprovohet sipas fesë. Sprova vazhdon ta mendojë robin derisa ta lëshojë atë, e të eci në tokë pa asnjë gjynah”.**⁴

E shumë hadithe të tjera që dëshmojnë se sprovat i fshijnë gabimet dhe gjynahet dhe se ato janë pengesë për dënimin e një robi të caktuar.

Gjynahet që fshihen prej sprovave janë në varësi të sprovës dhe në varësi të durimit dhe shpresimit të shpërblimit. Kush e ka sprovën e madhe, durimin e madh dhe shpresën për shpërblim të madhe, atij i fshihen gjynahe të mëdha. Kush e ka sprovën dhe durimin të vogël, atij i fshihen prej gjynaheve aq sa e ka sprovën dhe durimin dhe Allahu është më i ditur.

3- Pendimi dhe kërkimi i faljes.

Prej pengesave të dënimit të një personi të caktuar është edhe pendimi dhe kërkimi i faljes. Pendimi i fshin gjynahet e mëparshme përfshi këtu edhe shirkun me kufrin.

Allahu thotë: **﴿Kush pendohet pas padrejtësisë së tij dhe vepron mirë Allahu ia pranon teuben sepse Allahu është falës dhe mëshirues﴾** El maide, 39.

Dhe thotë: **﴿Unë jam falës për atë që pendohet dhe beson dhe vepron punë të mira dhe pastaj udhëzohet﴾** Taha 82.

Dhe thotë: **﴿Përveç atij që pendohet dhe beson dhe vepron punë të mirë. Atyre Allahu ua shëndron gjynahet e tyre në mirësi dhe Allahu është falës dhe mëshirues﴾** El furkan 70.

Transemtohet në hadithin sahih, se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Ai që pendohet prej gjynahut është si ai që nuk e ka kryer gjynahun”.**⁵

¹ E transmeton Ibn Hibani, El xhami’us sahih, 1592.

² Es silsiletus sahiha, 2410.

³ Es silsiletus sahiha, 2500.

⁴ E transmeton Tirmidhiu, Ibn Maxheh dhe Darimiu. Es silsiletus sahiha, 143.

⁵ Sahih sunen Ibn Maxheh.

Dhe thotë: *“Sikur të gabonit aq sa gabimet tuaja të arrinin qiellin dhe pastaj të pendoheshit, prapë kishte për t’ju pranuar pendimin”*.¹

Dhe thotë: *“Pasha atë në dorë të të cilit është shpirti im! Sikur të mos bënit gjynahe, Allahu kishte për t’ju larguar dhe do të sillte një popull tjetër, që bënin gjynahe dhe pastaj kërkonin falje dhe do t’i falte”*.²

Prej Ebu Hurejres ؓ prej profetit ﷺ i cili tregon prej zotit të tij: *“Një rob bëri një gjynah dhe tha: O Allah! Falma gjynahun! Allahu tebareke ue teala tha: Robi im bëri një gjynah, por e diti që ka zot që e fal gjynahun dhe dënon për të. Pastaj u kthye dhe bëri gjynah prapë dhe tha: O Zot! Falma gjynahun! Atëhere Allahu tebareke ue teala tha: Robi im bëri një gjynah, por e diti që ka zot që e fal gjynahun dhe dënon për të. Pastaj u kthye dhe bëri gjynah prapë dhe tha: O Zot! Falma gjynahun! Atëhere Allahu tebareke ue teala tha: Robi im bëri një gjynah, por e diti që ka zot që e fal gjynahun dhe dënon për të. Vepro çfarë të duash se ta kam falur”*.³

Imam Neveviu, në shpjegimin e këtij hadithi, thotë: *“Vepra çfarë të duash se ta kam falur, kuptimin e ka nëse vazhdon të pendohesh për gjynahet që bën dhe unë të fal”*.

Dhe thotë: *“Kush thotë: Kërkoj falje prej Allahut përveç të cilit nuk ka ilah tjetër, ai është i gjalli dhe drejtuesi i çdo gjëje dhe atij i pendohem, atij do t’i falen gjynahet edhe nëse është arratisur prej luftës”*.⁴

Pendimi i pranohet robit deri sa t’i vijë shpirti në grykë dhe ta shikojë vdekjen ose të lindë dielli prej perëndimit, siç thuhet në hadith: *“Allahu e pranon teuben e robit deri sa nuk gargarit”*.⁵

Dhe thotë: *“Pendimi nuk ndërpritet derisa të lindë dielli nga perëndimi”*.⁶ Atëherë robit nuk i bën dobi besimi nëse nuk ka besuar më parë.

Pendimi i sinqertë i fshin të gjitha gjynahet e mërpashme bashkë me shirkun dhe kufrin, përndryshe nuk do kishte kuptim ligjërimi i kërkimit të pendimit prej murtedëve dhe mushrikëve.

4- Shefati (ndërmjetësimi).

Prej pengesave të dënimit të një personi të caktuar është edhe shefati i profetit ﷺ në ditën e gjykimit për vepruesit e gjynaheve të mëdha prej umetit të tij dhe shefati i

¹ E transmeton ibn Maxheh, es silsiletus sahiha, 903.

² E transmeton Muslimi.

³ E transmeton Muslimi.

⁴ Sahih sunen Ebi Daud, 1343.

⁵ E transmeton Ahmed, Tirmidhiu dhe ibn Maxheh, Sahihul xhami, 1903.

⁶ E transmeton Ahmed dhe të tjerë, Sahihul xhami, 7469.

besimatarëve të tjerë, për ata që kanë vdekur në teuhid dhe nuk i kanë bërë shirk Allahut askënd. Prej Enesit ؓ se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Shefati im do të jetë për ata që kanë vepruar gjynahe të mëdha prej umetit tim”**.¹

Dhe thotë: **“Më erdhi dikush prej zotit dhe më kërkoi të zgjidhja mes futjes së gjysmës së umetit në xhenet dhe mes shefatit dhe unë zgjodha shefatin. Ai i takon atij që vdes dhe nuk i bën shirk Allahut asgjë”**.²

Dhe thotë: **“Shefatit tim për gjynahqarët e mëdhenj prej umetit tim e kam vonuar për në ditën e gjykimit”**.³

Dhe thotë: **“Njeriu më i lumtur prej shefatit tim në ditën e gjykimit është ai që thotë: La ilahe il-lallah me sinqeritet prej zemrës”**.⁴

Në hadithin e shefatit që e transmeton Enesi ؓ thuhet: **“Më thuhet: O Muhamed! Ngrije kokën dhe fol se do të pranohet! Bëj shefat se do të pranohet! Kërko se do të jepet! I them: O Zot! Umeti im, umeti im! Më thuhet: Shko dhe nxirr këdo që ka iman sa një kokërr elbi. Pastaj shkoj dhe i nxjerr dhe kthehem dhe e falenderoj me falenderime, pastaj i bie në sexhde dhe më thuhet: O Muhamed! Ngrije kokën dhe fol se do të pranohet! Bëj shefat se do të pranohet! Kërko se do të jepet! I them: O Zot! Umeti im, umeti im! Më thuhet: Shko dhe nxirr këdo që ka iman sa një kokërr misri ose hardalli. Pastaj kthehem dhe e falenderoj me falenderime. Pastaj i bie në sexhde dhe më thuhet: O Muhamed! Ngrije kokën dhe fol se do të pranohet. Bëj shefat se do të pranohet! Kërko se do të jepet. I them: O Zot! Umeti im, umeti im! I thotë: Shko dhe nxirr këdo që ka iman më pak se fara e hardallit. Pastaj e nxjerr prej zjarrit dhe kthehem për herë të katërt dhe e falenderoj me falenderime. Pastaj i bie në sexhde dhe më thuhet: O Muhamed! Ngrije kokën dhe fol se do të pranohet! Bëj shefat se do të pranohet! Kërko se do të jepet! I them: O Zot! Më jep leje për atë që thotë: La ilahe il-lallah dhe i thotë: Pasha krenarinë dhe madhështinë time, pasha lartësinë dhe madhërinë tim, do të nxjerrë prej tij çdokënd që thotë “La ilahe il-lallah”**.⁵

Në një rivajet thuhet: **“Vazhdoja të bëja shefat te zoti im dhe ma pranon shefatit. Sa herë që i kërkoj shefat ma pranon shefatin, derisa të them: Më lejo të bëj shefat për atë që thotë “La ilahe il-lallah” dhe më thotë: Kjo nuk të takon as ty dhe askujt tjetër o Muhamed. Kjo më takon mua. Pasha krenarinë, madhërinë dhe mëshirën time! Nuk kam**

¹ E transmeton Tirmidhiu dhe Ebu Daudi. Shejh Albani e ka konsideruar sahih në “Mishkatul mesabih” 5598.

² E transmeton Tirmidhiu dhe Ibn Maxheh. Shejh Albani e ka konsideruar sahih në “Mishkatul mesabih” 5600.

³ E transmeton Ibn Ebi Asim në “Es sunneh”. Shejh Albani e ka konsideruar sahih në shqyrtimin që i ka bërë këtij libri.

⁴ E transmeton Buhariu.

⁵ E transmeton Buhariu.

për të lënë në zjarr askënd që thotë “La ilahe il-lallah”.¹

Prej Ebu Said Hudariut thotë: I dërguari i Allahut ka thënë: **“Kur besimtarët të shpetojnë prej zjarrit në ditën e gjykimit dhe të sigurohen, do të debatojnë me zotin e tyre për vëllezërit e tyre, që kanë hyrë në zjarr, ashtu si ndonjëri prej jush debaton me vëllain e tij në dynja për të drejtën e tij.**

Thotë: U thotë: Shkoni dhe nxirrni këdo që njihni. Shkojnë dhe i dallojnë prej pamjeve të tyre, sepse zjarri nuk ua djeg pamjet (fytyrat). Disa prej tyre zjarri i djeg deri në mes të kërcirit e disa deri në nyje të këmbëve. I nxjerrin dhe thonë: Zoti ynë! I nxorrëm ata që na urdhërove. U thotë: Nxirreni këdo që në zemër ka (iman) sa kokrra e misrit². Ebu Saidi thotë: Kush nuk e beson këtë le të lexojë këtë ajet: ﴿Allahu nuk bën padrejtësi as sa një thërmijë. Nëse është vepër e mirë e shton atë dhe dhuron prej tij shpërblim të madh﴾.

Thotë: Pastaj thonë: O zoti ynë! I nxorrëm ata që na urdhërove dhe nuk ka mbetur në zjarr askush që ka hajër në të.

Thotë: Pastaj Allahu u thotë: Bënë shefat melekët, bëjnë shefat profetët, bëjnë shefat besimtarët, por ka mbetur më i mëshirëshmi i mëshiruesve.³

Thotë: Pastaj kap prej zjarrit një grusht ose thotë: dy grushta me njerëz që nuk kanë punuar mirë⁴ janë djeguar aq sa janë bërë hi. Thotë: Pastaj sillen pranë një uji që quhet “uji i jetës” dhe spërkaten me të dhe mbijnë ashtu siç mbin fara prej ujit të shiut dhe dalin prej guackave të tyre njësoj si perlat. Në shpinën e tyre kanë vula ku shkruhet: Të liruarit e Allahut.

Thotë: Pastaj u thuhet: Hyni në xhenet dhe çfarëdo që dëshironi dhe çfardo që shikoni është e juaja dhe unë kam fshehur për ju diçka më të mirë I thonë: O zoti ynë!

¹ E transmeton Ibn Ebi Asim në “Es sunneh” dhe shejh Albani e ka konsideruar sahih.

² Kjo është argument se imani është me grada të ndryshme dhe se ai shtohet dhe pakësohet në varësi të punëve.

³ Shefati i ndërmjetësuesve, mëshirimi dhe afrimi që ndodh mes robërve në dynja dhe ahiret është prej mëshirës dhe mirësisë së Allahut ﷻ ndaj robërve të tij. Mëshira e tij ka përfshirë çdo gjë, siç thotë Allahu: ﴿Mëshira ime ka përfshirë çdo gjë dhe unë kam për ta obliguar atë për ata që ruhen dhe e japin zekatin dhe në ajetet tona besojnë﴾ El araf, 156. Allahu thotë: ﴿O zoti ynë! Ti e ke përfshirë çdo gjë me mëshirë dhe dije prandaj fali ata që pendohen dhe ndjekin rrugën tënde dhe mbroji ata prej dënimit të zjarrit﴾ Gafir 7.

I dërguari i Allahut ﷻ në hadithin sahih thotë: **“Allahu ka njëqind mëshira. Një mëshirë prej tyre e ka shpërndarë në mesin e krijesave dhe prej saj mëshirohen dhe afrohen me njëri-tjetrin dhe prej saj edhe egërsira i mëshiron këlyshët e saj. Ndërsa nëntëdhjetë e nëntë mëshira i ka ruajtur e me të cilat do mëshirojë robërit e tij ditën e gjykimit”. Pra me mirësinë e Allahut dhe mëshirën e tij mëshirojmë dhe i pastrojmë vetet tona, siç thotë Allahu: (Sikur të mos ishte mirësia e Allahut ndaj jush dhe mëshira e tij nuk kishte për t’u pastruar askush prej jush por Allahu e pastron kë dëshiron dhe Allahu është dëgjues dhe i ditur) En nur 21. Allahu ka në dorë çdo gjë dhe e tij është mirësia dhe begatia.**

⁴ Qëllimi se ata nuk kanë bërë mirë asgjë është mirësia që është pas teuhidit dhe kushtet e tij dhe ata nuk kanë vepruar ndonjë prishës të imanit të cilat e nxjerrin njeriun prej islamit. Hadithin duhet ta kuptojmë në dritën e këtij rreguli sepse për këtë dëshmojnë argumentet që kanë lidhje me çështjen të mbledhura së bashku dhe Allahu është më i ditur.

Çfarë është më e mirë se kjo? Thotë: U thotë: Kënaqësia ime për ju. Nuk kam për t'u zemëruar me ju asnjëherë".¹

Dhe thotë: **"Shehidi bën shefat për shtatëdhjetë veta prej familjes së tij".²**

Prej pengesave të dënimit është edhe fëmija i devotshëm i cili lutet për prindin e tij për falje dhe mëshirë. Gjithashtu edhe rritja e vajzave dhe bamirësia ndaj tyre siç thuhet në hadith: **"Kush i rrit tre vajza, përkujdeset, i mëshiron dhe sillet butë me to, ai është në xhenet".³** Në një transmetim tjetër thuhet: **"Ato do të jenë për të pengesë prej zjarrit".⁴**

Gjithashtu lutja e muslimanëve për vëllezërit e tyre që kanë vdekur dhe falja e namazit të xhenazes i fshin gjynahet, siç thuhet në hadithin e që e transmeton Muslimi: **"Çdo musliman që vdes dhe xhenazen ia falin dyzet burra që nuk i bëjnë shok Allahut asgjë, Allahu ka për t'ua pranuar shefatin (ndërmjetësimin)".**

Pengesë janë edhe fjalët e mira që njerëzit thonë pas vdekjes së muslimanit, siç thuhet në hadithin e Enesit: **"I dërguari i Allahut kaloi pranë një xhenazeje dhe njerëzit folën mirë dhe nxituan ta përmendin për mirë dhe thanë: Me aq sa dimë e ka pas dashur Allahun dhe të dërguarin e tij. Atëhere i dërguari i Allahut tha: E meriton, e meriton, e meriton. Pastaj kaloi një xhenaze dhe njerëzit folën keq dhe nxituan të thoshin fjalë të këqija për të. Thanë: Ka qënë njeri i lig në fenë e Allahut. Atëhere i dërguari i Allahut tha: E meriton, e meriton, e meriton. Umeri i tha: Të bëfsha fli nënë e babë! Kaluan me një xhenaze dhe folën mirë e the: E meriton, e meriton, e meriton. Pastaj kaluan me një xhenaze dhe folën keq dhe the: E meriton, e meriton, e meriton. Atëhere i dërguari i Allahut tha: Ai për të cilin folët mirë e meriton xhenetin, ndërsa ai për të cilin folët keq e meriton zjarrin. Melekët janë dëshmitarët e Allahut në qiell ndërsa ju jeni dëshmitarët e Allahut në tokë. Ju jeni dëshmitarët e Allahut në tokë. Ju jeni dëshmitarët e Allahut në tokë".⁵**

Dhe thotë: **"Kushdo musliman për të cilin dëshmojnë katër veta me mirësi ka për të hyrë në xhenet. I thamë: Po tre? Na tha: Edhe tre. I thamë: Po dy? Na tha: Edhe dy. Por nuk e pyetëm për një dëshmitar".⁶** Hadithi dëshmon se fjalët e mira që besimtarët njësuës i thonë për një person të caktuar janë përgëzim për të dhe argument për përfundimin e mirë me lejen e Allahut. Por mos u mashtro për komplimentat që të devijuarit u bëjnë tagutëve zullumqarë, sepse ata nuk përfshihen në hadithet e mësipërme dhe Allahu është më i ditur.

¹ E transmeton Ahmedi dhe të tjerë. Es silsiletus sahiha, 2250.

² Sahih Ebi Daud, 2201.

³ Es silsiletus sahiha, 2492.

⁴ E transmeton Buahriu dhe Muslimi.

⁵ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

⁶ E transmeton Buhariu.

5- Dënimi me hadd.

Dënimi me hadd (në dynja) konsiderohet shlyerje për gjynahun¹ dhe nuk dënohet për këtë gjynah në ditën e gjykimit siç thuhet qartë në hadithin sahih të cilin e transmeton Ubade: **“kush vepron ndonjë prej këtyre gjynaheve dhe ndëshkohet në dynja ajo është shlyerje për të”**. Në një transmetim tjetër thuhet: **“Nëse dikush prej jush vepron gjynah që meriton të dënohet (në dynja) dhe ndëshkohet, ai është shlyerje”**.

Vërejtje:-

Nga kjo që përmendëm mësipërm kuptojmë se çdo pengesë prej pengesave të tekfirit konsiderohet pengesë për dënimin e gjynahut. Por jo çdo pengesë për dënimin e gjynahut konsiderohet pengesë për tekfirin, me përjashtim të teubes e cila fshin çdo gjë përpara saj. Këtë rregull do e përmendim dhe do e shpjegojmë më qartë në vazhdim.



¹ Këtu bën përjashtim haddi i riddes (daljes prej islamit) sepse ai nuk e shlyen gjynahun e riddes. Ai që vritet si qafir dhe murted do të jetë i përhershëm në xhehenem sepse Allahu thotë: **﴿Kushdo prej jush që bën ridde prej fesë së tij dhe vdes qafir atyre kanë për t’iu rrëzuar të gjitha veprat në dynja dhe ahiret. Ata janë banorët e zjarrit dhe në të do të jenë përjetësisht﴾** El bekarë 217.

Rregulli i tretë: Kënaqja me kufër konsiderohet kufër.

Kush kënaqet me kufrin, ose e pëlqen atë, ose e konsideron të lejuar, ose e konsideron të lejuar sundimin e tij pa imponim dhe pa shtirje, ai ka bërë kufër në pamje të jashtme dhe të brendshme, edhe nëse me gojë pretendon se është musliman.

Shkaku i kufrit është kënaqësia me atë që Allahu nuk kënaqet dhe dashuria e asaj që Allahu e urren. Shkak është edhe konsiderimi i mirë i asaj që Allahu e konsideron të keqe dhe lejimi i asaj që Allahu e ka ndaluar dhe pikërisht ky është kufri i qartë.

Allahu ﷻ thotë: **﴿Ju ka shpallur në libër që nëse dëgjoni të bëhet kufër dhe të tallen me ajetet e Allahut atëhere mos u ulni me ta derisa të ndryshojnë bisedë, sepse atëhere jeni njësoj si ata﴾** En nisa, 140.

Shejh Sulejman ibn Abdullahi thotë: “Kuptimi i ajetit është ashtu siç kuptohet në aparencë. Nëse dikush dëgjon të bëhet kufër dhe të tallen me ajetet e Allahut dhe qëndron ulur me qafirët që tallen pa imponim, pa i kundërshtuar, pa u ngritur prej kuvendit, ose pa e ndryshuar bisedën, atëhere ai është qafir njësoj si ata, edhe nëse nuk merr pjesë në veprën e tyre, sepse kjo nënkupton aprovim të kufrit dhe aprovimi i kufrit është kufër.

Dijetarët janë argumentuar me këtë ajet dhe ajete të ngjashme, se ai që kënaqet me gjynahun është njësoj si ai që e vepron atë. Nëse pretendon se ai e urren gjynahun me zemër nuk i merret parasysh, sepse gjykimi lidhet me pamjen e jashtëme dhe ai që e shfaq kufrin në pamje të jashtme ai është qafir”.¹

Ibn Xheriri në tefsirin e tij thotë: “Ju është shpallur se nëse uleni me ata që bëjnë kufër me ajetet e Allahut dhe tallen me to dhe ju i dëgjoni të bëjnë kufër dhe të tallen me ajetet e Allahut dhe ashtu siç e kanë kundërshtuar Allahun ata me talljen me ajetet e tij ashtu edhe ju keni e keni kundërshtuar Allahun dhe ju jeni njësoj si ata në këtë kundërshtim”.²

Kurtubiu thotë: “**﴿atëhere ju jeni njësoj si ata﴾** kush nuk largohet prej tyre, ai është kënaqur me veprën e tyre dhe kënaqja me kufër është kufër. Kushdo që ulet në një kuvend ku ushtrohet gjynahu dhe nuk e kundërshton atë, atëhere ai është pjesmarrës në gjynah njësoj si ata. Nëse nuk ka mundësi t'i kundërshtojë atëhere le të ngrihet dhe të largohet, që të mos përfshihet në këtë ajet”.³

Nëse në kuvend veprohet kufër ai është qafir njësoj si ata. E nëse veprohen gjynahe ai është gjynahqar njësoj si ata por jo qafir. Gjykimi për personin sillet rreth veprave që kryen

¹ Mexhmuatul teuhid, fq. 48.

² Xhamiul bejan, 4/330.

³ Xhamiul ahkam, 5/418.

në këtë vend.

I dërguari i Allahut ﷺ në hadithin sahih ka thënë: **“Kush beson në Allahun dhe botën tjetër të mos ulet në tryezën ku pihet verë”**. Dihet se ai që ulet në tavolinë me ata që pinë verë nuk bën kufër por merr gjynahun e pirjes së verës.

Umer ibn Abdulazizit i sollën disa njerëz që kishin pirë dhe urdhëroi të goditeshin me kamzhik. I thanë: Me ta është edhe një i agjërueshëm. U tha: Me këtë person filloni. A nuk e keni dëgjuar fjalën e Allahut: **«Ju ka shpallur në libër që nëse dëgjoni që po bëhet kufër dhe po tallen me ajetet e Allahut atëhere mos u ulni me ta derisa të ndryshojnë bisedë sepse ju atëhere do jeni njësoj si ata»**.¹ Ai e konsideroi prezantuesin e haramit njësoj si vepruesin e tij, sepse ulja me ta pa kundërshim dhe pa imponim dëshmon se ai është i kënaqur me veprat e tyre, prandaj dënohet njësoj si ata.

Agument se ai që kënaqet me diçka është njësoj si veprusi është edhe fjala e Allahut: **«Ata që bënë kufër prej izraelitëve janë mallkuar në gojën e Daudit dhe Isait birit të Merjemes. U mallkuan për shkak të kundërshimeve dhe tejkalimeve të caqeve. Ata nuk e ndalonin njëri-tjetrin prej të keqes që e vepronin dhe me të vërtetë keq vepronin»**. El maide 79.

Në tefsirin e këtij ajeti përmendet se izraelitët kur ranë në gjynahe dijetarët e tyre i ndaluan, por ata vazhduan me gjynahe. Dijetarët e tyre vazhduan të uleshin dhe të hanin e të pinin sëbashku me ta, derisa Allahu ua përziu zemrat me njëri-tjetrin dhe i mallkoi në gojën e Daudit dhe Isait alejhim selam.

Ibn Abasi ؓ thotë: *“U përzien me ta megjithëse i ndaluan në tregëtinë që bënëin, derisa Allahu ua përzieu zemrat me njëri-tjetrin”*.

Nëse kjo thuhet për atë që përzihet me ta megjithëse i ndalon dhe i kundërshton për haramin që bëjnë, çfarë mund të themi për atë që përzihet me ta dhe nuk i ndalon dhe as i kundërshton për atë që e veprojnë?! Padyshim se kjo është më e rëndë dhe më afër mallkimit të Allahut.

Gjithashtu fjala e Allahut: **«E nëse i pyet ata do të thonë: Ne po bisedonim dhe po bënim shaka. Thuaju: A me Allahun, me ajetet e tij dhe me të dërguarin e tij po talleshit?! Mos u justifikoni! Ju keni bërë kufër pas imanit tuaj. Nëse e falim një grup prej jush e dënojmë një grup tjetër sepse ata ishin kriminelë»** Et teube 65-66.

Fjala **«Nëse e falim një grup prej jush»** thuhet se ajo ka zbritur për një person të quajtur Muhashin ibn Himjer ؓ, i cili po hecete anash atyre që talleshin pa u përzier me ta në

¹ Argumentimi i Umer ibn Abdulazizit me këtë ajet dëshmon se mund të argumentohemi me atë që është më e rëndë për atë që është më e vogël, sepse ajeti edhe nëse ka zbritur për kufrin e madh mirëpo lejohet argumentimi me të për atë që ulet me gjynahqarët në kohën kur ata kryejnë gjynahe pa i kundërshtuar ata dhe pa u ngritur sepse ai në një farë mënyre hyn në këtë ajet.

bisedë, mirëpo ai qeshi dhe nuk i ndaloi. Ky person thoshte: O Allah! Unë e dëgjoj një ajet ku kihem për qëllim dhe më rrënqethet mishi dhe më coptohet zemra. O Allah! Ma merr jetën në rrugën tënde që askush të mos thotë: Unë e kam larë, unë e kam qefinosur, unë e kam varrosur. Ikreme thotë: Në ditën e Jemames u godit dhe të gjithë trupat e muslimanëve u gjetën, përveç trupit të tij.¹

Vështroje rrezikun që e zuri këtë person vetëm për një të qeshur, e cila u konsiderua shenjë e fshehtë për pajtimin e tij me veprimin e munafikëve dhe sikur të mos e mëshironte Allahu dhe ta falte kishte për të qënë prej të shkatërruarve.

Është saktësuar se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: ***“Çdo profet që Allahu e ka dërguar para meje ka pasur havarijunë dhe sahabë që udhëzoheshin me sunetin e tij dhe pasonin urdhrin e tij. Por ata që vinin më pas ndryshonin dhe thoshin atë që nuk e vepronin dhe vepronin atë që nuk urdhëroheshin. Kush i lufton ata me dorë ai është besimtar. Kush i lufton ata me gjuhë ai është besimtar. Kush i lufton ata me zemër ai është besimtar. Pas kësaj nuk ka iman as sa fara e hardallit”***.²

Fjala e profetit ﷺ: ***“Pas kësaj nuk ka iman as sa fara e hardallit”*** sepse pas moskundërshtimit me zemër, vjen vetëm kënaqësia dhe pohimi dhe rrëzohet i gjithë imani.

Ibn Tejmije thotë: ***“Ndryshimi i haramit nganjëherë bëhet me zemër, nganjëherë me gojë dhe nganjëherë me dorë. Mirëpo mohimi me zemër duhet të jetë i përhershëm, sepse mohimi me zemër nuk e dëmton njeriun. Ai që nuk mohon haramin me zemër nuk është besimtar. Ibn Mesudi është pyetur: Kush është i vdekuri prej të gjallëve? U tha: Ai i cili nuk e pëlqen të mirën dhe nuk e mohon haramin”***.³

I dërguari i Allahut ka thënë: ***“Ai që e prezanton gjynahun që veprohet në tokë dhe e urren është njësoj si ai që nuk e ka parë atë dhe kush nuk e prezanton gjynahun por kënaqet me të është njësoj si ai që e ka prezantuar atë”***.⁴

Kjo çështje lidhet me nijetin në zemër siç thotë profeti: ***“Punët janë me nijete dhe çdokujt i takon ajo që ka bërë nijet”***.⁵

Dhe thotë: ***“Dynjaja është për katër persona; një rob të cilit Allahu i ka dhuruar pasuri dhe dije dhe ai i frikësohet zotit për këtë pasuri, e përdor atë për lidhjen farefisnore dhe e ruan të drejtën e Allahut në të. Ky është në gradat më të larta. Një rob tjetër Allahu i ka dhuruar dije por jo pasuri dhe ai me nijet të singertë thotë: Sikur të kisha pasuri, kisha për të vepruar njësoj si filani. Atij i takon ajo që ka bërë nijet dhe shpërblimin e kanë***

¹ Tefsiri i Ibn Kethirit.

² E transmeton Muslimi.

³ Mexhmu’ul fetaua, 28/127.

⁴ Sahih sunen Ebi Daud, 3651.

⁵ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

njësoj. Një robi tjetër Allahu i ka dhuruar pasuri por jo dije. Ai e prish pasurinë e tij padije dhe pa ju frikësuar Allahut. As nuk e lidh farefisën me të dhe as nuk e ruan të drejtën e Allahut në të. Ky është në gradat më të ulta. Një robi tjetër Allahu nuk i ka dhuruar as dije dhe as pasuri dhe thotë: Sikur të kisha pasuri kisha për të vepruar njësoj si filani. Atij i takon nijeti i tij dhe gjynahun e kanë njësoj”.¹

Dhe thotë: *“Besimtar është ai që e mira e tij e gëzon dhe e keqja e tij e hidhëron”*. Kuptimi i anasjelltë i hadithit nënkupton se ai që nuk gëzohet me të mirën e tij dhe nuk hidhërohet për të keqen e tij ai nuk është besimtar.

Ibn Tejmije thotë: *“Nëse nuk e urren asnjë prej haramëve ai nuk ka fare iman”*.²

Kur Halid ibn Velidi ﷺ arriti në Ard në marshimin e tij për te banorët e Jemames, të cilët kishin bërë ridde, nisi si pararojë 200 ushtarë dhe u tha: *“Këdo që të kapni ma sillni mua! Ata arritën të kapnin Mexha’an me 23 veta prej fisit të tij. Kur arriti te Halidi i tha: O Halid! Ti e di shumë mirë që unë kur kam vajtur te profeti atëhere kur ishte gjallë i kam dhënë besën për islam. Unë sot e kësaj dite e ruaj besën e dikurshme. Nëse një gënjeshtar (Musejleme) ka dalur prej nesh atëhere Allahu thotë: ﴿Asnjë gjynah nuk rëndon mbi tjetrin﴾.*

I tha: O Mexha’ah! E braktise sot atë që e përkrahe mot. Pëlqimi dhe heshtja jote përpara këtij gënjeshtari, ndërkohë që ti je prijësi i Jemames, aq më shumë që u informove për marshimin e ushtrisë sime, ishte pohim dhe pëlqim për atë që pretendonte?! Ah sikur të gjeje justifikim dhe ta kundërshtoje ashtu siç e kundërshtuan të tjerët! Ashtu siç foli dhe kundërshtoi Thumame dhe Elishkiri. E nëse thua: Pata frikë për fisin, atëhere përse nuk erdhe te unë ose të më dërgoje një të dërguar?!

I tha: O bir i Mugiras! Ma bëj hallall të gjithë këtë. I tha: Ta kam falur gjakun por në zemër akoma kam dyshim për moskundërshtimin tënd”

Shiko se si Halid ibn Velidi e konsideroi Mexha’an të kënaqur dhe pohues të thirrjes së Musejleme gënjeshtarit dhe se ai kishte devijuar prej islamit, thjesht për shkak të qëndrimit të tij nën pushtetin e Musejlemes, pa u imponuar dhe pa e kundërshtuar, duke ditur që Mexha’a nuk foli as edhe një fjalë që dëshmon se është i kënaqur me Musejleme gënjeshtarin.

Sejid Kutbi thotë: *“Thjesht pranimi i legjimitetit të një metode, shpikje ose gjykimi prej tjetërkujt përveç Allahut ai është tamam dalja prej islamit. Islami për hir të Allahut është njësimi i nënshtrimit vetëm për të dhe për askënd tjetër”*.³

Nëse kuptohet kjo, atëhere le t’i frikësohen Allahut ﷻ ata që ulen në parlamente

¹ Sahihut tergib uet terhib, 14.

² Marre prej “Mexhmuatul teuhid”, fq. 299.

³ Rruga e thirrjes nën hijen e kuranit, 2/32.

sëbashku me ata që tallen me fenë e Allahut, duke kujtuar se po veprojnë mirë dhe marrin pjesë sëbashku në votim kundër ligjit të Allahut duke nënvleftësuar fenë e Allahut ﷻ. T'i frikësohen Allahut ﷻ ata që e ngrejne krijesën sipër krijesit nën parrullën “Ligji është në dorë të njeriut” dhe se ligji i njeriut është mbi ligjin e Allahut.

Ti frikësohen Allahut ata që çirren duke thirrur për respektimin e të drejtave dhe lirive edhe nëse këto liri nënkuptojnë ridde prej fesë dhe tallje me vetë Allahun.

Të mos kujtojnë ata se me këto vepra që veprojnë kanë vlerë te Allahu edhe nëse hiqen si muslimanë. Të mos kujtojnë se kanë pjesë në fe dhe janë të mbrojtur prej dënimit. Allahu thotë: **﴿Ruajuni prej një fitneje (kufrit) e cila nuk godet vetëm ata që kanë bërë padrejtësi prej jush dhe dijeni që Allahu është i ndëshkues i rrept﴾** El enfal 25.

Kurtubiu thotë: “*Ibn Abasi ؓ ka thënë: Allahu i ka urdhëruar besimtarët të mos e pohojnë haramin në mesin e tyre, që të mos i përfshijë Allahu në dënim*”.¹

Shenjat që dëshmojnë për kënaqësinë dhe besimin.

Përpara se të flasim për shenjat që dëshmojnë për kënaqësinë dhe besimin, do të ndalemi pak për të shpjeguar lidhjen reciproke që ekziston mes gjymtyrëve dhe zemrës sepse të dyja ato dëshmojnë për njëra-tjetrën dhe ndikohen nga njëra-tjetra.

Argumentet e sheriatit dëshmojnë se pamja e jashtme është reflektim i brendësisë. Çdonjëra prej tyre ndikohet dhe ndikon te tjetra dhe dëshmon për të. Prishja ose rregullimi i brendisë së njeriut patjetër do të reflektohet në punët e dukshme me prishje ose rregullim. Në vartësi të prishjes së brendshme shfaqet edhe prishja në veprat e dukshme dhe në varësi të prishjes së veprave të dukshme është edhe prishja e zemrës.

Nuk mund të supozohet një pamje e jashtme e prishur me një zemër të ndrequr, ose një zemër e prishur me vepra të jashtme të rregullt. Argumentet për këtë lidhje reciproke janë të shumta. Prej tyre fjala e Allahut: **﴿A nuk e shikon se Allahu solli shembull për fjalën e mirë, pemën e shëndoshë, e cila rrënjët i ka të forta dhe degët në qiell, e jep frytin e saj përherë me lejen e zotit të saj. Allahu u sjell njerëzve shëmbuj që ata të përkujtojnë﴾** Ibrahim, 24.

Allahu e solli këtë shembull për fjalën e teuhidit dhe imanit që ata të përkujtojnë. Imani është njësoj si pema sepse ai ka rrënjë në zemër dhe fryte të jashtme në vepra, ashtu siç pema ka rrënjë të zhytura në brendësi të tokës dhe degë të përhapura në qiell.

Ashtu si imani i brendshëm ndikohet dhe ndikon pozitivisht apo negativisht, po ashtu edhe frytet e kësaj peme ndikohen dhe piqen më shumë me ushqimin që rrënjët e thithin prej tokës dhe e dërgon atë për degët, frytet dhe gjethet. Gjithashtu edhe rrënjët ndikohen me

¹ Xhamiul ahkam, 7/391.

vijshmërinë e degëve dhe gjetheve, sepse nëse dielli do të fshihej dhe oksigjeni do të mbarohej, atëhere kjo pemë do të vyshket dhe do të thahet. Kështu është edhe imani në zemrën e njeriut në lidhje me gjymtyrët që janë njësoj si degët, frytet dhe gjethet e pemës. Nëse pengohen prej ushqimit të adhurimit dhe bindjes ndaj shariatit, çojnë në dobësimin dhe vdekjen e imanit të jashtëm dhe të brendshëm.

Kështu komentohet edhe ajeti: **«Ti nuk ke për t'i bërë të vdekurit të dëgjojnë dhe as shurdhët të dëgjojnë duanë»** En neml, 80.

Dhe Allahu thotë: **«Thoni: Nëse e doni Allahun atëhere më ndiqni mua që t'ju dojë Allahu dhe t'ju falë gjynahet tuaja dhe Allahu është falës mëshirues»** Ali Imran 31.

Kush tregohet i sinqert në dashurinë ndaj Allahut patjetër kjo dashuri do të shfaqet në bindjen me vepra ndaj shariatit. Sipas gradës së dashurisë së zemrës shtohet dhe pakësohet bindja, nënshtrimi dhe pasimi me vepra i udhëzimit të shariatit.

Prej argumenteve që vërtetojnë lidhjen e ndërsjelltë mes zemrës dhe veprave të jashtme është edhe hadithi i saktë: **“Në trup gjendet një organ, nëse rregullohet, atëhere i gjithë trupi rregullohet dhe nëse prishet, atëhere i gjithë trupi prishet. Ai është zemra”**.¹

Hadithi përmban dy kuptime. Një kuptim të drejtpërdrejtë se rregullimi dhe prishja e veprave të jashtme është rrjedhojë e rregullimit dhe prishjes së zemrës.

Dhe një kuptim të anasjelltë se rregullimi i veprave të jashtme është argument për rregullimin e zemrës dhe prishja e veprave të jashtme është argument për prishjen e zemrës.

Ky është mendimi i ehli sunneh uel xhema'ah të cilët thonë: Imani është besim fjalë dhe vepër, shtohet me bindje dhe pakësohet me gjynahe.

Në këtë pikë kanë devijuar murxhitë, të cilët nuk e konsideruan punën prej realitetit të imanit dhe thanë: Imani është fjalë dhe pohim. Ndërsa murxhitë e ekzagjeruar thanë: Imani është pohim me zemër. Me këto koncepte të gabuara e hodhën poshtë lidhjen mes pamjes së jashtme dhe të brendshme. Ata e konsideruan besimtar me iman të saktë edhe atë që e vepron kufrin me vepra por pa e konsideruar të lejuar me zemër²

Ibn Tejmije thotë: *“Këtu kemi disa parime për të cilat njerëzit janë kundërshtuar. Parimi i parë është se a mund të ndodhë vërtetim dhe përgënjeshttrim në zemër dhe kjo të mos reflektohet as në fjalë dhe as në vepra madje mund të shfaq të kundërtën e asaj që fsheh në zemër.*

Besimi i selefit, imamëve dhe shumicës së njerëzve është se besimi me zemër patjetër

¹ E transmeton Buhriu.

² Forma e lejimit sipas murxhive është kur personi e shqipton me gojë se ai e lejon kufrin me zemër ndërsa çdo formë tjetër nuk lejohet të konsiderohet lejim i zemrës sidoqë ta shqiptojë kufrin me gojë dhe ta veprojë me vepra.

duhet të reflektohet në vepra. Kush thotë: Unë e pohoj vërtetësinë e profetit, e dua atë, e madhëroj me zemrën time por nuk flet fare me fjalën e islamit dhe as nuk vepron asgjë prej veprave të obliguara pa u friksuar fare, ky person as në brendinë e tij nuk konsiderohet besimtar, përkundrazi konsiderohet qafir.

Xhehmiu _dhe ata që bien dakort me të_ thotë se ai konsiderohet besimtar në brendësi (zemër) thjesht me njohjen e zemrës. Sipas tij pohimi i zemrës është iman për të cilin shpërblehet në ditën e gjykimit edhe nëse nuk flet dhe nuk vepron asgjë. Ky mendim konsiderohet i kotë sipas shariatit dhe logjikës. Dijetarë të selefit si Vekiu dhe Ahmedi që mbrojnë këtë mendim (mendimin e ehli sunetit) e kanë shpallur Xhehmin qafir. I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Në trup gjendet një organ; nëse rregullohet, atëhere i gjithë trupi rregullohet dhe nëse prishet, atëhere i gjithë trupi prishet. Ai është zemra”** Profeti ﷺ e shpjegoi se rregullimi i zemrës kushtëzon rregullimin e trupit. Nëse trupi nuk është në rregull kjo dëshmon se zemra nuk është në rregull, ndërkohë që zemra e besimtarit duhet të jetë në rregull. Prej kësaj kuptojmë se kush e flet fjalën e besimit por nuk punon me të, ai nuk konsiderohet besimtar as në zemër, sepse trupi është vartës i zemrës. Çdo gjë që fshihet në zemër patjetër duhet të shfaqet rrjedhoja e tij në vepra në një mënyre apo në një tjetër”.¹

Gjithashtu thotë: **“Imani dhe nifaku origjinën e kanë në zemër. Veprat dhe fjalët e dukshme janë produkt dhe argument i asaj që është në zemër. Nëse njeriu shfaq ndonjë vepër, ai mban përsipër edhe përgjegjësinë e saj. Kur Allahu i lartë i përmendi munafikët që u tallen dhe cënuan profetin, e vërtetoi që fjalët e tyre janë dëshmi e nifakut dhe produkt i tij. Dihet mirë se nëse vërtetohet dëshmia dhe produkti i diçkaje kjo tregon se ajo gjë është realizuar edhe në origjinë. Kjo dëshmon se kurdo që personi tallet (me fenë) ai është munafik, njësoj nëse ka qënë munafik më përpara se të tallej apo u bë munafik në momentin që e tha këtë fjalë”.**²

Prej argumenteve që dëshmojnë se veprat e jashtme janë pasqyrë e zemrës është edhe fjala e profetit ﷺ: **“Nëse robi bën një gjynah i pikëzohet në zemër një pikë e zezë. Nëse kthehet, kërkon falje dhe pendohet, zemra i pastrohet. E nëse kthehet i shtohen pikat e zeza derisa ta mbulojnë zemrën dhe të arrijë në gradën e “Er-ran” për të cilën Allahu ﷻ thotë: (përkundrazi ata kanë mbulesë (ran) në zemrat e tyre për shkak të asaj që vepronin)”**³

Shiko se si vepra e keqe lë gjurmë në zemër me pikë të zezë. Pikat e zeza në zemër shtohen me teprimin në gjynahe në varësi të llojit dhe sasisë së gjynaheve, derisa ta mbulojnë të gjithë zemrën dhe ta pengojnë njeriun prej udhëzimit dhe kuptimit të së vërtetës.

Prej kësaj e kuptojmë gënjeshtren e atij që pretendon se zemrën e ka borë të bardhë dhe plot iman, ndërsa veprat i ka të prishura dhe plot mëkate.

¹ Mexhmu’ul fetava.

² Es sarimul meslul ala shatimir resul, fq. 34.

³ Sahih sunen Et Tirmidhi, 2654.

Për këtë dëshmon edhe fjala e profetit: **“Sprovat i paraqiten zemrës njësoj siç thuret hasëri (rrogoza) thupër thupër. Çdo zemër që i mbart ato pikëzohet me një pikë të zezë dhe çdo zemër që i refuzon ato pikëzohet me një pikë të bardhë, derisa të përfundojë te njëra prej dy zemrave: Ose e bardhë e kulluar të cilën nuk e dëmton asnjë sprovë sa të ekzistojë qielli dhe toka, ose e zezë sterrë si kupa e shtrembëruar, as nuk e njeh të mirën dhe as nuk e refuzon të keqen, por ndjek vetëm epshin e saj”^{1, 2}**

Zemra që nuk e konsideron asnjë të mirë për të mirë dhe asnjë të keqe për të keqe ajo është zemër e vdekur dhe pa iman, zemër e mbuluar me sprova, dyshime dhe gjynahe. Ajo është njësoj si copa e zezë të cilës nëse i shtohet një tjetër pikë e zezë nuk i prish punë. Kjo në dallim nga zemra e besimtarit, e cila është plot me ndjenjë keqardhje për gjynahet dhe të keqen. Besimtari edhe për të keqen më të vogël hidhërohet dhe sikletoset, a thua se armiku e ka sulmuar me të gjithë ushtrinë e tij, prandaj shpejton të pendohet dhe të kërkojë falje.

Është saktësuar se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Besimatar është ai që e mira e tij e gëzon dhe e keqja e tij e hidhëron”**. Kuptimi i anasjelltë i hadithit dëshmon se atë që e mira e tij nuk e gëzon dhe e keqja e tij nuk e hidhëron ai nuk është besimtar.

Sahabët ishin njerëzit më të ndjeshëm ndaj gjynaheve, aq sa dikush prej tyre ndiente ndryshimin e zemrës edhe atëhere kur bënte gjëra të lejuara që ja turbullonin imanin. E gjithë kjo buronte prej bindjes dhe imanit të lartë. Transmetohet nga Handhala Usejdi _prej shkruesve të profetit_ thotë: **“Më takoi Ebu Bekri dhe më tha: Si je o Handhala? I thashë: Gratë, fëmijët dhe pasuritë na bënë të harrojmë. Ebu Bekri më tha: Na ka zënë i njëjti hall. Pastaj u nisa me gjithë Ebu Bekrin, derisa hymë te profeti dhe i thashë: Bëri nifak Handhalaja o i dërguar i Allahut! I dërguari i Allahut më tha: Si është puna? I thashë: Kur jemi pranë teje na përkujton zjarrin dhe xhenetin, a thua se e shohim me sytë tanë. Por kur largohemi prej teje, gratë, fëmijët dhe pasuritë na bëjnë të harrojmë.**

I dërguari i Allahut më tha: Pasha atë në dorën e të cilit është shpirti im! Nëse do të qëndronit në të njëjtën gjendje sikur jeni pranë meje dhe në përkujtim (të Allahut), kishin për t’ju përshëndetur melekët në shtrate dhe në rrugë. O Handhala! Kjo ka kohën e saj dhe kjo ka kohën e saj. E përsëriti tre herë.”³

Prej Ibn Ebi Melikes thotë: **“Kam takuar tridhjetë sahabë. Të gjithë ata friksoheshin për nifakun e tyre dhe askush nuk thoshte: Unë e kam imanin si Xhibrili dhe Mikaili”⁴**

¹ Pra atë që epshi i tij e shikon si të mirë ajo është e mirë edhe nëse në shariat është e keqe. Ndërsa ajo që epshi i tij e mendon për të keqe ajo është e keqe edhe nëse në shariat konsiderohet e mirë. I adhuruari i tij të cilit i bindet është epshi i tij dhe jo Allahu. Për të tillë njerëz thuhet fjala e Allahut: **(A e shikon atë që e ka marrë epshin e tij për zot! A mos vallë mund të jesh ndihmëtar!)** El furkan 43.

² E transmeton Muslimi.

³ E transmeton Muslimi.

⁴ E transmeton Buhariu.

Këto fjalë burojnë prej fortësisë dhe pastërtisë së imanit të tyre dhe ndjenjës së fajit prej shkarjeve të ndryshme. Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata.

Prej Enesit thotë: ***“Ju punoni disa punë, të cilat në sytë tuaj duken më të holla se floku, ndërsa në kohën e profetit i kemi pas konsideruar shkatërruese”***.¹

Sahabët e profetit parapëlqenin të binin prej qiellit apo të shkrumboheshin shkrumb e hi, sesa të flisnin ndonjë fjalë të keqe prej vesvesit të veteve të tyre. Kur e njoftuan profetin për këtë u tha: ***“Ky është imani i sinqertë”***.² Pra shqetësimi për vesvesin është shenjë e imanit të sinqertë. Kjo dëshmon se ai që flet me kufër të qartë pa u shqetësuar fare për atë që vepron me duart e tij, ai është qafir pa pikë imani në zemër.

Shenjat që dëshmojnë për brendinë.

Vëndi i kënaqësisë është zemra. Kënaqësia është një çështje e brendshme dhe e fshehtë të cilën askush nuk mund ta dijë. Por nëpërmjet shenjave rrethuese të bazuara në fjalët dhe veprat e njeriut argumentohemi për kënaqësinë. Veprimi i disa veprave të tilla dëshmon për realitetin e zemrës. Prej shenjave të kënaqësisë mund të përmendim:-

Shenjat dëshmuese me fjalë.

Fjalët janë shenjat më domethënëse për realitetin e zemrës. Si në rastin kur njeriu, pa imponim, shprehet me fjalë të qarta se është i kënaqur me kufirin dhe e lejon atë, si ai që i konsideron të mira ligjet e kufirit të cilat rivalizojnë ligjet e Allahut, ose i konsideron ato ligjet më të mira të cilat sjellin përparim dhe lulëzim, ose shprehje të tjera të cilat dëshmojnë për realitetin e ngulur në zemër dhe se ku i fle zemra. Dijetarët islam pajtohen në një mendje se kjo është kufër i cili të nxjerr prej islamit.

Disa shprehje mund të nënkuptojnë kufër shumë qartë dhe nuk kanë nevojë të sqarohen, apo të kërkohet se çfarë ka dashur të thotë personi në fjalë me këtë shprehje, sepse ato nënkuptojnë vetëm kufirin dhe nuk lenë vend për mosbërjen qafir shprehësit, si psh ai që e shan Allahun dhe të dërguarin e tij e të tjera fjalë si këto.

Ndërsa disa shprehje të tjera mund të jenë me dykuptime dhe të përngjashme. Ato e nënkuptojnë kufirin në një këndvështrim, por mund të nënkuptojnë diçka tjetër në një këndvështrim tjetër. Pra nuk mund të komentohen vetëm si kufër apo jokufër. Në raste të tilla, duhet shikuar qëllimi i personit dhe nuk lejohet të konsiderohet qafir, vetëm nëse bisedojmë me të dhe na qartësohet qëllimi i fjalëve të tij.

¹ E transmeton Buahriu.

² E transmeton Muslimi.

Shenja në vepra.

Veprat e gjymtyrëve dëshmojnë për realitetin e zemrës dhe atë që është rrënjësor në zemër. Në shumë raste ato janë të mjaftueshme për të gjykuar për brendinë e njeriut, pa pasur nevojë që ai të shprehet me fjalë të qarta për kënaqësinë dhe lejimin e kufrit me zemër. Pra pa pasur nevojë për shprehje me fjalë. Prej këtyre shenjave mund të përmendim:

1- Ulja në vendet ku kuvendohet me kufër dhe tallje me fenë.

Siç u përmend më parë, ulja në vendet ku bisedohet me tallje me Allahun, ajetet dhe të dërguarin e tij, pa imponim dhe pa kundërshtim, është shenjë dëshmuese për kënaqjen me kufirin dhe veprat e tyre të ulta, prandaj ai konsiderohet qafir njësoj si ata. Allahu i lartë thotë: **﴿Ju ka shpallur në libër që nëse dëgjoni të bëhet kufër dhe të tallen me ajetet e Allahut atëhere mos u ulni me ta derisa të ndryshojnë bisedë sepse atëhere jeni njësoj si ata. Allahu do t'i mbledhë të gjithë munafikët së bashku në xhehenem﴾** En nisa, 140.

Kurtubiu në tefsirin e tij thotë: “*Kush nuk largohet prej tyre, ai është kënaqur me veprën e tyre dhe kënaqja me kufër është kufër. Kushdo që ulet në një kuvend ku ushtrohet gjynahu dhe nuk e kundërshton atë, atëhere ai është pjesmarrës në gjynah njësoj si ata.*”¹

Sheukani në tefsirin e tij thotë: “**﴿atëhere jeni njësoj si ata﴾** Pra nëse veproni kështu dhe nuk hiqni dorë prej kësaj atëhere ju jeni njësoj si ata në kufër”.²

Të njëjtën fjalë e thonë edhe shumë komentues të tjerë të Kuranit.

Vështroje fjalën e Kurtubiut: “*Kush nuk largohet prej tyre, ai është kënaqur me veprën e tyre*”. Ai e konsideroi thjesht uljen, pa imponim dhe pa kundërshtim, shenjë të qartë që dëshmon për aprovimin e veprës së tyre.

Më parë përmendëm fjalën e Sulejman Ali Shejhut kur thotë: “*Ai është qafir njësoj si ata edhe nëse nuk merr pjesë në veprën e tyre sepse kjo nënkupton aprovim të kufrit dhe aprovimi i kufrit është kufër*”.

Gjithashtu fjala e Halid ibn Velidit drejtuar Mexha'as: *O Mexha'ah! Pëlqimi dhe heshtja jote përpara këtij gënjeshtari, ndërkohë që ti je prijësi i Jemames, aq më shumë që u informove për marshimin e ushtrisë sime, ishte pohim dhe pëlqim për atë që pretendonte?!”. Ndërkohë që Mexha'a nuk shqiptoi as edhe një fjalë të vetme që dëshmon aprovimin e tij për pretendimet e Musejleme gënjeshtarit. Mirëpo përderisa qëndroi nën pushtetin e tij pa imponim dhe pa e kundërshtuar, atëhere kjo u konsiderua si shenjë që dëshmon për aprovimin e këtij gënjeshtari.*

¹ Xhamiul ahkam, tefsiri i Kurtubiut, vëll. 5, fq. 418.

² Tefsiri i Sheukanit, vëll. 1, fq. 527.

2- Tallja dhe cënimi i fesë goftë edhe në formë shakaje.

Allahu ﷻ thotë: **«E nëse i pyet ata do të thonë: Ne po bisedonim dhe po bënim shaka. Thuaju: A me Allahun, me ajetet e tij dhe me të dërguarin e tij po talleshit?! Mos u justifikoni! Ju keni bërë kufër pas imanit tuaj. Nëse e falim një grup prej jush e dënojmë një grup tjetër sepse ata ishin kriminelë»** Et teube 65-66.

Ky ajet dëshmon se kushdo që tallet me Allahun, ajetet dhe të dërguarin e tij, ai është qafir në pamje të jashtme dhe të brendshme. Tallja është shenjë e qartë për prishjen e zemrës. Edhe nëse e pohon me gojë se ai e nuk konsideron të vërtetë dhe të lejuar këtë tallje, sepse u tall për shaka dhe argëtim dhe nuk e kishte seriozisht dhe me besim. Nëse në zemër do të kishte iman nuk kishte për t'u tallur me fenë e Allahut në asnjë lloj mënyre.

Ibn Tejmije thotë: *“Allahu na njofton se ata bënë kufër pas imanit të tyre megjithëse ata u përpoqën të justifikoheshin duke thënë: Nuk e thamë kufirin se e besonim, por ishim duke u argëtuar dhe po bënim shaka. Allahu e tregoi qartë se tallja me ajetet e Allahut është kufër dhe ky kufër kryhet vetëm prej atij që ia ka hapur gjoksin kufrit. Nëse në zemër do të kishte iman, atëhere ky imani do ta pengonte prej të folurit me fjalë të tilla”*.¹

Shejhulislami gjykoi se tallja me fjalë buron vetëm prej atij që ia ka hapur gjoksin kufrit, për shkak të kësaj tallje. Kjo është shenjë dëshmuese për mospasjen e asnjë pike imani në zemër, sepse nëse do të kishte iman, ky iman kishte për ta frenuar prej kësaj fjale.

Ibn Tejmije thotë: *“Ky është teks i qartë se tallja me Allahun, ajetet dhe të dërguarit e tij është kufër. Atëhere sharja me qëllim është kufër edhe më i madh. Ky ajet dëshmon se kushdo që ofendon profetin me shaka apo seriozisht, ai ka bërë kufër”*.²

Ebu Bekër ibn Arabiu thotë: *“Bërja shaka me fjalë kufri është kufër pa asnjë kundërshtim në mes umetit”*³ Ai është kufër e konsideron të lejuar apo jo, e beson apo nuk e beson. Vendosja kusht në raste të tilla, se ai duhet ta lejojë apo ta besojë që të konsiderohet qafir është medhheb i murxhive dhe xhehmive të cilët nuk e konsiderojnë punën prej imanit.

3- Shfaqja e kufrit pa imponim dhe pa shtirje të lejuar.

Allahu thotë: **«Kush bën kufër me Allahun pas imanit të tij përveç atij që imponohet dhe zemra e tij është e qetësuar me iman, por ai që ja hap gjoksin kufrit, mbi ta ka rënë zemërimi i Allahut dhe ata kanë dënim të madh»** En nahl 106.

Ky ajet dëshmon se kushdo që e shfaq kufirin e qartë pa shtirje dhe pa imponim të pranuar në shariat, ai ia ka hapur zemrën dhe gjoksin kufrit; e aprovon apo nuk aprovon atë

¹ Mexhmu'ul fetaua, vëll. 7, fq. 220.

² Es sarimul meslul, fq. 31.

³ El xhamiu li ahkamil kuran, vëll. 8, fq. 197.

kufër, sepse realiteti i veprave të tij e përgënjeshton pretendimet me fjalë.

Ibn Tejmije thotë: “Ai e ka konsideruar këdo që flet me kufër, prej atyre që e meritojnë të dënohen me dënimin e qafirëve, përveç atij që imponohet dhe zemrën e ka të mbushur me iman. Nëse thuhet: Allahu ka thënë: **﴿por ai që ja hap gjoksin kufrit﴾**. I themi: Kjo pjesë e ajetit përputhet me fillimin e ajetit, sepse çdokush që bën kufër pa imponim, ai ia ka hapur gjoksin kufrit. Në të kundërt fillimi i ajetit do të ishte në kontradiktë me këtë pjesë. Nëse do të kihej për qëllim se kufër bën vetëm ai që ia hap zemrën kufrit, atëherë zemra nuk mund të imponohet dhe nuk do kishte kuptim të përjashtojë vetëm i imponuari, por duhej të përjashtojë i imponuari dhe i paimponuari nëse nuk e beson kufirin. Nëse flet me fjalë kufri me dëshirë ai ja ka hapur gjoksin kufrit dhe kjo është kufër”.¹

Vështroje fjalën e tij: “Nëse flet me fjalë kufri me dëshirë ai ja ka hapur gjoksin kufrit dhe kjo është kufër”. Ibn Tejmije e konsideroi fjalën e kufrit me dëshirë dhe pa imponim shenjë që dëshmon për kufirin e besimit në zemër dhe se ja ka hapur zemrën kufrit.

Shejh Muhamed ibn Abdulvehabi në komentimin e këtij ajeti thotë: “Allahu nuk justifikoi asnjërin prej tyre, përveç të imponuarve që zemrën e kishin të mbushur me besim. Ndërsa të tjerët bënë kufër pas imanit të tyre edhe nëse këtë vepër kufri e vepruan prej frikës, për politikë, për hir të vatanit apo fisit, për shkak të pasurisë, në formë shakaje, apo për arsye të tjera përveç imponimit. Ajeti dëshmon për këtë në dy aspekte:

*Së pari: Me fjalën **﴿përveç atij që imponohet﴾** përjashtoi vetëm të imponuarin.*

*Së dyti: Me e fjalën **﴿kjo sepse ata preferuan jetën e dynjasë më shumë se ahireti﴾**, u shpreh qartë se ky kufër dhe dënim nuk kanë qenë për shkak të besimit me zemër, apo padijes dhe urrejtjes së fesë, ose prej dashurisë së kufrit, por shkak i kufrit ishte preferimi i pasurisë së dynjasë më shumë se feja”.²*

¹ Mexhmu’ul fetaua, vëll. 7, fq. 220.

² Mexhu’ut teuhid, fq. 88-89. Fjala e shejhut: “prej frikës apo për politikë” duhet kuptuar kur frika është e supozuar, ose kur zgjerohet në fjalë me politikë pa imponim dhe pa shtirje të pranuar në shariat. Frika prej dënimit ose dëmit serioz dhe të sigurtë, nëse njeriu nuk flet me politikë ose nuk shtiret me shprehje kufri ose nuk i përkrah zullumqarët, shpresoj të jetë e lejuar, nëse njeriu flet aq sa të largojë dëmin dhe dënimin dhe pa u zgjeruar pa nevojë, nëse ky dëm nuk mund të largohet në tjetër mënyrë. Kjo hyn te format e imponimit të cilat Allahu i fal, sepse Allahu thotë: **﴿Të mos i marrin besimtarët qafirët për miq përveç besimtarëve e kush vepron kështu ai nuk është te Allahu asgjë, vetëm nëse ruheni (shtireni) prej tyre me ruajtje﴾** Ali Imran, 28. Ibn Kethiri thotë: **﴿vetëm nëse ruheni (shtireni) prej tyre﴾** nëse dikush frikësohet në disa vende ose në një kohë të caktuar prej sherrit të tyre, atij i lejohet që të ruhet prej tyre në pamje të jashtme, por jo me zemër dhe nijet. Transmeton Buhariu prej Ebu Dardasë se ka thënë: Ne zgërdhemi para disa njerëzve por zemrat tona i mallkojnë ata. Theuriu thotë: Ibn Abasi ka thënë: Shtirja nuk bëhet me vepra por vetëm me fjalë. Ndërsa Haseni thotë: Shtirja lejohet deri ditën e gjykimit”.

Ibn Xherir Taberiu thotë: **﴿vetëm nëse ruheni (shtireni) prej tyre﴾** vetëm nëse jeni nën pushtetin e tyre dhe frikësoheni për vetet tuaja dhe shtireni se i mbështetni me fjalë, por në zemra fshihni armiqtësinë dhe mos i përkrahni për kufirin e tyre dhe mos i ndihmoni kundër një muslimani tjetër me vepra”.

Prej argumenteve që dëshmojnë për kufirin e atij që e shpreh fjalë kufri me dëshirë dhe pa imponim është edhe fjala e Allahut: **«Betohe në Allah se nuk thanë asgjë! Por ata thanë fjalën e kufirit dhe bënë kufër pas imanin të tyre»** Et teube, 74. Dhe fjala e Allahut: **«E nëse i thyejnë betimet e tyre pas besës që dhanë dhe cënojnë fenë tuaj atëhere luftojeni parinë e kufirit sepse ata nuk kanë betime (marrvesheje) se mbase heqin dorë»** Et teube, 12.

Ibn Tejmije thotë: “Kjo dëshmon se çdo cënues i fesë është prijës në kufër”.¹

Kurtubiu thotë: “Disa dijetarë janë argumentuar me këtë ajet se vrasja e atij që cënon fenë është vaxhip, sepse ai është qafir. Cënimi i fesë ndodh atëhere kur e cilëson atë me gjëra që nuk i shkojnë për shtat, ose kur refuzon me nënçmim dhe përçmim dispozita të fesë. Transmetohet se një person tha në kuvendin e Aliut: Kab ibn Eshrefi është vrasë me tradhti. Atëhere Aliu ﷺ urdhëroi që t’i pritej koka. Dijetarët tanë (malikijtë) kanë thënë: Ky tip vritet dhe nuk i kërkohet pendim, sepse e ka akuzuar profetin me tradhti dhe me këtë konsiderohet zindik”.²

Shiko se si gjykohet për prishjen e zemrës dhe akides së njeriut, thjesht për një fjalë që e thotë pa u menduar gjatë.

Të vërtetën ka thënë i dërguari i Allahut ﷺ: **“Robi flet një fjalë që zëmëron Allahun për të cilën nuk ja priste mendja të arrinte aty ku arriti. Për shkak të saj Allahu ja shkruan zemërimin e tij deri në ditën kur ta takojë atë”**.³

E lus Allahun e lartë të na mbrojë prej shkarjeve dhe gabimeve dhe t’i vulosi punët tona me vepra që shkruajnë kënaqësinë e tij, deri në ditën e gjykimit. Allahu është dëgjues i lutjes, afër lutësit dhe i përgjigjet atij.

4. Kthimi për gjykim te taguti.

Prej shenjave që dëshmojnë për zbrazjen e zemrës prej imanit është edhe largimi prej ligjit të Allahut ﷻ dhe kthimi për gjykim te taguti dhe ligjet e tij. Allahu ﷻ thotë: **«A nuk i shikon ata që pretendojnë se kanë besuar atë që të është zbritur ty dhe atë që është zbritur para teje, dëshirojnë të gjykohe te taguti ndërkohë që janë urdhëruar të bëjnë kufër me të, mirëpo shejtani dëshiron t’i humbasë me humbje të largët»** En nisa, 60.

E njëjta gjë thuhet edhe për atë që dëshiron të largojë dëmin e armikut prej muslimanëve dhe nuk ka rrugë tjetër për mënjanimin e tij, atëhere kjo lejohet me lejen e Allahut. Për shembull, kur shtiret me fjalë se i përkrah qafirët për të përmbushur misionin e tij, siç ndodhi me sahabët kur profeti ﷺ i dërgoi për të vrasë tiranin çifut Kab ibn Eshrefin apo në misione të tjera. Këtë çështje e kam sqaruar më gjerë në librin tim “Rastet kur lejohet shfaqja e kufirit”.

¹ Es sarimul meslul, fq. 17.

² Tefsiri i Kurtubiut, vëll. 8, fq. 82.

³ E transmeton Maliku dhe Tirmidhiu i cili thotë: Hadith hasen sahih.

Ajeti dëshmon se kush kthehet për gjykim te taguti¹ me dëshirë dhe braktis gjykimin me sheriati e Allahut, megjithëse ka mundësi të gjykohet me të, ai është gënjeshtar kur pretendon me gojë se është besimtar. Ky është një pretendim i kotë. Po të ishte i sinqertë nuk do të shkonte për gjykim te taguti dhe ligjet e tij dhe nuk do t'i kthente shpinën shariatit të Allahut.

Shenkiti _Allahu e mëshiroftë_ në tefsirin e tij thotë: *“Prej argumenteve më të qarta për këtë është sqarimi që Allahu ﷻ bën në suren “En nisa” për ata që dëshirojnë të gjykohen me ligje të tjera dhe jo me shariat dhe çuditet me pretendimin e tyre se janë besimtarë. Kjo sepse pretendimi i imanit, në një kohë kur ata dëshirojnë të gjykohen te taguti është një gënjeshtër e madhe që të habit. Allahu ﷻ thotë: ﴿A nuk i shikon ata që pretendojnë se kanë besuar në atë që të është zbritur ty dhe atë që është zbritur para teje, dëshirojnë të gjykohen te taguti﴾ En nisa, 60.*

*Nga këto fjalë hyjnore duket qartë kufri i atyre që pasojnë ligjet e shpikura të cilat i ka ligjëruar shejtani në gojën e ithtarëve të tij, për të kundërshtuar sheriati që Allahu e ka shpallur nëpërmjet të dërguarve të tij. Duket qartë se nuk ka pikë dyshimi për kufirin dhe shirkun e tyre. Ata që kujtojnë të kundërtën, Allahu ua ka vulosur mendjet dhe sytë u janë verbuar prej dritës së shpalljes, për shkak të ithtarëve të shejtanit”.*²

Sejid Kutbi në tefsirin e tij thotë: *“Botëkuptimi i imanit me fitre dhe me logjikë të shëndoshë e shtyn njeriun që të kthehet për gjykim te ai i cili ka besuar. Nëse pretendon se ka besuar Allahun dhe atë që e ka zbritur, ka besuar profetin dhe atë që i është shpallur, pastaj ftohet për të gjykuar me urdhrin, ligjin dhe rrugën e atij që ka besuar, natyrisht dhe logjikisht do i përgjigjet kësaj ftese pozitivisht. Ndërsa kthimi i shpinës dhe refuzimi bie ndesh me realitetin e natyrës dhe logjikës së njeriut dhe është shenjë që zbulon nifakun dhe dëshmon*

¹ Ibën Tejmije e shpjegon kuptimin e fjalës tagut në “mexhmu’ul fetaua” 28/200 kur thotë: *“Fjala “tagut” e ka prejardhjen nga fjala arabe “tug’jan” e cila nënkupton tejkalim kufiri, padrejtësi dhe prishje. Prandaj ai që adhurohet përveç Allahut _nëse nuk e urren këtë adhurim_ është tagut. Në hadithin e saktë profeti i quajti idhujt tagutë kur thotë: “Ai që adhuronte tagutët do të shkojë pas tagutëve”. Tagut është edhe ai që njerëzit i binden në mosbindjen ndaj Allahut dhe në pasimin e diçkaje tjetër përveç udhëzimit dhe fesë islame, qofshin bindjet dhe idetë e tij të pranuar apo të praktikuara”.*

Nxënësi i Ibn Tejmijes dijetari i njohur Ibn Kajimi në librin “Këshillimi i dijetarëve” thotë: *“Tagut është çdo gjë e adhuruar, e pasuar ose që robi i bindet duke e tejkualuar kufirin e saj. Taguti i një populli është çdo person tek i cili kthehen për gjykim përveç Allahut dhe të dërguarit të tij, ose e adhurojnë përveç Allahut, ose e pasojnë pa urdhrin e Allahut, ose i binden në atë që nuk e dinë nëse është bindje ndaj Allahut. Këta janë tagutët në tokë. Nëse hulumton rreth tyre dhe hulumton për marrëdhënien e njeriut me tagutin, ke për ta kuptuar se shumica e tyre kanë braktisur adhurimin e Allahut për adhurimin e tagutit, kanë braktisur gjykimin e Allahut dhe të dërguarit për t’u gjykuar te taguti, kanë braktisur bindjen ndaj Allahut dhe pasimin e profetit për bindjen dhe pasimin e tagutit”.*

Pra tagut është çdo gjë që adhurohet përveç Allahut, kur i adhuruari e aprovon këtë adhurim _qoftë edhe në një lloj të vetëm ibadeti_ dhe tagut është kushdo që pretendon ose pohon për veten e tij cilësi që i takojnë vetëm Allahut të lartë dhe të pashoq dhe e kemi për detyrë ta konsiderojnë qafir dhe të bëjmë kufër me të.

² Eduaul bejan, 4/83.

për pretendimin e gënjeshtërt të imanit”.¹

Sheukani në tefsirin e tij thotë: “Në këtë ajet Allahu e fton të dërguarin e tij të habitet me realitetin e atyre që pretendojnë se kanë bashkuar sëbashku besimin me atë që i është shpallur profetit dhe profetëve të tjerë sëbashku me atë që e prish dhe e hedh poshtë këtë pretendim dhe se ata nuk janë askund me iman. Ky prishës i imanit është dëshira për t’u gjykuar te taguti ndërkohë që në shpalljen e profetit dhe të profetëve të mëparshëm janë urdhëruar që të bëjnë kufër me tagutin”.²

Këta dijetarë gjykuan për besimin e prishur të zemrës dhe i përgënjeshtroan ata që pretendojnë imanin e në të njëjtën kohë braktisin sheriatin dhe kthehen për gjykim te taguti dhe ligji i tij, megjithëse ata nuk u shprehën me fjalë për besimin në zemrat e tyre dhe për lejimin e gjykimit te taguti, përkundrazi kur u pyetën thanë: **﴿Ne deshëm vetëm të vepronim mirë dhe pajtim﴾** En nisa, 62.

Sheukani thotë: “Me kthimin për gjykim te dikush tjetër përveç teje (profetit) kishim qëllim të bënim mirë dhe jo keq. Ne deshëm të pajtonim palët në konflikt dhe jo të të kundërshtonim³. Ata e mohuan se vepra e tyre ishte rrjedhojë e besimit të lejimit të kthimit për gjykim te tjetërkush përveç profetit, mirëpo ky është pretendim i rremë **﴿Allahu i njeh mirë ata se çfarë kanë në zemra﴾** prej nifakut dhe gënjeshtres **﴿prandaj largohu prej tyre﴾** En nisa 63”.⁴

5. Braktisja e gjykimit me sheriat.

Allahu ﷻ thotë: **﴿Thonë: Kemi besuar në Allahun dhe të dërguarin e tij dhe jemi bindur por pastaj një grup prej tyre kthehen mbrapsh dhe ata nuk janë besimtarë. E kur ftohen që Allahu dhe i dërguari i tij të gjykojnë mes tyre e shikon një grup prej tyre të kthejnë shpinën﴾** En nur 48.

Ky ajet vërteton faktin se kthimi i shpinës ndaj gjykimit të profetit⁵ është shenjë e qartë për prishjen e zemrës dhe zbrazjen e saj prej imanit. Askujt nuk i bën dobi pretendimi i

¹ Fi dhilalil kuran, 2/694.

² Fethul kadir, 1/481.

³ Autori i librit “Fethul mexhid sherh kitabit teuhid” në fq. 392 thotë: “Kush kundërshton atë që e ka udhëruar Allahu dhe i dërguari dhe gjykon mes njerëzve me diçka që nuk e ka zbritur Allahu ose kërkon këtë lloj gjykimi prej epshit dhe dëshirës, ai e ka thyer besën e islamit dhe imanit edhe nëse pretendon se është besimtar. Allahu i qortoi ata që dëshiruan këtë gjykim dhe i përgënjeshtroi në pretendimin e imanit, sepse fjala **﴿pretendojnë﴾** nënkupton mohimin e imanit. Kjo fjalë zakonisht përdoret për atë që pretendon diçka të rremë, sepse ai vetë vepron të kundërtën e asaj që thotë. Këtë e përforcon edhe fjala e Allahut **﴿janë urdhëruar të bëjnë kufër me të﴾** sepse kufri ndaj tagutit është shtyllë e teuhidit, siç përmendet në ajetin e sures Bekare dhe nëse nuk plotësohet kjo shtyllë, atëherë ai nuk është njësuës me teuhid”.

⁴ Fet’hul kadir.

⁵ Kthimi për gjykim te profeti në kohën kur ka qënë gjallë bëhej me gjykimin përpara tij, ndërsa pas vdekjes së tij me kthimin te suneti i tij.

imanit me gojë edhe nëse pretendon njëmijë herë se ka besuar Allahun dhe të dërguarin, nëse realiteti i tij është i tillë. Kthimi i shpinës ndaj gjykimit të Allahut dhe të dërguarit e përgënjeshton këtë pretendim.

Nëse do të ishte i sinqertë në pretendimin e tij do të thoshte: U bindëm, dhe do t'i nënshtrohej gjykimit të Allahut dhe profetit të tij, siç thotë Allahu i Lartë për besimtarët: **«Fjala e besimtarëve kur ftohen që Allahu dhe i dërguari i tij të gjykojnë për ta ishte vetëm: Dëgjua dhe u bindëm dhe mu këta janë të shpëtuarit»** En nur 51.

Ibn Tejmije thotë: “Allahu ﷻ e sqaron se kush refuzon bindjen e profetit ﷺ dhe i kthen shpinën gjykimit të tij, ai është prej munafikëve dhe nuk është besimtar, sepse besimtari thotë: dëgjua dhe u bindëm. Nëse nifaku vërtetohet dhe imani rrëzohet thjesht me kthimin e shpinës, ndaj gjykimit të profetit dhe thjesht me dëshirën për t'u gjykuar te dikush tjetër _megjithëse kjo është thjesht një lënie, shkak i të cilës mund të jetë forca e epshit_, atëhere çfarë mund të themi për atë që cënon dhe shan (fenë dhe profetin)?!”¹

Gjithashtu Allahu ﷻ thotë: **«Thuaj: Bindjuni Allahut dhe të dërguarit. E nëse kthejnë shpinën atëhere Allahu nuk i do qafirët»** Ali Imran 32. Ky ajet tregon se kush i kthen shpinën bindjes ndaj Allahut dhe të dërguarit nuk është besimtar, por është prej qafirëve kryeneç.

Ibn Kethiri thotë: “Kjo dëshmon se kundërshtimi i rrugës së tij është kufër dhe Allahu nuk e do atë që e vepron kështu”.²

Imam Ahmedi thotë: “Vështrova në Kuran dhe e gjeta bindjen e profetit të përmendur në tridhjetë e tre vënde, pastaj lexoi **«Le të bëjnë kujdes ata që kundërshojnë urdhrin e tij se mos i godet ndonjë fitne ose mos i godet ndonjë dënim i dhimbshëm»** En nur 63. Pastaj tha duke e përsëritur disa herë: Çfarë është fitnia? Ajo është shirku. Nëse refuzon ndonjë fjalë të profetit, në zemër i hyn devijimi dhe zemra i devijon dhe shkatërrohet”.³

6. Bindja ndaj mushrikëve në kufrin e tyre.

Prej shënjave që dëshmojnë për prishjen dhe zbrazjen e zemrës prej imanit është edhe bindja e mushrikëve në konsiderimin e haramit të lejuar dhe konsiderimin e hallallit të ndaluar, ose bindja e tyre sepse janë mushrikë, ose bindja e tyre në kufrin e tyre.

Allahu i lartë thotë: **«Ata të cilët ia kthyen shpinën udhëzimit pasi u sqarua ata i mashtroi dhe i inspiroi shejtani sepse ata u thanë atyre që urrejtën atë që zbriti Allahu: Do ju bindemi ju në disa gjëra dhe Allahu e di mirë atë që fshehin»** Muhamed 26.

¹ Es sarimul meslul ala shatimir resul, fq. 38.

² Tefsiri i Ibn Kethirit, 1/366.

³ Es sarimul meslul, fq. 56.

Ata u kthyen në kufër pas imanit të tyre dhe pasi e kuptuan rrugën e udhëzimit, përshkak se u thanë atyre që urryen shpalljen e Allahut: Do ju bindemi në disa gjëra. Kjo fjalë ishte shenjë e qartë që dëshmon për prishjen e akides dhe për kufirin e tyre në zemër, sepse njeriu nuk mund të quhet murted¹ kur në zemër ka qoftë edhe një grimcë iman .

Ibn Kethiri në komentimin e ajetit **﴿Ata që ia kthyen shpinën udhëzimit pasi u sqarua﴾** thotë: *“Dmth. dolën prej imanit dhe u kthyen në kufër”*.²

Pra kufri dhe nifaku erdhën si pasojë e fjalës së tyre edhe nëse më përpara kanë qënë besimtarë. Po të kishin qënë përprara kësaj fjale munafikë nuk mund të thuhej: Dolën prej imanit dhe u kthyen në kufër, sepse munafiku është qafir dhe nuk ka iman dhe nuk thuhet për munafikun: U bë murted pas imanit.

Gjithashtu fjala e Allahut: **﴿Shejtanët i inspirojnë miqtë e tyre që të debatojnë me ju. E nëse u bindeni atyre ju jeni mushrikë﴾** El enam 121. Pra nëse u bindeni atyre në lejimin e asaj që Allahu e ka bërë haram, atëhere ju jeni mushrikë njësoj si ata dhe jo besimtarë³, sepse Kurani vërteton njëri-tjetrin.

7- Sikleti dhe moskënaqja me gjykimin e Allahut.

Allahu i lartësuar thotë: **﴿Jo pasha zotin tënd ata nuk besojnë derisa të të bëjnë ty gjykatës për atë që ka ndodhur mes tyre dhe pastaj të mos gjejnë në vetet e tyre asnjë siklet prej gjykimit tënd dhe ta pranojnë me nënshtrim﴾**En nisa, 65.

Ajeti dëshmon se moskthimi për gjykim të sheriatit, sikletosja dhe mospranimi i tij është shenjë e qartë që dëshmon për mospasjen iman në zemër dhe dëshmon për gënjeshtren e atij që pretendon imanin. Nëse do të ishte i sinqertë në pretendimin e tij, kishte për ta aprovuar gjykimin e sheriatit islam dhe nuk kishte për t'i kthyer shpinën për hatër të ligjeve të tagutit, sepse imani e shtyn besimtarin të kënaqet me gjykimin e Allahut dhe të profetit dhe të mos preferojë asnjë gjykim tjetër, siç thotë Allahu: **﴿Asnjë besimtari dhe besimtareje nuk i takon të zgjedhë për diçka që Allahu dhe i dërguari i tij kanë vendosur﴾** El Ahzab, 36. Ndërsa ata që kujtojnë se kanë liri zgjedhje mes aprovimit apo refuzimit të gjykimit të

¹ Fjala (irteddu) e përmendur në ajet që mund të përkthehet (ia kthyen shpinën) e ka kuptimin që ata u bënë murtedë pas imanit të tyre sepse kjo fjalë ka të njëjtën prejardhje me fjalën murted. Shën. i përkthyesit.

² Tefsiri i Ibn Kethirit, 4/193.

³ Bindja ndaj mushrikëve ndahet në dy lloje: Një lloj e nxjerr njeriun prej islamit dhe kjo ndodh atëhere kur u bindemi në kufrin dhe shirkun e tyre të madh, ose në lejimin e haramit dhe ndalimin e hallallit, ose përgënjeshtimin e të vërtetës dhe daljes në krah të së kotës dhe kur u bindemi atyre sepse janë mushrikë apo sepse nuk lejohet që t'ua refuzojmë fjalët. Kjo lloj bindje është kufër i madh që e nxjerr njeriun prej islamit. Lloji tjetër nuk e nxjerr njeriun prej islamit por konsiderohet fisk dhe gjynah. Kjo ndodh atëhere kur u bindemi në gjëra që janë më të vogla se kufri i cili u përmend më sipër. Psh kur u bindet në kryerjen e disa gjynaheve prej epshit, por jo se i shikon si hallall. Kjo lloj bindje është gjynah, por nuk arrin gradën e kufrit dhe nuk e nxjerr njeriun prej islamit.

Allahut dhe profetit, ata nuk janë besimtarë.

Ibn Kajimi thotë: “Allahu ﷻ u betua me veten e tij duke e përforcuar betimin me pjesëzën mohore “jo”, se ata njerëz nuk besojnë derisa ta bëjnë profetin ﷺ gjykues në çdo kundërshtim mes tyre, në bazat dhe degët e fesë, në dispozitat fetare, në dispozitat e ringjalljes, në cilësitë e Allahut ﷻ dhe në çdo gjë tjetër. Madje nuk mjafton vetëm kthimi për gjykim te profeti ﷺ për vërtetimin e imanit, por duhet të mos ndiejnë asnjë siklet dhe dyshim, por ta hapin gjoksin për gjykimin e tij dhe ta pranojnë menjëherë. E pas gjithë kësaj nuk cilësohen me iman, derisa të kënaqen, të dorëzohen dhe të mos kundërshtojnë gjykimin e tij”.¹

Them: Hedhja e shariatit në referendum, sipas botëkuptimeve të demokracisë, nuk është prej veprave të atyre që besojnë Allahun dhe të dërguarin e tij.

Ibn Kethiri në tefsirin e tij thotë: “Allahu betohet me veten e tij se askush nuk beson derisa ta bëjë profetin gjykues për të gjitha çështjet dhe ta pranojë këtë gjykim me nënshtrim dhe pa asnjë hezitim, refuzim apo kundërshtim”.²

8- Prej kushteve të imanit të sinqertë është kthimi për zgjidhjen e kundërshtimeve të Allahut dhe i dërguari.

Allahu thotë: ﴿Nëse bini në kundërshtim për diçka atëhere kthejeni atë te Allahu dhe i dërguari i tij nëse besoni në Allahun dhe botën tjetër﴾ En nisa 59.

Ajeti dëshmon se kthimi te Allahu dhe i dërguari është prej kushteve të imanit. Imani i kushtëzuar në këtë ajet rrëzohet me rënien e kushtit, sidomos në këtë rast kur kushtëzimi është mes dy gjërave, ku secila prej tyre bie me rënien e tjetrës.³ Pra Allahu e bëri moskthimin te Allahu dhe i dërguari në pamje të jashtme, argument për mospasjen iman në zemër.

Prej kësaj kuptojmë se kush refuzon t’i kthejë konfliktet dhe kundërshtimet e ndryshme te Allahu ﷻ dhe i dërguari i tij ﷺ duke preferuar t’i kthejë ato te ligjet e vendosura prej njerëzve, si ligjet OKB-së, ai nuk është besimtar sado që të pretendojë me gojën e tij.

9- Mospasimi me vepra (në pamje të jashtme).

Kush nuk e pason fare shariatit me fjalë e vepra, nuk ka pikë dyshimi për prishjen e zemrës dhe kufirin e tij në pamje të brendshme dhe të jashtme. Allahu ﷻ thotë: ﴿Thuaj: Nëse e doni Allahun më ndiqni mua që t’ju dojë Allahu﴾ Ali Imran 31.

¹ Et tibjan fi aksamil kuran, fq. 270.

² Tefsiri i Ibn Kethirit, 1/553.

³ Këtë e përmend Ibn Kajimi në “Ilamul muvakkil’in” 1/50.

Shenja që robi e do zotin është pasimi i profetit ﷺ në çdo gjë që i është shpallur. Dashuria është në varësi të ndjekjes dhe pasimit. Nëse dashuria në zemër është e madhe edhe pasimi me vepra është i madh. Nëse pasimi me vepra është i madh edhe dashuria në zemër është e madhe. Secila prej tyre është shenjë dhe kusht për tjetrën. Kështu mospasimi i udhëzimit të shariatit në asnjë lloj vepre është argument për mospasjen e asnjë lloj dashurie në zemër dhe mospasja e asnjë pikë dashurie për Allahun ndodh vetëm në zemrën e qafirit, i cili nuk beson Allahun e madh. E kush pretendon me gojë dashurinë e Allahut, por nuk pason profetin ﷺ ai është gënjeshtar dhe ky ajet i qartë e përgënjeshton atë.

Ibn Kethiri në tefsirin e tij thotë: “Ky ajet gjykon për gënjeshtërën e kujtdo që pretendon dashurinë e Allahut por nuk e pason rrugën e Muhamedit. Ai është gënjeshtar në pretendimin e tij derisa ta pasoj shariatit të Muhamedit dhe fenë e profetit ﷺ në të gjitha fjalët dhe veprat e tij”.¹

Hanbeli thotë: Më ka treguar Humejdi thotë: Më kanë treguar që disa njerëz thonë: Kush e pohon namazin, zekatin, agjërimin dhe haxhin por nuk vepron asnjë prej tyre derisa të vdesë dhe falet me shpinë nga kibla ai është besimtar përderisa nuk mohon. U thashë: Ky është kufri i qartë dhe kundërshtim i librit të Allahut ﷻ, i sunetit të profetit ﷺ dhe dijetarëve islam. Allahu ﷻ thotë: **«Ata u urdhëruan të adhurojnë vetëm Allahun me singëritet, nënshtrim dhe pastërti dhe ta falin namazin e ta japin zekatin dhe kjo është feja e vyer»** El bejineh, 5.

Pastaj Hanbeli thotë: E kam dëgjuar Ebu Abdullah Ahmed ibn Hambelin të thotë: Kush thotë kështu, ai ka bërë kufër me Allahun dhe i është kundërvënë urdhrin të tij dhe shpalljes që profetit i është zbritur prej Allahut”.²

Vështroje pak fjalën e Humejdit: Ky është kufri i qartë, dhe fjalën e imam Ahmedit: Kush thotë kështu, ai ka bërë kufër me Allahun. Ky gjykim është për atë që thotë këto fjalë. E si mund të jetë gjykimi për vepruesin?! Padyshim ai është kufër më i qartë dhe më i rëndë.

Prej kësaj na sqarohet rreziku i mendimeve të dijetarëve murxhi të cilët thonë: Imani vërtetohet thjesht me pohim edhe nëse nuk pasohet me punë dhe nënshtrim.

Rreth kësaj shejhul islam Ibn Tejmije thotë: “Nëse supozojmë se disa persona i thonë profetit ﷺ: Ne e besojmë me zemra atë që të është shpallur pa pikë dyshimi dhe i pohojmë me gojë të dy dëshmitë, mirëpo nuk të bindemi ty në asnjë urdhër dhe ndalesë. As nuk falemë, as nuk agjërojmë, as nuk bëjmë haxh, as nuk themi të vërtetën, as nuk e çojmë në vend amanetin, as nuk e përmbushim premtimin, as nuk i ruajmë lidhjet farefisnore dhe nuk veprojmë asnjë prej veprave të mirë me të cilën ke urdhëruar. E pijmë verën, martohemi me mehremet me zina, vrasim sa të kemi mundësi prej sahabëve dhe prej umetit tënd, ua

¹ Tefsiri i Ibn Kethirit, 1/366.

² Marrë prej Mexhmu'ul fetaua të Ibn Tejmijes, 7/209.

grabisim pasuritë, madje edhe ty të vrasim dhe luftojmë kundër teje në rradhët e armiqve të tu. A mos vallë njeriu i logjikshëm mund të përfytyrojë se profeti do u thoshte: Ju jeni besimtarë me iman të plotë. Ju ka për t'ju përfshirë shefati (ndërmjetësimi) në ditën e ringjalljes dhe shpresoj të mos hyni në zjarr. Përkundrazi çdo musliman pa pikë dyshimi e dhi se ai do u thoshte: Ju jeni njerëzit më qafirë me atë që jam dërguar, dhe kishte për t'i vrarë nëse nuk pendoheshin prej kësaj”.¹

Prej Ebu Is'hak Fezarit thotë: Euzaiu ka thënë: “Imani drejtohet vetëm me fjalë dhe imani dhe fjalët drejtohen vetëm me punë dhe imani, fjalët dhe punët drejtohen vetëm me nijet dhe përputhje të sunetit”.²

10- Mosgjykimi me atë që e ka zbritur Allahu.

Allahu thotë: **﴿Kush nuk gjykon me atë që e ka zbritur Allahu mu ata janë qafirët﴾** El maide 44.

Ajeti dëshmon se ai që i bën bisht gjykimit me atë që e ka zbritur Allahu dhe i jep përparësi gjykimit me ligjin e tagutit³, punon me këtë ligj, i detyron njerëzit të punojnë me të dhe lufton për mbrojtjen e tij, një person i tillë është qafir në brendësinë dhe në pamjen e jashtme të tij. Nuk ka dallim a shprehet me fraza që nënkuptojnë lejimin e gjykimit me atë që nuk e ka zbritur Allahu apo nuk shprehet, sepse prishja e veprave të jashtme dëshmon për prishjen e zemrës dhe brendisë së tij. Një person i tillë nuk hyn te fjala e Ibn Abasit ؓ: Kufër nën kufër, nuk është prej kufirit që po kujtoni.

Fjala e Ibn Abasit ؓ nuk përfshin tagutët e njohur për urrejtjen që kanë për ligjin e Allahut dhe urrejtjen për këdo që thërret për gjykim me atë që e ka zbritur Allahu. Kjo fjalë përfshin udhëheqësit musliman që gjykojnë me atë që ka zbritur Allahu në të gjitha fushat e jetës dhe në gjykata pa e refuzuar dhe pa e urreyer sheriatin, mirëpo në disa çështje dhe raste të caktuara gjykojnë me atë që nuk e ka zbritur Allahu, për shkak të interpretimeve të kota, dyshimeve, epshit, dobësisë, për të favorizuar të afërmit etj. Raste të tilla kanë ndodhur edhe në kohën e emevive dhe abasive. Të tillë persona i përfshin fjala e dijetarëve: Kufër nën kufirin e madh dhe se nuk është prej kufirit që kujtojnë njerëzit.

I dërguari i Allahut ؑ na ka njoftuar për këtë kur thotë: **“I pari që do ndryshojë rrugën time do të jetë një person prej emevive”**.⁴ Dmth do ndryshojë sunetin e tij në zgjedhjen e halifit islam me trashgimi dhe jo me shura.

Dhe thotë: **“Gjëja e parë që do të humbasë prej fesë është gjykimi dhe gjëja e fundit**

¹ Mexhmu'ul fetaua, 7/287.

² Mexhmu'ul fetaua, 7/296.

³ Çdo gjykim me ligjin e tjetërkujt përveç Allahut është gjykim taguti

⁴ Es silsiletus sahiha, 1749.

është namazi”.

Megjithatë, askush prej dijetarëve islam nuk i ka konsideruar qafirë prijësit emevi dhe abasi përshkak se e kthyen pushtetin në trashgimi.

Fjala e Ibn Abasit ﷺ “*Kufër nën kufrin (e madh)*”, patjetër duhet kuptuar në këtë mënyrë, përndryshe do të ishim të padrejtë me dijetarin e umetit dhe do e interpretonim fjalën e tij me gjëra që nuk ka dashur t’i thotë, duke i përplasur argumentet e sheriatit me njëritjetrit.¹

11- Miqësimi dhe përkrahja e mushrikëve kundër muslimanëve.

Miqësimi i mushrikëve dhe qafirëve është shenjë e qartë që dëshmon për realitetin e brendësisë së njeriut dhe dëshmon për prishjen dhe nifakun e tij edhe nëse me gojë pretendon të kundërtën.

Allahu ﷻ thotë: **﴿E nëse do të besonin në Allahun dhe profetin dhe në atë që ju zbrit atij nuk kishin për t’i zënë ata për miq, por shumica e tyre janë fasikë (të pabindur)﴾** El maide, 81.

Ibn Tejmije thotë: “*Kjo dëshmon se imani në aspektin shariatik bie në kundërshtim me zënien e qafirëve për miq dhe se nuk mund të bashkohet në zemër imani me zënien e tyre për miq. Njësoj me këtë është edhe fjala e Allahut: ﴿Mos i merrni çifutët dhe të krishterët për miq sepse ata janë miq të njëritjetrit. Kushdo prej jush që i merr ata për miq ai është prej tyre﴾* El maide, 51. Allahu na tregon në ajetin e mëparshëm se miqësuesi i tyre nuk është besimtar. Ndërsa në këtë ajet na tregon se ai është prej tyre, sepse Kurani vërteton njëritjetrit”.²

Vështroje fjalën “*nuk mund të bashkohet në zemër imani me zënien e tyre për miq*”! Sepse imani dhe kufri nuk mund të bashkohen në zemrën e njeriut, siç thuhet në hadith: “**Imani dhe kufri nuk bashkohen në zemrën e njeriut**”.³ Ekzistimi në zemër i njërit prej tyre hedh poshtë ekzistencën e tjetrit.

Allahu thotë: **﴿Të mos i marrin besimtarët qafirët për miq përveç besimatarëve. E**

¹ Profesor Muhamed Kutbi në librin e tij “Realiteti ynë bashkohorë” fq. 334 thotë: “*Sa padrejtësi i është bërë Ibn Abasit. Ai e tha këtë fjalë kur e tha për emevitët, kur i akuzuan se gjykojnë me atë që nuk e ka zbritur Allahu, dhe u pyet për hukmin rreth tyre. Askush deri më sot nuk ka thënë që emevitët ishin qafirë. Ata e kanë pas zbatuar sheriatin në të gjitha fushat e jetës, mirëpo patën rrëshkitur në disa çështje që lidheshin me pushtetin e tyre, për shkak të interpretimeve të ndryshme, ose prej epshit, mirëpo ata kurrë nuk patën shpikur ligje që rivalizojnë sheriatin e Allahut. Prandaj Ibn Abasi tha për ta: Ai është kufër nën kufrin (e madh). Si mund ta thoshte Ibn Abasi këtë fjalë për ata që e hedhin poshtë sheriatin tërësisht dhe vendos në vend të tij ligje të shpikura?!”.*

² Mexhmu’ul fetaua, 7/17.

³ Es silsiletus sahiha, 1050.

kush vepron kështu ai nuk është te Allahu asgjë, vetëm nëse shtireni ndaj tyre për t'u ruajtur. Allahu ju tërheq vërejtje që të frikësoheni prej tij» Ali Imran, 28.

Dhe thotë: «Nuk gjen asnjë popull që besojnë në Allahun dhe botën tjetër, të duan ata që luftojnë Allahun dhe të dërguarin e tij edhe nëse ata janë baballarët e tyre» El muxhadeleh 22.

Dhe thotë: «Përgëzoi munafikët me dënim të dhëmbshëm. Ata të cilët i zënë qafirët për miq përveç besimtarëve. A mos po kërkojnë tek ata krenarinë, ndërkohë që e gjithë krenaria i takon Allahut) En nisa 139. E shumë ajete të tjera që dëshmojnë për nifakun e atij që i zë qafirët për miq përveç besimtarëve dhe dëshmojnë për zemrën e prishur dhe të zbrazur prej imanit.

12- Braktisja e luftimit të qafirëve.

Prej shenjave të dukshme që dëshmojnë për prishjen e zemrës dhe qëllimit të keq, është braktisja e qafirëve dhe mushrikëve dhe pengimi i umetit prej xhihadit kundër tyre dhe propaganda kundër xhihadit dhe muxhahidave, shpifja ndaj tyre dhe tallja me ta. Këto cilësi gjenden vetëm në zemrën e atij që në zemër fsheh të keqen kundër islamit dhe muslimanëve.

Allahu i Lartë thotë: «O besimtarë! Mos jini si ata që bënë kufër dhe u thanë vëllezërve të tyre kur dolën në tokë ose u nisën për luftë: Nëse do ishin në mesin tonë nuk do të vdisnin dhe as do të vriteshin. Allahu do t'ua kthejë këtë fjalë në lëngim në zemrat e tyre. Allahu jep dhe merr jetë dhe ai e shikon çdo gjë që veproni» Ali Imran 156.

Ibn Kethiri thotë: “Allahu i ndalon besimtarët prej përngjasimit me qafirët në besimin e tyre të kotë që përfitohet prej fjalës për vëllezërit e tyre që vdiqën në udhëtim dhe në luftë: Nëse nuk do të dilnin nuk kishte për t'i goditur vdekja”.¹ Shiko se si e konsideroi këtë fjalë të tyre dëshmi për kufrin dhe besimin e tyre të prishur.

Allahu thotë: «Ata betohen për Allah se janë prej jush. Ata nuk janë prej jush, por vetëm friksohen prej jush. Sikur të gjenin strehim, ose vrimë, ose rrugalje kishin për të nxituar me vrap» Et teube, 57.

Allahu na tregon se ata betohen se janë besimtarë edhe pse nuk janë të tillë, por vetëm ja kanë frikën armikut.²

Allahu thotë: «Nuk të kërkojnë leje ata që besojnë Allahun dhe botën tjetër për të mos luftuar me pasuritë dhe vetet e tyre dhe Allahu i njeh mirë të ruajturit. Leje kërkojnë vetëm ata që nuk besojnë Allahun dhe botën tjetër dhe zemrat i kanë plot

¹ Tefsiri i Ibn Kethirit, 1/428.

² Siç thotë Ibn Tejmije në “Mexhmu’ul fetaua” 28/437.

dyshim dhe ata në dyshimin e tyre vërtiten Et teube, 45.

Ibn Tejmije thotë: “Allahu na njofton se besimtari nuk i kërkon leje profetit për lënien e xhihadit por këtë leje e kërkojnë ata që nuk besojnë. E çfarë mund të themi për atë që e lë xhihadin pa kërkuar leje”.¹

Çfarë mund të themi ne për atë që pengon umetin prej xhihadit dhe cënon xhihadin dhe muxhahidët?! Çfarë mund të themi për atë që refuzon të flasë për xhihadin si alternativë sepse ai nuk i përshtatet kësaj kohe?! Çfarë mund të themi për ata që i konsiderojnë muxhahidët kriminelë sepse po luftojnë në rrugë të Allahut?! Padyshim se është më afër nifakut dhe mohimit të imanit.

Allahu thotë: **«Ata që u thanë vëllezërve të tyre dhe nuk dolën (për xhihad): Nëse do na bindeshin ne nuk kishin për t’u vrrarë. Thuaj: Shmangeni atëhere vdekjen prej veteve tuaja nëse po thoni të vërtetën»** Ali Imran, 168.

Dhe thotë: **«Allahu i njeh mirë ata që pengojnë (prej xhihadit) dhe ata që u thonë vëllezërve të tyre: Ejani me ne (dhe mos shkoni në xhihad) dhe aspak nuk shkojnë në vështirësi (në luftë)»** El ahzab 18 deri te fjala e tij: **«Ata nuk kanë besuar dhe Allahu ua ka rrëzuar punët e tyre dhe kjo për Allahun është shumë e lehtë»** El ahzab 19.

Ibn Tejmije thotë: “Dijetarët kanë thënë: Munafikët ktheheshin prej hendekut dhe hynin në Medine dhe kur i takonte dikush i thoshin: Çudi me ty! Rri dhe mos dil! Pastaj u shkruanin vëllezërve të tyre në ushtrinë muslimane: Hajde kthehuni në Medine se po ju presim. I pengonin prej xhihadit dhe shkonin në kampin e muslimanëve, vetëm kur s’kishin rrugdalje, sa për sy e faqe dhe kur njerëzit nuk ishin vigjilent ktheheshin në Medine”.²

Fjala e Allahut **«Ata nuk kanë besuar»** përfshin ata që u përmendën me cilësitë e tyre në fillim të ajetit. Ata nuk besuan me iman të pastër sepse në zemrat e tyre fshihnin kufrin dhe nifakun, në kundërshtim me veprat e jashtme të cilat dëshmojnë për iman.³

Allahu ﷻ thotë: **«Ata të cilët presin të shfrytëzojnë rastin dhe nëse vjen çlirimi i Allahut thotë: Ne ishim me ju, e nëse qafirët kanë pjesë në fitore u thonë: A nuk ju përkrahëm dhe ju ruajtëm prej besimtarëve. Allahu ka për të gjykuar mes tyre në ditën e gjykimit. Allahu nuk ka për t’u dhënë asnjë shans qafirëve kundër besimtarëve. Munafikët përpiqen të mashtrojnë Allahun por Allahu i mashtron ata»** En nisa, 142.

Dhe thotë: **«Disa njerëz thonë: Besuam Allahun, por kur sprovohet për Allahun e konsideron sprovën e njerëzve njësoj si dënimi i Allahut. Nëse vjen fitore prej zotit tënd do të thonë: Ne ishim me ju. A nuk është Allahu më i ditur për atë që fshihet në zemrat e njerëzve?»** El ankebut 10.

¹ Mexhmu’ul fetaua, 28/438.

² Mexhmu’ul fetaua, 28/455.

³ Tefsiri i Sheukanit.

E shumë ajete të tjera që dëshmojnë se braktisja e xhihadit në rrugë të Allahut, pa justifikim të pranuar në shariat dhe pengimi i njerëzve prej xhihadit dhe prej përkrahjes së muxhahidave me shpifje dhe fabrikime të kota, është cilësi e munafikëve dhe shenjë që dëshmon për prishjen e zemrës.

Këty hyjnë edhe ata që ndihmojnë tagutët zullumqarë duke i përkrahur me fetva të kota kundër muslimanëve dhe muxhahidave. Ata që nuk kursejnë asnjë fjalë kundër muxhahidave. Ata që i tmerrojnë njerëzit prej tyre, duke i servirur ata si fitneshin, kriminelë dhe duke e servirur xhihadin e tyre si një gjynah të madh dhe se muxhahidat vendin e kanë në xhehenem dhe përfundimi i tyre do të jetë shumë i keq. E shumë e shumë shprehje të tjera që u shërbejnë tagutëve. Këta njerëz, edhe nëse shfaqen si muslimanë, të mos kujtojnë se besimi i tyre nuk është prekur, sepse ata janë më pranë kufrit dhe nifakut se kushdo tjetër.

Historia e Belamit, i cili u largua prej ajeteve të cilat Allahu ia dhuroi, për shkak të lutjes që bëri për qafirët nga populli i tij kundër muslimanëve, është një mësim i mirë për atë që dëshiron të marrë mësim. Allahu ﷻ thotë: **«Lexoju atyre historinë e atij që i dhamë ajetet tona por u largua prej tyre dhe ndoqi shejtanin dhe u bë prej të humburve. Nëse do të dëshironim kishim për ta ngritur lart me ajetet tona, por ai lakmoi këtë bote dhe ndoqi epshin e tij. Shembulli i tij është si shembulli i qenit, nëse e përzë nxjerr llapën e nëse e lë rehat prap e nxjerr llapën. Ky është shembulli i atyre që përgënjeshtrojnë ajetet tona, prandaj rrëfeju historinë se mbase përkujtojnë»** El araf, 175-176.

Këtyre njerëzve u shkon përshtat fjala e profetit: **“Ai prej të cilit më shumë frikësohem për umetin tim është munafiku orator”**.¹

Allahu thotë: **«Kur t’u largohet frika, ju rrjepin me gjuhë ashpërsisht. Kurrnacë për mirësinë»** El ahzab 19.

Ibn Tejmije thotë: *“Fjalët e ashpra me gojët e tyre janë disa llojesh:*

Nganjëherë munfikët u thonë besimtarëve: Kjo që na ndodhi ishte prej tersit tuaj. Ju i thirrët njerëzit në këtë fe dhe luftuat për të dhe i kundërshtuat njerëzit. Këto fjalë munafikët ua thoshin sahabëve.

Ndonjëherë thonë: Ju na këshilluat që të qëndrojmë deri tani këtu në këtë vend lufte. Nëse do kishim emigruar më përpara nuk kishte për të na ndodhur asgjë.

Ndonjëherë u thonë: E shikoni që jeni pak dhe të dobët dhe prap doni ta mposhni armikun. A feja juaj ju mashtrroi? Allahu thotë: «Kur munafikët dhe ata që në zemra kanë sëmundje thanë: Këta i ka mashtruar feja e tyre. E nëse i mbështeteni Allahut ai është i fuqishëm dhe i urtë». El enfal 49.

Ndonjëherë thonë: Ju jeni budallenj dhe pa logjikë. A mos doni t’i shkatërroni vetet

¹ E transmeton Ahmed i dhe të tjerë. Es silsiletus sahiha, 1013.

dhe njerëzinë?

*Ndonjëherë thonë fjalë shumë ofenduese, megjithëse kur vihen në lojë përfitimet materiale janë dorështrënguar, pra për pasurinë dhe plaçkën e luftës që e keni fituar nuk lëshojnë pe”.*¹

13- Shenja të tjera në vepra që dëshmojnë për prishjen e brendësisë.

Është saktësuar se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Kush i ka katër gjëra ai është munafik i pastër dhe kush ka një të njërin prej tyre ai ka një degë prej nifakut derisa ta lerë atë; kur flet gënjen, kur jep besën tradhton, kur premton nuk e përmbush dhe kur zihet ofendon”.**² Në një rivajet të Muslimit thuhet: **“Edhe nëse agjëron dhe falet dhe pretendon se është musliman”.**

Profeti e konsideroi bashkimin e këtyre degëve të nifakut te një person të vetëm, argument për nifakun dhe prishjen e brendësisë së tij edhe nëse pretendon se është musliman dhe falet e agjëron.³

Dalja prej xhamisë pas thirrjes së ezanit pa asnjë shkak është shenjë e nifakut. I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Kush e arrin ezanin në xhami dhe pastaj del pa asnjë nevojë dhe nuk dëshiron të rikthehet ai është munafik”.**⁴

Braktisja e tre namaze xhumaje pa arsye. I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Kush i lë tre xhuma pa asnjë arsye ai shkruhet prej munafikëve”.**⁵ Në një rivajet tjetër thuhet: **“E ka hedhur islamin pas shpine”.**⁶

Ibn Umeri ؓ thoshte: **“Kur nuk e shikonim një njeri për sabah dhe jaci mendonim keq për të”.**⁷ Pra dyshonim për nifak, sepse përtesa për namazin e sabahut dhe jacisë në xhami është prej shenjave të munafikëve, të cilët kur ngrihen për namaz ngrihen gjithë përtesë.

Nëse e braktis namazin e xhumasë tre herë shkruhet prej munafikëve dhe e ka hedhur islamin pas shpine. Nëse përton për faljen e namazit të sabahut dhe jacisë akuzohet me nifak

¹ Mexhmū’ul fetaua, 28/457-458. Them: Me preteksin e urtësisë, maturisë, logjikës, ruajtjes së nderit, ruajtjes prej fitnes, sot dëgjojmë shumë njerëz që në pamje të jashtme janë shumë fetarë mirëpo u drejtohen muxhahidëve këto shprehje _që janë shenjë e nifakut_ ose më tepër.

² E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

³ Po nëse këto degë bashkohen te ai që as falet dhe as agjëron _të cilët janë shtuar në këtë kohë_ çfarë mund të themi?!

⁴ Sahihut tergib uet terhib, 259. Këto punë edhe nëse janë shenjë e nifakut dhe prishjes së zemrës dhe ndihmojnë për dallimin e munafikëve mirëpo ato nuk janë të mjaftueshme për të gjykuar me kufër mbi personin dhe daljen prej islamit, prandaj bëj kujdes.

⁵ Sahihut tergib uet terhib, 731.

⁶ Sahihut tergib uet terhib, 735.

⁷ Sahihut tergib uet terhib, 414.

dhe mendohet keq për të. Po nëse e braktis namazin tërësisht dhe nuk falet për Allahun kurrë?! Padyshim që ky është kufër dhe nifak më i qartë.

I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Mes robit dhe kufrit dhe shirkut është lënia e namazit”**.¹

Dhe thotë: **“Mes kufrit dhe imanit është lënia e namazit”**.²

Dhe thotë: **“Besa që është mes nesh dhe mes tyre është namazi. Kush e lë atë ka bërë kufër”**.³

Dhe thotë: **“Mes robit dhe kufrit dhe imanit është namazi. Nëse e lë atë ka bërë shirk”**.⁴

I dërguari i Allahut ﷺ e konsideroi braktisjen e namazit shenjë që dëshmon për kufirin dhe besimin e prishur dhe zbrazen e zemrës prej imanit dhe lënësi i saj konsiderohet qafir dhe mushrik.

Abdullah ibn Shakik Ukaliu ؓ ka thënë: **“Sahabët e Muhamedit nuk shikonin se lënia e ndonjë veprë është kufër përveç namazit”**.⁵

Ibn Tejmije për lënësin e namazit thotë: **“Shumica e selefit mendojnë se ai vritet si qafir dhe e gjithë kjo nëse ai e pohon se namazi është vaxhip”**.⁶

Dhe thotë: **“Nëse njeriu refuzon të falet derisa të vritet, atëhere edhe në brendësinë e tij nuk e beson namazin për vaxhip dhe as mendon se duhet falur. Ky njeri është qafir me pajtimin e të gjithë muslimanëve. Fjalët e selefit për kufirin e këtij njeriu janë shumë të njohura dhe për këtë kanë dëshmuar argumentet e sakta”**.⁷

Shiko se si e konsideroi refuzimin e faljes së namazit derisa të vritet shenjë që dëshmon për kufirin në zemër dhe hapjen e gjoksit ndaj kufrit edhe nëse nuk shprehet me gojë se e mohon obligimin e namazit.

Shkurtimisht, bazuar në argumentet e përmendura, kënaqësia dhe aprovimi është një çështje e fshehtë (e brendshme) që ndonjëherë mësohet prej vetë fjalëve të personit dhe ndonjëherë prej veprave të gjymtyrëve që dëshmojnë për të. Argumentimi me këto shenja për atë që ndodhet në zemër ndryshon nga shenja në shenjë. Disa janë më të qarta e disa më pak

¹ E transmeton Nesaiu dhe të tjerë. Sahihut tergib uet terhib, 563.

² E transmeton Tirmidhiu.

³ E transmeton Ahmedi, Ebu Daudi, Nesaiu, Tirmidhiu dhe të tjerë. Sahihut tergib uet terhib, 564.

⁴ E transmeton Taberiu. Sahihut tergib uet terhib, 565.

⁵ E transmeton Tirmidhiu dhe të tjerë. Sahihut tergib uet terhib, 564. Them: Ai ka për qëllim kufirin e madh që të nxjerr prej islamit sepse sahabët e kanë konsideruar lënien e disa veprave përveç namazit si kufër i vogël dhe kufër veprash. Gjykimin për lënësin e namazit e kemi shpjeguar më gjerësisht në një libër të veçantë.

⁶ Mexhmu’ul fetaua, 28/308.

⁷ Mexhmu’ul fetaua, 22/48.

të qarta. Me këto vepra argumentohemi edhe nëse personi nuk shprehet hapur me fjalë për akiden dhe besimin që ka në zemër, sepse shenjat dëshmuese për gjendjen dhe veprat e këtij personi janë më domethënëse se fjalët e tij. Kjo çështje nuk ka asnjë kundërshtim mes ehli sunetit dhe xhematit të cilët thonë se imani është besim me zemër, fjalë dhe veprë.



Rregulli i katërt: Çdo pengesë për shpalljen qafir konsiderohet pengesë edhe për dënimin, por jo çdo pengesë prej dënimit konsiderohet pengesë për tekfirin (shpalljen qafir).

Më parë u përmend se rregulli konsiderohet i saktë atëhere kur bazohet në baza dhe argumente prej shariatit në të gjitha pikat e tij. Është e drejtë e hulumtuesit dhe lexuesit të mos e marrë parasysh një rregull, sidomos nëse ka lidhje me akiden dhe bazat e fesë, derisa të njihet me argumentet e shariatit që dëshmojnë për të. Në vijim po paraqesim disa argumente që dëshmojnë për vërtetësinë e këtij rregulli.

Fjala: **“Çdo pengesë për shpalljen qafir konsiderohet pengesë edhe për dënimin”** në dynja dhe ahiret, vërtetohet me argumentet e mëposhtëme:

1- Padija.

Transmetohen shumë argumente që dëshmojnë se kush bie në kufër prej padijes, të cilën nuk ka mundësi ta shmangë, kjo padije e pengon dënimin e tij në dynja dhe ahiret, derisa t'i sqarohet argumenti i shariatit, i cili e largon padijen dhe e largon pamundësinë e kuptimit të argumentit të cilin e ka kundërshtuar.

Allahu thotë: **﴿Nuk kemi për të dënuar derisa të dërgojmë të dërguar﴾** El isra, 15.

Dhe thotë: **﴿Të dërguar përgëzues dhe qortues që njerëzit të mos kenë asnjë argument kundër Allahut pas dërgimit të profetëve dhe Allahu është i fuqishëm dhe i urtë﴾**. En nisa, 165.

Dhe thotë: **﴿Allahu nuk e ngarkon askënd me atë që nuk ka mundësi﴾** El Bekare, 286.

Dhe thotë: **﴿Ruajuni Allahut aq sa keni mundësi﴾** Et tegabun, 16.

Prej Esued ibn Seriut ؓ prej profetit ﷺ thotë: **“Katër persona justifikohen në ditën e ringjalljes; shurdhi i cili nuk dëgjon asgjë, i çmenduri, plaku i shkuar në moshë dhe ai që vdes në fetra. Shurdhi thotë: O Zot! Islami erdhi por unë nuk dëgjoja asgjë. I çmenduri thotë: O Zot! Islami erdhi por unë nuk logjikoja asgjë. Ndërsa ai që ka vdekur në fetra thotë: O Zot! Nuk më ka ardhur asnjë i dërguar prej teje. Pastaj Allahu merr besën e tyre se do t'i binden atij, pastaj i urdhëron që të hyjnë në zjarr. Kush hyn, do ta gjejë atë të ftohtë dhe paqe, e kush nuk hyn hidhet në të”**.¹

Këta katër lloje njerëzish përfshihen në padijen e pashmangëshme, e cila i pengoi prej kuptimit të argumenteve edhe pse secili lloj justifikohet për padijen me shkaqe të ndryshme.

¹ E transmeton Ahmedi dhe të tjerë, Sahih el xhami es sagir, 881.

Ata që i kërkuan profetin ﷺ, kur ishin akoma të rinj në islam, t'u bënte një *“Dhatu enuat”* njësoj siç kishin mushrikët dhe profeti ﷺ u tha: *“Allahu ekber! Pasha atë në dorën e të cilit është shpirti im keni thënë njësoj siç i thanë izraelitët Musait: Na cakto një ilah (të adhuruar) ashtu siç kanë ata të adhuruar. Tha: Ju jeni popull i paditur. Keni për t'i ndjekur rrugët e atyre që kanë qënë para jush”*.¹

Shejh Sulejman Ali Shejhu në librin “Tejsirul azizil hamid” thotë: *“Në këtë histori ka argument se fjala “ilah” e ka kuptimin “i adhuruar” dhe ka argument se kush dëshiron të veprojë shirk padije por kur ndalohej, heq dorë prej tij, ai nuk bën kufër ...”*.

Padija e tyre ishte për shkak se ishin akoma të rinj në islam dhe kjo padije nuk mund të shmanget prandaj ata nuk i kap dënimi i kufirit.

Këtu hyn edhe fjala e Muavije ibn Hakem Silmiut ؓ kur i tha profetit ﷺ: *“Ne jemi një popull sapo jemi shkëputur prej xhahilijetit dhe Allahu na udhëzoi në islam por disa prej nesh shkojnë te fallxhorët. I tha: Mos shko te ata”*.²

Duke ditur që profeti ﷺ ka thënë për atë që shkon te fallxhorët: *“Kush shkon te ndonjë falltor dhe e beson atë për atë që thotë, ai ka bërë kufër me atë që i është zbritur Muhamedit”*. Në një rivajet tjetër thuhet: *“Ai është distancuar prej asaj që i është zbritur Muhamedit”*.

Profeti ﷺ nuk e zbatoi këtë kërcënim të madh mbi ta sepse ata shkonin te fallxhorët prej padijes, ngaqë ishin akoma të rinj në islam dhe profeti ﷺ nuk i tha Muavijes ؓ: Ti dhe populli yt jeni qafirë dhe jeni të distancuar prej meje, por e mësoi dhe i sqaroi argumentin e sheriatit dhe i tha: Mos shko te ata.

Adij ibn Hatim ؓ kur vajti te profeti ﷺ pasi ishte bërë musliman me një kryq ari të varur në qafë, i dërguari i Allahut ﷻ u mjaftua me fjalën: *“O Adij! Flake këtë put prej qafës”*, por nuk e shpalli qafir për shkak të varjes së kryqit në qafë dhe as nuk e urdhëroi të hynte në islam sërish, sepse ai e veproi këtë prej padijes, për shkak se ishte akoma i ri në islam.

Argumentet për justifikimin me padije janë të shumtë. Ato i kemi shpjeguar më gjerësisht në libra të tjerë. Këtu po mjafohemi vetëm me disa argumente që dëshmojnë për pjesën e parë të këtij rregulli **“Çdo pengesë për shpalljen qafir konsiderohet pengesë edhe për dënimin”**.

2- Keqinterpretimi.

Prej pengesave të tekfirit që pengojnë prej dënimit është edhe keqinterpretimi i pranuar si justifikim në shariat. Kush kundërshton shariatin për shkak të keqinterpretimit, atë

¹ E transmeton Tirmidhiu dhe ibn Ebi Asim në librin “Es sunneh” dhe shejh Albani e ka konsideruar sahih.

² Sahih sunen Ebi daud, 823.

nuk e kap dënimi.¹

Sahabiu dhe pjesmarrësi në betejën e Bedrit, Kudame ibn Medhuni ؓ dhe shokët e tij, gabuan në interpretimin e fjalës së Allahut: **«Ata që kanë besur dhe vepruar vepra të mira nuk kanë asnjë gjynah për atë që kanë nëse ruhen (prej Allahut) dhe besojnë dhe veprojnë vepra të mira»**. El maide, 93. Ai e lejoi pirjen e verës duke u bazuar në faktin se ata ishin prej atyre që besuan dhe vepruan vepra të mira, prandaj dhe nuk e ka haram verën. Ky është kufër, mirëpo keqinterpretimi i gabuar i ajetit pengoi prej shpallej së tij si qafir dhe e rrëzoi dënimin. Prandaj sahabët u pajtuan në një menje se duhet t'i kërkohet pendim dhe t'i ngrihet argumenti i sheriatit, e nëse këmbëngul atëhere vritet si qafir dhe murted, sepse ka ndërruar fe dhe ka lejuar atë që Allahu e ka bërë haram.

Faktikisht ai u pendua shumë prej këtij gjynahu aq sa Umeri ؓ i dërgoi një letër ku i shkruante: Nuk e di cili është gjynah më i madh; lejimi i haramit më përpara apo humbja e shpresës prej mëshirës së Allahut tani?!

Edhe gabimi i Hatib ibn Ebi Beltas ؓ, kur u shkruajti kurejshëve për nisjen e ushtrisë së profetit ﷺ në drejtim të Mekës. Kjo vepër konsiderohet përkrahje e mushrikëve kundër muslimanëve, mirëpo ai u bazua në një interpretim të gabuar, duke kujtuar se kjo nuk e dëmton imanin dhe islamin e tij dhe ishte i sigurtë në interpretimin e tij. Ai kujtoi se me këtë vepër nuk binte në ridde dhe as në kufër. Atëhere profeti e fali dhe nuk gjykoji mbi të as me kufër dhe as me nifak, me të cilën Umeri e akuzoi dhe i kërkoi leje profetit ta vriste.

Ibn Haxheri thotë: *“Justifikimi i Hatibit ishte për shkak të asaj që i përmendi profetit, se ai e veproi këtë duke u bazuar në keqinterpretim dhe duke kujtuar se kjo nuk përbën dëm”*.²

Po kështu edhe interpretimi i gabuar i Adij ibn Hatimit ؓ në lidhje me ajetin **«hani dhe pini derisa të dallohet peri i bardhë nga peri i zi prej agimit»** dhe lidhi në këmbë dy penj; një të bardhë dhe një të zi dhe hante e pinte derisa t'i dallonte, derisa profeti e sqaroi se bëhej fjalë për dritën e ditës dhe errësirën e natës. Por nuk e qortoi dhe as nuk e konsideroi gjynahqar për këtë interpretim të gabuar, madje as nuk e urdhëroi ta përsëriste agjërimit megjithëse ai vazhdonte të hante syfyr edhe pas shfaqjes së agimit.

Bazuar në këto argumente themi se interpretimi i gabuar që mund të pranohet në aspektin sheriatik dhe atë gjuhësor konsiderohet pengesë prej pengesave të tekfirit dhe pengesë prej pengesave të dënimit për gjynahun, për një person të caktuar.

¹ Interpretimi i gabuar mund ta rrëzojë dënimin në dynja dhe ahiret, por në disa raste ai është vetëm pengesë prej mosshpalljes qafir mirëpo nuk e rrëzon dënimin dhe ndëshkimin dhe në disa raste pengon edhe kufrin dhe dënimin dhe çdo pasojë tjetër. Gjithashtu jo çdo keqinterpretim i fshin gabimet dhe e rrëzon dënimin. Kjo varet nga lloji i keqinterpretimit, nga forca dhe pranimit i tij në shariat në aspektin e logjikës dhe gjuhës, prandaj tregohu i kujdesshëm.

² Fethul bari, 8/503.

3- Imponimi.

Imponimi është pengesë për shpalljen qafir të një personi të caktuar dhe pengesë prej dënimit dhe gjynahut sepse Allahu thotë: **﴿Kush bën kufër me Allahun pas imanit të tij përveç atij që imponohet dhe zemra e tij është e qetësuar me iman﴾** En nahl 106.

Në hadithin e saktë thuhet: *“Allahu ja ka falur umetit tim gabimin (e paqëllimtë), harresën dhe atë për të cilën imponohen”*.¹

4- Gabimi i paqëllimshëm dhe lapsusi.

Kush bie në kufër gabimisht dhe paqëllim justifikohet për këtë kufër, si për dënimin ashtu edhe për gjynahun. Si ai që i humbi shpresat për devenë e humbur dhe kur e gjeti përpara syve tha gjithë gëzim: “O Allah! Ti je robi im dhe unë jam zoti yt. Gaboi prej gëzimit të madh”. Njeriu nuk ndëshkohet për këtë lloj gabimi sepse nuk ka pasur qëllim.

Allahu thotë: **﴿Nuk merrni gjynahe për atë që gaboni (paqëllim) por për atë që zemra juaj e vepron qëllimisht dhe Allahu është falës dhe mëshirues﴾** El ahzab, 5.

Me argumentet e përmendura u vërtetua pjesa e parë e këtij rregulli **“Çdo pengesë për shpalljen qafir konsiderohet pengesë edhe për dënimin”**. Mbetet të sqarohen argumentet për pjesën e mbetur të rregullit: **“jo çdo pengesë prej dënimit konsiderohet pengesë për tekfirin (shpalljen qafir)”** të cilat janë si mëposhtë:

1- Veprat e mira: Veprat e mira i fshijnë gjynahet dhe e rrëzojnë dënimin sepse Allahu thotë: **﴿Fale namazin në dy skajet e ditës dhe gjatë natës. Veprat e mira i fshijnë të këqijat. Ky është përkujtim për ata që përkujtojnë﴾** Hud 114.

Profeti ﷺ ka thënë: *“Pasoje të keqen me një të mirë që ta fshijë atë”*.

Prej Enesit ؓ thotë: *Një person erdhi te i dërguari i Allahut dhe i tha: O i dërguar i Allahut! Kam bërë një gjynah që meriton ndëshkim prandaj më ndëshko. Pastaj hyri namazi dhe i dërguari i Allahut u fal. Pasi e kreu namazin i tha: O i dërguar i Allahut! Kam bërë një gjynah që meriton ndëshkim prandaj më ndëshko sipas librit të Allahut. I tha: A e fale namazin me ne? I tha: Po. I tha: Allahu ta ka falë”*.

Në një transmetim tjetër thuhet: *“Kur dole prej shtëpisë a morre abdes në mënyrë të përkryer? I tha: Po o i dërguar i Allahut! I tha: Pastaj e fale namazin me ne? I tha: Po o i dërguar i Allahut! Atëhere i dërguari i Allahut i tha: Allahu ta ka falur ndëshkimin ose*

¹ E transmeton imam Ahmedi dhe të tjerë. Sahihul xhami’is sagir, 1731.

tha: dënimin".¹

Dhe thotë: *"Çdo musliman që e përkryen abdesin pastaj ngrihet të falet dhe përqëndrohet në atë që thotë ai kthehet si ditën kur e ka lindur nëna*".²

Dhe thotë: *"Pesë namazet i fshijnë gjynahet ashtu siç e pastron uji pisllekun*".³

Dhe thotë: *"Hixhreti i fshin gjynahet para tij dhe haxhi i fshin gjynahet para tij*".⁴

Dhe thotë: *"Një qen po vërtitej rreth një pusi dhe etja gati po e vriste kur një lavire prej lavireve izraelite e pa dhe zbathi këpucën e saj dhe i dha të pijë dhe Allahu e fali*".⁵

E shumë argumente dhe hadithe të tjera që dëshmojnë se veprat e mira i fshijnë gjynahet dhe pengojnë prej dënimit të tij në ahiret.

Mirëpo a e pengojnë veprat e mira dënimin e kufrit nëse bie në kufër?

Them: Sado të mëdha të jenë veprat ato nuk e mbrojnë prej shpalljes qafir nëse bie në kufër dhe atë e përfshin dënimi i kufrit dhe rrjedhojat e tij si në dynja ashtu edhe në ahiret.

Veprat e mira fshijnë gjynahet që janë më të vogla se kufri dhe shirkun, ndërsa kufrin dhe shirkun nuk e fshijnë dot, sepse Allahu thotë: **﴿Atij që i bën shirk Allahut, Allahu ia ka bërë haram xhenetin﴾** Al maide, 72. Dhe thotë: **﴿E nëse bën shirk, ka për t'u zhvlerësuar e gjithë vepra jote dhe ke për të qënë prej të humburve﴾** Ez zumer, 65. Dhe thotë: **﴿E nëse do të bënin shirk kishin për t'u rënë poshtë e gjithë ajo që kishin punuar﴾** El enam, 88. Dhe thotë: **﴿Ju afruam asaj që kishin punuar dhe e bëmë pluhur e hi﴾** El furkan, 23.

Nëse thuhet: A përfshihet këtu edhe e mira e teuhidit?!

I themi: Edhe mirësia e teuhidit përfshihet vetëm në rast se teuhidi i tij e mohon shirkun dhe kufrin tërësisht. Vetëm kështu teuhidi i bën dobi praktikuesit dhe e shpëton prej dënimit. Vepra e teuhidit dhe e keqja e shirkut nuk mund të përfytyrohen së bashku në zemrën e njeriut. Teuhidi në disa gjëra dhe bërja shirk në gjëra të tjera, është në teuhid i pavlerë dhe është njësoj sikur nuk ekziston fare. Nuk mund të supozohet ekzistenca e teuhidit dhe shirkut sëbashku sepse ato hedhin poshtë njëri-tjetrin dhe kjo çon në pranimin e ekzistencës së diçkaje dhe të asaj që e rrëzon atë.

I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: *"Nuk bashkohen imani me kufrin në zemrën e një personi të vetëm*".⁶

Dhe thotë: *"Allahu thotë: O bir i Ademit! Për sa kohë më adhuron mua dhe*

¹ E transemeton Muslimi.

² Sahihut tergib uet terhib, 547.

³ E transemeton Ahmed. Sahih el xhami es sagir, 1668.

⁴ E transemeton Muslimi.

⁵ E transemeton Buhariu dhe Muslimi.

⁶ Es silsiletus sahiha, 1050.

*shpreson prej meje pa më bërë shok kam për të të falur sipas punëve që ke kryer. Nëse më takon me gabime e gjynahe sa qielli dhe toka kam për të të takuar me falje sa qielli dhe toka dhe do të fal pa më interesuar fare”.*¹

Dhe thotë: *“Dy gjëra janë obliguese. Një person i tha: Çfarë janë obligueset? I tha: Kush vdes dhe nuk i bën shok Allahut do të hyjë në xhenet dhe kush i bën shok Allahut do të hynë në zjarr”.*²

Maksimumi që mund të themi është se veprat e mira të shumta dhe të mëdha ndikojnë në përmisimin e përshtypjes për njeriun dhe arsyetimin e tij nëse kufri është i dyshimtë dhe mund të kuptohet ndryshe. Ato ndikojnë edhe në faljen e gjynaheve dhe rrëshqitjeve të cilat nuk e arrijnë gradën e kufrit të qartë. Siç ndodhi me Hatib ibn Ebi Beltan ؓ kur u shkruajti kurejshve, të cilit i doli në ndihmë vepra e mirë e luftimit në Bedër për të cilën profeti tha: *“Allahu i vështroi pjesmarrësit e Bedrit dhe u tha: Veproni çfarë të doni sepse ua kam falur”.*³

2- Sprovat.

Sprovat i fshijnë gjynahet dhe nuk dënohet për to siç thuhet në hadith: *“Besimtarit i falen gjynahet sa herë që sprovohet me sëmundje dhe lodhje, sa herë që e kap merakun, stresi dhe hidhërimi, madje edhe nëse e shpon gjembi”.*⁴

Dhe thotë: *“Nëse robi arrin te Allahu një gradë që nuk e ka arritur më parë Allahu e sprovon në trupin e tij, ose në pasurinë e tij, ose në fëmijën e tij, e pastaj i jep durim derisa ta arrijë atë gradë”.*⁵

Dhe thotë: *“Për çdo gjë që e godet dhe e mundon besimtarin në trupin e tij, Allahu i shlyen atij gjynahe”.*⁶

Dhe thotë: *“Allahu thotë: Nëse e sprovov një rob besimtar prej robërve të mi dhe më falenderon dhe duron në sprovën me të cilën e kam sprovuar, ai ngrihet prej shtratit me gjynahe si ditën kur e ka lindur nëna. Zoti u thotë melekëve që e ruajnë: Unë e pengova dhe e sprovova robin tim prandaj shkruajani shpërblimin që e shkruanit më përpara kur ishte i shëndoshë”.*⁷

Mirëpo a ja fshijnë sprovat gjynahun e kufrit dhe nuk dënohet për të as në dynja dhe as në ahiret? Padyshim që jo, sepse sado e madhe që të jetë sprovat, ajo nuk mund t’ia fshijë

¹ E transemeton Taberani, Sahihul xhami, 4341.

² E transmeton Muslimi.

³ E transmeton Buhariu.

⁴ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

⁵ Sahih sunen Ebi Daud, 2649.

⁶ Es silsiletus sahiha, 2274.

⁷ Es silsiletus sahiha, 2009. Them: Veprat e mira dhe sprovat sado të mëdha që të jenë nuk e fshijnë gjynahun e shirkut sepse atë e fshin vetëm pendimi dhe kërkimi i faljes dhe plotësimi i teuhidit.

kufirin dhe as ta ruaj prej dënimit të tij. Argumentet e përmendura më parë dëshmojnë se shirku e rrëzon dhe zhvlerëson të gjithë punën dhe të mirat e njeriut.

Pra durimi i sprovave e ruan njeriun prej dënimit të gjynaheve që janë më të vogla se kufri dhe shirku.

Mirëpo mund të themi se ai që sprovohet për hir të Allahut dhe i bën ballë kësaj sprove me sabër, duke u kapur fort me të vërtetën, atij i fshihen gjynahet dhe duhet të tregohemi më dorlëshuar në justifikimin e tij nëse gjejmë se ai ka rënë në një kufër që është i dyshimtë dhe mund të kuptohet ndryshe.

3- Shefati (ndërmjetësimi).

Prej shkaqeve të rrëzimit të dënimit është edhe shefati në ditën e gjykimit. Por a bën dobi shefati prej dënimit të kufirit dhe shirkut nëse ai ka qënë mushrik dhe qafir?

Padyshim që jo, sepse shefati përfshin vetëm atë që ka vdekur në teuhid, ndërsa për atë që ka vdekur në kufër dhe shirk nuk bën shefat askush dhe as nuk i bën dobi shefati.

Allahu thotë për mushrikët: **«Atyre nuk u bën dobi shefati i ndërmjetësuesve»** El mudethir, 48. Dhe thotë: **«Ata nuk kanë asnjë ndërmjetësues dhe as shok të ngushtë»** Esh shuara.

Në hadithin e saktë profeti ka thënë: **“Më është dhënë shefati dhe ai do të përfshijë këdo që nuk i bën Allahut shirk asgjë”**.

Dhe thotë: “Njeriu më i lumtur prej shefatit tim në ditën e gjykimit është ai që thotë: La ilahe il-lallah me sinqeritet prej zemrës”.¹

Dhe thotë: “Shefatin tim për gjynahqarët e mëdhenj prej umetit tim e kam vonuar për në ditën e gjykimit”.²

Në ditën e gjykimit, përveç profetëve, do të bëjnë shefat edhe melekët, shehidët dhe robërit e devotshëm, të cilëve Allahu u jep leje për shefat.

Shkurtimisht, shefati e rrëzon dënimin e gjynaheve që janë më të vogla se kufri dhe shirku, ndërsa ai që ka bërë shirk dhe kufër nuk i bën dobi shefati aspak.

4- Pendimi dhe kërkimi i faljes.

Pendimi i fshin gjynahet dhe e rrëzon dënimin. Allahu thotë: **«përveç atij që pendohet dhe beson dhe punon vepra të mira dhe këta do të hyjnë në xhenet dhe nuk do t’u bëhet padrejtësi asgjë»** Merjem 60. Dhe thotë: **«përveç atyre që pendohen dhe veprojnë vepra të mira dhe e shfaqin (besimin e tyre) atyre ua pranoj pendimin dhe unë**

¹ E transmeton Buhariu.

² E transemtan Ibn Ebi Asim në “Es sunneh” dhe shejh Albani e ka konsideruar sahih në shqyrtimin që i ka bërë këtij libri.

jam pranues i pendimit dhe i mëshirshëm El bekare 160. Dhe thotë: **«Allahu nuk do t'i dënojë ata kur ti je në mesin e tyre dhe nuk do t'i dënojë ata përderisa kërkojnë falje»** El enfal 33.

Nëse thuhet: Pendimi i fshin të gjitha gjynahet e mëparshme, duke përfshirë edhe shirkun me kufrin dhe e rrëzon dënimin e tyre. Prandaj kush pendohet prej kufrit ai është si ai që nuk e ka vepruar gjynahun e kufrit.

I themi: Pendimi e fshin kufrin dhe dënimin e tij pas pendimit por para pendimit ai vazhdon të quhet qafir dhe është i rrezikuar me dënimin e kufrit. Pra pendimi e largon kufrin vetëm atëhere kur e vepron atë një person i caktuar, prandaj dhe e kemi konsideruar si pengesë prej dënimit prej gjynaheve dhe jo pengesë prej pengesave të tekfirit dhe Allahu është më i ditur.

5- Shkaqe të tjera. Ekzistojnë edhe shkaqe të tjera si lutja e besimtarëve dhe kërkimi i faljes për të pas vdekjes, veprat e mira të cilat i dhurohen personit pas vdekjes, sadakatë që nxirren në emër të tij, haxhi, umra etj. Prej tyre është edhe dënimi i varrit. Për të gjitha këto kanë ardhur argumente të sakta dhe të qarta se ato e pengojnë dënimin e gjynaheve por nuk pengojnë dënimin e kufrit dhe nuk konsiderohen pengesë prej shpalljes qafir.

Transmetohet në hadithin e Abdullah ibn Amrit ؓ se As ibn Vaili ؓ porositi që të liroheshin njëqind rob në emër të tij (pas vdekjes) dhe i biri i tij Hishami liroi 50 rob, ndërsa biri tjetër Amri deshi të lironte 50 robërit e tjerë por pastaj tha: Më mirë të pyes profetin. Vajti te profeti dhe i tha: **“Nëse ka qënë musliman dhe lironi robër në emër të tij dhe jepni sadaka në emër të tij dhe bëni haxh në emër të tij, atij ka për t'i arritur (kjo punë e mirë)”**.¹ Pra nëse ka vdekur në kufër dhe shirk nuk i bën dobi anjëra prej këtyre veprave.

Shkurtimisht themi se këto argumente dëshmojnë për saktësinë e këtij rregulli: “Cdo pengesë për shpalljen qafir konsiderohet pengesë edhe për dënimin, por jo cdo pengesë prej dënimit konsiderohet pengesë për tekfirin (shpalljen qafir). Falenderimi i takon Allahut me mirësinë e të cilit përmbushen veprat e mira dhe devotshmëria.



¹ Sahih sunen Ebi Daud, 2507.

Rregulli i pestë: Për kufirin dhe imanin, merret në konsideratë pamja e jashtme.

Gjykimi me iman dhe kufër për një person bazohet në pamjen të jashtme të tij. Nëse e shfaq kufirin, pa shkaqe penguese në shariat, gjykohet mbi të me kufër dhe nëse e shfaq imanin gjykohet për të me iman, pa hulumtuar brendësinë e tij dhe pa kërkuar në realitetin e zemrës së tij. Brendësinë e zemrave e njeh vetëm i dituri i gajbit prandaj dhe gjykimet bazohen në pamjen e jashtme, në veprat dhe fjalët e personit.

Argumentet për këtë rregull janë të shumta, prej tyre:

Fjala e profetit ﷺ: ***“Jam urdhëruar t’i luftoj njerëzit derisa të dëshmojnë se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Allahut, ta falin namazin dhe ta japin zekatin. Nëse e vepronë këtë kanë siguruar prej meje gjakun dhe pasuritë e tyre përveç me të drejtën e islamit dhe llogaria e tyre i takon Allahut”***.¹

Veprat e përmendura në këtë hadith janë të dukshme, shikohen me sy dhe dëgjohen me vesh. Kush i kryen ato cilësohet si musliman. Pasuria dhe gjaku i tij konsiderohen të mbrojtura dhe sillemi me të si musliman.

Ibn Tejmije thotë: *“Kuptimi i këtij hadithi është se unë jam urdhëruar të pranoj prej tyre faljen e namazit në pamje të jashtme dhe ta kthejë brendësinë e tyre te Allahu. Profeti ﷺ nuk i zbatonte ndëshkimet e shariatit bazuar në dijen e tij ose në fjalën e një personi të vetëm, madje as bazuar në njohjen e tyre prej shpalljes, por bazohej në prova dhe fakte derisa të vërtetohej shkaku i ndëshkimit me fakte ose me pranim të akuzës prej fajtorit. A e shikon se si profeti ﷺ tha për gruan që kishte bërë “mulaenah” nëse fëmija do të lindë me këtë dhe atë cilësi, atëhere ai është i atij për të cilin je akuzuar. Dhe fëmija lindi me cilësitë e urryera atëhere i dërguari i Allahut ﷺ tha: **“Sikur të mos ishte imani kisha për të vepruar me të ndryshe”**. Dhe tha për një grua që vepronte vepra të këqija haptas: **“Nëse do më lejohej të gurëzoja ndokënd pa fakte kisha për ta gurëzuar atë”**.*

*Dhe u tha atyre që shkuan për gjykim te ai: **“Ju vini për gjykim te unë mirëpo disa prej jush janë më shumë oratorë në paraqitjen e provave dhe unë gjykoj sipas asaj që dëgjoj. Kujt i jap të drejtë prej të drejtave të vllait të tij të mos e marrë atë sepse po i jap një copë zjarri”**. Profeti nuk i vrau munafikët, megjithëse ata janë qafirë, përshkak se kufri i tyre nuk ishte shfaqur me prova të pranuar në shariat”*.²

Argument është edhe fjala e profetit ﷺ: ***“Kush fal namazin tonë dhe drejtohet nga***

¹ E transmeton Buahriu dhe Muslimi.

² Es sarimul meslul, fq. 356.

kibla jonë dhe ha prej kurbanit tonë ai është musliman. Atij i takon mbrojtja e Allahut dhe e të dërguarit të tij.¹ Në hadith përmendet se kush i vepron këto vepra të dukshme gjykohet si musliman dhe atij i takon mbrojtja e Allahut dhe e të dërguarit të tij.

Argument është edhe hadithi i Usama ibn Zejdit ؓ, thotë: Profeti ﷺ na dërgoi në një çetë dhe në mëngjes sulmuam fisin e Hurkatëve prej Xhuhejnes dhe kapa një person i cili tha: La ilahe il-la Allah. Mirëpo unë e godita. Pastaj më vrau ndërgjegjja dhe ia përmenda profetit dhe më tha: ***“A tha “la ilahe il-lallah” ndërsa ti e vrave?!”. I thashë: O i dërguar i Allahut! Ai e tha për t’u ruajtur prej shpatës. I tha: A mos ja hape zemrën që ta dije se e tha apo jo? Pastaj filloi ti përsëriste këto fjalë aq sa dëshirova të isha bërë musliman vetëm atë ditë.***

Në një transmetim tjetër thuhet: ***I dërguari i Allahut i tha: A e vrave?! I tha: Po! I tha: Si do ja bësh me fjalën “La ilahe il-llah” kur të vijë në ditën e gjykimit? I tha: O i dërguar i Allahut! Kërko falje për mua. Tha: Si do ja bësh me fjalën “La ilahe il-llah” kur të vijë në ditën e gjykimit?***²

Vështro sa ashpër e qortoi profeti ﷺ Usamën ؓ për bazimin në supozime që nuk pinë ujë në vrasjen e njeriut dhe paragjykimin se ai shtiret me dëshminë e teuhidit prej frikës së shpatës. Aq shumë e qortoi sa Usama ؓ dëshiroi që më mirë të ishte bërë musliman në ato çaste sesa të kishte vepruar këtë veprim.

Është e pamundur që Usama ؓ t’ia hapi zemrën _siç nuk ka mundësi askush_ për të ditur nëse e ka thënë me sinqeritet apo jo? Kjo nënkupton se ai duhej të bazohej për gjykim në pamjen e jashtme dhe ta linte të fshehtë për Allahun.

Imam Neveviu thotë: ***“Fjala e profetit “A mos ja hape zemrën” dëshmon për rregullin e njohur në fikh dhe në usul se gjykimet bazohen mbi gjërat e dukshme ndërsa fshehtësitë i lihen Allahut”***.³

Ibn Tejmije thotë: ***“Nuk ka kundërshtim mes muslimanëve, se qafiri që është në gjendje lufte me muslimanët, nëse bëhet musliman kur shikon shpatën e zhveshur, qoftë si i lirë ose i lidhur (rob lufte), atij i pranohet islami dhe i pranohet pendimi prej kufrit edhe nëse kjo gjendje dëshmon që brendësia e tij mund të jetë e ndryshme me atë që shfaq”***.⁴

Argument është edhe hadithi i Mikdad ibn Esuedit kur e pyeti profetin: O i dërguar i Allahut! Nëse përballem me një person qafir dhe ai më lufton dhe më pret njëren dorë me shpatë pastaj fshihet pas një peme dhe thotë: I jam dorëzuar Allahut, a ta vras o i dërguar i Allahut pas kësaj fjale? I tha: Mos e vrit. I thashë: O i dërguar i Allahut! Po ai më ka prerë njëren dorë dhe këtë fjalë e thotë pasi të ma presë dorën prandaj pse mos ta vras? I tha: ***“Mos***

¹ E transmeton Buhariu.

² E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

³ Shpjegimi i sahikut të Muslimit, 2/107.

⁴ Es sarimul meslul, fq. 329.

e vrit! Sepse po ta vrasësh ai do të jetë në pozitën tënde para se ta vrisje dhe ti do të ishe në pozitën e tij para se ta thoshte këtë fjalë”.¹

Neveviu thotë: “Ai do të jetë në pozitën tënde para se ta vrisje dhe ti do të jesh në pozitën e tij para se të thoshte këtë fjalë. Shpjegimi më i bukur dhe më i saktë është shpjegimi që i kanë dhënë imam Shafi’iu, Ibn Kasar Maliku dhe të tjerë se jeta e tij është e mbrojtur dhe ndalohet vrasja e tij pasi e tha fjalën “La ilahe il-lallah”, ashtu siç ishte jeta jote para se ta vrisje atë. Ndërsa jeta jote, pas vrasjes së tij është e pambrojtur dhe vrasja jote është e lejuar ashtu siç ishte jeta e tij para se ta thoshte fjalën “La ilahe il-lallah”.^{2,3}

Argument është edhe hadithi i Ebu Said Hudariut ؓ thotë: ***Erdhi një burrë me sy të futur, me nofulla të mëdha, ballëlartë, me mjekër të dendur, kokërruajtur, me izar të përveshur dhe tha: O i dërguar i Allahut! Friksoju Allahut!⁴ I tha: O i mjerë! A nuk më takon t’i friksohem Allahut më shumë se kushdo tjetër në tokë?!***

Thotë: Pastaj ai u largua dhe Halid ibn Velidi i tha: O i dërguar i Allahut! A t’ia pres kokën? I tha: Jo! Mbase falet. Atëhere Halidi i tha: Eh sa veta që falen dhe flasin me gojë atë që nuk e besojnë me zemër. I dërguari i Allahut i tha: Nuk jam urdhëruar të gërmoj zemrat e njerëzve dhe as t’i hap gjokset e tyre.

Pastaj vështroi drejt, tij ndërsa ai i kishte ktyer shpinën dhe tha: Ky do të jetë origjina e disa njerëzve që lexojnë librin e Allahut shkëlqyeshëm, por ai nuk ua kalon fytet. Dalin prej fesë ashtu siç del shigjeta prej harkut. Sikur t’i arrij kam për t’i vrarë njësoj si themudi”.⁵

Fjala “Nuk jam urdhëruar të gërmoj zemrat e njerëzve dhe as t’i hap gjokset e tyre” nënkupton që duhet të mjaftohemi me atë që shfaqin. Nëse shfaqin islamin në pamje të jashtme, si falja e namazit, sillemi me ta si muslimanë dhe u japim të drejtat dhe përgjegjësitë e muslimanit. E nëse shfaqin kufrin i trajtojmë si qafirë, pa kontrolluar në gjokset dhe zemrat e tyre.⁶

Ky qëndrim i profetit ﷺ ishte një mësim i vyer për Halid ibn Velidin në luftat dhe betjat e tij. Më parë përmendëm historinë e Mexha’as kur Halidi arriti në krye të 200

¹ E transemtion Buhariu dhe Muslimi.

² Shpjegimi i sahihut të Muslimit, 2/106.

³ Nëse thuhet: Përse nuk e vrau profeti Usamën i cili vrau një person që tha “La ilahe il-lallah”? I themi: Pyetësi le t’i kthehet rregullit të parë i cila thotë: Kërcënimi i përgjithshëm nuk nënkupton gjithmonë se ai zbatohet mbi një person të caktuar sepse mund të ketë pengesa që pengojnë prej dënimit dhe ndëshkimit të tij si padija, mosarritja e argumentit të sheriatit në atë pikë ku ka gabuar. Ngjarja e Usamës hyn pikërisht në këto pika dhe Allahu është më i ditur.

⁴ Shikoje guximin e havarixhve, Allahu i shkatërroftë, kundër profetit dhe muslimanëve pas profetit.

⁵ E transemtion Buahriu dhe Muslimi.

⁶ Hadithi është argument edhe për ndërmjetësimin e veprave të mira kur kufri është me dy kuptime sepse namazi i doli në krah këtij personi.

luftëtarëve në “*El Ard*” në marshimin e tij kundër banorëve të Jemames atëhere kur dezertuan prej islamit dhe u tha: “*Këdo që të kapni prej njerëzve merreni! Ata arritën të kapnin Mexha’an me 23 veta prej fisit të tij. Kur arriti te Halidi ؓ i tha: O Halid! Ti e di shumë mirë që unë kur kam vajtur te profeti atëhere kur ishte gjallë i kam dhënë besën për islam. Unë sot e kësaj dite e ruaj besën e dikurshme. Nëse një gënjeshtar (Musejleme) ka dalur prej nesh atëhere Allahu thotë: (Asnjë gjynah nuk rëndon mbi tjetrin).*”

I tha: O Mexhaah! E braktise sot atë që e përkrahe mot. Pëlqimi dhe heshtja jote përpara këtij gënjeshtari, ndërkohë që ti je prijësi i Jemames, aq më shumë që u informove për marshimin e ushtrisë sime, ishte pohim dhe pëlqim për atë që pretendonte?! Ah sikur të gjeje justifikim dhe ta kundërshtoj ashtu siç e kundërshtuan të tjerët. Ashtu siç foli dhe kundërshtoi Thumame dhe Elishkiri. E nëse thua: Pata frikë për fisin, atëhere përse nuk erdhe te unë ose të më dërgoje një të dërguar?!

I tha: O bir i Mugiras! Ma bëj hallall të gjithë këtë. I tha: Ta kam falur gjakun por në zemër akoma kam dyshim për moskundërshtimin tënd”.¹

Halid ibn Velidi ؓ e konsideroi Mexha’an aprovues të thirrjes së Musejleme gënjeshtarit dhe se ai e kishte braktisur islamin e mëparshëm, sepse ai në pamje të jashtme shfaqej i kënaqur me Musejleme gënjeshtarin. Megjithëse Mexhaah nuk pati thënë asnjë fjalë që dëshmonte se ai e përkrahte dhe e pranonte thirrjen e Musejleme gënjeshtarit, përkundrazi e pohonte se vazhdonte të ishte besnik i besës që i kishte dhënë profetit ﷺ për islamin.

Argument është edhe hadithi i Numan ibn Beshirit ؓ, thotë: Ishim me profetin ﷺ dhe dikush u afrua dhe i pëshpëriti diçka. I dërguari i Allahut ﷺ tha: Vriteni këtë. Pastaj u tha: A dëshmon se nuk ka të adhuroar me të drejtë përveç Allahut? I tha: Po por e thotë për t’u mbrojtur. I dërguari i Allahut tha: “*Mos e vrisni! Unë jam urdhëruar të luftoj njerëzit derisa të thonë: La ilahe il-lallah, e nëse e thonë atë i sigurojnë prej meje gjakun dhe pasuritë e tyre përveç me të drejtën e islamit dhe llogaria e tyre i takon Allahut*”.²

Profeti e refuzoi supozimin se ai e thoshte shehadetin për t’u mbrojtur prej vdekjes dhe u mjaftua me pamjen e tij të jashtme që dëshmon për islamin e tij.

Argument është edhe hadithi i Ali ibn Ebi Talibit ؓ, thotë: Disa skllëvër vajtën te i dërguari i Allahut ﷺ, në ditën e Hudejbijes, para se të shkruhej armpushimi dhe pronarët e tyre i shkruajtën profetit ﷺ dhe i thanë: O Muhamed! Ata nuk kanë ardhur te ty se e pëlqejnë fenë tënde por që të shpëtojnë prej skllavërisë. Disa njerëz dëshmuan se pronarët kanë thënë të vërtetën, prandaj duhet t’i kthejë ata. Atëhere i dërguari i Allahut ﷺ u zëmërua dhe tha: “*Më duket se nuk do i jepni fund deri sa të dërgojë Allahu dikënd që t’ju vrasë dhe ju vazhdoni të jeni në këtë gjendje*”. Pastaj refuzoi t’i kthente dhe tha: “*Ata janë të liruarit e*

¹ Mexhmuatul teuhid, 299.

² Sahih sunen En nesai, 3714.

Allahut”.¹

Abdullah ibn Utbe ibn Mesudit thotë: Kam dëgjuar Umer ibn Hatabin ؓ të thotë: “Disa njerëz janë gjykuar prej shpalljes në kohën e të dërguarit të Allahut ﷺ mirëpo tani shpallja është ndërprerë. Tani gjykojmë me veprat që i shfaqin. Kush e shfaq të keqen nuk e besojmë dhe nuk kemi siguri te ai edhe nëse pretendon se qëllimin e ka të mirë”.²

Fjala e tij: “Disa njerëz janë gjykuar prej shpalljes në kohën e të dërguarit të Allahut ﷺ mirëpo tani shpallja është ndërprerë” nënkupton se profeti i ka falur gabimet e dukshme të disa njerëzve sepse nëpërmjet shpalljes e mësonte pastërtinë e zemrave të tyre. Mirëpo kjo nuk i takon askujt tjetër pas vdekjes së profetit ﷺ. Askujt nuk i lejohet të argumentohet me disa raste specifike ku profeti ﷺ e morri parasysht brendësinë e disa njerëzve, si në historinë e Hatib ibn Beltas ؓ dhe disa të tjerëve, se duhet inspektuar brendësia e njeriut dhe zemra e tij për të njohur realitetin e tyre.³ Prandaj sahabët kanë pasë praktikuar parimin e gjykimit me pamjen e jashtme në rastin e kufrit dhe imanit.

Argument tjetër është edhe hadithi i Ibn Abasit ؓ, thotë: “Muslimanët hasën me një person që kishte një tufë të vogël bagëtish dhe ai i përshëndeti: *Es selamu alejkum, si shenjë për islamin e tij, por ata e vranë dhe i morrën bagëtinë. Pas kësaj zbriti ajeti: ﴿mos thoni për atë që ju jep selam: Ti nuk je besimtar, duke synuar pasurinë e kësaj bote﴾ bën fjalë për tufën e bagëtisë”.⁴ Ky ishte një mësim i mirë për ta dhe për muslimanët e tjerë.*

Po prej Ibn Abasit ؓ thotë: I dërguari i Allahut ﷺ i tha Abas ibn Abdulmutalibit kur arritën në Medine: “**O Abas! Paguaj shpagimin për veten tënde dhe për bijtë e vëllait tënd Akil ibn Ebi Talibit dhe Neufel ibn Harith dhe për Utbe ibn Amr ibn Xuhdumin, sepse ti ke pasuri të mjaftueshme. I tha: O i dërguar i Allahut! Unë kam qënë musliman mirëpo njerëzit më nxorrën me forcë. I tha: Allahu e di më mirë islamin tënd. Nëse kjo që thua është e vërtetë ka për të shpërblyer. Mirëpo në pamje të jashtme ti ke qënë kundër nesh prandaj paguaj shpagim për veten tënde**”. I dërguari i Allahut ﷺ morri në konsideratë veprat e dukshme dhe daljen e tij në rradhët e mushrikëve në betejën e Bedrit kundër muslimanëve. Prandaj profeti ﷺ u soll me të njësoj si me qafirët dhe nuk e pranoi justifikimin e daljes me forcë dhe se ishte musliman, sepse veprat e jashtme përgënjeshtonin pretendimin e tij. Abasi në atë kohë nuk e kishte të pamundur hixhretin prej vendit ku sundonin qafirët armiqësor për në shtetin islam në Medine.

I dërguari i Allahut ﷺ e ka pas pranuar pamjen e jashtme të munafikëve që dëshmonte

¹ Sahih sunen Ebi Daud, 2349.

² E transmeton Buahriu.

³ Profeti e ka pas dashur justifikimin dhe i falte gabimet e shokëve të tij sidomos të atyre që ishin të njohur për xihadin dhe sprovimin e tyre për hir të islamit dhe davetit. Ai anonte nga mëshira dhe falja për veprat që kuptohen me disa kuptime falja dhe nuk anonte nga dënimi dhe ndëshkimi. Kjo është dëshmi për moralin e lartë të profetit.

⁴ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

për islamin e tyre megjithëse ai e ka pas ditur¹ se ata në brendësinë e tyre janë qafirë dhe nuk e besojnë Allahun dhe të dërguarin. Veprimi kështu, për të përforcuar parimin e konsiderimit të veprave të dukshme në rastin e kufrit dhe imanit, pa inspektuar brendësinë e njerëzve dhe pa gërmuar në zemrat e tyre.

Imam Tahaviu në akiden e tij thotë: “Nuk dëshmojmë për askënd me kufër, shirk apo nifak derisa ta shfaqë diçka të tillë dhe i kthejmë të fshehtat e tij te Allahu”.

Ibn Ebilizzi, në shpjegimin e akides së Tahaviut thotë: “Jemi urdhëruar të gjykojmë me pamjen e jashtme dhe jemi ndaluar të pasojmë supozimet dhe atë që nuk e dimë. Allahu thotë: **﴿O besimtarë! Shmanguni shumë prej dyshimeve, sepse disa dyshime janë gjynah﴾** El huxhurat 12. Dhe thotë: **﴿Mos e ndiq atë që nuk e di sepse për dëgjimin, vështrimin dhe zemrën, për të gjitha ato njeriu është përgjegjës﴾** El isra 36”.

Bazuar në parimin e gjykimit me pamjen e jashtme, ehlisuneti falen pas atij që realiteti i tij nuk njihet, pa pyetur për akiden dhe fshehtësinë e tij dhe pa e vënë në provë për disa çështje të akides dhe jo ashtu siç veprojnë disa të paditur.

Ibn Tejmije thotë: “Namazi pas atyre që nuk njihet realiteti i tyre është i lejuar me pajtimin e katër imamëve dhe të gjithë dijetarëve muslimanë. Kush thotë: E fal xhumanë vetëm pas atij që ja njoh akiden që e fsheh në zemër, ai është bidatçi dhe ka kundërshtuar sahabët, tabinët, katër imamët dhe dijetarët e tjerë”.²

Dhe thotë: “Nuk është prej kushteve të faljes pas imamit njohja e akides së imamit dhe as provimi i tij me pyetje, sikur t’i thotë: Çfarë beson? Por falet edhe pas atij të cilit nuk i njihet realiteti.

Ai që thotë: Nuk falem pas atij që nuk e njoh dhe as nuk ia dorëzoj pasurinë time (zekatin) atij që nuk e njoh, ai është i paditur. Këtë fjalë nuk e ka thënë askush prej dijetarëve të islamit.”³

Në shpjegimin e ajetit: **﴿Allahu ka për t’i njohur ata që besuan dhe ka për t’i njohur munafikët﴾** El ankebut 34, thotë: “Sepse imani dhe nifaku origjinën e kanë në zemër ndërsa fjalët dhe veprat e dukshme janë rrjedhojë dhe argument të asaj që është në zemër. Prandaj nëse personi shfaq diçka ai gjykohet në bazë të asaj që ka shfaqur”.⁴

Sulejman Ali Shejhu për atë që ulet me ata që tallen me Allahun dhe argumentet e tij

¹ Allahu ia ka pas treguar profetit munafikët, mirëpo askush tjetër përveç profetit nuk mund ta dijë këtë sepse njohja e realitetit të zemrave i takon vetëm të diturit të së fshehtave. Ne mund të bazohemi vetëm në shenjat e jashtme dhe në shprehjet e tij të cilat na shtojnë të tregojmë kujdes dhe të ruhem prej munafikëve. Mirëpo nuk mund të gjykojmë për persona të caktuar se janë munafikë vetëm nëse bazohemi në fakte të qarta për kufirin dhe nifakun e tyre dhe vetëm atëherë mund të gjykojmë me to.

² Mexhmu’ul fetaua, 4/542.

³ Mexhmu’ul fetaua, 23/351.

⁴ Es sarimul meslul, fq. 34.

pa imponim dhe pa i kundërshtuar thotë: “Nëse pretendon se ai e urren këtë me zemër nuk i pranohet sepse gjykimi bazohet në pamjen e jashtme dhe ai e ka shfaqur kufirin prandaj konsiderohet qafir”.¹

Çështje: Nëse një person në pamje të jashtme vepron vepra imani dhe kufri, si duhet gjykuar dhe cilës i jepet përparësi?

Nëse njeriu shfaq vepra që dëshmojnë për imanin e tij dhe në të njëjtën kohë shfaq vepra që dëshmojnë për kufirin dhe daljen prej fesë, atëhere ai konsiderohet qafir dhe murted derisa t’i braktisë këto vepra kufri, të cilat ia prishin imanin dhe e nxjerrin prej islamit.

Nëse kufri i qartë ndërthuret me imanin atëhere i jepet përparësi kufirit. Imani në këtë rast nuk i bën dobi askujt sepse ai ka vepruar një gjë dhe atë që e hedh poshtë atë dhe është si ai që e adhuron Allahun dhe tagutin sëbashku.

Allahu ﷻ thotë: **﴿Shumica e tyre besojnë Allahun duke qënë mushrikë﴾** Jusuf 106. Ata besojnë se Allahu është zot por i bëjnë shok në adhurim prandaj dhe imani nuk u bën dobi.

Dhe thotë: **﴿Ju afruam asaj që kishin punuar dhe e bëmë pluhur e hi﴾** El furkan, 23.

I dërguari i Allahut ﷺ në hadithin sahih ka thënë: **“Nuk bashkohen imani me kufirin në zemrën e një personi të vetëm”**.²

Imani mund të bashkohet në zemër vetëm me kufirin e vogël në vepra ose me shirkun e vogël, si puna e rijasë, dhe me gjynahet që janë më të vogla se kufri dhe shirku sepse ato nuk e rrëzojnë imanin tërësisht, por e dobësojnë dhe e pakësojnë atë.

Por nëse bashkohen te një njeri islami i qartë me një kufër që mund të kuptohet me disa kuptime, atëhere i jepet përparësi imanit, sepse kufri i paqartë, i cili mund të komentohet si kufër ose si diçka tjetër, nuk ngrihet në gradën e imanit dhe islamit të qartë.

Kjo është akidja e ehlisunetit të cilët thonë: Imani është besim me zemër, fjalë dhe vepra, shtohet me vepra të mira dhe paksohet me gabime dhe gjynahe.

Çështje tjetër: Nëse dëshmia “La ilahe il-lallah” e ruan edhe armikun agresor prej vrasjes dhe ja siguron jetën dhe pasurinë, a i bën dobi kjo fjalë nëse më pas nuk i nënshtrohet shtyllave dhe obligimeve islame? Ose nëse e thotë këtë fjalë sa herë që i kërkohet dhe kur i intereson, mirëpo në anën tjetër vepron gjëra që e hedhin poshtë këtë fjalë pa justifikim të pranuar, a i bën dobi dëshmia e teuhidit në këtë rast?

¹ Mexhmuatul teuhid, fq. 48.

² Es silsiletus sahiha, 1050.

Dëshmia “La ilahe il-llah” në këtë rast nuk i bën dobi si në dynja ashtu edhe në ahiret, sepse ai e shqipton teuhidin me fjalë mirëpo në anën tjetër vepron fjalë dhe vepra që e hedhin poshtë këtë teuhid. Ai është si ai që dëshiron të bashkojë dy gjëra kontradiktore, njësoj si ai që thotë: Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe në anën tjetër thotë: Ka edhe një zot tjetër që e meriton të adhurohet, t’i bindemi dhe ta pasojmë. Pra e beson dhe e mohon në të njëjtën kohë.

Allahu thotë: **﴿Kush bën kufër me tagutin dhe beson në Allahun ai është kapur me kapjen më të sigurtë e cila nuk këputet﴾** El bekare 256. Allahu i dha përparësi kufirit me tagutin përpara imanit, sepse ai është kusht i saktësimi të imanit. Ai që beson por nuk bën kufër me tagutin, nuk është kapur me kapjen më të sigurtë e cila është fjala e teuhidit “La ilahe il-lallah”.

Allahu thotë: **﴿Kemi dërguar në çdo umet të dërguar që t’u thotë: Adhuroni Allahun dhe largojuni tagutit﴾** En nahl, 36. Ky është kuptimi i fjalës “La ilahe il-lallah” e cila ngrihet mbi dy baza, asnjëra prej tyre nuk bën dobi pa tjetrën. Baza e parë është kufri me tagutin, distancimi prej tyre dhe prej adhuruesve të tyre, urrejtja dhe konsiderimi i tyre qafirë. Ndërsa baza e dytë është imani me Allahun dhe pohimi me gojë e vepra se vetëm ai e meriton të adhurohet dhe çdo tjetër që adhurohet është e kotë dhe adhurohet padrejtësisht.

Tagut është çdo gjë që adhurohet përveç Allahut _kur kënaqet me të_ qoftë edhe në një formë adhurimi të vetme, ose nëse i jep vetes cilësi dhe kompetenca që i takojnë vetëm Allahut edhe nëse njerëzit nuk e pasojnë atë në pretendimin e tij.¹

Të mos kujtojnë ata që besojnë tagutin dhe Allahun së bashku, se janë në të drejtë dhe po veprojnë mirë sepse Allahu thotë: **﴿Nëse do të bësh shirk, ka për t’u rrëzuar puna jote﴾** Ez zumer, 65 dhe thotë: **﴿Kush bën shirk me Allahun Allahu ia ka bërë haram xhenetin﴾** El maide 72.

I dërguari i Allahut ﷺ në hadithin e saktë thotë se Allahu ka thënë: **“Unë jam më i panevojshmi i ortakëve për shirkun. Kush vepron një punë dhe më bën shirk (ortak) dikë tjetër kam për ta lënë atë dhe shirkun e tij”**.²

Dhe thotë: **“Kush vdes pa i bërë Allahut shirk asgjë do të hyjë në xhenet dhe kush**

¹ Nëse ai që adhurohet është njeri dhe e aprovon adhurimin e njerëzve ndaj tij, atëhere bëhet kufër me të, me adhurimin e tij dhe me ithtarët e tij. Allahu thotë për Ibrahimin: **﴿Keni pasur shembullin e mirë të Ibrahimit dhe ata që ishin me të kur i thanë popullit të tyre: Ne jemi të distancuar prej jush dhe prej asaj që e adhuroni përveç Allahut. Kemi bërë kufër me ju dhe mes nesh është shpallur armiqësia dhe urrejtja derisa të besoni me Allahun një dhe të vetëm﴾**.

Nëse ai nuk pajtohet me adhurimin e tyre, si puna e profetëve dhe njerëzve të mirë, bëhet kufër me adhurimin e tyre dhe me ata që i adhurojnë ata, por nuk bëhet kufër me vetë profetët dhe njerëzit e devotshëm, sepse ne e kemi detyrë që t’i duam dhe t’i respektojmë, prandaj nuk mund të konsiderohen tagutë.

² E transmeton Muslimi.

vdes duke i bërë Allahut shirk, do të hyjë në zjarr.¹

Dhe thotë: ***“Kush thotë: “La ilahe il-lallah, dhe bën kufër me atë që adhurohet përveç Allahut, atij i sigurohet jeta dhe pasuria dhe llogaria e tij i takon Allahut”***.² Kuptimi i anasjelltë i hadithit nënkupton se kush thotë “La ilahe il-lallah” por nuk bën kufër me atë që adhurohet përveç Allahut ai nuk e ka jetën dhe pasurinë të siguruar prandaj dhe nuk është musliman.

Shejh Kashmiri thotë: *“Kush bën kufër duke mohuar diçka të mirënjohur, si mohimi i ndalimit të alkolit, atëhere duhet të distancohet prej këtij besimi, sepse ai i ka pas pohuar dy dëshmitë e islamit sëbashku me këtë besim kufri, prandaj duhet të distancohet. Shafitë shprehen qartë në këtë çështje dhe ky është mendimi i autorit të librit “Reddul muhtar minel irtidad” dhe i autorit të librit “Xhamiul fusul”. Nëse shehadetin e shqipton se i është bërë zakon, nuk i bën dobi derisa të pendohet për atë që ka thënë, sepse vetëm kështu i fshihet kufri”*.³

Kufri nuk i fshihet edhe nëse i shqipton dy shehadetet, sepse ai vazhdon të kryej një vepër që e rrëzon imanin dhe e nxjerr atë prej islamit. Që shehadeti t’i bëjë dobi duhet që të distancohet prej kësaj gjëje që ishte shkak për kufrin dhe daljen e tij prej islamit. Askush nuk kundërshton në çështje të tilla përveç atyre që janë zhytur në mendimet e xhehmive dhe murxhive.

Shejh Muhamed ibn Abdulvehabi thotë: *“Kush e adhuron Allahun ditë e natë pastaj i lutet një profeti ose i lutet një njeriu të mirë pranë varrit të tij, ai ka adhuruar dy zota dhe nuk ka dëshmuar se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, sepse ilahu (zoti që meriton të adhurohet) është ai që meriton t’i luten. Kështu veprojnë mushrikët në varrin e Zubejrit dhe Abdulkadrit dhe në varre të tjera”*.

Fetvaja e shejhul islamit për ushtrinë e Tatarëve dhe atyre që janë si ata.

U pyet shejhul islami për ushtrinë e Tatarëve: Disa prej tyre dëshmojnë se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut mirëpo në anën tjetër veprojnë gjëra që e kundërshtojnë dëshminë e teuhidit. A lejohet luftimi i tyre?

U përgjigj: Këta njerëz, për të cilët po pyet, një pjesë e ushtrisë së tyre janë qafirë të krishterë dhe mushrikë, ndërsa pjesa më e madhe e tyre paraqiten si muslimanë të cilët dëshmojnë shehadetin kur u kërkohet. E respektojnë profetin mirëpo vetëm një pjesë e vogël e tyre falen. Ata që agjërojnë ramazanin në mesin e tyre janë më shumë se ata që falen. E vlerësojnë muslimanin më shumë se të tjerët ndërsa muslimanët e devotshëm kanë pozitë të

¹ E transmeton Muslimi.

² E transemtan Muslimi.

³ Ikfar el mulhidin, fq. 63.

lantë në mesin e tyre. Ata kanë disa gjëra prej islamit dhe janë me grada të ndryshme në besim.

Mirëpo realiteti i shumicës së tyre, për të cilin luftojnë, është braktisja e shumë dispozitave islame ose shumicën e tyre. Së pari ata e obligojnë hyrjen në islam mirëpo nuk e luftojnë atë që e braktis islamit. Në anën tjetër çdo qafir që lufton për shtetin mongol është i respektuar dhe është i lirë edhe nëse është qafir dhe armik i Allahut dhe i profetit. E luftojnë këdo që rebelohet kundër shtetit mongol edhe nëse është prej muslimanëve më të mirë.

Pra nuk i luftojnë qafirët dhe as nuk i ngarkojnë ehliktabin me pagimin e xhizjes dhe nënshtrim. As nuk i ndalojnë ushtarët e tyre të adhurojnë çfarë të dëshirojnë; diellin, hënën etj. Mesa kuptohet prej realitetit të tyre, ata e konsiderojnë muslimanin si njeri të drejtë dhe të devotshëm, ndërsa qafirin si muslimanët e prishur.¹

Shumica e tyre nuk e konsiderojnë jetën dhe pasurinë e muslimanëve të mbrojtura, vetëm nëse prijësi i tyre i ndalon. Pra nuk u qëndrojnë korrekt vaxhibeve fetare dhe nuk gjykojnë në mesin e tyre me atë që ka zbritur Allahu por gjykojnë me ligje të shpikura që ndonjëherë përputhen me islamit, por e kundërshtojnë atë në çështje të tjera.

Luftimi i këtij lloji njerëzish është detyrë me pajtimin e të gjithë muslimanëve. Askush që e njih islamin dhe e njih realitetin e tyre nuk dyshon për këtë. Kjo shtirje me islam dhe islami nuk mund të bashkohen kurrë.²

Nëse bëjmë një krahasim mes ushtrisë tatarë dhe ushtrive arabe bashkëkohore, detyra dhe misioni i të cilëve është vetëm ruajtja e fronit të tagutit dhe madhërimi i tij dhe po t'i krahasojmë me shumë ushtri të tjera në viset muslimane, ke për të kuptuar se ushtria tatarë ka qënë më e mirë se ushtritë arabe. Te ta do të gjejmë shumë vepra dhe cilësi të mira të cilat nuk i gjen në ushtritë bashkëkohore, e megjithatë Ibn Tejmije thotë për ta: “Luftimi i këtij lloji njerëzish është detyrë me pajtimin e të gjithë muslimanëve. Askush që e njih islamin dhe e njih realitetin e tyre nuk dyshon për këtë”.

Nëse luftimi i atij që bën kufër si tatarët është detyrë me ixhmanë e muslimanëve, atëherë luftimi i atyre që bëjnë kufër, mizori dhe poshtërsi më të mëdha, është detyrë më parësore.

Ibn Tejmije për ata që refuzojnë të pasojnë disa dispozita të islamit thotë: “Çdo grup që refuzon praktikimin e një dispozite prej dispozitave të dukshme të islamit dhe mutevatire (të mirënjohura) duhet të luftohet derisa e gjithë feja të jetë për Allahun. Kjo është me pajtimin e të gjithë dijetarëve. Prej Dejlem Himjeriut ؓ thotë: E pyeta të dërguarin e Allahut ﷺ: O i dërguar i Allahut! Ne jetojmë në një vend ku lodhemi shumë prej punës së rëndë, prandaj për të përballuar punën dhe ngricat prodhojmë një pije prej grurit. Tha: A të deh? I

¹ Ndërsa sot ata që thrrasin për patriotizëm i barazojnë të gjithë.

² Mexhmu'ul fetaua, 28/594.

thamë: Po. Tha: Lëreni. I thashë: Disa njerëz nuk duan ta lënë. Tha: Nëse refuzojnë ta lënë atëhere vritini”.

Dhe thotë në një vend tjetër: “Çdo grup që paraqitet si musliman dhe refuzon praktikimin e disa dispozitave të dukshme dhe të mirënjohura duhet të luftohet, me pajtimin e të gjithë muslimanëve, derisa feja të jetë e gjitha për Allahun. Ashtu siç i luftoi Ebu Bekri dhe sahabët ata që refuzuan dhënien e zekatit Kjo është vërtetuar me Kuran, me sunet dhe me konsensusin e umetit se kushdo që i nuk i qëndron korrekt një dispozite të islamit ai luftohet, edhe nëse i shqipton dy shehadetet.

Çdo grup që refuzon praktikimin e disa namazeve farz, ose agjërimin, ose haxhin, ose refuzon konsiderimin e jetës dhe pasurive si të mbrojtura, ose refuzon konsiderimin haram të alkolit, bixhozit dhe martesës me mehremin, ose nuk e pranon xhihadin e qafirëve, ose obligimin e xhizjes kundër ehlikitabit, e të tjera dispozita që lidhen me obligimet dhe ndalesat fetare për të cilat nuk mund të justifikohet askush që i mohon dhe i braktis dhe bën kufër me mohimin e obligueshmërisë së tyre, ky grup duhet të luftohet për këtë shkak edhe nëse i pohon këto dispozita. Në këtë pikë nuk di ndonjë kundërshtim në mesin e dijetarëve”¹.

Luftimi dhe vrasja e atij që vepron vepra që e rrëzojnë imanin është më parësore nëse këmbngul në mospendim. I dërguari i Allahut ﷺ në hadithin sahih thotë: “Vriteni atë që bën ridde (dezerton) prej fesë së tij”.

Vërejtje:-

*Kush shfaq islamin ndërsa në zemër fsheh kufrin, porse nuk shohim prej tij vepra që dëshmojnë për kufrin e tij në zemër, atëhere ai trajtohet si musliman në të drejtat dhe detyrat e tij. Por në ahiret do të dënohet me dënimin më të ashpër dhe do të jetë në thellësitë më të thella të xhehenemit. Allahu ﷻ thotë: **﴿Munafikët janë në thellësitë më të ulta të zjarrit﴾** En nisa, 145. Dhe thotë: **﴿Allahu u ka premtuar munafikëve dhe munafikeve dhe pabesimtarëve zjarrin e xhehenemit, të përjetshëm janë në të. Atë meritojnë dhe Allahu i ka mallkuar dhe ata do të kenë dënim të përhershëm﴾** Et teube 68.*

Imani që i bën dobi njeriut në dynja dhe ahiret është imani i jashtëm dhe i brendshëm (në vepra dhe me zemër). Ndërsa ata që besojnë në pamje të jashtme por jo me zemër, si puna e munafikëve, atyre islami u bën dobi në dynja por jo në ahiret.

Vërjetje tjetër:-

Ka dallim mes asaj që ja kursen jetën qafirit armiqësor dhe mes hyrjes së tij në islam. Jeta e qafirit armiqësor është çdo fjalë ose shenjë që dëshmon se ai dëshiron të hyjë në islam. Përshembull nëse e hedh armën dhe kërkon mbrojtje ose thotë: E lashë fenë time dhe

¹ Mexhmu’ul fetaua, 28/308, 347, 356, 357, 503.

nënkupton se është bërë musliman mirëpo nuk diti me u shpreh, atëhere pranohet prej tij dhe i kursehet jeta dhe i jepet mbrojtje mirëpo nuk konsiderohet se ka hyrë në islam.

Kështu ndodhi me Halid ibn Velidin ؓ kur i vrau ata që thanë: E lamë fenë, e lamë fenë. Kishin për qëllim se u bënë musliman, mirëpo nuk ditën të shpreheshin më mirë. Halidi ؓ nuk ua pranoi këto fjalë dhe i vrau. Kur profeti ﷺ u njoftua për veprimin e Halidit u zemërua shumë dhe u distancau prej këtij veprimi dhe tha: **“O Allah! Unë distancohem për hirin tënd prej veprës së Halidit”**. Këtë e përsëriti tre herë. Pastaj urdhëroi të paguhej shpagimi i të vrarëve.

A është e mjaftueshme fjala e njeriut: E lashë fenë time, ose të tilla fjalë për hyrjen në islam?

Përgjigjen e dhamë më lart se nuk mjafton dhe duhet patjetër të dëshmojë dëshminë e teuhidit se askush nuk e meriton të adhurohet përveç Allahut. Pas kësaj konsiderohet se ka hyrë në islam. Pas dëshmisë së islamit i paraqiten shtyllat e fesë, e nëse përgënjeshton ose refuzon ndonjëherë prej tyre, vritet si murted, sepse i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Jam urdhëruar t’i luftojë njerëzit derisa të dëshmojnë se askush përveç Allahut nuk meriton të adhurohet dhe se unë jam i dërguar i Allahut, të falin namazin dhe të japin zekatin ...”**:

I dërguari i Allahut ﷺ i tha xhaxhait të tij Ebu Talibit: **“Thuaj “La ilahe il-lallah” që të dëshmoj për ty në ditën e gjykimit. I tha: Sikur të mos më paragjykonin kurejshët se e thashë prej frikës kisha për të të gëzuar me këtë fjalë”**. Ai vdiq pa e thënë fjalën e teuhidit dhe Allahu zbriti për të: **«Ti nuk e udhëzon atë që dëshiron por Allahu udhëzon kë dëshiron»** El kasas 56. Vdiq në fenë e kufrit megjithëse e pati mbrojtur profetin në shumë situata dhe konflikte me kurejshët. Madje shpeshherë shqiptonte fjalë që dëshmonin vërtetësinë e profetit siç transmetohet se thoshte:

E di se feja e Muhamedit në mes feve është më e mira

Por ai vdiq duke refuzuar shehadetin dhe në fenë e kufrit, prandaj fjalët e mira për islamin nuk i bënë asnjë dobi.

Ibn Tejmije thotë: *“Nëse njeriu nuk i shqipton dy shehadetet, kur ka mundësi, ai është qafir me pajtimin e të gjithë muslimanëve. Ai është qafir në brendësi dhe në pamjen e jashtme sipas thënieve të selefit, imamëve dhe të gjithë dijetarëve”*.¹

Enes ibn Maliku ؓ thotë: **“Profeti sulmonte në namazin e sabahut. Nëse dëgjonte ezan tërhiqej dhe nuk sulmonte. Një ditë dëgjoi një person të thoshte: Allahu është më i madhi, Allahu është më i madhi. Tha: Sipas fitras (natyrës së pastër të njeriut). Pastaj ky person tha: Nuk ka të adhuroar me të drejtë përveç Allahut. Tha: Tani dole prej zjarrit”**.²

¹ Mexhmu’ul fetaua, 7/609.

² E transmeton Muslimi dhe të tjerë. Sahih sunen Et Tirmidhi, 1319.

Dhe prej zjarrit del vetëm muslimani i cili hyn në xhenet.

Nëse parashtrohet pyetja: Veprimi i disa veprave të tjera a e zëvendëson shqiptimin e shehadetit dhe e fut njeriun në islam?

Themi: Mendimi më i saktë është se asnjë vepër nuk e zëvendëson shehadetin përveç namazit. Ai që shikohet duke u falur konsiderohet musliman edhe nëse nuk dihet ta ketë shqiptuar shehadetin më parë, sepse profeti ﷺ thotë: **“Kush fal namazin tonë dhe i drejtohet kibles sonë dhe ha prej të therurës sonë ai është musliman. Atij i takon mbrojtja e Allahut dhe mbrojtja e profetit”**.¹

Kurtubiu thotë: *“Imani ka vlerë vetëm me fjalën “La ilahe il-lallah”. Asnjë fjalë apo vepër tjetër nuk e zëvendëson atë përveç namazit. Is’hak ibn Rahavejhi ka thënë: Dijetarët janë pajtuar për një çështje rreth namazit të cilën e kanë refuzuar për veprat e tjera. Ata janë pajtuar në një mendje se kush njihet për kufrin e tij pastaj shikohet të falë namazet rregullisht dhe në kohë dhe nuk kanë dëgjuar prej tij pohim me fjalë, ai person konsiderohet musliman. Mirëpo ata nuk kanë gjykuar me të njëjtën gjë për agjërimin dhe zekatin”*.²

Nuk është kusht për hyrjen në islam shpjegimi i dëshmisë së teuhidit me sqarime dhe argumente që dëshmojnë se ai i ka kuptuar kushtet dhe gjërat që e hedhin poshtë këtë fjalë, siç pretendojnë disa persona të shtrënguar dhe të paditur. Nuk ka asnjë argument që dëshmon për këtë, përkundrazi kjo është në kundërshtim me sunetin, pa folur që praktikimi i saj është i pamundur për masat e gjëra të umetit.

I dërguari i Allahut ﷺ, siç transmetohet në hadithin sahih, i tha vajzës që ruante delet: **“Ku është Allahu? I tha: Në qiell. I tha: Kush jam unë? I tha: I dërguari i Allahut. Pastaj i tha pronarit të saj Muavije ibn Hakemit: Liroje se ajo është besimtare”**.³ Profeti ﷺ dëshmoi se ajo është besimtare bazuar në pohimin e saj se Allahu është në qiell dhe se ai është i dërguar i Allahut.

Argument është edhe fjala e profetit ﷺ për personin që tha “La ilahe il-lallah”: **“Dole prej zjarrit”**. Argumentet që dëshmojnë se profeti ﷺ dëshmonte se dikush ishte besimtar bazuar vetëm në dëshminë e teuhidit janë të shumta dhe në asnjë rast ai nuk u kërkonte shpjegim dhe mësim përmendësh të argumenteve.⁴

Gazaliu thotë: *“Një grup kaluan në ekstrem dhe i konsideruan masat e muslimanëve qafirë dhe pretenduan se ai që nuk e njeh akiden e sheriatit me argumentet që ata i kanë caktuar ai është qafir. Këta njerëz e ngushtuan mëshirën e gjerë të Allahut dhe e veçuan*

¹ E transmeton Buhariu.

² El xhami li ahkamil kuran, 8/207.

³ E transmeton Muslimi.

⁴ Ka dallim mes gjësë se kur njeriu bëhet musliman dhe mes gjykimit të tij si musliman gjatë gjithë jetës së tij prandaj trego kujdes dhe mos i ngatërro këto dy çështje që të mos humbasësh.

*xhenetin për një turmë të vogël prej kalamistave”.*¹

Ibn Haxheri thotë: “Transmetohet prej shumë dijetarëve, të cilëve u merren në konsideratë fetvatë, se ata kanë thënë: Nuk është kusht të ngarkohen masat e gjëra të muslimanve me njohjen e akides me argumentet e saj sepse kjo është shumë më e vështirë madje edhe se njohja e çështjeve të fikhut”.²

Shumë njerëz nuk posedojnë shprehje në fjalë dhe nuk dinë të shprehen mirë për shumë gjëra që i besojnë nga zemra. Kjo ka pas ndodhur edhe me disa sahabë siç transmetohet në sunenin e Ebu Daudit prej Ebu Salihut prej një sahabiu të profetit thotë: Profeti ﷺ i tha dikujt: “Çfarë thua në namaz?. I tha: Them shehadetin dhe pastaj them: O Allah. Të kërkoj xhenetin dhe kërkoj mbrojtjen tënde prej zjarrit. Unë nuk di të shprehem ashtu siç thua ti dhe Muadhi. Atëhere i dërguari i tha: Edhe ne për këtë pëshpërisim”.³

Disa sahabë nuk kanë pasur aftësi për të mësuar përmendësh disa pjesë të Kuranit, siç transmetohet në hadithin e Abdullah ibn Ebi Eufas ؓ thotë: “Një person erdhi te profeti dhe i tha: Nuk mundem të mësoj asgjë prej Kuranit prandaj më mëso diçka tjetër përveç tij. I tha: Thuaj: Subhanallah, elhamdulilah, la ilahe il-lallah, Allahu Ekber, La haule ue la kuuete il-la bil-lah. I tha: O i dërguar i Allahut! Po ndonjë dua për veten time? I tha: Thuaj: O Allah! Më mëshiro, më furnizo, më ruaj në shëndet dhe më udhëzo. Kur u largua profeti bëri shenjë me dorë dhe tha: Ky i mbushi duart me mirësi”.⁴ Meditoi këto fjalë, Allahu të udhëzoftë dhe të ruajt prej rrugës së ekstremistave dhe anashkaluesve.

Çështje: Nëse gjykimi bazohet në pamjen e jashtme, përse atëhere dijetarët e kanë kushtëzuar shpalljen qafir të atij që vepron gjynahe të madha dhe gabime me konsiderimin të lejuar dhe mohimin e ndalimit të tyre kur dihet që lejimi dhe mohimi bëhet me zemër?

Dijetarët e kanë kushtëzuar shpalljen qafir të atij që bën gjynahe me lejimin e tyre dhe me mohimin e ndalimit të tyre, sepse gjynahet që janë më të vogla se kufri dhe shirku në vetvete nuk janë kufër, prandaj nuk lejohet që vepruesi i tyre të shpallet qafir. Qafir shpallet vetëm ai që i konsideron të lejuara dhe e mohon ndalimin e tyre, sepse ai po përgënjeshton Allahun dhe profetin dhe po refuzon dispozitën që e ka zbritur Allahu.

Ndërsa kufri dhe shirku janë kufër në vetveten e tyre dhe nuk është kusht ta konsiderojë të lejuar dhe të mohojë ndalimin e kufrit me zemër. Kush thotë fjalë kufri dhe vepron vepra kufri, ai bëhet qafir, i konsideron apo nuk i konsideron të lejuara.

¹ Fethul bari, 13/439.

² Fethul bari, 13/350.

³ Sahih sunen Ebi Daud, 710.

⁴ Sahih sunen Ebi Daud, 742.

Nëse thuhet: Si ta dimë që gjynahqari i konsideron të lejuara gjynahet që janë më të vogla se kufri, sepse ne nuk kemi dije për atë që fshehin në zemra dhe nuk jemi urdhëruar të kontrollojmë zemrat?

I themi: Lejuesi i gjynaheve njihet prej shenjave të qarta në fjalë dhe në vepra, të cilat dëshmojnë nëse i konsideron të lejuara këto gjynahe. Vetëm me këto shenja të qarta bëhet dallim mes atij që i lejon dhe të tjerëve. Pa dëshmi të qarta nuk na lejohet të gjykojmë për zemrat e gjynahqarëve. Ne nuk jemi urdhëruar për këtë dhe kjo është në kundërshtim me sunetin dhe rrugën e selefit.

Shkurtimisht themi: Gjykimi me kufër dhe iman bazohet në pamjen e jashtme dhe në fjalë dhe vepra që i shfaq njeriu. Përveç pamjes së jashtme nuk na lejohet të bazohemi në asgjë tjetër, prandaj themi: **Atij që e shfaq kufirin para nesh pa asnjë justifikim të pranuar në shariat i kundërvihemi me shpalljen qafir.**

Ky rregull është rregull i rëndësishm në rregullat e tekfirit prandaj kushtoi rëndësi atij pa harruar rregullin e parë që flet për pengesat e tekfirit.

Gjithashtu themi: **Kush e shfaq islamin gjykohet si musliman për aq kohë sa nuk shfaq diçka që e prish dhe e hedh poshtë atë.** Edhe kjo është prej rregullave të tekfirit prandaj kushtoi rëndësi.



Rregulli i gjashtë: Shqiptimi i kufrit është kufër dhe veprimi i kufrit është kufër.

Dije se shqiptimi i kufrit është kufër dhe veprimi i kufrit është kufër. Kush e flet ose e vepron kufrin e qartë, pa justifikim të pranuar në shariat, ai është qafir dhe murted. Nuk ka dallim mes atij që fjalëve dhe veprave të kufrit u shton edhe shenja të tjera që dëshmojnë për mohimin me zemër dhe mes atij që nuk shfaq shenja të tilla. Sepse kufri këtu lidhet me vetë fjalën dhe veprimin dhe nuk lidhet me gjëra të tjera.

Argumentet prej Kuranit dhe sunetit që dëshmojnë për këtë rregull janë të shumta. Këtu po paraqesim disa prej tyre:

1- Fjala e Allahut: ﴿Kush bën kufër me Allahun pas imanit të tij, përveç atij që imponohet dhe zemra e tij është e qetësuar me iman, por ai që ja hap gjoksin kufrit, mbi ta ka rënë zemërimi i Allahut dhe ata kanë dënim të madh. Kjo sepse ata preferuan jetën e dunjasë më shumë se ahireti dhe Allahu nuk e udhëzon popullin qafir﴾ En nahl 106-107.

Ajeti dëshmon se kush e shfaq kufrin me fjalë dhe vepra, pa imponim, konsiderohet qafir në pamjen e jashtme dhe të brendshme. Ai është prej atyre që ja kanë hapur gjoksin kufrit edhe nëse nuk e pranon këtë. Kështu kanë thënë dijetarët.

Ibn Tejmije thotë: *Nëse thuhet: Allahu ka thënë: ﴿por ai që ja hap gjoksin kufrit﴾. I themi: Kjo pjesë e ajetit përputhet me fillimin e ajetit sepse çdokush që bën kufër pa imponim ai ja ka hapur gjoksin kufrit. Në të kundërt fillimi i ajetit do të ishte në kontradiktë me këtë pjesë. Nëse do të kihej për qëllim se kufër bën vetëm ai që ja hap zemrën kufrit, atëherë zemra nuk mund të imponohet dhe nuk do të kishte kuptim të përjashtojë vetëm i imponuari, por duhej të përjashtojë i imponuari dhe i paimponuari nëse nuk e beson kufrin. Nëse flet me fjalë kufri me dëshirë ai ja ka hapur gjoksin kufrit dhe kjo është kufër”*.¹

Dhe thotë: *“Kush e shan Allahun dhe të dërguarin me vetdije dhe pa imponim, kush flet fjalë kufri me vetdije dhe pa imponim, kush tallet me Allahun ﷻ, ajetet dhe të dërguarin e tij ﷺ, ai është qafir në brendësinë dhe aparendën e tij. Kush thotë: Një person i tillë mund të jetë në brendësinë e tij besimtar sepse ky është kufër vetëm në pamjen e jashtme, ai ka thënë një fjalë që në fe dihet shumë mirë se është e kotë”*.²

Dhe thotë: *“Kush bën kufër me Allahun ﷻ pas imanit të tij pa imponim ai*

¹ Mexhmu’ul fetaua, vëll. 7, fq. 220.

² Mexhmu’ul fetaua, 7/557.

*konsiderohet murted”.*¹

Shejhulislami ka për qëllim se ai që e shfaq kufirin me fjalë dhe vepra pa imponim, ai është murted. Ai nuk ka për qëllim atë që e beson kufirin me zemër, sepse nuk mund të themi se ai që e beson kufirin me zemër pa imponim është murted, sepse besimi i kufirit me zemër është kufër dhe kufri me zemër nuk justifikohet as me imponim dhe as pa imponim, sepse imponimi nuk ndikon në besimin e zemrës.

Shejh Muhamed ibn Abdulvehabi thotë: “Allahu ﷻ nuk justifikoi asnjërin prej tyre përveç të imponuarve që zemrën e kishin të mbushur me besim. Ndërsa të tjerët bënë kufër pas imanit të tyre edhe nëse këtë vepër kufri e vepruan prej frikës, për politikë, për hir të vatanit apo fisit, për shkak të pasurisë, në formë shakaje, apo për arsye të tjera përveç imponimit. Ajeti dëshmon për këtë në dy aspekte:

*Së pari: Me fjalën **(përveç atij që imponohet)** përjashtoi vetëm të imponuarin.*

*Së dyti: Me e fjalën **(kjo sepse ata preferuan jetën e dynjasë më shumë se ahireti)**, u shpreh qartë se ky kufër dhe dënim nuk kanë qenë për shkak të besimit me zemër, apo padijes dhe urrejtjes së fesë, ose prej dashurisë së kufirit, por shkak i kufirit ishte preferimi i pasurisë së dynjasë më shumë se feja”.*²

Dhe thotë: “Allahu ﷻ gjykoj me gjykim të parevokueshëm se kush kthehet prej fesë së tij dhe shkon drejt kufirit ai është qafir, edhe nëse justifikohet me frikën prej njerëzve për veten dhe pasurinë, apo nëse bën kufër me zemër, apo në pamjen e jashtme dhe jo me zemër, dhe njësoj nëse bën kufër me fjalë dhe vepra apo me njërin prej tyre, dhe njësoj nëse synon ndonjë përfitim dynjaje prej mushrikëve apo jo. Në të gjitha këto raste ai është qafir përveç nëse është i imponuar. Nëse njeriu imponohet për të shfaqur kufirin dhe i thuhet: Bëj kufër ose të vramë, ose të rrahëm, ose kur mushrikët e kapin dhe e rrahin dhe nuk ka asnjë mundësi të shpëtojë prej tyre vetëm duke u shtirur se gjoja është me ta, me kusht që zemrën ta ketë të qetësuar me iman, besim dhe durim. E nëse pajtohet me ta me zemër atëhere ai është qafir edhe nëse e imponojnë”.³

Kurtubiu thotë: “Dijetarët kompetentë kanë thënë: Të imponuarit i lejohet ta shqiptojë kufirin në të njëjtën mënyrë si ne rastet kur i mashtron me lojra fjalësh⁴ sepse ai që ka mundësi të bëjë lojra fjalësh nuk lejohet të gënjejë. Nëse nuk vepron kështu ai është qafir, sepse në lojrat e fjalëve nuk mund të imponohet. Përshembull kur i thuhet: Bëj kufër me Allahun e zgjat fjalën me një i- të gjatë që t’ia ndryshojë kuptimin, ose i thuhet: Bëj kufër me nebiun (profetin) dhe thotë: Bëj kufër me nebiun dhe i jep sheddë b-së sepse kështu fjala

¹ Mexhmu’ul fetaua 16/28.

² Mexhmuatul teuhid, fq. 88-89.

³ Mexhmuatul teuhid, fq. 241.

⁴ Në rastet kur lejohet të luhet me lojra fjalësh dhe kihet mundësi që me përdorimin e tyre të dalim prej situatës pa e shqiptuar qartazi kufirin për të cilin imponohet.

merr kuptim tjetër dhe nënkupton vendin e lartë”.¹

Shikoje fjalën e dijetarëve: “Nëse nuk vepron kështu ai është qafir” kjo vlen për atë që ka aftësi të përdorë lojra fjalësh por nuk i përdor ato. Ndërsa ai që shqipton kufrin e qartë me vullnet të plotë dhe pa imponim ai është qafir dhe murted në mënyrë më parësore.

2- Fjala e Allahut: ﴿E nëse i pyet ata do të thonë: Ne po bisedonim dhe po bënim shaka. Thuaju: A me Allahun, me ajetet e tij dhe me të dërguarin e tij po talleshit?! Mos u justifikoni! Ju keni bërë kufër pas imanit tuaj. Nëse e falim një grup prej jush e dënojmë një grup tjetër sepse ata ishin kriminelë﴾ Et teube 65-66.

Këta persona bën kufër pas imanit të tyre për shkak të fjalëve tallëse dhe ofenduese që i thanë për profetin dhe sahabët, në formë shakaje dhe jo seriozisht.

Ibn Tejmije thotë: “Ky është një teks i qartë që dëshmon se tallja me Allahun, ajetet dhe të dërguarit është kufër. Atëhere sharja me qëllim është kufër edhe më i madh. Ajeti dëshmon se kushdo që ofendon profetin ﷺ me shaka apo seriozisht, ai ka bërë kufër.

Transmetohet prej disa dijetarëve, si Ibn Umeri, Muhamed ibn Kabi, Zejd ibn Eslemi, Katadja se një munafik në betejën e Tebukut tha: “Nuk kam parë më barkmëdhenj, më gënjeshtarë dhe më frikacakë në luftë se lexuesit tanë” kishte për qëllim profetin ﷺ dhe lexuesit e Kuranit prej sahabëve. Atëhere Auf ibn Maliku ؓ i tha: “Gjënjeshtar. Ti je munafik. Kam për t’i treguar të dërguarit të Allahut”. Pastaj nxitoi të shkonte te profeti ﷺ për ta njoftuar, mirëpo e gjeti Kuranin të kishte zbritur me shpallje përpara tij. Atëhere ky personi vajti te profeti, i cili kishte hypur në deve dhe qe nisur dhe i tha: O i dërguar i Allahut! Ne po bënim shaka dhe po bisedonim për të kaluar rrugën dhe për të hequr lodhjen e rrugës.

Ibn Umeri ؓ thotë: A thua se e kam para syve atë person kur zvarritej duke u kapur pas këmbës së devesë së profetit dhe gurët ia gjakosnin këmbët dhe thoshte: Ne po bisedonim dhe po bënim shaka, ndërsa profeti ia kthente ﴿A me Allahun, me ajetet e tij dhe me të dërguarin e tij po talleshit﴾ pa e kthyer shikimin nga ai dhe pa i shtuar asnjë fjalë tjetër”.²

Dhe thotë: “Allahu ﷻ e njoftoi (të dërguarin) se ata kanë bërë kufër pas imanit të tyre. Mendimi se ata bënë kufër me gojë pas imanit, por kjo ndodhi pasi kishin bërë kufër me zemrat e tyre, është mendim i pasaktë, sepse imani me gjuhë kur në zemër fshihet kufri realisht është kufër dhe nuk ka kuptim të thuhet: Ju keni bërë kufër pas imanit tuaj, sepse në realitet ishin qafirë përpara kësaj fjale dhe pas saj.

Nëse thuhet: Ata e shfaqën kufrin pas shfaqes së imanit³, atëhere u thuhet: Ata nuk e shfaqën këtë fjalë përpara njerëzve, por vetëm në rrethin e tyre dhe në rrethin e tyre ata kanë

¹ Tefsiri i Kurtubiut, 10/187.

² Es sarimul meslul, fq. 31.

³ Dmth. ata ishin munafikë, e shfaqnin imanin por e fshihnin kufrin. Kuptimi i ajetit sipas këtij pretendimi është se ata munafikë kanë bërë kufër duke e shfaqur kufrin haptas ndërkohë që më përpara hiqeshin si muslimanë.

qënë munafikë edhe më përpara.

E vërteta është se ata u bënë qafirë pas imanit, me talljen dhe nifakun e tyre dhe u frikësuan se mos zbriste ndonjë sure që do të demaskonte nifakun e zemrave të tyre. Konteksi i ajetit nuk dëshmon se ata ishin munafikë më përpara (se të thoshin këto fjalë)”¹

Kurtubiu thotë: “Thuhet sa kanë qënë tre veta. Dy prej tyre u tallën dhe njëri vetëm qeshi. Allahu fali vetëm atë që qeshi dhe nuk foli. Halife ibn Hajati në librin e tij të historisë thotë: “Ai e kishte emrin Muhashin ibn Himjer”. Thuhet sa ka qënë musliman mirëpo kur i dëgjoj munafikët qeshi dhe nuk i kundërshtoi.”²

Transmetohet se ky person thoshte: O Allah! Unë e dëgjoj një ajet ku kihem për qëllim dhe më rrënqethet mishi dhe më coptohet zemra. O Allah! Ma merr jetën në rrugën tënde që askush të mos thotë: Unë e kam larë, unë e kam qefinosur, unë e kam varrosur”³

Ki kujdes për fenë tënde! Bëj kujdes prej thirrjeve liberale dhe të hyrjes në biseda që nuk të lejohen, që të mos shkatërrosh e të mos humbasësh dynjanë dhe ahiretin sëbashku.

3- Fjala e Allahut: ﴿Ju ka shpallur në libër që nëse dëgjoni të bëhet kufër dhe të tallen me ajetet e Allahut atëhere mos u ulni me ta derisa të ndryshojnë bisedë, sepse atëhere jeni njësoj si ata. Allahu do t’i mbledhë të gjithë munafikët së bashku në xhehenem﴾ En nisa, 140.

Ky ajet, dëshmon për kufrin e atij që tallet me ajetet e Allahut dhe për kufrin e atij që ulet, pa imponim dhe pa kundërshtim, bashkë me atë që tallet me ajetet e Allahut edhe nëse nuk tallet vetë. Tallja dhe ulja janë fjalë dhe vepër dhe janë kufër në vetvete edhe nëse nuk shfaqet ndonjë shenjë që dëshmon se ai e beson dhe e lejon këtë me zemër.

Ebu Bekër ibn Arabiu thotë: “Shqiptimi i kufrit me shaka është kufër. Nuk ka asnjë kundërshtim mes umetit rreth kësaj”⁴

4- Argument për kufrin e atij që flet me kufër është edhe fjala e Allahut: ﴿Betohen në Allah se nuk thanë asgjë por ata thanë fjalën e kufrit dhe bënë kufër pas imanin të tyre﴾ Et teube, 74.

Shejh Kashmiri thotë: “Ibn Haxheri në librin e tij “El Alam” në kapitullin rreth kufrit që nuk ka kundërshtim rreth tij, duke citur librat e hanefinjve thotë: Kush shqipton fjalët e kufrit ai ka bërë kufër dhe kushdo që kënaqet dhe e pëlqen kufrin ai ka bërë kufër.

Në librin “El bahr” thuhet: Nëse një njeri bën kufër me gojë dhe pa imponim, ndërsa zemrën e ka me iman, ai është qafir dhe nuk konsiderohet te Allahu besimtar. E njëjta gjë

¹ Mexhmu’ul fetaua, 7/272.

² Tefsiri i Kurtubiut, 8/199.

³ Shiko tefsirin e Ibn Kethirit.

⁴ El xhamiu li ahkamil kuran, 8/197.

thuhet në fetvatë e Kadihanit dhe në fetvatë hindije dhe në “xhamiul fusul”.

Shkurtimisht kush flet fjalë kufri me shaka ai bën kufër sipas të gjithë dijetarëve dhe nuk mirret parasysh besimi në zemër, siç thuhet qartë në librin “El hanije” dhe në “Reddul muhtar”¹

5- (E nëse i thyejnë betimet e tyre pas besës që dhanë dhe cënojnë fenë tuaj atëhere luftojeni parinë e kufrit sepse atyre nuk u pranohen betimet, se mbase heqin dorë) Et teube, 12.

Ajeti dëshmon se cënimi i fesë është kufër dhe ai që e cënon fenë është qafir dhe se kufri i tij është kufër i rëndë dhe ai konsiderohet prej kokave të kufrit. Shkaku i kufrit të këtij personi është vetë cënimi dhe ofendimi dhe nuk është kusht që ta konsiderojë cënimin dhe ofendimin të lejuar. Kush e vendos lejjimin si kusht për bërjen qafir të atij që shan fenë ka devijuar prej të vërtetës dhe ka thënë një fjalë që dihet fare mirë se është e pavlerë në aspektin fetar. Një person i tillë ka ndjekur rrugën e xhehmive dhe murxhive. Kështu kanë thënë dijetarët dhe këtu po paraqesim disa prej fjalëve të tyre.

Kurtubiu thotë: *“Disa dijetarë janë argumentuar me këtë ajet se vrasja e atij që cënon fenë është vaxhip sepse ai është qafir. Cënim i fesë ndodh atëhere kur e cilëson atë me gjëra që nuk i shkojnë për shtat, ose kur refuzon me nënçmim dhe përçmim dispozita të fesë. Transmetohet se një person tha në kuvendin e Aliut ﷺ: Kab ibn Eshrefi është vrarë me tradhti. Atëhere Aliu ﷺ urdhëroi që t’i pritej koka. Dijetarët tanë (malikijtë) kanë thënë: Ky tip vritet dhe nuk i kërkohet pendim, sepse e ka akuzuar profetin ﷺ me tradhti dhe me këtë konsiderohet zindik”²*

Ibn Tejmije thotë: *“Allahu ﷻ i quajti ata pari të kufrit sepse cënuan fenë dhe çdo cënues i fesë është pari në kufër”³*.

Dhe thotë: *“Sharja e Allahut ﷻ dhe profetit ﷺ është kufër në pamje të jashtme dhe në brendësi. Nuk ka rëndësi nëse ai e beson me zemër se kjo është harram apo e lejuar apo nuk mendohet gjatë. Ky është medhhebi i fukahave dhe i ehlisunetit që besojnë se imani është fjalë dhe vepër.*

Nëse është musliman duhet të vritet me konsensus të plotë, sepse ai është bërë qafir dhe murted, madje edhe më i keq se qafiri (në origjinë) sepse edhe qafiri e madhëron zotin duke kujtur se feja që ai pason nuk është tallje dhe ofendim i Allahut”.

Imam Ebu Jakub Is’hak ibn Ibrahim Handhelii i njohur si Ibn Rahavejhi thotë: Të gjithë muslimanët janë pajtuar në një mendje se kush e shan Allahun ﷻ dhe të dërguarin ﷺ ose refuzon diçka që e ka zbritur Allahu, ose vret ndonjë profet të Allahut, ai është qafir me

¹ Ikfarul mulhidin, fq. 59.

² Tefsiri i Kurtubiut, vëll. 8, fq. 82-84.

³ Es sarimul meslul ala shatimir resul.

këto vepra edhe nëse pohon atë që e shpallur Allahu.

Abdullahi thotë: Babai im (Ahmed ibn Hanbeli) është pyetur për atë që thotë: O bir i kësaj dhe asaj, ti dhe kush të ka krijuar ty. Babai më tha: Ai është murted i dalur prej islamit. I thashë: A i pritët koka? Tha: Po! I pritët koka.

Hatabiu thotë për atë që shan profetin ﷺ: Nuk njoh ndonjë prej muslimanëve të ketë rënë në kundërshtim për obligimin e vrasjes së tij.

Ibn Umeri ؓ ka thënë: Kush e shan profetin ﷺ vritet.

Umer ibn Abdulazizi thotë: Kush shan profetin ﷺ ai është murted i dalur prej islamit. Asnjë musliman nuk mund ta shajë profetin ﷺ.

Abdullahi thotë: E pyeta babain tim _Ahmed ibn Hambelin_ për atë që shan profetin ﷺ: A i kërkohet pendim? Tha: Është detyrë të vritet pa i kërkuar pendim sepse Halid ibn Velidi ؓ vrau një person që shau profetin pa i kërkuar pendim.

Muxhahidi thotë: Sollën një burrë që kishte sharë profetin ﷺ te Umeri ؓ dhe e vrau, pastaj tha: Vriteni atë që shan Allahun dhe ndonjë prej profetëve.

Ibn Tejmije thotë: Murtedit i kërkohet të pendohet prej rides së tij. Mirëpo profeti ﷺ dhe sahabët e kanë pasë vrarë ofenduesin pa i kërkuar pendim sepse kufri i tij është kufër i rëndë, prandaj dhe vrasja e tij është obligim.

Dhe thotë: Duhet ditur se mendimi që kufri i ofenduesit është për shkak të lejimit të sharjes me zemër, është rrëshkitje dhe shkarje e madhe.

Në kundërpërgjigjen që shejhul islam u jep atyre që e konsiderojnë kufrin me sharje për shkak të lejimit me zemër dhe jo se vetë sharja është kufër¹ thotë: “Ky citim nga fukahatë se nëse e lejon me zemër bën kufër e nëse jo nuk bën kufër është citim i pabazë ...

Aspekti i dytë: Nëse kufri është lejimi me zemër, pra besimi me zemër se sharja është e lejuar, atëhere konsiderimi hallall me zemër për atë që Allahu e ka ndaluar është kufër mëvete. Kush i konsideron të lejuara haramet e mirënjohura si haram ai bën kufër. Në këtë rast s'ka dallim mes ofendimit të profetit ﷺ, apo akuzimit të besimtarëve për imoralitet, apo

¹ Për këto rreshta më shtynë mendimet e murxhive bashkohorë, të cilët prishëset e teuhidit i përkufizojnë vetëm me lejimin me zemër dhe përgënjeshtimin. Sipas tyre çdo kufër tjetër është kufër i vogël në vepra. Ata pretendojnë se shkak i kufrit të atij që shan Allahun dhe të dërguarin është konsiderimi hallall i sharjes në zemër dhe jo vetë sharja.

Për shembull shejh Nasiri, Allahu e mëshiroftë, një kasetë me titull “Kufri është dy llojesh” thotë: “Nuk mendojmë se sharësi i Allahut dhe i të dërguarit është gjithmonë qafir, sepse ai mund të shajë nga padija, ose përshkak të keqeducimit, ose prej hutimit, dhe ndonjëherë mund të jetë me qëllim dhe dije. Nëse bëhet me qëllim dhe dije kjo është ridde dhe këtu nuk ka asnjë kundërshtim. Mirëpo nëse sharja mund të interpretohet me një nga format e përmendura më sipër, atëhere duhet të mos e shpallim qafir dhe sigurimi në të tilla raste ka më shumë përparësi në aspektin islam”. Kjo fjalë e shejhut është e refuzuar dhe këtë e kemi shpjeguar më gjatë në librin tonë “Triumfi i pasuesve të teuhidit”.

gëneshtrës, apo gibeitit, apo fjalë të tjera që Allahu i ka ndaluar. Kushdo që vepron një prej këtyre veprime duke i konsideruar të lejuara me zemër ai ka bërë kufër. Mirëpo ne nuk mund të themi që akuzimi i muslimanit me imoralitet është kufër, gibeti është kufër duke nënkuptuar se ai e ka lejuar këtë me zemër.

Aspekti i tretë: Lejimi i sharjes me zemër është kufër, e praktikon apo nuk e praktikon sharjen. Atëhere i bie që sharja nuk ka asnjë ndikim në rënien e tij në kufër, por ajo që ndikon është vetëm besimi i zemrës dhe kjo bie në kundërshtim me konsensusin e dijetarëve.

Aspekti i katërt: Nëse shkak i kufrit është konsiderimi hallall dhe vetë sharja nuk dëshmon se ofenduesi e lejon me zemër apo jo, atëhere i bie që nuk duhet ta shpallim qafir sidomos nëse thotë: Unë besoj se kjo është haram por e thashë për ngacmim dhe për shaka siç thanë munafikët **(ne vetëm po bisedonim dhe po bënim shaka)**.

Nëse thonë: Ata nuk konsiderohen qafirë; atëhere kjo është në kundërshtim me Kuranin. E nëse thonë: Ata bëhen qafirë, atëhere i kanë bërë tekfir pa asnjë shkak sepse ata pretendojnë që sharja në vetvete nuk është kufër.

Allahu u tha: **(Mos u justifikoni! Ju keni bërë kufër pas imanit tuaj)** dhe nuk u tha: Ju gënjeni në pretendimin tuaj se po bënit shaka dhe po bisedonit. Allahu ﷻ nuk i përgënjeshtroi në justifikimin e tyre ashtu siç i përgënjeshtroi munafikët në justifikime të tjera të cilat nëse vërtetohen dëshmojnë për pafajsinë e tyre, përkundrazi e sqaroi se ata janë bërë qafirë pas imanit të tyre, pikërisht për shkak të kësaj bisede dhe shakaje.

Nëse sqarohet që medhhebi i selefët dhe pasuesve të tyre është se fjala (e kufrit) është kufër në vetvete e lejon apo nuk e lejon me zemër atëhere argument për këtë janë të gjitha argumentet që i përmendëm në çështjen e parë rreth kufrit të ofenduesit, hadithet dhe thëniet (e dijetarëve). Këto argumente janë të qarta se cënimi Allahut ﷻ dhe profetit ﷺ është kufër në vetvete pa hulumtuar nëse e lejon me zemër apo jo”.¹

Është saktësuar se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Njeriu flet një fjalë të vetme të cilës nuk i kushton rëndësi dhe fundoset për shkak të saj 70 vjeshta (vite) në xhehenem”.²

Dhe thotë: “Njeriu flet ndonjë fjalë pa u menduar gjatë, rrëshket për shkak të saj në zjarr sa hapësira mes lindjes dhe perëndimit”.³

Dhe thotë: “Njeriu flet ndonjë fjalë që e zemëron Allahun pa i kushtuar rëndësi, fundoset për shkak të saj në xhehenem”.⁴

Dhe thotë: “Njeriu flet ndonjë fjalë që zemëron Allahun pa kujtuar se arrin aty ku arrin. Për shkak të saj Allahu e obligon zemërimin e tij deri në ditën e gjykimit”.

¹ Shiko librin “Sarimul meslul” në faqet: 3, 4, 17, 298, 512, 515, 517, 546.

² E transmeton Tirmidhiu dhe të tjerë. Sahih sunen Et Tirmidhi, 1884.

³ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

⁴ E transmeton Buhariu.

Vështroji fjalët “nuk e mendon të keqe” “pa u menduar gjatë” “pa i kushtuar rëndësi” “pa kujtuar” e megjithatë i llogaritet si gjynah dhe dënohet dhe nuk justikohet. Ky është një mësim i mirë për ata që me padije vendosin si kusht qëllimin dhe dijen, besimin dhe lejjimin me zemër, për shpalljen qafir dhe ndëshkimin me dënimin e tyre.

6- Prej punëve që janë kufër në vetëvete është edhe miqësimi dhe përkrahja e mushrikëve kundër muslimanëve. Allahu thotë: **﴿O besimtarë! Mos i merrni çifutët dhe të krishterët për miq sepse ata janë miq të njëri-tjetrit, e kush i miqëson ata prej jush ai është prej tyre﴾** El Maide, 51.

Dhe thotë: **﴿Të mos i marrin besimtarët qafirët për miq përveç besimatarëve. E kush vepron kështu ai nuk është te Allahu asgjë, vetëm nëse shtireni ndaj tyre për t'u ruajtur. Allahu ju tërheq vërejtje që të frikësoheni prej tij﴾** Ali Imran, 28

Ibn Xherir Taberiu në interpretimin e ajetit **﴿nuk është te Allahu asgjë﴾** thotë: “*Ka për qëllim se ai është distancuar prej Allahut dhe Allahu është distancuar prej tij për shkak të daljes prej fesë dhe hyrjes në kufër*”¹

Dhe thotë: **﴿E nëse do të besonin në Allahun dhe profetin dhe në atë që ju zbrit atij, nuk kishin për t'i zënë ata për miq, por të gjithë ata janë fasikë (të pabindur)﴾** El maide, 81.

Ibn Tejmije thotë: “*Kjo dëshmon se imani në aspektin sheriatik bie në kundërshtim me zënien e qafirëve për miq. Nuk mund të bashkohet në zemër imani me zënien e tyre për miq. Njësoj me këtë është edhe fjala e Allahut: ﴿Mos i merrni çifutët dhe të krishterët për miq sepse ata janë miq të njëri-tjetrit. Kushdo prej jush që i merr ata për miq ai është prej tyre﴾ El maide, 51. Allahu na tregon në ajetin e mëparshëm se miqësuesi i tyre nuk është besimtar, ndërsa në këtë ajet na tregon se ai është prej tyre (çifutëve dhe të krishterëve) sepse Kurani vërteton njëri-tjetrin*”²

Shejh Muhamed ibn Abdulvehabi thotë: “*Dije se prishësit kryesorë të islamit janë dhjetë gjëra. Prej tyre përkrahja dhe ndihmimi i mushrikëve kundër muslimanëve. Argument për këtë është fjala e Allahut: ﴿Kushdo prej jush që i merr ata për miq ai është prej tyre﴾ El maide, 51.*”

Me fjalën miqësim kemi për qëllim përkrahjen dhe aleancën me ta dhe jo pasimin e çifutëve dhe të krishterëve në fenë e tyre, siç pretendojnë xehmitë dhe murxhitë. Ajeti nuk mund të ketë këtë kuptim, sepse shkak i zbritjes së ajetit dëshmon të kundërtën. Ky ajet ka zbritur për Abdullah ibn Ubejin kur tha: Unë friksohem se mos më godet ndonjë fatkeqësi prandaj dhe nuk heq dorë prej aleancës me çifutët, sepse mes tyre kishte aleancë”³.

¹ Xhamiul bejan, 3/228.

² Mexhmu'ul fetaua, 7/17.

³ Shiko tefsirin e Taberiu “Xhamiul bejan” dhe tefsire të tjera.

Këtë tefsir e përforcon edhe fjala e profetit: “*Aleati i një populli është prej tyre*”¹, e cila e qartëson më shumë fjalën e Allahut: **﴿Kush i miqëson ata prej jush ai është prej tyre﴾**, sepse Kurani dhe suneti vërtetojnë njëri-tjetrin.

Prej veprave që janë kufër në vetvete është edhe luftimi i muslimanëve dhe vrasja e tyre për shkak të islamit të tyre, ndëshkimi dhe përndjekja e thirrësve në fe dhe pengimi i tyre prej përhapjes së të vërtetës vetëm e vetëm se thërresin në islam dhe urdhërojnë për mirë dhe ndalojnë prej së keqes. Allahu thotë: **﴿Ata që bëjnë kufër me ajetet e Allahut dhe i vrasin profetët padrejtësisht dhe i vrasin njerëzit që urdhërojnë për mirë, përgëzoi ata me dënim të dhimbshëm. Atyre u janë shkatërruar punët në dynja dhe ahiret dhe nuk kanë asnjë ndihmues﴾** Ali Imran 22. Punët rrëzohen vetëm nëse vepron shirk që të nxjerr prej islamit, sepse Allahu thotë: **﴿Nëse do të bënin shirk kishin për t’u rrëzuar ato që punonin﴾** El enam 88.

Ibn Tejmije thotë: “*Nëse supozojmë se disa persona i thonë profetit: Ne e besojmë me zemra atë që të është shpallur pa pikë dyshimi dhe i pohojmë me gojë të dy dëshmitë, mirëpo nuk të bindemi ty në asnjë urdhër dhe ndalesë. As nuk falemi, as nuk agjërojmë, as nuk bëjmë haxh, as nuk themi të vërtetën, as nuk e çojmë në vend amanetin, as nuk e përmbushim premtimin, as nuk i ruajmë lidhjet farefisnore dhe nuk veprojmë asnjë prej vepër të mirë me të cilën ke urdhëruar. E pijmë verën, martohemi me mehremet me zina, vrasim sa të kemi mundësi prej sahabëve dhe prej umetit tënd, ua grabisim pasuritë, madje edhe ty të vrasim dhe luftojmë kundër teje në rradhët e armiqve të tu. A mos vallë njeriu i logjikshëm mund të përfytyrojë se profeti do u thoshte: Ju jeni besimtarë me iman të plotë. Ju ka për t’ju përfshirë shefati (ndërmjetësimi) në ditën e ringjalljes dhe shpresoj të mos hyni në zjarr. Përkundrazi çdo musliman pa pikë dyshimi e dhi se ai do u thoshte: Ju jeni njerëzit më qafirë me atë që jam dërguar, dhe kishte për t’i vrarë nëse nuk pendoheshin prej kësaj*”.²

Dhe thotë: “*Dëmtimi i muslimanëve*³ është më i rëndë se ndryshimi i fesë. Nëse ai që dëmton muslimanët dhe kujton se besimin në zemër e ka në rregull, ai te Allahu ﷻ, i dërguari i tij ﷺ dhe besimtarët është gënjeshtar në këtë pretendim. Dëmtimi i muslimanëve është më i rëndë sesa ndryshimi i fesë në dy aspekte:

- 1- Për shkak se dëmi i shkaktuar është më i madh.
- 2- Sepse ai kujton se besimi i tij është në rregull.

¹ E transmeton Taberani, Sahih el xhami es sagir, 3156.

² Mexhmu’ul fetaua, 7/287.

³ Me dëmtimin e muslimanëve kihet për qëllim dëmtimi i tyre për shkak të pasimit të islamit. Edhe ai që i lufton të gjithë muslimanët është qafir sepse fakti që ai i lufton të gjithë muslimanët për interesa personale dhe të kësaj bote, dëshmon se ai i lufton për shkak të fesë së tyre dhe padyshim ai ka bërë kufër dhe ka dalë prej fesë. Gjithashtu ai që i shan të gjithë muslimanët pa përjashtim ai është qafir sepse ai i shan të gjithë muslimanët vetëm e vetëm se ata janë të kapur me fenë e Allahut.

Prandaj kur këto vepra ndodhin prej atij që nuk dëshiron të ndërrojë fenë, dëmi i tij është më i madh se dëmi i ndryshimit të fesë, sepse ndryshimi i fesë dihet që është kufër dhe dëmi i tij është si dëmi i çdo qafiri të rëndomtë. Ndërsa ky person kujton se kjo është vetëm gjynah dhe jo kufër përveçse nëse e lejon me zemër. Mirëpo në të vërtetë ajo është prej llojeve më të mëdha të kufirit”¹

Argument për kufirin e atij që i torturon dhe keqtrajton muslimanët për shkak të imanit dhe urdhërimit me drejtësi ashtu siç ka urdhëruar Allahu, është se ai urren atë që ka zbritur Allahu. Allahu ﷻ në librin e tij ka urdhëruar për miqësimin e besimtarëve dhe dashurinë e tyre dhe kush urren atë që ka zbritur Allahu ﷻ ai është qafir dhe murted edhe nëse me gojë pretendon të kundërtën. Pretendimi i dashurisë për diçka dhe luftimi i saj në të njëjtën kohë nuk mund të bashkohen në një zemër të vetme sepse ato hedhin poshtë njëra-tjetrën.

Allahu thotë: **«Ata që kanë bërë kufër mallkuar qofshin dhe Allahu ua ka humbur punët e tyre, sepse ata e urryen atë që Allahu e zbriti prandaj ua rrëzoi punët e tyre»** Muhamed 9. Allahu e lidhi shkakun e kufirit të tyre me urrejtjen për atë që Allahu e ka shpallur.

Dhe thotë: **«Ata që ia kthyen shpinën udhëzimit pasi u sqarua, ata i mashtroi dhe i inspiroi shejtani sepse ata u thanë atyre që urryen atë që zbriti Allahu: Do ju bindemi në disa gjëra dhe Allahu e di mirë atë që fshehin»** Muhamed 26.

Nëse ata që vetëm me fjalë u thonë atyre që urrejnë shpalljen e Allahut: Do ju bindemi në disa gjëra, kanë bërë ridde dhe janë kthyer në qafirë pasi ju sqarua udhëzimi dhe e vërteta, atëhere çfarë mund të themi për ata që e urryen shpalljen e Allahut. Pa dyshim kufri i tyre është më i madh dhe më i rëndë se kufri i atyre që ju bindën munafikëve.

Urrejtja e asaj që e ka shpallur Allahu është prej gjërave më të mëdha që e rrëzon islamin, siç e përmend këtë shejh Muhamed ibn Abdulvehabi kur thotë: *“Kush urren diçka që Allahu e ka zbritur, edhe nëse e praktikon atë (që e urren), ai bën kufër me ixhma. Argument është fjala e Allahut: «sepse ata e urryen atë që Allahu e zbriti prandaj ua rrëzoi punët e tyre»* Muhamed 9.”.

Urrejtja buron nga zemra dhe arrihet të njihet me shenja të ndryshme në vepra. Shenja më e qartë për urrejtjen është përdorimi i forcës, internimi dhe torturimi i asaj që e urren. Vepra të tilla dëshmojnë për realitetin e zemrës dhe nuk kanë nevojë për shenja dhe argumente më të detajuara. Nëse një person kryen një kasaphanë të vërtetë duke vlarë dhe torturuar ata që i urren për t’u hakmarrë për të kotën, është budallallëk të pyesim: A e pranon me gojë se ti i urren këta që po i vret dhe po i torturon? Ne të gjykojmë vetëm me atë që e pranon me gojë ndërsa për torturat, vrasjet dhe krimet që i kryen me dorë je i lirë të veprosh çfarë të duash, se do ta gjejmë ndonjë arsye për justifikimin e tyre. Kërkojmë mbrojtje prej

¹ Es sarimul meslul, fq. 371.

Allahut prej devijimit dhe humbjes së xehmive dhe murxhivë.

Prej veprave që janë kufër në vetvete është edhe adhurimi i tjetërkujt përveç Allahut ﷻ si sexhdja për idhujt, sexhdja për varret dhe vendet e mira, lutja e krijesave për ndihmë të cilën e ka në dorë vetëm Allahu ﷻ, therja kurban për dikë tjetër përveç Allahut ﷻ, vendosja ndërmjetës në adhurim mes krijesave dhe Allahut ﷻ duke shpresuar shefatin e tyre dhe duke u afruar me adhurimin e tyre të Allahut ﷻ. Këto vepra janë kufër në vetvete, pa pyetur nëse e lejon me zemër apo jo. Allahu ﷻ thotë për mushrikët: **﴿E Allahut është feja e pastër. Ndërsa ata që kanë marrë përveç tij evlija (dhe thonë): I adhurojmë ata vetëm që të na afrojnë të Allahu. Allahu do të gjykojë mes tyre për atë që kundërshtohen. Allahu nuk e udhëzon atë që është gënjeshtar dhe qafir﴾** Ez zumer 3.

Dhe thotë: **﴿Ai që e synon takimin me zotin e tij le të veprojë vepra të mira dhe të mos i bëj Allahut shok në adhurim asgjë﴾** El kehf 110.

Dhe thotë: **﴿Thuaj: Unë i lutem vetëm zotit tim dhe nuk i bëj shok atij asgjë﴾** El xhin 20.

Dhe thotë: **﴿Allahu nuk e fal t'i bëhet shirk dhe ia fal atë që është më e vogël se ai atij që dëshiron﴾** En Nisa: 48.

E shumë ajete të tjera që dëshmojnë për kufrin e atij që i bën shirk Allahut ﷻ në çfarëdo lloj adhurimi.

Shejh Kashmiri thotë: *“Ibn Tejmije në librin e tij “Imani” thotë: Ka pajtim për disa vepra se janë kufër, megjithëse mund të pohojë me zemër (të kundërtën), sepse ato janë vepra me gjymtyrë dhe jo me zemër si shakaja me fjalë kufri edhe nëse nuk i beson me zemër, si sexhdja për idhujt, vrasja e profetëve, tallja me ta ose me Kuranin ose me Qaben. Mirpo janë dhënë mendime të ndryshme për formën e kufrit, pas konsensusit se ai shpallet qafir. Një mendim thotë se në shariat besimi i tij me zemër nuk merret parasysh edhe nëse ai në realitet ekziston.*

Ebu Bekau në librin “El kulijat” thotë: Kufri ndonjëherë mund të ndodhë me fjalë dhe ndonjëherë me vepra. Për fjalët që shkaktjnë kufër, si puna e përgënjeshtimit të diçkaje që ka pajtim të plotë dhe argumente të qarta, nuk bëhet dallim mes tyre për ato që thuhet prej besimit të zemrës, prej inatit apo në formë tallje. Ndërsa veprat që shkaktjnë kufrin janë ato vepra që kryen me vullnet të plotë dhe nënkuptojnë nënçmim të fesë si sexhja për idhujt”.¹

Shejh Muhamed ibn Abdulvehabi thotë: *“Dhjetë gjërat kryesore që e prishin islamin janë:*

E para: Shirku në adhurimin e Allahut ﷻ të vetëm dhe të pashok. Argument për këtë është fjala e Allahut: ﴿Allahu nuk e fal t'i bëhet shirk dhe ia fal atë që është më e vogël se

¹ Ikfar el mulhidin.

ai atij që dëshiron» En Nisa: 48. *Këtu hyn edhe kurbanit për dikë tjetër përveç Allahut si ata që therin për teqet dhe xhinët.*

E dyta: Ai që mes tij dhe mes Allahut vendos ndërmjetës, të cilëve u lutet dhe u kërkon shefatin. Ky person bën kufër me ixhma.¹

Prej veprave të kufrit që të nxjerrin prej islamit është kthimi i shpinës ndaj shariatit të Allahut totalisht, as nuk e mëson dhe as nuk punon sipas tij. Gjithashtu edhe kthimi i shpinës ndaj gjykimit me atë që ka zbritur Allahu ﷻ dhe zëvendësimi i shariatit me ligje dhe dispozita të tagutit.²

Allahu ﷻ thotë: **«Kush është më i padrejtë se ai që përkujtohet me ajetet e Allahut pastaj ua kthen shpinën atyre. Ne kemi për t'u hakmarrë prej kriminelëve»** Es sexhde 22.

Dhe thotë: **«A nuk i shikon ata që pretendojnë se kanë besuar atë që të është zbritur ty dhe atë që është zbritur para teje, dëshirojnë të gjykohen te taguti ndërkohë që janë urdhëruar të bëjnë kufër me të»** En nisa, 60.

Dhe thotë: **«Jo pasha zotit tënd ata nuk besojnë derisa të të bëjnë ty gjykatës për atë që ka ndodhur mes tyre dhe pastaj të mos gjejnë në vetet e tyre asnjë siklet prej gjykimit tënd dhe ta pranojnë me nënshtrim»** En nisa, 65.

Dhe thotë: **«A mos po kërkojnë gjykimin e xhahilijetit! E kush është më i mirë në gjykim se Allahu, për popullin që janë të bindur»** El maide, 50.

Dhe thotë: **«Kush nuk gjykon me atë që e ka zbritur Allahu mu ata janë qafirët»** El maide 44.

Dhe thotë: **«E nëse u thuhet: Ejani te ajo që ka zbritur Allahu dhe te i dërguari, ke për t'i parë munafikët t'i ndalojnë njerëzit prej teje»** En nisa 61.

Dhe thotë: **«A i shikon ata të cilëve u është dhënë një libër më parë. Thirren për te libri i Allahut që të gjykojë mes tyre mirëpo një grup prej tyre zbrapsen dhe i kthejnë shpinën»** Ali Imran 23.

Dhe thotë: **«Nëse u bindeni atyre atëhere ju jeni mushrikë»** El enam 121.

Dhe thotë: **«I morrën priftërinjtë dhe murgjit e tyre për zotër përveç Allahut) Et teube, 31.**

Dhe thotë: **«dhe nuk i bën shok në adhurim zotit të tij asgjë»** El kehf 110.

¹ Er resail shehsije, fq. 212-213.

² Këtu duam vetëm të sqarojmë se kufri mund ndodhë me fjalë dhe vepra ashtu siç mund të ndodhë me zemër. Nuk kemi për qëllim të përmendim të gjitha veprat që të nxjerrin prej islamit. Për këtë temë kam shkruar një libër dhe tema të tjera. Mund të kthehesh te libri "Vepra që të nxjerrin prej islamit".

E shumë ajete të tjerë. Nëse do të citonim një nga një fjalët e dijetarëve dhe të komentuesve të Kuranit për këto ajete, kishim për t'u bindur se cilësitë e përmendura në to janë vetëm për qafirin, mushrikun dhe murtedin.

Shejh Muhamed ibn Ibrahim thotë: “*Ai që gjykon me atë që nuk e ka zbritur Allahu është qafir ose kufër besimi me zemër që e nxjerr prej islamit ose kufër veprë që nuk e nxjerr prej islamit*”.¹

I pari është kufër besimi dhe ai është disa llojësh....

Lloji i pestë: Ky lloj është më i rëndi, më i përgjithshëm, më i qarti në refuzimin e sheriatit dhe ligjeve të tij, më i distancuari nga Allahu dhe i dërguari, ai që më shumë i rivalizon gjykatat e sheriatit nga aspekti i hartimit, financimit, parimeve dhe neneve, formave dhe llojeve, gjykimit dhe zbatimit, në burime dhe dokumentacion. Ashtu siç kanë gjykatat e sheriatit burime të bazuara në librin e Allahut dhe sunetin e profetit po kështu edhe këto gjykata kanë për burim ligjin e hartuar nga përzgjedhja e ligjeve të ndryshme, si ligji francez, ligji amerikan, ligji britanik ose ligje të tjera. Ato mund të jenë përzgjedhur prej rrymave bidatçije që i mvishen sheriatit ose nga gjëra të tjera.

Këto gjykata në shumë vende të islamit janë të përgatitura dhe të plotësuara. Dyert i kanë të hapura dhe njerëzit hyjnë turma turma. Gjykatësit e tyre gjykojnë mes muslimanëve me ligje që kundërshtojnë Kuranin dhe sunetin, prej neneve të ligjit të cilat u obligohen dhe vihen në zbatim mbi muslimanët. Cili kufër është më i madh se ky kufër?! Cili zhvlerësim i dëshmisë se Muhamedi është i dërguari i Allahut është më i madh se ky zhvlerësim?!”.

Shejh Ibn Bazi thotë: *S’ka iman ai që beson se gjykimet dhe mendimet e njerëzve janë më të mira se gjykimi i Allahut dhe i të dërguarit, apo njësoj si to, apo i përngjasojnë atyre, apo i braktis ato dhe vendos në vend të tyre ligje të shpikura dhe sisteme me burim prej njeriut edhe nëse beson me zemër se ligjet e Allahut janë më të mira, më të përkryera dhe më të drejta*”.²

Dyshim që e përhapin murxhitë dhe xehmitë.

Sa herë që tagutët e ligjeve të shpikura, të cilët s’kanë lënë lloj kufri pa e vepruar, përmenden me fjalë të këqija që u shkojnë përshtat dhe i meritojnë, ngrihen murxhitë me lloj-lloj justifikimesh për t’i mbrojtur, sepse kufri i tyre nuk është kufër i madh por kufër i vogël.

¹ Ndonjëherë dijetarët e përdorin termin “kufër i besimit” për kufirin e madh që të nxjerr prej islamit dhe jo kufirin që vepohet vetëm me zemër ose mohohet me zemër. Gjithashtu e përdorin termin “kufër veprë” për kufirin e vogël, qoftë ai me zemër apo me vepra. Kanë për qëllim kufirin e vogël që nuk të nxjerr prej islamit dhe nuk kanë për qëllim vetëm kufirin që vepohet me vepra të gjymtyrëve.

² “Gjykimi me ligje të shpikura” i shejh Muhamed Ibrahim Ali Shejhut, fq: 13, 17, 18 dhe përgjigjja e shejh bin Bazit në broshurën “Detyra e gjykimit me sheriat” fq, 39, botim i shtëpisë botuese “Muslim”.

Ata argumentohen me fjalën e Ibn Abasit¹ duke i kërkuar umetit që t'u binden dhe t'i duan këta qeveritarë dhe të mos rebelohen kundër tyre. Sipas tyre çdokush që i kundërshton ata, apo gëzohet me kryengritjet kundër tyre, ai është gjynahqar, i humbur, harixhi dhe prej xhematit të tekfirit.

Këtyre të humburve u themi: Kur i konsideroni këta tagutë si qafirë?!

Thonë: Kur ta konsiderojnë hallall gjykimin me atë që nuk e ka shpallur Allahu.

U themi: Ai që refuzon të gjykojë me atë që ka shpallur Allahu dhe lufton gjykimin me shariat dhe këdo që kapet pas shariatit, ose kërkon vendosjen e shariatit dhe në të njëjtën kohë nuk lëkundet në asnjë moment për gjykimin me ligjet e tagutit duke i imponuar ato mbi njerëzit me forcën e armës dhe anëmbanë vendit, a nuk e ka konsideruar ky person gjykimin me atë që nuk e ka shpallur Allahu për të lejuar?!

Thonë: Jo derisa të shprehet qartë se ai e mohon gjykimin e Allahut ose se ai e lejon që të gjykohet me atë që nuk e ka shpallur Allahu, ndërsa kjo që përmend ti është kufër vepra dhe nuk mjafton për t'i shpallur qafirë.

U themi: Po e fillojmë çështjen më shumë. Ai aspak nuk heziton në ligjërimin e ligjeve që rivalizojnë dhe kundërshtojnë shariatin e Allahut. Ai e konsideron ligjëvënien e tij detyrë të shenjtë që duhet zbatuar dhe pasuar dhe mjerë për atë që e kundërshton apo e korrigjon. A nuk e ka lejuar një person i tillë gjykimin me atë që nuk e ka zbritur Allahu dhe ka bërë kufër?

Thonë: Të gjitha këto nuk janë argument për konsiderimin hallall sepse ti përmende vepra, prandaj ai konsiderohet kufër në vepra dhe një kufër i tillë nuk të nxjerr prej islamit.

U themi: T'ju japim edhe disa informacione të tjera: Mbase nuk e dini, ose nuk doni ta dini, që taguti e përshkruan ligjin e tij si burim të drejtësisë, përparimit dhe lumturisë së shoqërisë, duke i thurur plot e plot elozhe të tjera në median e folur dhe në shtypin e shkruar. Çfarë mendimi keni për këtë?

Thonë: A ja ke hapur zemrën që ta dish se e ka lejuar apo jo gjykimin me atë që Allahu nuk e ka shpallur? A nuk e dëgjoni që ai thotë “La ilahe il-lallah”. Si ta bëjmë qafir atë që thotë “La ilahe il-lallah”?!

U themi: Në të njëjtën kohë ata e rrëzojnë dhe e përgënjeshtrojnë fjalën “La ilahe il-lallah” me fjalë dhe vepra. Ata janë njësoj si ai që thotë diçka dhe atë që e prish atë gjë, njëkohësisht. Një personi të tillë fjala “La ilahe il-lallah” nuk i bën dobi aspak.

Thonë: A e rrëzoi fjalën “La ilahe il-lallah” me lejim dhe mohim në zemër apo vetëm me vepra?

¹ E shpjeguar fjalën e Ibn Abasit “Kufër më i vogël se kufri” dhe se zbatimi i kësaj fjale për tagutët të cilët kanë rënë në të gjitha llojet e kufrit sëbashku, është padrejtësi që i bëhet Ibn Abasit dhe fjalës së tij.

U themi: Atëhere çfarë thoni për Iblisin? A mos ka qënë kufri i tij prej lejimit dhe mohimit me zemër apo edhe për Iblisin mendoni se nuk është qafir¹?

Nëse këto fjalë nuk janë fjalët e murxhive dhe xhehmive atëhere fjalët e kujt janë? Ju jeni murxhi dhe xhehmi edhe nëse e quani veten me emra të tjerë dhe pretendoni me gojë se nuk pajtoheni me rrugën e tyre dhe pretendoni se jeni në rrugën e selefit. Allahu i lartë do të gjykojë mes jush.

Çështja e lënësit të namazit:-

Prej punëve që janë kufër në vetvete është edhe lënia e namazit qoftë edhe pa e mohuar atë. Për këtë dëshmojnë argumentet e shariatit dhe ky është mendimi i selefit të këtij umeti.

I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Mes robit dhe kufrit e shirkut është lënia e namazit”**.

Dhe thotë: **“Mes njeriut dhe kufrit dhe shirkut është lënia e namazit”**.

Dhe thotë: **“Besa që është mes nesh dhe mes tyre është namazi. Kush e lë atë ka bërë kufër”**.

Dhe thotë: **“Mes robit dhe kufrit dhe imanit është namazi e nëse e lë atë ka bërë shirk”**.

Dhe thotë: **“Mbrojtja e Allahut është ndërprerë prej atij që e lë namazin me qëllim”**.

Dhe thotë: **“Do të këputen shtyllat e islamit një nga një, sa herë që rrëzohet një shtyllë, njerëzit kapen fort pas tjetrës. E para që do të rrëzohet është gjykimi dhe e fundit është namazi”**.² Pra kush e lë namazin, atij i janë rrëzuar të gjitha shtyllat e islamit dhe nuk i ka mbetur asgjë me çfarë të kapet.

Ibn Mesudi ؒ ka thënë: **“Kush e lë namazin është i pafe”**.³

Ebu Dardaja ؓ ka thënë: **“Nuk ka iman ai që nuk falet dhe nuk ka namaz ai që nuk merr abdes”**.⁴

Abdullah ibn Shakik Ukaliu ؒ ka thënë: **“Sahabët e Muhamedit nuk shikonin se lënia**

¹ Prej fjalëve më të çuditshme është pretendimi i disa prej tyre se Iblisi ka bërë kufër përgënjeshttrimi. Ata kundërshtuan fjalën e Allahut: **﴿Kur u thamë melaikeve: Bëjini sexhde Ademit dhe të gjithë ata ranë në sexhde përveç Iblisit i cili u tregua mëndjemadh dhe u bë prej qafirëve﴾** El Bekare 34. Dhe thotë: **﴿përveç Iblisit i cili u tregua mëndjemadh dhe u bë prej qafirëve﴾** Sad 74. E shumë ajete të tjera që dëshmojnë se kufri i Iblisit ka qënë për shkak të mëndjemadhësisë dhe mosbindjes dhe jo për shkak të përgënjeshttrimi.

² Të gjitha këto hadithe janë të sakta, disa prej tyre janë në dy sahihet. Shiko Sahih et terhib, 564, 563, 565, 568, 571.

³ Sahih et terhib, 573.

⁴ Sahih et terhib, 574.

e ndonjë veprë është kufër përveç namazit".¹ Këtu kihet për qëllim kufri i madh sepse sahabët shumë punë të tjera i konsideronin kufër të vogël.

Hafidh Mundhiriu thotë: *"Një grup sahabësh dhe dijetarë të tjerë pas tyre mendojnë që lënia e namazit derisa t'i dal koha dhe me qëllim është kufër, prej tyre: Umer Ibn Hatabi, Abdullah Ibn Mesudi, Abdullah ibn Abasi, Muadh Ibn Xhebeli, Xhabir Ibn Abdullahi dhe Ebu Dardaja, Allahu qoftë i kënaqur prej të gjithëve.*

Ndërsa prej dijetarëve pas sahabëve: Ahmed ibn Hambeli, Ishak ibn Rahaveji, Abdullah ibn Mubarek, Nehaiu, Hakem ibn Utejbe, Ejub Sihtijani, Ebu Daud Tajalisi, Ebu Bekr ibn Ebi Shejbe, Zuhejr ibn Harbi dhe shumë të tjerë".²

Ibn Tejmije thotë: *"Konsiderimi i lënësit qafir është mendimi më i njohur prej shumicës së selefët prej sahabëve dhe tabinëve. Edhe për vrasjen ka dy mendime: A vritet qafir apo si fasik? Shumica e selefët mendojnë se ai vritet si qafir. E gjithë kjo nëse ai e pohon se namazi është vaxhip*".

Në një fjalë tjetër thotë: *"Kush këmbëngul në braktisjen e namazit dhe nuk falet fare dhe vdes në këtë gjendje ai nuk është musliman*".³

Nëse shkakut i konsiderimit qafir është mohimi i namazit dhe jo lënia e tij, çfarë e dallon namazin prej adhurimeve të tjera, sepse edhe mohimi se sivaku është sunet ose mohimi i suneteve të tjera mutevatira është kufër, duke ditur që namazi është shtylla më madhe e islamit pas shehadetit?!

Patjetër që namazi bën dallim nga adhurimet e tjera sepse lënia e tij konsiderohet kufër në vetvete dhe Allahu është më i ditur.

Hanbeli thotë: Më ka treguar Humejdi thotë: *"Më kanë treguar që disa njerëz thonë: Kush e pohon namazin, zekatin, agjërimin dhe haxhin por nuk vepron asnjë prej tyre derisa të vdesë dhe falet me shpinë nga kibla ai është besimtar përderisa nuk mohon. U thashë: Ky është kufri i qartë dhe kundërshtim i librit të Allahut, i sunetit të profetit ﷺ dhe dijetarëve islam. Allahu ﷻ thotë: **﴿Ata u urdhëruan të adhurojnë vetëm Allahun me singëritet, nënshtrim dhe pastërti dhe ta falin namazin e ta japin zekatin dhe kjo është feja e vyer﴾** El bejineh, 5.*

Pastaj Hanbeli thotë: E kam dëgjuar Ebu Abdullah Ahmed ibn Habelin të thotë: Kush e thotë këtë ka bërë kufër me Allahun ﷻ dhe i është kundërvënë urdhit të tij dhe shpalljes që profetit ﷺ i është shpallur".⁴

Çështjen e lënësit të namazit e kemi trajtuar në librin me titull "Gjykimi për lënësin e

¹ E transmeton Tirmidhiu dhe të tjerë. Sahihut tergib uet terhib, 564.

² Sahih et tergib, fq. 235.

³ Mexhmu'ul fetaua, 20/96, 22/49, 28/308.

⁴ Marrë prej Mexhmu'ul fetaua të Ibn Tejmijes, 7/209.

namazit” ku u jemi përgjigjur gjerësisht argumenteve të palës tjetër.

Vërjetje:-

Këtu duhet të përmendim një rregull të njohur te ehlisuneti se: Nëse imani është besim me zemër, fjalë dhe vepër, dhe disa vepra janë kusht për saktësimin e imanit dhe disa të tjera jo, atëhere prej kësaj rrejdh që edhe kufri mund të jetë me zemër, fjalë dhe vepra.

Kush thotë se imani është besim me zemër, fjalë dhe vepër, shtohet dhe paksohet duhet patjetër të pohojë se edhe kufri është me besim me zemër, fjalë dhe vepra, ose përndryshe ka rënë në kundërshtim me vetveten.

Kush thotë se imani është vetëm vërtetim me zemër dhe fjalë goje prej kësaj rrjedh që kufri ndodh vetëm me përgënjeshttrimin e zemrës dhe me fjalë.

E kush thotë: Imani është vetëm vërtetim dhe njohje me zemër prej fjalës së tij rrjedh që kufri është vetëm me përgënjeshttrimin e zemrës. Dhe ky është medhhebi i Xhehmiut.

Ndërsa ata që e përkufizojnë imanin me përkufizimin e selefrit dhe në anën tjetër e përmbledhin kufirin vetëm në përgënjeshttrimin dhe mohimin me zemër, ata në një aspekt kanë rënë në kontradiktë me vetveten dhe në aspektin tjetër janë pajtuar me fjalën e xhehmive të humbur, edhe nëse me gojë pretendojnë se ndjekin akiden dhe rrugën e ehlisunetit.



Rregulli i shtatë: Përcaktimi i një kufri si kufër i vogël në vepra bëhet vetëm me argument dhe dëshmi nga sheriatit.

Më parë e cekëm se kufri ndahet në kufër të madh që të nxjerr prej islamit dhe kufër të vogël që nuk të nxjerr prej islamit. Këtu parashtrohet një pyetje: Si të bëjmë dallim mes këtyre dy llojeve? Si ta dimë që kufri i përmendur në argumentet e sheriatit është kufër i madh apo i vogël?

Dije se dispozitat e sheriatit të shtjelluara në Kuran dhe në sunet nuk lejohet t'i nxjerrim prej kuptimit aparent të tyre dhe t'i shpjegojmë me kuptime të tjera, përveçse nëse bazohemi në argumente të tjerë që dëshmojnë se kjo fjalë dhe kjo dispozitë ka një kuptim tjetër. Pa këtë rregull do të hidheshin poshtë shumë dispozita dhe do hapej porta interpretimeve të kota dhe deformimeve të zindikëve, të cilët do të gjenin fushë të lirë për të praktikuar humbjen e tyre. Në anën tjetër nëse tekset komentohen jo në kuptimin parësor të tyre ky është një përshkrim i gjërave në kundërshtim me cilësitë që Allahu ﷻ i ka përshkruar dhe është një shtrembërim i fjalës së Allahut ﷻ dhe profetit ﷺ.

Nëse Allahu ﷻ, ose i dërguari ﷺ, e përshkruajnë një vepër të caktuar si kufër, ky kufër duhet interpretuar në kuptimin parësor të tij. Kufri në kuptimin parësor nënkupton kufrin e madh i cili e rrëzon imanin, e nxjerr njeriun prej islamit dhe dënohet me zjarr të përherëshëm. Nuk lejohet që ky kufër të nxirret prej kuptimit parësor dhe të interpretohet si kufër mirësie apo kufër i vogël që është në gradën e gjynaheve të cilat nuk dënohen me zjarr të përherëshëm, vetëm në rast se ekziston ndonjë argument tjetër në sheriat që dëshmon për daljen e tij prej kuptimit parësor. Nëse nuk ekziston asnjë argument ose dëshmi atëhere duhet gjykuar me kuptimin e tij parësor.

Ibn Hazmi thotë: *“Nuk mund të emërtojmë në sheriat asgjë me ndonjë cilësi vetëm nëse Allahu na ka urdhëruar ose na e ka lejuar ta emërtojmë me atë cilësi. Vetëm nëpërmjet shpalljes mund të dimë se çfarë ka dashur Allahu të thotë. Allahu i ka qortuar ata që emërtojnë ndonjë gjë në sheriat pa lejen e tij: ﴿Ato (idhuj) janë vetëm emra me të cilat i keni quajtur ju dhe baballarët tuaj. Allahu nuk ka zbritur asnjë argument për to. Ata ndjekin vetëm hamëndje dhe epshin e tyre ndërkohë që prej zotit të tyre u ka ardhur udhëzimi. A mos po kujton njeriu se atij i takon çfarë t'i teket﴾ En nexhm 24. Dhe thotë: ﴿Ia mësoi Ademit të gjithë emrat pastaj i paraqiti përpara melaikeve dhe u tha: Më njoftoni për emrat e tyre nëse jeni të sinqertë. I thanë: Ne dimë vetëm atë që ti na ke mësuar﴾ El bekare 32. As melekëve dhe as njerëzve nuk u lejohet të emërtojnë diçka pa lejen e Allahut. Kush kundërshton këtë gjë ka shpifur ndaj Allahut dhe ka kundërshtuar Kuranin.*

Prandaj ne quajmë besimtar vetëm atë që Allahu e ka quajtur besimtar dhe nuk e

*mohojmë imanin prej askujt që ka hyrë në të përveç nëse Allahu e ka mohuar. Disa vepra Allahu i ka cilësuar si iman por nuk e ka mohuar cilësimin me iman të personit që i lë ato vepra dhe ne nuk na lejohet ta mohojmë imanin e këtij personi, por themi atij i ka humbur një pjesë e imanit dhe jo i gjithë imani”.*¹

Argumentet që vërtetojnë këtë rregull janë të shumtë, prej tyre mund të përmendim:

1- Mospaguesi i zekatit.

Allahu thotë: **﴿Nëse pendohen dhe e falin namazin dhe e japin zekatin ata janë vëllezërit tuaj në fe. Ne i qartësojmë ajetet për ata që kuptojnë﴾** Et teube 11.

Kuptimi i anasjelltë nënkupton që nëse nuk pendohen prej shirkut dhe nuk e falin namazin dhe nuk e japin zekatin, ata nuk janë vëllezër në fe dhe vllazëria fetare mohohet vetëm prej qafirëve.

Në aparence ajeti është argument për kufirin e atij që lë namazin dhe nuk jep zekatin. Mirëpo bazuar në një argument tjetër kufri i lënësit të zekatit nxirret nga kuptimi parësor i kufirit të madh. Prandaj gjykojmë për lënësin e namazit se është qafir, ndërsa për lënësin e zekatit nuk gjykojmë se është qafir, përshkak të dëshmimeve të tjera në shariat që e mohojnë kufirin e lënësit të zekatit. Argument për këtë është fjala e profetit ﷺ në sahihun e Muslimit: **“Allahu ka për ta mbledhur pasurinë e çdo pronari që nuk e paguan detyrimin e tij dhe ka për ta nxehur në zjarr të xhehenemit, pastaj ka për të vulosur me të ballin, krahët dhe shpinën e tij, derisa të përfundojë gjykimi mes krijesave në një ditë që është pesëdhjetë mijë vjet sipas llogarisë suaj, pastaj shikon rrugën e tij për në xhenet apo për në zjarr”.**² Kjo nënkupton se ai është në mëshirë të Allahut ﷻ, nëse dëshiron e fal dhe e fut në xhenet dhe nëse dëshiron e dënon dhe e fut në zjarr. Ai nuk është qafir sepse qafiri dënohet me zjarr të përjetshëm dhe nuk falet, siç thotë Allahu: **﴿Allahu nuk e fal t’i bëhet shirk dhe ia fal atë që është më e vogël se ai atij që dëshiron﴾** En Nisa: 48.

Prej argumenteve që dëshmojnë se kufri i lënësit të zekatit nuk është i madh është edhe fjala e Abdullah ibn Shakik Ukejliut ؓ: **“Sahabët e Muhamedit nuk shikonin se lënia e ndonjë vepre është kufër përveç namazit”.**³ Kjo padyshim e përfshin edhe lënien e zekatit.

2- Kufri i nimetit (mirësisë) dhe kufri (mosmirënjohja) i jetesës bashkshortore.

Ibn Abasi ؓ trasnemeton se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Mu shfaq zjarri dhe shumica e banorëve të tij ishin gra për shkak të mohimit (kufrit) të tyre. I thanë: “O i dërguar i Allahut a i bëjnë kufër Allahut? Tha: “Mohojnë jetesën bashkeshortore dhe mohojnë mirësinë. Sikur të tregohesh bamirës ndaj saj për gjithë jetën, pastaj shikon prej**

¹ El fisal fil milel uen ahuai uen nihel, 3/191.

² E transmeton Muslimi.

³ E transmeton Tirmidhiu dhe të tjerë. Sahihut tergib uet terhib, 564.

teje diçka të vogël, do të të thotë: Kurrë s'kam parë hair prej teje".¹

Fillimisht sahabët e kuptuan fjalën kufër për kufër me Allahun, sepse profeti ﷺ e tha të pakufizuar me ndonjë shenjë që të lë të kuptosh se nuk kihet për qëllim kufri me Allahun ﷻ, por gjynahu që është më i vogël se kufri, derisa profeti ﷺ ua sqaroi se kufri këtu nënkupton kufrin (mohimin) e mirësisë dhe jo kufrin të cilin e kujtuan sahabët.

Imam Buhariu e transmeton këtë hadith në kapitullin me titull: Mosmirënjohja për jetesën bashkshortore dhe kufri që është më i vogël se kufri.

Kadi Ebu Bekr ibn Arabiu thotë: *“Autori ka për qëllim të sqarojë se ashtu siç quhen veprat e mira iman edhe gjynahet quhen kufër, mirëpo ato cilësohen me kufrin që nuk të nxjerr prej islamit”*.²

Këtu hyn edhe fjala e profetit: *“Kujt i jepet një dhuratë dhe gjen atëhere le ta shpërblejë atë, e nëse nuk gjen le të thotë fjalë të mirë sepse ai që thotë fjalë të mirë ka falenderuar, dhe kush hesht ka bërë kufër (mosmirnjohje)”*.³ Pra është treguar mosmirënjohës për mirësinë dhe nimetin e atij që i dha këtë dhuratë.

Profeti ka thënë: *“Kush nuk falenderon për të paktën nuk ka falenderuar për të shumtën. Kush nuk i falenderon njerëzit nuk e ka falenderuar Allahun. Të folurit për mirësinë e Allahu është falenderim dhe lënia e saj është kufër (mosmirnjohje)”*.⁴ Pra është treguar mosmirënjohës për mirësinë që Allahu ia dhuroi dhe nuk kihet për qëllim kufri që të nxjerr prej islamit.

Kufri i nimetit nuk është si kufri me Allahun, me argument se mosdhënësi i zekatit që nuk e mohon atë, është prej njerëzve më mosmirnjohës për mirësitë e Allahut, sepse prej detyrave të falenderimit të mirësisë është nxjerrja e zekatit sipas shariatit. E megjithatë ai nuk bën kufër që të nxjerr prej islamit dhe vazhdon të jetë në mëshirë të Allahut siç u përmend më parë.

Gjithashtu profeti ka thënë: *“Kush e vret veten e tij me një hekur, me këtë hekur në dorë do të godasë barkun në zjarrin e xhehenemit përjetësisht. Kush pi helm dhe vret veten*

¹ E transmeton Buhariu.

² Fethul bari, 1/83.

³ Sahih et tergib uet terhib, 958.

⁴ Sahih et tergib 966. Kufri i mirësisë (mosmirnjohja) është dy lloje. Njëri lloj nënkupton mohimin e dhuruesit të mirësisë (Allahut) dhe pretendimi se mirësitë janë prej vetes dhe mundit të tij dhe jo prej Allahut. Ky është kufër i pastër që të nxjerr prej islamit. Allahu ﷻ thotë për Karunin: ﴿**Tha: Unë e kam fituar atë me dijen time. A nuk e di ai se Allahu i ka shkatërruar brezat që kanë qënë përpara tij e shumë prej tyre kanë pasur më shumë fuqi se ai dhe më shumë pasuri, mirëpo kriminelët nuk do pyeten për gjynahet e tyre**﴾ Al Kasas 78. Lloji tjetër nënkupton mosmirënjohjen për mirësinë dhe jo mohimin e dhuruesit të mirësisë, atëhere kur nuk falenderon për të dhe nuk e jep zekatin e saj. Ky është kufër i vogël që nuk të nxjerr prej islamit dhe Allahu është më i ditur.

ai ka për ta pirë atë në zjarrin e xhehenemit përjetësisht.¹

Ky hadith në pamje të parë të lë të kuptosh që vetëvrasësi është qafir. Qëndrimi i përjetshëm në zjarrin e xhehenemit është vetëm për qafirët të cilët vdesin në kufër dhe shirk dhe jo për gjynahqarët njësuës. Mirëpo bazuar në argumente të tjerë, të cilat e mohojnë kufrin prej atij që kryen vetëvrasje, por pa e lejuar atë², e kuptojmë se ai nuk është qafir. Dënimi i përmendur në hadithe është një formë kërcënimi për të penguar vetëvrasjen dhe për të sqaruar dëmin e madh të këtij gjynahu. Por ai sado që të dënohet në zjarr, në fund do të nxirret prej tij dhe destinacioni i tij do të jetë xheneti, me mëshirën dhe mirësinë e Allahut.

Argumenti që mohon kufrin e vetëvrasësit është hadithi që e transmeton imam Muslimi se i dërguari i Allahut ﷺ kur bëri hixhret për në Medine, bëri hixhret edhe Tufej ibn Amri ؓ me një burrë prej fisit të tij. Ai nuk u ambjentua dot me klimën e Medines dhe u sëmur prej humbjes së shpresës morri një gërshërë dhe preu nyjet e gishtave dhe i rrodhi gjak derisa vdiq. Më pas Tufejl ibn Amri ؓ e pa në ëndërr në pamje të bukur por me duar të mbuluara, dhe i tha: Çfarë veproi zoti me ty? I tha: Më fali për shkak të hixhretit tim³ te profeti ﷺ. I tha: Pse i shikoj duart të mbuluara? I tha: Më thanë: Nuk do ta rregullojmë atë që vetë e ke prishur. Pastaj Tufejli ؓ i tregoi profetit ﷺ dhe i dërguari i Allahut ﷺ tha: *“O Allah! Fale atë edhe për duart e tij”*.⁴

Fakti që Allahu ﷻ e fali për shkak të hixhretit dhe fakti që profeti ﷺ u lut për të me falje, na lë të kuptojmë që ai ka vdekur musliman, sepse Allahu ﷻ nuk e fal qafirin i cili vdes në kufër, sado të mëdha t'i ketë punët e mira dhe nuk lejohet të kërkojmë falje për të. Allahu thotë: **﴿Allahu nuk e fal t'i bëhet shirk dhe ia fal atë që është më e vogël se ai atij që dëshiron﴾** En Nisa: 48. Dhe thotë: **﴿Profetit dhe besimtarëve nuk u takon të kërkojnë falje për mushrikët edhe nëse janë të afërmit e tyre, pasi u është sqaruar se ata janë banorët e zjarrit﴾** Et teube 113.

Në sahihun e Muslimit transmetohet se i dërguari i Allahut ﷺ kur vizitoi varrin e nënës së tij qau aq sa edhe të pranishmit u prekën, pastaj tha: *“I kërkova leje zotit të kërkoj falje për të po nuk më lejoi. Pastaj i kërkova leje të vizitoj varrin e saj dhe më lejoi”*.⁵

Prej Aliut ؓ thotë: Dëgjova një person të kërkonte falje për prindërit e tij mushrikë. I thamë: Si po kërkon falje për ta kur ata janë mushrikë?! Tha: A nuk kërkoi falje Ibrahim i për

¹ E transmeton Muslimi.

² Lejimi me zemër në këtë rast është kusht për shpalljen e tij qafir sepse vetëvrasja nuk është kufër i madh në vetvete. Kushtëzimi i lejimit me zemër zbatohet për të gjitha gjynahet që nuk janë kufër dhe shirk i madh. Këto gjynahe kanë për qëllim dijetarët në fjalën e tyre: *“Nuk shpallim qafir askënd për shkak të gjynaheve përderisa nuk e konsideron të lejuar atë gjynah”*, pra gjynahet që nuk janë kufër i madh. Mirëpo ky kusht nuk vendoset për kufrin e madh i cili është kufër në vetvete, siç u sqarua më përpara.

³ Kjo dëshmon se veprat e mira i fshijnë të këqijat dhe e pengojnë dënimin e ndokujt.

⁴ E transmeton Muslimi.

⁵ E transmeton Muslimi dhe të tjerë.

babin e tij? Pastaj vajta dhe ia përmenda profetit ﷺ e më pas zbriti: **«Istigfari (kërkimi i faljes) i Ibrahimit për babain e tij ishte vetëm një premtim që ai ia pati dhënë, por kur iu sqarua se ai është armik i Allahut u distanca prej tij»**.¹

Këtu mund të hidhet një dyshim; se ky person e veproi këtë vepër para se vetëvrasja të ndalohej ose sepse atij nuk i kishte arritur argumenti dhe nuk e dinte se ishte haram prandaj edhe Allahu e fali.

Themi: Konteksi dëshmon të kundërtën. Nëse do të ishte kështu siç pretendove atëhere dy duart nuk do i kishte të mbuluara dhe nuk do i thuhej: *“Nuk do ta rregullojmë atë që vetë e ke prishur”*. Kjo dëshmon se ai e dinte që kjo është haram dhe i kishte arritur argumenti i sheriatit. Zbatimi i dënimit, qoftë edhe pjesërisht, është argument për arritjen e argumentit të sheriatit dhe se ai e dinte që ishte haram, sepse Allahu ﷻ thotë: **«Nuk do të dënojmë derisa të dërgojmë të dërguar»** El isra, 15. Kjo çështje u sqarua më gjerësisht në rregullin e parë.

Imam Nevevi në shpjegimin e hadithit thotë: *“Prej këtij hadithi nxirren konkluzione, sepse ky hadith është argument për një rregull të madh të ehlisuneti, se kush kryen vetëvrasje ose kryen ndonjë gjynah tjetër dhe vdes pa u penduar nuk dëshmohet për të se është në zjarr përkundrazi ai është në dëshirë të Allahut”*.²

Ibn Mubarek thotë: *“Të tilla transmetime që në pamje të jashtme dëshmojnë për tekfirin e gjynahqarëve ato nënkuputojnë ashpërsi dhe kërcënim”*.³

Këtu hyn edhe vrasja e muslimanit qëllimisht. Disa argumente në pamje të parë dëshmojnë se ai është qafir. Allahu ﷻ thotë: **«Kush e vret një besimtar qëllimisht shpërblimi i tij është xhehenemi, i përjetshëm është në të dhe Allahu është zemëruar me të dhe e ka mallkuar dhe i ka përgatitur një dënim të madh»** En nisa 93. Dënimi me zjarr përjetësisht i takon vetëm qafirit.

Profeti ﷺ ka thënë: **“Sharja e muslimanit është fisk dhe luftimi i tij është kufër”**.⁴ E shumë argumente të tjerë që dëshmojnë për kufrin e atij që vret një besimtar qëllimisht.

Por, për shkak të disa argumenteve të tjerë, kufrin e përmendur më sipër nuk konsiderohet kufër i madh, por kufër i vogël dhe vrasja padrejtësisht është gjynah i mëdh që nuk e nxjerr njeriun prej islamit.

Argument për këtë është fjala e Allahut ﷻ: **«O besimtarë! Ju është obliguar kisasi për të vvarët. I liri me të lirin, rob me robin, gruaja me gruan. E kujt i falet prej vëllait**

¹ Sahih sunen En nesai, 1925.

² Shpjegimi i sahihut të Muslimit, 2/132.

³ Shpjegimi i sahihut të Muslimit 2/126.

⁴ E transmeton Muslimi. Nëse luftimi dhe sharja e muslimanit bëhet për shkak të fesë së tij atëhere hadithi kuptohet me kuptimin e tij të jashtëm dhe kufrin në këtë rast nënkupton kufrin e madh.

të tij atëhere të bindet me mirësi dhe të shpaguej me mirësi﴾ El bekare 178.

Ibn Hazmi thotë: “Allahu ju drejtua fillimisht besimtarëve duke përfshirë vrasësin dhe të vvarin. Pastaj përmendi se vrasësi qëllimisht dhe përgjegjësi për gjakun e të vvarit janë vëllezër. Allahu ﷻ thotë: **﴿Besimtarët janë vëllezër﴾**. Kjo dëshmon se vrasësi qëllimisht është besimtar me vetë dëshminë e Kuranit. Kurani dëshmon që ata janë vëllezër në iman dhe kjo vllazëri nuk ekziston mes besimtarit dhe qafirit.

Allahu ﷻ thotë: **﴿Nëse dy grupe besimtare luftojnë me njëri-tjetrin pajtoni në mes tyre. E nëse ndonjëri prej tyre sulmon grupin tjetër atëhere luftojeni atë që sulmon padrejtësisht derisa të kthehet te urdhri i Allahut, e nëse kthehet atëhere pajtoni mes tyre me drejtësi dhe mbani drejtësi sepse Allahu i do të drejtët. Besimtarët janë vëllezër prandaj pajtoni mes vëllezërve dhe friksojuni Allahut﴾** El huxhurat, 10.

Ky ajet heq çdo pikë dyshimi, sepse Allahu ﷻ e konsideroi grupin agresor prej besimtarëve dhe i urdhëroi besimtarët e tjerë t'i luftojnë ata derisa të kthehen te urdhri i Allahut dhe i konsideroi ata vëllezër të besimtarëve që i luftojnë në grupin tjetër. Në këtë çështje rrëshkasin vetëm të humburit. Këto ajete janë argument i prerë kundër mutesilëve që e mohojnë imanin prej vrasësit dhe kundër atyre që e mohojnë imanin e gjynahqarit. Askush nuk mund të pretendojë se Allahu ﷻ i ka konsideruar ata vëllezër nëse pendohen, sepse ajeti thotë se ata janë vëllezër në momentin e agresionit dhe para se të kthehen te e vërteta”.¹

Argument që mohon se vrasësi është qafir është edhe fjala e profetit ﷺ: **“Përpara kiametit do të ketë herxh (kaos). I thanë: Çfarë është herxhi? Tha: Vrasja. Nuk do të vrisni mushrikët por njëri-tjetrin, derisa ta vrasë njeriu komshiun, vëllain, xhaxhain, çunin e xhaxhait. I thanë: A nuk ka mes nesh të logjikshëm atë ditë? Tha: Do zhduken njerëzit e logjikshëm prej banorëve të asaj kohe dhe në vend të tyre do të vinë disa mëndjelehtë. Shumica e tyre kujtojnë se janë në të drejtë mirëpo ata nuk janë në asgjë”**.² I dërguari i Allahut ﷺ e mohoi shirkun prej këtyre personave dhe bëri dallim mes tyre dhe mushrikëve megjithëse ata vrasin njëri-tjetrin.

Dhe thotë: **“U fala në namaz me dëshirë dhe frikë dhe i kërkova Allahut tre gjëra për umetin tim por më dha vetëm dy dhe ma refuzoi tjetrën. I kërkova që të mos i nënshtrojë ata para armikut nga jashtë tyre dhe ma pranoi. I kërkova që të mos i mbysë ata me përmbytje dhe ma pranoi. I kërkova që të mos hedhë mes tyre luftra por ma refuzoi”**.³

Megjithëse luftrat dhe vrasjet që do të ndodhin mes tyre, kjo nuk ua mohoi përfshirjen në umetin e Muhamedit ﷺ, për të cilët lejohet duaja dhe shefati.

I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Pushë atë që do të ndodhë me umetin tim pas meje**

¹ El fisel fil milel uen nihil, 3/235-236.

² E transmeton Ahmedi dhe të tjerë, Es silsiletus sahiha, 1682.

³ E transmeton Ibn Maxheh dhe të tjerë, Es silsiletus sahiha, 1724.

dhe derdhjen e gjakut mes tyre dhe më hidhëroi. Do të ndodhë ashtu siç ka ndodhur me umetet para tij. I kërkova Allahut të më lejojë për të bërë shefat për ta në ditën e gjykimit dhe ma pranoi”.¹

Përfshirja e tyre në shefatin e profetit ﷺ, megjithëse janë vrarë me njëri-tjetrin, dëshmon se ata janë muslimanë gabimtarë. Nëse do të bënin kufër të madh me derdhjen e gjakut të njëri-tjetrit, nuk do e meritonin shefatin e profetit ﷺ dhe as që nuk do lejohej shefati për ta.

Ibn Umeri ؓ thotë: Qëndruam një kohë të gjatë të mos kërkonim falje për vepruesit e gjynaheve të mëdha derisa dëgjuam prej gojës së profetit ﷺ të thotë: ***“Allahu nuk e fal t’i bëhet shirk por e fal atë që është më e vogël kujt dëshiron. Unë e kam ruajtur shefatin tim në ditën e gjykimit për vepruesit e gjynaheve të mëdha”*** Pastaj na u larguan shumë hamëndje në vetet tona”.²

Argument që mohon kufirin e madh prej vrasësit është edhe hadithi i Ubade ibn Samit ؓ se i dërguari i Allahut ﷺ ishte në mesin e sahabëve dhe u tha: ***“Ma jepni besën se nuk do t’i bëni shirk Allahut asgjë. Nuk do të vidhni. Nuk do të bëni zina. Nuk do t’i vrisni fëmijët tuaj. Nuk do të sillni ndonjë trillim mes këmbëve dhe duarve tuaja. Nuk do të kundërshtoni në vepra të mira. Kush e përmbush këtë, shpërblimin e ka te Allahu. Kush vepron ndonjë prej këtyre gjynaheve dhe ndëshkohet në dynja, ajo është kefaret (shlyerje) për të. Kush kryen diçka prej tyre dhe Allahu e mbulon, atëhere çështja e tij është te Allahu, nëse dëshiron e fal e nëse dëshiron e ndëshkon”.***³

Lënia në mëshirë të Allahut ﷻ e vepruesit të ndonjë prej gjynaheve të përmendura në hadith dëshmon se ai nuk është qafir.

Maziniu thotë: ***“Ky hadith është argument kundër havarixhëve të cilët i konsiderojnë gjynahet kufër”.***⁴

Nëse thuhet: Hadithi përfshin edhe shirkun dhe i bie që edhe mushriku të jetë në mëshirë të Allahut dhe kjo kundërshton bazat e akides.

I themi: Fjala ***“asgjë”*** përfshin shirkun e vogël që është rijaja dhe jo shirkun e madh. Hadithi qëndron në pamjen e tij parësore, sepse vepruesi i shirkut të vogël është në mëshirë të Allahut ﷻ njësoj si ai që vepron kufër të vogël siç u sqarua më parë.

Nëse supozojmë se shirku i përmendur në hadith nënkupton shirkun në përgjithësi, duke përfshirë edhe shirkun e madh, themi se vepruesi i shirkut të madh bën përjashtim prej

¹ E transmeton Ibn Ebi Asim në “Kitabus sunneh”. Shejh Albani e ka konsideruar sahih në shqyrtimin e haditheve të këtij libri.

² E transmeton Ibn Ebi Asim në “Kitabus sunneh”. Shejh Albani e ka konsideruar hasen.

³ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

⁴ Fethul bari, 1/68.

faljes dhe mëshirës së Allahut me argumente të tjerë si fjala e Allahut ﷻ: **«Allahu nuk e fal t'i bëhet shirk»** En nisa 48 dhe thotë: **«E nëse bën shirk ka për t'u hedhur poshtë e gjithë vepra jote dhe ke për të qënë prej humbësve»** Ez zumer, 65, dhe thotë: **«Atij që i bën shirk Allahut Allahu ia ka bërë haram xhenetin»** Al maide, 72.

Po ashtu, disa hadithe në pamje të jashtme dëshmojnë se konsumuesi i verës vazhdimisht, vepruesi i zinasë dhe hajduti nuk kanë iman. Profeti ﷺ ka thënë: **“Ai që e pi verën vazhdimisht është si adhuresi i idhujve”**¹ Dhe thotë: **“Atëhere kur zinaqari bën zina nuk është besimtar. Hajduti atëhere kur vjedh nuk është besimtar. E kur pi verë nuk është besimtar, vetëm nëse pendohet”**.²

Mirëpo ekzistojnë argumente të tjerë që dëshmojnë se vepruesit e këtyre gjynaheve janë besimtarë dhe në ditën e gjykimit janë të destinuar për në xhenet dhe do të jenë në mëshirë të Allahut, nëse dëshiron i dënon e nëse dëshiron i fal. Prej këtyre argumenteve, kuptojmë pa pikë dyshimi se në hadithet e mësipërme mohohet plotësia e imanit dhe jo i gjithë imani, dhe se vepruesit e këtyre gjynaheve nuk janë qafirë dhe nuk kanë bërë kufër të madh që të nxjerr prej islamit. Por nëse ata i veprojnë këto gjynahe duke i konsideruar të lejuara atëhere hadithet e mëparshme kuptohen në pamjen e tyre të jashtme dhe ata konsiderohen qafirë dhe murtedë, sepse e kanë konsideruar haramin të lejuar dhe jo vetëm për shkak se i kanë vepruar këto gjynahe.

Argument tjetër është edhe hadithi që e transmeton Umer ibn Hatabi ؓ se një person në kohën e profetit ﷺ me emrin Abdullah dhe nofkën e kishte *“himar”* e bënte profetin ﷺ për të qeshur dhe profeti e pati rrahur me kamzhik. Një ditë e sollën dhe e pranoi (që kishte pirë) dhe e goditën me kamzhik. Një person tha: Allahu e mallkoftë! Sa shumë që e sjellin (për dënim)! Atëhere profeti i tha: **“Mos e mallko! Unë e di se ai e do Allahun dhe të dërguarin e tij”**.³

Ky sahabi pinte verë dhe qe dënuar vazhdimisht e megjithatë profeti ﷺ nuk e konsideroi qafir dhe as adhures të idhujve, përkundrazi i ndaloi njerëzit prej mallkimit të tij, përshkak të dashurisë që ai kishte për Allahun ﷻ dhe të dërguarin ﷺ.

Transmetohet në sahihun e Muslimit, prej Ebu Dherrit ؓ thotë: I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Çdo rob që dëshmon “La ilahe il-lallah” pastaj vdes me të ai do të hyjë në xhenet. I thashë: Edhe nëse ka bërë zina dhe ka vjedhur? Më tha: Edhe nëse ka bërë zina dhe ka vjedhur. I thashë: Edhe nëse ka bërë zina dhe ka vjedhur? Më tha: Edhe nëse ka bërë zina dhe ka vjedhur. Ma përsëriti tre herë, e për herë të katërt tha: Edhe nëse s'ja ka qejfi Ebu Dherrit”**. Pastaj Ebu Dherrit ؓ doli duke thënë: Edhe nëse s'ja ka qejfi Ebu

¹ Sahih sunen Ibn Maxheh, 2720. Këtu hyn edhe fjala e profetit: **“Pirësi i verës vazhdimisht nuk do të hyjë në xhenet”**, sahih sunen Ibn Maxheh, 2721.

² E transmeton Muslimi.

³ E transmeton Buhariu.

Dhërrit.¹ Në një rivajet tjetër thuhet: “Edhe nëse ka bërë zina, ka vjedhur apo ka pirë verë”.

Neveviu thotë: “Fjala e profetit “Edhe nëse ka bërë zina dhe ka vjedhur” është argument për medhhebin e ehlisunetit se nuk gjykohet prerazi për vepruesit e gjynahve të mëdha se ata janë në zjarri. Nëse hyjnë në zjarr ato do të nxirren dhe do të hyjnë në xhenet përjetësisht”.²

Tirmidhiu thotë: “Nuk njoh asnjë dijetar që i pranohet mendimi, të ketë bërë qafir atë që bën zina, vjedh apo pi”.³

Argument tjetër është edhe hadithi i mëparshëm i Ubade ibn Samit ؓ: “**Kush kryen diçka prej tyre dhe Allahu e mbulon atëherë çështja e tij është te Allahu nëse dëshiron e fal dhe nëse dëshiron e ndëshkon**”. Kjo thuhet vetëm për besimtarin.

Gjithashtu hadithi i profetit ﷺ: “**Askush nuk beson derisa të dojë për vëllain e tij atë që e do për veten e tij**”,⁴ ka për qëllim mohimin e plotësisë së imanit duke u argumentuar me një rivajet tjetër që thotë: “**Nuk e arrin realitetin e imanit ...**” dhe realiteti i imanit është plotësimi i tij.

Ibn Haxheri thotë: “Këtu është mohuar imani i plotë, siç thuhet qartë në transmetimin e Ibn Hibanit prej Ibn Ebi Adijit prej Husejn El Mualim: “**Nuk e arrin realitetin e imanit ...**”. Padyshim realiteti këtu nënkupton plotësimin e imanit sepse ai që nuk cilësohet me këtë cilësi nuk konsiderohet qafir”.⁵

Neveviu thotë: “Dijtarët kanë thënë për kuptimin e këtij hadithi se ai nuk beson me iman të plotë, megjithëse baza e imanit ekziston edhe për atë që nuk e ka këtë cilësi”.⁶

Profeti ﷺ ka thënë: “**Nuk do të hyjë në xhenet personi prej të cilit komshiu i tij nuk është i sigurt**”.⁷ Prej hyrjes në xhenet pengohen vetëm qafirët, mirëpo është sakësuar se profeti ﷺ nuk është sjellur me atë që e cënon komshiu ashtu si qafirët dhe murtedët⁸. Prej kësaj kuptojmë se ky hadith nuk kuptohet në pamjen e tij të jashtme por qëllimi i tij është qortimi i rreptë dhe sqarimi i rëndësisë së të drejtave të komshiut.

Neveviu thotë: “Për fjalën e profetit “nuk hyn në xhenet” janë dhënë dy komente të cilat përfshijnë edhe hadithe të tjera të ngjashme.

I pari: Këtu kihet për qëllim ai që e konsideron cënimin e komshiut të lejuar megjithëse e di që kjo është haram. Një person i tillë është qafir dhe nuk hyn në xhenet.

¹ E transmeton Muslimi.

² Shpjegimi i sahihut të Muslimit, 2/97.

³ Fethul bri, 12/59.

⁴ E transmeton Buahriu dhe Muslimi.

⁵ E feth, 1/57.

⁶ Shpjegimi i sahihut të Muslimit, 2/16.

⁷ E transmeton Muslimi.

⁸ Shiko sahih sunen Ebi Daud, 4292.

I dyti: Këtu kihet për qëllim se ai nuk do të hyjë në xhenet atëhere kur të hyjnë ata që kanë fituar xhenetin dhe kur të hapen portat e tij, por do të vonohet, e më pas Allahu mund ta falë dhe ta fusë në xhenet që në fillim (pra pa hyrë në zjarr).

I thamë këto dy interpretime sepse medhhebi i pasuesve të së vërtetës është se kush vdes me teuhid, por ka gjynahe të mëdha, çështja e tij kthehet te Allahu nëse dëshiron e fal dhe e fut në xhenet që në fillim, e nëse dëshiron e dënon dhe më pas e fut në xhenet dhe Allahu është më i ditur”.¹

Pra, çdo gjynah që është emërtuar si kufër, nuk lejohet interpretimi i kufirit ndryshe nga kuptimi i tij parësor. Kjo lejohet vetëm nëse ekzistojnë argumente të tjerë në shariat, që dëshojnë se ky gjynah është kufër i vogël dhe se vepruesi i tij nuk është qafir, me kusht që të mos e veprojë atë gjynah për shkak se e konsideron të lejuar.

Prej argumenteve të përgjithshme që e mohojnë kufirin e atyre që veprojnë gjynahe më të vogla se kufri dhe shirkun i madh është fjala e Allahut: **﴿Allahu nuk e fal t’i bëhet shirk dhe ia fal atë që është më e vogël se ai atij që dëshiron﴾** En Nisa: 48.

I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Kush e takon Allahun pa i bërë shok asgjë do të hyjë në xhenet”².**

Dhe ka thënë: **“Kush vdes dhe nuk i bën shok Allahut asgjë, do të hyjë në xhenet dhe kush vdes duke i bërë Allahut shirk, do të hyjë në zjarr”³.**

Dhe ka thënë: **“Më është dhënë shefati (ndërmjetësimi), i cili do të përfshijë çdokënd që nuk i bën shirk Allahut asgjë”⁴.**

Allahu ﷻ thotë në hadithin kudsi: **“Kush është i bindur se unë kam mundësi t’ia fal gjynahet kam për ta falur dhe nuk më intereson aspak, përderisa nuk më bën shok asgjë”⁵.**

Në një hadith tjetër thuhet: Allahu i Lartë ka thënë: **“O bir i Ademit! Për sa kohë më adhuron mua dhe shpreson prej meje pa më bërë shok kam për të të falur sipas punëve që i ke kryer. Nëse më takon me gabime e gjynahe sa qielli dhe toka kam për të të takuar me falje sa qielli dhe toka dhe do të fal pa më interesuar aspak”⁶.**

Imam Neveviu thotë: **“Nuk do të qëndrojë në zjarr përjetësisht askush që vdes me teuhid, sado gjynahe të ketë vepruar. Gjithashtu nuk do të hyjë në xhenet ai që vdes me kufër sado vepra të mira të ketë vepruar. Kjo është përmbledhja e fjalës së pasuesve të së vërtetës**

¹ Shpjegimi i sahihut të Muslimit, 2/17.

² E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

³ E transmeton Muslimi.

⁴ E transmeton Ibn Ebi Asim në “Kitabus sunneh”. Shejh Albani e ka konsideruar sahih.

⁵ E transmeton Taberani dhe Hakimi. Sahihul xhami’is sagir, 4330.

⁶ E transmeton Taberani, Sahihul xhami, 4341.

për këtë çështje”¹.

Shkurtimisht themi se dispozitat e transmetuara në Kuran dhe në sunet, nuk lejohet t’i nxjerrim prej kuptimeve të tyre parësore duke u dhënë një kuptim tjetër, përveçse në rast se ekzistojnë argumente të tjerë që dëshojnë për këtë. Por nëse nuk ekziston asnjë argument që t’i japë kuptim tjetër atëhere qëndron në kuptimin e tij të parë.

Zakonisht, shumica e atyre që i bëjnë njerëzit qafirë për gjynahet që veprojnë, gabojnë pikërisht në këtë rregull. Ata bazohen në disa argumente që përmendin kufrin për disa gjynahe të cilat janë më të vogla se kufri i madh, por anashkalojnë argumente të tjerë të cilat shpjegojnë dhe sqarojnë kuptimin e kufrit në argumentet e parë. Ata i kuptuan këto argumente në pamjen e tyre të jashtme dhe i bënë njerëzit qafirë. Padyshim kjo është gabim dhe ata me dije apo padije janë futur nën hijen e havarixhëve të parë.

Ndërsa një grup tjetër nënvlerësuan dhe u zgjeruan në çështjen e mosbërjes qafir edhe kur ka shkaqe të qarta të kufrit bazuar në argumente që i cilësojnë disa gjynahe si kufër dhe kanë për qëllim kufrin e vogël. Ata e përgjithësuan këtë për të gjithë gjynahet duke përfshirë edhe gjynahet që janë kufër dhe shirk i madh dhe nuk i shpallën qafirë as ata që në shariat janë qafirë. Padyshim kjo është gabim dhe pasuesit e këtyre mendimeve me dije apo padije janë futur nën hijen e murxhive.

E vërteta e qartë qëndron mes këtyre dy grupeve pa teprim dhe pa anashkalim. Ehlisuneti sillen me argumentin dhe kuptimet e tij ngado që të sillen, pa deformuar dhe pa mohuar. Vetëm ata janë në rrugën e drejtë me të cilën Allahu ka urdhëruar: **«Kjo është rruga ima e drejtë prandaj ndiqeni atë dhe mos i ndiqni rrugët e tjera e të ndaheni prej rrugës së tij. Me këtë ju ka porositur që të ruheni (me devotshmëri)»** El enam 153.

Vërjetje:-

Disa dijetarë e përdorin termin “kufër në vepra” dhe kanë për qëllim kufrin e vogël me vepra i cili nuk e nxjerr njeriun prej islamit. Mirëpo disa xehmi dhe murxhi e shfrytëzuan këtë për interesat e tyre dhe e përgjithësuan për të gjithë llojet e veprave duke përfshirë edhe veprat që e nxjerrin njeriun prej islamit. Ata u argumentuan për këto ide të devijuara me disa terma që i përdorin disa dijetarë dhe kanë kuptime të ndryshme nga ajo që murxhitë i përdorin.

Që të mos shfrytëzohen këto terma për interesat e tyre dhe të mos lindin keqkuptime në masat e gjëra të muslimanëve, më i preferuar është përdorimi i termit “kufër i vogël në vepra” ose “kufër nën kufrin e madh” ose “kufër mirësie” dhe Allahu është më i ditur.

¹ Shpjegimi i sahihut të Muslimit, 1/217.

Vërejtje tjetër:-

Kufri dhe shirku i vogël nuk ndodhin vetëm me vepra të gjymtyrëve, siç kujtojnë disa njerëz. Ai mund të ndodhë me vepra si vrasja, zinaja, pirja e verës, vjedhja dhe të tjera punë të cilat u përmendën mësipërm. Ose mund të ndodhë me fjalë si betimi me dikë tjetër përveç Allahut në formë zakoni dhe jo adhurimi, vajtimi i të vdekurit, sharja, mallkimi e të tjera fjalë të cilat në hadith janë cilësuar si kufër dhe shirk dhe nënkuptojnë shirkun dhe kufrin e vogël. Ose mund të ndodhë me besimin dhe vepra të zemrës si syfaqësija, të cilën profeti e quajti kufër i vogël. E lus Allahun të na mbrojë të gjithëve prej kufrit të madh dhe të vogël, prej atij që shfaqet dhe prej atij që fshihet.



Rregulli i tetë: Kush e konsideron haramin të lejuar dhe hallallin të ndaluar ai ka bërë kufër.

Lejimi i asaj që Allahu ﷻ e ka bërë haram dhe ndalimi i asaj që Allahu ﷻ e ka bërë hallall është kufër i qartë dhe ridde prej fesë. Ligjvënia e cila përfshin ndalimin, lejimin, pëlqimin dhe mospëlqimin është e drejtë që i takon vetëm Allahut ﷻ. Askujt nuk i lejohet t'i bëjë shirk Allahut ﷻ në këtë cilësi, apo të pretendojë se ajo është e drejtë edhe e tij. Allahu thotë: **«Nuk ka bërë ortak në gjykimin e tij askënd»** El kehf 26, dhe thotë: **«Ju po adhuroni përveç Allahut vetëm disa emra me të cilat i keni quajtur ju dhe baballarët tuaj. Allahu nuk ka zbritur për ta asnjë argument. Gjykimi i takon vetëm Allahut. Ai ka urdhëruar të adhuroni vetëm atë. Kjo është feja e vyer por shumica e njerëzve nuk e dinë»** Jusuf 40.

Kushdo që e pretendon këtë të drejtë për veten e tij përveç Allahut ﷻ, ai e ka bërë veten e tij rival me Allahun ﷻ dhe zot që adhurohet me bindjen dhe pasimin e njerëzve. Kushdo që ia aprovon atij këtë të drejtë dhe e pason ai e ka bërë atë rival me Allahun ﷻ dhe e ka marrë atë për zot të adhuruar.

Argumetat që vërtetojnë këtë rregull dhe konsiderimin qafir të personave të tillë janë të shumta. Prej tyre po përmendim:

Allahu thotë: **«I morrën priftërinjtë dhe murgjit e tyre për zotër përveç Allahut. Edhe Mesihun të birin e Merjemes e konsideruan zot megjithëse u urdhëruan të adhurojnë vetëm një ilah të vetëm. Ai është ilahu (i adhuruari me të drejtë) i vetëm dhe i pastër është ai prej asaj që po shoqërojnë»** Et teube, 31.

«zotër përveç Allahut» nënkupton ligjvënës, të cilëve u atribojnë ligjërimin e hallallit dhe haramit, ndalesave dhe lejimeve, përveç Allahut. Pikërisht kjo ishte marrja e tyre për zotër dhe pikërisht ky ishte adhurimi që i bënë atyre përveç Allahut.

Begeviu thotë: *“Nëse thuhet: Ata nuk i adhuruan murgjërët dhe priftërinjtë e tyre! U themi: Kuptimi i ajetit është se ata iu bindën atyre në kundërshtimin e Allahut ﷻ dhe e konsideruan hallall atë që ata e bënë hallall dhe e konsideruan haram atë që ata e konsideruan haram dhe kështu i morrën ata për zotër.*

Prej Adij Ibn Hatimit ؓ thotë: Vajta te profeti ﷺ me një kryq ari në qafë dhe më tha: O Adij! Flake këtë put prej qafës tënde. E flaka dhe u ktheva prapë dhe e dëgjova të lexonte: «I morrën priftërinjtë dhe murgjit e tyre për zotër përveç Allahut». Kur përfundoi i thashë: Ne nuk i adhuronim ata. Më tha: A nuk ua bënë haram atë që Allahu ua pati lejuar dhe ju e konsideronit për haram dhe ua bënë hallall atë që Allahu ua kishte ndaluar dhe ju e

*konsideronit për hallall? I thashë: Po. Më tha: Ky është adhurimi i tyre”.*¹²

Prej Hudhejfe Ibn Jemanit thotë: “Ata nuk agjëronin dhe nuk faleshin për ta, por sa herë që ua lejonin diçka menjëherë e konsideronin hallall dhe kur ua ndalonin diçka që Allahu e kishte lejuar menjëherë e bënë haram. Kjo ishte marrja e tyre për zotër”.³

Ebu Buhturiu thotë: “Ata nuk u janë falur atyre. Sikur t’i urdhëronin që të faleshin për ta përveç Allahut nuk kishin për t’iu bindur, mirëpo ata i urdhëruan ta bënë hallallin e Allahut haram dhe haramin hallall. Ata u bindën dhe kjo ishte marrja e tyre për zotër”.⁴ Ky ishte adhurimi i tyre përveç Allahut ﷻ. Kështu e kanë komentuar ajetin edhe shumë dijetarë dhe komentues të tjerë.

Eh sa shumë janë ata që merren për zotër në kohën e sotme! Ata të cilët ligjërojnë për njerëzit hallallin dhe haramin pa udhëzim prej Allahut. Pretendojnë se janë ligjvënës sovran përveç Allahut. Pretendojnë se kjo është e drejtë e tyre përveç Allahut, të cilën e ushtrojnë nëpërmjet parlamentit legjislativ dhe institucioneve demokratike. Këto sisteme kanë ngulur rrënjë në trojet islame dhe po i ftojnë njerëzit në adhurimin e njerëzve.

Eh sa shumë janë ata që pa hezitim dhe siklet u binden dhe i pasojnë këta zotër! I madhërojnë ata dhe u thurin lavde dhe pastaj kujtojnë se janë besimtarë!

Argument është edhe fjala e Allahut ﷻ: **«Mos hani prej asaj që nuk është përmendur emri i Allahut sepse ajo është fisk (pabindje). Shejtanët i inspirojnë miqtë e tyre që të debatojnë me ju e nëse u bindeni atyre ju jeni mushrikë»** El enam 121. Pra nëse u bindeni në lejimin e asaj që Allahu ﷻ e ka bërë haram ose u bindeni në bërjen haram të asaj që Allahu ﷻ e ka lejuar, atëherë ju jeni mushrikë.

Begeviu thotë: “Mushrikët thanë: O Muhamed! Na trego se kush e mbyt delen e ngordhur? U tha: Allahu e ka mbyt. I thanë: Si pretendon se atë që e mbyt ti me shokët e tu është hallall dhe atë që e mbyt qeni, skifteri dhe tigri është hallall, ndërsa atë që mbyt Allahu është haram? Disa prej muslimanëve u vunë në siklet dhe Allahu ﷻ zbriti **«nëse u bindeni atyre»** në ngrënien e cofinës **«ju jeni mushrikë»**. Zexhaxhi thotë: Ky ajet është argument se kush e bën hallall atë që Allahu e ka bërë haram apo bën haram atë që Allahu e ka bërë hallall, ai është mushrik”.⁵

Ibn Kethiri thotë: “Fjala e Allahut **«nëse u bindeni atyre ju jeni mushrikë»** sepse e

¹ Tefsiri i Begeviut, 3/285.

² Ky hadith dëshmon për pranimin e justifikimit me padije dhe mund të merret për argument kundër atyre që bëjnë dallim mes padijes në çështjet e akides si emrat dhe cilësitë e Allahut dhe mes padijes që lidhet me teuhidin në vepra. Ata e justifikojnë të parin dhe nuk e pranojnë justifikimin për llojin e dytë duke ditur që padija në të dy rastet është rrjedhojë e pamundësisë siç u shpjegua më përpara.

³ Tefsiri i Taberit, 10/115.

⁴ Mexhmu’ul fetaua, Ibn Tejmije, 7/67.

⁵ Tefsiri i Begeviut, 2/127.

keni braktisur urdhrin dhe sheriatin e Allahut dhe keni marrë fjalën e dikujt tjetër dhe i keni dhënë përparësi më shumë se Allahu dhe ky është shirku, siç thotë Allahu: **﴿I morrën priftërinjtë dhe murgjit e tyre për zotër përveç Allahut﴾**.¹ Pra Kurani vërteton njëri-tjetrin.

Kurtubiu thotë: “Fjala e Allahut **﴿nëse u bindeni atyre﴾** në lejimin e coftinës **﴿ju jeni mushrikë﴾**. Ajeti dëshmon se kush e lejon diçka që Allahu e ka bërë haram ai bëhet mushrik për këtë shkak. Allahu e ka ndaluar ngrënien e coftinës me ajete të qarta, mirëpo nëse e konsideron hallall duke iu bindur tjetërkujt, ai ka bërë shirk”.²

Ibn Tejmije thotë: “Nëse njeriu e bën hallall haramin e njohur me konsensus të plotë, ose e bën haram hallallin e njohur me konsensus të plotë, ose ndryshon diçka në shariat që është e njohur me konsensus të plotë, ai është qafir dhe murted me pajtimin e të gjithë juristëve islam (fukahave)”.³

Argumenteve është edhe fjala e Allahut ﷻ: **﴿Ata që ia kthyen shpinën udhëzimit pasi u sqarua, ata i mashtroi dhe i inspiroi shejtani, sepse ata u thanë atyre që urryen atë që zbriti Allahu: Do ju bindemi në disa gjëra dhe Allahu e di mirë atë që fshehin﴾** Muhamed 26. Ata u bënë qafirë, pas sqarimit të udhëzimit, sepse u thanë atyre që urryen sheriatin e Allahut: Do ju bindemi për disa gjëra të cilat janë në kundërshtim me urdhrin e Allahut ﷻ dhe urdhrin e profetit ﷺ.⁴

Më përpara, ata ishin besimtarë që e kishin njohur udhëzimin dhe imanin. Mirëpo, ata ranë në nifak dhe kufër, për shkak të bindjes ndaj atyre që e urryjnë shpalljen e Allahut ﷻ për disa gjëra dhe jo për çdo gjë, por vetëm për disa gjëra që janë në kundërshtim me atë që Muhamedi ﷺ e ka kumtuar prej zotit. Argument për këtë është fjala e Allahut **﴿Ata që ja kthyen shpinën udhëzimit﴾**. Nëse do të ishin munafikë dhe qafirë nuk do të cilësoheshin se u kthyen prej fesë dhe nuk do të kishte asnjë dallim mes tyre dhe mes atyre që e urryjnë shpalljen e Allahut.⁵ Munafikët janë qafirë dhe nuk thuhet për ta se kanë bërë ridde pas imanit, megjithëse munafikët e urryjnë atë që ka zbritur Allahu edhe nëse ata shtiren me të kundërtën.

Sido që të kenë qënë munafikë apo besimtarë, në konsideratë merret gjeneralizimi i argumentit dhe jo specifikimi i shkakut të tij. Ajeti e gjeneralizon se kushdo që u bindet qafirëve dhe mushrikëve në bërjen haram të asaj që Allahu e ka lejuar apo në bërjen hallall të asaj që Allahu e ka ndaluar, ai është qafir dhe murted, pa bërë dallim nëse më parë ka qënë besimtar apo munfik dhe Allahu është më i ditur.

¹ Tefsiri i Ibn Kethirit, 2/177.

² Tefsiri i Kurtubiut, 7/77.

³ Mexhmu’ul fetaua, 3/267.

⁴ Tefsiri i Taberiut, 26/55.

⁵ Fjala e përdorur në ajet “irteddu” ka kuptimin e kthimit mbrapsh dhe kthimit të shpinës dhe largimit dhe prejardhjen e ka nga fjala “er-ridde”. Shën. i përkthyesit.

Argument është edhe fjala e Allahu ﷻ: **«O besimtarë! Nëse u bindeni një grupi prej atyre që u është dhënë libri kanë për t’ju kthyer pas imanit tuaj në qafirë»** Ali Imran, 100. Bindja që konsiderohet kufër është bindja e tyre në lejimin e haramit ose bindja e tyre në zbulimin e asaj që Allahu ﷻ e ka bërë të keqe ose në përbuzjen e asaj që Allahu ﷻ e ka bërë të mirë.¹

Gjithashtu Allahu ﷻ thotë: **«O besimtarë! Nëse u bindeni qafirëve kanë për t’ju kthyer mbrapsht dhe do të ktheheni të humbur»** Ali Imran 149.

Ibn Xheriri thotë: *“O ju që keni besuar Allahun dhe të dërguarin! O ju që keni besuar premtimin dhe dënimin e Allahut ﷻ, urdhrin dhe ndalesat e tij! Nëse do t’u bindeni qafirëve çifut dhe të krishterë që kanë mohuar profetësinë e profetit Muhamed ﷺ, në atë që ju urdhërojnë dhe ju ndalojnë dhe nëse e pranoni idetë e tyre dhe këshillat e tyre në ato çështje ku pretendoni se ata po ju këshillojnë **«kanë për t’ju kthyer mbrapsht»** pra kanë për t’ju shtyrë të bëni ridde pas imanit dhe të bëni kufër me Allahun ﷻ, ajetet dhe të dërguarin ﷺ, pas islamit”.*²

Argument është edhe fjala e Allahut ﷻ: **«Mos thoni me gjuhët tuaja gënjeshtër: Kjo është hallall dhe kjo është haram, që të mos trilloni ndaj Allahut gënjeshtër. Ata që trillojnë ndaj Allahut gënjeshtër nuk kanë për të shpëtuar»** En nahl 116. Kushdo që i bën disa gjëra hallall dhe haram sipas qejfit dhe pa asnjë udhëzim prej Allahut, ai ka trilluar gënjeshtër ndaj Allahut dhe përfshihet në ndëshkimin e përmendur në ajet.

Prej kësaj është edhe fjala e Allahut ﷻ: **«Thuaj: Çfarë medoni për furnizimin që e ka zbritur Allahu e ju diçka e keni bërë haram e diçka e keni bërë haram. Thuaj: A mos vallë Allahu ju ka dhënë leje për këtë apo ju po shpifni ndaj Allahut?»** Junus 59.

Konsiderimi i gjërave hallall, haram, të mira, të këqija është prej të drejtave që i takon

¹ Pëlqimi i diçkaje është më i gjerë se konsiderimi i saj hallall. Kushdo që e preferon dhe e pëlqen diçka e ka konsideruar të lejuar atë dhe e anasjellta nuk është e vërtetë. Transemtohet se Shafiu ka thënë: “Kush bën istihsan (preferon diçka nga vetvetja) ai ka ligjësuar”.

Nëse thuhet: A është çdo bindje ndaj qafirëve dhe mushrikëve kufër?

U themi: Bindja është disa llojëshe. Një lloj bindje është kufër që e nxjerr njeriun prej islamit. Një lloj tjetër është gjynah më i vogël se kufri. Ndërsa një lloj tjetër është e lejuar.

Bindja që është kufër ndodh atëhere kur u bindesh në shirkun e tyre, në përgënjeshttrimin e fesë, në lejimin e asaj që Allahu ﷻ e ka bërë haram dhe në ndalimin e asaj që Allahu ﷻ e ka bërë hallall. Ose kur i bindesh për vetveten e tij sepse ai është filani duke ju bindur në të drejtë dhe në të kotë dhe në çdo ligj që e vendos dhe çdo urdhër që e lëshon dhe e pason atë për çdo gjë sepse ai është filani, apo sepse beson se atij i lejohet të ligjitimojë ligje për njerëzit dhe si ligjvënës që është duhet t’i bindemi. Kjo lloj bindje është shirk dhe kufër i madh që e nxjerr njeriun prej islamit.

Ndërsa bindja që konsiderohet gjynah është bindja në veprimin e disa gjynaheve, por pa i konsideruar hallall dhe pa i pëlqyer ato, p.sh. kur muslimani i bindet qafirët në pirjen e verës, por pa e konsideruar verën hallall. Kjo lloj bindjeje është gjynah i madh që nuk arrin gradën e kufrit.

Ndërsa bindja e lejuar është në çështjet e organizimit, mjekimit, në rregullat e qarkullimit rrugor, bindja e mjekut qafir për mjekimin që të jep, etj. Kjo lloj bindje është e lejuar dhe nuk përbën problem.

² Tefsiri i Taberit, Xhamiul bejan, 4/122.

vetëm Allahu. Atë që Allahu e lëvdon ajo është e bukur dhe atë që e nënçmon ajo është e shëmtuar. Asnjë krijesave nuk e meriton këtë përshkrim. Gjykimi për çdo gjë kthehet vetëm te Allahu, një, i vetëm dhe pa shok. Prandaj kur një person nga fisi temim i tha profetit ﷺ: **“Lavdërimi im është i bukur dhe nënçmimi im është i keq, profeti ia ktheu: Kjo i takon vetëm Allahut!”**.¹ Nëse Allahu ﷻ e lëvdon diçka ajo patjetër është e mirë dhe nëse e nënçmon diçka, ajo patjetër është e keqe. Kjo i takon vetëm Allahut ﷻ dhe askujt tjetër. Lëvdimi i krijesave nëse përputhet me lëvdimin e Allahut ﷻ ai është i bukur, e në të kundërt është i shëmtuar edhe sikur të gjithë njerëzit të bashkohen në një mendje se ai është i bukur. Nënçmimi i njerëzve nëse përputhet me nënçmimin e Allahut ﷻ ajo gjë është e shëmtuar, e në të kundërt ajo është e mirë, edhe sikur të gjithë njerëzit të bashkohen në një mendje se ajo është e shëmtuar. Në konsideratë merret vetëm gjykimi i Allahut ﷻ.

Aliu ؑ ka thënë: Disa banorë të shomit pinë verë dhe emir i tyre ishte Jezid ibn Ebi Sufjani dhe thanë: Ajo është hallall duke keqkuptuar ajetin **«Ata që kanë besur dhe vepruar vepra të mira nuk kanë asnjë gjynah për atë që hanë»**. Atëhere Jezidi i shkroi Umerit ؓ dhe Umeri ؓ i shkroi: M’i dërgo mua këta persona para se t’i prishin njerëzit. Kur vajtën te Umeri ؓ i mblodhi njerëzit dhe u pleqërua me ta dhe i thanë: O prijës i besimtarëve! Mendojmë se ata kanë trilluar ndaj Allahut dhe kanë ligjëruar në fe atë që Allahu nuk e ka lejuar, prandaj prijua kokat. Aliu ؓ qëndroi në heshtje derisa Umeri ؓ i tha: Po ti o Ebu Hasen çfarë mendon? I tha: Mendoj se duhet t’u paraqesësh teuben. Nëse pendohen duhet ti dënosh me 80 kamzhikë për shkak të pirjes së verës. E nëse nuk pendohen hiqja qafat sepse kanë përgënjeshtuar Allahun ﷻ dhe kanë ligjëruar në fe atë që Allahu ﷻ nuk e ka lejuar. Pastaj Umeri ؓ u kërkoi të pendoheshin dhe u penduan dhe e ndëshkoi secilin prej tyre me 80 kamzhikë”.²

Ibn Tejmije thotë: *“Rreth kësaj janë pajtuar të gjithë sahabët dhe të gjithë imamët e islamit pa asnjë kundërshtim mes tyre. Kush mohon obligimin e një vaxhipi të njohur dhe mutevatir si pesë namazet, agjërimin e ramazanit, haxhin në Qabe, apo mohon ndalimin e disa haremeve të njohura dhe mutevatire si kurvëria, padrejtësia, vera, bixhozi, ribaja etj, apo mohon lejueshmërinë e asaj që mirënjihet se është hallall si buka, mishi, martesë, një person i tillë është qafir dhe murted. Atij i kërkohet pendim e nëse pendohet falet e në të kundërt vritet. Nëse këto mendime vazhdon t’i fshehë (në zemër) ai është zindik dhe munafik dhe nuk i kërkohet pendim sipas mendimit të shumicës së dijetarëve, por vritet pa iu kërkuar pendim nëse vërtetohet (që është zindik)”*.³

Dhe thotë: *“Është e mirënjohur në fenë islame dhe me pajtimin e të gjithë muslimanëve, se kush e lejon pasimin e një feje tjetër përveç islamit, apo të ndonjë sheriatit*

¹ Mexhmu’ul fetaua, 28/164.

² Cituar prej librit “Ikfarul mulhidin fi darurijatid din”, fq. 95.

³ Mexhmu’ul fetaua, 11/405.

tjetër përveç shariatit të Muhamedit ﷺ ai është qafir. Kufri i tij është njësoj si kufri i atij që ka besuar një pjesë të librit dhe ka mohuar një pjesë tjetër. Allahu ﷻ thotë: **«Ata që bëjnë kufër me Allahun dhe profetët e tij dhe duan të bëjnë dallim mes Allahut dhe profetëve dhe thonë: Ne besojmë disa gjëra dhe mohojmë disa të tjera, dhe dëshirojnë të ndjekin një rrugë mes kësaj, ata janë qafirët e vërtetë»**.¹

Dhe thotë: “Kush e lejon që mes njerëzve të gjykohet me ligje që ai i shikon si të drejtë dhe nuk pason atë që e ka shpallur Allahu, ai është qafir. Çdo millet në tokë pretendon se gjykon me drejtësi dhe drejtësia në fenë e tyre është pjellë e mendjes së parisë së tyre. Madje shumë prej pretenduesve të islamit gjykojnë me adetet e tyre të cilat nuk janë zbritur prej Allahut si puna e seualifeve të nomadëve. Ata mendojnë se gjykimi duhet të jetë sipas tyre dhe jo sipas Kuranit dhe sunetit. Mu ky është kufri. Shumë njerëz e deklarojnë islamin, por akoma vazhdojnë të gjykojnë me adetet e përhapura në mesin e tyre, me të cilat i kanë urdhëruar paria e tyre. Kur e mësojnë që nuk lejohet të gjykojnë me diçka tjetër përveç asaj që ka zbritur Allahu ﷻ, nuk i kushtojnë kësaj rëndësi, madje e shohin të lejuar të gjykohet me atë që e kundërshton shpalljen e Allahut ﷻ. Këta persona konsiderohen qafirë”.²

Sejid Kutbi thotë rreth kësaj: “Ai që e zotron të drejtën e lejit apo ndalimit është vetëm Allahu ﷻ dhe askush tjetër, qoftë ai individ, klasë shoqërore, një popull i caktuar, apo i gjithë njerëzimi së bashku, përveç me lejen e Allahut ﷻ dhe në përputhje me shariatën e Allahut ﷻ.

Lejimi dhe ndalimi është sheriati dhe feja. Nëse ai që e lejon diçka është Allahu ﷻ atëhere njerëzit janë në fenë e Allahut ﷻ, e nëse ai që ndalon dhe lejon është tjetërkush atëhere njerëzit i nënshtrohen këtij individ dhe janë në fenë e tij dhe jo në fenë e Allahut.³

Çështja në këtë prizëm është çështje e uluhijes (hyjnore) dhe e të drejtave që lidhen me të. Është çështje e fesë dhe kuptimit të fesë. Është çështje e imanit dhe kufirit. Të gjithë muslimanët anekënd botës duhet të shohin se ku janë në këtë pikë. Ku janë ata në këtë fe. Ku janë ata prej islamit edhe nëse këmbëngulin në pretendimin e islamit”.⁴

Arsyeja e kufirit të atij që e lejon atë që e ka ndaluar Allahu.

Shtrohet pyetja: Cili është shkaku i kufirit të atij që ndryshon dispozitat dhe përse konsiderohet qafir?

Themi: Ai që e lejon atë që e ka ndaluar Allahu ﷻ ose e ndalon atë që e ka lejuar Allahu ﷻ është qafir për disa shkaqe:

¹ Mexhmu’ul fetaua, 28/524.

² Mexhmuatul teuhid, fq. 293.

³ Konsiderohen të nënshtroar ndaj tij nëse e marrin atë për ligjëvënës përveç Allahut dhe e pasojnë atë në atë që e bën hallall dhe haram. Kështu duhet kuptuar fjala e Sejid Kutbit.

⁴ Rruga e davetit nën hijen e kuranit, 2/179.

1- Me lejimin e haramit ai ka refuzuar dhe i ka kthyer shpinën ligjit të Allahut ﷻ dhe ka refuzuar bindjen dhe nënshtrimin ndaj tij.

Një person i tillë është qafir me kufër të madh dhe nuk ka asnjë grimcë imani, siç thotë Allahu ﷻ: **«Jo pasha zotin tënd ata nuk besojnë derisa të të bëjnë ty gjykatës për atë që ka ndodhur mes tyre dhe pastaj të mos gjejnë në vetet e tyre asnjë siklet prej gjykimit tënd dhe ta pranojnë me nënshtrim»** En nisa 65.

Ibn Kajimi thotë: “Allahu ﷻ u betua me veten e tij duke e përforcuar betimin me pjesëzën mohore “jo”, se ata njerëz nuk besojnë derisa ta bëjnë profetin ﷺ gjykues në çdo kundërshtim mes tyre, në bazat dhe degët e fesë, në dispozitat fetare, në dispozitat e ringjalljes, në cilësitë e Allahut ﷻ dhe në çdo gjë tjetër. Madje nuk mjafton vetëm kthimi për gjykim te profeti ﷺ për vërtetimin e imanit, por duhet të mos ndiejnë asnjë siklet dhe dyshim, por ta hapin gjoksin për gjykimin e tij dhe ta pranojnë menjëherë. E pas gjithë kësaj nuk cilësohen me iman, derisa të kënaqen, të dorëzohen dhe të mos kundërshtojnë gjykimin e tij”.¹

Utbe Ibn Damras thotë: Babai më ka treguar për dy burra që shkuan për të zgjidhur konfliktin mes tyre te profeti ﷺ. Profeti ﷺ i dha të drejtë atij që kishte të drejtë kundër të padrejtit. Mirëpo ai që humbi gjyqin i tha: Nuk pajtohem me këtë gjykim. Pala tjetër i tha: Çfarë dëshiron? I tha: Shkojmë te Ebu Bekri. Atëhere shkuan te Ebu Bekri ﷺ dhe ai të cilit profeti ﷺ i dha të drejtë, tha: Vajtëm te profeti ﷺ për gjykim dhe më dha të drejtë mua. Atëhere Ebu Bekri i tha: Ju jeni sipas gjykimit të profetit ﷺ. Mirëpo ai prap nuk u kënaq dhe tha: Vemi te Umer ibn Hatabi. Atëhere shkuan dhe personi që kishte të drejtë i tha: Vajtëm te profeti ﷺ dhe më dha të drejtë mua por ky nuk u kënaq. Pastaj vajtëm te Ebu Bekri ﷺ dhe na tha: Ju jeni sipas gjykimit të profetit ﷺ, por prap nuk u kënaq. Atëhere Umeri ﷺ e pyeti: A është kështu? I tha: Po. Atëhere Umeri ﷺ i tha: Prisni pak sa të dal dhe do të gjykoj mes jush. Pastaj doli me shpatë në dorë dhe e goditi atë që kërkoi të shkonin te Umeri dhe e vrau. Atëhere ky personi u kthye te profeti ﷺ dhe i tha: O i dërguar i Allahut! Umeri e vrau shokun tim e sikur të mos shpëtoja prej tij kishte për të më vrarë. I dërguari i Allahut ﷺ i tha: **“Nuk besoj se Umeri guxon të vrasë ndonjë besimtar”**. Atëhere Allahu ﷻ zbriti: **«Jo pasha zotin tënd ata nuk besojnë derisa të të bëjnë ty gjykatës për atë që ka ndodhur mes tyre»**, kështu Allahu ﷻ e shfaqësoi Umerin ﷺ për veprimin e tij”.²

Imam Ahmedi ka thënë: “Vështrova në Kuran dhe e gjeta bindjen e profetit ﷺ të përmendur në tridhjetë e tre vënde, pastaj lexoi: **«Le të bëjnë kujdes ata që kundërshojnë urdhrin e tij se mos i godet ndonjë fitne ose mos i godet ndonjë dënim i dhimbshëm»** En nur 63. Pastaj tha duke e përsëritur disa herë: Çfarë është fitnia? Ajo është shirku. Nëse refuzon ndonjë fjalë të profetit ﷺ, në zemër i hyn devijimi dhe zemra i devijon dhe

¹ Et tibjan fi aksamil kuran, fq. 270.

² Es sarimul meslul, Ibn Tejmije, fq. 38.

shkatërrohet”.¹

Ibn Tejmije thotë: “Nifaku vërtetohet dhe imani rrëzohet me injorimin e gjykimit të profetit ﷺ dhe me kthimin për gjykim te dikush tjetër”.²

2- Ai ka rrëzuar dhe ndryshuar ligjin e Allahut ﷻ, sepse kur Allahu ﷻ thotë për diçka se është haram, ai thotë: Jo! Kjo është hallall! Ose nëse Allahu ﷻ thotë për diçka se është hallall, ai thotë: Jo! Është haram dhe e ndaluar! Pikërisht ky është përgënjeshtrimi dhe kufri i qartë.

Allahu ﷻ thotë: **﴿Vetëm Allahu gjykon dhe askush nuk e rrëzon gjykimin e tij dhe ai është i shpejtë në llogari﴾** Er rad 41.

Dhe thotë: **﴿Allahu gjykon çfarë të dëshirojë﴾** El maide, 1.

Dhe thotë: **﴿O besimtarë! Mos flisni përpara Allahut dhe të dërguarit dhe friksojuni Allahut sepse Allahu dëgjon dhe di çdo gjë﴾** El huxhurat 1.

Besimtarit _nëse dëshiron të ruaj imanin dhe islamin e tij_ nuk i lejohet të flasë dhe të gjykojë përpara Allahut ﷻ dhe profetit ﷺ dhe as të shpreh mendime dhe ide përpara gjykimit të Allahut ﷻ dhe të dërguarit ﷺ.

Rreth fjalës së Allahut ﷻ: **﴿O besimtarë! Mos i ngrini zërat tuaj mbi zërin e profetit dhe mos i bërtisni atij ashtu siç i bërtisni njëri-tjetrit se mos ju rrëzohen punët pa e kuptuar﴾** El huxhurat, 2, Ibn Tejmije thotë: “Bëni kujdes dhe friksojuni që të mos ju rrëzohen punët. Punët i rrëzon vetëm kufri, sepse ai që vdes me iman patjetër do të hyjë në xhenet dhe do të dalë prej zjarrit nëse hyn në të. Nëse do t’i rrëzoheshin të gjitha punët nuk kishte për të hyrë në xhenet sepse veprat e mira i rrëzon e kundërta e tyre dhe punët e mira vetëm kufri i kundërshton tërësisht.

Duket qartë se ngritja e zërit dhe bërtitja ndaj profetit ﷺ mund të jetë shkak që çon në kufër pa e kuptuar, duke i zhvlerësuar të gjithë punët”.³

Rrëzimi i punëve të atij që ngre gjykimin e tij sipër gjykimit të Allahut ﷻ dhe profetit ﷺ dhe i jep përparësi më shumë se Kurani dhe suneti, është më i merituar.

Ibn Kajimi thotë: “Nëse ngritja e zërit mbi zërin e profetit ﷺ është shkak për rrëzimin e punëve, si qëndron puna e atij që i jep përparësi ideve, mendimeve, shijes, politikës dhe dijës së tij më shumë sesa ajo me të cilën profeti ﷺ është dërguar?! A nuk e meriton më shumë që t’i rrëzojë veprat kjo punë?!”⁴

3- Ndryshuesi i ligjit të Allahut ﷻ e konsideron Allahun ﷻ gabimtar në dispozitat që i

¹ Es sarimul meslul, fq. 56.

² Es sarimul meslul, fq. 38.

³ Es sarimul meslul, fq. 55.

⁴ l’lamul muakki’in, 1/51.

ka ligjëruar në fe dhe e përshkruan atë me mangësi dhe dobësi. Pra ose e përgënjeshton Allahun ﷻ ose trillon për të. Padyshim që ky është kufër i qartë.

Nëse Allahu ﷻ thotë për diçka se është haram ai thotë _qoftë edhe me dëshminë e realitetit të tij_: Jo! Kjo është hallall. Nuk mund ta konsiderojmë këtë gjë haram, sepse nuk përshatet me aktualitetin dhe parametrat e kohës dhe as me njeriun modern, etj.

4- Lejuesi i asaj që Allahu ﷻ e ka ndaluar e ka bërë veten rival me Allahun ﷻ duke i dhënë vetes cilësinë e ligjëvënies e cila i takon vetëm Allahut ﷻ dhe kjo është kufër dhe shirk.

Kur Allahu ﷻ thotë: **«Gjykimi i takon vetëm Allahut»** El enam 57, ai _qoftë edhe me dëshminë e realitetit_ thotë: Jo! Gjykimi më takon edhe mua¹ dhe jo vetëm Allahut. Ajo që unë them hallall është hallall dhe ajo që unë them haram është haram. Njerëzit duhet të më binden mua. Pikërisht kjo është uluhija të cilën e pretendoi faraoni kur tha: **«O njerëz! Nuk njoh për ju ndonjë ilah (zot) tjetër përveç meje»** El kasas 38. Pra vetëm unë jam sovrani që duhet t'i bindeni dhe vetëm unë jam ligjëvënës tek i cili duhet të ktheheni për çështjet fetare dhe të kësaj bote. Kompetencat e lejitimit dhe ndalimit më takojnë vetëm mua dhe askujt tjetër. Kjo ishte uluhija që faraoni e pretendoi për veten e tij.

Nëse Allahu ﷻ thotë: **«Nuk e bën askënd ortak në gjykimin e tij»** El kehf; 26, ai thotë: Jo! Unë jam ortak i Allahut në gjykim dhe ligjëvënie për çështjet që njerëzit duhet t'i zbatojnë. Hallall është ajo që unë e lejoj jo ajo që e lejon Allahu. Ndërsa haram është ajo që unë e ndaloj dhe jo ajo që e ndalon Allahu. Kjo është tamam shirku dhe kufri i qartë të cilin Allahu nuk e fal kurrsesi, përveçse me teube të sinqertë.

5- Me lejitimin e haramit e ka marrë epshin e tij për zot që adhurohet përveç Allahut. Ai e konsideron për hallall dhe haram atë që epshi i tij e shikon si hallall apo haram. Realisht ai adhuron epshin e tij dhe asgjë tjetër, siç thotë Allahu ﷻ: **«A e shikon atë që e ka marrë epshin e tij për ilah (të adhuruar) dhe Allahu e ka humbur me dije»** El xathijeh, 23.

Dhe thotë: **«E kush është më i humbur se ai që pason epshin e tij pa udhëzim prej Allahut»** El kasas, 50.

Dhe thotë: **«Mos ju bind atij që ja kemi hutuar zemrën prej përkujtimit tonë dhe ka pasuar epshin e tij»** El kehf 28.

Ibn Tejmije thotë: *“Kush adhuron atë që do epshi i tij, ai ka adhuruar epshin e tij dhe atë që e ka dashur ai është i adhuruar i tij. Ai nuk adhuron atë që e meriton të adhurohet por adhuron atë që i teket. Ky që e ka bërë epshin e tij zot të adhuruar shpreh dashuri (për të adhuruarin) njësoj si dashuria e mushrikëve për idhujt e tyre dhe njësoj si dashuria e*

¹ Ai që e pretendon ligjëvënien mund të jetë institucion që përfshin një grup ligjëvënësash, si parlamentet legjislativë në kohën tonë. Ose mund të jetë organizatë, individ, parti, sundues, kryetar partie, pari e fisit, etj. Të gjithë këta _megjithëse emrtimet i kanë të ndryshme_ përfshihen në kufrin e qartë.

adhuruesve të viçit për të adhuruarin e tyre. Kjo lloj dashurie është dashuri me Allahun dhe jo dashuri për Allahun. Kjo është dashuria e mushrikëve”.¹

Bazuar në këto arsye i gjithë umeti _të hershmit dhe të mëvonshmit_ janë pajtuar se kush e lejon atë që Allahu e ka ndaluar apo e ndalon atë që Allahu e ka lejuar ai është qafir dhe nuk ka bërë përjashtim prej kësaj ixhmaje asnjë dijetar i njohur.

Kushtet e pranimit të teubes së atij që lejon haramin.

Më parë u përmend se murtedit i paraqitet pendimi prej kufrit të tij sepse Allahu ﷻ thotë: **﴿përveç atyre që pendohen dhe veprojnë vepra të mira dhe e shfaqin (besimin e tyre), atyre ua pranoj pendimin dhe unë jam pranues i pendimit dhe i mëshirshëm﴾** El bekare 160. *“Allahu na njoftoi se ai është falës dhe mëshirues për ata që pendohen pas riddes. Kjo përfshin faljen në dynja dhe ahiret. Prandaj një person i tillë nuk ndëshkohet me vrasje”.²* Pra teubeja e rrëzon dënimin dhe e fshin gjynahun e riddes.

Dhe thotë: **﴿Kur të kalojnë muajt e shenjtë vritini mushrikët kudo që t’i gjeni dhe kapini, rrethojini dhe zijuni pritë në çdo rrugë. E nëse pendohen dhe e falin namazin dhe e japin zekatin atëhere lejini të lirë sepse Allahu është falës dhe mëshirues﴾** Et teube, 5.

Ibn Tejmije thotë: *“Kjo fjalë përfshin luftimin e çdo mushriku ose lirimin e tij nëse pendohet prej shirkut të tij, e fal namazin dhe e jep zekatin, qoftë ai mushrik në origjinë apo mushrik murted.*

Ky ka qënë mendimi i sahabëve, sepse pas vdekjes së profetit ﷺ kur shumica e arabëve u kthyen në kufër përveç banorëve të Mekës, Medines dhe Taifit, dhe një grup ndoqën profetët e rremë si Musejlemen, Ansiun, Tulejha Esdiun, atëhere Ebu Bekri ؓ me gjithë sahabët i luftuan derisa shumica e tyre u kthyen në islam dhe ua pranuan teuben dhe nuk vranë asnjë prej të kthyerve në islam. Prej kokave të murtedëve që u pendua dhe u kthye në islam ishte vetë Tulejha Esdiu i cili u hoq si profet dhe Eshathi nga fisi Kajs dhe shumë të tjerë. Kjo është shumë e mirënjohur dhe nuk mund të jetë e paqartë për askënd”.³

Kashmiri për sqarimin e kushteve të pranimit të teubes së atij që zhvlerëson haramin, thotë: *“Kush bën kufër duke mohuar diçka të mirënjohur, si mohimi i ndalimit të verës, atëhere duhet të distancohet prej këtij besimi, sepse ai i ka pas pohuar dy dëshmitë e islamit sëbashku me këtë besim kufri, prandaj duhet të distancohet. Shafitë shprehen qartë në këtë çështje dhe ky është mendimi i autorit të librit “Reddul muhtar minel irtidad” dhe i autorit të librit “Xhamiul fusul”. Nëse shehadetin e shqipton se i është bërë zakon, nuk i bën dobi*

¹ Mexhmu’ul fetaua, 8/359

² Marrë nga fjala e Ibn tejmijes, Es sarim el meslul, fq. 314.

³ Es sarim el meslul, fq. 318.

*derisa të pendohet për atë që ka thënë, sepse vetëm kështu i fshihet kufri”.*¹

Kjo për shkak se kufri i tij ishte për shkak të lejimit të verës, mohimit të ndalimit të saj dhe jo sepse ai nuk i pohon dy dëshmitë e teuhidit. Një personi të tillë nuk i bën dobi asnjë lloj adhurimi derisa të braktisë këtë prishës të imanit. Që të hiqet gjykimi me kufër dhe ridde duhet patjetër që të distancohet dhe të pendohet prej këtij prishësi të imanit i cili ishte shkak për daljen e tij prej islamit, krahas shqiptimit të shehadetit.

Për ta sqaruar më shumë këtë çështje po sjellim një shembull: Nëse dikush thotë që pesë namazet nuk janë farz dhe nuk janë obligim ndaj muslimanëve, e megjithatë ai falet², agjëron, kryen haxhin, bën xhihad dhe kryen lloj-lloj ibadete të tjera. Të gjitha këto nuk i bëjnë dobi dhe nuk rifutet në islam përveçse nëse pendohet prej këtij mendimi dhe e pohon që namazi është farz. Kjo është një çështje e qartë për të cilën nuk ka asnjë kundërshtim.

Shejh Ibn Bazi thotë: “Kush agjëron ditën dhe falet natën, e njëson Allahu me adhurim, e pason profetin ﷺ, mirëpo pas kësaj e kryen ndonjë adhurim për tjetërkënd përveç Allahut ﷻ, psh kur i kryen disa adhurime për profetin, ose për filan veli, apo për filan idhull, apo për diellin, hënë, ndonjë planet etj, duke iu lutur dhe duke kërkuar ndihmë dhe fitore prej tij, atëhere të gjitha punët i rrëzohen derisa të pendohet dhe të kthehet te Allahu ﷻ sepse Allahu ﷻ thotë: **(E nëse do të bënin shirk kishte për t’u rënë poshtë e gjitha ajo që kishin punuar)** El enam 88.

Nëse beson çdo gjë që lidhet me Allahun ﷻ dhe e beson atë në çdo gjë përveç zinasë dhe thotë zinaja është e lejuar, ase homoseksualiteti është i lejuar, ose vera është e lejuar, atëhere ai bëhet qafir edhe nëse i kryen të gjitha detyrat e tjera fetare, sepse nëse e lejon diçka të mirënjohur në fe të cilën Allahu e ka ndaluar, atëhere bëhet qafir dhe murted për shkak të këtij lejimi dhe asnjë vepër tjetër nuk i bën dobi, madje as teuhidi, me pajtimin e të gjithë muslimanëve.

E njëjta gjë thuhet nëse ndalon atë që Allahu e ka bërë hallall edhe nëse vepron me teuhid, singëritet dhe i beson profetët. Psh nëse thotë: Unë nuk e konsideroj të lejuar devenë, lopën, bagëtinë, apo gjëra të tjera për të cilat nuk ka kundërshtim se Allahu ﷻ i ka bërë hallall ndërsa ai thotë se janë haram, atëhere bëhet qafir dhe del prej islamit, pasi t’i ngrihet huxhja (ti paraqiten faktet) nëse është prej atyre që zakonisht janë të paditur.

Ose thotë: Nuk e konsideroj të lejuar grurin dhe elbin sepse ato janë haram, atëhere ai bëhet qafir. Ose nëse thotë: Lejohet martesë me vajzën ose me motrën, atëhere konsiderohet qafir dhe i dalë prej islamit (murted) edhe nëse falet, agjëron dhe i kryen të gjitha ibadetet e tjera sepse çdonjëra prej këtyre veprave e prish fenë.”³

¹ Ikfarul mulhidin, fq. 63.

² Duke besuar se ajo është nafile.

³ Realiteti i teuhidit dhe shirkut, marrë prej revistës “El hikme”, 3/100-101.

Për këtë dëshmon edhe pendimi që sahabët i kërkuan Ibn Medhunit dhe shokëve të tij kur pinë verë bazuar në interpretime të gabuara për lejimin e saj. Të gjithë sahabët morrën vendim që ata nëse nuk pendohen prej lejimit të verës, atëhere ata janë qafirë dhe duhet të vriten sepse kanë përgënjeshtuar Allahun ﷻ dhe kanë ligjëruar në fe atë që Allahu ﷻ nuk e ka lejuar. Dihet që Ibn Medhuni ka qënë prej luftëtarëve të Bedrit dhe luftëtarët e Bedrit kanë pasur vlera dhe virtyte më shumë se të tjerët. Por mirësia e Bedrit dhe mirësitë e tjera nuk do i vlenin nëse do këmbëngulte në lejimin e verës edhe pas sqarimit të argumenteve.

Ibn Tejmije thotë: *“Umeri me të gjithë pjesmarrësit në shura u pajtuan në një mendje që atij dhe shokëve të tij duhet t’u kërkohet pendimi, e nëse e pranojnë që është haram goditen me kamzhik, e nëse nuk e pranojnë që është haram atëhere konsiderohen qafirë”*.¹

Prej kësaj nxjerrim si konkluzion se veprat e mira, sado të mëdha të jenë duke përfshirë edhe shehadetin, nuk i bëjnë dobi njeriut nëse ai vepron kufër dhe shirk të madh. Veprat e mira i bëjnë dobi njeriut për gjynahet që janë më të vogla se kufri dhe shirku dhe atëhere kur vepra mund të konsiderohet kufër nga një aspekt dhe mund të mos konsiderohet kufër në një aspekt tjetër.

Allahu ﷻ thotë: **﴿E nëse bën shirk ka për t’u hedhur poshtë e gjithë vepra jote dhe ke për të qënë prej të humburve﴾** Ez zumer, 65.

Dhe thotë: **﴿E nëse do të bënin shirk kishin për t’u rënë poshtë e gjitha ajo që kishin punuar﴾** El enam, 88.

Dhe thotë: **﴿Iu afruam asaj që kishin punuar dhe e bëmë pluhur e hi﴾** El furkan, 23. Pra shirku i zhvlerëson të gjitha veprat e mira a thua se nuk janë kryer. Allahu na ruajt prej kufrit dhe shirkut.

Sqarim dhe vërejteje.

Dijetarët e umetit, të hershmit dhe të mëvonëshmit, kanë rënë në shumë kundërshtime rreth shumë çështjeve që lidhen me hallallin dhe haramin dhe detyrat fetare. Këto çështje janë çështje për të cilat lejohet ixhtihadi. Megjithëse kundërshtimet në mendime janë të shumtë, mirëpo askush prej tyre nuk e ka shpallur qafir atë që ndonjë haram e ka bërë hallall apo ndonjë haram e ka bërë hallall. Kjo për shkak se ata nëse kanë gabuar në çështjet e hallallit dhe haramit, nuk kanë gabuar për shkak se kanë dashur kundërshtimin e shariatit dhe përgënjeshttrimin e profetit, por për shkak të ixhtihadit dhe interpretimeve të ndryshme. Këta dijetarë, bazuar në ixhtihadin e tyre, kanë kujtuar se ia kanë qëlluar të vërtetës dhe e kanë kuptuar qëllimin e shariatit. Rregulli se “Kush e lejon haramin ka bërë kufër” nuk vlen për ta, sepse nëse gabimi rrjedh prej ixhtihadit të lejuar atëherë atij i takon një shpërblim, siç transmetohet në hadith: *“Nëse gjykatësi gjykon dhe bën ixhtihad dhe ja qëllon të vërtetës*

¹ Sarimul meslul, fq. 530.

atij i takojnë dy shpërblime. E nëse gjykon dhe bën ixhtihad por gabon atij i takon vetëm një shpërblim”.¹

Ibn Tejmije thotë: “Prej kësaj sqarohet që muxhtehidi nëse gabon përfiton një shpërblim dhe gabimi i falet, sepse gjetja e mendimit të drejtë në të gjitha çështjet është ose e pamundur ose shumë e vështirë”.²

Dhe thotë: “Besimi për vaxhipin e njohur dhe mutevatir, dhe rreth haramit të njohur dhe mutevatir është prej bazave më të mëdha të imanit dhe themeleve të fesë. Mohuesi i tyre konsiderohet qafir me ixhma, megjithëse muxhtehidi nëse gabon në disa prej këtyre çështjeve nuk konsiderohet qafir me ixhma edhe pse e ka gabuar të vërtetën”.³

Shejhul islami ka thënë fjalë shumë të bukura rreth kësaj çështje në librin e tij të çmuar “Mosqortimi i dijetarëve të mëdhenj”, i cili është prej librave më të bukur që janë shkruajtur në këtë temë.

Një dyshim dhe sqarimi i tij.

Prej ndarjeve të shpikura të cilat i përhapin murxhitë bashkohorë është ndarja e lejimit të haramit në dy lloje: Lejim me zemër që të nxjerr prej islamit dhe lejim me vepra që nuk të nxjerr prej islamit.⁴

Kjo ndarje është e pavlerë dhe e shpikur. Selefët nuk e kanë pas njohur atë. Lejimi vendin e ka në zemër dhe kush e lejon një gjynah me vepra dhe në pamje të jashtme, atëhere ai e ka lejuar atë edhe në zemër, sepse pamja e jashtme me brendësinë e zemrës kanë lidhje dhe ndikim reciprok. Nuk thuhet për vepruesin e gjynahut, që është më i vogël se kufri, se me veprimin e tij e ka lejuar gjynahun. Burimi i lejimit është në zemër dhe është i lidhur ngushtë me zemrën, mirëpo veprimi i gjynahut është diçka tjetër dhe nuk quhet lejim, sepse lejimi nënkupton ngulitjen e gjynahut në zemër dhe jo çdokush që e vepron gjynahun është i tillë.

Çështje që lidhen me kufrin e lejimit.

Këtu po paraqes disa çështje të cilave u kam kthyer përgjigje mot, për t’u plotësuar dobia dhe si përgjigje për ata që përhapin dyshime rreth kësaj teme.

Çështja e parë: Liçensat që shteti u jep bankave që punojnë me riba, mosndërryrja për largimin e ribasë, mbrojtja dhe financimi i këtyre bankave nëse

¹ E transmeton Buhariu.

² Raful melam an eimetil a’lam, fq. 57.

³ Mexhmu’ul fetaua, 12/496.

⁴ P.sh. shejh Albani, Allahu e mëshiroftë, në librin “Et tahdir min fitnetit tekfir” thotë: “Duhet ditur se kufri ashtu si fisku dhe dhulmi ndahet në dy lloje: Kufër dhe fisk dhe dhulm që të nxjerr prej islamit dhe ai kthehet te lejimi me zemër dhe një lloj tjetër që nuk të nxjerr prej islamit dhe ai është lejimi me vepra”.

kalojnë krizë ekonomike, a konsiderohet lejim praktik i ribasë? Na e sqaroni Allahu ju lartësoftë dhe ju shpërbleftë me të mira.

Përgjigje: Falenderimi i takon vetëm Allahut, zotit të botrave. Nëse vendosen ligje që i liçensojnë bankat e kamatës dhe përfitimin me riba dhe ribaja konsiderohet e lejuar, ndërkohë që para daljes së këtyre ligjeve ishte e ndaluar, ky veprim në këtë formë dhe në këtë mënyrë është konsiderim hallall i ribasë. Njeriu konsiderohet qafir nëse e vepron diçka të tillë. Edhe nëse hartuesit e ligjit nuk e pranojnë me gojë konsiderimin e ribasë të lejuar, mirëpo realiteti dhe veprimet e tyre janë më të sinqerta dhe më të qarta se fjalët e gojës, dhe Allahu është më i ditur.

Nëse këtij veprimi i shtohet edhe mbrojtja e këtij harami me forcën e armës dhe urdhërimi i ushtarëve dhe policisë për ruajtjen e tyre dhe dënimi i çdokujt që dëshiron t'i dëmtojë këto banka harami, atëhere kjo konsiderohet kufër dhe gjynah shetesë dhe Allahu është më i ditur.

Shejh Muhamed ibn Abdulvehabi thotë: *“E shpallim qafir atë që i mbron teqetë në të cilat i bëhet shirk Allahut dhe atë që i lufton ata që kundërshtojnë dhe kërkojnë prishjen e tyre”*.¹

Shiko se si i konsideroi ata qafirë thjesht sepse i mbrojnë këto teqe me forcën e armës edhe nëse nuk kryejnë rituale në to dhe nuk e lejojnë këtë me gjuhë dhe zemër.

Ata që ruajn ligjin e kufrit dhe të shirkut me forcën e armës, ata janë qafirë edhe nëse nuk shprehen me gojë për lejimin e tyre. Ruajtja e këtyre ligjeve dhe pengimi i atyre që mundohen t'i heqin ato është argument më i qartë dhe më i besueshëm për kufirin e tyre sesa lejimi me shprehjen e gojës dhe Allahu është më i ditur.

Çështja e dytë: Shejhul islami në Mexhmu'ul fetua (3/267) thotë: “Nëse njeriu e bën hallall haramin e njohur me ixhma ose e bën haram hallallin e njohur me ixhma ose ndryshon diçka në shariat që është e njohur me ixhma, ai bëhet qafir dhe murted me pajtimin e të gjithë fukahave”.

Çfarë kuptimi ka fjala “tebdil” (zëvendësim, ndryshim) dhe çfarë ka për qëllim me ndryshimin e shariatit? Cilat janë rastet që konsiderohen ndryshim dhe zëvendësim në kohën tonë? A është e vërtetë kjo fjalë: “Ndryshimi” në terminologjinë e fukahave nënkupton gjykimin me atë që nuk e ka zbritur Allahu duke e konsideruar atë prej fesë dhe shariatit të Allahut?

Kërkojmë sqarime duke përmendur fjalët e dijetarëve për këtë çështje të rëndësishme. Allahu ju shpërbleftë me të mira.

¹ Er resail esh shehsije, fq. 60.

Përgjigje: Falendërimi i takon Allahut zotit të botrave. Kuptimi i fjalës “tebdil” është zëvendësimi i shariatit të zbritur prej Allahut ﷻ me një ligj tjetër të kotë i cili mund t’i atribohet Allahut ﷻ padrejtësisht ose t’i atribohet njeriut dhe epshit të tij. Nuk ka dallim mes tyre në kufirin e tyre.

Këtë ka për qëllim shejhul islami dhe dijetarët e tjerë kur flasin për zëvendësimin e shariatit dhe kufirin e atij që e zëvendëson shariatit e Allahut. Askush prej tyre nuk ka bërë dallim mes ndryshuesve dhe nuk kanë thënë se kush e ndryshon shariatit dhe pretendon se ky ndryshim është prej Allahut ﷻ ai bën kufër, ndërsa kush e ndryshon shariatit me ligjet dhe epshet e njeriut nuk bën kufër.

Nuk ka asnjë argument për këtë dallim. Asnjë dijetar i njohur prej dijetarëve të selefit nuk e ka përmendur këtë dallim. Ky është vetëm një dyshim i frymëzuar prej shejtanit që ua ka hedhur dijetarëve të murxhive bashkohorë.

Kujtoja se dyshimet e këtyre njerëzve në këtë çështje kishin marrë fund dhe ishin sqaruar me fjalët e dijetarëve të udhëzuar, mirëpo herë pas here befasohem me lindjen e dyshimeve të tjera për të cilat Allahu ﷻ nuk ka zbritur asnjë argument. Burim i këtyre dyshimeve janë shejtanët të cilët i përhapin te njerëzit që shpresojnë se i pranojnë ato. Nuk e dimë me çfarë dyshimesh do të befasohemi në të ardhmen. Këto dyshime e pengojnë rininë islame prej rrugës së drejtë dhe i devijojnë prej detyrave të mëdha që i kanë marrë përsipër.

Atij që bën dallim mes zëvendësuesve i kërkohet argumenti përkatës dhe paraqitja e fjalëve të dijetarëve. Përderisa ai po pohon një dispozitë, atij i takon të sjellë argument. Megjithatë unë po paraqes disa argumente dhe fjalë të dijetarëve që dëshmojnë për vërtetësinë e fjalës sonë, që t’u qetësohet shpirti besimtarëve dhe të ulen pasuesit e epshit dhe të bidateve.

Allahu thotë: **﴿Ata që nuk gjejnë me atë që ka zbritur Allahu mu ata janë qafirët . . . të padrejtët . . . fasikët (të pabindurit)﴾** Ibn Abasi ka thënë: *“Allahu e ka zbritur këtë ajet për dy fise çifutësh. Njëri fis e kishte nështruar fisin tjetër në kohën e xhahilijetit, derisa ranë dakort dhe u pajtuan me shpagimin prej 50 uasak për çdo të vrarë që e vret fisi i fortë dhe me shpagimin prej 100 uasak për çdo të vrarë që e vret fisi i dobët. Kjo marrveshje ekzistoi deri në mbërritjen e profetit ﷺ në Medine. Me mbërritjen e profetit ﷺ të dy fiset e humbën pozitën e tyre dhe profeti ﷺ nuk e aprovoi marrveshjen mes tyre. Më pas fisi i dobët vrau një person prej fisit të fortë dhe fisi i fortë i kërkoi fisit të vogël që të paguanin 100 uasak. Mirëpo fisi i dobët u përgjigj: Pse bëni dallim mes dy fiseve që kanë një fe, një prejardhje, një atdhe? Përse shpagimi i njërit të jetë sa gjysma e shpagimit të tjetrit? Ne e patëm paguar më përpara sepse ju na imponuat me padrejtësi. Mirëpo tani që erdhi Muhamedi ﷺ nuk paguajmë më si më parë.*

Atëhere gati sa nuk plasi luftë mes tyre, por pastaj ranë dakort që të bënin gjykatës

mes tyre të dërguarin e Allahut ﷻ. Fisi i fortë tha: Betohe mi për Allah se Muhamedi nuk ka për t'ju dhënë dyfishin e asaj që ju paguani. Ata u treguan të singertë se në fund të fundit na paguanin më shumë padrejtësisht dhe prej shtypjes. Prandaj fusni te Muhamedi ﷺ ndonjë person që t'ju tregoj për mendimin e tij. Nëse ju jep atë që dëshironi shkoni dhe gjykohuni, e nëse nuk ju jep të drejtë ruajuni prej tij dhe mos shkoni për gjykim. Pastaj futën te i dërguari i Allahut ﷻ disa munafikë që të zbulonin mendimin e profetit ﷺ. Mirëpo kur i dërguari i Allahut ﷻ erdhi, Allahu ﷻ e njoftoi për historinë dhe planet e tyre dhe zbriti këtë ajet: **﴿O i dërguar! Mos u dëshpëro për ata që nxitojnë në kufër prej atyre që thanë: Kemi besuar﴾** e deri te fjala **﴿e kush nuk gjykon me atë që ka zbritur Allahu mu ata janë qafirët﴾**. Pastaj (Ibn Abasi) tha: Pasha Allahun për ata ka zbritur dhe ata ka pasur për qëllim Allahu”.¹

Le t'i rikthehem edhe njëherë leximit të hadithit sepse me të vërtetë kemi për të gjetur argument të qartë për mendimin e pohuar në fillim të përgjigjes dhe falenderimi i takon vetëm Allahut.

Çifutët kur ndryshuan ligjin e vrasjes nuk pretenduan se kjo është prej Allahut ﷻ, por ia mvëshën veteve të tyre. Si fisi i fortë ashtu edhe i nënshtruar, e dinin se kjo ishte padrejtësi dhe nuk ka mundësi që kjo padrejtësi të ndodhë mes dy fiseve që fenë e kanë të njëjtë. Prandaj fisi i nënshtruar u tha: “E patëm paguar më përpara sepse ju na imponuat me padrejtësi”. Pra e dinin se ky gjykim nuk ishte prej fesë së tyre dhe askush prej tyre nuk pretendoi që ky gjykim është prej fesë së tyre.

Madje vetë fisi i fortë e pohoi se fjala e fisit tjetër ishte e vërtetë dhe se ky ndryshim ishte padrejtësi e epshit të tyre dhe kurrsesi nuk pretenduan se kjo është prej Allahut ﷻ: “Ata u treguan të singertë se në fund të fundit na paguanin më shumë padrejtësisht dhe prej shtypjes”. Fisi i nënshtruar nuk paguante më shumë sepse kjo kishte zbritur në fenë e tyre. As fisi më i madh nuk merrte më shumë duke pretenduar se është zbritur në fenë e tyre, e megjithatë Allahu ﷻ zbriti për ta: **﴿mu ata janë qafirët﴾**.

Ky është argument shumë i fortë për rrëzimin e fjalëve të bidatçive bashkohorë të cilët thonë: Kush ia mvësh vetes së tij ndryshimin e ligjit të Allahut ﷻ nuk bën kufër.

Ky është argument i fortë për rrëzimin e pretendimit se kush zëvendëson shariatën dhe në të njëjtën kohë e pranon që ai është i padrejtë, ai nuk bën kufër. Kështu thotë shejh Ibn Uthejmini, Allahu e mëshiroftë. Unë kam shkruar një replikë ndaj tij në një ese të veçantë të publikuar në faqen tonë të internetit.

Prej fjalëve ku shejh Albani ka kundërshtuar xhematin është komentimi i këtij hadithi në “Es silsile” 6/111 në përputhje me disa baza të tij të kota rreth imanit kur thotë: “Nëse e kupton këtë atëhere nuk lejohet të zbatohen këto ajete për sundimtarët dhe kaditë muslimanë të cilët gjykojnë me ligje toksore të tjera dhe jo me atë që ka zbritur Allahu ﷻ. Unë them:

¹ E transmeton Ahmed i dhe të tjerë. Es silsiletus sahiha, 2552.

Nuk lejohet t'u bëhet tekfir për këtë shkak dhe të konsiderohen të dalë prej umetit nëse ata besojnë Allahun ﷻ dhe të dërguarin ﷺ, megjithëse atëhere kur nuk gjykojnë me atë që ka zbritur Allahu ﷻ kanë bërë krim. Ata u përgjasojnë çfiutëve në aspektin e gjykimit mirëpo ata i kundërshtojnë ata në një aspekt tjetër, sepse ata besojnë dhe e vërtetojnë atë që ka zbritur Allahu ﷻ në dallim nga çfiutët qafirë, të cilët e mohojnë atë siç thanë në fjalën e tyre: "e nëse nuk ju jep të drejtë ruajuni prej tij dhe mos shkoni për gjykim".

E vërteta fshihet në faktin se kufri është dy llojesh: Kufër besimi dhe kufër veprimi. Kufri i veprimit vendin e ka në zemër ndërsa kufri i veprimit ndodh me gjymtyrë. Kush vepron një kufër që kundërshton sheriatin dhe përputhet me kufrin që e ka në zemër atëhere ai është kufër besimi dhe ky është kufri që Allahu nuk e fal. Ndërsa nëse nuk përputhet me atë që ka në zemër, atëhere ai është besimtar me gjykimin e Allahut mirëpo ai e kundërshton këtë me veprat e tij dhe bën kufër në vepra dhe jo kufër besimi, prandaj vazhdon të jetë në mëshirë të Allahut; nëse dëshiron e dënon e nëse dëshiron e fal".

Ajo që e shtyu shejhun në këtë interpretim të gabuar, që më shumë i përngjason deformimit të fjalëve të hadithit sesa interpretimit, janë bazat e pasakta që ai ka në çështjen e imanit të cilat janë më afër bazave të xhehmive dhe murxhive ekstremë. Prandaj do ndalemi pak te fjalët e shejhut për disa sqarime dhe komente të shkurtëra.

1- Tagutët e gjykimit të cilët nuk kanë lënë prishës të imanin pa e kryer dhe pa vepruar ata janë besimtar sipas shejhut. Përse: Sepse ata e vërtetojnë atë që ka zbritur Allahu.

Nëse e pyesim shejhun për përkufizimin e imanit ka për t'u përgjigjur menjëherë: Besim, fjalë dhe vepër shtohet dhe paksohet.

Lind pyetja: Si ta përputhim këtë përkufizim me fjalën e shejut për tagutët në gjykim se ata janë besimtarë përshkak se vërtetojnë atë që ka zbritur Allahu në dallim nga çfiutët që e mohojnë. A mos çështja lidhet vetëm me një vërtetim dhe pastaj të ndodhë çfarë të ndodhë.

Nëse do studionim bazat e të humburit Xhehm ibn Safuan kishim për të gjetur se ai e lidh imanin me vërtetimin e zemrës dhe e lidh kufrin me mohimin ose përgënjeshttrimin e zemrës. Kjo fjalë është pikërisht fjala e shejh Nasirit Allahu e faltë dhe e mëshiroftë.

2- Këtë e përforcon edhe ndarja në dy lloje që shejhu i bën kufrin: Kufër që të nxjerr prej islamit dhe vendin e ka vetëm në zemër dhe kufër që nuk të nxjerr prej islamit dhe verprohet me vepra. Pra sado që kufri të shfaqet në vepra i qartë dhe i pastër përderisa zemra nuk pajtohet dhe e pohon kufrin atëhere ai nuk është qafir por prej besimtarëve njësuës dhe prej banorëve të xhenetit. Kjo është pikërisht fjala e të humburit Xhehm ibn Safuan Allahu e gjykoftë.

Rikthejuni fjalës së shejhut edhe njëherë: *Kush vepron një kufër që kundërshton sheriatin dhe përputhet me kufrin që e ka në zemër atëhere ai është kufër besimi dhe ky është kufri që Allahu nuk e fal".* Pra çdo kufër tjetër nuk është kufër i madh.

3- Si t'i përputhim bazat e ehli sunetit _të cilat shejhu i aprovon_ të cilat pohojnë lidhjen reciproke mes veprave të jashtme dhe zemrës me fjalën e shejhut: “Në pamje të jashtme qafir ... bën kufër me vepra ... por në zemër është besimtar ... zemrën e ka me besim ... udhëheqës qafir dhe që i kundërvihet shariatit të Allahut ﷻ me vepra të dukshme ... besimtar në brendësinë dhe zemrën e tij”.

4- Fjala e shejhut se shkak i kufrit të çifutëve ishte mohimi dhe përgënjeshtrimi me zemra në dallim nga tagutët e gjykimit të cilët gjykojnë në vendet islame, të cilët e pohojnë besimin me zemër, nuk është e vërtetë. Në hadith nuk ka asnjë dëshmi për këtë pretendim. Argumentimi që shejhu përdor nuk është i saktë as në gjuhë dhe as në formën dhe realitetin e tij. Ai tha: “*Të cilët e mohojnë atë siç thanë në fjalën e tyre: “e nëse nuk ju jep të drejtë ruajuni prej tij dhe mos shkoni për gjykim”.*”

Ku është argumenti në këtë frazë se çifutët mohuan me zemrat e tyre?! Sikur të zgjidhnim medhhebin që bën interpretimet më të kota, prap se prap nuk do të mund ta interpretonim këtë fjalë me mohimin dhe përgënjeshttrimin e zemrës.

Këtu lind pyetja: Interpretimi që e transformon kuptimin a është medhheb i selefit? I sulmojmë kundërshtarët tanë për interpretimet deformuese dhe i kritikojmë rëndë dhe pastaj biem vetë në një lloj të rëndë deformimi.

Nëse thuhet: Interpretimi që nuk bazohet në pamjen e jashtme lejohet në rast nevoje. I themi: Çfarë nevoje ka këtu? Vetëm nëse shpjegimi i fjalëve të hadithit sipas ideve të Xhehmiut konsiderohet domosdoshmëri që e lejon të ndaluarën.

Në anën tjetër Kurani e vërteton që çifutët nuk e kanë pas mohuar me zemrat e tyre as profetin, as ajetet dhe argumentet me të cilat u dërgua dhe as Kuranin. Përkundrazi ishin të sigurtë në zemrat e tyre se profeti ﷺ është i vërtetë dhe se me të vërtetë ishte dërguar prej zotit. Allahu ﷻ thotë: **﴿I mohuan ato padrejtësisht dhe me mendjemadhësi edhe pse ishin të sigurtë në vetet e tyre﴾** En neml 14. Ata i mohuan ajetet me gojët e tyre edhe pse ishin të sigurtë në vetet e tyre so ato ishin të vërteta. Ajo që i shtyu për këtë mohim në pamje të jashtme ishte vetëm hasedi dhe inati.

Allahu ﷻ thotë: **﴿Kur u erdhi ajo që e njohën bënë kufër. Mallkimi i Allahut qoftë mbi qafirët﴾** El bekare, 89.

Dhe thotë: **﴿Ata të cilëve u kemi dhënë librin e njohin atë ashtu siç njohin fëmijët e tyre por një grup prej tyre e fshehin të vërtetën megjithëse e njohin atë﴾** El bekare, 146.

E shumë ajete të tjera të cilat dëshmojnë se çifutët e pohonin në zemra se profeti ﷺ është i dërguar prej Allahut ﷻ dhe se ajo me të cilën është dërguar është e vërtetë. E megjithatë bënë kufër për shkak të mendjemadhësisë që të mos nënshtroheshin ndaj shariatit në vepra dhe mendime.

Një argument tjetër që dëshmon për kufirin e atij që ndryshon sheriatin me ligje të tjera që i ka shpikur vetë ose i ka marrë prej tagutëve njerëzorë është hadithi i profetit ﷺ që thotë: **“Izraelitët, kur kaloi shumë kohë dhe iu ngursuan zemrat, shpikën një libër prej veteve të tyre të cilin e deshtën me gjithë zemër dhe e predikuan me fjalët e tyre. Mirëpo e vërteta vazhdoi t’i pengonte ata prej shumë epsheve të tyre derisa e hodhën librin e Allahut mbas shpinës a thua se nuk e njohin dhe thanë: Paraqiteni këtë libër para izraelitëve e nëse ju pasojnë në këtë libër atëhere lejini të lirë e nëse ju kundërshtojnë vritini ..”**¹

Dhe thotë: **“Izraelitët shkruajtën një libër të cilin e pasuan dhe e braktisën Teuratin”**.

Të njëjtën gjë veprojnë edhe tagutët që e ndryshojnë sheriatin e Allahut sot. Çdo tagut prej tyre shkruan një libër sipas qejfit dhe e quan “ligj” ose “kushtetutë” dhe pastaj i detyron njerëzit me forcë dhe kush nuk e pranon forcën e ligjit dhe nuk pajtohet me të dënohet me vrasje, burg ose internim.

Këto metoda janë të vjetra. Ky është pasimi i rrugëve të atyre që kanë qënë para nesh kut për kut e pëllëmbë për pëllëmbë, edhe nëse hyjnë në zgravën e zhapikut kemi për të gjetur në këtë umet disa njerëz që do të hyjnë në të.

Ibn Hazmi thotë: **“Nuk ka dallim mes atij që e lejon shpikjen e ligjeve të cilat ndalojnë dhe lejojnë sipas ideve të njerëzve, për të cilat as Allahu ﷻ dhe as i dërguari ﷺ nuk kanë dëshmuar dhe mes atij që duke u bazuar në idetë e tij e hedh poshtë një ligj të cilin Allahu ﷻ e ka ligjëruar në gojën e profetit ﷺ. Kush bën dallim mes këtyre të dyjave ka shpifur dhe ia ka futur kot sepse të dyja ato janë kufër i qartë”**.²

Dhe thotë: **“Shpikja e ligjeve ndahet në katër lloje.**

1- Rrëzimi i një farzi të njohur; si rrëzimi i disa namazeve, ose rrëzimi i një pjese të agjërimit, ose i një pjese të zekatit ose i një pjese të haxhit, ose rrëzimi i dënimit të zinasë dhe shpifjes për zina, ose rrëzimi i tyre tërësisht.

2- Kur shton diçka në këto farze si shpikja e një farzi të ri.

3- Lejimi i haramit si lejimi i mishit të derrit, lejimi i verës dhe i ngordhësirës.

4 Ndalimi i hallallit si ndalimi i ngrënies së mishit të dashit etj.

Ai që vepron secilin prej këtyre llojeve është mushrik, njësoj si çifutët dhe të krishterët”.³

Xhesasi, në tefsirin e fjalës së Allahut ﷻ; thotë: **﴿Jo pasha zotin tënd ata nuk besojnë derisa të të bëjnë ty gjykatës për atë që ka ndodhur mes tyre﴾** : **“Në këtë ajet ka**

¹ E transemtion Bejhakui në “Shuab el iman”, Es silsiletus sahiha, 2694.

² El ihkam, 2/208.

³ El ihkam 2/274.

argument se kush e refuzon ndonjë prej urdhrave të Allahut ﷻ dhe të dërguarit të tij ﷺ, ai ka dalë prej islamit. Nuk ka dallim nëse e refuzon me dyshim apo e refuzon me mosaprovim dhe nuk pranon t'i nënshtrohet ..”

Ibn Tejmije thotë: “Ata që i morrën murgjërit dhe priftërinjtë e tyre për zotër, atëhere kur iu bindën në lejimin e asaj që Allahu e kishte bërë haram dhe në ndalimin e asaj që Allahu e kishte lejuar, ata ndahen në dy lloje: Lloji i parë janë ata që e dinë se kanë ndryshuar fenë e Allahut dhe prapë se prapë i pasojnë ata në këtë ndryshim dhe e lejojnë atë që Allahu e ka bërë haram dhe e ndalojnë atë që Allahu e ka lejuar, duke iu bindur parisë së tyre, megjithëse e dinë që ata e kanë kundërshtuar fenë e profetëve. Ky është kufër dhe Allahu ﷻ dhe profeti ﷺ e kanë konsideruar atë si shirk”.¹

Ai i konsideroi ata mushrikë thjesht për shkak të ndryshimit megjithëse ata e dinin që po kundërshtonin fenë e profetëve dhe se ligjet që i kishin shpikur nuk ishin prej Allahut ﷻ por prej vetes së tyre.

Dhe thotë: “Kjo është feja islame me të cilën Allahu ﷻ e ka dërguar të dërguarin e tij ﷺ. Ajo është nënshtrimi ndaj Allahut ﷻ një dhe të vetëm. Kush nuk i nënshtrohet Allahut ﷻ ai është treguar mëndjemadh ndaj adhurimit të tij. Allahu ﷻ thotë: **﴿Ata që tregohen mëndjemëdhën timer për adhurimin tim ata do të hyjnë në xhehenem të përbuzur﴾**. Ndërsa ai që i nënshtrohet dikujt tjetër përveç Allahut ﷻ ai është mushrik dhe Allahu ﷻ thotë: **﴿Allahu nuk e fal t'i bëhet shirk﴾**”.²

Dhe thotë: “Është vërtetuar me Kuran dhe me sunet dhe me ixhmanë e umetit, se ai që largohet prej sheriatit islam luftohet edhe nëse i shqipton dy shehadetet”.³

Dhe thotë: “Allahu ﷻ është betuar në veten e tij se kushdo që largohet prej rrugës dhe sheriatit të profetit ﷺ ai nuk beson derisa të kënaqet me gjykimin e të dërguarit të Allahut ﷻ për çdo çështje që lidhet me fenë dhe dynjanë dhe të mos gjej asnjë siklet në zemrën e tij. Argumentet kuranore për këtë çështje janë të shumta. Çdo njeri me pozitë që refuzon t'i bindet Allahut ﷻ dhe të dërguarit ﷺ ai i ka shpallur luftë Allahut ﷻ dhe të dërguarit të tij ﷺ. Kushdo që punon në tokë me diçka tjetër përveç Kuranit dhe rrugës së profetit ﷺ ai ka përhapur çrregullime në tokë”.⁴

Dhe thotë: “Është e mirënjohur në fenë islame dhe me konsensusin e të gjithë muslimanëve, se kush e lejon pasimin e një feje tjetër përveç islamit dhe pasimin e ndonjë ligji tjetër përveç sheriatit të Muhamedit ﷺ, ai konsiderohet qafir”.⁵

¹ Mexhmu'ul fetaua, 7/70.

² Mexhmu'ul fetaua, 28/23.

³ Mexhmu'ul fetaua, 28/357.

⁴ Mexhmu'ul fetaua, 28/470-471.

⁵ Mexhmu'ul fetaua, 28/524.

Dhe kanë thënë e kanë thënë...! Sikur t'i mblidhnim të gjitha fjalët që kanë thënë dijetarët, ata prap kishin për t'i keqinterpretuar dhe për t'i deformuar, për të përkrahur tagutët që kanë ndryshuar ligjet e Allahut ﷻ dhe që luftojnë sheriatin e Allahut ﷻ të cilët gjykojnë me ligjet e tagutit **(Kujt nuk i jep Allahu dritë ai nuk ka dritë)**.

Çështja e tretë: Çfarë kihet për qëllim me fjalën “lejim” dhe cilat janë kushtet e saj? Kur nuk është kusht lejimi për gjykimin e një gjynahqari që ai është qafir? Gjykimi i pushtetarit me atë që nuk e ka zbritur Allahu në legjislacionin e shtetit a nënkupton që ai e ka lejuar atë edhe nëse me gojë pretendon se nuk e ka lejuar? Vazhdimësia në kryerjen e gjynahut që është kufër ose nuk është kufër a nënkupton që ai e ka konsideruar të lejuar atë? Ju lutemi të na e sqaroni gjerësisht sepse ka disa gjëra që nuk i kemi kuptuar. Allahu ju dhënë bereqet dhe ju udhëzofte.

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahu zotit të botrave. Me fjalën “lejim” kemi për qëllim konsiderimin hallall të veprave që Allahu i ka bërë haram ose lejimin e moskryerjes së farzeve dhe riteve fetare. Kush bie në këtë lloj lejimi ai bën kufër me ixhmanë e të gjithë dijetarëve.

Ky lloj lejimi konsiderohet kusht për shpalljen qafir të atij personi që vepron një gjynah që është më i vogël se kufri dhe shirku. P.sh. themi: Ai që pi verë nuk bën kufër vetëm në rast se konsideron të lejuar. Po kështu edhe ai që vjedh dhe bën zina.

Mirëpo ky lloj lejimi nuk është kusht për shpalljen qafir të personit që kryen një gjynah që është kufër dhe shirk. Në këtë rast nuk kushtëzohet lejimi për vepruesin e këtij lloj gjynahu sepse kufri dhe shirku janë kufër në vetvete dhe të pavarur nga lejimi. Nuk është kusht që vepruesi i kufrit ta konsiderojë atë të lejuar. Prandaj ai është qafir dhe mushrik nëse e vepron kufrin duke e konsideruar të lejuar apo duke mos e konsideruar të lejuar.

Përsa i përket pyetjes: Gjykimi i pushtetarit me atë që nuk e ka zbritur Allahu në legjislacionin e shtetit a nënkupton që ai e ka lejuar atë edhe nëse me gojë pretendon se nuk e ka lejuar?

Nëse ke për qëllim se ai nuk gjykon me atë që ka zbritur Allahu asnjëherë dhe u bindet taguatve në çdo ligj që e ligjërojnë dhe gjykon me ato ligje, apo gjykon me ligje që i ka shpikur vetë dhe i ka vendosur si kushtetutë që pasohet; nëse po pyet për një person të tillë, atëherë një person i tillë e ka lejuar gjykimin me atë që nuk e ka zbritur Allahu ﷻ edhe nëse me gojë pretendon të kundërtën, sepse realiteti i veprave të tij e përgënjeshton atë dhe veprat e tij janë më të sinqerta se pretendimi me fjalë.

Përsa i takon pyetjes: Vazhdimësia në kryerjen e gjynahut që është kufër ose nuk është kufër a nënkupton që ai e ka konsideruar të lejuar atë?

Them: Vazhdimësia në gjynah nuk nënkupton që ai e ka lejuar gjynahun por

frikësohemi se me kalimin e kohës dhe vazhdimësinë në gjynah mund të bjerë në lejim dhe në zbukurimin e gjynahut sepse gjynahet e vogla të shtynjë drejt të mëdhajave dhe gjynahet e mëdhaja të shtynjë drejt kufirit dhe shirkut, Allahu na ruajt prej tij.

Medito për fjalën e profetit: *“Ai që e pi verën vazhdimisht është si adhuruesi i idhujve”*¹ dhe : *“Pirësi i verës vazhdimisht nuk do të hyjë në xhenet”*². E lus Allahun të na ruaj dhe të na falë.

Çështja e katërt: Jeni në dijeni, _Allahu ju ruajt_, që fjala e Allahut (E kush nuk gjykon me atë që ka zbritur Allahu mu ata janë qafirët) ka zbritur për qafirët e ehlikitabit dhe se ajo përfshin këdo që mohon gjykimin e Allahut. Çfarë kihet për qëllim me fjalën “mohon gjykimin e Allahut”? Na e sqaroni Allahu ju shpërbleftë.

Përgjigja: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Mohimi nënkupton përgënjeshttrimin, refuzimin dhe mosvërtetimin. Ai është tre llojesh dhe të gjitha këto lloje janë kufër që të nxjerr prej islamit.

Mohim në pamje të jashtme por jo me zemër; si mohimi i çifutëve për profetësinë e profetit ﷺ megjithëse në brendësitë e tyre ishin të sigurtë se ai ishte profet i vërtetë. Allahu ﷻ thotë: **(I mohuan ato padrejtësisht dhe me mëndjemadhësi edhe pse ishin të sigurtë në vetet e tyre)** En neml 14.

Mohim me zemër por jo në pamje të jashtme; si mohimi i munafikëve të cilët hiqen se pranojnë dhe besojnë por në zemra fshehin mohimin dhe përgënjeshttrimin. Këta persona janë qafirë pa dyshim dhe pa asnjë kundërshtim.

Mohim me zemër dhe në pamje të jashtme. Kufri i këtij lloj mohuesi është më i rëndë dhe më i ndërlikuar. Allahu na ruajt!

Ajo që deshëm të themi me këto fjalë se të gjitha llojet e mohimit janë kufër i madh. Kushdo që bie në një nga këto lloje të mohimit ai është qafir dhe del prej islamit dhe Allahu ﷻ është më i ditur.

Çështja e pestë: Prej Bera ibn Azibit ﷺ thotë: Pranë meje kaloi Ebu Burda ﷺ me një flamur. I thashë: Për ku je nisur? Më tha: I dërguari i Allahut ﷻ më ka dërguar te një person që është martuar me gruan e babait të tij për t’ia sjellë kokën. E transmeton Tirmidhiu. Në rivajetin e Ebu Daudit shtohet: “për t’ia prerë kokën dhe për t’ia marrë pasurinë”. Ndërsa në rivajetin e Ahmedit thuhet: “As nuk e pyetën dhe as nuk i folën”.

Ibn Kajimi ka thënë: Nesaiu ka përmendur në sunenin e tij prej hadithit të

¹ Sahih sunen Ibn Maxheh, 2720.

² Sahih sunen Ibn Maxheh, 2721.

Abdullah ibn Idrisit, na ka treguar Ibn Ebi Kerimeh prej Muavije ibn Kurras prej babait të tij se i dërguari i Allahut ﷺ e dërgoi babain e tij që është gjyshi i Muavijes për te një person që u martua me gruan e babait të tij dhe ia preu kokën dhe ia morri një të pestën e pasurisë.

Pyetja është: Si t'i përputhim këto hadithe dhe tekset e tyre, sidomos fjalën: “ia morri një të pestën e pasurisë” me mendimet e dijetarëve për këto hadithe, duke ditur që akidja e ehlisunetit është mes akides së havarixhëve dhe murxhivëve dhe nuk i bëjnë qafirë ata që veprojnë gjynahe të mëdha që nuk janë kufër vetëm në rast se i lejojnë ato. Prej gjynaheve të mëdha është edhe martesë me gruan e babait. Allahu ju shpërbleftë me të mira.

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Dije se marrëdhënia me gruan e babait është gjynah i madh që nuk ngjitet në gradën e kufrit të qartë. Nuk di asnjë dijetar të besueshëm që të ketë thënë se ajo është kufër. Mirëpo veprimi i këtij personi, për shkak të së cilit profeti urdhëroi të vritej, ishte martesë me gruan e babait dhe bërja dasëm duke e konsideruar atë grua të tij dhe hallall.¹ Pikërisht ky është lejimi me të cilin personi bën kufër edhe nëse nuk shprehet me gojë se ai e ka konsideruar të lejuar në zemër. Sepse veprimi i tij dëshmon për këtë dhe është më i sigurtë sesa fjala e gojës. Prandaj profeti ﷺ urdhëroi që të vritej dhe t'i merrej një e pesta e pasurisë, sepse ai ishte qafir dhe murted.

Fjala *“As nuk e pyetën dhe as nuk i folën”*, sepse vepra e tij ishte shumë e qartë për lejimin e marrëdhënieve (me gruan e babait) dhe nuk kishte nevojë ta pyesnin: A e lejon me zemër apo nuk e lejon me zemër?

Ky hadith është argument se ndonjëherë vepra mund të jetë e mjaftueshme si dëshmi dhe argument që njeriu e konsideron një gjynah të caktuar të lejuar dhe bazuar në dëshminë e veprave gjykohet se është qafir dhe murted.

Në këtë hadith ka argument kundër të infektuarve me dyshimet e irxhasë të cilët e ndajnë “lejimin” në dy lloje: lejim i gjynaheve me vepra i cili nuk konsiderohet kufër dhe lejim i brendshëm dhe me zemër i cili konsiderohet kufër. Sipas tyre duhet që njeriu ta shprehë me gojë që e lejon këtë gjynah ose këtë kufër që ta dimë se ai e ka lejuar me zemër këtë gjynah përndryshe nuk konsiderohet se e ka lejuar.

Prandaj them: Kushdo që vepron njësoj si ky person dhe martohet me gruan e të atit, gjykohet se ka bërë ridde dhe kufër, sepse ai ka lejuar atë që Allahu e ka ndaluar pa pasur nevojë ta pyesim se çfarë beson dhe lejon me zemër. Ai vritet për këtë ridde edhe nëse pretendon me gojë se ai nuk e lejon nikahun me gruan e babait me zemër dhe nuk i

¹ Të njëjtin gjykim ka edhe martesë mes homoseksualëve. Kush kryen një martesë të tillë konsiderohet qafir sepse ai martesën e kryen vetëm e vetëm që të jetë bashkëshort i ligjshëm dhe kjo nënkupton që ata i konsiderojnë të lejuara marrëdhëniet homoseksuale mes tyre dhe kjo është kufër. Shënim i përkthyesit.

zihet besë, sepse realiteti i tij është më i besueshëm se pretendimi me fjalë.

Çështja e gjashtë: Kur konsiderohet lejimi i haramit dhe ndalimi i hallallit kufër dhe vepruesi i tij qafir?

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Kush e lejon haramin që është haram me ixhma apo e ndalon hallallin që është hallall me ixhma, pa pasur justifikim të pranueshëm, ai është qafir dhe murted sepse kjo nënkupton përgënjeshtimin e sheriatit në çështjet e hallallit dhe haramit dhe nënkupton mohimin e asaj që e ka zbritur Allahu ﷻ dhe sepse ai e ka konsideruar veten burim prej burimeve të ligjvënies dhe bazë në konsiderimin e gjërave për të lejuara dhe të ndaluara.

Ibn Tejmije thotë: *“Kush i mohon disa vaxhibe të njohura dhe mutevatire si pesë namazet, agjërimin e muajit të ramazanit, haxhin, ose mohon ndalimin e disa haremeve të njohura dhe mutevatire si gjërat e turpshme, padrejtësinë, alkolin, kumarin, zinanë etj, ose mohon lejimin e disa gjërave të njohura si të lejuara dhe mutevatire si buka, mishi dhe martesat; ai është qafir dhe murted, i kërkohet pendim, e nëse pendohet i pranohet e në të kundërt vritet. Nëse këto mendime i fsheh dhe nuk i shfaq atëhere konsiderohet zindik dhe munafik dhe nuk i kërkohet pendim sipas mendimit të shumicës së dijetarëve por vritet pa i kërkuar teube nëse fillon dhe i shfaq (këto mendime)”*.¹

Dhe thotë: *“Nëse njeriu e bën hallall haramin e njohur me ixhma ose e bën haram hallallin e njohur me ixhma ose ndryshon diçka në sheriat që është e njohur me ixhma, ai është bërë qafir dhe murted me pajtimin e të gjithë fukahave”*.²

Dhe thotë në librin e tij të vyer “Mosqortimi i dijetarëve islam”: *“Nëse është rritur në malësi të largëta ose është akoma i ri në islam dhe vepron ndonjë harram pa e ditur se është harram nuk ka gjynah dhe nuk dënohet edhe nëse nuk argumentohet për veprimin e tij me ndonjë argument prej sheriatit.*

Ndërsa atij që nuk i ka ardhur argumenti për ndalimin e diçkaje dhe bazohet në lejimin e saj në argumente prej sheriatit ai e meriton të justifikohet më shumë madje ai është shpërblehet dhe lavdërohet për ixhtihadin e tij”.³

Çështja e shtatë: Shejhul islami në librin “Minhaxhus sunneh” ka thënë: “Nëse _ata të cilët njerëzit u binden_ e mësojnë që nuk lejohet gjykimi me atë që nuk e ka zbritur Allahu ﷻ mirëpo nuk e praktikojnë atë përkundrazi e lejojnë që të gjykohet me atë që nuk e ka zbritur Allahu ﷻ, atëhere ata konsiderohen qafirë ose në të kundërt

¹ Mexhmu’ul fetaua, 11/405.

² Mexhmu’ul fetaua, 3/267.

³ Mosqortimi i dijetarëve islam; fq. 56.

janë të paditur ...” Çfarë qëllimi ka shejhul islami me fjalën “e lejojnë”?

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Në disa raste ai që gjykon me atë që nuk e ka zbritur Allahu ﷻ nuk bën kufër vetëm nëse e konsideron të lejuar. P.sh. si ai që gjykon me atë që nuk e ka zbritur Allahu në një ose në disa çështje prej epshit, ose sepse tregohet i dobët, duke e pranuar që kjo është gabim dhe gjynah. Ky person nuk konsiderohet qafir përderisa nuk gjykon me atë që nuk e ka zbritur Allahu duke e konsideruar si të lejuar dhe përderisa nuk mohon dhe përgënjeshtron. Këtë ka pasur për qëllim shejhul islami në fjalën e mësipërme.

Lejimi në disa raste mund të jetë shprehje e qartë me gojë dhe në disa raste shfaqet qartë në vepra dhe të dyja këto lloj lejimesh merren në konsideratë për atë që e lejon gjykimin me atë që nuk e ka zbritur Allahu ﷻ, dhe Allahu është më i ditur.

Çështja e tetë: Çfarë mendimi keni për konsiderimin e zinasë si diçka të rëndomtë prej atij që bën zina aq sa e konsideron atë si një të drejtë të tij? Apo marrjen e gjykit jo me ligjin e Allahut si diçka të rëndomtë dhe se ai ka nevojë për lejen e pushtetarit që të vihet në praktikë? Nëse e përfytyroj veten si kadi nuk kisha për të gjykuar me ridde derisa personi të shprehet me të tilla fjalë dhe kisha për t’u larguar prej gjykit me kufrin e tij nëse nuk shprehet me fjalë të tilla edhe nëse unë jam i sigurtë se ai e beson këtë me zemër.

A nuk e shikon se nëse do i cilësojmë njerëzit në njerëz që i shikojnë haramet për gjëra të thjeshta, apo të mira apo të penduar kishim për t’u futur në klasifikimin e zemrave për brendinë e të cilave Allahu është më i ditur dhe në këtë mënyrë e kemi braktisur gjykimin me pamjen e jashtme i cili dëshmon për daljen e tij prej islamit?

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Nuk është kusht gjithmonë për tekfirin apo shpalljen e një personi të caktuar si qafir që ai ta pohojë me gojë përpara teje se ai beson se kjo është e lejuar, ose të të thotë troç: Unë bëj kufër me Allahun dhe e përgënjeshtroj sheriatin e Allahut. Këto lloj fjalësh shumë rrallë mund t’i dëgjosh prej zindikëve dhe murtedëve. Mund të ketë shumë njerëz që praktikojnë kufrin e qartë me të gjitha llojet e tij dhe në të njëjtën kohë pranon prej teje çdo akuzë përveç akuzës së kufrit të cilën kurrësesi nuk e pranon!

Është saktësuar prej sunetit të profetit ﷺ se disa kriminelë dënohen për gjynahet e tyre edhe nëse nuk i pohojnë me gojë të tyre, madje në disa raste edhe pa u kërkuar pendim, siç transmetohet në hadithin ku profeti ﷺ urdhëroi të vritej ai që u martua me gruan e babit të tij dhe t’i merrej një e pesta e pasurisë, pa i kërkuar shpjegim për veprën e tij nëse e bëri duke e konsideruar të lejuar apo jo. Kjo për shkak se vepra e tij ishte dëshmi më e qartë për kufrin e tij sesa fjalët e gojës.

Gjithashtu mendimi më i saktë është se zindikut nuk i kërkohet pendim por vritet, sepse nëse do të merrej në pyetje ka për të mohuar dhe përgënjeshtuar veprën e tij e cila është kufër i qartë dhe për të cilën është njohur si zindik. Shumica e dijetarëve mendojnë se ai vritet pa i kërkuar pendim dhe pa u marrë në pyetje sepse kërkimi i teubes bëhet për një diçka të njohur ndërkohë që zindiku nuk pranon asgjë edhe nëse do t'i sillje të gjitha provat që dëshmojnë kufirin e tij ai prapë kishte për të debatuar dhe kishte për t'u hequr si musliman i kulluar dhe nuk do të toleronte në akuzat që i bëhen. E sa të shumë ka si këta tipa në kohën tonë.

Fjalë të zgjedhura prej Sejid Kutbit rreth bindjes dhe ligjvënies.

Shpjegimin e këtij rregulli dëshiroj ta mbyll me disa fjalë të mrekullueshme të Sejid Kutbit që lidhen me këtë rregull.

*“Allahu ﷻ thotë: **﴿Allahu i dërgoi profetët si përgëzua dhe qortues dhe u zbriti atyre librin me të vërtetën për të gjykuar mes njerëzve në kundërshtimet e tyre﴾** El bekare 213.*

Islami e vendos librin që Allahu ﷻ e zbriti me të vërtetën për gjykuar në kundërshtimet e njerëzve; e vendos këtë libër bazë në jetën e njeriut. Jeta më pas rrjedh dhe nëse përputhet me këtë bazë dhe bazohet në të atëhere kjo është “e vërteta” e nëse bazohet në baza të tjera atëhere kjo është “e kota”. Kjo është e kota edhe nëse njerëzit e pëlqejnë atë në epoka të caktuara të historisë. Njeriut nuk i takon të jetë arbitër që gjykon për të vërtetën dhe të kotën. E vërteta nuk është ajo që njerëzit e pohojnë. Feja nuk është ajo që njerëzit e pohojnë. Pikpamja e islamit ngrihet mbi bazën: “Veprat, fjalët dhe mënyra e jetesës së njerëzve nuk e kthen diçka në të vërtetë nëse ajo është në kundërshtim me Kurandin” dhe nuk e bën atë gjë si bazë fetare dhe nuk e shpjegon fenë me realitetin e kësaj veprë dhe as nuk e justifikon atë vetëm e vetëm se disa breza janë bazuar në të.

Pranimi i ligjërit të një menhexhi, aktualiteti apo ligji jo prej Allahut ﷻ është pikërisht dalja prej islamit. Islami është feja e Allahut. Islami është njësimi i Allahut një dhe të vetëm prej krijesave të tij.

*Allahu ﷻ thotë: **﴿O Besimtarë! Nëse u bindeni një grupi prej atyre që u është dhënë libri kanë për t'ju kthyer pas imanit në qafirë. E si bëni kufër ndërkohë që ajetet e Allahut ju lexohen dhe i dërguari i Allahut është në mesin tuaj! E kush kapet fort me Allahun ai është udhëzuar në rrugë të drejtë﴾** Ali Imran 101.*

Me të vërtetë habitem se si e marrim sistemin e jetës sonë, ligjet dhe dispozitat tona prej këtyre burimeve të shpikura. Habitem se si e marrim etikën e sjelljes dhe të edukatës prej këtij pusi të ndotur ku ka përfundur civilizimi materialist, i cili zhveshur nga çdo formë feje. Pastaj ngrihem dhe pretendojmë _pasha Allahun është për t'u habitur_ se jemi muslimanë!

Gjynahu i këtij pretendimi është më i madh sesa gjynahu i kufrit të qartë. Ne kështu po dëshmojmë që islami është i dështur dhe bajat. As ata që nuk pretendojnë si ne se janë muslimanë nuk kanë guxuar të dëshmojnë për islamin kështu.

Allahu i lartë nuk pranon prej individit musliman dhe as prej shoqërisë islame që të marrin në jetën e tyre metoda prej burimeve të ndryshme. Nuk pranon që për jetën intime, për ritet fetare, për ibadetet, për moralin, për edukatën të marrin menhexh librin e Allahut; ndërsa për marrëdhëniet ekonomike, shoqërore, politike, ndërkombëtare të marrin për menhexh librin e tjetërkujt dhe filozofinë njerëzore. Atëhere nuk mbetet as iman dhe as islam! Nuk ka as iman dhe as islam! Sepse ata që veprojnë kështu akoma nuk kanë hyrë në iman dhe nuk i kanë pranuar bazat e islamit, duke filluar nga e para e saj fjala “La ilahe il-lallah”, prej të cilës rrjedh se gjykuesi i vetëm është vetëm Allahu ﷻ dhe ligjvënësi i vetëm është vetëm Allahu ﷻ.

Islami është menhexh i gjithë jetës. Kush e pason atë ai është besimtar në fenë e Allahut. E kush pason ndonjë menhexh tjetër qoftë edhe në një dispozitë të vetme¹ ai e ka refuzuar imanin dhe i ka tejkalluar caqet në uluhijen e Allahut ﷻ dhe ka dalë prej fesë së Allahut ﷻ sado që të hiqet me respekt për akiden islame dhe të hiqet si musliman. Pasimi i sheriatit të dikujt tjetër përveç sheriatit të Allahut ﷻ e hedh poshtë pretendimin e tij dhe e çon në daljen prej fesë së Allahut ﷻ.

Çudia më e madhe është me disa njerëz që pretendojnë islamin, por e marrin menhexhin e jetës së tyre prej filanit dhe fistekut të cilët Allahu ﷻ i ka cilësuar të verbër. Pastaj këmbëngulin se janë muslimanë! Allahu ﷻ thotë: **﴿a mos është njësoj ai që e di se ajo që të ka zbritur ty prej zotit tënd është e vërtetë me atë që është i verbër﴾** Er rad, 19.

Muslimanit që pretendon se beson Allahun ﷻ dhe të dërguarin ﷺ dhe beson se ky Kuran është shpallur prej Allahut, nuk i takon të imitojë të verbrin në çështjet e jetës së tij. Sidomos në çështjet që lidhen me sitemin e jetës njerëzore dhe me normat dhe vlerat ku bazohet jeta. Nuk i takon muslimanit që e njuh udhëzimin e Allahut dhe e njuh të vërtetën me të cilën është dërguar i dërguari i Allahut ﷻ të ulet në bankë si nxënës përpara njeriut që nuk

¹ Nuk ka dallim mes të paktës dhe të shumtës për gjërat që e kundërshtojnë imanin. Ai që e shan Allahun ﷻ një herë është qafir njësoj si ai që e shan Allahun ﷻ dhjetë herë. Ai që refuzon një ligj prej ligjeve të Allahut ﷻ është njësoj si ai që i refuzon të gjitha ligjet e Allahut ﷻ. Kjo përsa i përket çështjes së kufrit dhe daljes prej islamit sepse kufri i atij që e përsërit kufirin shpeshherë është më i madh dhe më i rëndë dhe përfundimi i tij është më i keq.

Ibn Tejmije në librin e tij “Sarimul meslul” fq. 87, thotë: “Nuk ka dallim në fjalët që e rrëzojnë imanin nëse thuhet një herë apo shumë herë edhe nëse nuk shprehet me gojën e tij që u bëra qafir. P.sh. ai që bën kufër me një ajet të vetëm ose me një farz të vetëm ose shan profetin ﷺ një herë të vetme, është njësoj si ta ketë përgënjeshtuar profetin ﷺ (për çdo gjë). Gjithashtu edhe fjalët që abrogojnë betimet nëse janë të qartë, p.sh. kur thotë: E kam prishur marrëveshjen që kishim mes nesh, kam dalë jashtë protektoriatit tënd, marrëveshja e tij prishet edhe nëse nuk e përsërit këtë fjalë disa herë. E njëjta gjë thuhet edhe për sharjen dhe fyerjen e fesë dhe për vepra të ngjashme të cilat nuk kanë nevojë të përsëriten”.

e ka pranuar këtë udhëzim dhe nuk e ka njohur këtë të vërtetë.

Veçoria më specifike e uluhijes _nëse bëjmë krahasim me njeriun_ është robërimi i njeriut dhe ligjërimi i ligjeve që lidhen me jetën e tyre dhe vendosja e rregullave. Kush pretendon për veten e tij diçka të tillë ai ka pretenduar cilësinë më të rëndësishme të uluhijes dhe e ka bërë veten e tij ilah me Allahun.

*Kur robi pretendon se njerëzit duhet t'i binden atij në vetveten e tij¹, se atij i takon e drejta e ligjëvënies në vetveten e tij, se atij i takon e drejta e caktimit të rregullave dhe normave në vetveten e tij, atëhere ai ka pretenduar se është ilah edhe nëse nuk thotë ashtu siç tha faraoni: **«Unë jam zoti juaj më i lartë»**. Aprovimi i tij ai është shirku dhe kufri në Allah. Ai është forma më e keqe e çrregullimit në tokë.*

Çdo njeri që pretendon se zotëron pushtetin e ligjëvënies në vetveten e tij ai ka pretenduar se është ilah në cilësi dhe vepra, e shpreh këtë me gojë apo nuk e shpreh. Kushdo që e mbështet këtë njeri në këtë “të drejtë” ai e ka mbështetur atë në të drejtën e uluhijes, e quan atë me emrin e saj apo nuk e quan.

Ose pushtetarët do të zbatojnë sheriatin e Allahut ﷻ tërësisht që të konsiderohen brenda rrethit të imanit ose do të zbatojnë një ligj tjetër për të cilin Allahu ﷻ nuk ka zbritur asnjë argument dhe këta janë qafirët, zullumqarët dhe të pabindurit.

Njerëzit, ose do të pranojnë prej pushtetarëve dhe gjykatësve ligjin e Allahut ﷻ dhe gjykimin e tij për çështjet e tyre që të jenë besimtarë, ose në të kundërt nuk mund të jenë besimtarë. Nuk ka diçka të mesme me këtyre dy rrugëve. Këtu nuk pranohen arsyetime, justifikime dhe pretendime që lidhen me interesat.

Asnjë robi të Allahut nuk i lejohet të thotë: Unë e refuzoj sheriatin e Allahut ﷻ. Unë jam më largpamës për interesat e krijesave sesa Allahu ﷻ. Nëse shprehet kështu _me gojën e tij apo me veprat e tija_ ai ka dalë prej rrethit të imanit. Nuk mund të bashkohet imani me mosmarrjen për gjykim sheriatin e Allahut ﷻ apo përbuzjen e gjykitimit me këtë shariat.

¹ Kuptimi i fjalës “për vetveten e tij” është se ai e meriton t'i binden njerëzit për shkak se është “filani”, pa i kushtuar rëndësi se ajo që ai thotë është e drejtë apo e kotë. Atij duhet t'i bindemi dhe ta pasojmë në çdo gjë qoftë ajo e drejtë apo e kotë. Kush pretendon diçka të tillë ai ka pretenduar për veten e tij uluhijen dhe rububijen përveç Allahut ﷻ. Kush e mbështet këtë person në këtë pretendim dhe e pason ai e ka bërë atë rival me Allahun ﷻ dhe ka rënë në shirk sepse Allahu ﷻ thotë: **«Disa prej njerëzve marrin përveç Allahut rivalë të tjerë dhe i duan ata ashtu siç e duan Allahun. Mirëpo ata që kanë besuar e duan më shumë Allahun»** El bekare 165.

Ibn Tejmije në “Mexhmu’ul fetaua” 10/607 thotë: “Nuk lejohet që të duhet ndonjë prej krijesave për shkak të vetes së tij përveç Allahut ﷻ. Çdo gjë që duhet në botë duhet të duhet për shkak të diçkaje tjetër jo për vetë veten e tij. Vetëm zoti duhet të duhet për vetë veten e tij. Ky është kuptimi i fjalës së Allahut: **«Nëse do të kishte në to ilahe (të adhuruar me të drejtë) përveç Allahut kishin për t'u shkatërruar»**. Dashuria e diçkaje për vetë veten e tij është shirk. Nuk duhet për veten e tij askush tjetër përveç Allahut ﷻ sepse kjo është prej veçorive të uluhijes së tij. Këtë lloj dashuri nuk e meriton askush tjetër përveç Allahut ﷻ dhe çdo gjë tjetër që nuk duhet për hir të Allahut ﷻ dashuria e tij është e kotë”.

Ata që pretendojnë se janë besimtarë e në anën tjetër nuk gjykojnë me sheriatin e Allahut në jetën e tyre dhe nuk kënaqen me zbatimin e ligjeve të sheriatit, ata vetëm pretendojnë, pretendojnë me rrena. Ata duhen ballafaquar me këtë fjalë të prere **﴿Ata nuk janë besimtarë﴾**¹.

Kush dëshiron të thotë se sheriatin nuk i përshtatet njerëzimit në një epokë të caktuar le të thotë, mirëpo pas kësaj më mirë ta shprehë qartë se ai është qafir *_Allahu na ruajt_ dhe nuk beson në këtë fe dhe e përgënjeshton fjalën e zotit të botrave.*

Këtë çështje e sqaron Allahu ﷻ në fjalën e tij: **﴿O i dërguar! Mos u dëshpëro për ata që nxitojnë në kufër prej atyre që thanë: besuam me gojët e tyre por zemrat e tyre nuk kanë besuar﴾** El maide 41.

Kështu sqarohet kjo çështje: Një ilah i vetëm, një sundues i vetëm, atëhere duhet edhe të themi: Një gjykues i vetëm, një ligjvënës i vetëm, një përgjegjës i vetëm, një sheriat i vetëm, një menhexh i vetëm, një ligj i vetëm. Bindja, pasimi dhe gjykimi me atë që ka zbritur Allahu ﷻ ky është imani dhe islami, ndërsa mosbindja dhe gjykimi me atë që nuk e ka zbritur Allahu ﷻ ky është kufri, dhulmi dhe fisku.

Çfarë prisni të thotë ai që e hedh poshtë sheriatin në jetën së tij dhe e zëvendëson me ligjin e injorancës dhe e vendos epshin e tij apo epshin ndonjë populli prej popujve, apo epshin e një epoke njerëzore më lart se gjykimi dhe sheriatin e Allahut?

Çfarë prisni të thotë ai, sidomos kur pretendon se është musliman? Situata! Realiteti i paqartë! Njerzit nuk e duan! Nga frika e armiqve! A nuk i ka ditur Allahu ﷻ të gjitha këto atëhere kur i urdhëroi muslimanët të zbatonin sheriatin e tij dhe të ecnin në rrugën e tij dhe të mos bien në fitne për atë që Allahu ka zbritur?

Sheriatin nuk i përmbush të gjithë nevojat e kohës! Realiteti që transformohet dita ditës! Nuk ka stabilitet! A nuk i ka ditur Allahu të gjitha këto atëhere kur urdhëroi me rreptësi dhe tërhoqi vërejtjen me ashpërsi?

Një jomusliman mund të thotë çfarë të dojë, mirëpo muslimani apo ata që pretendojnë islamin nuk mund të thonë të tilla fjalë nëse duan të mbeten në islam. Këtu ndahen rrugët. Këtu nuk pi ujë zgjedhja dhe debati ... ose islam ose xhahilijet, ose iman ose kufër, ose ligj të Allahut ose ligj të xhahilijetit.

Pra nuk mjafton që njerëzit të vendosin për veten e tyre një ligj që i ngjason sheriatit të Allahut ﷻ. Madje nuk mjafton të zbatojnë sheriatin e Allahut ﷻ pike e presje por duke ia atriubuar atë veteve të tyre apo duke ua përshtatur veteve të tyre derisa t'ia atriubojnë atë Allahut ﷻ dhe ta zbatojnë atë në emër të Allahut ﷻ me nënshtim ndaj sundimit të tij, me

¹ Surja El Maide 43. Ajeti i plotë: **(E si kërkojnë të të bëjnë ty gjykues kur ata kanë teuratin në të cilin gjendet ligji i Allahut, por pastaj i kthejnë shpinën dhe ata nuk janë besimtarë).**

pranim të uluhijes së tij, me njësim në uluhijen e tij, me njësimin i cili e zhvesh robin prej të drejtës së pushtetit dhe gjykimit, por vetëm zbatim të sheriatit të Allahut ﷻ dhe pohim të sundimit të tij në tokë.¹

*Nënshttrimi ndaj sheriatit të Allahut ﷻ nënkupton mosnjohjen e askujt tjetër përveç Allahut ﷻ në të drejtën e uluhijes, rububijes, rregullimit dhe sundimit. Këtu nuk bëhet dallim mes mosnjohjes me fjalë apo me vepra² sepse kjo është çështje e kufrit dhe imanit, e xhahilijetit dhe islamit. Rreth kësaj sillen ajetet e Allahut **(e kush nuk gjykon me atë që ka zbritur Allahu mu ata janë qafirët ... të padrejtët ... të pabindurit)**.*

Në çdo skaj të botës, në çdo epokë, në çdo kohë ekzistojnë dy baza ku bazohet sistemi i jetës, dy rregulla për përfytyrimin e jetës; njëra bazë është njësimi i Allahut në uluhije, rububije, rregullim dhe sundim. Mbi këtë bazë ngrihet sistemi i jetës ku njeriu zhvishet prej çdo lloj uluhije dhe rububije, prej çdo lloj mbizotrimi dhe sundimi. Sistemi i jetës ku njeriu e pranon Allahun ﷻ një dhe të vetëm. Vetëm prej tij e marrin akiden, etikën morale dhe shoqërore, mënyrën e jetesës, ligjet dhe sheriatin të cilat i zbatojnë në këtë botë dhe nuk i mëson këto gjëra prej askujt tjetër përveç tij. Pra sistemi ku dëshmohet se ilahu dhe i adhuruari me të drejtë është vetëm Allahu ﷻ.

Ndërsa baza tjetër e mohon uluhijen, rububijen, mbizotrimin dhe sundimin e Allahut ose totalisht duke mohuar ekzistencën e tij ose në çështjet e kësaj bote, në jetën e njerëzve, në ligjet dhe sheriatin e tyre. Kjo bazë pretendon se njeriut, qoftë ai individ, shoqëri, institucion, shtresë; i jepet e drejta për të ushtruar në jetën e njerëzve kompetenca që i takojnë vetëm Allahut në uluhijen, rububijen, mbizotrimin dhe sundimin e tij. Njerëzit që e ngrejnë jetën e tyre mbi këtë bazë nuk dëshmojnë që vetëm Allahu është ilah i adhuruar me të drejtë.³

Këto dy baza nuk mund të bashkohen sëbashku; sepse njëra është xhahilijet dhe tjetra islam. Pa u zgjatur shumë në format e ndryshme, në situatat e lloj-llojshme dhe në emërtimet e shumta me të cilat njerëzit e emërtojnë xhahilijetin e tyre si: pushtet monark, pushtet popullor, komunizëm, kapitalizëm, demokraci, diktaturë, otokrati, teokrati!! Këto emërtime

¹ Siç veprojnë demokratët në sistemet e tyre demokratike, të cilët çdo gjë ia atribojnë popullit siç pretendojnë. Atë që populli e vendos dhe e zgjedh ajo vihet në veprim dhe zbatim. Ndërsa atë që populli e refuzon nuk veprohet dhe nuk zbatohet edhe nëse përputhet me sheriatin e Allahut për të çuar në vend dëshirën e përfaqësuesve të popullit. Ndonjëherë mund të ndodhë që të zgjdhin diçka që përputhet me sheriatin, mirëpo kjo përputhje nuk konsiderohet ligj i Allahut ﷻ dhe apo se ata po gjykojnë me disa ligje të Allahut ﷻ, sepse ata nuk e veprojnë këtë si nënshttrim dhe ibadet për Allahun por e veprojnë për hatër të dëshirës së shumicës dhe dëshirës së ligjëvënësve të tjerë përveç Allahut ﷻ.

² Sepse vepra ndonjëherë mund të jetë më e qartë për atë që njeriu e fsheh në brendësi sesa fjalët dhe deklaratat e gojës.

³ Edhe nëse e deklarojnë me fjalë mirëpo në anën tjetër kryejnë vepra dhe thonë fjalë që e kundërshtojnë dhe e hedhin poshtë këtë deklaratë. Ata janë njësoj si ai që e pranon diçka bashkë me të kundërtën e saj. Prandaj ata në realitet nuk dëshmojnë se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, edhe nëse me gojët e tyre pretendojnë të kundërtën.

dhe këto forma nuk kanë shumë rëndësi; sepse të gjitha kthehen te një bazë e vetme që është “adhurimi që njeriu kryen për njeriun” dhe mohimi i uluhijes, rububijes, mibizotrimin dhe sundimit të Allahut në jetën e njeriut. Ndryshimi i formave dhe emrave nuk ka shumë rëndësi sepse baza ku bazohen është njësoj.

Ajo që ka rëndësi për konsiderimin e sistemit islam është burimi nga vjen ky sistem. Nëse ai buron prej Allahut ai është sistem islam dhe islami është feja mbizotruese në atë kohë. E nëse buron prej tjetërkujt atëhere ai është sistem xhahil dhe xhahilijeti mbizotron në atë kohë. Këtu ndahen rrugët mes xhahilijetit dhe islamit, në çdo periudhë dhe në çdo sistem pa pasur nevojë të hyjmë në detaje dhe analiza për këtë sistem”.¹



¹ Cituar prej librit “Rruga e davetit në hijen e kuranit” vëll. 2, dhe libri “Baza të botëkuptimit islam”.

Rregulli i nëntë: Islamin e qartë e rrëzon vetëm kufri i qartë.

Njeriu bëhet musliman atëhere kur pranon me seriozitet dy dëshmitë e teuhidit jo në formë tallje, përçmimi apo stimulimi.¹ Asnjë punë tjetër nuk i zëvendëson dy dëshmitë e teuhidit (për hyrjen në islam), përveç namazit sepse ai i përfshin këto dy dëshmi; bazuar në fjalën e profetit ﷺ: **“Kush fal namazin tonë dhe drejtohet nga kibla jonë dhe ha prej kurbanit tonë ai është musliman. Atij i takon mbrojtja e Allahut dhe mbrojtja e profetit”**.²

Kurtubiu thotë: *“Imani arrihet vetëm me fjalën “La ilahe il-lallah” dhe me asnjë fjalë apo vepër tjetër përveç namazit. Ishak ibn Rahaveji ka thënë: Dijetarët janë pajtuar për diçka rreth namazit për të cilën nuk janë pajtuar në ibadetet e tjera. Të gjithë ata kanë thënë: Kush njihet si qafir dhe pastaj shikohet të falë namazin në kohën e tij dhe fal namaze të shumtë dhe nuk kanë dëgjuar prej tij ndonjë pohim me gojë dëshmohet për të imani. Mirëpo ata nuk kanë dëshmuar për agjërimin dhe zekatin njësoj”*.³

Nëse hyn në islam nuk lejohet të nxirret prej islamit vetëm në rast se kryen kufër të qartë i cili nuk mund të interpretohet ndryshe, për të cilin kemi dëshmi dhe argument prej Kuranit dhe sunetit.

Siguria nuk rrëzohet me dyshime, prandaj edhe islami i qartë nuk rrëzohet me një kufër i cili mund të shpjegohet dhe interpretohet me mënyra të ndryshme.

Më poshtë po paraqesim disa argumente për këtë rregull:

Argument për këtë rregull janë ajetet që na urdhërojnë për t’u siguruar dhe për t’u bindur plotësisht përpara se të bëjmë tekfir apo të vrasim ndokënd. Këto ajete ndalojnë prej hamëndjeve dhe dyshimeve në rastet kur kufri është i pasigurtë, siç thotë Allahu ﷻ: **﴿O besimtarë! Nëse dilni në rrugë të Allahut sigurohuni dhe mos i thoni atij që ju jep salam: Ti nuk je besimtar, për të lakmuar të mirat e dynjasë sepse te Allahu ka më shumë shpërblime. Kushtu keni qënë edhe ju më parë por Allahu ju udhëzoi prandaj sigurohuni sepse Allahu e di çdo gjë që veproni﴾** En nisa, 94.

Ibn Xheriri thotë për fjalën “sigurohuni”: *“Thotë: Tregoni durim para se të vrisni atë që keni dyshim dhe nuk jeni të sigurtë për imanin apo kufrin e tij; që të mos vrisni atë që nuk*

¹ E them këtë sepse në kohën tonë ka njerëz që e thonë dëshminë e teuhidit me tallje, shtirje dhe sa për debat. Kjo dëshmi nuk ka asnjë lloj vlere sepse ajo nuk thuhet me akide, iman dhe nënshtrim.

² E transmeton Buhariu. Më parë e sqaruar dallim mes asaj që e fut njeriun në islam dhe mes vazhdimësisë së ruajtjes së islamit gjatë jetës. Ai bëhet musliman me fjalën “La ilahe il-lallah” dhe e ruan islamin e tij gjatë jetës duke iu shmangur gjërave që e prishin teuhidin sepse nëse vepron diçka që e prish teuhidin ai ka vepruar dy gjëra kontradiktore dhe ka dalur prej islamit.

³ Xhamiul ahkam, 8/207.

e njihni. Mos e vrisni askënd derisa të bindeni plotësisht se ai është armik që lufton Allahun dhe të dërguarin e tij.

Përmendet se ky ajet ka zbritur për shkak të një personi që u vra prej çetës që e kishte dërguar profeti pasi tha: Unë jam musliman, ose pasi e shprehu shehadetin e vërtetë, ose pasi u dha selam¹, për shkak të një tufe bagëtish që e kishte në pronësi apo për çdo lloj prone tjetër dhe ata ia grabitën”.

Transmetuesit e kiraeteve të Kuranit e kanë lexuar këtë ajet me dy forma, njëra është “tebejjenu” me kuptim “sigurohuni” dhe e dyta është “tethebtu” me kuptim “prisni dhe mos u nxitoni”.

Ibn Xheriri thotë: “Mendimi ynë është se këto dy kiraete janë të njohura dhe të transmetuara prej kiraeteve të muslimanëve dhe kanë kuptim të njëjtë edhe nëse janë përdorur dy fjalë të ndryshme, sepse ai që pret dhe nuk nxiton pret që të sigurohet, dhe ai që sigurohet nuk është nxituar. Prandaj me cilindo kiraet të lexojë ai është i saktë”.²

Prej argumenteve është edhe fjala e Allahut: **﴿O besimtarë! Nëse ndonjë njeri i prishur ju sjell ndonjë lajm atëhere sigurohuni që të mos akuzoni askënd padije dhe pastaj të pendoheni prej asaj që vepruat﴾** El huxhurat, 6

Ibn Kajimi thotë: “Ky ajet ka zbritur për Velid ibn Ukbe ibn Ebi Muitin ؓ atëhere kur i dërguari i Allahut ؑ e dërgoi te fisi Mustalak për të mbledhur sadakatë. Mes tyre ka pasur armiqësi në xhahilijet. Kur njerëzit morrën vesh për ardhjen e tij e pritën me respekte për shkak të profetit ؑ. Mirëpo shejtani e mashtroi dhe kujtoi se ata duan ta vrasin, prandaj u frikësua dhe u morri rrugën për t’u kthyer te i dërguari i Allahut ؑ. Kur arriti i tha: Fisi i Musatalakut refuzuan t’i jepnin sadakatë dhe u përpoqën që të më vrisnin. Atëhere i dërguari i Allahut ؑ u zemërua dhe u bë gati për luftë. Mirëpo kur njerëzit (nga fisi Mustalak) e morrën vesh se ai u kthye, vajtën te profeti ؑ dhe i thanë: O i dërguar i Allahut! Dëgjuam se po vinte emisari yt dhe dolëm që ta prisnim me respekte dhe t’i jepnim atë që e kemi detyrë për ta dhënë. Mirëpo e pamë që ai nuk erdhi dhe u friksuam se mos u kthye prej ndonjë letre që ti i dërgove për shkak se u zemërove prej nesh. Ne i kërkojmë mbrojtje Allahut prej zemërimit të tij dhe zemërimit të profetit të tij.

Profeti ؑ nuk u zuri besë dhe në fshehtësi dërgoi Halid ibn Velidin ؓ me disa ushtarë dhe e urdhëroi që të mos diktohej dhe i tha: Vështroi ata! Nëse shikon shenja që dëshmojnë për imanin e tyre atëhere merre zekatin e pasurisë së tyre. Por nëse nuk shikon shenja të tilla atëhere sillu me ta njësoj si me qafirët.

Halidi ؓ i zbatoi direktivat dhe kur arriti te ata dëgjoi ezanin e namazit të akshamit dhe të jacisë. Pastaj morri zekatin e tyre dhe prej tyre pa vetëm bindje dhe mirësi. Më pas u

¹ Këto fjalë imam Taberiu i ka transmetuar me senede të plota në tefsirin e tij.

² Tefsiri i Taberiu, 4/227, shtëpia botuese “El kutubul ilmije”.

kthye te i dërguari i Allahut ﷻ dhe i tregoi. Atëhere Allahu ﷻ zbriti: «O besimtarë! Nëse ndonjë njeri i prishur ju sjell ndonjë lajm atëhere sigurohuni» Sigurimi nënkupton njohjen e realitetit të tij dhe sigurimit prej lajmit të tij”.¹

Ibn Xherir Taberiu rreth fjalës së Allahut **«që të mos akuzoni askënd padije»** thotë: *“Sigurohuni që të mos akuzoni njerëz të pafajshëm për shpifjet që ju janë bërë dhe ju nuk i dini”*.²

Gjynahu me i padrejtë është shpifja dhe akuzimi i njerëzve të pafajshëm me kufër dhe ridde padije dhe pa u siguruar; sepse kjo gjë sjell pasoja të rënda dhe të padëshiruara.

Në hadithin e Ubade ibn Samitit ﷺ thuhet: **“I dërguari i Allahut na thirri dhe ne i dhamë besën. Prej gjërave që i dhamë besën ishte edhe dëgjimi dhe bindja në çdo gjë që e pëlqejmë apo e urrejmë, në rehati apo në vështirësi dhe të mos ua rrëmbejmë pushtetin atyre që u takon derisa të shohim kufër të qartë për të cilin kemi argument prej Allahut”**.³

Kufri i qartë është kufri i dukshëm që nuk kuptohet dhe interpretohet ndryshe dhe për të cilin kemi argumenta të qartë prej librit të Allahut ﷻ dhe sunetit të profetit ﷺ.

Kuptimi i anasjelltë i hadithit është se nëse sunduesi musliman bie në ndonjë kufër që është i dyshimtë dhe jo i qartë i cili mund të kuptohet në ndonjë formë tjetër që nuk është kufër, atëhere ai nuk shpallet qafir dhe nuk luftohet me armë, sepse luftimi me armë nënkupton shpalljen e tij qafir dhe dëshmon se ai ka rënë në kufër të qartë. Në anën tjetër luftimi me armë është rrjedhojë e shpalljes së tij qafir, nëse krijohen mundësitë. Pra të dyja janë rrjedhojë dhe pasojë e njëra-tjetrës.⁴

¹ Et tefsirul kajjim, fq. 440.

² Tefsiri i Taberiu, 11/385.

³ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

⁴ Ky është medhhebi ynë në këtë çështje bazuar në argumentet e Kuranit dhe të sunetit. Prej tyre është hadithi i Ubade ibn Samit ﷺ në dy sahihët i cili u përmend mësipër. Gjithashtu edhe hadithi i saktë: **“Pas meje keni për të parë padrejtësi dhe gjëra që do t’i urreni. I thanë: Me çfarë na urdhëron o i dërguar i Allahut? U tha: Jepuni atyre hakun e tyre dhe kërkoni prej Allahut hakun tuaj”**.

Dhe thotë: **“Kush urren diçka prej emirit të tij le të bëjë durim, sepse ai që largohet prej pushtetit një pëllëmbë vdes me vdekje xhahilijeti”**. Dhe thotë: **“Kush shikon prej emirit diçka që e urren le të bëjë durim sepse kush i ndahet xhematit një pëllëmbë vdes me vdekje xhahilijeti”**.

Në hadithin e Hudhejfe ibn Jemanit ﷺ thuhet: **“Nëse shikon ndonjë halife atëhere qëndro me atë edhe nëse të goditet shpina”**. Në transmetimin e Muslimit thuhet: **“Dëgjo dhe bindiu emirit edhe nëse pi dhe ta merr pasurinë ti prap dëgjo dhe bindu”**. Dhe thotë: **“E ke detyrë të dëgjosh dhe të bindesh në vështirësi dhe rehati, në atë që të pëlqen dhe atë që e urren edhe nëse të bëjnë padrejtësi”**. Në një transmetim tjetër thuhet: **“Dëgjo dhe bindu në vështirësi dhe rehati, në atë që të pëlqen dhe atë që e urren, edhe nëse të bëjnë padrejtësi dhe ta hanë pasurinë dhe të godasin kurrizin”**. E shumë e shumë hadithe të tjera të sakta që urdhërojnë për mos ngritjen krye kudër pushtetarëve të padrejtë përderisa padrejtësia e tyre nuk arrin kufirin e kufirit të qartë.

Në anën tjetër kryengritja ndaj pushtetarëve të padrejtë dhe të prishur _të cilët nuk arrijnë në gradën e kufirit_ çon në dëme më të mëdha sesa pranimi i tyre si pushtetarë duke u mjaftuar me këshillimin e tyre dhe urdhërimi i tyre për mirë dhe ndalimi i tyre prej së keqes me urtësi dhe predikim të bukur.

Hatabiu thotë: “Kuptimi i fjalës “i qartë” është kufri i dukshëm dhe i kuptueshëm. Kjo rrjedh nga folja arabe “baaha jebuuhu” që nënkupton diçka të qartë dhe të përhapur”.

Ibn Haxheri për fjalën “për të cilin keni argument prej Allahut” thotë: “Argument të qartë prej ajeteve dhe haditheve të cilat nuk mund të interpretohen ndryshe. Kuptimi i anasjelltë i tij është se nuk lejohet kryengritja kundër tyre nëse argumenti mund të interpretohet ndryshe”.¹

Them: Ky hadith nënkupton se nuk lejohet edhe tekfiri i tyre nëse kufri i tyre është i dyshimtë dhe mund të interpretohet ndryshe.

Në sahihun e Muslimit prej hadithit të Ummu Selemesë thotë: I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Do të vinë disa sundues të cilët keni për t’i njohur dhe keni për t’i urryer. Kush i dallon ata ai është i pafajshëm. Kush i kritikon ai është i shpëtuar. Por kush pajtohet dhe i ndjek ata. I thanë: A t’i luftojmë? U tha: Jo! Për aq kohë sa falen”.

Në një transmetim tjetër thuhet: “Të parët tuaj më të këqinj janë ata që i urreni dhe ju urrejnë, i mallkoni dhe ju mallkojnë. Thanë: I thamë: O i dërguar i Allahut! Atëhere le t’i luftojmë? U tha: Jo! Për aq kohë sa e falin namazin mes jush. Për aq kohë sa e falin namazin mes jush”.

Përderisa ata falen dhe e urdhërojnë popullin të falet atëhere mos i shpallni qafirë dhe

Ibn Haxheri në “El fet’h” (7/13) thotë: “Ibn Batali ka thënë: Ky hadith është argument për moskryengritjen ndaj sunduesit edhe nëse është i padrejtë. Fukahatë janë pajtuar me ixhma se bindja ndaj sundimtarit që sundon me forcë dhe xihadi me të është vaxhip, dhe se bindja e tij është më e mirë se kryengritja sepse kjo çon në derdhjen e gjakut dhe **teskin ed duhama**. Ata nuk kanë përjashtuar asnjë përveç në rastin kur sundimtari bie në kufër të qartë atëhere nuk lejohet t’i bindemi por është vaxhip luftimi i tij për atë që ka mundësi”.

Po në “El fet’h” (13/61) thotë rreth hadithit të Ibn Umerit atëhere kur i kritikoi banorët e Medinës kur dolën kundër Jezid ibn Muavijes pasi i kishin dhënë besën: “në këtë hadith përmendet obligimi i bindjes së imanit të cilit i është dhënë besa (Bej’ah) dhe ndalimi prej ngritjes kundër tij edhe nëse është i padrejtë në pushtetin e tij dhe se ai nuk shkarkohet nga detyra për shkak të fiskut të tij”.

Neveviu në shpjegimin e sahihut të Muslimit (12/229) thotë: “Kryengritja kundër tyre dhe luftimi i tyre është haram me ixhmanë e të gjithë muslimanëve edhe nëse ata janë fasikë (të pabindur) dhe zullumqarë. Hadithet që dëshmojnë për këtë gjë janë të shumtë. Ehlisuneti ka rënë në ixhma se sultani nuk shkarkohet prej detyrës për shkak të fiskut.

Dijetarët kanë thënë: Shkaku i mosshkarkimit të tij dhe i ndalimit të kryengritjes janë fitnet dhe derdhja e gjakut dhe prishja e lidhjeve mes njerëzve. Dëmi i prishjes së lidhjeve dhe i shkarkimit të tij është më i madh se dëmi i qëndrimit të tij”.

Them: Durimi me të cilin imam Ahmedi përballoi sprovat dhe kamzhiqet e sundimtarëve në fitnen e “krijimit të Kuranit” është prej këtij lloji.

Këtu i tërheqim vrejten lexuesit se kjo fjalë e mësipërme e dijetarëve nuk vlen për sundimtarin qafir i cili ka bërë kufër të qartë, sepse argumentet dëshmojnë për këtë dhe nga ana tjetër durimi në kufër është provë më e madhe sesa kryengritja ndaj tij _nëse kihet mundësi_ sado të mëdha të jenë sakrificat. Allahu ﷻ thotë: **﴿Fitneja është më e rëndë se vrasja﴾** dhe thotë: **﴿luftojni ata derisa të mos ketë fitne dhe feja të jetë vetëm e Allahut﴾**. Asnjë fitne nuk e është më e madhe dhe më e dëmshme për vëndin dhe njerëzit sesa fitnia e kufirit. Nuk është vendi të zgjatemi më shumë në këtë çështje sepse për këtë çështje kemi shkruar një kërkim të veçantë.

¹ Fethul bari, 8/13.

mos i luftoni çfarëdo që të punojnë _nëse nuk është kufër i qartë_ edhe nëse mund të duket si kufër por që mund të interpretohet ndryshe. Kjo sepse ekziston një dëshmi e qartë si falja e namazit, që na shtyn në mendimin mirë për këtë person atëhere kur vihemi në dyshime dhe ndodhin gabime.

Ky hadith është argument se ai që e braktis namazin dhe nuk urdhëron me të shkarkohet nga detyra, qoftë edhe me shpatë, dhe ai është qafir me kufër të qartë, sepse kryengritja bëhet obligim vetëm kundër atij që bie në kufër të qartë siç u përmend më parë në hadithin e Ubade ibn Samit ؓ.

Kadiu Ijad ka thënë: *“Dijetarët kanë rënë në ixhma se imameti nuk i ngakohet qafirit dhe nëse sundimtari bie në kufër të qartë shkarkohet ... Po kështu edhe ai që e braktis namazin dhe urdhërimin me namaz”*.¹

Prej argumenteve që dëshmojnë për vërtetësinë e këtij rregulli është edhe hadithi që e transmeton Muslimi në sahihun e tij prej Usama ibn Zejdit ؓ thotë: ***I dërguari i Allahut ؑ na dërgoi në një çetë dhe sabahu na kapi te fisi i Xhuhejnës dhe kapa një burrë i cili tha: La ilahe il-lallah. Mirëpo unë e godita. Pastaj rashë në dyshime dhe i tregova profetit ؑ dhe më tha: Ai tha “La ilahe il-llah” ndërsa ti e vrave?! I thashë: O i dërguar i Allahut! Ai e tha prej frikës së armës! I tha: A mos ja çave zemrën që të bindeshe se e tha apo jo? Pastaj vazhdoi ta përsëriste aq dëshirova të isha bërë musliman vetëm në këtë çast.***

Profeti e qortoi Usamën ؑ ashpërsisht sepse vrau një person me dyshime dhe pa u siguruar atëhere kur islami i tij ishte vërtetuar. Pra ai e refuzoi islamin e qartë bazuar në dyshime. Islamin e qartë nuk e hedh poshtë kufri i dyshimtë sepse hamëndjet nuk vlejnjë para së vërtetës. Allahu thotë: **﴿Hamëndja nuk vlen asgjë përpara të vërtetës﴾** En nexhm, 28.

I tillë është edhe hadithi i Mikdad ibn Esuedit ؓ kur i tha profetit ؑ: O i dërguar i Allahut! Nëse përballem me një person qafir dhe ai më lufton dhe më pret një rën dorë me shpatë pastaj fshihet pas një peme dhe thotë: I jam dorëzuar Allahut, a ta vras o i dërguar i Allahut pas kësaj fjale? I tha: Mos e vrit. I thashë: O i dërguar i Allahut! Po ai më ka prerë një rën dorë dhe këtë fjalë e thotë pasi të ma presë dorën, prandaj pse mos ta vras? I tha: ***“Mos e vrit sepse po ta vrasësh ai do të jetë në pozitën tënde para se ta vrisje dhe ti do të jesh në pozitën e tij para se ta thoshte këtë fjalë”***.²

Profeti ؑ e ndaloi prej vrasjes së tij edhe pse sahabiu u përpoq që t’i mbushte mëndjen profetit ؑ se ka shumë mundësi që ai ta thotë këtë fjalë për t’u ruajtur prej shpatës dhe se

¹ Shpjegimi i sahihut të Muslimit, 12/229.

² E transemtion Buhariu dhe Muslimi. Fjala e tij: ***“ai do të jetë në pozitën tënde para se ta vrisje”*** pra do ta ketë të ruajtur jetën dhe të drejtat e tjera për shkak të islamit ashtu siç e kishe edhe ti jetën dhe të drejtat e ruajtura për shkak të islamit përpara se ta vrisje ***“ti do të ishe në pozitën e tij para se ta thoshte këtë fjalë”*** pra gjaku yt do të ishte i lejuar ashtu siç ishte gjaku i tij i lejuar përpara se ta thoshte këtë fjalë sepse ti ke vrarë një musliman duke e ditur dhe padrejtësisht.

shkak për vrasjen e tij është se ai i ka prerë dorën. Mirëpo profeti e ndaloj duke i shpjeguar se gjykimi nuk bazohet në hamëndje dhe dyshime, çfarëdo qoftë ai shkak dhe se islami i qartë rrëzohet vetëm me kufër të qartë.

Ibn Batali ka thënë: *“Islami i të cilit vërtetohet me siguri nuk del prej tij përveçse me siguri”*.¹

Prej argumenteve që dëshmojnë për vërtetësinë e këtij rregulli është edhe qëndrimi që profeti ﷺ mbajti me harixhiun i cili i tha: ***Friksoju Allahut o Muhamed! Atëhere profeti i tha: Kush do i bindet Allahut nëse e kundërshtoj unë?!***

Halid ibn Velidi ؓ i tha: O i dërguar i Allahut! A t'ia pres kokën? I tha: Jo! Mbase ai falet. Halidi i tha: E sa veta që falen, flasin me gojë atë që nuk e besojnë me zemër. I dërguari i Allahut ﷺ i tha: Nuk jam urdhëruar të gërmoj zemrat e njerëzve dhe as t'i hap gjokset e tyre”.²

Gjithashtu edhe hadithi i konfliktit që ndodhi mes Zubejrit ؓ dhe një ensariu për vaditjen e arës dhe profeti ﷺ i tha: ***“Vadit o Zubejr dhe pastaj lëshoje edhe për komshiun tënd”***. Atëhere ensariu u zemërua dhe i tha: ***O i dërguar i Allahut! A meqë ishte çuni i hallës tënde?!*** Atëhere fytyra e profetit ndërroi ngjyrë.

Pra a gjykove për Zubejrin dhe anove nga ai sepse ai është çuni i hallës tënde. Kjo fjalë është shumë e rrezikshme dhe ngjitet deri në gradën e kufirit. Mirëpo në rastin e ensariut konsiderohet si kufër i paqartë i cili nuk e rrëzon islamin e tij të qartë. Prandaj profeti ﷺ nuk ja morri për bazë dhe nuk transmetohet se ai i kërkoi atij që të pendohej prej kufirit dhe riddes.

Gjithashtu edhe qëndrimi i profetit ﷺ me Ibn Ubejin dhe munafikët që ishin me të. Shpeshherë vepronin gjëra që dëshmonin për nifakun dhe kufrin e tyre mirëpo ato nuk ngjiteshin në gradën e kufirit të qartë prandaj dhe nuk ua merrte për bazë dhe ua pranonte justifikimet.

Në një hadith daif thuhet: ***“Shmangini ndëshkimet e haddit për shkak të dyshimeve sa të keni mundësi. Nëse gjeni ndonjë justifikim për të lejoni të lirë”***. Hadithi është i dobët mirëpo kuptimin e ka të drejtë. Për këtë kuptim dëshmojnë rregullat e fesë dhe argumente të tjerë.

Prej ndëshkimeve që duhet të largohen me dyshime është edhe ndëshkimi i riddes dhe gjykimi i të tjerëve me kufër dhe ridde. Sikur të mblidhnim të gjitha argumentet do të na duhej të sillnim me dhjetra argumente që dëshmojnë për vërtetësinë e këtij rregulli.

Kështu kuptohet edhe qëndrimi i Halid ibn Velidit ؓ me Mexha'an kur e fali sepse kufri i tij nuk ishte shumë i qartë por ishte i dyshimtë dhe mund të kuptohej në disa forma dhe

¹ Fethul bari i Ibn Haxherit, 12/314.

² E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

nuk mund ta rrëzojnë islamin e qartë të Mexha'as. Historia e tij u përmend e plotë mëpërpara.

Kushtu kuptohet edhe qëndrimi i Aliut ﷺ me havarixhët të cilëve nuk u bëri tekfir megjithëse ata i shpallën Aliun ﷺ me sahabët qafirë.

Këtu hyn edhe qëndrimi i selefit me bidatçitë dhe mosbërja qafir e shumë personave konkretë megjithëse ata kishin rënë në kufër. Mbledhja e të gjitha dëshmimeve rreth kësaj pike do e zgjaste shumë librin dhe do e nxjerrte prej objektivit të tij.

Bazuar në këtë që thamë disa dijetarë kanë thënë: Është obligim të ndalemi në çështjen e tekfirit nëse ka luhatje dhe dyshime dhe nëse ka 99 mundësi që të jetë kufër dhe një mundësi të vetëme që të mos jetë kufër atëhere më e mira është që të ndalemi dhe të mos bëjmë tekfir dhe Allahu është më i ditur.

Çështje: Gabimi në bërjen qafir të një muslimani është më i rëndë se gabimi në konsiderimin e një qafiri për musliman.

Prej gjërave që na shtyjnë për maturi në gjykimin e një personi konkret si qafir atëhere kur ka luhatje dhe dyshime dhe nuk jemi plotësisht të sigurtë është edhe fakti se gabimi në shpalljen e një muslimani si qafir është më i rëndë se gabimi në shpalljen e një qafiri si musliman, bazuar në pikat e mëposhtëme:

- Bërja e muslimanit qafir gabimisht nënkupton cënimin padrejtësisht të të gjithë të drejtave që islami ia ka garantuar muslimanit. Kjo nënkupton ndërprerjen e dashurisë dhe të mirëkuptimit mes muslimanëve. Prandaj tekfiri i muslimanit është njësoj si vrasja e tij, siç thuhet në hadith: *“Nëse njeriu i thotë vëllait të tij: O qafir! është njësoj si vrasja e tij. Edhe mallkimi i besimtarit është njësoj si vrasja e tij”*.¹ Ndërkohë që ky cënim nuk ndodh atëhere kur e konsiderojmë një qafir si musliman gabimisht por ndodh e kundërta sepse i garantohen të drejtat e islamit si ruajtja e jetës, pasurisë dhe nderit, miqësohet ashtu siç miqësohen të gjithë muslimanët, dhe i jepen të gjitha të drejtat e tjera.
- Bërja e muslimanit qafir gabimisht është gabim i shumfishtë. Së pari ai është gabim në të drejtën e Allahut ﷻ sepse gjykohet mbi një musliman me kufër në kundërshtim me gjykimin e Allahut ﷻ. Pra nuk ia ka qëllur gjykimin të Allahut ﷻ. Në anën tjetër ai është gabim në të drejtën e robit sepse me tekfirin e tij i cënohen të gjitha të drejtat që ia ka dhënë islami. Pra gabimi këtu është i dyfishtë; gabim në të drejtën e Allahut ﷻ dhe gabim në të drejtën e robit. Ndërsa konsiderimi i një qafiri musliman gabimisht është vetëm gabim në të drejtën e Allahut ﷻ sepse nuk ia ka qëlluar gjykimin të

¹ E trasmeton Ahmedi dhe Buhariu, Sahihul xhami, 710.

Allahut ﷻ.¹

Padyshim se gabimi në të drejtën e Allahut ﷻ dhe në të drejtën e robit është më i rëndë sesa gabimi që është vetëm në të drejtën e Allahut. Në hadith thuhet: **“Padrejtësia është tre llojesh: Një padrejtësi Allahu nuk e fal dhe një padrejtësi Allahu e fal dhe një padrejtësi nuk e lë pa ndëshkuar. Padrejtësia të cilën Allahu nuk e fal është shirku. Allahu thotë: (Shirku është padrejtësi e madhe). Ndërsa padrejtësia të cilën Allahu e fal është padrejtësia mes robërve dhe zotit të tyre. Ndërsa padrejtësia të cilin Allahu nuk e lë pa ndëshkuar është padrejtësia mes robërve derisa të gjykohet mes tyre”.**²

- Tekfiri i muslimanit gabimisht e çon personin në shkatërrim dhe mbase edhe në kufër pa e kuptuar, sidomos nëse tekfiri nuk bazohet në baza të sakta të shariatit dhe as në interpretime të pranuar. Është saktësuar se i dërguari i Allahut ﷻ ka thënë: **“Kushdo që i thotë vëllait të tij: O qafir, ajo i kthehet njërit prej tyre. Nëse është ashtu siç ka thënë mirë e në të kundërt i kthehet atij”.**³

Dhe thotë: **“Kush thotë për besimtarin atë që nuk e ka do të hidhet në sekrecionet e banorëve të zjarrit derisa të gjejë një argument për atë që ka thënë”.**⁴

Këto shkarje nuk ndodhin atëhere kur dikush e konsideron një qafir për musliman gabimisht, sidomos nëse gabimi ndodh si pasojë e ixhtihadit dhe interpretimit.

Gazaliu në librin “Dallimi mes imanit dhe zendekasë” thotë: **“Duhet bërë kujdes prej tekfirit sa të kemi mundësi. Lejimi i gjakut të namazlinjve që e pranojnë teuhidin është gabim dhe gabimi në dhënien jetë të njëmijë qafirëve është më i lehtë sesa gabimi i derdhjes së gjakut të një muslimani”.**⁵

- Rregullat dhe argumentet e shariatit anojnë më shumë nga falja nëse kihet mundësi. Gabimi në falje është më i lehtë se gabimi në ndëshkim siç thuhet në hadithin e Ebu Hurejrës ؓ: **Një person u vra në kohën e profetit dhe i treguan profetit dhe ia dërgoi (vrasësin) përgjegjësit të viktimës. Atëhere vrasësi i tha: O i dërguar i Allahut! Pasha Allahun nuk kisha për qëllim ta vrisja. Pastaj i dërguari i Allahut i tha përgjegjësit të viktimës: “Nëse ai është i singertë dhe ti pastaj e vret, ke për të hyrë në zjarr”. Pastaj e la të lirë.”**⁶

¹ Nëse ky gabim është si pasojë e ixhtihadit dhe interpretimit që merret për bazë atëhere personi nuk hyn te rregulli: “Kush nuk e shpall qafirin qafir ai ka bërë kufër”. Këtë çështje do e shpjegojmë më hollësisht në shpjegimin e këtij rregulli.

² Sahihul xhami’, 3961.

³ E transmeton Muslimi.

⁴ E transmeton Ahmedi, Ebu Daudi, Hakimi. Es silsiletus sahiha, 437.

⁵ Prej fetuhul barit i Ibn Haxherit, 12/314.

⁶ Sahih sunen Ebi Daud, 3775.

Prej Enes ibn Malik ؓ thotë: **“E kam parë profetin ﷺ të urdhëronte për falje sa herë që i ngrihej një çështje që kishte kisas”.**¹

Abdullah ibn Zubejri në komentimin e fjalës së Allahut **﴿zgjidh faljen﴾** thotë: **“I dërguari i Allahut ﷺ, prej moralit të njerëzve u urdhërua të zgjidhte faljen”.**²

Në një hadith daif thuhet: **“Nëse imami gabon në falje është më mirë se të gabojë në ndëshkim”.**³ Hadithi megjithëse është i dobët mirëpo kuptimin e ka të vërtetë sepse për këtë dëshmojnë bazat dhe rregullat e sheriatit.

Vërejtje:-

Nga rregulli “Islamin e qartë e rrëzon vetëm kufri i qartë” përfitojmë se nuk bëhet tekfir për shkak të gjynaheve të mëdha dhe mëkateve që janë më të vogla se kufri dhe shirku sepse Allahu ﷻ thotë: **﴿Allahu nuk e fal ti bëhet shirk dhe ia fal atë që është më e vogël se ai atij që dëshiron﴾** En Nisa: 48. Është saktësuar në hadith se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Më është dhënë shefati dhe ai do të përfshijë çdokënd që nuk i ka bërë shirk Allahut asgjë”.**⁴

Prej Ibn Umerit ؓ thotë: Për një kohë të gjatë vazhdonim të mos kërkonim falje për vepruesit e gjynaheve të mëdha derisa dëgjuam prej gojës së profetit ﷺ të thotë: **“Allahu nuk e fal t’i bëhet shirk por ia fal atë që është më e vogël kujt dëshiron. Unë e kam ruajtur shefatin tim në ditën e gjykimit për vepruesit e gjynaheve të mëdha”** Pastaj na u larguan shumë hamëndje në vetet tona”.⁵

Mosbërja qafir e vepruesve të gjynaheve të mëdha është një nga pikat kryesore që e dallojnë ehlsunetin prej havarixhëve ekstremë të cilët u bëjnë tekfir muslimanëve për shkak të gjynaheve të mëdha të cilat nuk arrijnë gradën e kufrit të madh.

Kjo çështje e trajtua në faqe të ndryshme të këtij libri prandaj nuk ka nevojë të përsëritet.

Prej këtij rregulli përfitojmë gjithashtu se nuk lejohet të hyjmë me hamendje në akiden dhe nderin e njerëzve padije dhe pa u siguruar. Sidomos nëse ata njerëz e meritojnë që të gjejmë për ta justifikime. Prandaj duhet të anojmë nga mendimi i mirë për ta, si p.sh. për ata që janë përpjekur në dije dhe kanë dhënë kontribute të mëdha për islamin dhe xihadin. Mbase një fjalë të vetme që e thotë njeriu me shkujdesje dhe pa e kujtuar për gjë të madhe mund ta hedhë në zjarr të xhehenemit dhe zemërimi i Allahut bie mbi të pa e kuptuar. Allahu

¹ Sahih sunen Ebi Daud, 3774.

² Sahih sunen Ebi Daud, 4004.

³ Daif sunen Et Tirmidhi, 237.

⁴ E transmeton Ibn Ebi Asim dhe shejh Albani e ka saktësuar në shqyrtimin e tij.

⁵ E transmeton Ibn Ebi Asim në “Kitabus sunneh”. Shejh Albani e ka konsideruar hasen.

ﷻ thotë: **«Kur thoshit me gojët tuaja atë që nuk e dinit dhe kujtonit se është e parëndësishme por për Allahun ishte shumë e madhe»** En nur 15.

Dhe thotë: **«Ata që i lëndojnë (fyejnë) besimtarët dhe besimtare për gjëra që nuk i kanë bërë ata kanë mbartur mbi vete shpifje dhe gjynah të qartë»** El ahzab 58.

Gjëja që i lëndon dhe prek më shumë besimtarët është akuzimi i tyre në akide dhe fe _sepse ato janë gjërat më të shtrenjta për ta_ dhe akuzimi i tyre me kufër dhe zendeka prej të cilës janë të pastër.

Është saktësuar në hadithin e profetit ﷺ se ai ka thënë: **“Kush thotë për besimtarin atë që nuk e ka do të hidhet në sekrecionet e banorëve të zjarrit derisa të gjejë një argument për atë që ka thënë”**.¹

Dhe thotë: **“Ribaja më e madhe është lëshimi i gjuhës kundër nderit të muslimanit padrejtësisht”**.²

Çështja e ndalimit dhe sigurimit.

Prej çështjeve të nxehta në këtë kohë e cila ka marrë kohën e shumë studiuesve dhe nxënësve të dijes është edhe çështja e pritjes dhe sigurimit. Ata thonë: Ndalemi në çështjen e gjyqimit të njerëzve me kufër dhe iman dhe nuk gjykojmë derisa të sigurohemi.

Një grup prej tyre ka vendosur si kusht shtesë edhe sprovimin e njeriut rreth çështjeve të caktuara në akide, e nëse u përgjigjen pozitivisht gjykojnë me islamin e tyre, e nëse nuk u përgjigjen ose nuk dinë të përgjigjen ashtu siç duhet, atëhere gjykojnë me kufër.

Them: Ky është shtrëngim dhe ekstremizëm i pabazë që bie në kundërshtim me argumentet dhe bazat e sheriatit. Këtij grupi mund t'i përgjigjemi shkurtimisht me pikat e mëposhtëme:

1) Ide si “ndalja dhe sigurimi”, “grada mes dy gradave”, me të cilat nuk gjykojmë as me islam dhe as me kufër vetëm pasi të sigurohemi; janë ide të shtrënguara prej të cilave jemi ndaluar. Ato janë fjalë të shpikura që kundërshtojnë selefinit e këtij umeti dhe kundërshtojnë argumentet e sheriatit. Njerëzit ndahen në dy grupe: në qafirë dhe muslimanë. Nuk ka në mes tyre ndonjë gradë apo emërtim tjetër ku personi nuk është as qafir dhe as musliman. Allahu ﷻ thotë: **«Ai ju ka krijuar ju, dhe prej jush disa janë qafirë dhe disa besimtarë. Allahu është më i ditur për atë që punoni»** Et tegabun, 2.

2) Ideja e “ndaljes” dhe e “gradës mes dy gradave” është më afër mendimit të mutezilive të humbur të cilët gjykuan se vepruesi i gjynahut të madh qëndron në një gradë mes dy gradave dhe thanë: Ai nuk është as qafir dhe as besimtar por është mes dy gradave.

¹ E transmeton Ahmedi, Ebu Daudi, Hakimi. Es silsiletus sahiha, 437.

² Sahih sunen Ebi Daud, 4081.

Kjo bie në kundërshtim me atë që u pohua më parë se njerëzit janë ose qafirë ose muslimanë.

3) Atyre që ndalen u shtrojmë këtë pyetje: Si silleni me personin për të cilin ndaleni dhe nuk gjykoni as për kufër dhe as për iman përpara se të siguroheni dhe të bindeni, sepse kjo periudhë mund të zgjasë me vite ose një jetë të tërë?

Nëse thonë: Sillemi me të si të jetë musliman.

U themi: Si silleni me të si një musliman kur nuk gjykoni me islamin e tij?!

Por nëse thonë: Sillemi me të si qafir.

U themi: Si silleni me të si me një qafir kur nuk gjykoni me kufrin e tij?!

Nëse thonë: E injorojmë dhe nuk sillemi me të as si musliman dhe as si qafir.

U themi: Këtë nuk e pranon as logjika dhe as sheriat. Njerëzit kanë nevojë për njëri-tjetrin dhe patjetër duhet të sillen në një mënyrë ose në një tjetër me njëri-tjetrin dhe kjo kërkon njohjen e njëri-tjetrit.

Gjithashtu u thuhet: Si doni ta ringjallni akiden e miqësimit dhe armiqësimit kur nuk e njihni fenë dhe akiden e të tjerëve dhe nuk silleni me ta as me miqësi dhe as me armiqësi?!

4) Ideja e “ndaljes dhe sigurimit” është e pamundur të praktikohet prej njeriut. Si mundet që njeriu të dallojë akiden e 1.5 miliard muslimanëve një nga një, në vende të ndryshme dhe të largëta?! Kjo është e pamundur. Islami është në një gradë më të lartë se sa të ngarkojë njeriun me gjëra të pamundura. Allahu ﷻ thotë: **﴿Allahu nuk e ngarkon askënd me atë që nuk ka mundësi﴾** El Bekare, 286. Dhe thotë: **﴿Ruajuni Allahut aq sa keni mundësi dhe dëgjoni e binduni﴾** Et tegabun, 16. Dhe thotë: **﴿Nuk e ngarkojmë askënd me atë që nuk ka mundësi﴾** El araf, 42.

5) Nëse ngrihet pyetja: Cili është rregulli që na jep mundësinë të dallojmë muslimanin dhe qafirin?

Themi: Rregulli është shoqëria ku jeton ky person. Dispozitat e tyre kthehen te shoqëritë ku jetojnë. Nëse është shoqëri muslimane dhe shumica janë muslimanë ata konsiderohen muslimanë dhe sillemi me ta si muslimanë dhe gjykohen me islam për aq kohë sa nuk ka dëshmi apo shenjë dalluese që dëshmon për kufrin e tyre dhe se nuk është musliman.¹

¹ Në mesin e shoqërisë muslimane jetojnë komunitete më të vogla si ndonjë fshat apo krahinë ku shumica e njerëzve janë qafirë jo muslimanë, çifutë, të krishtere, karamitë, batini, etj. Në këtë rast ky komunitet i vogël nuk ka të njëjtin gjykim si shoqëria e gjërë muslimane, por konsiderohet komunitet qafir dhe sillemi me ta në varësi të akides dhe fesë së tyre.

Gjithashtu në mes të shoqërisë qafire mund të gjendet ndonjë fshat ose zonë ku shumica ose të gjithë banorët janë muslimanë. Atëhere ky komunitet në këtë fshat ose zonë nuk merr të njëjtin gjykim si shoqëria e madhe qafire përse i takon marrëdhënieve me ta dhe indentitetit dhe fesë së tyre.

E njëjta gjë thuhet për shoqëritë jo muslimane ku shumica e banorëve janë në kufër dhe shirk. Sillemi me njerëzit duke i konsideruar qafirë përderisa nuk shfaqen haptas ose ekzistojnë shenja që janë muslimanë. Ky është rregulli dhe peshorja me të cilën dallojmë muslimanët dhe qafirët në shoqëri.

Është saktësuar se i dërguari i Allahut ﷺ u pyet: **“Cili është islami më i mirë? Tha: Dhurimi i ushqimit dhe t’i japësh selam atij që e njeh dhe atij që nuk e njeh”**.¹ Profeti ﷺ urdhëroi që t’i jepësh selam atij që e njeh dhe atij që nuk e njeh përderisa jeton me muslimanët dhe në shoqërinë e tyre, përveçse nëse dallon gjëra që dëshmojnë se ai nuk është musliman.

Dhënia e selamit nënkupton konsiderimin e tij për musliman, megjithëse nuk e njeh atë, sepse selami i jepet vetëm muslimanit.

Madje profeti ﷺ e ka konsideruar kushtëzimin e njohjes së personit për t’i dhënë selam _siç është medhhebi i këtyre që ndalen_ prej shenjave të kiametit. Është saktësuar se ai ka thënë: **“Prej shenjave të kiametit është përshëndetja vetëm e atyre që njeh”**. Në një rivajet tjetër thuhet: **“Kur njeriu t’i jap selam tjetrit vetëm nëse e njeh”**. Pra i jep selam sepse e njeh, ndërsa atë që nuk e njeh nuk i jep selam. Ky ves i keq është prej shenjave të kiametit.

Tufejl Ibn Ubej Ibn Kabit tregon se ai shkante te Abdullah ibn Umeri ؓ pastaj dilnin sëbashku në treg. Thotë: Kur niseshim për në treg, sa herë që kalonte para Ibn Umerit ؓ ndonjë shitës i gjërave të përdorura, ndonjë tregtar, varfanjak ose çdokush tjetër, i jepte selam.

Thotë: Një ditë vajta te Ibn Umeri ؓ dhe u nisëm për në treg. I thashë: Pse shkon në treg kur nuk pyet as për të blerë dhe as për mallra, kur as nuk negocion në çmime dhe as nuk ulesh në mexhliet e tregut. Më mirë ulemi këtu dhe bëjmë muhabet. Abdullahi ؓ më tha: O Ebu Batan! Shkojmë në treg për të përhapur selamin. Këdo që takojmë i japim selam”.²

Aq sa Ibn Umeri ؓ prej shumicës së selamit që jepte qëllonte që t’i jepte selam edhe ndonjë të krishteri prej *Ehlidhimme-s* pa e ditur. Transmetohet në etherin e saktë prej Abdurrahman ibn Zejdit thotë: Ibn Umeri ؓ kaloi para një të krishteri dhe i dha selam dhe ai ia ktheu selamin. Pastaj i treguan që ishte i krishterë. Atëhere u kthye dhe i tha: Ktheje mbrapsht atë selamin që të dhashë”.³

Kjo gjë ndodhte me shumë selefë. Kjo për shkak se njerëzit vepronin me njëri-tjetrin në bazë të shoqërisë ku jetonin përderisa nuk vinte ndonjë shenjë që dëshmonte për të kundërtën dhe e kundërshton këtë rregull.

Transmetohet në ether se Ukbe ibn Amir Xhuhenui kaloi para një personi me pamje

¹ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

² Sahih el edeb el mufred, 770.

³ Sahih el edeb el mufred, 849.

muslimani dhe i dha selam. Ai ia ktheu: Ue alejke ue rahmetullahi ue berekatuhu. Shërbëtori i tij i tha: Ai është i krishterë! Atëhere Ukbeja iu vu pas derisa e arriti dhe i tha: Mëshira e Allahut dhe bereqeti i tij qofshin për besimtarët. Ndërsa ty Allahu të dhëntë jetë, fëmijë dhe pasuri”.¹

Shiko se si u bazua vetëm në përngjashmërinë me pamjen e muslimanit _kur ai jetonte në mesin e muslimanëve_ si një shenjë për islamin e tij aq sa i dha selam duke e kujtuar për musliman. Mund të ndodhin gabime në raste të tilla, mirëpo ato me lejen e Allahut janë të falura, sepse ato ndodhin me ixhtihad, padashje dhe paqëllim. I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Allahu ia ka falur umetit tim gabimin, harresën dhe atë për të cilën janë imponuar”.**

Shkurtimisht themi: Gjykojmë për njerëzit në bazë të shoqërisë ku jetojnë. Nëse jetojnë në shoqëri islame gjykojmë me islam dhe sillemi me ta si muslimanë vetëm nëse shfaqet ndonjë gjë që dëshmon se ai është qafir. Ndërsa në shoqëritë e kufrit gjykojmë me kufër dhe sillemi me ta njësoj si me qafirët përderisa nuk shfaqet ndonjë gjë që dëshmon se ai është musliman. Për këtë shkak dhe për shkaqe të tjera sheriati ka urdhëruar për bërjen hixhret nga vëndet e kufrit për në vëndet islame.



¹ Sahih el edeb el mufred, 847.

Rregulli i dhjetë: Në konsideratë mirret përfundimi i punëve.

Në konsideratë merret përfundimi i njeriut. Nëse jeta i përfundon me iman ai është besimtar dhe prej banorëve të xhenetit sado punë të këqija të ketë bërë më përpara. E nëse jeta i përfundon me kufër ai është qafir dhe prej banorëve të zjarrit sado punë të mira të ketë vepruar më parë. Pra në konsideratë merret përfundimi dhe me çfarë punësh e mbyll jetën.

Argumentet rreth kësaj janë si mëposhtë:

Allahu ﷻ thotë: **«Ata që kanë bërë kufër dhe kanë vdekur qafirë mbi ta bie mallkimi i Allahut, i melekëve dhe i të gjithë njerëzve. Në të (zjarr) do të jenë të përhershëm. As nuk u lehtësohet dënimi dhe as nuk priten»** El bekare, 162.

Dhe thotë: **«Ata që kanë bërë kufër dhe kanë vdekur qafirë nuk do të pranohet prej asnjërit prej tyre edhe nëse paguajnë të gjithë tokën me flori për të shpëtuar. Ata kanë dënim të dhëmbshëm dhe askush nuk u del në ndihmë»** Ali Imran, 91. Allahu ﷻ e vari dënimin e tyre me vdekjen e tyre në kufër.

Dhe thotë: **«Ata që kanë bërë kufër dhe kanë penguar prej rrugës së Allahut pastaj kanë vdekur qafirë, Allahu kurrë nuk ka për t'i falur»** Muhamed 34. Allahu ﷻ e lidhi dënimin dhe mosfaljen e tyre me vdekjen e tyre në kufër.

Dhe thotë: **«Nuk u pranohet teubeja (pendimi) atyre që punojnë të këqijat derisa kur t'u vijë vdekja thonë: Unë u pendova tani dhe as atyre që vdesin qafirë. Atyre u kemi përgatitur dënim të dhëmbshëm»** En nisa 18. Allahu ﷻ nuk e pranon teuben e askujt pas vdekjes në kufër.

Dhe thotë: **«Kushdo prej jush që bën ridde prej fesë së tij dhe vdes qafir atyre kanë për t'iu rrëzuar të gjitha veprat në dynja dhe ahiret. Ata janë banorët e zjarrit dhe në të do të jenë përjetësisht»** El bekare 217. Allahu ﷻ e lidhi qëndrimin e përhershëm në zjarr të xhehenemit me vdekjen në kufër. Kjo nënkupton se njeriu mund të përfitojë prej të mirave të tij, mirëpo nëse vdes në kufër nuk përfiton asgjë prej tyre. Kjo çështje do të sqarohet më gjerësisht në vazhdim.

Në hadithin sahih, i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Kush vdes duke e ditur se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut ai ka për të hyrë në xhenet”**.¹ Shiko se si profeti ﷺ e kushtëzoi hyrjen në xhenet me vdekjen në teuhid dhe njohjen e teuhidit.

Këtu hyn edhe fjala e profetit ﷺ: **“Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se unë jam i dërguari i Allahut. Çdokush që e takon Allahun me këto**

¹ E transmeton Muslimi.

*dy fjalë pa pikë dyshimi në to ai do të hyjë në xhenet”.*¹

Dhe thotë: “Çdo rob që thotë “Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut” e pastaj vdes do të hyjë në xhenet”.² I dërguari i Allahut ﷺ e kushtëzoi hyrjen në xhenet me vdekjen në teuhid. Kjo nënkupton se ai që nuk vdes në teuhid _edhe nëse para vdekjes ka qënë në teuhid_ nuk është prej banorëve të xhenetit dhe as nuk do të hyjë në të.

Argument për këtë është edhe fjala e profetit ﷺ: “Pasha atë në dorë të të cilit është shpirti im! Ndonjëri prej jush punon vepra të banorëve të xhenetit aq sa nuk mbetet mes tij dhe mes xhenetit më shumë se një kut, mirëpo e paraprin atë libri dhe punon vepra të banorëve të zjarrit dhe futet në të. E ndonjëri prej jush punon vepra të banorëve të zjarrit aq sa mes tij dhe mes zjarrit nuk ka më shumë se një kut, pastaj e paraprin atë libri dhe punon me vepra të banorëve të xhenetit dhe futet në të”.³ Pra e parakalon ajo që është shkruajtur në libër (El leuhul mahfudh) dhe vepron me atë që i është paracaktur dhe vdes në atë gjendje.

Prej Enes ibn Malikut ؓ thotë: I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Mos u habisni me punën e askujt derisa të shikoni se me çfarë do e mbyllë. Njeriu punon për një kohë të gjatë në jetën e tij ose një farë kohe prej jetës së tij me vepra të mira, sikur të vdiste me to kishte për të hyrë në xhenet, mirëpo pastaj ndryshon dhe fillon të punojë vepra të këqija. Dhe njeriu punon për një kohë të gjatë prej jetës së tij me punë të këqija nëse do vdiste me to kishte për të hyrë në zjarr, mirëpo pastaj ndryshon dhe punon vepra të mira. Nëse Allahu ia do të mirën një robi e udhëzon atë të veprojë vepra të mira para vdekjes dhe pastaj ia merr shpirtin”.⁴

Prej Aishes thotë: Thashë: O i dërguar i Allahut! Ibn Xhedani në xhahilijet është kujdesur për farefisnin dhe e ushqente të veboktin. A i bën dobi kjo? I tha: “Nuk i bën dobi. Ai kurrë nuk pati thënë: O zot! M’i fal gjynahet e mia në ditën e gjykimit”.⁵

Veprat e mira nuk i bënë asnjë dobi sepse ai vdiq në shirk. Vdekja në teuhid i bën dobi atij në fshirjen e veprave të këqija siç transmetohet në sahihun e Buhariut se një person i veshur me përkrenare hekuri erdhi te profeti ﷺ dhe i tha: O i dërguari i Allahut! A të luftoj apo të bëhëm musliman? I tha: Bëhu musliman pastaj lufto. Pastaj u bë musliman dhe luftoi derisa u vra. Atëhere i dërguari i Allahut ﷺ tha: “Punoi pak dhe u shpërblye shumë”.

Në një transmetim te Muslimi thuhet: Një person prej ensarëve erdhi dhe tha: Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se ti je rob dhe i dërguar i tij. Pastaj u nis përpara dhe luftoi derisa u vra. Atëhere profeti ﷺ tha: “Punoi pak dhe u

¹ E transmeton Muslimi.

² E transmeton Muslimi.

³ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

⁴ E transmeton Ahmedin dhe të tjerë. Es silsiletus sahiha, 1334.

⁵ E transmeton Muslimi.

shpërblye shumë”.

Në hadithin sahih i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Pasha atë në dorën e të cilit është shpirti i Muhamedit! Askush nuk dëgjon për mua prej këtij umeti qoftë ai çifut apo i krishterë e pastaj vdes pa besuar në atë me të cilën jam dërguar veçse do të jetë prej banorëve të zjarrit”.**¹ Profeti ﷺ e lidhi hyrjen e tyre në zjarr me vdekjen në kufër dhe mohimin e dërgesës profetike.

Transmetohet se imam Ahmedi në agoninë e vdekjes zuri të thoshte: Akoma jo, akoma jo. I biri i tij, Abdullahi i tha: O baba! Ç’janë këto fjalë që thua. I tha: *O bir! Iblisi është ulur në qoshe të shtëpisë duke kafshuar gishtat dhe më thotë: Më rrëshkate prej duarve o Ahmed. E unë i them: Akoma jo, akoma jo.* Pra nuk shpëton prej tij derisa të vdesë në teuhid, e për aq kohë sa është në jetë nuk është i sigurtë prej fitnes.²

Neveviu thotë: *“Askush që ka vdekur në teuhid nuk do të qëndrojë në zjarr përgjithmonë sado gjynahe të ketë punuar. E askush që vdes në kufër nuk do të hyjë në xhenet sado punë të mira që të ketë vepruar. Kjo është fjala e përmbledhur e medhhebit të pasuesve të së vërtetës në këtë çështje”.*³

E lus Allahun të na dhurojë përfundimin e mirë dhe t’i përmbyllë veprat tona me mirësi.

Çfarë përfitohet prej këtij rregulli?

Prej këtij rregulli përfitohen shumë dobi:

- Durimi dhe qëndrimi në rrugën e drejtë duhet të shkojë deri në fund. Fundi i rrugës duhet të mbyllet me vdekjen në iman dhe teuhid. Në asnjë mënyrë nuk mund të ndalet në mes të rrugës dhe të ngrejë parrullën “mjaf”, mjaft kemi kontribuar, u plakëm tani, u lodhëm, dhjetra vite në fushën e davetit dhe xihadit, erdhi koha të shplodhemi, i takon brezave të ardhshëm ta çojnë në fund punën tonë.

Apsolutisht! Feja ka nevojë për përpjekje dhe mund nga djepi e gjer në varr. Muslimani nuk duhet të shplodhet për sakohë që në vena i rrjedh gjaku i jetës. Ata që u përpoqën dhe u munduan një apo dy ditë .. një apo dy muaj .. një apo dy vjet .. pastaj dorëzohen për shplodhje dhe rehati, për gjum letargjik! Shejtani i mashtron se mjaft më, detyrën e kryet. Asgjë nuk ju dëmton pas këtyre përpjekjeve dhe kontributeve. Këta njerëz nuk e kanë kuptuar natyrën e kësaj feje dhe as natyrën e misionit me të cilin janë ngarkuar dhe për të cilin janë krijuar.

¹ E transmeton Muslimi.

² Parathënia e musnedit të imam Ahmedit, 1/14, El mekteb el islami.

³ Shpjegimi i sahihut të Muslimit, 1/217.

Shumë njerëz janë bërë të njohur në skajet e botës, për kapjen me fenë dhe xhihadin e tyre, në fund, sprovohen dhe e mbyllin jetën me vepër të keqe. Unë njoh njerëz që kanë duruar dhjetra vite në hixhret dhe xhihad, pastaj, para vdekjes ankohen se janë lodhur dhe këputur dhe anojnë nga tagutët zullumqarë. La haule ue la kuuete il-la bil-lah.

- Sado vepra të mira të ketë punuar njeriu, përderisa vazhdon të jetojë në këtë botë ai nuk është i sigurtë prej fitneve. Nuk i takon ta lavdërojë veten dhe askënd tjetër për gjëra që i di vetëm Allahu ﷻ. Në çdo çast duhet të synojë shpëtimin, t'i kërkojë Allahut ﷻ qëndrueshmërinë dhe përfundimin e mirë dhe vdekjen në iman dhe teuhid.

- Duhet marrë patjetër në konsideratë përfundimi i një personi të caktuar nëse dëshirojmë të flasim për ahiretin e tij; nëse ai është prej banorëve të zjarrit apo për çdo gjykim tjetër. Përfundimi i tij njihet prej punëve të cilat i shfaq në fund të jetës. Prandaj ai që gjithë jetës e shfaq kufirin dhe pastaj nuk shfaq asnjë shenjë pendimi dhe imani, ai gjykohet si qafir dhe do të jetë i përhershëm në xhehenem; sepse ai nuk ka shfaqur asgjë që dëshmon të kundërtën e kufirit të tij. Prandaj dëshmojmë për të atë që shohim në pamje të jashtme.

Nëse thuhet: Mbase e ka pasur zemrën të pastër dhe është drejtuar në iman para se të vdiste dhe njerëzit rreth tij nuk e kanë ditur.

U themi: E pranojmë se atë që e fshehin zemrat e di vetëm Allahu ﷻ. Asnjë krijesë nuk mund të dijë se çfarë fshehin zemrat, përveçëse me shenjat dhe veprat e dukshme të cilat dëshmojnë për realitetin e zemrës. Prandaj ne bazohemi në pamjen e jashtme ndërsa Allahu gjykon për të fshehtat. Nëse ndodh ndonjë gabim në këto raste, ai është i falur dhe personit i takon një shpërblim _me lejen e Allahut_, sepse ai është bazuar në rregulla të vërtetuara prej shariatit për të cilat dëshmojnë argumente prej Kuranit dhe sunetit.

Ai që gjykon për munafikun _i cili e fsheh kufirin_ se është musliman dhe besimtar, duke u bazuar në pamjen e tij të jashtme, nuk qortohet për këtë gabim dhe nuk është e drejtë t'i thuhet: Ti ke gjykuar për një munafik qafir me islam dhe iman. Kjo nuk është e drejtë. Çdo musliman e di pa pikë dyshimi se ai ka vepruar drejt atëhere kur është bazuar për gjykim në pamjen e jashtme. Ndërsa gabimi në realitetin e brendshëm është i falur dhe ai shpërblehet për këtë siç transmetohet në dy sahihet: ***“Nëse gjykuesi bën ixhtihad dhe ia qëllon ai ka dy shpërblime e nëse bën ixhtihad dhe gabon ka një shpërblim”***.

Pastaj gjykimi për një person të caktuar me kufër dhe se ai është prej banorëve të zjarrit nuk nënkupton detyrimisht se ky person është prej banorëve të zjarrit, sepse në dijen e Allahut ai mund të jetë prej banorëve të xhenetit dhe të përfitojë prej mëshirës së Allahut ﷻ, sepse gjykimi i vërtetë i takon vetëm Allahut të lartë dhe të fuqishëm.

- Nëse dëshmojnë për një qafir që është akoma gjallë se është qafir, nuk duhet të dëshmojmë se ai është i përjetshëm në zjarr sepse nuk i dihet se mund të pendohet përpara

vdekjes dhe përfundimin ta ketë të mirë. Nëse patjetër duhet të dëshmojmë se ai është në zjarr atëherë duhet ta kushtëzojmë me vdekjen e tij në kufër. Psh të thotë: Ai është qafir, e nëse vdes në kufrin e tij ai është i përjetshëm në zjarrin e xhehenemit. Në të kundërt njeriu hyn në kompetencat e Allahut padije dhe hyn në aventura të rrezikshme dhe Allahu është më i ditur.

Çështje që lidhen me rregullin.

Çështja e parë: A dëshmohet për një musliman të caktuar se ai është prej banorëve të xhenetit?

Ka dallim mes dëshmisë së papërcaktuar se muslimanët e vdekur janë në xhenet dhe se muslimanët e vrarë janë shehidë dhe në xhenet dhe mes dëshmisë për një person konkret se ai është prej banorëve të xhenetit.

Dëshmia e parë është e lejuar, si p.sh. kur thotë: Muslimanët e vrarë janë shehidë dhe janë në xhenet. Shehidët musliman në Palestinë janë në xhenet. Muslimanët e vrarë në betejat e riddes, në betejën e Jermukut, në betejën e Hitinit etj, janë shehidë dhe në xhenet. Ose kur thotë: Kush vritet në mbrojtje të një suneti ai është shehid dhe është në xhenet. Kush vritet në mbrojtje të fesë, të nderit, të pasurisë ose për të larguar padrejtësinë ai është shehid dhe është në xhenet. Të gjitha këto shprehje të papërcaktuara janë të lejuara dhe nuk përbëjnë problem. Argumentet e Kuranit dhe të sunetit dhe veprat e selefit që dëshmojnë për këto thënie janë të shumta.

Ndërsa dëshmia për një person konkret se ai është shehid dhe prej banorëve të xhenetit është e ndaluar. Nuk dëshmohet për një person konkret se ai është prej banorëve të xhenetit vetëm në rast se i dërguari i Allahut ﷺ ka dëshmuar për persona konkretë se ata janë në xhenet, si p.sh. dhjetë sahabët e përgëzuar me xhenet. Për personat e vërtetuar me argumente se ata janë prej banorëve të xhenetit, dëshmojmë për ta se janë prej banorëve të xhenetit, pa shtuar dhe pa paksuar.

Arsyet që pengojë për dëshminë me xhenet për një person konkret janë si mëposhtë:

1- Punët që të fusin në xhenet janë të kushtëzuara me nijetin dhe besimin e sinqertë. Veprat e pasinqerta dhe pa besim të drejtë nuk i bëjnë dobi, përkundrazi janë shkak për dënimin dhe shkatërrimin e tij.

E përmendëm se njohja e fshehtësive të zemrave është kompetencë vetëm e Allahut. Askush nuk e di se çfarë fshehin zemrat. Allahu ﷻ e di ndërsa ne nuk e dimë: **﴿Allahu di ndërsa ju nuk dini﴾** En nur 19. Ai që nuk e di diçka nuk mund të dëshmojë për të. E sa të shumtë janë ata për të cilët dëshmohet xheneti dhe devotshmëria e tyre mirëpo ai në dijen e Allahut është qafir dhe munafik në gradën më të ulët të zjarrit.

Imam Buhariu transmeton në sahihun e tij në kapitullin me titull “*Kapitull: Nuk*

thuhet filani është shehid”: Ebu Hurejra ؓ transmeton prej profetit ﷺ se ai ka thënë: “Allahu është më i ditur për atë që lufton në rrugën e tij. Allahu është më i ditur për atë që plagoset në rrugën e tij”. Sepse ai mund të ketë luftuar me rija dhe për t’u bërë i njohur, ose sepse është zemëruar por jo për hir të Allahut, mirëpo këtë askush nuk e di përveç Allahut.

Prej Sehl ibn Sad Saidiut se i dërguari i Allahut u përball me mushrikët dhe u përleshën. Kur profeti u tërhoq në kampin e tij dhe të tjerët (qafirët) u tërhoqën në kampin e tyre, në mesin e sahabëve të profetit ishte edhe një person i cili i ndoqi qafirët këmbakëmbës duke i goditur me shpatë. Thanë: Sot, nuk na bëri punë askush më shumë se sa filani. Mirëpo i dërguari i Allahut ﷺ tha: Në fakt ai është prej banorëve të zjarrit. Atëhere një prej të pranishmëve u ngrit dhe tha: Unë do e ndjek atë.

Thotë: U vu në ndjekje të tij, sa herë që ndalonte ndalonte edhe ai, e sa herë që nxitonte nxitonte me të. Thotë: Pastaj ai u plagos rëndë dhe i parapriu vdekjes, duke vendosur dorezën e shpatës në tokë dhe gjoksin mbi tehim dhe pastaj u lëshua mbi shpatë dhe vrau veten.

Atëhere ky personi u kthye te profeti ﷺ dhe i tha: Dëshmoj se ti je i dërguar i Allahut. I tha: Si është puna? I tha: Personi të cilin e përmende më parë se është prej banorëve të zjarrit dhe njerëzit u friksuan dhe unë u thashë: Unë do ta ruaj atë. Pastaj e ndoqa derisa u plagos rëndë dhe i parapriu vdekjes duke e vendosur dorezën e shpatës në tokë dhe teshun e tij në gjoks pastaj u lëshua mbi të dhe vrau veten.

I dërguari i Allahut ﷺ tha: Njeriu vepron me punën e banorëve të xhenetit në sytë e njerëzve mirëpo ai është prej banorëve të zjarrit. Njeriu mund të veprojë prej punëve të banorëve të zjarrit në sytë e njerëzve mirëpo ai është prej banorëve të xhenetit”.¹

Ibn Haxheri ka thënë: “Fjala e tij: “Kapitull: Nuk thuhet filani është shehid”, pra nuk thuhet me bindje të plotë, nëse nuk jemi të informuar prej shpalljes. Mesa duket ai nënkupton hadithin e Umerit ؓ i cili tha në hutbe: Në betejat tuaja thoni: Filani është shehid, filani ka vdekur shehid. Ku e dini ju se ai nuk e ka lodhur kafshën e tij kot. Mos thoni kështu por thoni ashtu siç thoshte i dërguari i Allahut ﷺ: “Kush vdes ose vritet në rrugë të Allahut ai është shehid”. Ky hadith është hasen. E transmeton Ahmedi dhe të tjerë.

Pra ai ka për qëllim që është e ndaluar të cilësohet një person i caktuar se është shehid, mirëpo lejohet të thuhet në mënyrë të përgjithshme dhe pa përcaktim.

Fjala e tij: “Allahu është më i ditur për atë që plagoset në rrugë të tij”. Sepse këtë nuk e di askush përveç atij që Allahu e ka informuar. Prandaj nuk duhet të dëshmohet për

¹ Fakti që dikush është prej banorëve të zjarrit megjithëse në sytë e njerëzve punon punë të banorëve të xhenetit, kjo është për shkak të njetit dhe synimit të tij të prishur, sepse njerëzit nuk kanë mundësi ta dinë atë. Ndërsa ai që vepron në sytë e njerëzve vepra të banorëve të zjarrit mirëpo është prej banorëve të xhenetit, ai gjykohet bazuar në përfundimin e tij të cilin nuk e di askush _para se të ndodhë_ përveç Allahut.

*çdo njeri të vrarë në xhihad se ai është vrarë në rrugë të Allahut”.*¹

Një hadith të ngjashëm e transmeton edhe Muslimi në sahihun e tij prej Ebu Hurejres ؓ thotë. E kam dëgjuar të dërguarin e Allahut ؑ të thotë: **"Njeriu i parë që gjykohet në ditën e gjykimit është dikush që ka rënë shehid. Sillet para Allahut dhe i tregon mirësitë e tij të cilat i pranon. I thotë: Çfarë ke vepruar me to? Thotë: Luftova për hirin tënd derisa rashë shehid. I thotë: Gënjen. Ti luftove që të thuhej: Filani është guximtar dhe kjo tashmë është thënë. Pastaj urdhëron të tërhiqet prej fytyre derisa të hidhet në zjarr.**

Pastaj (gjykohet) një burrë që e ka mësuar dijen, e ka përhapur atë dhe ka lexuar Kuran. Sillet para Allahut dhe i tregon mirësitë e tij të cilat i pranon. I thotë: Çfarë ke vepruar me to? Thotë: E kam mësuar dijen e kam dhënë atë dhe kam lexuar Kuran. I thotë: Gënjen. Ti ke mësuar që të thuhej: I ditur. E ke lexuar Kuranin që të thuhej: Ai është recitues, dhe kjo tashmë është thënë. Pastaj urdhërohet të tërhiqet prej fytyre derisa të hidhet në zjarr.

Pastaj (gjykohet) një burrë që Allahu i ka dhënë nga të gjitha llojet e pasurisë. Sillet para Allahut dhe i tregon mirësitë e tij të cilat i pranon. I thotë: Çfarë ke vepruar me to? Thotë: S’kam lënë asgjë që ty të pëlqen shpenzimi për të veçse kam shpenzuar për ty. I thotë: Gënjen. E ke bërë që të thuhet: Ai është bamirës, dhe kjo tashmë është thënë. Pastaj urdhërohet të tërhiqet prej fytyre derisa të hidhet në zjarr”.

Shiko se si Allahu ؑ ua refuzoi punët këtyre tre lloje njerëzish; shehidit, dijetarit recitues, dhënësit të sadakave, përshkak se e dinte nijetin dhe synimin e tyre të prishur. Është e pamundur që njerëzit ta dinë këtë, sepse vetëm Allahu ؑ e di ndërsa ne nuk e dimë. Allahu nuk e pranon asnjë vepër të mirë përderisa nuk është kryer vetëm për hir të tij, siç thuhet në hadithin që e transmeton Muslimi në sahihun e tij prej Ebu Hurejres ؓ thotë: I dërguari i Allahut ؑ ka thënë: **“Allahu ؑ ka thënë: Unë jam ortakun më i panevojshëm për shirkun. Kush vepron ndonjë punë dhe bën me mua ndonjë ortak tjetër e braktis atë me gjithë punën e tij”.**

Gjithashtu edhe ai që i urdhëron njerëzit për vepra të mira dhe nuk i vepron dhe i qorton për vepra të këqija por ai vetë i vepron ato, ai sipas njerëzve është prej banorëve të xhenetit për shkak të devotshëmrisë së tij dhe për shkak se urdhëron për mirë dhe ndalon nga e keqja ndërkohë që në dijen e Allahut ؑ ai është prej banorëve të zjarrit.

Në hadithin e Usamas ؓ thotë: E kam dëgjuar të dërguarin e Allahut ؑ të thotë: **“Do të sillet një person në ditën e gjykimit dhe do të hidhet në zjarr derisa t’i dalin zorrët e barkut dhe i mbështillen rreth trupit ashtu siç rrotullohet gomari rreth mullirit. Banorët e zjarrit mblidhen rreth tij dhe i thonë: O filan! Si është puna jote? A nuk na ke pas urdhëruar për mirë dhe na ke ndaluar nga e keqja? U thotë: Ju urdhëroja për mirë por**

¹ Fet’hul bari sherh sahih el buhari, 6/105-106.

nuk e veproja dhe ju ndaloja nga e keqja por e veproja".¹

Së dyti: Thënia me siguri për një person të caktuar se ai është shëhid apo prej banorëve të xhenetit është një lavdërim i tepërt (tezkije) për këtë person me padije dhe ndërhyrje në kompetencat e Allahut. Prandaj heriati ka ndaluar prej kësaj. Allahu thotë: **﴿Mos i lavdëroni vetet tuaja. Ai është më i ditur për atë që ruhet﴾** En nexhm 32. Dhe thotë: **﴿A nuk habitesh me ata që lavdërojnë vetet e tyre! Por Allahu lavdëron kë dëshiron dhe atyre nuk u bëhet padrejtësi﴾** En nisa 49.

Është saktësuar se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Mos i lavdëroni vetet tuaja. Allahu është më i ditur për të devotëshmit”**.² Nëse nuk lejohet që njeriu të lavdërojë veten e tij për të cilën është më i ditur si atëhere mund të lavdërojë të tjerët?!

Dhe ka thënë: **“Nëse duhet patjetër të lavdërojë dikë atëhere le të thotë: Besoj se është kështu dhe kështu nëse ai mendon se është ashtu, dhe gjykues i tij është Allahu, dhe të mos lavdërojë para Allahut askënd”**.³

Fjala e tij *“patjetër”* nënkupton që në origjinë nuk lavdëron askënd mirëpo nëse duhet patjetër le të lavdërojë dhe të flasë mirë për ato që i di dhe jo për atë që nuk e di dhe pastaj duhet ta kushtëzojë këtë me fjalën *“nuk lavdërojmë para Allahut askënd”* sepse Allahu është më i ditur për të devotëshmit dhe vepërmirët.

Prej Kab ibn Uxhres ؓ thotë: Profeti nuk e pa Kabin për një farë kohe dhe pyeti për të. I thanë: Është i sëmurë. Pastaj shkoi në këmbë deri te ai dhe kur hyri brenda i tha: Përgëzohu o Kab! Nëna e tij i tha: Hallall të qoftë xheneti o Kab! Atëhere i dërguari i Allahut tha: Kush është kjo që përzihet në kompetencat e Allahut. I tha: Nëna ime o i dërguar i Allahut. I tha: Ku e di ti o Ummu Kab (nëna e Kabit) se Kabi nuk ka folur gjëra që nuk i takojnë ose ka penguar prej gjërave që nuk i takojnë?!”.⁴

Transmetohet në sahihun e Buhariut prej Ebi Melikes se ka thënë: Kam arritur tridhjetë prej sahabëve të profetit. Të gjithë ata frikësoheshin prej nifakut. Askush prej tyre nuk thoshte: Imani im është si imani i Xhibrilit dhe Mikailit.

Nëse vetë sahabët vepronin me vetet e tyre në këtë mënyrë atëhere ata që janë pas sahabëve duhet të frikësohen më shumë dhe të mos i lavdërojnë vetet e tyre apo të tjerët para Allahut.

Së treti: Dëshmia për një person të caktuar se i është në xhenet nënkupton barazimin e tyre me sahabët për të cilët profeti ka dëshmuar se janë në xhenet. Kjo nënkupton që sahabëve t’u hiqet një nga veçoritë dalluese prej të tjerëve. Dëshmia e profetit ﷺ se disa

¹ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

² E transmeton Muslimi.

³ E transmeton Buhariu.

⁴ E transmeton Ibn Ebi Dunja dhe të tjerë. Es silsiletus sahiha, 3103.

sahabë janë në xhenet e humb vlerën e saj përderisa edhe njerëzit e tjerë mund të dëshmojnë për këdo që dëshirojnë se ai është prej banorëve të xhenetit. Kjo nuk është e pranueshme as në shariat dhe as logjikisht.

Bazuar në këto arsye themi: Nuk lejohet të dëshmojmë për një person të caktuar se është shehid apo se ai në ditën e gjykimit është në xhenet me profetët dhe të devotëshmit dhe shehidët përveç për ata persona për të cilët kanë dëshmuar argumentet e shariatit.

Na lejohet të flasim përgjithësisht por pa përcaktim. P.sh. themi: Kush vritet në rrugë të Allahut ai është shehid. Të vrarët tanë janë në xhenet ndërsa të vrarët e qafirëve janë në zjarr. Shehidët musliman në Uhud, në Mu'te, në Jermuk, në Palestinë, në Çeçeni, në Afganistan janë në xhenet. Shprehjet e përgjithshme nuk janë të ndaluara _me lejen e Allahut_ sepse suneti e lejon përdorimin e shprehjeve të tilla.

Vërejtje:-

Ndonjëherë ekzistojnë shenja dhe dëshmi që dëshmojnë për përfundimin e mirë. Këto shenja janë përgëzim për njeriun në ahiret dhe na shtojnë të mendojmë mirë për këtë person dhe shpresohet për të xheneti në ditën e gjykimit me lejen e Allahut.

Prej këtyre shenjave është lavdërimi dhe komplimentat e besimtarëve për veprat e mira dhe devotshmërinë e tij. Sepse Allahu ﷻ nëse e do dhe e pranon një rob i dhuron pranim dhe dashuri në mesin e njerëzve dhe vendos në gjuhën e njerëzve të mirë lëvdata dhe komplimente për të.

Në hadithin e transmetuar prej Enesit ؓ thuhet: : ***“I dërguari i Allahut ﷺ kaloi pranë një xhenazeje dhe njerëzit folën mirë dhe nxituan ta përmendin për mirë dhe thanë: Me aq sa dimë e ka pas dashur Allahun dhe të dërguarin e tij. Atëhere i dërguari i Allahut tha: E meriton, e meriton, e meriton. Pastaj kaloi një xhenaze dhe njerëzit folën keq dhe nxituan të thoshin fjalë të këqija për të. Thanë: Ka qënë njeri i lig në fenë e Allahut. Atëhere i dërguari i Allahut tha: E meriton, e meriton, e meriton. Umeri i tha: Të befsha fli nënë e babë! Kaluan me një xhenaze dhe folën mirë e the: E meriton, e meriton, e meriton. Pastaj kaluan me një xhenaze dhe folën keq dhe the: E meriton, e meriton, e meriton. Atëhere i dërguari i Allahut ﷺ tha: Ai për të cilin folët mirë e meriton xhenetin, ndërsa ai për të cilin folët keq e meriton zjarrin. Melekët janë dëshmitarët e Allahut në qiell ndërsa ju jeni dëshmitarët e Allahut në tokë. Ju jeni dëshmitarët e Allahut në tokë. Ju jeni dëshmitarët e Allahut në tokë”***¹

Prej Ebu Esued Dejliut thotë: Shkova në Medine kur në të ishte përhapur një epidemi dhe patën vdekur shumë njerëz. U ula afër Umer ibn Hatabit ؓ dhe kaloi një xhenaze dhe folën mirë për të. Umeri ؓ tha: E meriton. I thashë: Çfarë meriton o emirulmuminin? Më tha:

¹ E transmeton Buhariu dhe Muslimi. Shiko tahrixhin e shejh Albanit në “Dispozitat e xhenazes” fq. 44.

Unë thashë ashtu siç ka thënë profeti: **“Çdo musliman për të cilin dëshmojnë katër veta për mirësi Allahu do e fusë në xhenet. I thamë: Po tre veta? Tha: Edhe tre veta. I thamë: Po dy? Tha: Edhe dy. Por nuk e pyetëm për një person të vetëm”**.¹

Dhe thotë: **“Çdo musliman që vdes dhe për të dëshmojnë katër veta prej komshive të tij të afërt se ata kanë parë prej tij vetëm mirë, Allahu thotë për të: E kam pranuar fjalën tuaj, ose: E kam pranuar dëshminë tuaj dhe ja kam falur atë që nuk e dini”**.²

Prej Ibn Mesudit ؓ thotë: I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Nëse komshinjtë e tu dëshmojnë mirë për ty atëhere je punëmirë. E nëse komshinjë dëshmojnë keq për ty atëhere je punëkeq”**.³

Dhe thotë: **“Nëse dikush vjen te një grup njerëzish dhe i thonë: Mirësevjen! atëhere atij i thuhet mirësevjen edhe në ditën kur ta takojë zotin e tij. E nëse vjen e i thonë: Shporru! tëhere i thuhet shporru edhe në ditën e gjykimit”**.⁴

Prej Ibn Abasit ؓ thotë: I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Banorët e xhenetit janë ata të cilëve Allahu ua ka mbushur veshët me lavdërimet e njerëzve dhe ai i dëgjon. Ndërsa banorët e zjarrit janë ata të cilëve Allahu ua ka mbushur veshët me kritikën (qortimet) e njerëzve dhe ai i dëgjon”**.⁵

Dhe thotë: **“Nëse falet namazi për një xhenaze dhe flasin mirë për të Allahu thotë: E kam pranuar dëshminë e tyre për atë që e dinë dhe e kam falur për atë që nuk e dinë”**.⁶

Prej Ebu Hurejrës ؓ thotë: I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Nëse Allahu e do një rob e thërret Xhibrilin dhe i thotë: Unë e dua filanin prandaj duaje atë. Atëhere Xhibrili e do. Pastaj thërret në qiell dhe thotë: Allahu e do filanin prandaj duajeni atë. Atëhere banorët e qiellit e duan atë. Pastaj i dhurohet pranimit në tokë”**.

E nëse e urren një rob e thërret Xhibrilin dhe i thotë: Unë e urrej filanin prandaj urreje. Atëhere Xhibrili e urren dhe thërret banorët e qiellit dhe thotë: Allahu e urren filanin prandaj urrejeni. Ata e urrejnë atë dhe ai urrehet në tokë”.⁷

Po prej Ebu Hurejrës ؓ thotë: I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Çdo rob e ka vlerësimin në qiell. Nëse vlerësimi në qiell është i mirë ai është i mirë edhe në tokë. E nëse vlerësimi i tij në qiell është i keq ai është i keq edhe në tokë”**.⁸

¹ E transmeton Buhariu dhe të tjerë.

² E transmeton Ahmedi dhe Hakimi i cili thotë: Sahih sipas kushteve të Muslimit. Këtë e ka përkrahur edhe Dhehebiu. Shiko “Dispozitat e xhenazes”.

³ E transmeton Ahmedi, Ibn Hibani dhe Hakimi. Sahihul xhami 277.

⁴ E transmeton Hakimi dhe e ka saktësuar dhe më këtë është pajtuar edhe Dhehebiu. Es silsiletus sahiha, 89.

⁵ E transmeton Ibn Maxheh dhe të tjerë. Es silsiletus sahiha, 1740.

⁶ Sahihul xhami, 662.

⁷ E transmeton Muslimi.

⁸ Es silsiletus sahiha, 2275.

Nëse thuhet: Si i bëhet puna me tagutët zullumqarë të cilët kur vdesin shoqërohen me elozhe dhe brohëritje prej mijra e mijra njerëzve, pa folur për mediat dhe shpalljen e zisë? Si mund t'i shpjegojmë argumentet që dëshmojnë se lëvdatat e njerëzve janë shenjë për përfundimin e mirë?

Them: Këto hadithe janë vetëm për lavdërimin që e bëjnë besimtarët njësuës dhe të drejtë dhe për askënd tjetër. Elozhet e masave të humbura dhe ngashërimi i tyre nuk vlen asgjë dhe nuk dëshmon për asgjë në peshoren e drejtë.

Gjithashtu lëvdatat e shumë prej masave të popullit për zullumqarët janë rrjedhojë e shtypjes me hir dhe pahir. Janë rrjedhojë e faktorëve disinformues në media të ndryshme. Prandaj ata detyrohen të bëjnë komplimenta, të gënjejnë, të shtiren etj. Të tilla dëshmi nuk merren parasysh dhe nuk hyjnë në hadithet e mësipërme.

Gjithashtu lëvdatat mund të jenë për shkak të fesë ose mund të kenë lidhje vetëm me dynjanë. Prandaj nëse lëvdohet në fenë dhe akiden tij në moralin dhe devotshmërinë e tij kjo lëvdatë merret parasysh te Allahu. Ndërsa lëvdatat e tjera nuk hyjnë në këto hadithe, p.sh. kur thuhet: Ishte marangoz i zoti, mjek, inxhinier apo shkrimtar i rrallë, ose ishte hatib orator, ose politikan i zoti. Këto dëshmi përfshijë të mirin dhe të keqin dhe nuk merren parasysh.

Shumë prej shenjave të vdekjes së mirë i ka përmendur shejh Muhamed Nasirudin Albani në librin e tij “Dispozitat e xhenazes”, të shoqëruara me argumentet përkatëse. Prej tyre:

- Shqiptimi i shehadetit para vdejes.
- Vdekja me djersitjen e ballit.
- Vdekja ditën ose natën e xhuma.
- Rënia shehid në fushëbetejë.
- Vdekja në luftë në rrugë të Allahut.
- Vdekja prej mortajës.
- Vdekja prej sëmundjeve të barkut.
- Mbytja në ujë ose vdekja kur i rrënohet banesa përsipër.
- Vdekja e gruas gjatë lehonisë e saj për shkak të fëmijës.
- Djegia.
- Vdekja prej turberkulozit.
- Vdekja në ruajtje të kufinjve në rrugë të Allahut.

- Vdekja gjatë kryerjes së një punë të mirë.¹

Këto shënja dhe dëshmi janë përgëzim për njeriun dhe duhet të përmisojmë mendimin tonë për të dhe për përfundimin e mirë, mirëpo ato nuk nënkuptojnë se duhet të dëshmojmë se ata janë në xhenet ashtu siç dëshmohet për sahabët bazuar në argumentet që u përmendën më pare, sepse argumentet shpjegojnë njëri-tjetrin dhe Allahu është më i ditur.

2- Çështja e dytë: A i lejohet personit të dëshmojë për imanin e vetes së tij (se është mumin).

Nëse me fjalën mumin (besimtar) ka për qëllim besimin dhe vërtetimin e asaj me të cilën është dërguar i dërguari i Allahut ﷻ prej zotit të tij dhe mohimin e dyshimit atëhere kjo është e lejuar.

Mirëpo nëse ka për qëllim se ai është mumin (besimtar) prej banorëve të xhenetit sepse shpërblimi i besimtarit është xheneti, atëhere ai duhet ta kufizojë këtë me dëshirën e Allahut². Nuk lejohet lavdërimi i vetes me siguri të plotë sepse ai nuk e di përfundimin e tij. Nuk e di përfundimin e punët e tij. Të shumtë janë ata që ngrysen besimtar e gdhihen qafirë ose gdhihen besimtarë dhe ngrysen qafirë. Njeriu mund të kujtojë se është në mirësi të madhe, mirëpo nuk është i tillë. E lusim Allahun të na bëjë të patundur në fenë tonë dhe të na dhurojë përfundimin e mirë.

Shumë selefë e kanë pas urreyer këtë pyetje dhe përgjigjen e saj dhe e kanë pasë konsideruar si bidat të shpikur në fe. Nëse pyteshin thonin: Kam besuar në Allahun, në melekët e tij, në librat e tij, të dërguarit e tij dhe nuk e kalonin këtë cak.³

3- Çështja e tretë: A dëshmohet për një musliman të caktuar që kryen gjynahe të mëdha se ai është prej banorëve të zjarrit.

Ndëshkimet me të cilat janë kërcënuar gjynahqarët në Kuran dhe në sunet duhet t'i besojmë papërcaktim. Besojmë se gjynahet janë shkak për ndëshkimet e transmetuara për këto gjynahe dhe besojmë se kjo është e vërtetë dhe i friksojmë me këto ndëshkime gjynahqarët dhe zullumqarët.

Por kjo nuk nënkupton se çdokush që i vepron këto gjynahe do të ndëshkohet me këto dënime sepse mund të ekzistojnë pengesa të shumta që nuk lejojnë zbatimin e këtij ndëshkimi, të cilat i sqaruam hollësisht më përpara. Gjithashtu Allahu ﷻ mund ta falë një person të caktuar, sepse prej urtësisë dhe mëshirës së Allahut ﷻ është se çdo gjynah përveç shirkut mbetet në dëshirë të Allahut ﷻ, nëse dëshiron e fal e nëse dëshiron e dënon. Allahu

¹ Shiko librin "Dispozitat e xhenazes" të shejh Albanit Allahu e mëshiroftë.

² Thotë: Unë jam besimtar nëse do Allahu (inshaallah).

³ Shiko librin "El ibaneh an sheriati l firkatin naxhijeh" kitabul iman, 2/877.

ﷻ thotë: **«Allahu nuk e fal t'i bëhet shirk dhe ia fal atë që është më e vogël se ai atij që dëshiron»** En nisa 48.

Në hadithin e Ubade Ibn Samitit ﷺ në sahihun e Buahriut thuhet: **“Kush kryen diçka prej tyre dhe Allahu e mbulon atëhere çështja e tij është te Allahu nëse dëshiron e fal dhe nëse dëshiron e ndëshkon”**.¹

Përderisa këto gjynahe janë në mëshirë dhe dëshirë të Allahut atëhere nuk na lejohet të prononcohemi me siguri të plotë se filani do të ndëshkohet në zjarr. Prononcimi me siguri për një musliman se ai do të dënohet apo se është në zjarr konsiderohet ndërhyrje në punët dhe kompetencat e Allahut me padije.

Në sahihun e Muslimit transmetohet prej Xhundubit ﷺ se i dërguari i Allahut ﷻ u tregoi se një person tha: **Pasha Allahun! Allahu nuk ka për ta falë filanin! Atëhere Allahu tha: Kush është ky që betohet në emrin tim se gjasme nuk do e fal filanin?! E kam falur filanin dhe ta kam rrëzuar punën tënde”**.

Ky person humbi ahiretin dhe e futi veten në vëndin e humbjes përshkak se ndërhyri në kompetencat e Allahut padije dhe pa argument. Muslimani duhet të tregohet i edukuar me Allahun ﷻ ashtu si Isai ﷺ kur tha **«Tha: I pastër je ti! Nuk më takon mua të pretendoj atë që nuk më takon. Nëse e kam thënë ti e ke ditur atë. Ti e di se ç'ka në veten tim por unë nuk e di ç'ke ti në veten tënde sepse tij je i gjithëdituri i gajbeve»** El maide 116.

4- Çështja e katërt: A dëshmohet për një qafir të caktuar se ai është prej banorëve të zjarrit?

Nësa jeta e personit mbyllet në kufër atëhere dëshmohet se ai është qafir dhe i përjetshëm në zjarrin e xhehenemit. Këtë e themi si bindje ndaj Allahut ﷻ dhe të dërguarit të tij ﷺ dhe për të përmbushur urdhrin e Allahut ﷻ dhe të dërguarit të tij ﷺ. Është saktësuar se i dërguari i Allahut ﷻ i thirri qafirët e vrarë në betejën e Bedrit me emrat e tyre duke u thënë: **“O ju që jeni në bunar²! O Utbe ibn Rabia! O Shejbe ibn Rabia! O Umeje ibn Halef! O Ebu Xhehl ibn Hisham! Derisa i numëroi një nga një ata që ishin në bunar. A e gjetët atë që ju pati premtuar zoti juaj të vërtetë, sepse unë e gjeta atë që më premtoi zoti im të vërtetë?”**.

Në një rivajet te Buhariu thuhet: **“Nisi t'i thërriste me emrat e tyre dhe emrat e baballarëve të tyre: O filan i biri i filanit! O filan i biri i filanit! A u kënaqët që iu bindët Allahut dhe të dërguarit të tij?! Ne e gjetëm të vërtetë atë që na premtoi zoti ynë. Po ju a e gjetët të vërtetë atë që ju premtoi zoti juaj?”**.

Prej Amir ibn Saidit prej babait të tij thotë: **“Erdhi një beduin te profeti dhe i tha:**

¹ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

² I dërguari i Allahut i hodhi mushrikët e vrarë në bedër në pus.

Babai im përkujdesej për farefisën dhe ka qënë kështu e ashtu, atëhere ku është ai? I tha: Në zjarr. Mesa duket beduini u prek pak dhe i tha profetit: O i dërguar i Allahut! Po babai yt ku është? I tha: Sa herë që të kalosh pranë varrit të ndonjë qafiri përgëzoje atë me zjarr. Thotë: Më pas ky beduini u bë musliman dhe tha: Më ka ngarkuar i dërguari i Allahut ﷺ me punë të rëndë. Sa herë që kaloj pranë varrit të ndonjë qafiri e përgëzoj me zjarr”¹.

Shejh Albani, Allahu e mëshiroftë, thotë: “Prej këtij hadithi përfitohet një dobi e rëndësishme të cilën e kanë anashkaluar shumë libra të fikhut. Kjo dobi është lejimi i përgëzimit i qafirit me zjarr nëse kalon pranë varrit të tij”².

Them: Ky përgëzim lidhet me qafirin e përcaktuar. Ky hadith është argument shumë i qartë për lejimin e gjykimit me zjarr për qafirin e përcaktuar i cili vdes në kufër.

Një dyshim dhe sqarimi i tij:-

Mbase dikush mund të thotë: Gjykimi për një qafir konkret se ai është në zjarr është ndërhyrje në kompetencat e Allahut. Ky person për të cilin kemi gjykuar se është qafir dhe në zjarr a nuk është e mundur që në dijen e Allahut ﷻ të jetë besimtar dhe të hyjë në xhenet? Në këtë rast ne kemi gjykuar për një besimtar me kufër dhe kemi dëshmuar me zjarr për një banor të xhenetit.

U themi: Kjo nuk është ndërhyrje në kompetencat e Allahut për dy arsye:

E para: Dëshmia me zjarr për një qafir konkret është zbatim i urdhrave të Allahut ﷻ dhe të dërguarit të tij ﷺ. Allahu ﷻ nëpërmjet të dërguarit të tij ﷺ na ka urdhëruar ta përgëzojmë çdo qafir me zjarr. Kjo nuk është ndërhyrje në kompetencat e Allahut ﷻ sepse ndërhyrja në kompetencat e Allahut ﷻ ndodh në rast padije dhe në kundërshtim me urdhrat e Allahut ﷻ.

E dyta: Allahu ﷻ na ka treguar me argumente të qarta se gjykimi për atë që vdes në kufër është një gjykim i vetëm dhe i pandryshueshëm dhe ai është hedhja në zjarr përgjithmonë. Ne kur gjykojmë për të me zjarr kemi gjykuar me gjykimin e Allahut ﷻ me të cilin ka urdhëruar dhe na ka informuar. Kjo nuk konsiderohet hyrje në kompetencat e Allahut. Hyrja në kompetencat e Allahut ﷻ ndodh për çështje të gajbit dhe të panjohura me argument, të cilat sillen rreth faljes dhe dënimit. Ndërsa në rastin tonë çështja ka një gjykim të vetëm.

Për faktin se ai në dijen e Allahut mund të jetë besimtar që e meriton xhenetin, ne nuk qortohemi përderisa gjykimi është marrë në bazë të rregullave të sakta të shariatit. Prej këtyre rregullave është marrja në konsideratë pamja e jashtme. Pradaj një gabim i tillë nëse ndodh

¹ E transmeton Taberani. Shejh Albani ka thënë: Ky sened është i saktë. Të gjithë transmetuesit janë të besueshëm dhe të njohur. Es silsiletus sahiha, 18.

² Es silsiletus sahiha, 1/26.

ai është i falur, sepse është produkt i një ixhtihadi të drejtë. Në fund të fundit gjykimi ynë për këtë person nuk e pengon atë prej hyrjes në xhenet _nëse në dijen e Allahut është besimtar_ sepse fjala e fundit i takon vetëm Allahut.

Mbase dikush mund të thotë: Përse nguruat dhe nuk dëshmuat me xhenet për atë që në pamje të jashtme është besimtar ndërkohë që për atë që në pamje të jashtme është qafir dhe vdes i tillë nuk nguruat të dëshmoni me zjarr?

I themi: Sepse për hyrjen në xhenet është kusht që të jetë besimtar dhe musliman në pamje të jashtme dhe në brendësinë e tij. Ne njohim vetëm imanin dhe islamin e dukshëm ndërsa imanin dhe islamin e brendshëm nuk e njohim prandaj edhe ngurrojmë të dëshmojmë me xhenet.

Ndërsa ai që në dukje kryen kufër të qartë nuk ka mundësi që në brendësi të jetë besimtar. Prandaj ai konsiderohet qafir në pamje të jashtme dhe në brendësi. Këtu bën përjashtim vetëm ai që e kryen kufirin i imponuar ose në rast shtirje dhe zemrën e ka plot me iman. Një njeri i tillë zakonisht njihet dhe nuk i bëhet tekfir sepse nuk ndodh të jetojë tërë jetën i imponuar. Prandaj nëse shikohet kufri i qartë dhe nuk ka asnjë pengesë prej tekfirit atëhere veqohet siç u shpjegua më lart dhe gjykojmë me pamjen e dukshme ndërsa fshehtësitë dhe të panjohurat i kthejmë te Allahu.

5- Çështja e pestë: A i rrëzon riddja të gjitha punët e njeriut apo vdekja në kufër është parakusht për rrëzimin e punëve?

Kufri i rrëzon të gjitha punët mirëpo punët e mira të cilat i ka vepruar para kufirit mund t'i bëjnë dobi nëse nuk vdes në kufir. Murtedi nëse pendohet prej kufirit dhe rikthehet në islam atëhere i rikthehen edhe të mirat që i ka pas vepruar më parë dhe përfiton prej tyre. Argumentet prej Kuranit dhe sunetit dëshmojnë për këtë. Allahu ﷻ thotë: **﴿Kushdo prej jush që bën ridde prej fesë së tij dhe vdes qafir atyre kanë për t'iu rrëzuar të gjitha veprat në dynja dhe në ahiret. Ata janë banorët e zjarrit dhe në të do të jenë përjetësisht﴾** El bekare 217. Allahu ﷻ e kushtëzoi rrëzimin e veprave në dynja dhe ahiret me vdekjen në kufër.

Ibn Xheriri, në tefsirin e tij thotë: *“Kufizimi me fjalën (dhe vdes qafir) pra vdes para se të pendohet prej kufirit të tij sepse atyre u rrëzohen veprat”*.¹

Sheukani, në tefsirin e tij thotë: *“Prej kufizimit me fjalën (dhe vdes qafir) përfitohet se veprat e murtedit, rrëzohen nëse vdes në kufër. Dijetarët janë kudërshtuar në çështjen e riddes; a i rrëzon veprat menjëherë apo i rrëzon pas vdekjes në kufër. Në këtë rast ajetet e tjera të përgjithshme duhet t'i kufizojmë me këtë ajet”*.²

¹ Tefsiri i Ibn Xherir Taberiu, 2/367, botim i shtëpisë botuese “El kutubul ilmije”.

² Tefsiri i sheukanit “Fethul kadir”, 1/218.

Shafi'u Allahu e mëshiroftë ka thënë: “Kush bën ridde dhe kthehet në islam veprat nuk i rrëzohen dhe as haxhi të cilin e ka kryer. Mirëpo nëse vdes në ridde atëhere i rrëzohen të gjitha punët”.¹

Prej Ebi Said Hudariut ؓ thotë: I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “**Nëse robi bëhet musliman dhe islami i tij përmisohet atëhere Allahu ia shkruan si veprë të mirë çdo të mirë që ka pas punuar dhe ia fshin çdo të keqe që e ka punuar. Pas kësaj do gjykoresh me njëpërnjë; çdo e mirë shpërblehet dhjetë fish e deri shtatëfish, ndërsa e keqja dënohet sa një e vetme nëse Allahu nuk e fal**”.²

Neveviu ka thënë: “Mendimi më i saktë të cilin e kanë përqafuar edhe studiuesit e shquar aq sa disa kanë përmendur si konsensus; se qafiri nëse vepron vepra të mira si sadakaja dhe përkujdesja për farefisin e pastaj bëhet musliman dhe vdes në islam atëhere i shkruhet shpërblimi i këtyre veprave”.³

Them: Përfitimi prej veprave të cilat i ka vepruar kur ka qënë musliman është më parësor. Sindi në shpjegimin e sunenit të Nesaiut thotë: “Ky hadith dëshmon se veprat e mira të qafirëve lihen pezull, nëse bëhet musliman i pranohen e nëse jo i refuzohen. Me këtë koncept ajete si **(veprat e atyre që kënë bërë kufër janë si mirazhi)** janë të kushtëzuar me vdekjen e personit në kufër. Mesa duket nuk ekziston ndonjë argument që e kundërshton këtë”.

Shejh Albani, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: “Njësoj si ajeti të cilin e përmendi Sindiu *Allahu e mëshiroftë* janë edhe ajetet e tjera që dëshmojnë për rrëzimin e veprave për shkak të shirkut. Këto ajete shpjegohen me vdekjen e personit si mushrik. Këtu del edhe një çështje fikhu: Nëse muslimani bën haxh pastaj bëhet murted pastaj kthehet në islam; haxhi i tij nuk është rrëzuar dhe nuk e ka obligim përsëritjen e tij. Ky është medhhebi i imam Shafiut dhe një prej mendimeve të Lejth ibn Sadit. Këtë mendim e ka përzgjedhur edhe Ibn Hazmi duke e përkrahur me fjalë të bukura dhe të goditura”.⁴

Njësoj si ky hadith është edhe hadithi në dy sahihet prej Urve ibn Zubejrit se Hakim ibn Hizami ؓ i ka treguar se i tha të dërguarit të Allahut ﷺ: O i dërguar i Allahut! Çfarë thua për vepra që unë i konsideroja të mira në xhahilijet si sadakaja, lirimi i robërve, lidhja e farefisit, a kam shpërblim për to? I tha: “**Islami yt është bashkë me veprat e mira që i ke bërë mëparë**”

Ibn Hazmi thotë: “Kështu vërtetohet se murtedi nëse bëhet musliman dhe qafiri që nuk ka qënë musliman nëse bëhet musliman ata bëhen muslimanë duke iu llogaritur edhe

¹ El xhami' li ahkam el kuran, 3/48.

² E transmeton Nesaiu. Es silsiletus sahiha, 247.

³ Es silsiletus sahiha, 1/438.

⁴ Es silsiletus sahiha, 1/439.

*mirësitë që i kanë bërë mëparë”.*¹

Shejh Albani thotë: “Nëse sqarohet kjo atëhere nuk ka asnjë kontradiktë mes këtij hadithi dhe hadithit **“Qafiri shpërblehet për veprat që i ka bërë për Allahun në dynja”** sepse këtu bëhet fjalë për qafirin të cilin Allahu e ka ditur se do të vdesë në kufër, me argument fjalën e profetit ﷺ në fund të hadithit: **“Derisa kur të shkojë në ahiret nuk i mbetet asnjë e mirë për të cilën do të shpërblehet”**. Ndërsa qafiri të cilin Allahu ﷻ e ka ditur se do të bëhet musliman dhe do të vdes besimtar, ai shpërblehet në ahiret për veprat e mira që i ka bërë kur ka qënë qafir, siç përfitohet prej haditheve të mëparshme”.

Një dyshim dhe sqarimi i tij:

Disa mund të keqkuptohen dhe të thonë: Është e njohur se është kusht për pranimin e veprës të jetë kryer për hir të Allahut. Nëse është kështu atëhere si pranohet vepra e qafirit mushrik kur ka qënë në kufër dhe pastaj është bërë musliman?

U themi: Pa dyshim që Allahu ﷻ nuk e pranon asnjë vepër në të cilën ka shirk as prej qafirit e as prej muslimanit sepse Allahu ﷻ është më i panevojshmi për shirk dhe ortakë. Por qafiri mund të veprojë disa vepra të mira _siç u përmendën në hadithin e Hakim ibn Hizamit_ pa i bërë Allahut shirk në to dhe t’i veprojnë vetëm për Allahun ﷻ, siç thuhet në hadithin që e transmeton Muslimi: **“Allahu nuk i bën padrejtësi besimtarit në asnjë vepër të mirë. Për shkak të saj furnizohet në dynja dhe për të shpërblehet në ahiret. Ndërsa qafiri prej të mirave që i ka punuar për Allahun ushqehet në këtë botë derisa kur të shkojë në ahiret nuk i mbetet asnjë e mirë për të cilën shpërblehet”**.

Vështroje fjalën e profetit: **“që i ka punuar për Allahun”**. Kjo dëshmon se ai mund të veprojë vepra vetëm për Allahun ndërsa kufri i tij mund të jetë në vepra të tjera.



¹ Es silsiletus sahiha, 1/441.

² Es silsiletus sahiha, 1/441.

Rregulli i njëmbëdhjetë: Kush e bën qafir një musliman ai ka bërë kufër.

Rregulli: “Kush e bën qafir një musliman ai ka bërë kufër” është një rregull i saktë. Për të dëshmojnë shumë argumente të sakta. Prej tyre fjala e profetit ﷺ: **“Nëse njeriu bën qafir vëllain e tij ai kthehet te njëri prej tyre”**.¹

Dhe thotë: **“Kushdo që i thotë vëllait të tij: O qafir! Ai është kthyer te njëri prej tyre. Nëse është ashtu siç thotë mirë, por në të kundërt i kthehet atij”**.

Dhe thotë: **“Kush pretendon kufrin e një njeriu ose e quan atë armik të Allahut kur ai nuk është i tillë, atëhere i kthehet atij”**.

Prej Ibn Umerit ؓ thotë: I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Kushdo musliman që e shpall qafir një musliman, nëse ai vërtetë është qafir mirë por në të kundërtën ai vetë është qafir”**.²

Ibn Said Hudariu ؓ thotë: I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Sa herë që një person e shpall qafir një tjetër atëhere ai kthehet te njëri prej tyre. Nëse është qafir mirë e në të kundërt bën kufër për shkak të tekfirit të tij”**.³

Dhe thotë: **“Akuzimi i muslimanit me kufër është njësoj si vrasja e tij”**.⁴

I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Nëse njeriu i thotë vëllait të tij: O qafir! Është njësoj si vrasja e tij”**.⁵ Pra kjo është njësoj si vrasja e tij në pasoja dhe në cënimin e të drejtave të muslimanit që rrejdhet prej këtij tekfiri.

Shkaqet që shtynë për tekfirin e muslimanit janë katër:

- 1- Përgënjeshtrimi i gjykimit të Allahut.
- 2- Për shaka dhe lojë.
- 3- Interpretimi i gabuar.
- 4- Ixhtihadi i gabuar.

Kufri i përgënjeshtimit është i qartë, për shkak se ai e ka kundërshtuar gjykimin e Allahut ﷻ duke i përshkruar gjërat jo me përshkrimin që u ka dhënë Allahu ﷻ. P.sh. kur Allahu thotë për diçka se është hallall ndersa ai _pa arsye të pranueshme_ thotë: Jo kjo gjë është e ndaluar. Ose kur Allahu ﷻ thotë: Kush e vepron këtë është besimtar, ndersa ai thotë:

¹ E transmeton Muslimi.

² E transmeton Buhariu dhe Muslimi. Sahih sunen Ebi Daud, 3921.

³ E transmeton Ibn Hibani. Sahih et tergib, 2775.

⁴ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

⁵ E transmeton Bezari, Sahih et tergib, 2777.

Kush e vepron këtë ai është qafir. Pra nuk gjykon dhe nuk i përshkruan disa gjëra ashtu siç ka gjykuar dhe i ka përshkruar Allahu ﷻ duke gjykuar me kufër për imanin. Padyshim kjo është kufër dhe dalje prej islamit.

Ndërsa ai që e bën muslimanin qafir me shaka ai bën kufër sepse Allahu thotë: **«Thuaju: A me Allahun, me ajetet e tij dhe me të dërguarin e tij po talleshit?! Mos u justifikoni! Ju keni bërë kufër pas imanit tuaj. Nëse e falim një grup prej jush, e dënojmë një grup tjetër sepse ata ishin kriminelë»** Et teube 65-66. Këto ajete kanë zbritur për disa njerëz që folën me tallje dhe shaka për besimtarët me fjalë që nuk arrijnë gjynahun e tekfirit. E megjithatë ata bën kufër pas imanit të tyre. Ata thanë për besimtarët: *“Nuk kemi parë më barkmëdhenj se lexuesit tanë dhe as gënjeshtarë më të mëdhenjë dhe as më frikacakë se ata”*. Bënë kufër vetëm për shkak të kësaj fjale. Atëhere ç’mund të thuhet për atë që i akuzon besimtarët me kufër thjesht për tallje dhe shaka!? Padyshim që ata hyjnë në këtë ajet: **«Kenë bërë kufër pas imanit tuaj»**.

Më përpara e përmendëm se shakaja me fjalë kufri është kufër te rregulli “Shqiptimi i kufrit është kufër” kështuqë nuk ka nevojë ta përsërisim edhe njëherë.

Ndërsa ai që gabon në interpretim ai është gjynahqar, sepse ka folur pa dije, mirëpo ai nuk bëhet qafir sepse argumentet e shariatit na pengojnë prej bërjes qafir të një personi të caktuar për shkak të gabimit në interpretim.¹

Si puna e havarixhëve të cilët i shpallën qafirë disa sahabë dhe pasuesit e tyre prej muslimanëve dhe i shpallën qafirë muslimanët që veprojnë gjynahe të mëdha. Megjithatë sahabët nuk i shpallën ata qafirë dhe nuk i përfshinë te rregulli “Kush e bën qafir një musliman ai ka bërë kufër” edhe pse të gjithë sahabët i konsideruan gabimtarë havarixhët dhe i luftuan.

Ibn Tejmije thotë: *“Bidati i havarixhëve ishte prej bidateve më të qarta. Luftimi dhe tekfiri i umetit islam ishte shumë i qartë prej tyre. Mirëpo askush prej sahabëve nuk i shpalli qafirë. As Ali ibn Ebi Talibi ؑ dhe as ndonjë sahabi tjetër. Përkundrazi i vlerësuan ata si musliman zullumqarë dhe agresorë”*.

Gjithashtu thotë: *“Ata janë të parët që i shpallën qafirë pasuesit e kibles (umetit islam) për shkak të gjynahve, madje për shkak të atyre që ata i kujtojnë për gjynahe. Për këtë shkak e derdhën gjakun e muslimanëve dhe ishin ashtu siç i përshkroi profeti ﷺ: “I luftojnë*

¹ Në disa raste keqinterpretimi mund të konsiderohet justifikim i plotë dhe nuk merret në përgjegjësi fare. Ndërsa në disa raste të tjerë merret në përgjegjësi në disa aspekte dhe i pranohet si justifikim në disa aspekte të tjerë. P.sh. shiko se si keqinterpretimet e havarixhëve dhe dyshimet e tyre e shtynë Aliun ؑ që të mos i shpallte qafirë, mirëpo nuk e penguan atë prej luftimit, vrasjes dhe shpalljes së tyre si gjynahqarë. Ndërsa në disa raste të tjera keqinterpretimi mund të kalojë në deformim të qartë të argumenteve dhe bazave të fesë. Në këtë rast nuk i pranohet si justifikim për asgjë, si keqinterpretimet e karamitëve, batinive dhe grupeve të tjera ekstreme.

muslimanët dhe i lënë adhuruesit e idhujve”. Aliun dhe Uthmanin ﷺ me gjithë pasuesit e tyre i shpallën qafirë. Aliun ﷺ e vranë duke besuar se kjo është e lejuar. Atë e vrau Abdurrahman ibn Mulxhim Muradiu. Ata ishin shumë të zellshëm në ibadet mirëpo ishin injorantë prandaj dhe u shkëputën prej xhematit dhe sunetit”.

Havarixhët thanë: Njeriu është ose besimtar ose qafir. Besimtar është ai që i vepron të gjitha vaxhipet dhe i braktis të gjitha haramet. Ai që nuk është i tillë ai është qafir dhe do të dënohet në zjarr përgjithmonë. Pastaj e konsideruan qafir çdokënd që kundërshtoi mendimin e tyre dhe thanë: Uthmani, Aliu dhe pasuesit e tyre nuk gjykuan me atë që zbriti Allahu dhe bënë padrejtësi prandaj dhe u bënë qafirë”.¹

Ndërsa muxhtehidi që gabon në tekfirin e një muslimani me ixhtihad bazuar në argumente, rregulla dhe dispozita të sheriatit, ai është i justifikuar madje atij i takon një shpërblim sepse i dërguari i Allahut ﷻ ka thënë: **“Nëse gjykatësi bën ixhtihad dhe gabon ai ka një shpërblim”**.

Këtu hyn akuza që Umeri ﷺ i bëri Hatib ibn Beltas ﷺ se ka bërë kufër dhe nifak atëhere kur i informoi kurejshët për sekretin e marshimit të muslimanëve drejt Mekës. Madje ai i kërkoi leje profetit që ta vriste por profeti i tregoi se Hatibi ﷺ nuk është munafik dhe se zemrën e ka të pastër. Por në të njëjtën kohë nuk i tha Umerit ﷺ: Ti gjykoje mbi vëllain tënd

¹ Mexhmu’ul fetaua 7/217 7/481-482.

U përmend më parë se shubuhatet (paqartësitë) e ndryshme që ka një person arsyetohen në varësi të shkaqeve të tyre dhe në varësi të pranimit të tyre në shariat. Nëse këto paqartësi janë pa shkaqe dhe pa arsye të pranueshme në shariat dhe argumentet e sheriatit janë të qarta dhe nuk lënë vend për dyshim, atëhere këto dyshime dhe paqartësi nuk justifikohen dhe gjykimi i përgjithshëm me kufër zbatohet mbi këtë person. Bazuar në këtë koncept dijetarët islam janë kundërshtuar për kufrin e havarixhëve dhe atyre që u ngjasojnë atyre. Disa prej tyre nuk i kanë konsideruar ata qafirë por muslimanë zullumqarë. Ndërsa disa të tjerë i kanë konsideruar ata qafirë të dalë prej islamit. Gjykimi rreth tyre lidhet me shqyrtimin që këta dijetarë u kanë bërë dyshimeve dhe paqartësive të havarixhëve dhe se a konsiderohen këto paqartësi pengesë prej tekfirit të tyre dhe vlejné si justifikim për ta apo jo?

Ibn Tejmije në Mexhmu’ul fetaua (28/518) thotë: “Dijetarët janë ndarë në dy mendime të njohura në medhhebin e Malikut dhe Ahmedit rreth tekfirit të havarixhëve. Gjithashtu edhe në medhhebin e Shafiut jepen dy mendime për kufrin e tyre. Në medhhebin hambeli ka dy mendime të përhapura: I pari se ata janë rebelë (bugatë) ndërsa i dyti se ata janë qafirë njësoj si murtedët dhe lejohet që t’u shpallim luftë nga ana jonë dhe lejohet vrasja e robërve të tyre dhe lejohet ndjekja e të arratisurve të tyre. Nëse kapen u kërkohet teube njësoj si murtedi e nëse nuk pendohen vriten ...”.

Deri kur thotë: “...Prej fjalës së Aliut ﷺ kuptohet se ata nuk janë qafirë si murtedët që kanë kundërshtuar thelbin e islamit. Ky mendim është transmetuar qartë prej imamëve si Ahmedi dhe të tjerë. E megjithatë ata nuk janë njësoj si pjesmarrësit në “El xhemel” dhe “Safin” por ata janë një lloj i tretë. Ky është mendimi më i saktë prej të tre mendimeve”.

Them: Havarixhët dhe sorollapi i tyre prej bidatçive janë në grada të ndryshme dhe paqartësitë e tyre variojnë në llojin dhe gradën e tyre. Ata janë në grada të ndryshme devijimi dhe çdo rast ka specifikën e tij ashtu siç çdo person prej tyre ka gjykim të veçantë në varësi të llojit dhe gradës së dyshimeve dhe paqartësive të tij.

Por përgjithësisht mund të themi: Nëse kushtet e tekfirit përmbushen te një person konkret dhe bien pengesat që pengojnë prej tekfirit të tij atëhere ai shpallet qafir me përcaktim qoftë ai prej havarixhëve apo çfardo grupi tjetër sepse pasimi i havarixhëve nuk është pengesë prej tekfirit nëse plotësohen kushtet dhe shkaqet e tij.

musliman se është qafir dhe munafik, prandaj kufri dhe nifaku të kthehen ty. Nuk i tha kështu sepse Umeri ؓ u bazua në një ixhtihad të lejuar.

Këtu hyn edhe leja që Halid ibn Velidi ؓ i kërkoi profetit ﷺ për të vrarë personin _sepse e konsideroi munafik_ që i tha profetit ﷺ: Frikësoju Allahut! Profeti ﷺ e ndaloi dhe i tha: **“Mbase ai falet. Unë nuk jam urdhëruar të gërmojë zemrat e njerëzve dhe as të hap gjokset e tyre”**. Mirëpo nuk i tha Halidit ؓ: Gjykimi që pate për këtë person është kthyer mbi ty.

Këtu hyn edhe fjala e Usejd ibn Hudejrit ؓ drejtura Sad ibn Ubades ؓ përpara syve të profetit ﷺ atëhere kur Sadi ؓ u mundua të mbronte kokën e munafikëve Ibn Ubejin. Usejdi ؓ i tha: Ti je munafik dhe u del në krah munafikëve. Mirëpo profeti ﷺ nuk i tha Usejdit: Gjykimi me nifak të është kthyer ty, sepse ai në këtë fjalë u bazua në ixhtihad.

Edhe mendimi që sahabët dhanë fillimisht për keqinterpretuesit e ndalimit të verës dhe e lejuan atë. I pari i tyre ishte Abdullah ibn Medhuni, prej pjesmarrësve të Bedrit. Atëhere Umeri ؓ u kërkoi sahabëve një mendim rreth ta dhe ata i thanë: O emirulmuminin! Mendojmë se ata kanë përgënjeshtuar Allahun ﷻ dhe kanë ligjëruar në fe atë që Allahu ﷻ nuk e ka lejuar, prandaj pritua kokat. Kjo nënkupton se ata gjykuan mbi ta me kufër dhe ridde. Por e vërteta ishte në krahun e Aliut ؓ me të cilën më pas u pajtuan edhe sahabët; se atyre duhej t’u kërkohet pendimi; e nëse do të pendoheshin duhej të dënoheshin me 80 kamzhikë përshkak se kanë pirë verë; e nëse nuk do të pendoheshin duhej të vriteshin sepse kanë ligjëruar në fe atë që nuk e ka lejuar Allahu ﷻ.

Sahabët që fillimisht gjykuan për ta me kufër nuk mund të themi: Tekfiri i tyre iu është kthyer atyre sepse kanë bërë qafir një musliman pashkak; sepse gjykimi i tyre ishte i bazuar në ixhtihad.

Këtu hyn edhe tekfiri që dijetarët i kanë bërë havarixhëve. Nuk lejohet të themi për këta dijetarë se ata kanë bërë muslimanët qafirë dhe ai që e bën muslimanin qafir ai ka bërë kufër, sepse qëndrimi i tyre është bazuar në ixhtihad dhe është ngritur mbi rregulla dhe argumente fetare.

Apo kundërshtimi për lënësin e namazit dhe shtyllave të tjera të fesë. Ai që nuk gjykon me kufirin e tyre nuk lejohet t’u thotë atyre që gjykojnë me kufirin e tyre: Ju keni shpallur muslimanët qafirë dhe ai që e shpall një musliman qafir ka bërë kufër dhe kufri ju kthehet juve, sepse gjykimi i tyre është bazuar në ixhtihad dhe në baza fetare të pranuar. Nëse kanë gabuar, shpërblehen për këtë ixhtihad të tyre me një shpërblim dhe Allahu është më i ditur.

Vërejtje:-

Ky rregull zbatohet për ata njerëz që i bëjnë tekfir muslimanëve pa përjashtim, si ai që

thotë: Muslimanët janë qafirë, ose: të gjithë muslimanët janë qafirë. Kjo fjalë është kufër dhe me të shprehet vetëm një qafir smirëzi. Kjo fjalë është kufër sepse:

- Tekfiri i të gjithë muslimanëve dhe konsiderimi i tyre të humbur papërrjashtim buron vetëm prej atij që i urren muslimanët. Nuk mund të përfytyrohet një person që i bën tekfir të gjithë muslimanëve të botës dhe pastaj e pëlqen fenë e tyre. Allahu ﷻ thotë: **﴿Ata që vepruan krime i përqeshnin besimtarët dhe kur kalonin pranë tyre bënë me shenja dhe kur ktheheshin te familjet e tyre ktheheshin gjithë gëzim dhe kur i shikonin ata thoshin: Këta janë të humbur. Ne nuk i kemi pas dërguar rojtarë të tyre. Por sot besimtarët do i përqeshin qafirët﴾** El mutafifin 29-34. Pra ata bënë kufër dhe faj të madh atëhere kur thanë për besimtarët: (Këta janë të humbur). Po ai që thotë: Këta janë qafirë. Padyshim se faji i tij është më i madh. Ibn Hazmi në “El milel uen nihil” (3/237) thotë: *“Nuk ka dyshim se ai që i akuzon të gjithë muslimanët dhe i lufton ata për shkak të islamit të tyre ai është qafir”*.
- Tekfiri i të gjithë muslimanëve papërrjashtim bie në kundërshtim me dhjetra argumente që dëshmojnë se ky umet nuk do të bjerë i gjithi në humbje dhe se Allahu ﷻ do ta ruaj fenë e tij nëpërmjet një grupi që do të jetë në të drejtën deri në ditën e gjykimit. Pra tekfiri i të gjithë muslimanëve papërrjashtim nënkupton mohimin e këtyre argumenteve.
- Tekfiri i të gjithë muslimanëve papërrjashtim nënkupton që njeriu të braktisë akiden e miqësimin të besimtarëve dhe armiqësimin të qafirëve, sepse si mund t’i dojë muslimanët kur ka gjykuar me kufirin e tyre?!!

Shkurtimisht themi: Ky rregull “Kush e bën qafir një musliman ai ka bërë kufër” është rregull i saktë mirëpo ai ka kushtet dhe kufizimet e tij dhe varet sipas realitetit të atij që jep gjykimin dhe atij për të cilin jepet gjykimi.

Prandaj ai që dëshiron të zbatojë këtë rregull për persona konkretë duhet patjetër të ndjekë përjashtimet e mësipërme dhe të mos e zbatojë këtë rregull vend e pavend, që të mos bjerë në tekfirin e vëllezërve të tij muslimanë dhe sidomos në tekfirin e thirrësve dhe dijetarëve pa e kuptuar.



Rregulli i dymbëdhjetë: Kush nuk e bën qafir qafirin ose dyshon në kufrin e tij ai ka bërë kufër.

Ashtu siç është tekfiri i muslimanit një gabim shumë i madh po ashtu edhe mos bërja qafir e qafirit ose dyshimi në kufrin e tij konsiderohet gabim dhe rrezik i madh. Ashtu siç duhet të ruhet muslimani prej bërjes qafir të muslimanëve gjithashtu duhet të ruhem i mosbërjes qafir të qafirit.

Rregulli “Kush nuk e bën qafir qafirin ose dyshon në kufrin e tij ai ka bërë kufër” është rregull i saktë për të cilin dëshmojnë argumente fetare. Dijetarët e kanë konsideruar atë prej gjërave që prishin islamin dhe e nxjerrin njeriun prej tij.

Allahu thotë: **﴿Thuaj: O pabesimtarë (qafirë)﴾** El kafirun¹. Pra Allahu na ka urdhëruar t’u drejtohem atyre me këtë emër pa hezitim dhe pa treguar dobësi por t’u themi: (O pabesimtarë).

Allahu thotë: **﴿Keni pasur shembullin më të mirë të Ibrahimit dhe ata që ishin me të, kur u thanë popullit të tyre: Ne jemi distancuar prej jush dhe prej asaj që adhuroni përveç Allahut. Ju kemi kundërshtuar ju dhe mes nesh dhe mes jush është shfaqur armiqësia dhe urrejtja përgjithmonë derisa të besoni në Allahun një dhe të vetëm﴾** El mumtehine 4.

Prandaj duhet t’u drejtohem me këto shprehje: Ne jemi të distancuar prej jush dhe prej asaj që e adhuroni përveç Allahut. Ju kemi kundërshtuar ju dhe mes nesh dhe mes jush ka filluar armiqësia dhe urrejtja përgjithmonë derisa të besoni në Allahun një dhe të vetëm. Vetëm kështu plotësohet teuhidi dhe kushtet e tij.

Shejh Muhamed ibn Abdulvehabi thotë: “Ai që nuk i shpall qafirë mushrikët ose dyshon në kufrin e tyre ose e saktëson medhhebin e tyre ai ka bërë kufër me ixhma”.¹

Vështoroje fjalën e tij: “Ka bërë kufër me ixhma”, kjo nënkupton se nuk ka kundërshtime mes dijetarëve për saktësinë e këtij rregulli.

Dhe thotë: “Njeriu nuk bëhet njësuës i Allahut derisa ta mohojë shirkun dhe të distancohet prej tij dhe ta konsiderojë qafir atë që e vepron atë”

Dhe thotë: “Tërheqja vërejtje prej shirkut në adhurimin e Allahut dhe qortimi i ashpër rreth kësaj dhe armiqësia për shkak të tij dhe tekfiri i atij që e vepron atë. Teuhidi plotësohet vetëm me këto që përmendëm dhe kjo është feja e profetëve...” derisa thotë: “... Allahu i ka cilësuar mushrikët me kufër në ajete të shumtë prandaj duhet patjetër t’i shpallim

¹ Letrat personale, Er resail shehsije, fq. 213.

ata qafirë. Kjo është kusht i fjalës “La ilahe il-lallah”, fjalës së sinqeritetit. Kuptimi i kësaj fjale plotësohet vetëm me tekfirin e atij që i bën shirk Allahut ﷻ në adhurim, siç thuhet në hadithin e saktë: **“Kush thotë “La ilahe il-lallah” dhe bën kufër me atë që adhurohet përveç Allahut pasuria dhe jeta e tij janë të mbrojtura dhe llogaria e tij është para Allahut”**. Fjala “bën kufër me atë që adhurohet përveç Allahut” është përforcim për mohimin e çdo të adhuruari tjetër përveç Allahut ﷻ në dëshminë e teuhidit. Pra njeriut nuk i mbrohet jeta dhe pasuria derisa të veprojë kështu. Por nëse dyshon ose lëkundet atëhere nuk i mbrohet as jeta dhe as pasuria. Këto gjëra janë plotësuese të teuhidit sepse fjala “Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut” është kufizuar në disa hadithe me kushte të rënda të cilat janë: Dija, pastrimi i adhurimit, sinqeriteti, bindja e plotë dhe mosdysshimi. Njeriu nuk konsiderohet njësuës (muvehid) derisa t’i veprojë, t’i besojë, t’i pranohet dhe t’i dojë të gjitha këto gjëra dhe të përkahë dhe urrejë për shkak të tyre”.¹

Nipi i tij shejh Sulejmani në broshurën e tij “Kapja më e fortë e imanit” thotë: “Nëse dyshon në kufrin e tyre ose është i paditur atëhere i sqarohen argumentet prej Kuranit dhe sunetit për kufrin e tyre. E nëse prap vazhdon të dyshojë atëhere bëhet qafir me pajtimin e të gjithë dijetarëve sepse ai që dyshon në kufrin e qafirëve ai është qafir edhe nëse thotë: Qafirët e tjerë janë qafirë mirëpo këta njerëz nuk janë qafirë. Kjo nënkupton që ai i ka konsideruar ata muslimanë sepse nuk ka ndonjë gjë të ndërmjetme mes kufrin dhe islamit. Nëse nuk janë qafirë atëhere i bie që të jenë musliman. Atëhere i bie që të kemi quajtur kufrin islam dhe ai që i konsideron qafirët për muslimanë ai është qafir, prandaj ky person (që nuk i bën qafirët qafirë) është qafir”.²

Shejh Muhamed ibn Sehnuni thotë: “Të gjithë dijetarët janë pajtuar në një mendje se ai që shan dhe fyen profetin ﷺ ai është qafir, madje kush dyshon në kufrin ose dënimin e tij ai ka bërë kufër”.³

Shkak i kufrin të tij është sepse ai që nuk e bën qafirin qafir ai nuk i ka quajtur gjërat ashtu siç i ka quajtur sheriati por ka gënjyer për to në kundërshtim me gjykimin e Allahut ﷻ. Ai e ka konsideruar kufrin dhe shirkun për islam dhe iman ndërsa mushrikët dhe qafirët që duhen urreyer i ka marrë për muslimanë të cilët duhen dashur dhe e meritojnë të hyjnë në xhenet. Kjo konsiderohet kundërvendje ndaj Allahut ﷻ dhe refuzim i gjykimit të tij. Kjo është mohim dhe përgënjeshtrim i urdhrave të Allahut ﷻ edhe nëse personi në fjalë nuk e pranon se ka përgënjeshtruar.

Shembulli i tij është i njëjtë me atë që përpiqet të imitojë sheriatin e Allahu duke vendosur ligje që e kundërshtojnë sheriatin. Allahu e ka përshkruar kufrin me disa cilësi të cilat nëse gjenden te një person ai konsiderohet qafir dhe mushrik në fenë e Allahut, ndërsa

¹ Mexhmu’ul teuhid, fq. 34-35.

² Marrë prej “Mexhmu’ul teuhid”.

³ Ikfarul mulhidin, fq. 64.

ky person vjen e na thotë: Absolutisht! Këto cilësi nuk janë cilësi të kufrit dhe ai që përshkruhet me këto cilësi nuk është qafir përkundrazi është besimtar i cilit duhet dashur dhe e meriton të hyjë në xhenet.

Padyshim, kjo është prej kufrit të qartë dhe përgënjeshtimit të hapur për të cilin kemi argument prej librit të Allahut ﷻ dhe sunetit të profetit ﷺ.

Vërejtje:-

Ky rregull nuk duhet përgjithsuar dhe nuk duhet të përfshijë çdokënd që nuk e bën qafir qafirin; sepse mund të ndodhë që nuk e bën qafir qafirin bazuar në ixhtihad apo në ndonjë keqinterpretim, ose për shkak të padijes së justifikuar. Këta persona kanë gjykim tjetër. Në vijim po japim një shpjegim më të gjerë:

1- Ai që nuk e bën qafir qafirin bazuar në ixhtihad apo në interpretim të pranuar:

Këtu hyjnë ata dijetarë që nuk e konsiderojnë qafir lënësin e namazit¹, ose kundërshtimi rreth konsiderimit qafir të disa grupeve të humbur si havarixhët dhe mutezilitë. Askush prej dijetarëve që gjykojnë për këto grupe se janë grupe qafire nuk e ka zbatuar rregullin “Kush nuk e bën qafirin qafir ai është qafir” mbi ata dijetarë që nuk gjykojnë me kufirin e këtyre grupeve. Kjo sepse ata dijetarë nuk i kanë shpallur qafirë këto grupe bazuar në ixhtihad dhe interpretim dhe siç dihet prej sunetit nëse muxhtehidi ia qëllon, atij i takojnë dy shpërblime, e nëse gabon i takon vetëm një shpërblim.

Këtu hyn edhe kundërshtimi i dijetarëve rreth kufrit të Haxhaxhit. Shabiu ka pas thënë: “*Dëshmoj se ai është besimtar me tagutin dhe qafir për Allahun*”.

Tausi ka thënë: “*Çuditë me vëllezërit tanë irakian se si e quajnë Haxhaxhin besimtar*”.

Tausi i konsideroi për vëllezër dijetarët irakian që e kundërshtonin, sepse ai e dinte që ata kishin bërë ixhtihad dhe se tiraninë e Haxhaxhit që e kishte parë Tausi e cila e shtyu ta shpallte qafir mund të mos e kishin parë dijetarët e Irakut.

Këto koncepte duhet të jenë të qarta dhe të përfitojmë prej tyre. Shumë herë jam dëshpërohesha me vëllezër të cilët binin në kundërshtim rreth tekfirit për një person të caktuar, secili sipas argumenteve që i shikon më të sakta. Mirëpo debati vazhdonte derisa përfundonte në bërjen tekfir të atyre që nuk e bëjnë tekfir atë person dhe si pasojë e këtij tekfiri vjen edhe miqësimi, armiqësimi dhe bojkotimi i njëri-tjetrit, i cili është fitne më e

¹ Mendimin të cilin besojmë se është më i sakti është: ai që e lë namazin totalisht ai është qafir dhe ka bërë kufër të madh që të nxjerr prej islamit edhe nëse me gojë pretendon se e beson që namazi nuk duhet lënë sepse është vaxhip. Këtë çështje e kemi sqaruar me gjithë argumentet e saj në një librin “Dispozita e lënësit të namazit”.

madhe se vetë kundërshtimi i parë. Shkak i gjithë kësaj është përdorimi i gabuar i këtij rregulli dhe përdorimi i tij jo në vendin dhe rastet e duhura.

Vërejtje:

Kundërshtimet mund të pranohen për disa persona realiteti i të cilëve mund të jenë i diskutueshëm sepse kufri i tyre nuk është shumë i qartë dhe ka paqartësi. Mirëpo kundërshtimet dhe ixhtihadi nuk mund të pranohen në kufrin e tagutëve të cilët i kanë mbledhur të gjitha llojet e kufrit dhe kufri i tyre është i qartë për dijetarët dhe për njerëzit e thjeshtë dhe është më i qartë se dielli në mes të ditës.

Prandaj themi: Kush përpiqet të bëj ixhtihad _duke ditur që ixhtihadi nuk lejohet kur përplasat me tekset e qarta të shariatit_ dhe debatton për t'i përfshirë në rrethin e islamit këta tagutë dhe i cilëson ata me cilësitë e islamit dhe imanit ai konsiderohet si mik dhe përkrahës i tyre kundër islamit dhe muslimanëve dhe ai është pasues i këtyre tagutëve edhe nëse pretendon se është prej muslimanëve sepse Allahu ﷻ thotë: **«e kush i miqëson ata prej jush ai është prej tyre»** El Maide, 51. Rregulli i mësipërm zbatohet mbi këta persona të cilët debatojnë për të kotën dhe u mbajnë anën pabesitarëve, mushrikëve dhe zullumqarëve.

Kundërshtimi është i pranueshëm rreth kufrit të diskutueshëm, për personin i cili e shfaq imanin në disa aspekte mirëpo në anën tjetër shfaq gjëra që e kundërshtojnë imanin, ose herë shfaq imanin e herë shfaq të kundërtën, prandaj çështja e tij është e paqartë. Kjo çështje mund të ndodhë madje ka ndodhur shpesh.

Ndërsa kundërshtimi rreth atij që vepron kufër shumë të qartë për të cilin kemi argumente të qarta dhe të prera nga libri i Allahut ﷻ dhe suneti i profetit ﷺ, është i papranueshëm dhe refuzohet.

2- Ai që nuk e bën qafir qafirin për shkak të padijes dhe jo prej kryeneçësisë apo për shkak të kundërshtimit të shariatit. Këta persona janë dy llojesh:

a- I padituri i cili nuk i dallon gjërat që e rrëzojnë imanin ose disa prej tyre. P.sh. nëse dikush vepron ndonjë vepër që e rrëzon islamin ai e kujton atë person për musliman për shkak se nuk e di se ajo gjë të nxjerr prej islamit. Një person i tillë justifikohet me padijen e tij nëse kjo padije është përshkak se është akoma i ri në islam apo jeton në një vend larg dijes dhe ai nuk ka mundësi të dalë jashtë vendit të tij për të mësuar këtë dije. Mirëpo nëse jeton në vendin e muslimanëve ku mbizotron dija e shariatit dhe e ka të lehtë të kërkojë dhe të mësojë mirëpo për shkak të hutimit pas dunjasë dhe bukurive të saj e lë pasdore këtë dije atëhere ai nuk justifikohet për padijen e tij.

Këtë çështje e cekëm më përpara dhe e kemi sqaruar më gjerësisht në librin tonë “Justifikimi me padije dhe ngritja e huxhes”.

b- I paditur për realitetin e pabesimtarit. P.sh. nëse nuk e njeh personin në fjalë dhe prandaj nuk gjykon dot për të, ose e njeh atë por nuk e di që ai ka vepruar diçka që të nxjerr nga islami. Një person i tillë justifikohet me padijen e tij derisa t'i bëhet i njohur realiteti i atij pabesimtari me fakte të sigurta. E nëse pas këtyre fakteve nuk e konsideron atë pabesimtar atëhere konsiderohet qafir dhe për këtë lloj njeriu zbatohet rregulli: “Kush nuk e bën qafir qafirin ose dyshon në kufirin e tij ai ka bërë kufër”.

Këtu tërheqim vërejtjen se ka dallim mes një pabesimtari të panjohur që jeton jetën e tij pa pasur ndonjë ndikim në shoqëri dhe në jetën e njerëzve, dhe mes një pabesimtari fitnia e të cilit është përhapur mes njerëzve dhe shfaqet haptas para njerëzve me kufirin dhe fitnen e tij duke i sprovuar njerëzit në fenë e tyre dhe duke përhapur çrregullim në tokë.

Mosnjohja e realitetit të personit të parë është shumë normale dhe nuk është kusht që të njihet madje më e mira është të mos gjurmohet dhe të mos humbë kohën pas tyre sepse nuk ka ndonjë dëm në fe ose në dynja.

Ndërsa mosnjohja e realitetit të personit tjetër me cilësitë e përmendura është anormale sidomos prej muslimanëve me dije dhe pozitë, sepse mosnjohja e kufirit të tij çon në përhapjen e çrregullimit, fitnes dhe humbjes të cilën vetëm Allahu e di.

Prandaj themi: Çdo pabesimtar fitnia e të cilit është përhapur shumë ndër njerëz duhet që muslimanët e ditur ta demaskojnë dhe t'ua sqarojnë njerëzve dhe të sqarojnë gjykimin e Allahut në lidhje me këta persona në mënyrë që njerëzit të largohen dhe të ruhen prej tij dhe për të përmbushur detyrën që ua ka caktuar sheriati (për sqarimin e të vërtetës).

Heshtja në këtë rast është e papranueshme sepse ajo konsiderohet tradhti ndaj Allahut, profetit ﷺ dhe besimtarëve. Allahu ﷻ thotë: **﴿Kështu i sqarojmë ajetet në mënyrë që të sqarohet rruga e keqbërësve﴾** El enam 55. Demaskimi i keqbërësve dhe sqarimi i gjykimit të Allahut ﷻ për ta është një formë prej formave të sqarimit të rrugës së tyre.

Prej Ibn Mesudit ؒ thotë: I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Allahu, në ditën e gjykimit ka për t'i veshur frerë zjarri kujdo që i ka dhënë një dije por ai e ka fshehur”**.¹

Pyetje që lidhen me këtë rregull.

U jam përgjigjur disa pyetjeve që lidhen me këtë rregull dhe po i paraqes këtu për të përfituar.

Pyetja e parë: Shejh i nderuar! Çfarë mendoni për çështjen e konsiderimit qafir të personave të cilët aderojnë në parti murtede. A mendoni se pengesat e tekfirit i përfshijnë edhe ata që aderojnë dhe luftojnë në rradhët e murtedëve apo jo?

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Partitë murtede në kohën e

¹ E transmeton Taberani, Sahihul xhami, 2714.

sotme kanë divergjenca dhe nuk janë në një gradë të vetme përsa i takon qartësisë së kufrit dhe praktikimit të tij. P.sh. ka dallim mes partisë komuniste ideologjia e të cilës bazohet mbi ateizmin dhe luftimin e fesë dhe mohimin e Allahut dhe mes një partie murtede tjetër që e ka përzier të vërtetën me të kotën dhe që beson me një pjesë të Kuranit dhe e hedh poshtë një pjesë tjetër dhe që thërret për moral të lartë dhe ndalon prej veprave të ulta dhe propagandon për lirin e atdheut ... etj.

Ai që aderon në partinë komuniste nuk justifikohet me padijen e tij dhe as me ndonjë pengesë tjetër prej pengesave të tekfirit dhe konsiderohet qafir me përcaktim, sidomos nese arrin deri aty sa të luftojë ne rradhët e tyre kundër besimtarëve dhe njësuësve. Kjo në dallim me një parti tjetër në të cilën mund të ketë elementë të humbur të cilët aderojnë në të. Në këtë rast justifikimi i tyre është më i pranueshëm dhe nuk shpallen qafirë me përcaktim vetëm atëhere kur t'u jetë ngritur argumenti i sheriatit i cili e largon padijen për shkak të së cilës ata kanë aderuar në këtë apo atë parti, e sidomos nëse ata janë prej namazlive që i drejtohen kibles së muslimanëve.

Me fjalë të tjera sa më i rëndë, i pastër dhe i qartë të jetë kufri i partisë murtede aq më shumë ngushtohet rrethi i justifikimit të tyre dhe shpallen qafirë me përcaktim. E sa më i paqartë dhe i fshehtë të jetë kufri i partisë murtede aq më shumë zgjerohet edhe rrethi i justifikimeve penguese prej shpalljes së tyre si qafirë, derisa t'u ngrihet argumenti i sheriatit prej thirrjes profetike sidomos nëse janë prej namazlive dhe masës së gjerë.

Fjala se: **“Çdokush që aderon në një këto parti është qafir me përcaktim dhe nuk justifikohet me asnjë lloj pengese prej pengesave të kufrit”** nuk është e drejtë dhe e goditur. Po ashtu edhe mendimi i atij që thotë se të gjithë ata që aderojnë në partitë e kufrit janë të justifikuar me pengesat e tekfirit dhe se duhet patjetër t'u ngrihet argumenti para se të shpallen qafirë, edhe kjo fjalë nuk është e drejtë dhe as e goditur.

Mendimin që e shohim si të drejtë është se këtu ka dallim mes një personi dhe një personi tjetër, mes një partie dhe një partie tjetër, siç u përmend në fillim të pyetjes, dhe Allahu është më i ditur.

Pyetja e dytë: Një vëlla thotë se të krishterët në perëndim janë të humbur dhe qafirë përgjithësisht mirëpo pastaj thotë: Ai nuk e shpall një të krishter qafir me përcaktim derisa t'i ngrejë argumentin ose derisa të bëjë kufër prej kryeneçësisë, e në të kundërt nuk i shpall ata qafirë. Me çfarë e këshilloni këtë vëlla dhe çfarë është dispozita për atë që thotë fjalë të tilla? Allahu ju shpërbleftë me të mira.

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Të krishterët janë qafirë kudo që të jenë, bazuar në argumente të prerë nga Kurani: **«kanë bërë kufër ata që thanë: Allahu është mesihu i biri i Merjemit»** dhe ajeti: **«Kanë bërë kufër ata që thanë: Allahu është një prej të treve, mirëpo ilahu është vetëm një ilah i vetëm»**.

Ai që nuk i konsideron ata qafirë ka refuzuar Kuranin dhe ka përgënjeshtur Allahun ﷻ. Ky është kufër i pastër. Për të tillë persona praktikohet rregulli i njohur: Kush nuk e konsideron qafirin qafir ai ka bërë kufër.

Nëse ky shoku juaj nuk i shpall qafirë të krishterët me përcaktim a mos i konsideron vallë si muslimanë?! Njeriu nëse nuk është musliman ai është qafir e nëse nuk është qafir është musliman. Këtu nuk kemi një mundësi të tretë. Nëse nuk i konsideron ata qafirë me përcaktim atëhere kjo nënkupton që ai i konsideron ata muslimanë dhe ky është një lloj kufri tjetër sepse ai e quan kufrin dhe shirkun (e të krishterëve) si islam.

Unë e këshilloj që t'i ruhet Allahut dhe të mos flasë pa dije dhe të kërkojë diturinë dhe të pyesë nëse nuk di sepse kurimi i injorancës është pyetja e dijetarëve siç thotë Allahu ﷻ: **﴿pyesni dijetërit nëse nuk dini﴾**.

Pyetja e tretë: A është obligim ngritja e argumentit ndaj tagutëve qeveritarë bashkohorë përpara se të gjykojmë mbi ta me kufër?

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Ngritja e argumentit është obligim atëhere kur personi gabon për shkak të padijes që nuk e shmang dot. Ndërsa tagutët për të cilët po pyet nuk janë të tillë përkundrazi ata janë prej njohësave më të mirë të fesë prandaj dhe dinë t'i planifikojnë shumë mirë planet për luftimin e islamit sepse ata janë eksperta për fenë dhe e dinë mirë rrezikshmërinë e fesë ndaj tyre.

Ai që vendos si kusht ngritjen e argumentit ndaj tagutëve është një injorant që vetë ka nevojë t'i ngrihet argumenti.

Pyetja e katërt: Te xehmitë e kohës sonë mbizotëron mendimi se kurrresi nuk mund t'i bëhet tekfir një personi të caktuar përderisa nuk plotësohen kushtet dhe largohen pengesat (e tekfirit) qoftë kjo në bazat e fesë apo në degët e saj. Ata ia mveshin këtë rregull imamëve të thirrjes selefiste si puna e Ibn Tejmijes, Ibn Kajimit, Muhamed ibn Abdulvehait. Sa i vërtetë është ky rregull dhe përkatësia e tij. Ju vëmë në dijeni se nuk kemi pasur mundësi t'i gjejmë dy librat tuaj: Justifikimi me padije dhe rregulla në tekfir.

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Personi i caktuar ose është jo musliman ose është musliman. Nëse nuk është prej muslimanëve shpallet qafir me përcaktim dhe nuk lejohet të mos dëshmojmë për kufrin e tij dhe të hezitohet. Mirëpo nuk dëshmojmë se ai është në zjarr derisa t'i arrijë thirrja profetike dhe thirrja profetike arrin atëhere kur i jepen argumente të mjaftueshme se Muhamedi ﷺ është i dërguar i Allahut për te njerëzit dhe se Allahu ﷻ e ka dërguar atë me dëshminë e teuhidit.

Por nëse është musliman dhe pastaj bie në kufër me vepra ose fjalë ose në besim,

atëhere shikohet nëse është prej të justifikuarve (që ndryshe quhen edhe pengesat e tekfirit) _justifikimi është pamundësia prej të cilës nuk shpëton dot prandaj dhe bie në gabim qoftë ky gabim edhe në gradën e kufrit_ atëhere nuk shpallet qafir përveçese nëse i sqarohet e verteta me argumente të cilat ia largojnë pamundësinë që e pengonte nga njohja e të vërtetës. Këto quhen ndryshe edhe kushtet e tekfirit. Këtu nuk ka dallim mes bazave dhe çështjeve të detajuara të fesë.

Mirëpo nëse bie në kufër jo për shkak të pamundësisë për njohjen e të vërtetës _pra pa ndonjë justifikim të pranueshëm_ dhe ka mundësi që ta largojë këtë pamundësi por për shkak të dynjasë dhe hutimit pas saj nuk i kushton shumë rëndësi, atëhere një person i tillë ka rënë në kufër të qartë dhe shpallet qafir sepse në rastin e tij pengesat e tekfirit janë larguar.

Shprehja: “Shpallja qafir e një personi të cakuar kryhet pas përmbushjes së kushteve dhe largimit të pengesave” është e vërtetë, por shpeshherë nuk praktikohet në mënyrën e duhur. Shumë njerëz fshihen pas kësaj shprehje për të mbrojtur të kotën kur vjen fjala për tagutët dhe kokat e kufrit të cilët janë më të informuar se edhe vetë Iblisi !!

Përshkak të përgjithshmërisë së kësaj shprehje shumë njerëz, për të mbrojtur mendimet e sëmura të murxhiave, e deformojnë kuptimin që dijetarët i kanë dhënë asaj në librat e tyre.

Përsa i takon dallimit që bëhet mes bazave dhe degëve të fesë u sqarua më parë se nuk ka dallim mes tyre dhe selefët nuk kanë pas bërë dallim mes tyre përsa i takon justifikimit.

Edhe fjala e atyre dijetarëve që kanë bërë dallim mes tyre dhe se justifikimi në bazat e fesë është i papranueshëm sepse njohja e tyre është përhapur në të gjithë skajet e botës dhe se njohja e tyre është kollaj për të gjithë ata që e kërkojnë të vërtetën, prandaj ata që bien në kufër dhe shirk nuk justifikohen, jo sepse ai ka rënë në kufër apo në shirk por sepse ai ka rënë në kufër atëhere kur i ka të gjitha kushtet që ta largojë pamundësinë e tij.

Prandaj këta dijetarë e justifikojnë njeriun në çështjet që lidhen me degët e fesë sepse është e pamundur njohja e të gjithë detajeve të fesë, por nuk justifikojnë në bazat e fesë dhe në çështjet e mirënjohura nga të gjithë sepse pamundësia e mosnjohjes së këtyre bazave dhe çështjeve të mirënjohura nuk ekziston. Kushdo që dëshiron t'i mësojë ato i mëson sepse dija e tyre është e lehtësuar për të gjithë dhe injoranca rreth këtyre çështjeve është produkt i neglizhencës dhe jo pamundësi që nuk mund të shmanget.

Kjo nënkupton se: Nëse përmbushen rrethanat dhe kushtet e pamundësisë që pengon për njohjen e të vërtetës _qoftë ajo edhe në bazat e fesë_ atëhere patjetër duhet të justifikohen sepse Allahu ﷻ thotë: **﴿Allahu nuk ngarkon askënd me atë që nuk ka mundësi﴾**, dhe thotë: **﴿Ruajuni prej Allahut aq sa të keni mundësi﴾**.

Shafi'u ka thënë: “Allahu e njeh atë që ka mundësi dhe vepron aq sa ka mundësi prandaj edhe e shpërblen dhe atë që ka mundësi por nuk e vepron atë që ka mundësi prandaj

dhe e dënon. Allahu e dënon atë sepse nuk e vepron atë që ka mundësi dhe Allahu e di shumë mirë sa mundësi ka ai. Ndërsa atë që nuk ka mundësi Allahu as nuk e urdhëron dhe as nuk e dënon sepse ai nuk ka mundësi”.

Them: Pamundësia i rrëzon ngarkesat fetare me pajtimin e dijetarëve pa asnjë dallim mes bazave dhe degëve të fesë.

Ibn Tejmije në librin e tij të vyer “Mosqortimi i dijetarëve” thotë: “Justifikimi pranohet atëhere kur është rezultat i pamundësisë për ta larguar (padijen). Por nëse njeriu ka mundësi ta njohë të vërtetën dhe e neglizhon atëhere ai nuk konsiderohet i justifikuar”.¹

Ndërsa në librin “Mexhmuul fetaua” thotë: “Pamundësia e rrëzon urdhëresën dhe ndalesën fetare edhe në qoftëse ajo është obligim (vaxhib) në origjinë”.²

Kjo ishte një përmbledhje e medhhebit të fukahave të mirënjohur rreth pyetjes suaj. Prej tyre shejhulislami dhe nxënësi i tij Ibn Kajimi, shejh Muhamed ibn Abdulvehabi etj. Sikur të zgjatesha kisha për t’i përmendur fjalët e tyre njëpërnjë, por ju mund të gjeni shpjegime më të shtjelluara për këtë çështje në librat e tjerë të mi dhe falenderimi i takon Allahu zotit të botrave.

Pyetja e pestë: Ne jetojmë në Egjipt dhe siç dihet ai është një vend murted ashtu si edhe vendet e tjera islame në këtë kohë për shkak se e kanë lënë fenë e Allahut dhe kanë përqaftuar fenë e tagutit, ligjin e tij dhe gjykimin e tij. Banorët e këtyre vendeve megjithëse thonë “La ilahe il-lallah” mirëpo ata kanë vepruar çdo gjë që e rrëzon dëshminë e shehadetit, si psh në çështjen e gjyimit dhe kthimit për gjykim te ligjet e shpikura, në çështjen e adhurimit të varreve dhe tyrbeve, miqësimi me qafirët që luftojnë fenë, luftimi i muslimanëve njëses dhe të devotshëm.

Pyetja është se unë në këto vende nuk gjykoj me islamin e një personi realitetin e të cilit nuk e njoh dhe falem vetëm pas atyre për akiden e të cilëve jam i informuar, dhe ha vetëm prej asaj një e ka therur një njëses të cilin e njoh. A konsiderohet kjo bidat? A mjafton fjala “La ilahe il-lallah” për të gjykuar për islamin e dikujt? A është namazi dëshmi e majftueshme për islamin e dikujt në këto kohra? Duke mos harruar se fetvaja duhet të bazohet në dy baza: Në njohjen e realitetit të personave dhe në njohjen e dispozitës së shariatit?

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Kufri i sistemeve qeverisëse nuk nënkupton edhe kufirin e muslimanëve të cilët jetojnë në ato vende ku gjykojnë sistemet murtede.

Vëndet tona nuk ndryshojnë shumë nga shteti i Mardinit për të cilin është pyetur

¹ Mosqortimi i dijetarëve, fq 114.

² Mexhmu’ul fetaua, vëll. 20, fq. 61.

shejhul islami Ibn Tejmije. Klasa qeverisëse në këtë shtet ishin qafirë ndërkohë që muslimanët përfaqësonin shtresat e gjëra të popullit. Shejhu islami duke u përgjigjur për këtë situatë tha: *“Gjaku dhe pasuria e muslimanëve janë të mbrojtura kudo qofshin, në Mardin apo në çdo vend tjetër .. Ndërsa përsa i takon çështjes se ai është vend lufte apo paqeje, atëhere ai konsiderohet nga të dy aspektet, në njërën anë nuk konsiderohet vend paqeje ku praktikohen ligjet e islamit dhe ushtria është islame, dhe as nuk është njësoj si vendi i luftës banorët e të cilit janë qafirë, por klasifikohet në një grup të tretë dhe sillemi me muslimanin me atë që i takon dhe luftohet ai që del kundër sheriatit islam ashtu siç e meriton”*.¹

Them: Ky gjykim vlen edhe për tokat muslimane në këtë kohë sepse realiteti i tyre është njësoj si shteti i Mardinit për të cilin është pyetur shejhul islami.

Ndërsa fjala jote për banorët e Egjiptit dhe për vendet e tjera islame se ata janë qafirë dhe murtedë papërrjashtim sepse kanë vepruar çdo gjë që e rrëzon imanin, kjo fjalë nuk është e drejtë dhe as e goditur dhe dëshmon se ju nuk e njihni realitetin e njerëzve dhe të shoqërisë. Kjo fjalë ndikon negativisht në fenë dhe ahiretin tënd.

Ashtu siç e përmende edhe ti, fetvaja e bazuar në sheriat duhet të bazohet në njohjen e realitetit të çështjes dhe njohjen e argumenteve fetare të cilat i përshtaten këtij realiteti. Mirëpo ti nuk i more parasysh këto baza atëhere kur u nxitove në këtë gjykim.

Prandaj po të them: Duhet të dëshmojmë me islamin e atij që e shpreh dëshminë e teuhidit apo falet haptas apo vepron gjëra që dëshmojnë për islamin e tij dhe duhet të sillemi me të si musliman, pra të falemi pas tij, të hamë mishin e therur prej tij. Nuk lejohet të sillemi me të ndryshe dhe as të gjykojmë me kufirin dhe daljen e tij prej islamin vetëm në rast se ai pa ndonjë justifikim të pranuar në sheriat vepron kufër të qartë për të cilin kemi argumente të prera nga Kurani dhe nga suneti i profetit ﷺ.

Është saktësuar se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Kush fal namazin tonë, drejtohet drejt kibles tonë dhe ha të therurën tonë ai është musliman. Atij i takon mbrojtja e Allahut dhe mbrojtja e të dërguarit të tij”**. E transmeton Buhariu.

Transmetohet në sahihun e Muslimit se i dërguari i Allahut ﷺ një ditë _në një nga betejat e tij_ dëgjoi një person të thoshte: **“Allahu Ekber, Allahu Ekber. Tha: Sipas fitres. Pastaj ai tha: Nuk ka të adhurar me të drejtë përveç Allahut. Tha: “Dole prej zjarrit”**.

Ky ishte gjykimi i profetit ﷺ prandaj bëj kujdes dhe mos e kundërshto gjykimin dhe urdhrin e tij që të mos humbasësh dhe të jesh prej të shkatërruarve.

Për namazin pas atij të cilit realiteti i tij nuk njihet Shejhulislami ka përcjellur pajtimin e të gjithë imamëve kur thotë: *“Lejohet namazi pas muslimanit realiteti i të cilit nuk njihet me pajtimin e të katër imamëve dhe të imamëve të tjerë. Ai që thotë: Unë e fal xhumanë*

¹ Mexhmu’ul fetaua, vëll. 24. fq. 280.

ose namazin me xhemat vetëm pas atij të cilit ia njoh akiden që ka në zemër; ky person është bidatçi që kundërshon sahabët, tabinët e mirë, katër imamët dhe dijetarët e tjerë”¹

Dije se kjo akide që ti beson _përveç kundërshtimit të Kuranit, të sunetit, të sahabëve dhe të dijetarëve_ burimin e ka prej shejtanit dhe vesveseve të tij dhe përfundimi i saj është i hidhur. Egzagjerimi në fe ose mund të arrijë deri aty sa të besosh se nuk ka muslimanë të tjerë në tokë përveç teje, ose t’i bësh tekfir vetes tënde disa herë në ditë ashtu siç ka ndodhur realisht me të tjerë persona, prandaj unë të këshilloj të ruhesh prej këtyre mendimeve.

Pytja e gjashtë: Si të bëjmë përputhje mes mendimit se njeriu shpallet qafir pasi t’i ngrihet argumenti dhe të mos ketë pengesa për tekfirin dhe qëndrimit të shejhulislam Ibn Tejmijes i cili edhe pasi ua sqaroi argumentet xhehmive nuk i shpalli qafirë disa persona konkretë prej tyre. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe imam Ahmedi me mutezilitë. Megjithëse argumentet u janë sqaruar (ata nuk u shpallën qafirë) përkundrazi mund të konsiderohen dijetarë në disa lëmi fetare dhe në gjuhën arabe.

Justifikimi i tyre i shtyn disa njerëz të pranojnë edhe justifikimin e tagutëve të gjykimit me preteksin se janë të imponuar dhe të paditur. Nëse thua: Padija e tyre nuk është e pranueshme, të kundërpërgjigjen: Padija e Mamunit nuk pranohet sepse ai ka qënë njeri i ditur. Allahu ju shpërbleftë me të mira.

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Është saktësuar se imam Ahmedi i ka shpallur qafirë disa persona konkretë prej xhehmieve të cilët pretenduan se Kurani është i krijuar ndërsa disa të tjerë nuk i ka shpallur.

Edhe pse ata kishin rënë në të njëjtin gjynah, imam Ahmedi në diferencimin në tekfirin e tyre u nis nga fakti se për ata që u bind se janë përmbushur kushtet e tekfirit dhe nuk kanë justifikime penguese i shpalli qafirë. Ndërsa të tjerët nuk i shpalli qafirë përshkak të ekzistimit të ndonjë pengese që e pengon tekfirin megjithëse ata kishin rënë në kufër.

Nëse thua: Është i mirënjohur argumenti që imam Ahmedi nuk i ka shpallur qafirë disa persona të caktuar prej xhehmive, mirëpo na sill argument se imam Ahmedi i ka shpallur qafirë disa të tjerë.

Them: Saliu, i biri i Ahmed ibn Hambelit transmeton prej babait të tij se u ka treguar për burgosjen e tij në shtëpinë e Is’hak ibn Ibrahimit, thotë: Çdo ditë më vinin dy persona. I pari quhej Ahmed ibn Rabah, ndërsa tjetri Ebu Shuajb Haxhami. Rrinin gjithë kohën duke debatuar e kur mbaronin urdhëronin që të lidhesha me pranga të tjera. Thotë: Derisa më vunë në një këmbë të vetme katër pranga. Thotë: Ditën e tretë erdhi njëri prej tyre dhe filloi të debatonte. I thashë: Çfarë thua për dijen e Allahut? Më tha: Dija e Allahut është e krijuar. I

¹ Mexhmu’ul fetaua, vëll. 4. Fq. 542.

thashë: Bëre kufër. Emisari i Ishak ibn Ibrahimit më tha: Ky është emisari i Emirit të besimtarëve. I thashë: Mirëpo ai u bë qafir.¹

Shiko se si imam Ahmedi e shpalli atë qafir sapo tha këtë fjalë të kotë.

Ndërsa krahasimi që ti bën për tagutët e gjykimit në këtë kohë me personat që imam Ahmedi i ka pas justifikuar edhe pse thoshin që Kurani është i krijuar, është një krahasim i kotë dhe i pavërtetë për disa shkaqe:

1- Kufri i atyre personave që imam Ahmedi i justifikoi ishte për shkak të keqinterpretimit të disa cilësive dhe mendimi se Kurani është i krijuar, ndërsa kufri që bëjnë tagutët e gjykimit bashkohorë i përfshin të gjitha llojet rrëzuese të islamit të dukshmet dhe të padukshmet.

2- Mohuesit e cilësive humbën për shkak të keqinterpretimit i cili nuk i shfaqson prej humbjes dhe gjynahut, mirëpo i justifikon disa prej tyre prej tekfirit. Ndërsa për pushtetarët e sotëm nuk themi dot se kanë rënë në këtë kufër për shkak të keqinterpretimit. Nuk themi dot: Ata gabuan në interpretim atëhere kur e rrëzuan sheriatin dhe sollën ligjet e kufrit. Nuk bëhet fjalë këtu për interpretime që pengojnë prej tekfirit të tyre. Nuk mund të thuhet: Ata i bënë vetet e tyre zotër përveç Allahut duke ligjëruar ligje dhe rivalizuan Allahun për shkak se gabuan në interpretim. Nuk mund të thuhet: Ata u miqësuan dhe i ndihmuan mushrikët, çifutët dhe të krishterët kundër muslimanëve dhe pasuesve të teuhidit, sepse gabuan në intrerpretim. Nuk mund të themi për ata që luftojnë fenë e Allahut me të gjitha mundësitë dhe fuqitë që kanë, se e bënë padashje dhe gabuan në interpretim.

3- Ata që keqinterpretuan disa cilësi si puna e Mamunit kishin për qëllim lartësimin dhe madhërimin e Allahut ﷻ dhe jo përgënjeshttrimin dhe mohimin e asaj që e dinin me siguri se është prej fesë së Allahut ﷻ. Ky ishte shkaku kryesorë përse imam Ahmedi dhe dijetarët e tjerë nuk i shpallën qafirë disa prej tyre.

Ndërsa për tagutët e gjykimit sot, nuk themi dot: Ata synojnë madhërimin dhe pastrimin e fesë, sepse ata kanë rënë në kufër të pastër me të gjithë llojet e tij.

Për këto arsye dhe për arsye të tjera themi: Krahasimi i tagutëve të gjykimit me mohuesit e disa cilësive është i kotë dhe i pabazë.

Pyetja e shtatë: Për çështjen e kufrit në tagut a duhet të shqiptohet përpara tagutit dhe t'i themi: Ti je qafir, apo me ndonjë mënyrë që kjo fjalë t'i arrijë atij dhe përkrahësve të tij, apo mjafton që ta shprehim atë përpara vllëzërve tanë, apo duhet patjetër që të thuhet haptas përpara njerëzve?

Si bëhet kufër në tagutin me vepra? A duhet të përpiqemi për vrasjen e tagutit

¹ Musnedi i imam Ahmedit, me korigjime prej Ahmed Shakirit, vëll. 1, fq. 91.

apo të përkrahësve të tij? Apo kjo çështje duhet të bazohet në politikën e sheriatit? Ju lutemi na e sqaroni.

Ata njerëz që pretendojnë se e kanë mohuar tagutin, mirëpo në të njëjtën kohë i shikon të mbështetin tagutët duke u dalë në mbrojtje, a bëhen këta njerëz qafirë për këtë shkak?

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Dije se shpalojsja e armiqësisë dhe urrejtjes së tagutit, ushtrisë dhe mbështetësve të tij është prej obligimeve më të konfirmuara në fe. Allahu thotë: **﴿Keni pasur shembullin e mirë të Ibrahimit dhe ata që ishin me të kur i thanë popullit të tyre: Ne jemi të distancuar prej jush dhe prej asaj që e adhuroni përveç Allahut. Kemi bërë kufër me ju dhe mes nesh është shpallur armiqësia dhe urrejtja derisa të besoni Allahun një dhe të vetëm﴾.**

Ashtu si obligimet e tjera edhe ky obligim është i kushtëzuar sipas mundësive. Muslimani shfaq prej armiqësisë dhe urrejtjes aq sa ka mundësi, pa e ngarkuar veten me atë që nuk e përballon dot dhe pa e futur veten në sprovë, siç transmetohet në hadith: **“Nuk është besimtar ai që e poshtron veten e tij. E hedh veten në sprovë për të cilat nuk ka takat”**. Çdo njeri e di vetë se sa mundësi ka, prandaj nuk i takon askujt të gjykojë të tjerët sipas mundësisë dhe pamundësisë së tij.

Kufri në tagut me vepra nuk është vetëm në vrasjen dhe luftimin e tij siç u përmend në pyetje. Ai vërtetohet edhe me distancimin prej tij, mosshoqërimin e tij, mosmiqësimin, mosndihmimin e tij dhe mos përkrahjen e tij dhe shumë punë të tjera, dhe Allahu është më i ditur.

Ndërsa ata që me gojë pretendojnë se e kanë mohuar tagutin ndërsa në realitet e ndihmojnë dhe e përkrahin tagutin duke i shtuar atij forcë dhe gjallëri, ata bien në kontradiktë me vetet e tyre. Ata janë njësoj si personi që pohon diçka dhe të kundërtën e saj. Këtyre u shkon për shtat fjala e Allahut ﷻ: **﴿O ju që keni besuar! Përse thoni atë që nuk e veproni? Sa shumë e urren Allahu të thoni atë që nuk e veproni﴾.**

Mirëpo a janë ata qafirë dhe a kanë dalë prej islamit? Them: Duhet të shikojmë se ku i përkrahin. Jo çdo përkrahje nënkupton kufër, ashtu siç i tha Usejd ibn Hudejri ؓ Sad ibn Ubades ؓ atëhere kur i doli në mbrojtje kokës së munafikëve Ibn Ubejit në ndodhinë e gënjetrës kundër Aishes, i tha: “Gënjen pasha Allahun. Kemi për ta vlarë. Mirëpo ti je munafik dhe përkrah munafikët”. Këto fjalë u thanë në prezencën e profetit ﷺ.

Kjo që veproi Sad ibn Ubade ؓ ishte një përkrahje në një farë mënyre për kokën e munafikëve Ibn Ubejin e megjithatë kjo nuk u konsiderua kufër. Gjithashtu profeti ﷺ nuk i doli në mbrojtje Sadit ؓ dhe nuk i tha Usejdit ؓ: Jo o Usejd. Kjo që bëri Sadi ؓ nuk quhet përkrahje. Pra ajo ishte përkrahje mirëpo përkrahja e qafirëve ndahet në disa lloje njësoj si miqësimi me ta; në disa raste është kufër e në disa raste jo. Patjetër duhet të vështrojmë llojin

e përkrahjes dhe peshën e saj përpara se të japim gjykimin për atë që përkrah tagutin. Gjithashtu duhet të marrim parasysh edhe shkaqet e përkrahjes, realitetin e vetë personit, gradën e dyshimeve që ai ka dhe duhet të shohim edhe vetë tagutin dhe qartësinë e tagutizmit të tij dhe Allahu është më i ditur.

Pyetja e tetë: Si të sillemi me ata njerëz realitetin e të cilëve nuk e njohim _ata të cilët në paraqitje nuk kanë shenja dalluese të islamit dhe as të kufrit_ përsa i takon dhënies së selamit, dhe sidomos për ngrënien e mishit të therur prej tyre? Probabiliteti më i madh është që të mos jetë as namazli siç është realiteti i vendit tonë që është mbushur plot me murtedë të cilët e lënë namazin dhe është përhapur sharja e fesë në mes të të rriturve dhe fëmijëve.

Përgjigja: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Origjina e njerëzve në vendet islame është islami përveçse në ato raste kur vërtetohet e kundërta me siguri. Për sa kohë që çështja bazohet në probabilitet atëhere mendoj se më mirë dhe më afër shariatit që t'i japim përparësi probabilitetit që njerëzit janë muslimanë edhe nëse ai është probabilitet i dobët sepse gabimi në tekfir të shtyn në probleme dhe gabime të tjera të cilat nuk ndodhin nëse gjykojmë gabimisht për islamit e një personi.

Pyetja e nëntë: Çfarë gjykimi ka një person i cili i mbron tagutët ditë e natë, debaton për ta, i pranon veprat e tyre dhe i konsideron të ligjshme? Ai i përçmon pasuesit e teuhidit dhe i quan havarixh, të poshtër, të humbur etj.

A lejohet bërja tekfir e një personi të caktuar prej tyre? A është kusht t'u ngrihen argumentet apo jo? Nëse u sqarohen argumentet a mund t'i shpallim qafirë? Apo unë duhet të di nëse ky person e njeh apo nuk e njeh realitetin e tagutit dhe kufrit e tij? Shpresojmë të na përgjigjemi dhe Allahu ju shpërbleftë me të mira.

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Ai që i mbron tagutët dhe debaton në mbrojtje të tyre dhe në mbrojtje të kufrit dhe të kotës së tyre ai është qafir njësoj si ata. Ky është një gjykim i përgjithshëm për të cilin kanë dëshmuar argumentet e shariatit.

Ndërsa për shpalljen qafir të një personi të caktuar në mesin e tyre dhe nëse është kusht sqarimi i argumenteve atëhere them: Duhet të kemi parasysh disa gjëra përpara se të japim gjykim për këtë çështje. Duhet shikuar nëse kufri i këtij taguti është i qartë me argumente të qarta nga libri i Allahut ﷻ dhe suneti i profetit ﷺ të cilat nuk mund të kuptohen ndryshe dhe nuk ka kundërshtim dhe debat rreth tyre, apo kufri i tij nuk është shumë i qartë sepse ai hiqet si njeri i devotshëm që i frikësohet Allahut për të mashtruar masat e njerëzve?!

Në rastin e parë tekfiri i një personi të caktuar që përkrah dhe i del në mbrojtje tagutit është i saktë. Nuk është kusht sqarimi i argumenteve dhe as njohja e shkaqeve sidomos nëse

ndihma që ai jep është kundër islamit dhe muslimanëve, sepse njohja e këtyre argumenteve është shumë e thjeshtë.

Ndërsa në rastin e dytë _atëhere kur shtiren para njerëzve_ nuk duhet të nxitohemi në tekfir. Këtu është kusht sqarimi i argumenteve dhe debatimi me të në mënyrën më të mirë sidomos nëse ata persona njihen për dijen dhe devotshëminë e tyre dhe janë sprovuar në rrugë të Allahut. Argumentet fetare na shtyjnë që për të tillë persona të gjejmë justifikime dhe shfaqime të pranueshme.

Gjithashtu duhet shikuar edhe gjendja e personit që i përkrah ata. A ka justifikime, shkaqet që e kanë shtyrë për t'i përkrahur, lloji i përkrahjes? Këto gjëra duhet të merren parasysh atëhere kur taguti i mashtron njerëzit me shtirje dhe Allahu është më i ditur.

Nëse thua: Sikur të kishit përmendur disa argumente për këtë përgjigje. Të them: Nuk është vendi për t'u futur në detaje por nëse dëshiron mund t'i kthehesh librit tonë "Justifikimi me xhehl dhe sqarimi i argumentit" dhe librit të shejhul islamit "Mosqortimi i imamëve të shquar".

Vërejtje:

Nëse bindesh pa pikë dyshimi në kufirin e ndonjë personi të caktuar prej përkrahësve dhe ndihmuesve të tagutit pasi të jenë përmbushur kushtet dhe pengesat e tekfirit dhe nëse ti je person që i njeh argumentet atëhere të lejohet _madje e ke detyrë_ që ta shpallësh atë person qafir. Por nuk të lejohet që t'i imponosh të tjerët me gjykimin tënd rreth këtij personi sepse ti mund të kesh parë diçka që dikush nuk e ka parë, ose dikush mund të ketë parë ndonjë pengesë që ti nuk e ke parë, njësoj si kundërshtimi në mesin e dijetarëve për tekfirin e Haxhaxhit. Kundërshtimi në mesin e tyre nuk i shtyu ata që t'i bënin tekfir njëri-tjetrit, dhe Allahu është më i ditur.

Pyetja e dhjetë: Ndonjëherë disa shejhë mund të thonë fjalë kufri. A lejohet që të gjykojmë mbi ta bazuar në pamjen e jashtme të këtyre fjalëve apo duhet të marrim parasysh qëllimin e tyre me këto fjalë? Allahu ju shpërbleftë me të mira.

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Nëse ajo fjalë është kufër i qartë dhe i pastër atëhere nuk ka nevojë që të shohim qëllimin e tij. Mirëpo nëse është kufër që mund të kuptohet në disa mënyra _pra nga njëra anë kuptohet si kufër dhe nga një anë tjetër mund të kuptohet ndryshe_ atëhere duhet të dimë qëllimin që folësi ka pasur, ashtu siç e mori parasysh profeti ﷺ qëllim që Hatib ibn Belta ؓ pati atëhere kur i shkruajti letër qafirëve të kurejshve. Dhe ashtu siç duhet ta merrte parasysh Halid ibn Velidi ؓ qëllimin e atyre që thanë: E lamë fenë, sepse ata kishin për qëllim të thoshin: U bëmë muslimanë, mirëpo nuk gjetën fjalët e duhura dhe Allahu është më i ditur.

Shkurtimisht kjo çështje ndonjëherë ka vënd për justifikime dhe ndonjëherë jo, në varësi të personit që e thotë fjalën dhe në vartësi të qartësisë së kufrit që përmban kjo fjalë dhe në varësi të justifikimit dhe rrethanave ku janë thënë këto fjalë dhe Allahu është më i ditur.

Pyetja e njëmbëdhjetë: Sa e vërtetë është kjo fjalë: Bëjmë dallim mes veprimit dhe llojit dhe personit të caktuar. Fjala e atij që thotë kufër dëshmon për kufër mirëpo ne nuk e bëjmë qafir një person të caktuar.

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Kjo fjalë nuk është plotësisht e saktë. Tekfiri i përgjithshëm nuk nënkupton tekfirin e një personi të caktuar atëhere kur ekzistojnë pengesa të pranueshme në shariat të cilat pengojnë shpalljen qafir të një personi të caktuar. Ndërsa nëse plotësohen kushtet dhe nuk ka pengesa atëhere tekfiri i përgjithshëm e përfshin edhe personin e caktuar dhe rregulli në shariat thotë: “Atij që e shfaq kufirin e qartë pa asnjë pengesë të pranueshme, i kundërpërgjigjemi me tekfir”.

Pyetja e dymbëdhjetë: Kush janë tekfirsat? A është islami origjinë e shoqërisë islame sot apo kufri?

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Pyetja është parashtruar gabim. Mbase ke pasur për qëllim ata që e tejkalojnë masën në tekfir, sepse takfirsat _ashtu siç është përhapur në mesin e njerëzve_ kanë qënë edhe profeti ﷺ ynë me gjithë shokët e tij ﷺ dhe të gjithë ata që e pasojnë atë. Ata i kanë bërë tekfir çdokujt që e meritonte dhe për këdo që Allahu ﷻ ka gjykuar me të për kufër. Ndërsa ata që e tejkalojnë masën në tekfir janë ata të cilët kanë rënë në egzagjerim dhe ekstremizëm duke bërë tekfir me dyshime, apo me gjynahe që nuk arrijnë gradën e kufrit, prandaj dhe u pajtuan me havarixhët e dikurshëm në shumë prej gjykimeve dhe fjalëve të tyre.

Ndërsa për shoqëritë që ti po pyet, nëse ke për qëllim njerëzit atëhere islami është origjina derisa të bindemi për të kundërtën. Ndërsa nëse ke për qëllim me shoqërinë sistemin dhe ligjet e atij vendi atëhere ato janë sisteme qafire dhe të xhahilijetit.

Pyetja e trembëdhjetë: A e kam për detyrë o shejh që ta shpall qafir çdo person për kufirin e të cilit jam siguruar?

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Po! Nëse sigurohesh plotësisht për kufirin e tij atëhere atëhere duhet që ta konsiderosh atë për qafir në të kundërt do biesh në kundërshtim me vetveten.

Pyetja e katërbëdhjetë: A e kam për detyrë të hulumtojë për gjendjen e çdo

personi rreth të cilit hidhen dyshime? Sepse kohët e fundit janë përhapur disa çështje për disa grupe të caktuara prej xhamive të cilët u dalin në mbrojtje tagutëve murtedë. Mua më kanë thënë që ata janë murtedë.

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Më e mira është që të mos merremi me këto çështje nëse kufri i tij është i paqartë dhe me dyshime dhe as të mos hulumtojmë për realitetin e imanit apo kufrit të tij. Kjo është egzagjerim prej të cilit jemi ndaluar. Mirëpo në rast se personi në fjalë është prej kokave të tyre dhe fitnexhi i madh dhe rrethanat na imponojnë që të flasim me xherh dhe tadil atëhere ju këshilloj që t'u ktheheni dijetarëve të cilët e njohin realitetin dhe fjalët e tij. Nuk e shoh të lejuar që muslimanët e thjeshtë të merren me këto çështje vetëm në ato raste kur pasojnë dijetarët.

Nëse thua: Përse? Të them: Sepse kufri i tij është i paqartë dhe mund të kuptohet në shumë mënyra. Tekfiri i tij ka nevojë që të shikohen pengesat dhe përmbushja e kushteve të cilat kanë nevojë për devotshmëri, dije dhe drejtësi. Këtë gjë kanë mundësi ta bëjnë vetëm dijetarët njësues dhe Allahu është më i ditur.

Pyetja e pesëmbëdhjetë: Çuditem me një person. Sa herë që një person shfaq disa gjëra që e prishin islamin ai thotë: Mbase ka pasur për qëllim kështu dhe ashtu. Pra i gjen justifikime dhe interpretime. Çfarë mendimi keni ju o shejh?

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahut. Kush e shfaq kufirin e pastër, pa pengesa të pranueshme në shariat, i kundërvihemi me tekfir. Në këtë rast nuk kemi nevojë të shikojmë qëllimin dhe të kërkojmë justifikime, sepse qëllimi dhe justifikimi merren parasysh në rastin e dyshimeve dhe kur kufri është i paqartë dhe mund të kuptohet në shumë mënyra dhe Allahu është më i ditur.

Pyetja e gjashtëmbëdhjetë: E e konsideroni sundimtarin qafir. Nëse po, ai që punon në qeveri a konsiderohet qafir?

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Shpallja qafir e sundimtarëve që kanë shfuqizuar shariatin apo që nuk gjykojnë me atë që ka zbritur Allahu ﷻ nuk nënkupton tekfirin e të gjithë njerëzve që punojnë në qeveritë e tyre ashtu siç propagandojnë disa njerëz për të friksuar muslimanët që të mos u bëjnë tekfir tagutëve të gjykimit. Ajo që ne themi: Kush i del në krah tagutit sundimtar dhe e ndihmon atë kundër muslimanëve ai është qafir njësoj si ai sepse ai është prej ithtarëve të tij. Mirëpo ky realitet nuk përkon me realitetin e çdokujt që punon në qeveri dhe Allahu është më i ditur.

Pyetja e shtatëmbëdhjetë: Shejh i nderuar! Allahu ju ruajt dhe ju forcoftë në të vërtetën dhe ju shpërbleftë me xhenet! A është i saktë namazi pas murxhive xhehmi,

sidomos kokat e këtij bidati dhe teoricienët e tyre? A është transmetuar prej selefit tekfiri i atyre që kanë këtë akide? A janë njësoj thirrësi në këtë bidat me imituesin? Si ta praktikojmë pa egzagjerim dhe ekstremizëm rregullin se kush nuk e bën qafir qafirin ai është qafir? Sepse shumë njerëz e kanë kufizuar këtë rregull vetëm për ata që në origjinë janë qafirë, ndërsa një palë tjetër ekstremiste e praktikon këtë rregull edhe për ata një nuk e konsiderojnë qafir lënësin e namzit apo nuk i shpall qafirë disa bidatçi për tekfirin e të cilëve ka kundërshtime në mesin e dijetarëve. Allahu ju shpërbleftë me të mira.

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Allahu të shpërbleftë për duanë e bukur dhe unë lutem për ty me të njëjtën lutje që u lute për vëllain tënd. Si përgjigje për pyetjen tënde po të them: Tekfiri i selefit dhe i shumë dijetarëve për xhehmitë është i mirënjohur. Ndërsa tekfiri i një personi të caktuar prej xhehmive ka nevojë për përmbushjen e kushteve dhe largimin e pengesave.

Nëse kufri i një personi të caktuar vërtetohet me siguri të plotë atëhere nuk lejohet falja pas tij e në të kundërt lejohet edhe pse më mirë është të braktiset dhe të falesh pas një imami që pason sunetin dhe teuhidin që t'i shërbejë si mësim dhe qortim përpara besimtarëve. Por nëse nuk ke mundësi ta bësh këtë dhe ke frikë se nuk gjen namaz me xhemat tjetër atëhere falu pas tij.

Rregulli “Kush nuk e bën qafir qafirin ai është qafir” është rregull i saktë. Ai përfshin atë që është qafir në origjinë dhe qafirin murted. Ajo përfshin edhe ata që refuzojnë t'i konsiderojnë qafirë ata që kanë bërë kufër të qartë dhe të pastër qoftë kufri i tyre në origjinë apo sepse kanë bërë ridde dhe zendeka. Ndërsa nëse kufri është jo shumë i qartë apo e pranon kundërshtimin dhe ixhtihadin atëhere nuk lejohet zbatimi i këtij rregulli për ata vëllezër që bien në kundërshtim me ty rreth tekfirit.

Pyetja e tetëmbëdhjetë: Si të përgjigjemi për gjykimin rreth një personi të cilin nuk e njohim? P.sh. nëse na thuhet: Çfarë gjykimi ka filani i biri i filanit në filan vend?

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Nuk je i obliguar në shariat të japësh gjykime për persona konkretë të cilët nuk i njeh aq mirë sa për të gjykuar mbi ta. Nëse patjetër duhet të përgjigjesh atëhere kërkon prej pyetësit që të të informojë rreth tij detajisht dhe në varësi të informatave të tij i thua: Nëse fjala jote është e vërtetë ai është musliman ose qafir. Pra lidhe gjykimin tënd me vërtetësinë e fjalës së tij sepse ajo mund të jetë gabim ose ai mund të gënjejë për realitetin e këtij personi të caktuar dhe Allahu është më i ditur.

Pyetja e nëntëmbëdhjetë: Disa njerëz përhapin dyshime dhe thonë se tekfiri i tagutit sundimtar që ka shfuqizuar shariatën nënkupton bërjen tekfir në seri derisa të bëjmë qafir masat e gjëra të muslimanëve dhe ata të cilët nuk e meritojnë t'u bëhet

tekfir. Si t'i kundërpërgjigjemi këtij dyshimi?

Përgjigje: Tekfiri në seri nënkupton bërjen qafir të atij që nuk e bën qafirin qafir dhe bërjen qafir të atij që nuk e bën atë person që nuk e bën qafirin qafir dhe bërjen qafir të atij që nuk e bën atë i cili nuk e bën qafir personin që nuk e konsideron qafirin qafir e kështu me rradhë derisa lista të plotësohet me tekfirin e masave të gjëra të muslimanëve dhe dijetarët.

Them: Kjo fjalë është e kotë dhe e pavërtetë për disa arsye:

- Kjo është fjalë e shpikur (bidat). Atë e thonë vetëm injorantët e sëmurë me simptomën e ekstremizmit ose ndonjë murxhi i ulët i cili ka për qëllim të hedhë pluhur mbi të vërtetën dhe pasuesit e saj për të përkarahur tagutët tiranë.

- Tekfiri ka rregulla dhe kufizime, kushte dhe pengesa dhe nuk lejohet bërja tekfir pa pasur parasysh këto kushte dhe kufizime. Nëse plotësohen kushtet por ka disa pengesa atëhere duhet të ndalemi prej tekfirit qoftë ai në seri apo jo. E nëse plotësohen kushtet dhe nuk ka pengesa atëhere bëhet tekfir qoftë ai në seri apo jo.

- Seria sa më shumë të zgjerohet aq më shumë elemente përfshin në veten e saj dhe rrjedhimisht zgjerohet edhe rrethi i justifikimeve dhe shfaqësimeve, sepse ai që nuk e bën qafir qafirin nuk është njsoj si ai që nuk e bën qafir atë që nuk e bën qafirin qafir, ata nuk janë njsoj në justifikime, shfaqësime dhe faljen e gabimeve.

Pyetja e njëzetë: Një person thotë: Bërja tekfir e një personi konkret i lejohet vetëm dijetarëve ndërsa të tjerëve nuk u lejohet. Sa e vërtetë është kjo fjalë?

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Kjo fjalë nuk është plotësisht e saktë. Nga njëra anë është e saktë dhe në një anë tjetër e gabuar.

Ajo është e saktë atëhere kur kufri është i paqartë dhe me shumë kuptime dhe ka nevojë për plotësimin e kushteve dhe largimin e pengesave. Ky lloj tekfiri ka nevojë për dije, ixhtihad dhe devotshmëri. Prandaj i këshillojmë muslimanët e thjeshtë të mos futen në aventurat e tekfirit në raste të tilla, por të pyesin dijetarët.

Por kjo fjalë është e gabuar nëse kufri është i qartë dhe i sigurtë si kufri i çifutëve, të krishterëve, mexhusëve, politeistëve, komunistëve dhe pabesimtarët e tjerë të cilët kanë mohuar bazat e islamit shumë qartë. Ky lloj qafirësh duhet të shpallen qafirë nga të gjithë, si nga muslimanët e thjeshtë ashtu edhe nga dijetarët. Në këtë rast nuk është kusht që bërësi i tekfirit të jetë prej dijetarëve dhe muxhtehidave, përkundrazi çdokush prej masave të muslimanëve duhet që këtë lloj qafirësh zullumqarë t'i konsiderojnë qafirë dhe të distancohen prej tyre.

Nëse pretendojmë se muslimanët e thjeshtë nuk kanë mundësi ta njohin qafirin dhe as nuk kanë mundësi të bëjnë dallim mes shirkut dhe teuhidit si atëhere ta ringjallim në mesin e

tyre sunetin e distancimit nga shirku dhe mushrikët dhe pasuesve të mileteve të kufrit me të cilin jemi urdhëruar në dhjetra argumente prej sheriatit. Njohja e kufrit dhe pasuesve të kufrit dhe dallimi mes pasuesve të së vërtetës dhe të kotës është kusht themelor për distancimin prej tyre sepse injoranti është njësoj si ai që nuk posedon asgjë dhe nuk të jep dot asgjë.



Rregulli i trembëdhjetë: Lënia e çdo kushti të imanit është kufër dhe lënia e çdo kufri është kusht për saktësinë e imanit.

Ky rregull është i saktë dhe gjithpërfshirës. Për këtë dëshmojnë argumentet e Kuranit, sunetit dhe rregullat e shariatit. Më poshtë po paraqesim një shpjegim më të zgjeruar:

Gjysma e parë e rregullit “Lënia e çdo kushti të imanit është kufër”.

Kuptimi i kushtit është: Ai i cili pa të nuk saktësohet ajo gjë ose nuk ekziston, por nëse përmbushet nuk do të thotë që ajo gjë të ekzistojë. Çdo gjë ka kushtet dhe rrethanat e saj specifike dhe gjëja ekziston vetëm atëhere kur këto kushte dhe rrethana përmbushen të gjitha sëbashku. Çdo mangësi, qoftë edhe në një kusht të vetëm nënkupton rrëzimin e asaj gjëje ose mosekzistencën e saj.

Imani bazohet në kushte dhe atëhere kur këto kushte plotësohen të gjitha sëbashku ekziston imani, por nëse mungon qoftë edhe një kusht i vetëm atëhere imani rrëzohet dhe zhduket dhe rrjedhimisht bie në kufër.

Pohimi dhe shqiptimi i teuhidit është kusht për saktësinë e imanit dhe teuhidit sepse i dërguari ﷺ në hadithin mutefek alejhi thotë: **“Jam urdhëruar t’i luftoj njerëzit derisa të dëshmojnë se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Allahut”**. Kush e lë shqiptimin e dëshmisë së teuhidit, megjithëse i ka të gjitha mundësitë që ta thotë, ai ka bërë kufër dhe është jashtë kufijve të islamit, sado që t’i përmbushë kushtet dhe obligimet e tjera.

Edhe kufri në tagut është kusht për saktësinë e imanit sepse Allahu ﷻ thotë: **«Kush bën kufër me tagutin dhe beson në Allahun ai është kapur me kapjen më të sigurtë e cila nuk këputet»** El bekare 256. Ai që e lë atë ka bërë kufër dhe ka dalë nga islami.

Mospasja dyshime dhe besimi me bindje të plotë i dëshmisë së teuhidit, është kusht për saktësinë e imanit sepse në të kundërtën ai ka dyshuar dhe nuk është plotësisht i bindur në dëshminë e teuhidit dhe rrjedhimisht ka rënë në kufër.

Praktikimi i teuhidit është kusht për saktësinë e teuhidit. Imani dhe teuhidi janë të saktë vetëm nëse praktikohen, sepse ai që e braktis praktikimin e teuhidit ka rënë në shirk dhe kufër.

Falja e namazit është kusht prej kushteve të teuhidit dhe imanit. Imani saktësohet vetëm me faljen e tij, prandaj kush e braktis atë ka bërë kufër dhe shirk, siç dëshmojnë për këtë tekset e shariatit.

Nëse kthimi për gjykim të shariatit dhe pajtimi me gjykimin e Allahut është kusht për saktësinë e imanit _siç dëshmojnë argumentet_ atëhere moskthimi për gjykim të shariatit dhe

mospajtimi me dispozitat e saj është kufër i madh që të nxjerr prej islamit.

Kjo përfshin çdo besim, fjalë apo vepër që konsiderohet kusht për saktësimin e imanit me argumente të qartë dhe braktisja e tyre konsiderohet kufër që të nxjerr prej islamit.

Pjesa e dytë e rregullit “Lënia e çdo kufri është kusht për saktësinë e imanit”.

Braktisja e çdo besimi, fjale ose vepre kufri është kusht për saktësimin e besimit sepse imani dhe kufri nuk mund të bashkohen në zemrën e njeriut sëbashku, siç thuhet në hadithin e saktë: **“Imani dhe kufri nuk bashkohen në zemrën e njeriut”.**¹ Pra rrëzimi i njërit është kusht për ekzistimin e tjetrit.

Përshembull imani i atij që adhuron idhujt dhe tagutët saktësohet vetëm nëse ai e braktis adhurimin e tyre. Imani i atij që beson se Isai është bir i Allahut saktësohet dhe pranohet vetëm me braktisjen e këtij besimi të kotë dhe vetëm me besimin se Isai është rob dhe i dërguar i Allahut dhe jo bir i zotit.

Po ashtu imani i atij që mohon gjëra shumë të mirënjohura në fe nuk është i saktë deri sa ta braktisë këtë mohim dhe t’i pohojë këto gjëra.²

Gjithashtu imani i lënësit të namazit saktësohet vetëm atëhere kur fillon të falet dhe pendohet prej mosfaljes.

Këtu hyn edhe pretendimi i krijesës se ka të drejtë të vendosë ligje dhe të bëjë hallall dhe haram gjërat sipas epshit të tij duke vendosur ligje që rivalizojnë ligjet e Allahut. Ky është kufër i qartë siç dëshmohet prej argumenteve të qarta. Braktisja e këtij kufri dhe kthimi i të drejtës së ligjvënies për Allahun është kusht për saktësinë e imanit dhe teuhidit.

Nëse tallja me fenë është kufër atëhere mostallja, respektimi dhe madhërimi i Allahut dhe i fesë janë kushte për saktësimin e imanit dhe teuhidit.

Nëse kërkimi i ndihmës prej krijesave për ato gjëra që janë vetëm në dorë të Allahut është kufër i madh atëhere braktisja e saj dhe kërkimi i ndihmës duke iu drejtuar me lutje vetëm Allahut është kusht për saktësimin e imanit dhe të teuhidit.

Pra braktisja e çdo vepëre të cilën sheriati e ka cilësuar si kufër të madh është kusht për saktësimin e imanit dhe teuhidit.

¹ Es silsiletus sahiha, 1050.

² Prej bazave dhe rregullave për të cilën kanë dëshmuar argumentet e shariatit se: “Urdhërimi për diçka nënkupton ndalimin prej të kundërtës së asaj gjëje dhe ndalimi prej diçkaje nënkupton urdhërimin për kryerjen e të kundërtës së asaj gjëje”. P.sh. urdhërimi për sinqeritet nënkupton ndalimin prej gënjeshtërisë dhe ndalimi prej gënjeshtërisë nënkupton urdhërimin për sinqeritet. Urdhërimi për bamirësi dhe sadaka nënkupton ndalimin prej koprracisë dhe mosdhënies sadaka. Edhe ndalimi prej koprracisë dhe prej mosdhënies sadaka është urdhërim për bamirësi dhe dhënie sadaka. Urdhërimi për teuhid është ndalim prej shirkut dhe ndalimi prej shirkut është urdhërim për teuhid.

Largim i një dyshimi:

Këtu mund të ngrihet një dilemë: Nëse ky rregull është i saktë kjo nënkupton që teuhidi paska dhjetra kushte dhe jo vetëm nëntë kushte siç përmendet në librin tuaj “Kushtet e fjalës “La ilahe il-lallah”?!“

Them: Të gjitha veprat të cilat janë kusht për saktësinë e teuhidit dhe të gjitha veprat braktisja e të cilave është kusht për saktësimin e teuhidit, përmbliidhen në një kusht të vetëm që është kushti i praktikimit të teuhidit me vepra. Ato janë kushte të cilat rrjedhin nga një kusht i vetëm prej kushteve të teuhidit i cili është kushti i praktikimit të teuhidit me vepra dhe Allahu është më i ditur.



Rregulli i katërmbëdhjetë: Çdo qafir konsiderohet injorat por jo çdo injorant konsiderohet qafir.

Është vërtetuar në shumë ajete kuranore se qafiri konsiderohet injorant dhe se qafirët nuk dinë dhe nuk kuptojnë dhe nuk logjikojnë; se nëse do të dinin, do të kuptonin dhe logjikonin, kishin për të besuar Allahun ﷻ dhe mesazhin me të cilin është dërguar profeti ﷺ. Atëhere kur shqisat dhe logjika e tyre nuk e përmbushën detyrën për të cilën u krijuan, ato ishin njësoj sikur të mos ekzistonin. Allahu ﷻ thotë për ta: **﴿Ata janë shurdhë, memecë, të verbër dhe ata nuk logjikojnë﴾** El Bekare 171.

Dhe thotë: **﴿Kafshët më të këqija te Allahu janë shurdhët memecë të cilët nuk logjikojnë﴾** El Enfal 22.

Dhe thotë: **﴿e ka hedhur pisllekun mbi ata që nuk logjikojnë﴾** Junus 100.

Dhe thotë: **﴿Me të vërtetë ata janë budallenjtë por ata nuk e kuptojnë﴾** El Bekare 13.

Dhe thotë: **﴿Allahu ua vulosi zemrat prandaj ata nuk kuptojnë﴾** Et Teube 93.

Dhe thotë: **﴿Kemi krijuar për xhehenemin shumë xhinde dhe njerëz. Ata kanë zemra që nuk kuptojnë. Ata kanë sy me të cilët nuk shikojnë. Ata kanë veshë me të cilët nuk dëgjojnë. Ata janë njësoj si bagëtia, madje ata janë akoma edhe më të humbur. Ata janë të shkujdesurit﴾**. El Araf. 179.

Dhe thotë: **﴿Zemrat e tyre janë vulosur dhe ata nuk kuptojnë﴾** Et teube 87.

Dhe thotë: **﴿Kjo sepse ata besuan dhe pastaj bënë kufër dhe zemrat e tyre u vulosën prandaj ata nuk kuptojnë﴾** El munafikun, 3.

Dhe thotë: **﴿por munafikët nuk kuptojnë﴾** El munafikun, 7.

Dhe thotë: **﴿dhe thanë: Sikur të dëgjonim dhe të logjikonim nuk kishim për të qënë prej banorëve të zjarrit﴾** El mulk, 10. E pranuan se nuk logjikonin sepse po të logjikonin kishin për t'u udhëzuar dhe nuk kishin për të qënë prej banorëve të zjarrit.

Ibn Abasi ؓ ka thënë: “Sikur të dëgjonim udhëzimin dhe të logjikonim, apo sikur të kishim dëgjuar me kuptim dhe meditim dhe sikur të logjikonim me dallim dhe hulumtim”.

Kurtubiu ka thënë: “Kjo dëshmon se qafiri nuk kupton prej logjikës asgjë”.¹

Kurtubiu, rreth fjalës së Allahut: **﴿A mos vallë mëndja e tyre i urdhëron me këtë apo ata janë njerëz që i kanë tejkualuar caqet﴾** thotë:

¹ Xhami'ul ahkamil kuran, Imam Kurtubiu, vëll. 10, fq. 212.

“Fjala “Ahlamuhum” e përmendur në ajet nënkupton mendjet pasi qafiri nuk ka logjikë sepse po të kishte logjikë kishte për të besuar. Qafiri ka mendje mirëpo kjo mendje do të jetë dëshmuar kundër tij. Mendja lidhet me njohuritë ndërsa logjika shkon më larg sepse bën dallim mes njohurive dhe i jep urdhrave dhe ndalesave kufinj të tyre.

Transmetohet se një person i tha profetit ﷺ: O i dërguar i Allahut! Ky filan i krishter është njeri me shumë logjikë. Atëhere profeti ﷺ i tha: Mos thuaj kështu! Qafiri nuk ka logjikë. A nuk e ke dëgjuar fjalën e Allahut ﷻ: **﴿dhe thanë: Sikur të dëgjonim dhe të logjikonim nuk kishim për të qënë prej banorëve të zjarrit﴾** El mulk, 10.

Ndërsa në transmetimin e Omerit ؓ thuhet: Profeti ﷺ e ndaloi të thoshte kështu dhe i tha: Mos thuaj kështu! Njeriu me logjikë është ai që i bindet Allahut”.¹

Injoranca e qafirit është rrjedhojë e arsyeve të ndryshme si: mendjemadhësia, inati, urrejtja e të vërtetës, imitimi i verbër i të parëve, i prifërinjve dhe i klerikëve, dhënia pas dynjasë dhe kënaqësive të saj. Këto arsye nuk e justifikojnë injorancën e njeriut, përkundrazi e shtojnë gjynahun dhe kufrin e tij dhe në ditën e gjykimit do të jenë për të poshtërim dhe pendim.

Ndërsa fraza: “Jo çdo injorant është qafir” nënkupton injorancën që rrjedh si pasojë e pamundësisë për ta larguar atë. Në të tilla raste njeriu justifikohet me padije dhe shfaqësohet derisa t’i krijohet mundësia për ta larguar injorancën, nëpërmjet kërkimit të argumenteve dhe arritjen e tyre te ky person. Këtë e shpjegoam më gjerë në rregullin e parë i cili thotë: “Kufri i përgjithshëm nuk nënkupton domosdoshmërisht kufrin e një personi konkret”.



¹ Xhami’ul ahkamil kuran, Imam Kurtubiu, vëll. 17, fq. 73. Them: Prej gabimeve që janë përhapur në fjalorin e thirrësve islam bashkohorë është përshkrimi i qafirëve me logjikë apo me logjikë të shëndoshë apo thënie të ngjashme. Duket qartë se kjo është gabim sepse qafiri posedon mendje por jo logjikë.

Rregulla të gabuar të përhapur në mesin e njerëzve.

Në mesin e njerëzve qarkullojnë disa rregulla të pasaktë që lidhen me çështjet e kufirit dhe imanit. Prej këtyre rregullave:

1- Mohimi i islamit të një personi nënkupton shpalljen e tij qafir.

Kuptimi i këtij rregulli është se kushdo që vepron ndonjë vepër apo thotë ndonjë fjalë për shkak të së cilës është mohuar islami i tij në disa argumente të shariat atëhere kjo nënkupton se ai ka bërë kufër dhe se ai shpallet qafir.

Duke kërkuar më shumë rreth këtij rregulli u binda se ai nuk plotësisht i saktë. Jo çdo mohim i islamit të dikujt nënkupton se ai ka bërë kufër. Në disa raste _ose më mirë të themi në shumicën e rasteve_ mund të jetë kufër e në disa raste të tjera nuk është kufër. Rrethanat dhe dëshmitë e përcaktojnë se çfarë nënkuptohej prej argumentit.

Është saktësuar se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: ***“Nëse dy persona hyjnë në islam dhe pastaj braktisin njëri-tjetrin atëhere njëri prej tyre ka dalë prej islamit derisa të rikthehet”*** Ka për qëllim të padrejtin¹

Por bazuar në argumente të tjerë që dëshmojnë se braktisja e muslimanit është padrejtësi që nuk arrin deri në gradën e kufirit, e kuptojmë me siguri të plotë se me daljen prej islamit në hadith nuk kihet për qëllim dalja prej umetit islam por është një krahasim për të treguar se sa i madh është gjynahu i braktisjes së muslimanit.

I dërguari i Allahut ﷺ thotë: ***“Kush ndahet nga xhemati ai ka e zhveshur qaforen e islamit nga qafa e tij”***² Dihet se ndarja prej xhematit të imamit _kalifit_ nuk është kufër që të nxjerr nga islami me argumente të shumtë prej selefët të cilët nisur nga disa interpretime të tyre janë ndarë në disa çështje e megjithatë askush nuk thotë që ata kanë bërë kufër. Mirëpo nëse me fjalën “ndarje” në hadith nënkuptohej ndarja nga feja e xhematit të muslimanëve dhe bërja ridde atëhere hadithi kuptohet me pamjen e tij të jashtme.

I dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: ***“Prej kurrizit _ose pasardhësve_ të këtij njeriu kanë për të dalë një popull të cilët e lexojnë Kuranin por ai nuk e kalon fytyrën e tyre. Ata dalin prej islamit ashtu siç del shigjeta prej harkut. I vrasin muslimanët dhe nuk i lejnë politeistët. Nëse i arrij ata kam për t'i vrarë ashtu siç janë vrarë populli i Adit”***.³

Ky hadith është thënë për havarixhët, e megjithatë Ali ibn Ebi Talibi ؑ dhe selefë të

¹ E transmetojnë Bezari në musnedin e tij dhe të tjerë. Es silsiletus sahiha, 3294.

² Sahih sunen Ebi Daud, 3981.

³ E transmeton Buhariu dhe Muslimi.

tjerë nuk i konsideruan ata qafirë por i konsideruan prej fitnexhive muslimanë. Kjo nënkupton se ata nuk e kanë shpjeguar fjalën “dalin prej islamit” me kuptimin e kufrit dhe se kanë dalë plotësisht prej islamit.

Gjithashtu i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: **“Muslimani është ai prej dorës dhe gjuhës së të cilit shpëtojnë muslimanët e tjerë”**. Kuptimi i anasjelltë i hadithit nënkupton se ai person prej dorës dhe gjuhës së të cilit muslimanët nuk shpëtojnë, ai nuk është musliman. E megjithatë nuk mund të gjykojmë me kufër për atë njeri që bezdis muslimanët me dorën dhe fjalët e tij, vetëm nëse kihet për qëllim se ata nuk shpëtojnë prej tij për shkak të urrejtjes që ai ka për muslimanët në përgjithësi dhe për fenë e tyre; sepse në këtë rast hadithi kuptohet në pamjen e tij të jashtme dhe dëshmon për kufirin dhe daljen nga islami tërësisht.

Bazuar në këto hadithe dhe në hadithe të tjerë themi që ky rregull nuk është plotësisht i saktë edhe pse ai është shumë i përhapur në gojën e njerëzve dhe Allahu është më i ditur.

2- Kufri i shquar me nyjen shquese “el” nënkupton përherë kufirin e madh.

Pas disa hulumtimeve mendoj se ky rregull nuk është plotësisht i vërtetë sepse fjala “kufër” në trajtën e shquar me nyjen shquese “el” nganjëherë nënkupton kufirin e madh dhe ndonjëherë nënkupton kufirin e vogël.

Allahu ﷻ thotë: **﴿e kush nuk gjykon me atë që ka zbritur Allahu mu ata janë qafirët﴾** El maide, 44. Fjala “qafirët” ka ardhur në trajtën e shquar mirëpo selefët dhe dijetarët e tefsirit e kanë shpjeguar atë me të dyja kuptimet, me kufirin e madh dhe kufirin e vogël në varësi të realitetit të atij që gjykon.

Është saktësuar se i dërguari ﷺ ka thënë: **“Tre gjëra janë prej kufrit _në një transmetim tjetër: Tre gjëra ato janë kufri në Allah_ shqyerja e rrobave, vajtimi me gjëmë dhe mohimi i prejardhjes”**.¹ Megjithëse fjala “kufër” ka ardhur në trajtën e shquar mirëpo ajo nuk nënkupton kufirin e madh, sepse shqyerja e rrobave, vajtimi me gjëmë dhe mohimi i prejardhjes nuk konsiderohen kufër i madh me pajtimin e të gjithë dijetarëve.

Ibn Abasi ؓ është pyetur për personin që kryen marrëdhënie anale me gruan e tij dhe tha: **“Ky po më pyet për kufirin”**. Fjala “kufër” edhe këtu ka ardhur në trajtën e shquar e megjithatë askush prej dijetarëve nuk thotë se marrëdhëniet anale janë kufër i madh që të nxjerr prej islamit.

Gjithashtu fjala e profetit ﷺ: **“Mes robit dhe kufrit është lënia e namazit”**. Dhe ka thënë: **“Mes kufrit dhe imanit është lënia e namazit”**.² Edhe pse fjala “kufër” ka ardhur në

¹ E transmeton Ibn Hibani dhe Hakimi. Sahihut tergib 3525.

² Megjithatë besojmë se lënësi i namazit është qafir jo sepse fjala “kufër” ka ardhur në trajtën e shquar por sepse nuk ka argumente që të dëshmojnë se me kufirin këtu nënkuptohet kufri i vogël dhe sepse ky mendim është mendimi i shumicës së sahabëve.

trajtën e shquar mirëpo shumë dijetarë si Shafiu, Ebu Hanifja, Maliku, nuk gjykojnë me kufrin e lënësit të namazit, dhe ata nuk kanë thënë: Kufri këtu ka ardhur në trajtën e shquar prandaj ai patjetër nënkupton kufrin e madh. Kjo dëshmon se ky rregull nuk ka qënë i pranueshëm në mesin e tyre nëse supozojmë se e kanë pasë dëgjuar këtë rregull.

Bazuar në këto argumente themi se ky rregull nuk është plotësisht i saktë. Kufri nuk duhet të klasifikohet bazuar në këto rregulla të gabuara qofshin ato edhe të përhapura në mesin e njerëzve.

3- Prej rregullave të gabuara dhe të përhapura është edhe rregulli që thotë: **“Çdo kërcënim shpërblimi i të cilit është përmendur hyrja në xhehenemit përjetësisht, ai nënkupton kufrin përgjithmonë”** dhe qëndrimi në xhehenem i atij që e meriton këtë kërcënim do të jetë i përjetshëm njësoj si qafirët.

Pas kërkimeve u sigurova se edhe ky rregull nuk është i plotësisht i saktë sepse përmendja e përjetësisë në xhehenem nganjëherë nënkupton kufrin dhe qëndrimin në xhehenem njësoj si qafirët, dhe nganjëherë nuk e nënkupton këtë. Dëshmitë rrethuese e përcaktojnë kuptimin e saj.

Allahu ﷻ thotë: **«Kush e vret një besimatar qëllimisht shpërblimi i tij është xhehenemi, i përjetshëm është në të dhe Allahu është zemëruar me të dhe e ka mallkuar dhe i ka përgatitur një dënim të madh»** En nisa 93. Qëndrimi përgjithmonë këtu nuk nënkupton kufrin dhe nuk nënkupton qëndrimin e vrasësit në xhehenem njësoj si qafirët sepse të tjera argumente në shariat e mohojnë kufrin e vrasësit me qëllim i cili e njëson Allahun ﷻ.

Është saktësuar se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: ***Kush pi helm dhe vret veten ai ka për ta pirë atë në zjarrin e xhehenemit përjetësisht***.¹

Transemtohet në dy sahihat se: ***Kush e hidhet prej majës së malit për të vrrarë veten ai do të rrëzohet në zjarrin e xhehenemit përjetësisht. Kush pi helm dhe vret veten ai ka për ta pirë atë në zjarrin e xhehenemit përjetësisht. Kush e vret veten me një hekur, me këtë hekur në dorë do të godasë barkun në zjarrin e xhehenemit përjetësisht***”.

E megjithatë vetvrasja _pa kundërshtim mes dijetarëve_ nuk konsiderohet kufër dhe ai që vret veten nuk do të jetë në zjarrin e xhehenemit përgjithmonë ashtu siç do të qëndrojnë qafirët. Shefati në ditën e gjykimit e përfshin edhe atë që ka vrrarë veten, me lejen e Allahut.



¹ Sahih sunen Ebi Daud, 3280.

Çështje të ndryshme që lidhen me kufrin, imanin, premtimin me xhenet dhe kërcënimin me zjarr.

Në këtë shtojcë do të shqyrtojmë disa çështje që lidhen me kufrin dhe imanin, çështje për të cilat ndodhin keqkuptime në mesin e njerëzve:

Çështja e parë: Kuptimi i hadithit: *“Pastaj Allahu thotë: Nxirrni prej zjarrit këdo që ka iman në zemër sa pesha e një fare hardalli. Dalin prej tij të nxirë sterrë dhe hidhen në lumin e jetës dhe mbijnë ashtu siç mbin fara pranë përroit të ujit”* E transmeton Buhariu.

A do të jetë prej të shpëtuarve ai që vepron prej bazave dhe detyrave të fesë dhe imanit sa pesha e kësaj grimce?

Përgjigje: Qëllimi prej fjalës së profetit: *“ka iman sa pesha e një fare hardalli”* është pesha e punës që ka punuar përveç bazës së imanit dhe teuhidit dhe kushteve të saktësisimit të tij. Njeriu nuk konsiderohet besimtar nëse këto baza dhe kushte nuk plotësohen. Patjetër duhet ta kufizojmë kuptimin e hadithit; sepse veprat e mira sado të shumta të jenë nuk vlejné në rast se njeriu vepron shirk të madh pasi shirku i zhvlerëson të gjitha punët. Allahu ﷻ thotë: **﴿Më është shpallur mua dhe profetëve para meje se nëse bën shirk ka për t’u hedhur poshtë e gjithë vepra jote dhe ke për të qënë prej humbësve﴾** Ez zumer, 65

Dhe thotë: **﴿E nëse do të bënin shirk kishin për t’u rënë poshtë e gjitha ajo që kishin punuar﴾** El enam 88.

Nëse punët e mëdha nuk i bëjnë asnjë dobi atëhere, veprat e mira sa pesha e farës së hardallit apo misrit është më parësore të mos i bëjnë dobi, nëse është përlyer me vepra shirku. Pra imani sa pesha e një fare hardalli i bën dobi njeriut nëse ai e braktis shirkun dhe e plotëson teuhidin.

Ibn Haxheri thotë: *“Me “farën e hardallit” kihen për qëllim punët që kryhen shitesë pas plotësisimit të bazës së teuhidit, bazuar në transmetimin tjetër: “Nxirreni atë që ka thënë “nuk ka të adhurar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe ka punuar punë të mira sa pesha e një milingone”.*

Në një transmetim tjetër thuhet: *“Prej zjarrit del çdokush që ka thënë “Nuk ka të adhurar tjetër me të drejtë përveç Allahut” dhe në zemrën e tij ka mirësi sa pesha e një milingone”.*¹

Ky kuptim sqarohet më shumë prej fjalës së profetit ﷺ në hadithin e saktë: **“E kur Allahu ﷻ ta përfundojë gjykimin e krijesave dhe dëshiron që me mëshirën e tij të nxjerrë**

¹ Fet’hul bari.

këdo që dëshiron prej banorëve të zjarrit, i urdhëron melekët të nxjerrin prej zjarrit këdo që nuk i ka bërë shirk Allahut asgjë, prej atyre që dëshiron t'i mëshirojë dhe kanë thënë “Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut”. Melekët i dallojnë ata në mesin e zjarrit prej shenjave të sexhdes sepse zjarri djeg çdo gjë prej njeriut, përveç shenjave të sexhdes”. E transmeton Muslimi.

Fjala “I dallojnë ata prej shenjave të sexhdes” dëshmon se ata kanë qënë prej namazlive. Hadithi dëshmon që namazi është domosdoshmëri dhe kusht për saktësimin e imanit dhe teuhidit dhe se lënësi i tij është qafir dhe mushrik.

Kështu duhet kuptuar fjala e profetit ﷺ: *“Njerëz që nuk kanë vepruar mirësi për Allahun aspak”* pra nuk kanë vepruar punë shtesë mbi bazën e teuhidit. Këta njerëz sado pak punë të mira të kenë dhe sado shumë punë të këqija të kenë, mirëpo ata nuk e kanë humbur teuhidin sepse sikur të mos kishin teuhid nuk kishte për t'i përfshirë mëshira e Allahut dhe nuk kishin për të hyrë në xhenet.¹

Për këtë kuptim dëshmon edhe fjala e profetit ﷺ: *“Disa njerëz prej pasuesve të teuhidit do të dënohen në zjarr derisa të bëhen shkrumb e hi, pastaj do i mbërthejë mëshira e mëshiruesit dhe nxirren e hidhen te portat e xhenetit dhe banorët e xhenetit i spërkasin me ujë dhe mbijnë ashtu siç mbijnë fundërinat në llumin e rrëkeve dhe pastaj hyjnë në xhenet”*.²

Profeti ﷺ i quajti ata prej pasuesve të teuhidit. Ky hadith shpjegon qartë ato hadithe prej të cilave mund të kuptohet se njeriun do ta përfshijë mëshira e Allahut edhe nëse nuk ka vepruar asnjë vepër të mirë dhe as teuhidin ashtu siç kujtojnë dijetarët e murxhivë.

Edhe hadithi: *“Në xhenet do të hyjë vetëm një njeri musliman”*³ i përkufizon hadithet e lartpërmendura. Në një transmetim tjetër thuhet: *“O Ibn Hatab! Shko e thirr ndër njerëz: Në xhenet do të hyjnë vetëm besimtarët”*⁴ Pra vetëm njësuesit. Në një transmetim tjetër te Ebu Daudi thuhet: *“O Ibn Euf! Shaloje kalin dhe pastaj thirr: Xheneti është hallall vetëm për besimtarin”*, pra vetëm për njësuesin.

Ky është kuptimi i fjalës së Allahut ﷻ: **﴿Allahu nuk e fal t'i bëhet shirk dhe ia fal atë që është më e vogël se ai atij që dëshiron﴾** En nisa, 48, sepse Kurani dhe suneti shpjegojnë dhe vërtetojnë njëri-tjetrin.

Çështja e dytë: Është saktësuar se i dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Allahu ia ka bërë haram zjarrin atij që dëshmon se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut

¹ Es silsiletus sahiha, 2250.

² Es silsiletus sahiha, 2451.

³ E transemtion Buhariu dhe Muslimi.

⁴ E transmeton Muslimi.

dhe se Muhamedi është i dërguar i Allahut”¹.

A mjafton vetëm shqiptimi i dëshmisë së teuhidit që dikush të jetë prej banorëve të xhenetit, apo ajo është e kushtëzuar me kushte të tjera që dëshmojnë për saktësinë e teuhidit.

Përgjigje: Dije se dëshmia e teuhidit është kushtëzuar me kushte të tjera përveç kushtit të shqiptimit dhe pohimit. Nëse ato kushte nuk plotësohen atëhere ajo dëshmi nuk vlen. Prej këtyre kushteve mund të përmendim:

- Kufri në tagut.
- Dija.
- Singëriteti.
- Largimi i dyshimeve dhe bindja e plotë.
- Praktikimi i saj.
- Dashuria për të dhe për pasuesit e kësaj dëshmie.
- Pranimi i saj me kënaqësi.
- Nënshtrimi ndaj saj.
- Vazhdimësia në të.

Nëse përmbushen këto kushte, njeriut i bën dobi dëshmia e teuhidit, por me mospërmbushjen e një kushti prej tyre, njeriu nuk konsiderohet prej pasuesve të teuhidit dhe rrjedhimisht kjo dëshmi nuk i bën dobi në ditën e gjykimit.

Çështja e tretë: Çfarë domethënia ka fjala e disa dijetarëve: “Askënd nuk e shpallim qafir për shkak të ndonjë gjynahu përderisa nuk e konsideron atë të lejuar” A është kusht që dikush ta konsiderojë diçka të lejuar përpara se ta konsiderojmë qafir?

Përgjigje: Me gjynahun këtu nënkuptohen gjynahet që nuk arrijnë gradën e kufrit dhe shirkut të madh, si zinaja, vjedhja, pirja e verës etj. Këto gjynahe nuk e hedhin njeriun në kufër dhe nuk bëhet qafir, vetëm në rast se ai i konsideron ato të lejuara. Nëse i konsideron ato të lejuara atëhere bëhet qafir edhe nëse nuk i vepron këto gjynahe (sepse kufri konsiston te konsiderimi hallall i haramit). Ndërsa gjynahet që janë kufër i madh ato janë kufër në vetvete dhe kushdo që i vepron ato bëhet qafir i konsideron apo nuk i konsideron të lejuara.

Dijetarët, me këtë shprehje kanë dashur të replikojnë me havarixhët të cilët i shpallin muslimanët qafirë për shkak të gjynaheve të cilat nuk janë as shirk dhe as kufër. Mirëpo murxhitë bashkohorë i dhanë tjetër nuancë kësaj shprehje duke i dhënë kuptime për të cilat shprehja nuk dëshmon. Fatkeqësisht ata e shfrytëzuan vend e pavend këtë shprehje për interesat e tyre dhe e kushtëzuan “konsiderimin të lejuar” si kusht për të gjitha gjynahet

¹ E transmeton Muslimi.

papërbashtim përfshi edhe kufirin me shirkun e madh. Sa herë që dikush debaton me ta për kufirin e ndonjë taguti që vepron kufër të qartë fare, të hidhen duke thënë: A e beson dhe e konsideron ai të lejuar këtë kufër? A mos ja keni hapur zemrën? Ne nuk shpallim askënd qafir për shkak të ndonjë gjynahu, çfarëdo qoftë ai gjynah, derisa ta konsiderojë atë të lejuar.¹

Kjo fjalë është gabim dhe refuzohet prej Kuranit dhe sunetit. Askush prej dijetarëve të hershëm dhe të mëvonshëm nuk e ka thënë atë. Në faqet e këtij libri e shpejguam këtë pikë më gjerësisht prandaj dhe nuk po i rikthehem. Për të mënjeluar shfrytëzimin vend e pavennd të kësaj shprehje, më e mira është që shprehja kështu: **“Nuk e shpallim askënd qafir për shkak të ndonjë gjynahu që nuk është kufër përderisa nuk e konsideron atë të lejuar”**.

Çështja e katërt: A lejohet të thuhet: Kush vritet për hir të vatanit ai është shehid (dëshmor). Kush vritet për hir të umetit islam ai është shehid. Kush vritet për hir të njerëzimit ai është shehid. E të tjera shprehje të tilla që janë përhapur mes njerëzve.

Përgjigje: Falenderimi i takon Allahut zotit të botrave. Duhet të dimë se luftimi klasifikohet vetëm në dy lloje:

- 1- Luftim në rrugë të Allahut ﷻ dhe ai është çdo luftim për të lartësuar fjalën e Allahut ﷻ në tokë.
- 2- Luftim në rrugë të tagutit dhe ai është çdo luftim që nuk kryhet për hir të Allahut ﷻ. Allahu ﷻ thotë: **«Ata që kanë besuar luftojnë në rrugë të Allahut ndërsa ata që kanë bërë kufër luftojnë në rrugë të tagutit»** En nisa, 76.

Në hadithin e saktë thuhet: **“Kush lufton për të lartësuar fjalën e Allahut ai është në rrugë të Allahut”**.²

Luftimi nëse përzihet me shirk _atëhere kur një pjesë e tij është në rrugë të Allahut

¹ Prej dijetarëve që e thonë këtë fjalë është edhe vetë shejh Muhamed Nasirudin Albani _Allahu e mëshiroftë_ dhe shumë prej pasuesve të tij, kur thotë në komentimin e fjalës së Tahaviut: “Askënd nga pasuesit e kibles nuk e shpallim qafir për shkak të ndonjë gjynahu derisa ta konsiderojë atë të lejuar”: “Pra ta konsiderojë të lejuar me besim në zemër, sepse kushdo që e vepron një gjynah e ka lejuar atë me vepër. Prandaj duhet të bëjmë dallim mes atij që e konsideron gjynahun të lejuar me besim në zemër _dhe kjo është kufër me ixhma_ dhe mes atij që e vepron gjynahun vetëm me vepra i cili konsiderohet gjynahqar. Shpjeguesi i tahavijes (Ibn Abdulizz El Hanefi) e ka përcjellur fjalën e ehli sunetit se imani është fjalë dhe vepra, shtohet dhe pakësohet dhe se veprimi i çfarëdolloj gjynahi është kufër në vepra dhe jo në besim”.

Kufri në vepra sipas shejhut është kufri i vogël i cili nuk e nxjerr njeriun prej islamit.

Them: Shpjeguesi i Tahavijes nuk e ka thënë këtë që përmendi shejhu, përkundrazi ka thënë të kundërtën e saj kur thotë: “Prandaj shumë dijetarë nuk pranojnë ta thonë fjalën “Askënd nuk e bëjmë qafir për shkak të gjynahut” përgjithësisht dhe të pakushtëzuar, por thonë: “Nuk i bëjmë ata qafirë për çfarëdolloj gjynahu ashtu siç veprojnë havarihet”.

Shejhun e shtyu në këtë gabim mbrojtja e flaktë për medhebin e kotë të murxhive në disa çështje të kufirit dhe imanit. Për replikë më të zgjeruar mund t'i ktheh librit tim “Triumfi për pasuesit e teuhidit”.

² E transemtion Buhariu.

dhe një pjesë në rrugë të tagutit_ ai konsiderohet në rrugë të tagutit sepse Allahu ﷻ pranon vetëm veprat që janë të sinqerta dhe të pastra nga shirku. Allahu ﷻ nuk ka nevojë për ortak siç thuhet në hadithin kudsî: **“Allahu thotë: Unë jam ortaku më i panevojshëm për ortak. Kush punon një punë dhe më bën mua shirk kam për ta braktisur atë bashkë me shirkun e tij”**.¹

Prandaj themi: Nuk lejohet të quhet shehid ai që lufton në rrugë të vatanit, apo në rrugë të umetit sepse këto vepra duhet të jenë të sinqerta vetëm për Allahun ﷻ.

Nëse lind pyetja: Si ta përputhim ndalimin prej luftimit për hir të tokës me obligimin e mbrojtjes së tokës së islamit dhe muslimanëve? Si ta përputhim këtë mendim me hadithet që dëshmojnë se kush lufton për të mbrojtur pasurinë dhe nderin e tij ai është shehid?

Them: Nuk ka asnjë kontradiktë mes tyre. Ka dallim të themi që dikush lufton për hir të diçkaje pa e kthyer këtë çështje te Allahu ﷻ dhe mes atij që lufton për të mbrojtur diçka për hir të Allahut ﷻ dhe si bindje ndaj urdhrat të tij. Këtë të dytin e ka lejuar sheriatu islam dhe ai është adhurimi më i mirë me të cilin robi mund t’i afrohet Allahut ﷻ. Ndërsa i pari është i kotë dhe shirk sepse ai nënkupton kryerjen e veprave jo për hir të Allahut ﷻ.

Që shprehja të jetë më e qartë mund të themi: Luftojmë në rrugë të Allahut për të mbrojtur trojet dhe vlerat e islamit. Kush vritet me këtë nijet ai është shehid.

Çështja e pestë: Nëse dëshmia: “Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut”, e merr në mbrojtje edhe qafirin muharib që në origjinë është qafir, mirëpo a e merr në mbrojtje murtedin që lufton islamit.

Përgjigje: Nëse murtedi muharib ka bërë ridde të thjeshtë atëhere sipas sunetit i kërkohet të pendohet dhe i pranohet pendimi. Prandaj nëse e thotë dëshminë “Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut” ajo e merr në mbrojtje edhe gjatë luftës me kusht që ta braktisë luftimin ose ta dorëzojë armën sepse këto janë dëshmi rrethore që dëshojnë për pendimin e tij të sinqertë, ashtu siç veproi Ebu Bekri me shumë prej mutedave gjatë luftave të ridde.

Mirëpo nëse ka bërë ridde të rëndë dhe ka munduar e vrarë muslimanë dhe ka cënuar fenë, atëhere nuk është prej sunetit kërkimi i pendimit madje as nuk i pranohet pendimi nëse bie në dorë të muslimanëve. Në një rast të tillë dëshmia “Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut” nuk e merr në mbrojtje gjatë betejës edhe nëse kapet pas pëlhurave që Qabes duke kërkuar strehim. Allahu ﷻ thotë: **«Nuk do t’u pranohet pendimi atyre që kanë bërë kufër pas imanit të tyre dhe pastaj e kanë tepruar në kufër, dhe ata janë të humburit»** Ali Imran 90.

¹ E transmeton Muslimi.

Shejhul islam Ibn Tejmije thotë: “Allahu ﷻ na ka treguar se pendimi nuk pranohet prej atyre që e kanë tepruar në kurfër pas imanit të tyre dhe ka bërë dallim mes teprimit në kufër dhe kufrit të thjeshtë. E ka pranuar pendimin prej të dytit por jo prej të parit. Ai që pretendon se pendimi pranohet për çdo lloj kufri pas imanit ai ka kundërshtur teksin e qartë të Kuranit”.¹

Mëparë e përmendëm qëndrimin që mbajti profeti ﷺ me grupin nga fisi Ukal të cilët përveç riddes vodhën devetë e muslimanëve dhe vranë barinjte e tyre prandaj urdhëroi që të vriteshin dhe të mos u pranohej pendimi, dhe qëndrimin që mbajti me Ibn Hatelin _siç përmendet në sahihun e Buahriut_ kur dikush i tha: Ibn Hateli është varur në mbulesën e Qabes duke kërkuar mbrojtje i penduar por i dërguari i Allahut u tha: “Vriteni”.

Të njëjtin qëndrim mbajti edhe Ebu Bekri ؓ kur dogji me zjarr personat që bënë ride, dezertuan dhe vodhën pasuritë dhe devetë e muslimanëve të cilat i kishte planifikuar për luftimin e murtedëve dhe nuk e pranoi pendimin e tyre.

I njëjti qëndrim duhet mbajtur me zendikat dhe murtedët të cilët nga njëra anë shtiren me islam dhe nga ana tjetër propagandojnë kufirin e pastër. Pendimi i tyre pasi të bien në duart e muslimanëve nuk duhet të pranohet.

Shejhul islam Ibn Tejmije thotë: “Bëhet dallim mes riddes së thjeshtë ku vritet vetëm pasi t’i kërkohet pendimi dhe mes riddes së rëndë ku vritet dhe nuk i kërkohet pendim”.²

Nëse thuhet: Atyre që nuk u është pranuar pendimi për shkak të rides së rëndë ata nuk kanë qënë në fushën e betejës, themi: Në fushën e betejës kemi një arsye më shumë për të mos ua pranuar pendimin. Dhe Allahu është më i ditur.



¹ Es sarim el meslul, 368.

² Mexhmu’ul fetaua, vëll. 20, fq. 103.

PROLOG

O kërkues i dijes! Ja ku janë përpara teje rregullat e tekfirit prandaj përpiku t'i studiosh dhe t'i kuptosh drejt. Bëj shumë kujdes se mos punon me disa prej tyre dhe neglizhon disa të tjera që të mos humbasësh vetë dhe të mos humbasësh të tjerët. Atë që një rregull e thotë përgjithësisht, një rregull tjetër mund ta kufizojë. Atë që një rregull e thotë shkurtimisht një rregull tjetër mund ta qartësojë. Atë që një rregull e pengon, një rregull tjetër mund ta lejojë. Prandaj ai që dëshiron të shpëtojë nga gabimet duhet të punojë me të gjitha rregullat sëbashku, pa anashkaluar asnjërin prej tyre.

Shumica e atyre që kanë rënë në ekstrem apo tolerim të tepruar, janë bazuar në disa rregulla dhe kanë anashkaluar shumë të tjerë. I mëshojnë fort një rregulli të caktuar, ndërsa rregullat e tjerë nuk i marrin parasysh, dhe mbi këtë një apo dy rregulla i bazojnë të gjitha çështjet e kufirit dhe të imanit. Prandaj herë anojnë nga ekstremi dhe herë nga tolerimet e murxhive.

Shumë prej rasteve të paqarta të cilat kanë nevojë për njohjen e gjykimit të sheritit në mënyrë të sigurtë, kanë nevojë që të zbatohen për to më shumë se një rregull, në mënyrë që t'ia qëllosh gjykimit të shariatit për ato raste të paqarta. Këtë gjë ka mundësi ta kryej vetëm ai që i ka përvetësuar mirë rregullat e tekfirit dhe kufizimet e tyre.

Më përpara këshilluam dhe prapë po e përsërisim këshillën: Çështjet e kufirit dhe të tekfirit mund të jenë të qarta dhe shumë të padiskutueshme të cilat nuk kanë nevojë për shumë përpjekje dhe hulumtime, por mund të jenë edhe të paqarta dhe të diskutueshme në disa aspekte dhe kanë nevojë përpërpjekje dhe përputhje të rregullave dhe argumenteve me njëra-tjetrën, në mënyrë që të arrijmë në një gjykim që përputhet sa më shumë me shariatin.

Ndërsa çështjet që janë të qarta dhe të padiskutueshme ato u takojnë edhe masave të gjëra, për ti mësuar dhe për të sqaruar gjykimin e Allahut rreth tyre. Nuk është e udhës që të pengohen njerëzit dhe t'u thuhet: Konsiderimi i qafirave si qafira nuk është kompetencë e jote; mos u merr me këtë punë; kjo është kompetencë vetëm e dijetarëve Këto fjalë janë të pabaza dhe bien ndesh me detyrën e mohimit të tagutëve dhe tekfirit të tyre dhe të adhuruesve të tyre sëbashku me distancimin prej tyre.

Si do të ketë mundësi muslimani ta praktikojë akiden e miqësisimit dhe të distancimit në lidhje me qafirët mushrikë?! Si ta praktikojë akiden e mohimit të tagutëve zullumqarë në formën e duhur?! Ndërkohë që në anën tjetër e detyrojmë atë të mos i bëjë tekfir askujt sepse ai nuk është dijetar dhe nuk flet dot me siguri për tekfirin e tyre; sepse ai nuk di të dallojë mes qafirët dhe muslimanit!!

Si t'i kërkojmë atij të praktikojë fenë e Ibrahimit ﷺ, ashtu siç ka thënë Allahu ﷻ **«Keni pasur shembullin më të mirë te Ibrahim dhe ata që ishin me të, kur u thanë popullit të tyre: Ne jemi distancuar prej jush dhe prej asaj që adhuroni përveç Allahut. Ju kemi kundërshtuar ju dhe mes nesh dhe mes jush është shfaqur armiqësia dhe urrejtja përgjithmonë derisa të besoni në Allahun një dhe të vetëm»** El mumtehine 4, ndërkohë që ne besojmë se ai e ka të pamundur t'i dallojë keqbërësit dhe ato gjëra që adhurohen përveç Allahut. Kjo është e pamundur dhe është bashkim i dy të kundërtave njëkohësisht.

Kjo përsa i takon kufrit të qartë dhe të padiskutueshëm. Por nëse kufri është i dyshimtë, mund të interprehetohet me forma të ndryshme, nga një aspekt mund të jetë kufër po nga një aspekt tjetër mund të kuptohet ndryshe, atëherë kjo ka nevojë për ixhtihad, për njohuri në dispozitat e fikhut dhe për devotshmëri dhe ka nevojë për njohjen e rregullave dhe të argumenteve përkatëse. **Për këtë lloj i ndalojmë masat e gjëra të futen në të përveç nëse pyesin dijetarët dhe të diturit** dhe kjo për dy arsye:

E para: Mosbërja tekfir ndaj tyre nuk shkakton ndonjë shkelje në aspektin e sheriatit dhe as që do të merren në përgjegjësi se përse nuk u keni bërë tekfir apo nuk keni gjykuar për atë peson realiteti i të cilit është i tillë. Kjo në dallim nga mosbërja tekfir ndaj atij personi kufri i të cilit është shumë i qartë dhe i padiskutueshëm sepse në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje të sheriatit që merret në përgjegjësi.¹

E dyta: Mundësia e gabimit në raste të tilla është më e madhe dhe pasojat që rrjedhin prej këtij gabimi janë të rrezikshme dhe të papëlqyeshme. Këto pasoja janë më të këqija se pasojat e gabimit në gjykimin ndaj qafirit me islam. Prandaj kemi thënë dhe themi se duhet kthyer te dijetarët për çështjet që janë të paqarta dhe nuk duhet të flasin përpara tyre duke dhënë gjykime.

Mos harro o rob i zotit, se ekstremi gjen shije dhe dashuri të shpirti i dobët dhe i sëmurë dhe po kështu edhe neçlizhenca dhe irxhaja. Këto janë dy shtegjet e shejtanit për të depërtuar të shpirti i sëmurë. Nëse nuk ka sukses nga shtegu i ekstremimit dhe i egzagjerimit në fe atëherë i orvatet nga shtegu i neglizhencës dhe irxhasë dhe tolerimit të tepruar, duke ja zbukuruar atë. Në dallim nga rruga e mesme e cila nuk anon as nga egzagjerimi dhe ekstremizimi dhe as nga irxhaja dhe anashkalimi e cila është e vështirë për të sëmurin por e dashur për besimtarin e drejtë i cili ia ka mbyllur portat shejtanit, sepse ajo është rruga e vërtetë të cilën Allahu e pëlqen.

¹ Paqartësitë dhe mundësitë e shumta që lidhen me kufirin e paqartë janë relative. Ajo që është e paqartë për dikë, mund të jetë shumë e qartë për dikë tjetër, sepse secili di prej realitetit të personit atë që nuk e di tjetri. Në këtë rast këta të dy duhet të arsyetojnë njëri-tjetrin në lidhje me personin përkatës dhe konkret dhe të mos akuzojnë njëri-tjetrin me akuzat dhe ofendime dhe të mos nxitojnë të bëjë tekfir mbi njëri-tjetrin, siç veprojnë disa injorantë të cilët nuk friksohen për fenë e tyre dhe nuk i peshojnë gjërat në mendjet e tyre.

E lusim Allahun e lartë të na forcojë dhe të na dhurojë përfundim të mirë dhe të na bëjë prej njerëzve të drejtë dhe të mesëm, sipas rrugës së profetit Mustafa dhe të shokëve të tij bujarë, pa anim nga ekstremi dhe as nga irxhaja toleruese. Me të vërtetë ai është dëgjues i lutjeve, i afërt dhe u përgjigjet atyre.

Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi profetin, mbi familjen e tij dhe shokët e tij.

Rishikimi i këtij libri përfundoi në mëngjesin e datës 13.3.1424h që përkon me datën 14.3.2003 dhe falenderimi i takon Allahut zotit të botrave.

Abdulmunim Mustafa Halime

Ebu Basir Tartusi.

PASQYRA E LËNDËS

Parathënie	6
Hyrje	11
Terma dhe kuptime që lidhen me kërkimin	11
1- Kufri	11
2- Shirku	17
3- Fisku	20
4- Dhulmi	22
5- Nifaku	26
6- Zendeka dhe zindiku	31
7- Ridja	33
8- Epshi	38
9- Miqësimi	41
10- Imani	48
Rregulla rreth tekfirit	
Rregulli i parë: Kufri i përgjithshëm nuk nënkupton domosdoshmërisht shpalljen qafir të një personi të caktuar	62
Thëniet dhe konsensusi i dijetarëve rreth këtij rregulli	67
Pengesat e shpalljes qafir të një personi të caktuar	68
1- Mosarritja e tekseve të shariatit	70
2- Keqinterpretimi i tekseve të shariatit	72
3- Kur është akoma i ri në islam	75
4- Jetesa në krahina të largëta	76
5- Gabimi i paqëllimtë	78
6- Ixhtihadi	79
7- Imponimi	82

8- Shaqja e kufrit për të larguar një kufër më të madh dhe më të rëndë	84
9- Veprat e mira	90
Kushtet për shpalljen qafir të një personi konkret	91
1- Mosekzistimi i asnjë pengese prej pengesave të tekfirit	91
2- Sigurimi dhe vërtetimi	91
3- Sqarimi i argumentit	92
Një kusht i pavlerë	93
Rregulli i dytë: Përbushja e premtimit dhe vonimi i kërcënimit	94
Pengesat që pengojnë prej dënimit	96
1- Veprat e mira	96
2- Sprovat dhe musibetet	100
3- Pendimi dhe kërkimi i faljes	101
4- Shefati (ndërmjetësimi)	102
5- Dënimi me had	106
Rregulli i tretë: Kënaqja me kufër konsiderohet kufër	107
Shenjat që dëshmojnë për kënaqësinë dhe besimin	111
Shenja me fjalë	115
Shenja me vepra	116
Rregulli i katërt: Çdo pengesë për shpalljen qafir konsiderohet pengesë edhe për dënimin, por jo çdo pengesë prej dënimit konsiderohet pengesë për tekfirin	134
Rregulli i pestë: Për kufrin dhe imanin, merret në konsideratë pamja e jashtme	142
Rregulli i gjashtë: Shqiptimi i kufrit është kufër dhe veprimi i kufrit është kufër	157
Çështja e lënësit të namazit	171
Rregulli i shtatë: Përcaktimi i një kufri si kufër i vogël në vepra bëhet vetëm me argument dhe dëshmi nga sheriati	174
Rregulli i tetë: Kush e konsideron haramin të lejuar dhe hallallin të ndaluar ai ka bërë kufër	185
Çështje që lidhen me kufrin e lejimit	198
Fjalë të zgjedhura prej Sejid Kutbit rreth bindjes dhe ligjëvënies	211

Rregulli i nëntë: Islamin e qartë e rrëzon vetëm kufri i qartë	217
Çështja e ndalimit dhe sigurimit	226
Rregulli i dhjetë: Në konsideratë mirret përfundimi i punëve	230
Çështje që lidhen me rregullin	234
Rregulli i njëmbëdhjetë: Kush e bën qafir një musliman ai ka bërë kufër	247
Rregulli i dymbëdhjetë: Kush nuk e bën qafir qafirin ose dyshon në kufrin e tij ai ka bërë kufër	252
Pyetje që lidhen me këtë rregull	256
Rregulli i trembëdhjetë: Lënia e çdo kushti të imanit është kufër dhe lënia e çdo kufri është kusht për saktësinë e imanit	272
Rregulli i katërbëdhjetë: Çdo qafir konsiderohet injorat por jo çdo injorant konsiderohet qafir	275
Rregulla të gabuar të përhapur në mesin e njerëzve	277
1- Mohimi i islamit të një personi nënkupton shpalljen e tij qafir	277
2- Kufri i shquar me nyjen shquese “el” nënkupton përherë kufrin e madh	278
3- Çdo kërcënim shpërblimi i të cilit është përmendur hyrja në xhehenemit përjetësisht, ai nënkupton kufrin përgjithmonë	279
Çështje të ndryshme që lidhen me kufrin, imanin, premtimin me xhenet dhe kërcënimin me zjarr	280
Prolog	286
Pasqyra e lëndës	289